Mathieu Aref

SHQIPËRIA

(Historia dhe gjuha)

Odiseja e pabesueshme e një populli parahelen

Plejad

Të gjithë autorët e lashtë, ndër të cilët Homeri, smHesiodi, Hekate i Miletit, Akusiliaos, Hellanikos, Herodoti, Tuqididi ose Efori, na bëjnë të ditur shkurtimisht, por mjaftueshëm, se, përpara mbërritjes së grekëve, vendi që do të bëhej Greqi ka qenë i banuar nga Pellazgët. Ata, gjithashtu, pohojnë se këta Pellazgë nuk ishin Grekë, por "barbarë", d.m.th. nuk flisnin greqisht dhe, së fundi, se ata u lanë trashëgim grekëve një pjesë të madhe të kulteve dhe të perëndive të tyre. Asgjë më shumë se kjo nuk do të mjaftonte për të na bindur, se përpara mbërritjes së helenëve ka ekzistuar një qytetërim i madh jo-grek. Është kuptimi i kësaj fjale të famshme -"mbërritje"- të cilën nuk e kanë kuptuar mirë të gjithë autorët modernë. Është thënë gjithçka kundër kësaj teme. Deri në zbulimin e tabelëzave të mbiquajtura mikeniane, "të deshifruara" nga Ventris dhe Kadvik, kishte shumë dyshime për to. Por, qysh kur këta dy dijetarë shpallën se Lineari B mikenian ishte në greqishten e vjetër, gjithçka u përmbys në favor të tezës së vijimësisë së dy qytetërimeve (mikeniane dhe greke), dhe kjo pavarësisht katër shekujsh heshtjeje tërësore. Këtë teori po e zbuloj me argumente, për ta vërtetuar në mënyrë që askush të mos dyshojë që ajo çfarë u quajt mikeniane nuk ishte gjë tjetër veçse pellazgjishtja e lashtë (gjuha), nga e cila ka dalë pjesërisht greqishtja e lashtë.

Mathieu Aref

SHQIPËRIA

(Historia dhe Gjuha)

ose odiseja e pabesueshme e një populli parahelen

Përkthyer nga:
Iliriana ANGONI

Plejad

Titulli origjinalit:
ALBANIE (Histoire et langue)
ou l'incroyable odyssèe d'un peuple prèbellènique

Botimi i parë:
Plejad 2007

© Plejad

Përkthyer nga:
Iliriana ANGONI

Redaktor:
Dilaver BAXHAKU

Arti grafik:
Agron SEJAMINI

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Mathieu, Aref SHQIPËRIA (Historia dhe Gjuha)
ose odisea e pabesueshme e një populli parahelen/Mathieu Aref;
përkth. Iliriana Angoni - Tiranë
Plejad, 2007
608 f; 21 cm
Titulli i origjinalit: Albanie (Histoire et langue)
ou l'incroyable odyssèe d'un peuple prèbellènique
ISBN 978-99943-903-9-7

TABELA E LËNDËS

Parathënie 5

I. HISTORIA E LASHTË: STËRGJYSHËRIT E SHQIPTARËVE
- Pellazgët parahelenë ose zgjidhja e një enigme 11
- Homeri dhe poemat e para epike 54
- Thrako - Ilirët : stërgjyshërit e drejtpërdrejtë të shqiptarëve 66
- Kronologjia e parahistorisë së Europës 95
- Kronologjia e Greqisë arkaike, klasike, helene 99
- Kronologjia e botëve egjeo-kretase dhe mikeniane 101
- Kronologjia e Italisë së lashtë 103

II. SHQIPËRIA
- Historia mijëvjeçare 106
- Shqiptarët e Mesjetës deri në shekullin XX 119
- Shqipëria : aspekt i përgjithshëm 131
- Aspekti etno - kulturor 137
- Folklori 147
- Kronologjia iliro - shqiptare 171
- Kosovarët dhe serbët 196
- Histori e shkurtër e sllavëve të jugut 208

III. GJUHËSIA
- Pellazgët dhe gjuha e tyre 229
- Gjuha : paraqitje dhe mendime të përgjithshme gjuhësore 239
- Indo- europianizmi 252

- Përputhjet gjuhësore pellazgo – shqipe..... 283
- Homografet dhe homofonet te Homeri..... 338
- Përputhjet pellazge dhe thrako – ilire..... 345
- Ndikimi i pellazgjishtes së lashtë mbi gjuhën greke, latine dhe gjuhët e tjera..... 356
- Toponime dhe oronime..... 368
- Fjalë të vjetra të tipit të përgjithshëm..... 380
- Fondi i vjetër pellazg dhe leksikologjia e tij..... 410
- Pellazgo – shqipja..... 433
- Ndikimet e nënshtresës pellazge (mbi gjuhën baske, armene, anglo – saksone, kelte e gjermanike)..... 478
- Pellazgo – shqipja dhe greqishtja..... 481
- Pellazgo – shqipja dhe latinishtja..... 502
- Pellazgo – shqipja dhe etruskishtja..... 515
- Pellazgo – shqipja dhe thrako – ilirishtja, mesapishtja..... 523
- Pellazgo – shqipja dhe kelto – gjermanikja, letonishtja, lituanishtja dhe rumanishtja..... 533
- Pellazgo – shqipja dhe ndërfutje të ndryshme..... 545
- Baskët dhe gjuha e tyre..... 561

IV. BIBLIOGRAFI

V. HARTA, FOTOGRAFI

PARATHËNIE

Ky libër do të befasojë shumë lexues. Ai nuk nguron të ndërmarrë një qëndrim krejt të kundërt ndaj asaj, që, me sa duket, është një e vërtetë e ndërtuar. A mos ka qenë i mbivlerësuar vendi i Grekëve në historinë e Gadishullit Ballkanik dhe, me sa duket, vetvetiu e pa nxjerrë pikëpyetje, ne jemi mësuar ta ngjisim deri në periudhën Mikeniane e madje edhe më tej dhe ta vendosim pothuajse natyrshëm si të ketë qenë faktori thelbësor i historisë së këtij rajoni? Të varur, pas shumë shekujsh kulture klasike, nga imazhi që Helenët i japin së kaluarës së tyre, a mos, për shkak të tyre, kemi harruar se kultura të tjera, të cilat nuk ishin aspak Greke, kanë ekzistuar në këtë pjesë të Europës dhe mund ta kenë ndihmuar atë, duke i dhënë fizionominë që tashmë është e saja, pikërisht në momentin kur "mrekullia greke" shfaqi një qytetërim, trashëgimtarë të të cilit, në shumë aspekte, ne ende jemi? Ka një farë kohe, që një hulumtues amerikan i është vënë kësaj përçapjeje ikonoklase: kjo ne na ka kushtuar një libër të bujshëm "Athina e zezë", ku perëndesha e bardhë me sy ngjyrë deti, Perëndesha e diturisë, mbrojtëse e Athinës, ka një të kaluar afrikane dhe ku helenizmi papritmas e gjen veten borxhli ndaj pjesësh të tëra të qytetërimit në Egjipt ose në Feniki.

Në këtë vepër, Aref Mati hulumton në një tjetër drejtim dhe ravijëzon një botë tjetër, atë Pellazge, së cilës Grekët i detyrohen për një pjesë jo të vogël të së kaluarës së tyre. Por kësaj here ajo nuk duhet kërkuar jashtë apo matanë deteve, ajo duhet të ketë qenë aty, në Ballkan, përpara Grekëve, dhe këtyre, kur mbërritën, nuk u mbeti gjë tjetër veçse të depërtonin e të merrnin atë çfarë ajo u ofronte.

Duke mbrojtur këtë vizion të së kaluarës më të lashtë të Greqisë, Aref Mati, në thelb, nuk bën gjë tjetër veçse përsërit atë që grekët, apo të paktën ata më mendjemprehtët, e kanë thënë qysh prej shumë kohësh midis tyre. Sigurisht që për ata ka qenë më e përshtatshme, që në sytë e athinasve të epokës klasike të thonë se Grekët kanë qenë gjithmonë aty, se ata kanë qenë autoktonë në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, d.m.th. pasardhës të të moçmëve, që kishin lindur aty qysh në kohë që nuk mbahen mend, nga toka e vetë Atikës, ashtu si bimët që toka e saj pjellore i bën të lulëzojnë. Por ata që i kapërcyen këto përfaqësime dashamirëse mitike, si historiani Herodot, e dinin se historia e së kaluarës së rajonit nuk ka qenë një kalim i thjeshtë dhe në vijë të drejtë, i cili, duke u nisur nga zanafillat, e përfundonte pa diskutim vijimësinë për bashkëkohësit e tij. Evokohet për Athinën, por edhe për shumë vende të tjera, një popullsi e lashtë më e kahershme se banorët aktualë, që ishte popullsia Pellazge. Dhe ata që kanë shqyrtuar identitetin e këtyre Pellazgëve ishin më se të detyruar që ta njihnin faktin se ata nuk ishin Grekë dhe se nuk mund të ishin Grekë. Sipas një arsyetimi mbi gjuhën, që ata mund të kenë folur, Herodoti arrinte në përfundimin se ata ishin barbarë, një rrjedhim sipas kuptimit të mirëfilltë të nocionit gjuhësor, pse ata flisnin një idiomë tjetër, të ndryshme nga greqishtja. Por, gjithashtu, është pranuar se këta barbarë, (barbarë meqenëse prirja ka qenë që të shihnin tek ta vetëm njerëz të egër pa asnjë qytetërim), pra gjithsesi këta kishin jetuar në tokën e tyre dhe mund të kenë patur

ndikim dhe t'i kenë dhënë Grekëve pasardhës elemente jo të pakta nga kultura e tyre. Kuptohet që këta Grekë do ta kenë damkosur Herodotin për tradhti ndaj helenizmit dhe do ta kenë denoncuar për dashaligësinë e tij - gjë do të bëhet objekt i një trajtese të vogël të Plutarkut - e cila e shtyn atë të njohë cilësitë e barbarëve, dhe kjo, sipas atyre, i zhvlerëson bashkëpatriotët. Por Herodoti ka patur shumë të drejtë : Grekët nuk kanë qenë të parët mbi këtë tokë dhe, nëse ka patur të tjerë më parë, atëherë është më se e qartë se u detyrohen atyre për një pjesë të rëndësishme të qytetërimit. Kërkimet e gjuhëtarëve të kohëve tona mbi greqishten - duke cituar vetëm këta - e tregojnë gjerësisht, se : gjuha greke, kjo gjuhë që përcaktonte helenen kundrejt barbarëve, duke përfshirë shumë terma, që nuk janë aspak greke, të cilat përcaktohen, për shembull, si parahelene dhe që emërtojnë krejt florën dhe faunën mesdhetare, që Grekët i kanë zbuluar duke mbërritur në tokën e Heladës. Kjo mund të thuhet edhe për termat para-indo-europiane, të cilat të çojnë drejt asaj që mund të trajtohet si një nënshtresë e lashtë e popujve të vendosur në rajon përpara se folësit indo-europianë - si p.sh. grekët - të fillonin të përhapeshin aty. Këto mund të jenë edhe fjalë të shpjegueshme nëpërmjet indo-europianes, por që nuk i përkasin fjalorit grek dhe nuk paraqesin trajtime fonetike të pritshme për këtë gjuhë. Dhe, pikërisht këtu, ne gjejmë të famshmit pellazgë, për të cilët flet tradita : megjithëse nganjëherë është dashur, që, nga ndonjë përçapje jo e bazuar, ta përcaktojnë me termin pellazg këtë shtresë gjuhësore, indo-europiane, por jo greke, dhe e cila mund të të kthejë sërish në popullsi të vendosura në këto vise, të cilat tashmë do të kenë përdorur një të folur të tipit indo-europian, por që nuk do të ketë qenë helene.

Vepra e Aref Matit ngulitet në vijimësinë e këtij hulumtimi dhe nuk është pa paraardhës shkencorë. Ashtu si edhe ata, ai hulumton këtë pjesë jo të vogël, kundrejt asaj që është greke që e fsheh helenizmin, këtë pjesë tjetër pa të cilën nuk do të kishte patur mrekulli greke. Por

këtë ai e bën qartë, duke propozuar një tezë: se duhen bërë vrojtime nga ana e Shqipërisë për të kuptuar këta pellazgë misteriozë, për të konceptuar atë çfarë kanë zbuluar këta grekë duke mbërritur në Heladë dhe që i bëri ata ashtu si ata u bënë. Kjo mund të të habisë. Çfarë mund të ketë qenë e përbashkët, të cilën Herodoti e quante të rëndësishme, midis këtyre paraprijësve të grekëve në tokën e vendit të tyre dhe këtij populli të sotëm, pra shqiptarëve, që aktualiteti i mëvonshëm e bëri të dalë në problematikën e francezëve? Shqiptarët në sytë tanë na janë dukur si një nga popujt dytësorë në kufijtë e kombeve të mëdha, të cilët bënë historinë. Dhe, megjithatë, a nuk janë rrënojat e këtyre ilirëve që kanë pushtuar Ballkanin në antikitet, por që në ndryshim me grekët apo latinët – si të thuash nuk na ka lënë asnjë dëshmi të drejtpërdrejtë mbi gjuhën e tyre dhe që vetëm arkeologjia – mjaft e zhvilluar në Shqipëri pas Luftës II botërore - fillon ta nxjerrë nga errësira? Sigurisht që gjuha e sotme shqipe ka evoluar shumë qysh prej kohëve antike; sigurisht që vendi, megjithëse ka qenë fanatik në ruajtjen me krenari të personalitetit të tij përballë racave të tjera, është përballur me vizitorë të shumtë njëri pas tjetrit apo edhe me pushtues të shumtë. Por nuk është e papërligjur që të përpiqesh të nxjerrësh gjithçka sa mundesh për të njohur Shqipërinë, qytetërimin e saj, gjuhën e saj, nga e cila arrijmë të sqarojmë këtë të kaluar ballkanike që na ka shpëtuar. Por lipset ta njohësh edhe më këtë vend dhe, madje do të thoja, ta dashurosh atë. Ndërkohë që kjo njohje dhe kjo dashuri për vendin e shqiponjave nuk i mungon Aref Matit, sepse edhe ai vetë është me zanafillë shqiptare.

Aref Mati e njihte shumë mirë gjuhën shqipe. Kjo mund të duket e thjeshtë, por nuk është kështu: njohja e gjuhës shqipe nuk është shumë e përhapur në Francë, as në vendet e tjera europiane. Pothuajse kurrë, asnjëri prej atyre që kanë patur prirje ndaj historisë antike të Gadishullit Ballkanik nuk e ka praktikuar këtë gjuhë: në propozimet e tyre ata nuk e kanë futur këtë fakt për të rindërtuar të kaluarën. Mbi të gjitha,

gjuha shqipe a mos është një gjuhë për të cilën na jepet e drejta të quhet si "e mëvonshme" përbri greqishtes dhe latinishtes, të dëshmuara mjaft mirë për Antikitetin, dhe kjo deri aty sa ne të rrezikojmë të harrojmë se ka patur krah tyre, dhe në rastin konkret përpara tyre, popuj që flisnin gjuhë të tjera, por ndër këto gjuhë, gjuhët e emërtuara "barbare" sot ne të mos mundemi t`i arrijmë? I tillë është rasti në veçanti për këta ilirë : për të krijuar një ide për të folurën e tyre nuk ka mënyrë tjetër, veçse duke u orvatur të ngjitemi në vazhdën e kohërave, duke u nisur nga gjuha e sotme shqipe, për t`u përpjekur të rigjejmë në gjurmët gjuhësore që mund të vlerësohen si të lëna nga ilirët, si dhe në veçanti në emrat e përveçëm ose emrat e vendeve që ne njohim për hapësirën gjeografike ku ky popull ka banuar (i cili ka mundur madje të shtrihet matanë zonës së populluar nga ilirët e epokës klasike të grekëve ose të epokës romake, gjë që është e mundur të sqarohet nëpërmjet gjuhës shqipe). Metoda gjuhësore duhet të jetë rigoroze : ajo duhet të krijojë lista termash dhe të ravijëzojë etimologjinë e tyre. Prej nga edhe rrjedh një aspekt kategorik, që është i nevojshëm për një pjesë të veprës, pjesë që paraqitet në formën e listës së fjalëve, bashkë me interpretimin që është propozuar për ato. Gjithsesi, kjo është një përçapje e nevojshme dhe mund të ngazëllejë që një dokumentacion i tillë tashmë është ofruar dhe është futur në debatin shkencor.

Por ka edhe pjesë të tjera, ku Aref Mati trajton historinë e vendit të tij, të zakoneve të tij. Dhe këto përbëjnë faqet nga më tërheqëset të kësaj vepre, ato më pasionantet, ku autori na përshkruan vendin, na bën të kuptojmë gjeografinë e tij plot kontraste, na kujton historinë e tij drithëruese, na bën të marrim pjesë në një festë vendase ose të admirojmë zakonet e kësaj apo asaj krahine. Kjo, ndoshta, mund të duket sikur qëndron shumë larg një përçapjeje historike, një hulumtimi mbi historinë më të lashtë të kësaj pjese të Europës, e cila mund të dalë nga një dijetar me mendje të ftohtë, që punon në qetësi dhe në heshtje

në kabinetin e tij. Por, ashtu siç e shpjegon shumë mirë Aref Mati, përçapja shkencore nuk mund të jetë e njëjtë për sektorët, në të cilët ne jemi aq mirë të dokumentuar, si Greqia ose Roma e lashtë, si dhe për këtë botë të pjesës së brendshme të Gadishullit Ballkanik, mbi të cilin burimet tona janë të rralla - dhe jo gjithmonë të informuara mirë.

Historiani duhet të shndërrohet në gjeograf, në gjuhëtar, në folklorist dhe në shumë specialitete të tjera, nga të cilat secila sjell dritën e saj dhe mundëson për të arritur në siguri absolute, pa dyshim jo pa u gabuar, por të paktën për të ngritur njërin cep të mbulojës – dhe për të arritur të shohësh se përkrah qytetërimeve klasike kanë ekzistuar edhe popuj të tjerë, të cilët kanë patur edhe ata vendin e tyre në histori. Është ky thelbi i veprës së Aref Matit për Shqiptarët dhe stërgjyshërit e tyre të lashtë. Ne nuk na mbetet gjë tjetër, vetëm t'i urojmë të japë ndihmesën e tij për të ngjallur interesin dhe dashurinë për një vend, që ende mbetet tejet i panjohur.

DOMIINIK BRIKEL
(Dominique Briquel)
Profesor në Universitetin e Parisit - Sorbonë

I.

HISTORIA E LASHTË:
STËRGJYSHËRIT E SHQIPTARËVE

PELLAZGËT PARAHELENË
OSE ZGJIDHJA E NJË ENIGME

Falë disa autorëve të lashtë, ndër ta Homeri, Hesiodi, Hekate i Miletit, Helanikos i Mitilenit apo Herodoti, arrihen të njihen më mirë Pellazgët; banorët e parë të botës ballkano-danubiane si dhe të Egjeut, që ishin aty përpara mbërritjes së Grekëve. Pra, duke u nisur nga shkrimet e tyre, kam arritur të rindërtoj rebusin e zanafillave të popujve parahelenë, të shkoj shkallë-shkallë deri në vetë burimet e qytetërimit helen dhe të dekriptoj prurjen kulturore të semito-egjiptianëve (Danaos, Kadmos...). Së fundi, kjo më ka dhënë mundësinë të bëj ravijëzimin e veprës që keni në dorë, pikësynimi i së cilës është të provojë për këtë popull pellazg, çfarë tashmë është zbuluar nga autorët e lashtësisë, dhe, si rrjedhojë, për të mbështetur tezën e paraekzistencës së Pellazgëve kundrejt Helenëve të parë, ky i fundit popull semito-egjiptian, i cili pushtoi vendin e tyre (Danaos Egjiptiani dëbon nga Argosi, Pellazgët dhe mbretin e tyre Pelasgos ; themelimi i Tebës nga Fenikasi Kadmos ; pushtimi i Peloponezit nga Asiriani Pelops etj.).

Kështu, për të përcaktuar problemin e zanafillave të qytetërimit grek dhe, me pikësynimin për të sjellë sqarimet e nevojshme, të përcaktuara nga provat dhe argumentet përkatëse, unë kam kryer

studime të shumta, hulumtime dhe analiza të hollësishme në pesë fusha të ndryshme: Histori, Arkeologji, Antropologji, Gjuhësi, Mitologji/ poemat epike. Secila prej këtyre fushave ndihmon njëra-tjetrën.

Deri më sot, pjesa më e madhe e dijetarëve të lidhur me këto fusha janë të të njëjtit mendim, të paktën për një fakt të vetëm, por fakt thelbësor: katër shekuj të errët të Greqisë parahelene (vitet 1200–800 para Krishtit) në të vërtetë nuk na kanë lënë gjurmë në letërsinë e shkruar apo mbetjet e rrënojave, nuk na bëjnë të ditur ndonjë gjë për historinë e kësaj periudhe. Katër shekuj heshtje dhe një shkëputje e vërtetë me qytetërimin (grek) pasues: këtu historia ka ngelur në vend. Për pjesën që mbetet, kundërshtitë lulëzojnë.

Kjo hamendësohet, ose, ndonjëherë midis rreshtash, arrin të zbulosh apo të dekriptosh qartë këtë apo atë tregues ndër shkrimet antike (Homeri, Hesiodi, Hekate, Hellanioni, Herodoti ose Tuqididi ...). Pra, më është dashur të lundroj nëpër ujëra të turbullta, duke u përpjekur që në magmën e shkrimeve të ndryshme, studimeve dhe pjesës tjetër të mbetur materiale, të zbuloj treguesin më të vogël ndriçues dhe verifikimin e saktësisë së tij, ose për të zhbiruar kontradiktat e shumta dhe të ndryshme, polemikat, pavërtetësitë apo manipulimet që piketohen në shkrimet e shumta të lashtësisë, madje edhe në ato të kohës sonë.

Në të vërtetë, shumë shekuj të mbetur në heshtje e ndajnë fundin e qytetërimit të mbiquajtur Mikenian (datë e hamendësuar e luftës hipotetike të Trojës 1193-1183 para Krishtit) dhe qytetërimit që kanë njohur Grekët, duke filluar nga fundi i shekullit VII para Krishtit, por që e pati kulmin e tij vetëm në shekullin V (shekulli i artë i Perikliut). Duhet shënuar për fillestarët se emri Mikenian, i cili i është dhënë një qytetërimi më të mëparshëm se ai i Grekëve, është një shpikje moderne, që daton qysh me zbulimet arkeologjike të kryera në "Mikenë" nga Shlieman (1822-1890). Gjithsesi, as në tabelëzat mikeniane, as në poemat homerike nuk gjenden gjurmë të një qytetërimi të ngjashëm me atë (helen) që do të shfaqet pas shekullit VII në Greqi, Itali, Azi e Vogël ose në Egje.

Grekët janë fryt i një përzierjeje shumë të hollë midis Pellazgëve autoktonë dhe pushtuesve të parë semito-egjiptianë (Danaos, Kadmos, Pelops... të gjithë eponime heronjsh të huaj). Ja një përmbledhje e studimeve dhe e hulumtimeve të kryera në fushat në vijim (Shiko "Greqia parahelene : Pellazgët ose zgjidhja e një enigme"):

I - Historia
II - Arkeologjia
III - Antropologjia
IV - Poemat epike dhe Mitologjia
V - Gjuhësia

I - Historia

Të gjithë autorët e lashtë, ndër të cilët Homeri, Hesiodi, Hekate i Miletit, Akusilaos, Hellanikos, Herodoti, Tuqididi ose Efori, na bëjnë të ditur shkurtimisht, por mjaftueshëm, se, përpara mbërritjes së grekëve, vendi që do të bëhej Greqi ka qenë i banuar nga Pellazgët. Ata, gjithashtu, pohojnë se këta Pellazgë nuk ishin Grekë, por "barbarë", d.m.th. nuk flisnin greqisht dhe, së fundi, se ata u lanë trashëgim grekëve një pjesë të madhe të kulteve dhe të perëndive të tyre. Asgjë më shumë se kjo nuk do të mjaftonte për të na bindur, se përpara mbërritjes së helenëve ka ekzistuar një qytetërim i madh jo-grek. Është kuptimi i kësaj fjale të famshme -"mbërritje"- të cilën nuk e kanë kuptuar mirë të gjithë autorët modernë. Është thënë gjithçka kundër kësaj teme. Deri në zbulimin e tabelëzave të mbiquajtura mikeniane, "të deshifruara" nga Ventris dhe Kadvik, kishte shumë dyshime për to. Por, qysh kur këta dy dijetarë shpallën se Lineari B mikenian ishte në greqishten e vjetër, gjithçka u përmbys në favor të tezës së vijimësisë së dy qytetërimeve (mikeniane dhe greke), dhe kjo pavarësisht katër shekujsh heshtjeje tërësore. Këtë teori po e zbuloj me argumente, për ta vërtetuar në mënyrë që askush të mos dyshojë që ajo çfarë u quajt mikeniane nuk ishte gjë tjetër veçse pellazgjishtja e

lashtë (gjuha), nga e cila ka dalë pjesërisht greqishtja e lashtë. Përveç kësaj, një tjetër argument mbështet këtë tezë të fundit: sipas Herodotit (I. 57 - VIII, 44 - VII, 95) Jonianët ishin Pellazgë të kthyer në helenë duke përshtatur gjuhën greke! Çuditërisht, Tuqididi, shovinizmi i të cilit nuk ka nevojë të tregohet, pohon se Pelopsi (pushtuesi i Peloponezit) ishte një i huaj i ardhur nga Azia (I, 5); hera e vetme që ai përmend zanafillën e huaj të një prej grekëve të tij të lashtë.

Midis argumenteve të tjerë historikë po përmendim atë të zanafillës së Dorianëve, të cilët nuk janë cituar nga Homeri (rreth viteve 800, 750 ose 700 para Krishtit ?), por pas tij, dhe që Herodoti në shekullin V (VI, 53, 54 - VIII, 73) i trajton si pasardhës të Danaos Egjiptianit. Megjithatë, duhet shënuar se ata janë përmendur në vijimësi vetëm duke filluar nga Pindari (510-438) dhe se Eskili (525-456) i përmend vetëm një herë. Kjo zanafillë semito-egjiptiane pohohet edhe nga Testamenti i Vjetër (libri i Makabeve I, XII / 6 - 23) si dhe nga burime të tjera të ndryshme, të cilat e përforcojnë këtë mendim të fundit. Nga ana tjetër, këmbëngulja shumë herë e përsëritur, sipas së cilës ekzistonte një pushtim dorian rreth vitit 1100, është i papërligjur dhe për këtë nuk gjendet asnjë njoftim historik e asnjë gjurmë materiale: arkeologjia nuk ka gjetur asnjë rrënojë që të provojë ekzistencën e këtij "pushtimi". Në mënyrë të pakundërshtueshme, është Tuqididi (I, 12) në fillesën e këtij gabimi: "tetëdhjetë vjet pas rënies së Illionit (Troja), dorianët me heraklidët pushtuan Peloponezin" (1183 - 80 = 1103 para Krishtit ?). Kështu bën që të përputhen fundi i "shekujve të errët" me mbërritjen e dorianëve (grekët e vërtetë për të). Kjo nisje nga një pistë e gabuar përvijon vazhdimisht. Kjo tezë është e gabuar plotësisht.

Midis argumenteve të tjera të lashta, që shkojnë kundër qytetërimit grek, ja edhe mendimi i Flavius Jozefit, lindur në vitin 37 ose 38 pas Krishtit, i cili në veprën e tij "Kundër Apionit" (Belle Lettres 1972, faqe 4) pohon: "Në të vërtetë, kam gjetur se ndër grekët gjithçka është e mëvonshme dhe daton, siç thotë një fjalë, e djeshmja apo e

pardjeshmja: me këtë unë nënkuptoj themelimin e qyteteve, shpikjen e arteve dhe hartimin e ligjeve, por nga të gjitha gjërat, më e vonshmja, apo që ndër ta mungon, është meraku për të shkruarit".

Kështu, asnjë tregues, madje edhe më i vogli, nuk ka provuar ekzistencën e grekëve para shekullit VIII. Në fakt, gjithçka, që me të vërtetë prek qytetërimin grek, e thënë tamam është krijuar pas shekujve të quajtur "të errët": fillimi i kultit i Apolonit (Delfit, Delos). Homeri e vërteton vetvetiu, kjo sepse ai nuk mund të përmendte atë që nuk e njihte kur ishte gjallë, si dhe atë çfarë ndodhi pas tij.

Së fundi, shtoj se Homeri nuk i ka cituar helenët as si popull dhe as si komb grek. Ky emër ka qenë përmendur vetëm një herë në Iliadën, Kënga II, 684 (në mos po bëhet fjalë edhe një herë për një futje të gabuar të mëvonshme). "Më pas vijnë ata të Argosit pellazg – të gjithë popujt e Alopes, të Alosit dhe të Trakisë, - ata të Fties dhe të Heladës me gra të bukura të quajtura Mirmidonë, Helenë, Akenë". Këta helenë zinin një pjesë të Thesalisë (Argosi pellazg). Kjo në këtë epokë u përkiste ende pellazgëve. Homeri, pra, ka folur vetëm për akenë, danaenë dhe argianë, si kamp kundërshtar i trojanëve. Ai i përmend Pellazgët në Greqi, në Azinë e Vogël dhe në Kretë. Për të, Zeusi (Iliada XVI, 234) është pellazg dhe dodonas (Dodona në Epir, kryeqytet kulti i Pellazgëve). Ja disa ngjarje që kanë ndodhur pas shekullit VIII, pra pas Homerit:

- Djegia e kufomës ("inhumation") te mikenianët.
- Përdorimi i hekurit, i panjohur nga mikenianët, (Epoka e Bronzit).
- Përshtatja e alfabetit fenikas, i përpunuar duke i shtuar zanoret (fundi i shekullit VIII), i vënë në përdorim rreth shekulli VII/VI. Sipas Herodotit (V. 58 – II, 49), alfabeti u fut në Greqi (Beoti) nga Kadmos fenikasi. Eubianët e Kalkisë do ta kenë futur në Kumes rreth vitit 750 (mbishkrimet në kupën e Nestorit): hiatus i rëndë, sepse Eubea nuk e njihte alfabetin në këtë epokë. Disa mendojnë se grekët dhe fenikasit kanë banuar përbri njëri-tjetrit (Kumes, El Mina, Qipro...?), në një

vijimësi të mjaftueshme, prej nga edhe kanë huazuar alfabetin e tyre.

● Epopetë e para (Iliada dhe Odiseja), të transkriptuara në gjuhën greke, duke nisur nga fundi i shekullit VI para Krishtit (epoka e Pisistratit dhe e bijve të tij, Hipiasit dhe Hiparkut), më parë bënin pjesë në traditën gojore. Te panathenët, pisistraditët imponuan për herë të parë poemat epike të recituara nga rapsodët.

● Ndërtimi i tempujve të parë prej guri, rreth shekullit VII.

● Pushtimi kolonial çuditërisht fillon në Perëndim (jugu i Italisë), pastaj në Lindje (Azia e Vogël). A të kenë qenë këta fenikasit e Kartagjenas (të themeluar në vitin 814 para Krishtit), apo nga veriperëndimi i Sicilisë (të vendosur rreth shekullit IX), të cilët do të kenë zbarkuar në Pitekusë (rreth vitit 775 para Krishtit) përpara se të pushtonin qytetin Kumes në Kampanja (rreth 400 km nga Kartagjena) dhe që prej aty u nisën (drejt Lindjes) për pushtimin e Peloponezit? Pushtuesit semito-egjiptianë, për të cilët flasin autorët e lashtë, a zbarkuan drejtpërdrejt nga skajet e Fenikisë (Tir, Sidon, Biblos, El Mina?), apo nga Egjipti?

● Delfi, të cilin Homeri nuk e njeh, kërthiza e botës, bëhet vendi i shenjtë karakteristik grek dhe omfalos, nën tiraninë e Klistenës (rreth viteve 600–570 para Krishtit). Delfi dhe Delos: praktikumet e para të kultit.

● Stili gjeometrik (poçeri, qeramikë, urnet funerale...): kulmon midis viteve 770 dhe 750 (Lefkandi, Diflon...) - mënyra gjeometrike zbulon një këmbim të pushtimit të tokës. Stili Diflon është një kalim i mënyrës gjeometrike në gjeometrinë e mëvonshme.

● Arti orientalizues (rreth viti 725 para Krishtit).

● Monedha (fundi i shekullit VI).

● Stilet arkitekturore (shfaqja së bashku me mbërritjen e helenëve): stili dorik (shekulli VII), stili jonik (shekulli VI) dhe stili korintas (shekulli V).

● Arti i ri luftarak: armatim i ri (hoplit* etj.)

● Me mbërritjen e helenëve, dalja në skenë e Polisit dhe Amfiktonisë: dy elemente thelbësore të qytetërimit grek, të cilat Homeri nënkuptohet se nuk i njeh fare.

● Shfaqja e perëndive të reja, midis tyre Dionisi dhe Pani; mbretërit-poetë, ndër ta Orfeu dhe Muza (nismëtarë të qytetërimit grek, sipas vetë grekëve); ose të heronjve të rinj, midis tyre Herakli dhe Tezeu, i cili sipas disa autorëve ishte krijuesi i sinocizmit athinas.

● Grekët e nisin historinë e tyre me Lojërat Olimpike, të themeluara, me sa duket, në vitin 776 para Krishtit. Por kjo datë, (ashtu si dhe të tjerat), sipas autorëve të shumtë të kohëve të sotme, ndër të cilët J.C. Pursat (Greqia Paraklasike, Seuil, 1995) duhet kthyer të paktën 60 vjet prapa, d.m.th. rreth vitit 716. Pelopsi, nga i cili do të kenë rrjedhur Atridët, do të ketë qenë themeluesi i këtyre lojërave. Mirëpo Homeri nuk i përmend Lojërat Olimpike. Diodori i Sisilisë pohon se Pelopsi nuk ishte as grek, as frigjian dhe as pasardhës i dardanëve, por ishte një perëndi kombëtare te asirianët, pushtues i mbretërisë së Izraelit (viti 721 para Krishtit). Simerianët i dhanë fund mbretërisë frigjiane rreth vitit 690 para Krishtit dhe vetë këta u dëbuan nga medesët. Së fundi, emri "Pelopides" ka qenë përmendur për herë të parë në shekullin V nga Eskili (Agamemnoni 1600, Koefori 503).

● Midis viteve 800–750 para Krishtit, popullsia e Atikës u katërfishua; pati ndryshime shoqërore shumë të dallueshme.

II - Arkeologjia

Qysh nga fillimi i epokës së Paleolitikut, territoret e Ilirisë (qysh në kohët e lashta, prej dy brigjeve të Danubit deri në Epir) ishin të banuara nga njeriu, siç edhe e provojnë zbulimet e shumta, ndër të cilat shpella e Kaprinas (në Kroaci), që daton prej rreth 160.000 vjet, shpella e

---

* *Ushtar këmbësor i armatosur rëndë në epokën e Greqisë së Lashtë*

Gajtanit (në Shqipëri, pranë Shkodrës) etj. Eugjen Pitardi në vitin 1916 pohonte: "Tashmë e kam thënë diku tjetër, më duket se Shqipëria i përmbys dokumentet më të rëndësishme arkeologjike dhe antropologjike për sa i takon zanafillave të popullsive të lashta të Gadishullit të Ballkanit; popullsi, të cilat në agimin e historisë i shohim të figurojnë nën emrin Ilirë ["Popullsitë e Ballkanit, skica antropologjike, Neuchatel / Paris"]. Pothuajse 100 vjet më vonë: çfarë profecie! Në të vërtetë, zbulimet e realizuara prej arkeologëve shqiptarë qysh nga Lufta II Botërore janë të një rëndësie të pallogaritshme. Kërkimet arkeologjike, deri më sot kanë qenë kryesisht të lidhura me vendet mitike, aty ku lindën qytetërime të mëdha të arritura deri në ditët tona falë realizimeve të tyre monumentale: Sumeri, Egjipti, Greqia, Roma.... Në Shqipëri nuk ka të tilla. Koha, dhe pse jo edhe njeriu, i ka fshirë apo dëmtuar gjurmët e shumta të qytetërimit, të paktën kështu është në dukje. Por ja se si gurët e Deukalionit dhe të Pirrhas, mbetje rrënojash, pa qenë krijesa të gjalla, na bëjnë të përjetojmë të kaluarën e lavdishme, duke u ngjitur nëpër qytetërimet që kanë paraprirë qytetërimin grek, ndër të cilët qytetërimi i mbiquajtur Mikenian.

Sa për Pellazgët, ata kanë lënë rrënoja megalitike: ndërtime të quajtura ciklopike apo pellazge, të dallueshme edhe deri në ditët tona. Është fjala për mure gjigande të ndërtuara me blloqe guri të stërmëdha, të pa lidhura me llaç dhe të latuara në faqet e tyre të jashtme. Këto ndërtime ciklopike gjenden e rigjenden kudo në pellgun mesdhetar (Greqi, Azi e Vogël, Egje, Itali, Palestinë...) ku jetonin Pellazgët dhe Tursanët (Tirrenët apo Etruskët). Këto etni pellazge janë në zanafillën e të gjithë monumenteve parahelenë të Greqisë së Lashtë, ose më saktë mikeniane, ndër të cilët muret e famshme të Tirintit. Pelargikoni i Akropolit të Athinës është një shembull i qartë i tyre. Vërejmë se kjo ishte një fortesë e lashtë parahelene e zaptuar nga pushtuesit helenë. Në shekullin V, në kohën e Perikliut, u ngritën ndërtesa madhështore, të tilla si ato të Fidias (Partenon, Erekteion).

Arkeologjia na zbulon se kultura e bakrit në Shqipëri përfshin të gjithë mijëvjeçarin III. P.sh në shtretërit stratigrafikë të Maliqit II, vërehen më mirë aspektet e kësaj kulture kalkolitike. Kjo i bashkëngjitet grupeve të tjera ballkanikë, ndër të cilët Sakulta-Krivodol-Bubanj-Hum ose Suplevec-Bukarno Gumo të Pelagonisë. Të gjitha fazat e Neolitikut, duke u nisur nga një nënshtresë e lashtë, përbëjnë një fenomen krejtësisht evolues, pa ndonjë shkëputje apo mosvijimësi me fazat paraardhëse. Ndodh e njëjta gjë për periudhat në vijim: e Bronzit dhe e Hekurit. Periudha e Maliqit III a do të ketë qenë bashkëkohore me grupin Armendohori të Pelagonisë dhe me fazën më të vonshme (Bronzi i Lashtë) të Thesalisë dhe të Maqedonisë dhe Maliqi III b (fundi i Bronzit të Lashtë) a do të përkonte me fazën e fundit të Helladikës së Lashtë? Duke filluar nga kjo epokë, ndeshen prodhime vendore, që kanë të bëjnë me tipet e Minoanit të Mesëm (ushta me gjinish të tipit sikladik), thikat me një teh (tip egjeas), tasa të tipit Keftiu të zbuluara në Pazhok. Përveç kësaj, tumula të shumta, varre në formë rrethore (Bronzi i Lashtë) kanë ravijëzuar në tokën shqiptare.

Disa pohojnë se kulturat e Bronzit të Lashtë, të tilla si ato të Badenit, Kostalac ose Vucedol, kanë dalë nga popullsi Neolitike, të cilave iu vishet në përgjithësi ky tip tumule. Është pikërisht në këtë epokë që hasen tumula në Shqipëri, në Epir dhe më vonë në krahinat e Greqisë të mbiquajtura mikeniane. Një kupë e tipit të Vafio dhe një shpatë mikeniane janë zbuluar në një nga tumulat e Pazhokut.

Si rrjedhojë, krahinat e zëna nga pellazgo-ilirët nuk kanë qenë aspak të izoluara nga pjesa tjetër e botës ballkano-danubiane dhe egjease. Ajo që bie në sy dhe që është unike në Evropë, është fakti se shqiptarët e sotëm kanë rrjedhur prej një popullsie autoktone, që ka lulëzuar në të gjithë hapësirën ballkano-danubiane (Pellazgë, Thrakë, Ilirë, Panonianë, Dardanë, Tesprotë, Molosë, Epirotë, Maqedonë...); në Egje (Karianë, Lisianë, Kuretë..); në Azinë e Vogël (Frigjianë, Trojanë, Lidianë, Mushkinë); në Itali (Etruskë, Venetë, Japigë, Mesapë, Moskë); madje

në Palestinë (Filistinë, Girgashitë, Jebuzianë) dhe nga këta më të lashtët qysh nga periudha neolitike (rreth viteve 6500/6000). E mbrapsur prej shumë pushtimesh, kjo popullsi përfundimisht është përqendruar dhe vendosur në malësitë e Ilirisë së Jugut (Shqipëria e sotme, Epiri).

III - Antropologjia

Arkeologjia vërteton vijimësinë antropologjike dhe etno-gjuhësore të kësaj etnie pellazgo-iliro-shqiptare qysh nga Neolitiku. Përveç kësaj, antropologjia ka mbështetur provat paleontologjike, arkeologjike, historike dhe etno-gjuhësore. Në të vërtetë, shqiptarët e sotëm paraqesin veçorinë e treguesit cefalik (85-90) më të lartë në Evropë (Hiperbrakicefalik/kokë rrumbullake) dhe një planocipitalia e theksuar (shtypje e kavitetit të prapmë dhe të poshtëm të kafkës). Riplei, në sistemin e tij të klasifikimit e trajtonte formën e kokës si treguesin më të vlefshëm në shqyrtimin e racave. Zhak de Morgan pohon (Njerëzimi arkeologjik, Paris 1921): "Dokumentet më të lashta arkeologjike që ne zotërojmë në lidhje me këta kolonë, na bëjnë të mendojmë se imigrimi i tyre u bë gjatë mijëvjeçarit të katërt para erës sonë, duke ardhur nga Europa Kontinentale. Pastaj Pellazgët do të kenë luajtur rolin e tyre, duke sjellë me vete dijet për metalin. Duke zënë të gjithë Heladën evropiane, këto fise do të kenë përparuar deri në ishujt dhe territoret aziatike... fisi tjetër më i vonshëm do të ketë qenë autor i kulturës mikeniane dhe nga një trung me fiset që në atë kohë jetonin në Trakë dhe përgjatë lumit të Danubit. Këta kolonë nuk ishin helenë, e thënë më saktë ishin thrako-frigjianë".

Kjo brakicefali është, gjithashtu, ajo e "malësorëve" të mbiquajtur "kokë rrumbullakët" të mijëvjeçarit V dhe IV, të cilët populluan pjesërisht Lindjen e Afërme dhe të Mesme, të tillë si Sumerianët (popull jo semit), Hititët, Elamitët. Kjo karakteristikë është vërtetuar nga gërmimet arkeologjike të realizuara në nekropolet më të lashta, të

zbuluara në një hapësirë që shkon prej Danubit të Sipërm deri në Azinë e Vogël, duke kaluar nëpër Ballkan dhe, në veçanti, në krahinat e populluara sot nga popullsi të trungut pellazgjik (etni shqiptare). Dhe, për të përfunduar këtë kapitull, vë në dukje se C.H. dhe C.B. Haues (Kreta, paraardhëse e Greqisë, Londër 1909), kanë vendosur analogjitë e nxjerra në pah midis kafkave brakicefale të krahinave të traditës doriane (Kretë dhe Peloponez) dhe kafkave shqiptare. Ky zbulim mbështet një herë e përgjithmonë zanafillën pellazgo-ilire të popullsive të mbiquajtura doriane, me zanafillë nga veriu i Greqisë, ndërkohë që prijësit apo mbretërit e tyre, minoritarë në vend (mbreti i Spartës Agis IV, në shekullin III para Krishtit, pohonte se aty kishte tre përlakë për një spartiat) ishin me zanafillë semito-egjiptiane, siç e provojnë argumentet e shumta që unë kam trajtuar.

IV - Poemat epike dhe mitologjia

Homeri vendoset midis viteve 800–700 para Krishtit (kronologjia e pranuar më zakonisht). Disa e vendosin më përpara (rreth viteve 900–800 para Krishtit). Përkundrazi, të tjerë mendojnë që është shumë më i vonshëm (rreth viteve 700–670 para Krishtit), duke e pohuar madje që ai do të ketë shkruar epitafin e mbretit frigjian Midas (i cili ka vdekur rreth vitit 675). Së fundi, të tjerë pohojnë se ai nuk ka ekzistuar kurrë.

Sa për Iliadën dhe Odisenë, poemat parahelenike (rreth shekullit XII para Krishtit, Epoka të Errta?) "të ripërshtatura" për nevojat e kauzës së pushtuesve të rinj grekë në epokën e sulmeve të para (rreth shekullit VII para Krishtit) kundër pellazgëve, trojanëve ose frigjianëve të Azisë së Vogël, bëhet fjalë që në zanafillë, prej nga del edhe një farë dykuptimësie që konsiston në përzierjen e një legjende të lashtë me elemente të një periudhe të mëvonshme. Futja e elementeve të ndryshëm të mëvonshëm dhe modifikimet e ngatërrojnë edhe më shumë përmbajtjen e tyre. Duke u nisur nga tradita gojore, këto dy poema

epike u kopjuan në gjuhën greke dhe u përhapën në epokën e tiranisë së Pisistratit (600–527 para Krishtit). Por ndërfutje elementesh të gabuara dhe përpunimet reshtën vetëm në periudhën aleksandrine (shekulli III, madje shekulli II para Krishtit), epokë në të cilën ato u kopjuan përfundimisht ashtu si i njohim sot.

Flavius Jozefi shkruan për këtë çështje (Kundër Apionit): "Është shumë më vonë dhe e vështirë që ata [grekët] të njihnin shkrimin... askund në Greqi nuk gjendet ndonjë shkrim që të njihet si më i lashtë se poezia e Homerit. Mirëpo është e qartë që ky poet është edhe më i vonshëm se Lufta e Trojës. Dhe për vetë atë, thuhet se nuk i ka lënë poemat e tij me shkrim, por të përcjella në kujtesë. Më vonë ato u formuan duke bashkuar këngët, prej nga vërehen edhe mospërputhje të shumta".

Legjenda e Deukalinoit u krijua për të fshirë plotësisht të kaluarën pellazge, një përmbytje që fshin gjithçka, në mënyrë që të fillohet nga zero. Kështu, si me magji, dolën në dritë Heleni i Deukalionit dhe i Pirrhas: Helen. Eponim i stërgjyshit të grekëve. De Zhubainvil e thotë me forcë: "Ndërfutja e një përmbytjeje në fund të historisë pellazge është pasojë e natyrshme e pushtimit të Greqisë nga raca helene, historia e së cilës fillon me përmbytjen e Deukalionit".

V – Gjuhësia

Gjuhësia është pengesa. Është kjo, pa dyshim, që i ka çoroditur shumë gjuhëtarët, arkeologët dhe historianët. Në të vërtetë, janë të rrallë ata që kanë marrë në konsideratë dy pika thelbësore:

- Pellazgët, të cituar së tepërmi nga autorët e lashtë, ishin paraardhësit e grekëve në atë tokë që do të bëhej Greqi. Për fat të keq, disa e trajtojnë se emri "pellazgë" ishte vetëm një emër "gjinor", që emërtonte popullsi të shpërndara dhe që nuk kanë midis tyre asnjë lidhje etno-gjuhësore. Pra nuk ka qenë vendosuras një përputhje midis pellazgëve, lelegëve,

karianëve, ligurve, trojanëve, etruskëve, thrakëve, frgjianëve dhe ilirëve, duke përmendur ata që ishin më të shquarit. Përveç kësaj, asnjë përqasje nuk është bërë midis këtyre fiseve të ndryshme (dhe jo etni) dhe pasardhësve të fundit të tyre: pra shqiptarëve të sotëm.

- Duke qenë pranuar se Pellazgët ishin një popull autokton dhe helenët një popull pushtues, atëherë si mund të shpërfillet rëndësia e trashëgimisë që këta pellazgë i lanë helenëve: mitologjinë (perënditë, perëndeshat, heronjtë), kultin (Homeri thotë se Zeusi ishte pellazg), një pjesë të madhe të kulturës dhe gjuhës së tyre. Kjo e fundit nuk është pa peshë: greqishtja e lashtë ngjason (fonetikë, sintaksë...) të ngatërrohet me dialektin gegë të Shqipërisë së Veriut. Nëse vihesh të lexosh me kujdes ato që autorët e lashtë kanë dhënë si të vërteta, do të kuptosh se nuk mund të fshihet me një të rënë të lapsit fakti se (cf. Herodoti) Jonianët ishin pellazgë të kthyer në helenë, duke përshtatur gjuhën e tyre. Grekët, pra, nuk mund t'i anashkalonin Pellazgët pa huazuar të paktën një pjesë të kulturës dhe gjuhës së tyre. Ja përse një pafundësi antroponimesh, eponimesh, toponimesh, oronimesh dhe fjalësh të tjera i kanë mbijetuar stuhive të kohëve dhe arrijnë të shpjegohen me gjuhën e sotme shqipe, dhe jo me gjuhën greke. Kështu gjuha e Pellazgëve ka mbetur pothuajse e paprekur, e mbrojtur kundrejt pushtimeve të shumta përgjatë mijëvjeçarëve, ndër malësitë e pamposhtura të Shqipërisë. Ja disa shembuj për këtë:

* Athina, fortesë e mirëfilltë e pellazgëve = E thëna, E thana = premtimi ndër Pellazgët (cf. Herodoti I, 56, 57, 58 - II, 51 - V, 64).

* Mikena (në greqisht Mikenaï), kryeqytetit legjendar i Atridëve (vjen nga fjala shqip "Atërit" !) = mik = rrënjë (...miqesi) e gjuhës shqipe.

* Korint (në greqisht Korinthos), qytet i lashtë dhe i pasur tregtar, rival me atë të Spartës dhe të Athinës = Korr, Korra = rrënja në gjuhën shqipe do të thotë me korr, me vjel. Më gjerë përdoret kjo rrënjë për të

shprehur një arritje (korr fitore). Kjo është në zanafillë të emrit "Kore", që është perëndesha e të vjelave, përpara se ajo të merrte emrin Persefoni. Kulti i saj shpesh ishte i lidhur me kultin e nënës së saj, Demetran.

* Tirynthe (Tirinti), qytet legjendar i Argolidës "me mure të fortë", thotë Homeri, = Thurrësët = popullsi e një hapësire të fortifikuar. Rrënja "thur", e cila do të përkthehej rrethoj, ndërtoj një mur rrethues.



KAMNIK: Vazo antropomorfe (terakotë e pikturuar) - Neoliti i hershëm
(nga "Shqipëria arkeologjike"-Tiranë-1971)

* Argianët, banorë të Argosit (kryeqyteti i Argolidës); ky qytet, ashtu si Mikena, sipas Homerit ishte i pasur në ar = Arxhi = argjendar dhe më gjerë "qyteti i argjendarëve".

* Zeus, zot i plotfuqishëm i Olimpit, fillimisht zot i qiellit dhe i fenomeneve atmosferike (bubullima, shkreptima, vetëtima, stuhia) të cilin Homeri e cilësonte si "pellazg" (Iliada XVI, 234). Në Dodonë, Zeusi i jepte përgjigjet e tij falë "fëshfërimës" së gjetheve të lisave (fëshfërimë e kthyer në "zërin" e Zeusit = Za, Zan (gegërisht). Porfiri pohon se Pitagora (me zanafillë pellazgo-tursane) e quante Zeusin "Zan".

* Akili (në greqisht do të thotë Akhilleus = pa buzë !) heroi më i shquar i Iliadës = "aq i lehtë" . "Aspeitos" = A shpejt, d.m.th. "i shpejti" (Homeri e cilëson si "i shpejti").

* Helena = gruaja e Melenaut e rrëmbyer nga Parisi = E lena = e lëna, e braktisura.

* Ajaks, hero legjendar (Iliada) që dalldisi dhe, duke kujtuar se vrau një trupë luftëtarësh, kishte vrarë një kope deshësh = gjaks (shqiptimi i fjalës "gjakësor").

* Atride, pasardhës i Atres = atërit (gegë) = etërit, stërgjyshërit.

* Odise, epopeja homerike ("udhëtimi" i Uliksit) = udhësia.

* Uliksi (Odiseja), heroi kryesor i Odisesë = udhëzi = udhëtari. Uliksi eshtë emëri "latin" që vjën nga fjala shqip "ulice" (ulicari)

* Penelopa, bashkëshortja e Uliksit, e cila çdo ditë shtërrjet pëlhurën që ka endur = penë e lyp = ajo që lyp fillin (penin, perin).

* Telemak, biri i Uliksit dhe i Penelopës = të leu mec (gegërisht) = të lindi djalë!

* Laerte, babai i Uliksit = le urtë = ka le i matur, ose i virtytshëm.

* Demeter, perëndesha e pjellorisë dhe e të vjelave, perëndesha e "tokës ushqyese" = dhè motër = tokë-motër.

* Thetys (Tetis), perëndesha e detit = deti.

* Thetis, nëna e Akilit dhe një nga Nereidat = deti.

* Themis, perëndesha e drejtësisë = të mys (gegërisht) = të mbys, në kuptimin më të gjerë, vendos drejtësi.

* Monument, vepër e përcaktuar për të përkujtuar një kujtim, një ngjarje = mani ment (gegërisht) = mbani mend.

* Skeptri (në greqisht "skeptron"), ky simbol i Zeusit (sipas Homerit Zeusi është pellazg) është një shkop dhe në njërin prej skajeve ka një kokë, ose një "sqep" shqiponje = skep (gegërisht) = sqepi.

* Aleksandri i Madh III (në greqisht "Aleksandër" do të thotë "ai që ka lindur për të ruajtur njerëzit") = Ka le si (n')andërr ose Ai leu si (n') andërr (gegërisht) apo më gjerë "bir i andrrës". Në të vërtetë, nëna e tij, Olimpia (princesha epirote, pra pellazgo-ilire, emri i së cilës në gjuhën shqipe do të thotë "ajo që është bekuar nga perënditë", pra "O e lumtja") pa në ëndërr se një kafshë e çuditshme (dragua apo gjarpër gjigand) u shndërrua si një fantazmë dhe e barsi. Priftërinjtë e Dodonës (kryeqytet kulti i pellazgëve) këtë ëndërr e interpretuan si më poshtë: "Fëmija që do të lindësh do të jetë me prejardhje nga Zeusi. Ai do të shkëlqejë dhe fama e tij do të shtrihet deri në kufijtë e botës".... Emri pellazgo-shqiptar Aleksandër e mbart më së miri kuptimin e kësaj legjende, ndërkohë që emri i interpretuar nga ana fonetike (nga gjuha pellazge në atë greke) nga grekët sipas gjuhës së tyre (ai që ruan njerëzit) nuk i përafrohet. Megjithatë, një legjendë tjetër ngjan të jetë ngatërruar për këtë: ajo e lindjes së Parisit, biri i Priamit, mbretit të Trojës. Pas një ëndrre që pa nëna e tij Hekuba, Parisi u quajt gjithashtu, Aleksandër (emri i parë). Në të vërtetë, kur ishte shtatzënë ajo pa në ëndërr që kishte lindur një pishtar të zjarrtë. Ajo mendoi se kjo ëndërr ishte preludi i një flake që do të përpinte qytetin e Trojës. Duke u druajtur nga ky parashikim i keq dhe nga frika se mos kjo ëndërr do dilte e vërtetë, ajo e la birin e saj në malin Ida, ku e strehoi bariu Agelaus, i cili e quajti Paris. Kur u rrit, Parisi arriti të zbulojë prejardhjen e tij dhe u paraqit në oborrin e mbretit Priam. Motra e tij Kasandra, profetja e mirënjohur (emri i saj shpjegohet me gjuhën pellazgo-shqiptare: Qes

andërr (gegërisht) d.m.th ajo që shpjegon ëndrrat!, e njeh vëllain e saj dhe thërret: Ai ka le si n`andërr d.m.th ai ka lindur si në ëndërr (nënkuptohet ky që lindi nëna e saj). Të mos harrojmë që trojanët (teukrët), dardanët dhe frigjianët e Azisë së Vogël ishin pellazgë autentikë.

Përfundimi dhe sinteza.

Kështu del se gjurmët e para të qytetërimit grek stricto sensu u shfaqën vetëm në shekullin VIII para Krishtit. Më parë, në veçanti periudha e mbiquajtur mikeniane (1450–1200 para Krishtit) dhe ajo e Epokave të Errta që vjen më pas (1200–800 para Krishtit), një qytetërim, një kulturë dhe një etni, të ndryshme nga ato të helenëve, tashmë ekzistonin edhe përpara mbërritjes së helenëve.

Siç e kemi parë në fillim të kapitullit, shumë tregues (arkeologjikë, antropologjikë, etno-gjuhësorë, etj.), argumentet që i mbështesin, vërtetojnë se qytetërimi parahelen ishte ndryshe nga ai i grekëve. Nga ana tjetër, një mori toponimesh, oronimesh, antroponimesh, teonimesh, etnonimesh ose eponimesh nuk shpjegohen aspak me gjuhën greke, por arrijnë të dekriptohen vetëm falë gjuhës së sotme shqipe, e vetmja që ka shpëtuar nga pellazgjishtja e lashtë nëpërmjet gjuhës thrako-ilire. Gjithashtu, mund të qëmtojmë nga të dhëna të çmuara që na japin autorë të shumtë antikë grekë dhe që shpesh janë kaluar pa u vënë re ose kuptimi i thellë ose i fshehur i ka shpëtuar plotësisht autorëve të shumtë të kohëve tona. Në këtë mori të dhënash antike, ja edhe disa shembuj kuptimplotë. Në të vërtetë, nëse ky qytetërim parahelen (1450–800 para Krishtit) ka qenë grek, do të kishte patur vetëm emra grekë ose të shpjegueshëm prej greqishtes. Nuk është aspak një rast i tillë, siç e kam shpalosur gjatë gjithë veprës sime. Nëse e nisim nga fillimi i historisë së Greqisë, e thënë më saktë, do të shohim se grekët e nisin zanafillën e tyre etnike nga legjenda (Platoni, Aristoti dhe të tjerë jo më pak të shquar e besonin) e Përmbytjes së Deukalionit, që përpiu

gjithçka (d.m.th. nënkuptohet, qytetërimin parahelen të pellazgëve) në mënyrë që të lindte qytetërimi i tyre. Megjithatë, viti 776 para Krishtit daton si rrjedhojë me Lojërat Olimpike dhe, gjithashtu, me fillesën e qytetërimit të tyre. Por kronistët e kohëve të sotme e çojnë këtë datë nga fundi i shekullit VIII. Përveç kësaj, nismëtarët e qytetërimit grek, sipas traditës antike, ishin Orfeu dhe Muza. Mirëpo këta nuk janë përmendur nga Homeri (rreth viteve 750–650 para Krishtit). Pra ata ishin të një kohe më të vonshme se ajo e Homerit.

Grekët janë përpjekur që fillesën e qytetërimit të tyre ta ngjisin nëpër shkallën e epokave sa më lart që të jetë e mundur. Datat parahelene të dhëna nga Herodoti dhe autorë të tjerë antikë janë të pasigurta. Vetëm duke u nisur nga Soloni (rreth viteve 640-558 para Krishtit) fillon të ketë disa data të sakta. Përveç kësaj, këta autorë, ngjarje të mëvonshme i kanë vendosur në një të kaluar të largët dhe i kanë riinterpretuar legjendat pellazge (interpretime greke) duke u nisur nga të dhëna vendase. Duhet shënuar që disa mite të përfytyruara nga grekët dhe romakët fshihnin një dëshirë të qartë për të aneksuar viset, për të përvetësuar popujt pellazgjikë dhe për ta bërë për vete të kaluarën e tyre të lavdishme. Ja mendimet e tre historianëve të shquar bashkëkohorë në lidhje me këtë çështje (Boren, Braudel, dhe Snodgras), të cilët, bashkë me të tjerë, të përmendur tashmë, si Gloc, Zharde, G.Puason, M.R.Sauter ose Sartio, si dhe të tjerë jo më pak të shquar, bëjnë pjesë në ata historianë të rrallë që kanë dhënë disa të vërteta befasuese ose kuptimplote dhe, në këtë rast, japin ndihmesën e tyre për çështjen tonë. S'është aspak e nevojshme të them se i miratoj plotësisht të gjitha sa kanë shkruar. Në të vërtetë, disa të meta ekzistojnë në analizat e tyre globale, si mendimi se mikenianët mund të kenë qenë stërgjyshërit e grekëve. Përveç kësaj, ata nuk kanë vendosur ndonjë lidhje etno-gjuhësore midis pellazgëve, thrako-ilirëve dhe shqiptarëve të sotëm. Për ata, Pellazgët ishin thjesht para-helenë që u zhdukën plotësisht (trup e shpirt, gjuhë dhe etni). Po kjo nuk i pengon që t'i

kuptojnë misteret e historisë greke me kthesat e saj të shumëfishta, manipulimet ose të pavërtetat dhe të kenë qenë gati pranë pikësynimit, por pa arritur ta prekin:

Klod Boren (Grekët dhe Mesdheu lindor, PUF 1997): "Është ky boshllëk që, si rrjedhojë, kërkon të mbushë pak a shumë erudicioni antik.... Nuk ka dyshim që rreth kësaj epoke [fundi i epokës gjeometrike, rreth vitit 750 para Krishtit] ndërfuten dhe përpjekjet e para për të hedhur një urë midis këtyre dy epokave të rëndësishme të së kaluarës greke. Një nga përpjekjet e ndjekura ishte sigurisht që tek prijësi individët të kërkojnë të "dalin nga fati i tyre" si dhe në kërkim të legjitimitetit për të vendosur pushtetin e tyre të përzmadhuar, përpunimin e gjeneanologjive tepër fiktive... Ndërkohë është ravijëzuar ideja e një shkëputjeje të thellë në historinë antike greke, kjo pothuajse në çdo aspekt bie në fund të Epokës së Bronzit.... Në fakt kjo zgjedhje, që daton përreth vitit 1200, tregon se erudicioni modern është lënë të gabohet, të ngërthehet nga një ripushtim i rremë i së kaluarës mitike, i përpunuar në rrjedhën e shekujve nga dijetarë antikë, të kujdesshëm për t`i dhënë bashkëkohësve të tyre zanafilla njëkohësisht të largëta dhe të pranueshme, por në harmoni me perceptimin historik që përdoret sot dhe, më e mira, duke ua propozuar këtë me anë të poetit.... Por ekzistojnë, gjithashtu, tregues që paraqesin se shumë rrëfenja ishin të sajuara me qëllim që të simbolizonin dhe të ngulitnin atë që bashkësitë apo grupet dëshironin të besonin në lidhje me të kaluarën e tyre... kjo është e pranishme në një varg episodesh... zanafilla e të cilave duket se mëton të kërkojë thelbësoren në kërkesën e pavetëdijshme, por të ndjerë në disa grupe dhe individë të shekujve VIII–VI dhe të përsëritur në çdo shekull, për tu vendosur si përballë bashkësisë së tyre edhe përballë së "kaluarës së veçantë"....

Fernand Brodel (Kujtime të Mesdheut, Botimet de Fallois, 1998): "Këta popuj të parë egjeas (Pellazgët e traditës greke) lënë jo më pak gjurmë të thella. Analizat gjuhësore për këtë rast janë të prera. Të

ardhurit e rinj, [Brodel nënkupton këtu grekët] nëse e kanë ruajtur gjuhën e tyre, kanë bërë shumë huazime nga ata që mundën. Kësisoj gjuha greke përfundimisht trashëgoi një numër të madh fjalësh, të cilat janë të huaja për të. Janë toponimia dhe onomastika që e tregojnë këtë, madje me zë të lartë: edhe qytete me famë si Korinti, Tirinti, Athina ose mali i Parnasit, nën orakullin e Delfit, në zemër të Heladës dhe që është "kërthiza e botës", nuk kanë emra grekë. Aq më shumë, nuk janë grekë disa emra heronjsh homerikë, si Akili, Uliksi: sa keq!... Edhe më kuptimplote është zanafilla jo-greke e fjalëve të shumta që vijnë nga lëmi i bujqësisë: gruri, vreshti, fiku, ullishta, trëndafili, jasemini, zambaku, manxurana... Ose nga lundrimi: arti i lundrimit është një nga dhuratat më të çmuara, edhe se vreshtat dhe ullishtat, që Helada jo-greke i bëri pushtuesve indo-europianë, të pamësuar me detin: dhe as thalasa e as pontos nuk janë fjalë me zanafillë greke!... A ka patur ndonjëherë një pushtim dorian? Pyet me qesëndi një historian serioz".

Në të vërtetë, sipas disa autorëve të lashtë, Pellazgët, ashtu si të gjithë fiset e të njëjtit trung: ilirët, liburnët dhe filistinët, ishin zotë të deteve dhe zotëronin njëkohësisht flotë luftarake dhe marinë tregtare; përveç kësaj, fjala thalasa shpjegohet me fjalën shqipe tallaz! Sllavët, të cilët nuk ishin lundërtarë apo detarë, edhe ata e huazuan këtë fjalë nga popujt ilirë, të cilët i pushtuan në shekujt VI dhe VII pas Krishtit.

Antoni Snodgrans (Greqia Arkaike, Hashet, 1980/1986): "Gjatë vijimësisë së përzgjatur, fakti që të bie më shumë në sy është, dhe mbetet, rritja e përgjithshme e popullsisë gjatë shekullit VIII në të gjithë Greqinë.... Ndërtimet e para të qëndrueshme të vendeve të shenjta filluan nga fundi i shekullit VIII apo më saktë pakëz më vonë. Faza vendimtare e lulëzimit të qytetit grek daton në shekullin VII dhe, përveç kësaj, përkon me idenë se fenikasit mund të kenë ushtruar aty ndikimin e tyre... Në epokën historike, grekët, të ngërthyer në grindje për tokat, vazhdimisht kërkonin me ngulm të kaluarën legjendare në mënyrë që

të përligjnin pretendimet e tyre... E gjithë kjo, madje edhe më shumë, kryhet në Greqi në një hapësirë të shkurtër kohore prej njëqind vitesh, më saktë midis fillimit të shekullit VIII dhe dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit VII"...

Nga ana tjetër, grekët e nxjerrin etninë e tyre nga veriu i Greqisë. Asgjë nuk provon se ata vijnë nga ky veri. Si mund të vinin ata prej andej, kur dihet se Danaos (Egjiptiani, biri i Belos dhe vëlla binjak i Egjiptos) kishte mundur Argosin, kryeqyteti i pellazgëve dhe e kishte dëbuar mbretin e saj Pelasgos; se Kadmosi (Fenikasi, emri i të cilit shpjegohet nga gjuha semito-arabe Kadem, që do të thotë mbërritësi, të cilit grekët i shtuan prapashtesën e tyre të famshme "os") pushtoi Beotinë dhe themeloi Tebën (Kadmenët janë përmendur vetëm një herë në Iliadë, IV, 385; madje sipas disa autorëve kjo është një ndërfutje e mëvonshme) dhe se Pelopsi (Asiriani, emri i të cilit nënkupton "fytyrën e lyer më baltë", gjë që ka të ngjarë të nënkuptojë i zeshkët) pushtoi Peloponezin? Duhet të shënojmë se Pelopsi është trajtuar si një themelues i Lojërave Olimpike. Si rrjedhojë, a fillon me Pelopsin qytetërimi i vërtetë helen?

Në të vërtetë, në lidhje me këtë duhet thënë se autorë të shumtë antikë grekë prireshin të zvogëlonin zanafillën e tyre semito-egjiptiane dhe ndikimet e Lindjes së Afërme. Ata, ose e anashkalojnë zanafillën e tyre ose e fshehin plotësisht atë (Tuqididi është një shembull i përkryer ndër këta autorë). Gjithsesi, disa tekste antike kanë kaluar pothuajse pa u vënë re qoftë sepse nuk është dashur tu besohet, qoftë pse kanë dashur t'i fshehin apo të shmangin përhapjen e tyre, qoftë se i kanë hequr nga padija ose për mangësi hulumtimesh. Ja disa shembuj nga këta:

Diodori i Sicilisë pohon se Pelopsi nuk ishte as frigjinan as pasardhës i Dardanos, por ishte perëndia kombëtare e Asirianëve, të cilët pushtuan Frigjinë, dhe se egjiptianët mburreshin se athinasit ishin me prejardhje nga një koloni egjiptiane e Saisit dhe se u ishin nënshtruar princërve

egjiptianë, ndër të cilët Kekropsi dhe Erektori, mbretërit e parë egjiptianë, ishin pushtues të Athinës. Ai pohon gjithashtu se Pani dhe Sileni, të trajtuar nga grekët si perëndi, ishin prijës të një ushtrie të Osiris-it. Për sa i takon Polienit, ai ia vesh Panit përdorimin strategjik të krahëve mbrojtës të trupave ushtarake kryesore të Egjiptit. Një legjendë greke e bën Panin një buall të shenjtë, një perëndi që nderohej njëkohësisht në Arkadi dhe në Egjipt. Platoni te Timea pranonte një lidhje gjenetike midis grekëve dhe egjiptianëve, si dhe midis athinasve dhe saisve (në perëndim të deltës së Nilit). Në Menexenë (245 c, d) ai pohon se athinasit janë etnikisht me të pastër sesa tebainët dhe peloponezianët e kolonizuar nga lindorët. Sipas Herodotit, (II, 29, 62) Soloni (nga vitet 640–558 para Krishtit) u prit si një i afërm nga egjiptianët e Saisit, kryeqyteti i Egjiptit (664–525 para Krishtit) në këtë epokë, për shkak të lidhjes që bashkonte athinasit me egjiptianët. Straboni pohon se banorët e qytetit të Saisit në Egjipt kërkonin me ngulm lidhjen e tyre fisnore me mbretin e lashtë të Athinës, ndër të cilët edhe Kekropsi i famshëm (cf. Herodoti VII, 141/ VIII, 44, 53)

Isokrati, megjithëse një panhelen i zjarrtë, e lë të dalë në dritë pushtimin e huaj të Greqisë (Lëvdata e Helenit, 68): "Më parë Barbarët, fatkeqë në tokën e tyre, gjykohej se ishin prijës të qyteteve greke. Danaosi, duke u larguar fluturimthi nga Egjipti, pushtoi Argosin, Kadmos i Sidonit mbretëroi në Tebë". Më në fund, duhet shënuar se Eskili ishte në zanafillën e një trilogjie që lidhej me pushtuesit semito-egjiptianë : supliantët, egjiptianët, danaidët. Çuditërisht, dy tragjeditë e fundit të tij nuk na janë përcjellë. Për të komentuar tekstet e paragrafit të mësipërm po filloj me Kekropsin, gjeneanologjia e zakonshme e trajton atë si mbretin e parë legjendar të Athinës (gjysmë njeri-gjysmë gjarpër). Siç e kemi vërejtur, autorë të shumtë antikë e kanë trajtuar si egjiptian me zanafillë nga qyteti i Saisit. Mirëpo është interesante se si Herodoti e vendos atë pas mbretit Kranaos. Ja çfarë pohon ai (VIII, 44): "Athinasit, në epokën kur Pellazgët zotëronin vendin që quhet

Greqi, ishin pellazgë të emërtuar kranaenë [nënshtetas të Kranaos, Pellazgu] dhe, nën mbretin e tyre Kekrops, ata do të quhen kekropidë; kur pushteti kaloi në duart e Erekteut, ata e ndryshuan emrin dhe u quajtën Jonianë". Kranaosi ishte me plot të drejtë një mbret pellazg i rrëzuar nga froni prej pushtuesve helenë. Përveç kësaj, siç e tregon emri i tij, ai rrjedh nga rrënja pellazgo-shqipe (kre, që në dialektin gegë do të thotë kokë, kreu, fillimi, i cili ka krijuar krena, krenar dhe kresor = kryesor). Ky emër i greqizuar përfundoi duke zëvendësuar emrin e mbretit pellazg: Krena-os.

Herodoti, të paktën, është i logjikshëm dhe vërteton këtu atë çfarë ai ka pohuar diku tjetër (I, 56, 57, 58, / II 50, 51, 146/ V, 26, 64/ VII. 94, 95) d.m.th se Greqia përpara mbërritjes së grekëve ishte e populluar nga Pellazgët, nga të cilët rridhnin jonianët dhe athinasit, të kthyer në grekë pas helenizimit të tyre. Dihet shumë mirë që athinasit i përkisnin pellazgëve që ndërtuan pelargikonin, muri i parë rrethues fortifikues i Athinës, dhe që janë në fillimin e ndërtimeve të para fortifikuese të epokës parahelene: ndërtimeve të quajtura gjithashtu ciklopike. Sidoqoftë, historia e Kekropsit na sqaron atë që ka kaluar përpara dhe prapa. Legjenda e shpjegon mirë atë që ka ndodhur me të vërtetë. Me mbërritjen e tij në Athinë, plasi një grindje (luftë) që vuri përballë Athinën (perëndeshë pellazge e mirëfilltë, e marrë nga helenët) dhe Poseidonin (perëndi greke, e mirëfilltë, e personifikuar nga Kekropsi, pushtues semito-egjiptian) për zotërimin Athinës (lufta midis Pellazgëve dhe pushtuesve helenë për zotërimin e këtij qyteti). Shënojmë në këtë rast, se Poseidoni është në fillesat e mbretërve të shumtë dhe heronjve semito-egjiptianë me Danaosin dhe Egjiptosin, dhe Azhenor (dega fenikase me Kadmosin dhe Feniksin). Perëndi dhe heronj të tjerë janë vendosur në këtë renditje: Perseu, Heraklesi, Dionisi, Edipi, Lakedemoni (themeluesi i Spartës) etj.

Duke lidhur logjikën me realitetin e fakteve, Herodoti, i vetmi ndër autorët antikë, e vendos mbretin pellazg, Kranosin, si të parin mbret

të Athinës, para Kekropsit që disa e trajtojnë si mbretin e parë grek të Athinës. Në të vërtetë, para Kekropsit nuk ka patur mbretër grekë në Athinë, qytet pellazg emri i të cilit nuk shpjegohet me gjuhën greke por me pellazgo-shqipen: E thëna, E thana, çka do të thotë premtim, i zgjedhur, që do të thoshte qyteti i pellazgëve, qytet i premtuar Athinës. Këta (logografët, kronografët, mitologët, kozmologët grekë etj,) që kanë ngritur në fron Kekropsin si mbret të parë të Athinës, kanë dashur të mbulojnë zanafillën e vërtetë të Helenëve. Atëherë, për të bërë këtë, ata përfunduan në shpikjen e legjendës së Deukalionit dhe Pirrhas (ka të ngjarë të jetë mit i lashtë parahelen - parodi e përmbytjes së Gilgameshit – e kthyer në dobi të kauzës greke) të cilët, siç e kemi përsëritur, janë të shpëtuarit nga përmbysja që shkatërroi gjithçka dhe nga e cila rilindi një etni e re, ose një popull i ri. Për më tepër, fëmijët e dalë nga ky çift mitik dhe të dalë nga ky boshllëk apo kjo zhdukje, janë veçse Heleni (i cili kishte tre fëmijë: Doros, Eolos dhe Kzutos), prej nga doli emri i "helenëve" (stërgjyshërit e presupozuar të grekëve) dhe Amfiktioni, prej nga vjen termi "amfiktoni ose lidhja amfiktonike" (Amfiktion është në zanafillë të krijimit dhe të ndërtimit të tempujve, të cilat gjithsesi dolën në dritë vetëm nga fundi i shekullit VIII dhe kultet e parë apoloniane që nisën në Delfi – të cilin Homeri nuk e njeh - dhe në ishullin e Delos). Duke u nisur nga kjo, u sajua gjeneanologjia e pushtuesve parahelenë: historia e Greqisë fillon me këtë legjendë.

Le të kthehemi te Kranaosi. Ky mbret pellazg i rrëzuar nga froni ishte martuar me Pedias, që lindi tri vajza: Kranaen, Kranaikmen dhe Atthisën, së cilës i dha emrin e saj Atikës. Për të shkrirë historinë e ngadhënjimtarëve helenë me atë të pellazgëve autoktonë, Amfiktionin e bëjnë dhëndër të Kranaos! Nga ana tjetër, legjenda na thotë se Amfiktioni (vëllai i Helenit, emër eponim i grekëve) e kishte dëbuar mbretin Kranaos. Pra, nga kjo del qartë pushtimi i parë i Athinës nga grekët. Legjenda e Kekropsit do t'i jetë mbivendosur asaj të Kranaosit, e cila, sipas gjasave, i ngatërron edhe më shumë pistat. Kështu, fakti që

Kekropsin (egjiptiani i Saisës) e bënë "mbretin e parë të Athinës", provon pushtimin e këtij qyteti nga kolonët semito-egjiptianë. Si rrjedhojë, pas Kekropsit aty nuk mund të kishte një mbret (Kranaos, pellazgu) që kishte dalë nga një popull i nënshtruar! Pothuajse gjithshka që i takon historisë së paraardhësve të grekëve është bërë nga ky lloj manipulimi.

Megjithatë, është e qartë se mbretërit apo prijësit dorianë ishin me zanafillë semito-egjiptiane (Herodoti, VI, 53/ VIII, 73 – Makabè XII, 1 - 23. etj.), sa për popullin dorian, ai ishte me zanafillë ilire. Bëhet fjalë për periekët (qytetarë të lirë, të klasës së ulët) pasardhës të popullsive paradoriane (në këtë rast pellazgo-ilire). Ndërsa spartiatët ishin pasardhësit e vërtetë të pushtuesve semito-egjiptianë. Është kjo zanafillë pellazgo-ilire e popujve të pushtuar që i ka detyruar disa autorë antikë dhe të kohëve të sotme të thonë se dorianët rrjedhin nga popullsitë që vinin nga veriu. Përveç kësaj emri Dorë, Dorët shpjegohet në bazë të gjuhës shqipe, dhe do të thotë "dorë apo një grusht" (kuptimi i parë) dhe "kategori, grup, klasë, mjedis" (kuptimi i dytë), ndërsa emri Hiperboreanë shpjegohet me fjalën Epër borët që do të thotë "përtej, mbi dëborën". Përveç kësaj, mbreti i parë legjendar (përpara pushtimit të Peloponezit) i Spartës, Oibalos ose Oebalos, gruaja e tij Bateia, si edhe biri i tyre Tindari, mbanin emra të mirëfilltë ilirë

Le të kthehemi në këtë Veriun e famshëm, të cilin grekët e trajtojnë (pa të drejtë) si vendin e zanafillës së tyre, që nuk është gjë vjetër veçse Iliria e Jugut dhe Epiri i Veriut, dy krahina që gjithmonë kanë qenë të banuara (madje deri në ditët tona) nga popullsi thrako-ilire (Epiri, emër gjithashtu i përkthyer në bazë të gjuhës shqipe me epër - epëri dhe që do të thotë "ajo që është sipër apo përtej", që nënkupton se është matanë Greqisë"). Mbretëria e të vdekurve e mitologjisë greke konceptohej e lokalizuar në një vend verior të largët (Hiperbore), ndërkohë që në të vërtetë ishte në kufi të Epirit! Ky ishte vendi i të përtejmes: pragu i botës së të gjallëve. Duhej kaluar lumi Akelosi për të hyrë aty. Disa

autorë antikë pohonin se Greqia mbaronte në lindje të lumit Akelos. Por pjesa më e madhe e historianëve dhe e gjeografëve antikë, nga të cilët edhe Efori, e niste Greqinë nga perëndimi, pikërisht në Akarnani, vendi i parë që gjendet në kufi me Epirin. Më tej në veri, Epiri nuk bënte pjesë në Greqi, të paktën në epokën klasike (cf. Efori, Straboni, VIII, I, 3). Megjithatë, gjatë kësaj epoke klasike, Akarnania dhe Etolia nuk ishin shumë të helenizuara dhe kishin mbetur për pak kohë jashtë botës greke. Epiri është bërë pjesë e Greqisë shumë vonë (shekulli III). Së fundmi, për grekët e shekullit V, Ilirët dhe Maqedonët ishin Barbarë (atëkohë kjo fjalë nuk kishte ende kuptimin që i japin sot, por, sipas autorëve antikë, emërtonte etnitë e ndryshme nga grekët, ata që nuk flisnin gjuhën e tyre).

Homeri tek Iliada dhe Odiseja flet vetëm për danaenë, akeanë, argjianë dhe jo për grekë. Helenët (fis i Thesalisë jugore të quajtur po ashtu Argosi pellazg), në epokën e tij nuk formonin ende një popull ose një komb (Tuqididi, 1, 3). Homeri pohon në Iliada se "Zeusi është pellazg dhe dodonas" (XVI, 234). Pikërisht këta pellazgë ishin të trajtuar nga të gjithë autorët antikë grekë si banorët e parë të Greqisë përpara se të arrinin helenët. Tashmë të shohim edhe një fjalë që është kuptuar gabim ose është fshehur. Në të vërtetë, grekët, meqenëse nuk ishin autoktonë, kanë mbërritur nga ndonjë pjesë tjetër. Meqenëse nuk kanë ardhur nga veriu (janë munduar të na bëjnë të besojmë të kundërtën) ata nuk janë gjë tjetër veçse të huaj të ardhur nga diku tjetër. Është kjo fjalë 'diku tjetër' që është shumë e vështirë për ta përcaktuar saktësisht. Por legjendat, të cilat nuk janë veçse fakte historike të zbukuruara, të idealizuara apo të metamorfozuara, na japin disa tregues të vlefshëm mbi etnitë e para të huaja që kanë pushtuar vendin e pellazgëve: Danaenët (egjiptianët nga të cilët rrjedhin dorianët), kadmenët (fenikasit) dhe pelopidët (asirianë). Midis popujve të Greqisë arkaike, jonianët, etolianët dhe arkadianët rridhnin nga Pellazgët, populli vendase që u nënshtruan nga pushtuesi helen: ata mund të pretendojnë

së janë autoktonë. Mirëpo Herodoti e shpjegon mjaft mirë se Jonianët (i onë = i jonë) ishin Pellazgë, të cilët, pasi hasën ndër grekë dhe mësuan gjuhën e tyre, u bënë të gjithë helenë. Jonianët ("i onë" nw gjuhwn shqipe), ishin pra një grupim i popullsisë pellazge që përshtatën qytetërimin e pushtuesve helenë, duke e asimiluar kulturën e tyre dhe duke e integruar etninë e tyre (Herodoti I, 56, 57, 58 / VIII, 44). Gjithsesi, Homeri i përmend vetëm një herë jonianët (Iliada, XIII/ 685) dhe dorianët (këta të fundit janë cituar vetëm në Kretë dhe jo në Greqi: Iliada XIX, 177). Megjithatë, këto dy citime janë trajtuar nga specialistët e Homerit dhe kritikët aleksandrinë si ndërfutje të mëvonshme. Kështu, gjithçka të bën të besosh se periudha homerike ka qenë përpara lindjes së qytetërimit grek, e thënë tamam, e referuar nga shumë logografë të shquar apo historianë të periudhës klasike, madje ka qenë e fundit të periudhës arkaike. Por poemat epike dhe në veçanti Iliada shfaqin veçorinë e përzierjes së ngjarjeve të lashta me ato më të vonshme si dhe me ato bashkëkohore të Homerit. Kështu poemat homerike i japin personazheve të epokës homerike ritet bashkëkohore të Homerit.

Kundërvënia joniano-doriane haset në të gjithë historinë greke, ku gjithçka i ndan: Jonianët rrjedhin nga Pellazgët autoktonë dhe dorianët janë semito-egjiptianë. Ja përse kjo kundërvënie midis dy etnive të ndryshme – njëra e përbërë nga elemente vendase të helenizuara (madje të përziera) dhe tjetra plotësisht e huaj (Herodoti, VIII/73 – VI, 53) ka ravijëzuar pjesën më të madhe të historisë së lashtë greke: pushtimi i Athinës pellazge, joniane prej semito-egjiptianëve (helenë të vërtetë); luftë e pamëshirshme (lufta e Peloponezit, cf. Tuqididi, Lufta e Mesenikut) për të arritur pushtetin suprem; mosmarrëveshje politike, luftërat për influencë, për themelimin e kolonive etj. Të rrallë janë ata që kanë përcaktuar sensin e këtij antagonizmi të mprehtë midis dy përbërësve etnikë të popullit grek : për të vrojtuar dhe zbuluar gjithçka që i vinte përballë njëri-tjetrit këto dy grupe etnike të quajtura si të një trungu, të cilat për më tepër zhvillonin luftëra të pafundme vëllavrasëse.

Së fundi, mund të nxjerrim përfundimin se poemat homerike përbëjnë një fidanishte që na jep disa saktësime të rralla si dhe zbulime mbi periudhën arkaike, atë të Greqisë që po lindte. Në veprën e tij (Greqia...PUF/1939) Robert Kohen shpjegon mirë atë që poemat homerike i frymëzojnë cilido hulumtuesi modern. Në të vërtetë, ky autor pohon që epoka homerike ka qenë e konceptuar midis viteve 750 dhe 650 para Krishtit, qoftë nga një bashkësi rapsodësh të Kios, qoftë nga një poet i vetëm (Homeri), qoftë edhe se ka qenë pjesë e një tradite parahelene (legjendë), e cila është marrë dhe është ripunuar sipas nevojave të kauzës helene të periudhave të para të kolonizimit të Azisë së Vogël dhe në veçanti të Triadës. Është kjo teza e fundit, që unë mbështes, argument në mbështetje të saj në veprën time të ardhshme. Kjo është hipoteza e mbajtur nga shumë autorë modernë, ndër të cilët Emil Miro, J. Berard, Finlei... dhe është bojkotuar nga ata që gjithmonë i kanë thurur lavde hipotezës të pranuar në përgjithësi.



Ekspansioni i indo - europianëve

Kështu, sipas pjesës më të madhe të autorëve antikë, Pellazgët dhe fiset e tyre të shumtë të një trungu luzmonin në rajonin ballkano-danubian dhe në pellgun mesdhetar përpara mbërritjes së helenëve (cf. Herodoti I, 56, 58/ II, 50, 52/ VII, 94/I, 46/ VIII, 44; Tuqididi I, 3, etj): në Ballkan, duke përfshirë të gjithë pjesën e jugut, ndër të cilat Thesalia, Atika, Arkadia, Argolida ose Lakonia (Pellazgët, arkadianët, dolopët, perrebët, lapithët, driopët, enianët, ilirët, trakët, peonianët, dardanët, triballët, tesprotët, molosët, kainët, Gjetët, dakët, misianët etj.) Kreta (Pellazgët, cf. Homeri XIX, 177/Herodoti I, 56, 57, 58/ VII, 94, 95/I, 173...); ishujt e Egjeut (pellazgë, tirenian, karianë, leleg, lisianë); Azisë së vogël (pellazgë, trojanë, teukër, lidianë, japodë, dardanë, frigjianë, moskë, enetë, paflagonë, kaukonë etj.); Itali (pellazgë, ligurë, etruskë, mesapë, japigë, pisenianë, daunianë, venetë etj.); gadishulli Iberik (iberë, baskë); Kaukaz (kolkidianë, kaukazianë etj.; Qipro (driopët); Palestinë (filistinët, girgashitët, jebuzianët...) etj.

Nëse nuk vendos një lidhje midis pellazgëve, thrako-ilirëve, frigjianëve me shqiptarët e sotëm, kjo duket e pakuptimtë dhe habitëse! Në të vërtetë, ky është gabimi që kanë bërë disa, d.m.th duke e trajtuar emrin pellazg si një emër gjinor që përmbledh popuj të ndryshëm dhe, për më tepër, duke arritur në përfundimin se ky popull parahelen pa dyshim që ishte zhdukur, ndërkohë që ai përvijon në Shqipëri nëpërmjet thrako-ilirëve të fundit, pasardhës të etnisë pellazge. Pra, me një të rënë të lapsit zhduket rëndësia e këtyre pellazgëve dhe tërthorazi janë frenuar apo ndaluar hulumtimet në lidhje me këtë.

Megjithatë, duhet ditur se popujt e lashtë, për të folur më saktë secili shtet, ishte i ndërtuar dhe i përcaktuar me kufij të përpiktë (me ferra, mure rrethues, roje kufitare etj.!), si ato që ekzistojnë në kohët tona. Për sa i takon pellazgëve, bëhet fjalë për një popull të përbërë nga "tribu" (fisa) të panumërta, të cilët kishin emra të ndryshëm, por që flisnin midis tyre të njëjtën gjuhë, madje kishin edhe të njëjtat tradita. Fjala tribu në kuptimin e saj të vërtetë përcakton një nënndarje të të

njëjtit dhe të vetmit popull që ka të njëjtën gjuhë, besëtytni të njëjta, tradita të njëjta, të njëjtin organizim shoqëror, që jeton në të njëjtin vend apo që zhvendoset i gjithë së bashku. Në lidhje me numrin e madh të popujve me zanafillë pellazge, Herodoti citon shembullin e trakëve (popull pellazg, i mirëfilltë), i cili, sipas tij, ishte "populli më i shumtë në numër në të gjithë botën, pas indianëve" (V, 3). Megjithatë, Plini (Historia natyrore, libri IV) pohon se ilirët (vëllezër të një race me thrakët) formonin dymbëdhjetë fise dhe treqind kombe. Ata i quajnë skritari dhe si vendndodhje të tyre caktojnë viset pranë Kolkinumit (Dulcigno, ka të ngjarë Ulqini i lashtë, qytet shqiptar i marrë nga malazezët). Ptolemeu kujton se në epokën e tij (shekulli II pas Krishtit) banorët e qytetit të Albanopolis (sot Zgërdhesh, pranë Krujës në Shqipëri), quheshin arbanitë ose albanitë dhe skirtonë (që përqaset me Skritarin e Plinit dhe me fjalën Shqiptar, emri kombëtar i shqiptarëve).

Të mos harrojmë se grekët ishin një pakicë drejtuese, e cila kishte pushtuar një vend që i përkiste popullsive autoktone parahelene, prej së cilës ata absorbuan një pjesë të madhe të kulturës dhe gjuhës së tyre, siç e përcaktuam në kapitujt e mësipërm.

Fillimisht Pellazgët e parë ishin një popull gjahtar – vjelës neolitik, pastaj barinj dhe më pas bujq - blegtorë dhe, më në fund, metalurgë të shkëlqyer dhe ndërtues të mrekullueshëm fortesash dhe muresh rrethues, të quajtur ndryshe ciklopikë ose pellazgjikë. Zbulimi i metalit ishte shenjë e pararendësit të qytetërimit pellazg, që u quajt ndryshe danubian, proto-danubian, proto-ilir, egjeas, mikenian etj. Në fakt, mikenët (emër i shpikur nga arkeologët modernë) ishin një popull parahelen, pra pellazgë dhe jo grekë. Egjeasit (emër i dhënë në mënyrë të padrejtë nga historianët popullsive të ishujve të detit Egje) ishin gjithashtu popuj pellazgë, të tillë si lelegë, karianë, lisianë, kretas etj. Këta të fundit, ka të ngjarë të kenë qenë përzier më vonë me popullsi të tjera mesdhetare.

Përveç sqarimeve të sjella nga argumentet historike arkeologjike ose antropologjike, ekzistojnë prova të tjera të dukshme të përhapjes

dhe të lulëzimit të pellazgëve në dy ekstreme të Europës, dhe ato janë nga lëmi i gjuhësisë. Rasti i ibero-baskëve, kaukazianëve dhe armenëve në lidhje me këtë është kuptimplotë. Emri i iberëve shpjegohet nga gjuha pellazgo-shqiptare: i parë. Në të vërtetë, iberët, të grumbulluar që në antikitetin e hershëm në gadishullin të quajtur Iberik, do të kenë arritur përpara të tjerëve, d.m.th. të parët që u nisën apo që u ndanë nga grupi zanafillor. Madje arrihet të nxirret një numër i konsiderueshëm fjalësh të fjalorit bask (afërsisht 90) dhe toponime të shumta të shpjegueshme në bazë të gjuhës së sotme shqipe. Gjuha baske e ndërton foljen në bazë të një rrënje me anë parashtesash apo prapashtesash, duke përfshirë vepruesin, kundrinën, pësuesin si dhe veprimin, ashtu si në gjuhën shqipe etj. (cf. studime gjuhësore).

Përveç të tjerave, Benlou nuk ka gabuar: "Hasen në Spanjë një varg emrash që mbarojnë me nda, ndo, ua që janë tipike liguro - ilire: Kolenda, Asendo, Bondua... Garone (Garunda)". Lahovari, duke ecur në të njëjtin drejtim, shpjegon: "Fakti që ky emër kolektiv gjendet [emra që mbarojnë me ista, este], përveç Ilirisë, edhe në vende me toponimi jo-ariane, duhet të mjaftojë për të provuar, përveç kësaj, edhe karakterin para-arian, ose të një periudhe shumë më të vonë, por supersticioni indo-europian i bëri studiuesit të mbyllin sytë para shumë gjërash, megjithëse të dukshme... Midis gjermanishtes së hershme, etruskishtes dhe gjuhëve ballkanike parasllave, moderne dhe të lashta, si dhe midis baskes dhe gjuhëve të Kaukazit, po ashtu edhe gjuhëve të Ballkanit, udhëkryq i ndikimeve aziatike dhe mesdhetare do të bëhet edhe ekzistenca e lidhjeve fonetike më të ngushta, të cilat as nuk t`i merr mendja".

Në lidhje me këtë gjuhë, që zë një hapësirë të stërmadhe, ja edhe mendimi i autorëve të tjerë modernë. Karlo Batisti (Polemica etruske në studimet etruske, VIII) pohon: "Nga mbetjet e shumta para-indo-europiane në toponomastikë dhe leksik, mbi të gjitha në Alpet dhe përgjatë kurorës së Apenineve, vazhdojnë të mbijetojnë tipet e fjalëve

që gjenden në Iberi dhe në Azinë e Vogël". Thomopopulos (Pellazgjika, 1912) pranonte analogji të shumta midis shqipes dhe etruskishtes. Ja një tjetër mendim, ai i Buonamiçit (Studime etruske, 1921): "Qysh prej 1920 unë kam formuluar hipotezën se etruskët i përkasin një shtrese shumë të hershme, që do t`a quaja thrako-frigjiano-ilire". Alfred Ernut (Elemente etruske në fjalorin latin, 1930) dëshmon nga ana e tij, pasurinë e elementeve etruskë në fjalorin latin dhe pohon se autorët antikë latinë nuk kanë denjuar të pohojnë ekzistencën e shumë fjalëve etruske. I. Sesi (1927) pohon se etruskishtja është një idiomë anariane, egjease, ashtu si ajo lidiane, lisiane, pellazgjishtja e paraheleneve me "fonema jo zanafillore, por që mbajnë vulën indo-europiane". Hubshmidt hamendëson një shtresë gjuhësore të përbashkët për të gjithë hapësirën mesdhetare të mbuluar me një shtresë hispano-kaukaziane, e cila do të ketë ndikuar edhe në veriun e Europës.

Rreth vitit 610 para Krishtit, një fis thrako-ilir vendoset në krahinën e Uratrusë në epokën e mbretit Medes Siaksar. Ky fis quhej Haikan, sipas emrit të prijësit të tij Haik, themelues i mbretërisë që mbajti më vonë emrin Armeni dhe simbol i popullit armen. Emri i Haik-ut mund të ngatërrohet me fjalën shqipe hek (heik – dialekti gegë) ose hik, që do të thotë "të ikësh, t`ia mbathësh, të nisesh" (cf. në studimin Konkordanca Gjuhësore janë rreth 40 fjalë armene që deshifrohen nëpërmjet gjuhës shqipe). A duhet të ketë marrë arratinë ky fis thrako-ilir për të shpëtuar nga diçka (për të shmangur një ndëshkim, për shkak vrasjesh apo thjesht "niset" për aventurë etj.)?

Sa për gjuhën e lashtë kaukaze, me morfologjinë dhe strukturën gramatikore të saj, ajo i ngjan gjuhës shqipe. Autorë të shumtë antikë, ndër të cilët Straboni (Libri VI,/ 4/2), Apiani (III, 8, 4) ose Ptolemeu kanë përmendur shqiptarët (albaniens) e Kaukazit. Ky i fundit pohon se në epokën e tij, shqiptarët e Kaukazit ishin të ndarë në njëzetegjashtë popullsi, nga të cilat secila fliste dialektin e saj, ose shqipen e veçantë. Straboni përmend këto tri popullsi të bashkuara të Kaukazit. "Armenët

dhe popujt e njohur nën emrin shqiptarë dhe iberikët që banonin prapa Kolkidës, kishin nevojë vetëm për praninë e një guvernatori romak"...

Nga ana tjetër, nuk harrojmë që këta që quhen me një emër Popujt e Detit, të njohur nën këtë emër qysh nga viti 1190 (filistinë ose pelesetë, turshas ose tiras, teukrë ose zekerë, lisianë ose lukus, dardanë ose dardanu, karianë ose uesheshë d.m.th njerëz të Uasos në Karia etj.) nuk ishin gjë tjetër veçse popullsi proto-ilire arkaike, të cilat, duke filluar nga viti 2200 para Krishtit, zunë rajonin lindor të jugut të Europës (Iliri, Epir, Thesali, Peloponez, deti Egje, Anatoli etj.). Filistinët (pelesht-im nga Bibla, emri i pellazgëve i shtrembëruar nga semitët) ishin pellazgë të vërtetë (shpellagji, emri zanafillor = popull i shpellës"). Dardanët dhe teukrët ishin fise trojane. Dardanët e Azisë së Vogël nuk ishin tjetër veçse dardanë, fis ilir i Ballkanit, (Kosova e sotme). Këta të fundit, bashkë me teukrët, janë me zanafillë trojane, nga të cilët Dardani dhe Teukro ishin stërgjyshit legjendarë. Përveç kësaj, analet hitite i përmendin dardanët si aleatë të Trojës. Frigjianët (pellazgo-shqiptarët = frigji që do të thotë "frigohet" d.m.th. në kuptimin e gjerë të fjalës "të shpëtuarit nga shkatërrimi" aluzion për tërmetet, shpërthimet vullkanike apo përmbytjet që do të kenë ndodhur në këtë zonë në mijëvjeçarin III dhe II), që vinin nga Ballkani, ku u quajtën brigët (Herodoti VII 73/ VII, 45/VII, 185). Lidianët u quajtën meonianë (Herodoti I, 7/VII, 74). Ata banonin në Mesia, vend thrak, përpara se të kalonin në Azinë e Vogël. Mushkitë (moskët) janë nga i njëjti trung pellazg. Këta të fundit gjithashtu kanë kaluar në Azinë e Vogël prej Europës ballkano-danubiane. Ata ishin kalorës dhe rritës të shkëlqyer kuajsh apo mushkash. Në të vërtetë, emri i tyre shpjegohet nëpërmjet gjuhës pellazgo-shqiptare: Kjo fjalë rrjedh nga shqipja mushkë dhe në kuptimin e gjerë të fjalës do të thotë "rritës mushkash". Analet asiriane shënojnë dyndje popullsish mushkish, që do të kenë prekur deri kufijtë e Eufratit të Sipërm. Sa për misianët, Herodoti (I, 171) pohon se ata bënin pjesë në të njëjtën etni, ashtu si lidianët, karianët (Lidos, Misos

dhe Kar ishin vëllezër, thotë ai) dhe lelegët (emri i lashtë i Karianëve). Të mos harrojmë, se, sipas Herodotit (I, 94), etruskët (tirrenët) janë me zanafillë nga Lidia, ata u larguan për në Itali rreth shekullit XIII para Krishtit. Ja çfarë mendon Straboni (libri V) në lidhje me të qenët nga një trung pellazgo-etrusk: "Nuk është për tu habitur nëse gjen në Italinë e lashtë [epoka etruske] legjenda që përkojnë njëherazi me Pellazgët dhe trojanët, sepse këta tre popuj rridhnin nga i njëjti trung etnik".

Kështu, ne kemi prova bindëse se të gjithë këta popuj janë të lidhur midis tyre nëpërmjet të njëjtës gjuhë, anë të njëjtat kulte, të njëjtën kulturë dhe të njëjtat ngjarje. Onomastika na jep një ndihmë të madhe për të gjetur gjurmët e të gjitha këtyre popullsive të lashta pellazge.

Në të vërtetë, toponimia dhe oronimia e shumë vendeve të Europës zbulojnë ekzistencën e së njëjtës gjuhë të përdorur në një epokë të hershme, prej Atlantikut deri në Detin e Zi dhe prej brigjeve të Danubit deri në Mesdhe (cf. studimi im Mbi përputhjet gjuhësore). Përveç kësaj, emra të shumtë (antroponime, etnonime, eponime etj.) të Greqisë parahelene, të mbërritura te ne falë poemave epike, epigrafeve dhe shkrimeve antike, nuk shpjegohen aspak nga gjuha greke, por nga gjuha pellazgo-shqiptare, një lloj fosile e gjallë dhe e vetmja gjuhë parahelene që i mbijetoi stuhive të kohëve. Në lidhje me pjesën më të madhe të këtyre popullsive parahelene, ja edhe disa shënime plotësuese dhe mendimi i disa autorëve antikë dhe të kohëve të sotme që e mbështesin apo e përkrahin thelbin e studimeve dhe analizave të mia mbi Pellazgët dhe fiseve të tjera të të njëjtit trung.

Herodoti (I, 56) mendon se e gjithë Greqia quhej "Pellazgji" përpara mbërritjes së grekëve aty. Për Tuqididin, banorët e Lemnosit, të Atikës si dhe bizaltianët, krestonianët, edonianët në epokën e tij ishin pellazgo-tirrenë (IV, 109). Sipas Eskilit, perandoria pellazge, përpara mbërritjes së Danaos, kishte si kryeqytet Argosin dhe si kufi lindor Algosin dhe Strimonin. Euripidi quan "pellazgë" banorët e Argosit, Efori e trajtonte

si "pellazg" Peloponezin parahelen. Herodoti (VII, 94) popullsinë e bregdetit Aegialos, e cila më vonë mori emrin Akaia, e trajtonte si pellazge. Simonidi pohon se perrebët përfaqësonin trungun pellazg të popullsisë thesaliane. Për atë, banorët e krahinave të Girtonit, Peneas, Osas, Pelionit, Demetrias, Larisas, Skotusas, Mopsionit, Atraksit dhe të buzëliqenit Nesonide, Boibeisit, ishin një përzierje e perrhebëve dhe lapithëve. Dolopët së bashku me Pellazgët trajtohen se janë banorët e parë të ishullit të Skiros (vend fqinj i Thesalisë, vend pellazg, i mirëfilltë). Pauzani (Korinthiaka, Argolis, I/II, 22) e trajton Argosin si një mbretëri të Pelasgosit, ku gjendet varri i tij dhe se Akropoli i këtij qyteti u quajt Larisa, sipas emrit të bijës së tij, dhe se Pellazgët, kudo ku jetonin, i quanin qytetet e tyre Larisa. Straboni (VIII, 1, 3, 30 - 3, 31 / II, 3, 31) pohon se emri "Olimp" është një nga toponimet dhe oronimet e shumta të Peloponezit me zanafillë "thesaliane". Ai pohon se epirotët janë me zanafillë pellazge. Për atë, thrakët, ilirët dhe epirotët banonin përbri Greqisë (VII, 7, I). Për Eforin dhe Pseudo-Skilaksin, Greqia shkonte nga gjiri i Ambrakisë deri në grykat e Peneas thesaliane. Gjatë periudhës helene, banorët e Kiosit, Lesbosit, Lemnosit dhe Imbros shënoheshin si pellazgë. Megjithatë, autoetnonimia "helenët" dëshmohet vetëm në fillim të shekullit VI (mbishkrim atik).

Karl Otfrid Myler është një nga autorët e rrallë të kohëve të sotme, që e kuptoi rëndësinë e qytetërimit pellazg në lindjen e Greqisë. Ja çfarë pohon ai: "Me më shumë mendjemprehtësi të depërtohet në historinë e Greqisë, më shumë vëmendje t`i kushtohet elementit pellazg të sakrifikuar deri më tani". Nieburi zbuloi arsyen kryesore të zhdukjes së qytetërimit pellazg, këtë lehtësi të habitshme të pellazgëve për tu identifikuar në të gjitha gjërat me pushtuesit e vendit të tyre. Të dy autorët e lartpërmendur e vendosin vatrën zanafillore të pellazgëve në veri-perëndim të Greqisë, d.m.th në Epir dhe në Ilirinë e jugut.

Maks Myleri, në veprat e tij të mitologjisë krahasuese, ka paraqitur se gjeneza e mitologjisë helene është krijuar në thelb me anë të një

interpretimi metaforik, poetik ose me shndërrimin e emrave të lashtë teoforë të perëndive pellazge në sensin e etimologjisë populo-vulgare. Për këtë autor, panteoni grek në pjesën më të madhe i detyrohet një materializimi të teologjisë abstrakte të pellazgëve parahelenë.

Robert Koheni pohon me siguri: "Duhet kujtuar se ata (grekët) u futën në udhën e përparimit vetëm kur u vunë në zotërim të trashëgimisë parahelene, d.m.th. të thesarit të tyre material e intelektual... Të grumbulluar për shekuj me radhë nga individë, që sigurisht ishin të një zanafille të ndryshme me ta... nëse bën bilancin për atë që helenët iu detyrohen paraprijësve të tyre... bota parahelene ishte pafundësisht më e madhe se sa do të jetë bota klasike greke... shihet fare lehtë gjithçka që grekët iu detyrohen këtyre parahelenëve gjeni... thuhet nuk do të ishte e pamundur "të tregosh cili ishte themeluesi i parë i qytetërimit grek: do të mjaftonte t`i hidhje një vështrim listës së fjalëve parahelene, të cilat kanë kaluar në gjuhën e pushtuesve".

Në tezën e tij mbi Ligurët dhe Pellazgët, Jozef Karst pohon: Nëse këta dijetarë [Gustav Mejer, H.Petersen, H.Bariç, Norbert Jokl] nuk kanë mundur të përthithin shumë material, kjo vjen nga neveria që kanë për tezat pellazge të Georg von Hahn (Studime Shqiptare, 1854) dhe paraprijësve të tjerë, ndërsa është anashkaluar plotësisht elementi para-arian në Shqipëri".

Emil Miro pohon se premisat e historisë së Greqisë, e thënë saktë, vendosen midis shekujve VIII dhe në fund të shekullit VI. Ai vendosi të paraqesë provat në mbështetje të asaj se vepra e Homerit i shërbente interesave politike të Greqisë që po lindte. Ai gjithashtu mendon se Homeri do t'i ketë nxjerrë krejtësisht nga thesari poetik i grumbulluar përpara tij prej një populli rapsodësh dhe në të njëjtën kohë do ta ketë kthyer në vepër të tij.

Mishel Breali e ngjit thurjen e Iliadës dhe të Odisesë së Homerit në shekullin VII, madje në shekullin VI. Viktor Berardi mendon se këto poema epike nuk kanë arritur të realizohen vetëm përpara shekullit

VII. Zhan Berardi nga ana e tij pohon: "... është një fakt i sigurt, se, sido që të jetë Odiseja, ajo çfarë na paraqet sot kjo vepër, përmban elemente të epokave të ndryshme... Nga shekulli IX deri në shekullin VII këta detarë fenikas kanë patur një rol të rëndësishëm në rilindjen e epokës arkaike greke, pra, nga fundi i shekullit IX, kur themeluan Kartagjenën".

Autorë të shumtë antikë (kritikë aleksandrinë të epokës helene) dhe modernë pohojnë se "rregulluesit" kanë vazhduar punën e tyre të ndërfutjes dhe të manipulimit deri në fund të shekullit VI, madje edhe më vonë. Viktor Berard, Pol Mazon, Mauris Kruzet dhe të tjerë autorë modernë i veshin Homerit vetëm një pjesë të dy poemave, që kanë mbërritur deri te ne me emrin e tij.

A. Zharde pohon: "Vetë grekët nuk dinin asgjë mbi historinë zanafillore të vendeve që do të bëhen Greqi... Tuqididi, ndërsa studion me shpejtësi Greqinë, nxjerr nga Homeri të dhënat dhe argumentimin e tij... Në mungesë të një historie të shkruar ... historia më e lashtë greke merr me lehtësi formën e gjeneanologjive... Nga këto gjeneanologji mitike është kërkuar të nxirren të dhënat historike, duke shënuar se të moçmit, nëpërmjet të qenët nga një trung i heronjve, kanë dashur të paraqesin përafërsinë e popujve dhe të racave... Historianët janë përpjekur të bëjnë historinë e dialekteve greke, historinë e fiseve greke: kjo është të harrosh që gjuha është e pavarur si nga raca dhe nga kombësia". Megjithatë ai është i bindur se në epokën neolitike, një qytetërim i tillë, i cili dëshmon një qeramikë identike, shtrihej në të gjithë Greqinë e Veriut, nga krahina e Orkomenisë deri në kufijtë e Maqedonisë dhe të Thesalisë shumë më e pyllëzuar se sa sot, pra më pak e depërtueshme, dhe se për një kohë të gjatë ishte e zënë nga popullsi barinjsh, ka të ngjarë pellazgë. Ai shton se figurat e turpshme të zbuluara në shtresën e parë thesaliane, të kujtojnë thënien e Herodotit (III, 51) ku ai ia vesh pellazgëve tipin e hermesit itifalik, prej të cilëve e huazuan grekët.

Paçi (Gjurmë trake në Adriatik, 1907) nxjerr lidhjet etnike dhe gjuhësore midis popujve ilirë dhe popujve dorianë.

Së fundi, duke u nisur nga gjithë këto kërkime, studime dhe analiza, unë kam shtjelluar dhe jam thelluar në dy volume të tjera të mia për botim (Greqia parahelene: Pellazgët ose zgjidhja e një enigme) se :

1) Pellazgët dhe fiset e shumtë të të njëjtit trung janë të parët popuj evropianë të njohur dhe tepër të cituar nëpër shkrimet antike, qofshin ato greke, latine apo më të lashta, d.m.th. analet ose tekstet hitite, ugaritike, asiriane ose egjiptiane.

2) Qytetërimi grek i mbivendosur ndaj atij të Pellazgëve me shumë prurje semito-egjiptiane (gjuha, organizimi shoqëror, perënditë dhe kultet orientale, ndërtimi i tempujve etj.).

3) Elementet fillestare të qytetërimit grek shfaqen në të vërtetë vetëm nga shekulli VIII përpara Krishtit. Asnjë tregues, sado i vogël, nuk ka dëshmuar apo mbështetur ndonjë shfaqje të Helenëve në këtë periudhë.

4) Poemat, të ashtuquajtura të Homerit, janë një fond i lashtë i përcjellë gojarisht dhe se logografët i kanë ripunuar dhe i kanë sjellë përfundimisht në formë në kohën e Pisitratit, në shekullin VI para Krishtit (rreth viteve 546–527). Unë personalisht jam i bindur se Homeri nuk ka shkruar asgjë. Disa madje pohojnë se ishte i verbër dhe të tjerë se ai kishte shkruar epitafin e Midas, i cili ka vdekur rreth vitit 676 para Krishtit. Homeri, nëse ka ekzistuar, si poet epik që ishte, thjesht do t'i ketë kënduar këto poema nga qyteti në qytet. Rilindja e epopesë fillimisht ka qenë e lidhur me zhvillimin tregtar dhe kolonial të pushtuesve helenë. Ajo do të shfrytëzojë një legjendë të vjetër epike, që do të pasurohet me fakte dhe vepra ose me ngjarje bashkëkohore të Homerit ose të homerikëve (bashkësia e rapsodëve të Kios). Pra është fjala për një rithurje fragmentesh parahelene të përziera me elemente historike më të vona të shumë shekujve. Poemat e para epike u krijuan në Eolidë (Azi e Vogël) ndërsa mbërritja e grekëve të parë mori formë në Joni, aty ku luftërat midis grekëve dhe vendasve bënë që të lindë

dhe të rilindë legjenda e Luftës së Trojës. Për disa autorë, ndër të cilët Emil Miro, Homeri banonte në qytetin e Smirnës dhe shkonte shpesh në oborrin e vogël të pasardhësve të Agamemnonit në Kimé; muza e tij paraqiste bëmat e mëdha të pelopidëve të epokës.

5) Gjuhësia moderne, plot mangësi dhe fragmentare, e ka fshehur faktorin pellazg, duke e zëvendësuar pa të drejtë me sistemin indo-europian. Tashmë ajo duhet t'i vihet seriozisht gjuhës shqipe (e vetmja gjuhë e mbijetuar në Evropë nga kjo gjuhë e lashtë, me të vërtetë një fosile e gjallë) me qëllim që të kuptojë më mirë zanafillën dhe misteret e gjuhëve parahelene. Fakti se duhet të bazohesh në trilogjinë sanskritisht - greqisht - latinisht, ka çoroditur gjuhëtarë të shumtë, të cilët nuk kanë bërë asnjë lidhje midis këtyre gjuhëve parahelene me zanafillë pellazge (gjuha pellazge e lashtë, gjuha ligure, gjuha thrake, gjuha frigjiane, gjuha etruske, gjuha ilire, duke përmendur vetëm ato kryesoret) dhe gjuhës së sotme shqipe, e vetmja që ka shpëtuar nga këto gjuhë parahelene. Megjithatë, duhet shënuar se disa gjuhë të sotme, që kanë rrjedhur nga idioma të lashta, të tilla si ajo baske, kaukaziane, armene, sumeriane ose elamite, as që janë studiuar apo as nuk janë marrë në konsideratë.

6) Ajo, që në mënyrë të përgjithshme dhe artificiale quhet gjuhë mikeniane, nuk është gjë tjetër veçse gjuha pellazge e lashtë, nga e cila grekët kanë huazuar shumë. Nëse Ventrisi dhe Kadviku besuan se në gjuhën mikeniane zbuluan një lloj "greqishte të lashtë", rrodhi sepse kjo e fundit, në pjesën më të madhe, ka dalë nga kjo gjuhë pellazge. Ventrisi, pavarësisht "zbulimit" të tij, nuk e modifikoi perspektivën që ne pohojmë për historinë greke. "Deshifrimi" i "Linearit B" paraqet një karakter të pjesshëm dhe të njëanshëm të dokumentacionit të ofruar nga trajtesat e tij. Fjalët dhe emrat e përdorur në këtë shkrim, të frymëzuara nga "Lineari A" i kretasve, nuk janë tekste letrare dhe nuk na lejojnë të njohim as qytetërimin as historinë e kësaj epoke. Në të vërtetë, bëhet fjalë shpesh për repertorë dhe inventarë llogaritjeje të të

gjitha llojeve të prodhimeve të papërpunuara ose të përpunuara, nga të cilat emrat rrjedhin nga fjalë ose emërtime me zanafillë të huaj të mbiquajtura mikeniane. Gjithsesi prurja filologjike ose gjuhësore mbetet tepër e kufizuar. Shënojmë, po ashtu, se emrat parahelenë të perëndive të mitologjisë tashmë figuronin në tabelëzat kretase të epokës së pallateve (2700-1700 para Krishtit).

7) Arkeologjia dhe antropologjia sjellin prova plotësuese për vijimësinë e kulturës pellazge në tokën e Shqipërisë së sotme. Deri në mes të shekullit XX gërmimet arkeologjike janë drejtuar vetëm në zonat me emër ose të trajtuara si të tilla: Greqia, Azia e Vogël, Kreta, Italia, Egjipti, Lindja e Afërme etj. Prandaj deri në një epokë të vonshme nuk ka të tilla në Shqipëri, vend i cili në planin arkeologjik ishte trajtuar si tokë e askujt, e braktisur dhe e palëvruar nga qytetërimi. Gjithsesi gjërat filluan të ndryshojnë nga pushteti komunist pas viteve '50. Në të vërtetë u hapën kantiere të mëdha dhe zonat arkeologjike u gërmuan me imtësi. Më në fund nga kjo u zbulua se Shqipëria kishte një të kaluar plot jetë si në rrafshin paleolitik, neolitik apo kuprolitik edhe në atë të Bronzit dhe të Hekurit. Mbetje të shumta, që datojnë nga fillimi dhe mesi i mijëvjeçarit II, ngjasojnë të ngatërrohen me ato të rajoneve të tjera ballkanike, që datojnë në të njëjtën epokë. Megjithatë në varret janë zbuluar epigrafe që përmbajnë shkrime në gjuhën mesape (gjuha e një etnie pellazgo-ilire të Italisë së juglindjes) që zbulojnë emra të përbashkët për të dy popujt të vendosur në të dyja anët e Adriatikut. Pra, falë këtyre zbulimeve të çmuara arkeologjike, dallohet se Shqipëria e sotme nuk ka qenë aspak e izoluar nga bota ballkano-danubiane, italike, egjease. Këto zbulime (objekte të ndryshme, shpata, maska varrimesh që datojnë nga epoka mikeniane, madje para-mikeniane) kanë bërë gjithashtu të mundur të zbulohet që shqiptarët e sotëm rrjedhin nga një popullsi autoktone, vijimësia kulturore e së cilës nuk ka qenë shkëputur për asnjë çast dhe as nuk është ndërprerë qysh prej antikitetit të hershëm. Antropologjia, shkencë relativisht e vonshme, nuk ka

mbetur prapa. Në të vërtetë, qysh prej njëqind vjetësh, të gjitha studimet dhe kërkimet kanë provuar tendencën brakicefale madje hiperbrakicefale të shqiptarëve (treguesi cefalik më i lartë se 85, madje 90). Në kapitujt e mëparshëm kemi vërejtur se CH dhe CB Hauis kanë vendosur analogji të dallueshme midis kafkave brakicefale të krahinave me traditë doriane (Kretë dhe Peloponez) dhe kafkave shqiptare. Gjithashtu, kemi vërejtur se populli dorian (në veçanti periekët) ishin me zanafillë ilire.

Disa historianë (mbi të gjithë ata antikë) duke pasur tmerr për boshllëkun e mbetur nga "katër shekujt e errët" (1200–800 para Krishtit) kanë gjetur në poemat homerike nyjën e duhur për të lidhur këtë boshllëk, në mënyrë që ta ngjisin historinë greke katër shekuj më sipër. Kështu, për tu dhënë atyre një ekzistencë të mëparshme dhe "të pranueshme", "akenët" e Homerit i nxjerrin me prejardhje nga "mikenianët" e hamendësuar, emër i sajuar nga arkeologët modernë.

Ja pra historia e pellazgëve, një nga popujt më të vjetër të njohur të Europës, e panjohur nga shumica, madje nga disa autorë të rrallë, por që, prapësepraprë, është zanafilla e qytetërimeve më të mëdha europiane: greke dhe romake.



Shpërnguljet e ndryshme indo-europiane sipas katër specialistëve

PELLAZGËT

Populli parahelen madje parahistorik: emri i fiseve të dalë nga i njejti trung entno-gjuhësor

dega perëndimore	dega egjease	dega lindore
ILIRËT	LELEGËT	THRAKËT
Thesprotët (Epirotët)	Karianët	Frigjianët
Molosët	Lisianët	Trojanët
Kaonët	Kretasit	Moskët
Dodonët	Lesbianët	Lidianët
Thesalianët		Mizianët
Argianët		Etruskët
Dardanët		
Panonianët		
Venetët		
Liburnët		
Dalmatët....		
Mesapianët		Maqedonët
Japigët		Getët
Daunianët.		Dakët
Ligurët	Egjeanët	Hititët (prijësit)
Iberët (Gadish. iberik)	Popuj të Detit	Girgashitët (Palestinë)
Filistinë me zanafillë ilire, të vendosur në Palestinë		Jebuzianët (Palestinë)
Baskët		

Jonianët (Pellazgë autoktonë të kthyer në helenë pasi kanë mësuar greqishten, sipas Hekate, Herodoti, etj..)
Periekët, Hilotët, Penestët (etni ilire autoktone të nënshtruara nga Dorianët)

Keltët
Arvenët
Galët
Druidët

Kaukazianë (Thrakë)
Shqiptarë të Kaukazit
Armenë (Frigjianë)
Burshush (Afganistan)
Disa etni minoritare
në Azerbaixhan, etj.

Pasardhës të drejtpërdrejtë të
THRAKO-ILIRËVE

Shqiptarë
Shqipëri
Kosovë
Epiri
Maqedoni
Mal i Zi
Rajoni i Thrakës
(sot ne Bulgari, Greqi dhe Turqi)

Zanafilja e drejtpërdrejtë të
GREKËVE

1) Semito-egjiptianë : } zanafilla

Danaenë(Egjiptianë) } e
Akenë (Asirianë) } Dorianëve
Kadmenë (Fenikas) }
Dorianë (stërgjyshër të vërtetë
të Helenëve): Peloponez, jugu i
Azisë së Vogël, Kretë....

2) Jonianë = Atikë (ndër të ciët
Thesali, Arkadi, Egje, Qipro, Azi e
Vogël (Joni), etj. që rrjedhin nga
Pellazgët

Homeri dhe poemat e para epike

Veprat e para që njihen nga bota antike janë ato të Homerit dhe të Hesiodit. Këto janë të vetmet, sepse Herodoti (shekulli V para Krishtit) na thotë se nuk njihte të tjerë poetë para këtyre.

Homeri dhe Hesiodi kanë jetuar, sipas Herodotit (II, 53), "katërqind vjet para tij", pra rreth vitit 850. Sipas tij, të dy poetët duhej të ishin bashkëkohës. Gjithsesi, është pranuar njëzëri që Hesiodi ka lindur në Askra rreth vitit 750 para Krishtit madje në vitin 700 para Krishtit. Si të shpjegohet ky shekull diferencë? Misteri qëndron se askush nuk është i zoti të japë data të sakta. Por kjo nuk na pengon të reflektojmë, të ndërmarrim hulumtime apo të analizojmë tekstet antike. Duke pranuar se Herodoti gabohet në lidhje me "katër shekujt" duke e ndarë nga këta dy poetë, se data e lindjes Hesiodi-t është më pranë realitetit dhe së fundi se Homeri ishte bashkëkohës i këtij të fundit (pavarësisht të tjerave, kjo do të ketë qenë e mundur madje edhe me pesëdhjetë vjet ndryshim), ne mund të përshtatim kronologjinë e "ulët" për sa i takon datës së epokës kur jetoi Homeri, d.m.th. vitin 800-750 para Krishtit (më e mundshmja, ndryshimi midis dy skajeve) madje viti 700 para Krishtit (sipas disa autorëve). Disa autorë modernë pohojnë se Homeri nuk ka ekzistuar, ndër të cilët Abe d`Obinjak (HAMENDËSIME akademike ose disertacion mbi Iliadën - 1715).

A ishte i verbër Homeri? Askush nuk e vërteton dhe askush nuk është në gjendje ta hedhë poshtë. Gjithsesi, verbëria te të lashtët lidhej me largpamësinë e tyre shpirtërore, me hyjnizimin dhe me dhuntinë poetike: një poet i madh duhej patjetër të ishte i verbër! Por është pranuar njëzëri se Homeri ishte i verbër dhe se nuk mund t'i shkruante poemat e tij. Për më tepër, shkrimi që do të bëhej "greqishtja" e epokës klasike nuk ekzistonte ende, ose ishte në "ngjizje". Shkrimi u shfaq në Joni (Azi e Vogël) rreth shekullit VII para Krishtit. Por aty nuk ka patur shkrime përpara shekullit VII. Poemat e Homerit në të vërtetë u

transkriptuan nga logografët, vetëm në epokën e "Pisistratit", në shekullin VI, dhe u kopjuan në formën e tyre të sotme vetëm në epokën "aleksandrine", rreth shekullit III dhe II para Krishtit. Nëse ne i përmbledhim të gjitha këto, do të vërehet se këto poema rrëfejnë për një epope (Iliada) dhe aventurat (Odisea) që do të kenë ndodhur në shekullin XII para Krishtit, poema të kënduara nga Homeri në shekullin IX ose në shekullin VIII (rreth katër shekuj më vonë), të kopjuara për herë të parë nën Pisistratin në shekullin VI dhe më në fund plotësisht e përkryer në epokën aleksandrine, d.m.th pothuajse nëntë shekuj pas luftës hipotetike të Trojës! Është krejt normale që një vepër e tillë, histori apo legjendë, të ketë mbetur e paprekur dhe të na ketë mbërritur pa kurrfarë zbukurimesh, pa rregullime, pa manipulime. Ajo ka kaluar ndër duar të shumta dhe me ndikim, të cilët e kanë "ripunuar" sipas shijes së tyre për t'i shërbyer interesave të veçanta, kolektive apo kombëtare. Këtë askush nuk mund ta mohojë. Në të vërtetë, shumë studime serioze e tregojnë këtë. Sepse, në fund të fundit, edhe "Bibla e Shenjtë" ka pësuar këtë lloj metamorfoze (cf. kapitulli që i kushtohet kësaj teme në "Manipulimet e historisë"- vepra e ardhshme).

Në zanafillë të përcjelljes së poemave homerike gjendet Likurgu, legjislator spartiat i qytetit të tij, Soloni, legjislator athinas, tirani Pisistrati (vitet 546–527 para Krishtit) dhe biri i tij, Hiparku. Këta dy të fundit, me sa duket, do të kenë luajtur rolin kryesor. Gjithsesi, disa e venë në dyshim ekzistencën e Likurgut. Nëse ai ka ekzistuar, atëherë ka të ngjarë se ka jetuar përpara Homerit. Sipas disa autorëve, Soloni do të ketë vendosur që në festën fetare të "Panathenëve", të recitoheshin nga rapsodët veprat e Homerit. Përkundrazi, Platoni pohon në veprën e tij "Hiparku": Hiparku, më i madhi dhe më i dituri i djemve të Pisistratit, dha shumë prova të shquara të mençurisë së tij: pikërisht ai i solli për herë të parë në Atikë veprat e Homerit dhe më pas i detyroi rapsodët t`i recitonin, duke i zëvendësuar në festën e Panathenëve atë çfarë bëhet edhe sot. Ciceroni në "De Oratore" (III, 34) saktëson se

Pisistrati do t`i ketë mbledhur veprat e Homerit të mbetura andej-këndej dhe do të ketë bërë botimin e parë të tyre.

Ku do të ketë jetuar poeti ynë epik? Ka të ngjarë në një port jonian të Azisë së Vogël. Në cilin? Mileti? Asgjë nuk është e sigurt. Simonid d'Amorgos e quante "njeriu i Kios" dhe Pindari "njeriu i Kios dhe Smirnas". Thuhet shpesh se Homeri, i cili "ka lindur në Smirna, ka ardhur në Kios dhe ka vdekur në Ios", një nga Cikladat. Dihej që ai kishte lënë pasardhës ose "vijuesit" ("homerikët"), ndër të cilët ata kryesorë do të kenë jetuar në Kios. Platoni i ka përmendur shumë herë këta homerikë.

Pindari, në "Nemenenë e dytë" na thotë: "Imitojmë homerikët, këta poetë epikë, të cilët me këngët e tyre të qepur njëra-tjetra, kërkojnë që preludin e tyre ta nisin me Zeusin". Izokrati shkruan në "Mburrja e Elenës": "Disa nga homerikët tregojnë se Helena iu shfaq një natë Homerit dhe e urdhëroi të thurte një poemë për luftëtarët që kishin luftuar kundër Trojës". Së fundi, shtatë qytete debatojnë për të pasur nderin si vendlindje të Homerit.

Homeri recitonte ose deklamonte poemat e tij duke u endur nga njëri qytet në tjetrin. Ai ndiqte një traditë "gojore", e cila rrëfente një episod të luftës së Trojës dhe bëmat e lavdishme të heronjve të saj të hyjnizuar (Iliada) si dhe aventurat e Uliksit pas kësaj lufte (Odisea). Por këto epope tashmë njiheshin nga rapsodët e periudhave më të hershme se Homeri. Në zanafillë, ka të ngjarë se ishte fjala për poema të shkurtra të dallueshme nga njëra-tjetra dhe që ishin bërë për tu kënduar më shpesh ndër princat, prijësit e luftërave, gjatë gostive, ndër festa etj... . Këto poema (Iliada dhe Odisea), të tilla si ne i njohim sot (12.000 deri 16.000 vargje secila) në fakt nuk mund të këndoheshin pa shkëputje. Në këtë epokë, rapsodët viheshin të këndonin pjesë nga 300 deri në 400 vargje për një temë të caktuar, ose njërën poemë, më të rëndësishmen, prej 1.000 deri 1.500 vargje, por të ndjekura me pushime

të rregullta. Nga kjo del se, për të kënduar 12.000 deri 16.000 vargje, do të ishte një hap që disa nuk guxonin t`a kapërcenin. Përkundrazi, në Panathenet, rapsodë të shumtë zëvendësoheshin rregullisht për të recituar poemat e Iliadës dhe të Odisesë.

Është e sigurt se Homeri nuk ka qenë dëshmitar i bëmave të heronjve të tij. Afërsisht katër shekuj e ndajnë atë nga fundi i luftës së Trojës, nëse ajo ka ekzistuar me të vërtetë. Poeti ynë antik ka ngjallur kundërshti të shumta si për datën edhe për vendin e lindjes, madje edhe për ekzistencën e tij. Ja, pra, çfarë dimë ne kalimthi për rapsodin tonë grek. Pjesa tjetër është veçse hipotezë dhe hamendësim.

Sa për gjuhën homerike, ajo përfshin dialekte të lashta akene dhe arkado-qipriote; ajo në thelb është e formuar nga një përzierje e gjuhës eoliane dhe joniane, por themeli gjuhësor është "jonian", i cili ka pësuar disa modifikime të tilla, si zhdukja e digamas, shkurtime të shumta etj... Gjithashtu, është fjala për një gjuhë joniane që përfshin fjalë kretase, qipriote dhe futje të huaja të ndryshme. Gjithsesi, kjo gjuhë homerike është artificiale dhe kurrë nuk ka qenë e folur si e tillë në asnjë pjesë të botës greke.

Të gjithë helenistët dhe historianët e kohëve tona, madje dhe ata antikë, e dëshmojnë praninë e mbivendosjeve të ndryshme, kundërshtive të shfaqura dhe anakronizmave (p.sh. Homeri përmend përdorimin e hekurit që ekzistonte në epokën e tij, por që nuk ekzistonte në luftën e Trojës, ose bronzin dhe bakrin që ishin ndërkohë në përdorim). Të gjitha këto modifikime dhe mbivendosje të tjera kanë filluar në epokën e Solonit dhe pastaj në arë të Pisistratit, dhe janë vetëm "kritikët aleksandrinë" që përfundimisht i kanë ndërtuar të dy veprat të tilla siç i njohim ne sot. Dikush, të cilit ia kam harruar emrin, ka thënë se "poetët e parë epikë" kanë qenë "rregulluesit e parë". Eugjen Laser në hyrjen e tij të Iliadës (GF / Flamarion) thotë në lidhje me atë: "Ndërhyrja e një poeti gjenial, i cili dallohej nga kapja e temave tradicionale, është e pakundërshtueshme". Por poemat e Homerit, për

arsye të përsosjes së tyre, na bëjnë të ngremë pyetjen: A mos poemat kishin dalë nga një letërsi më e lashtë, p.sh. nga ato të kretasve apo të pellazgëve? Apo bëhet fjalë për një kompozim shumë më të vonshëm, më të përpunuar, më elegant, të retushuar apo për një shkrim më të spastruar të dalë nga një ose dy poetë gjenialë të fundit të epokës arkaike, para klasike? Gjithsesi, kretasit e kishin një lloj shkrimi, d.m.th. një gjuhë të shkruar, dhe, ka të ngjarë, një letërsi. Fatkeqësisht ne nuk zotërojmë asnjë gjurmë të saj. Ata do të kenë qenë në gjendje të thurnin poema ose këngë të tilla si ato që hasen tek lindorët (hititët, babilonasit, kanaenët) ose tek egjiptianët.

Unë nuk do të trajtoj këtu gjuhën, stilin apo bashkimin e poemave të Homerit. Kjo gjë është bërë shumë herë nga specialistë të shquar. Pra parapëlqehet të preket një tjetër aspekt më konkret dhe më mësimdhënës, do të doja të flisja për "përmbajtjen" dhe për "kuptimin", nganjëherë të fshehur, që shpaloset në pjesën më të madhe të paragrafëve të këtyre poemave. Poezia gjithmonë ka paraprirë prozën. Ishte tradita e kënduar, ashtu siç ka qenë rasti për Testamentin e Lashtë këngët e gostive, të festimeve, të të korrave, të dasmave (Kantika e kantikave) ose këngët e vajtimit dhe të luftës (në një numër të madh në Bibël). A nuk ka në Bibël një përzierje gjinish dhe stilesh letrare: bashkim dokumentesh heteroklite, tërësisht të larmishme (këngë, thënie, proverba, fjalë bekimi ose mallkimi)? Profetët, për të patur më shumë përjetësi, a nuk ua shpallën ligjet njerëzve në emër të "mandatit hyjnor" të tyre? A nuk përfaqëson Dekalogu ligjet, të cilat Testamenti i Vjetër ia vesh dorës së Zotit, sipas dy versioneve të Eksodit (20/ l, 21) dhe të Deutoronomit (5/1, 30)? Ky është procesi i lindjes së çdo kulture zanafillore. Pentateuki u përpilua përfundimisht vetëm rreth shekullit VI para Krishtit dhe ka qenë i shkruar të paktën nga tre redaktorë të ndryshëm! Egjiptianët, asirianët dhe hititët nuk kanë bërë kurrë aluzion me "popullin hebre" përpara shekullit IX. Një fenomen i ngjashëm ndodhi në Italinë antike. Etruskët (rreth shekullit XIII, ashtu siç e pohon

Herodoti, ose rreth viteve 1.050 ose 850 para Krishtit) kishin alfabetin e tyre, gjuhën e tyre dhe një qytetërim tepër të përparuar. Mirëpo gjuha latine i mori "germat e fisnikërisë" së saj dhe statutin e gjuhës mbizotëruese vetëm nga shekulli III para Krishtit! Është ky momenti kur filloi të arrihej bashkimi italik falë pushtetit përqendrues të Romës. Së fundi, pas Homerit, nga mesi i shekullit VIII, jonianët e Azisë së Vogël përshtatën alfabetin fenikas apo lidian sipas disa autorëve. Por ky shkrim u përshtat nga athinasit vetëm rreth vitit 403 para Krishtit. Kësisoj poemat e Homerit u kënduan gojarisht gjatë një periudhe shumë të gjatë. Teogonia e Hesiodit bazohet në faktet e treguara nga Homeri. Por poemat e njërit dhe Teogonia e tjetrit u kopjuan vetëm në epokën e Pisistratit (546-527 para Krishtit). Volfi te "Prolegomenët" (1795) kërkon të tregojë se para shekullit VII shkrimi ishte i panjohur për grekët dhe se poemat e Homerit të thurura nga këngëtarë të ndryshëm popullorë dhe të përcjella gojarisht as nuk ishin bashkuar, as nuk ishin hartuar përpara shekullit VI. Përveç kësaj, ja edhe paragrafi, ai i një



APOLLONIA: obelisk i ngritur në shekullin III pas Krishtit para murit kodrina e shenjtë



APOLLONIA : pamje ballore e Agnonotetëve (selia e buleuterionit) - shekulli 160-180 pas Krishtit

historiani hebreo-grek, Jozefi, i cili shërben si bazë te "Prolegomenët" e Volfit: "askund në Greqi nuk gjendet ndonjë shkrim më i lashtë i njohur, se sa poezia e Homerit. Mirëpo, është e qartë që ky poet është shumë më i vonshëm se sa lufta e Trojës. Dhe vetë ai, thuhet se nuk i la poemat e tij me shkrim, por të përcjella në kujtesë dhe ato më vonë u ndërtuan nëpërmjet bashkimit të këngëve; dhe nga kjo vërehen aty kundërshti të shumta". Shihet qartë se historia e popullit helen ka ndjekur pothuajse të njëjtën rrugë me atë të popullit hebre.

Për neofitët*) është e domosdoshme të shënohet se Homeri, në asnjë moment tek Iliada apo te Odisea, nuk i përmend Helenët si popull që formon një "komb grek". Ky emër gjendet i përmendur një herë në Iliadë (II, 684) si i tribusë së Ftisë, mbretëria e Akilit. Tuqididi është i prerë për këtë çështje në librin I, kapitulli 3: "... Provën më të mirë e gjejmë te Homeri. Megjithëse ka jetuar shumë pas luftës së Trojës, ai në asnjë vend nuk e ka dhënë vendin e helenëve si një tërësi grekësh". Fakt tjetër i rëndësishëm për t`u shënuar: Homeri nuk e njihte një nga faktet më të rëndësishëm të fillesave të qytetërimit grek, më saktë: trilogjinë "Eolianë-Jonianë-Dorianë". Në të vërtetë, rreth shekullit VIII, madje më vonë, grekët u vendosën në Azinë e Vogël (Eolidë, Joni dhe Doridë). Megjithatë, këto tri popullsi, sipas vetë grekëve, janë në zanafillën e qytetërimit grek strictu sensu : etnia dhe gjuha (tri dialektet, eolian, jonian dhe dorian). Aty, në Azinë e Vogël, u shfaq shkrimi, trashëgimia e fenikasve ose e popujve që ata gjenden në vend (lidianë, frigjianë, lisianë...). Qytetërimi i tyre më pas u përcoll në Greqinë kontinentale dhe në ishujt.

Përveç kësaj, Homeri nuk e ka përmendur kurrë Joninë dhe e vetmja herë ku ai citon emrin e jonianëve është tek Iliada, kënga XIII, 685: "Beotianët, jonianët me tunika, lokrianët" etj. Nga ana tjetër, ky varg

---

*) *Neofitët - fillestarët.*

është trajtuar nga shumë kritikë si një ndërfutje e përcaktuar për të lajkatuar mendjemadhësinë e athinasve.

Dy kolonitë e tjera greke të Azisë së Vogël, Eolida dhe Dorida, nuk janë cituar aspak nga Homeri. Për atë, Eolida ishte ishulli i Eolisë (zot i erërave) d.m.th. "Stromboli" në Itali (Odiseja X, I, 55). Sa për emrin e dorianëve, ai është përmendur vetëm një herë tek Odiseja, kënga XIX, 177: "... Shikon përbri njëri-tjetrit akenët, kidonianët, trimat eteokretas, dorianët në tri grupe dhe Pellazgët hyjnorë." Por edhe aty është fjala për një ndërfutje të mëvonshme dhe një anakronizëm të sigurt. Për më tepër, se ai gjithashtu nuk e njeh legjendën e "Kthimit të Heraklidëve", e cila është veçse një shpikje e mitologëve grekë, siç e pohojnë autorë të shumtë dhe analistë modernë.

Për sa i takon dorianëve, janë ngritur shumë pyetje për këtë çështje. Homeri nuk i njeh ata sepse ata nuk ekzistonin në epokën e luftës së Trojës (Tuqididi - I, 12, - na thotë se ata kishin pushtuar Peloponezin 80 vjet pas luftës së Trojës, gjë që na çon në vitin 1100 para Krishtit)? Por, nëse ne kemi parasysh datën e Tuqididit, atëherë Homeri duhej të dinte për ekzistencën e tyre, madje t'i njihte personalisht, sepse ai kishte lindur në shekullin IX ose VIII, pra pas vitit 1100 para Krishtit! A të ketë dashur t'i mbetet besnik tekstit të lashtë që nuk i ka përmendur ata? Sido që të jetë rasti, ai ka përdorur kaq shumë anakronizma sa të vjen pyetja se përse të mos i përmendte edhe këto, a mos kjo sepse ata ishin një nga pjesëtarët më të rëndësishëm të "qytetërimit grek" dhe, për më tepër, ka të ngjarë të bashkëkohësve të tij? Përndryshe, mund të mendohet se: ose dorianët kanë arritur në Greqi pas Homerit (arsye e pranueshme e mosnjohjes nga ana e tij) ose emri i dorianeve është "fabrikim" pas-homerik ose plotësisht i sajuar.

Homeri, gjithashtu, nuk e njeh emrin e Peloponezit, të cilin ai e quan Argosi aken, si dhe legjendat tragjike që kanë lidhje me Pelopsin, heroi eponim i Peloponezit dhe i Spartës. "Argosi pellazg" për atë ishte Thesalia. Themelimi i qytetit të Spartës është i panjohur për të si dhe

ekzistenca e dorianëve: me sa duket bashkimi në shekullin IX (gjë që nuk është provuar aspak) i katër fshatrave doriane në luginën e Eurotas: Limnai, Mesoa, Kinosura dhe Pitani. Gloci, në lidhje me këtë na thotë: "Një sinocizëm bashkoi katër fshatrat; qyteti që lindi u quajt Spartë". Sa për Perseun, biri i Zeusit dhe i Danaes, Homeri nuk dinte asgjë për legjendën sipas së cilës ai, qysh se kishte lindur, ishte vendosur bashkë me nënën e tij në një arkë, të cilën gjyshi i tij Akrisiosi e kishte lëshuar në det dhe që dallgët e hodhën në ishullin Serifos, ku mbretëronte Polidiktesi. Ai, gjithashtu, nuk e njeh legjendën sipas së cilës Perseu preu kokën e Meduzës, pa u parë nga gorgonët e tjerë. Të vetmet herë kur Perseu është përmendur te Odiseja gjenden në Këngën III, 414/444 dhe te Iliada, kënga XIV, 320. Në të dy rastet thjesht është përmendur në një vijimësi gjeneanologjie.

Në Këngën XXIV, 1/14 (autenticiteti shumë i dyshimtë) të Odisesë dhe askund tjetër Hermesi nuk është perëndi e Cilenit, as udhëheqës i shpirtrave, që mban në dorë shufrën e artë. Homeri nuk e njeh fare birin e tij, Pan, perëndi e shpërfytyruar, monstruoze dhe e llahtarshme. Ja përse, në kuptimin e gjerë të fjalës ky emër ka personifikuar "frikë", prej nga vjen dhe fjala "panik"! Legjenda e Panit do të ketë qenë bashkëkohëse me mbretin Midas të Frigjisë (rreth viteve 738–675 para Krishtit).

Pas eolianëve, jonianëve, dorianëve, helenëve (si popull ose si komb grek) apo emrit "Peloponez", Homeri, gjithashtu, nuk njeh mitin sipas të cilit Tezeu bëhet mbret i Athinës "njësuesi i Atikës". Përveç kësaj, ky njësim është krijuar shumë më vonë, në epokën historike të Greqisë stricto sensu. Një legjendë tregon se gjatë betejës së Marathonës (viti 490 para Krishtit) athinasit pohonin se e kishin parë Tezeun! Tek Odiseja, kënga XI, vargu 321 deri 325, Homeri përmend Arianën të rrëmbyer nga Tezeu dhe paragrafi përfundon me këto fjalë: "e thënë më parë nga Dionisi, ajo vdiq e goditur nga Artemisa, në ishullin e Dias, e rrethuar nga dallgët". Këto vargje janë të dyshimta, sepse Dionisi nuk është përmendur kurrë në pjesët autentike dhe të lashta të Odisesë.

Emri Athinë është përmendur në Iliadë vetëm në mënyrë sporadike në Këngën II, vargjet 546, 551 dhe 558, të cilat janë trajtuar si ndërfutje "athinase", sepse bëhet fjalë për një anakronizëm të dukshëm. Në të vërtetë, zotërimi i Salaminës ka qenë debatuar ashpër midis Athinës dhe Megarës. Ky varg zbulon pretendimet e Athinës për ishullin e Ajaksit në epokën e Solonit (rreth viteve 640-558 para Krishtit). Në Këngën IV, 328 ai përmend Menestean dhe nënshtetasit e tij "athinasit", me përvojë në beteja. Për sa i takon Odisesë, Athinasit nuk përmenden aty. Përkundrazi, Athina është e përmendur në këngët III, 278, 307/ VIII, 80/XI, 323. Por Athina e epokës homerike nuk kishte të bënte fare me Athinën e Greqisë. Ajo as që ishte e krahasueshme me qytetet e mëdha të epokës homerike: Mikena, Argosi, Pilosi ose Tirinti.

Për atë, Athinasit dhe prijësi i tyre, Menesteu, rridhnin nga Erekteu, perëndia gjarpër dhe biri i Hefaistos dhe i Tokës. Ai nuk përmend as Kranaonin as Sekropsin (apo Kekropsin), të cilët, pjesa më e madhe e autorëve i përcaktojnë si mbretërit e parë të Athinës. Pra, këta mbretër duhet të kenë jetuar pas Homerit. Për Herodotin, athinasit dhe jonianët ishin me prejardhje nga Pellazgët (VIII, 44). Për Tuqididin (II, 15) ishte Tezeu ai që e bëri Athinën kryeqytet të Atikës. Por Tuqididi pohon se Akili dhe shokët e tij "ishin pikërisht helenët e parë". Duhet t`i nxjerrësh këta të fundit me prejardhje nga Heleni, mbreti i Ftias dhe biri i Deukalionit dhe i Pirrhas, i cili i kishte shpëtuar Përmbytjes së përbotshme. Ky mit i Deukalionit (që i ngjan atij të Noes së Biblës) ka qenë ndërtuar në një epokë relativisht të mëvonshme. Legjenda çuditërisht i njeh atij tre djem, Dorosin, Eolosin dhe Ksutosin, të lindur nga nimfa Orseis. Zbulohet se këta të fundit (çfarë rastësie!) janë stërgjyshërit e tërësisë së Grekëve: dorianët, eolianët, jonianët dhe akenët. Sipas mendimit tim, ky miti i fundit ka lindur bashkë me shfaqjen e grekëve në epokën historike të Greqisë, e thënë saktë, kur e kërkon nevoja për të gjetur një zanafillë "të pranueshme" për të tri dialektet greke: eoliane, joniane dhe doriane. Këto janë pikërisht tri dialektet që gjenden në Azinë e Vogël, gjatë kohës së

migrimeve të para greke - rreth shekullit VII para Krishtit, gjë që përkon plotësisht me tri krahinat e pushtuara nga Grekët në Azinë e Vogël: Eolida, Jonia, dhe Dorida!

Tradita homerike (Iliada XXI, 565 - 571.. " trupi i tij është i ndjeshëm") në lidhje me Akilin, biri i Tetit dhe i Peleut (mbreti i Ftias në Thesali), heroi më i madh i grekëve, ndryshon nga traditat e mëvonshme. Për atë (Homerin), Akili nuk ka qenë rritur nga nëna e tij Teti dhe Feniksi, biri i Amintorit dhe i Kleobules ose Hipodamisë. Ai nuk e njeh fabulën sipas së cilës Akili u la nga Tetis në ujërat e Stiksit, që e bënë "të paprekshëm", përveç thembrës.

Ai nuk e njeh ekzilin e Edipit (XXIII, 680) dhe legjendën e sakrificës së Ifigjenisë. Orfeu dhe biri i tij Muza janë krejtësisht të panjohur për të. Në të vërtetë, kjo është krejt normale, sepse këta poetë legjendarë do të kenë jetuar pas Homerit. Herodoti (II, 53) në lidhje me ta na thotë : "Poetët [saktësisht, Orfeu dhe Muza] që thuhet se kanë ekzistuar përpara këtyre njerëzve [Homerit dhe Hesiodit], për mendim tim janë të mëvonshëm". Sipas traditës klasike, Orfeu dhe Muza ishin "nismëtarët" e qytetërimit grek. Janë paraqitur lidhje të shumta nga një trung, fetare dhe mistike të Orfeut me Dionisin dhe këtë paraqitje e bëjnë në shekullin VI. Herodoti (IV, 95) na thotë se për shkak të disa ngjashmërive, prej Pitagorës ata i bashkëngjiteshin Egjiptit. Për sa i takon Dionisit, emri i tij nuk është përmendur askund në pjesët e lashta të poemës së Homerit. Të gjitha përmendjet për Dionisin janë vetëm ndërfutje të mëvonshme. Si rrjedhojë, ai nuk e njeh as emrin e Priapit, perëndia itifalike, biri i të njëjtit Dionis dhe i Afërditës. Edipi përmendet vetëm një herë në Iliadë (XXIII, 679) dhe një herë tek Odiseja (XI, 271, 280). Versioni që ai përmend në lidhje me fundin e Edipit (për atë Edipi vdes në një luftim) është krejt ndryshe nga ai i përshtatur nga Sofokliu në Edipi në Kolonë (legjendë sipas së cilës Edipi nxori sytë pasi kishte zbuluar se ishte martuar, pa e ditur, me nënën e tij Jokasta – e quajtur Epikasta nga Homeri, e cila nga tmerri u var).

Homeri, gjithashtu, duket se nuk e njeh legjendën e Bashkës së Artë. Në të vërtetë, argonautët dhe Jasoni janë përmendur vetëm një herë tek Odiseja, Kënga XII, vargjet 69 - 72. Gjithsesi, këto vargjet e fundit janë mbajtur si të dyshimta nga kritikët e Greqisë antike.

Te Homeri nuk ka patur asgjë për sa u takon manifestimeve panhelene, të cilat Greqia i njohu në fund të epokës arkaike dhe në fillim të periudhës klasike: lojërat olimpike, pitike, istmike ose nemense. Pjesa më e madhe e autorëve antikë pohojnë se lojërat olimpike kanë qenë themeluar nga Pelopsi. Të tjerë, ndër këta edhe Timeu, mendojnë se më saktë themeluesi i tyre është Herakli. Pra, kjo është një çështje e diskutueshme. Sido që të jetë, Homeri nuk i njihte as njërin as tjetrin nga këto dy versione. Gjithsesi, dimë se lojërat olimpike kanë qenë themeluar në vitin 776 para Krishtit. Datë kjo gjithashtu e diskutueshme, por në përgjithësi e pranuar për shkak të mungesës së provave të mjaftueshme.

Mikenasit kryenin djegien e të vdekurve të tyre. Mirëpo Homeri përmend vazhdimisht djegien e kufomave tek akenët (kufomat e djegura). Homeri në asnjë rast nuk bën aluzion me "maskat e varrimit" prej flete të artë, kaq e zakontë te mikenët.

Së fundi, shënojmë se ai kurrë nuk ka përmendur emrin Maqedoni. Në të vërtetë, Maqedonia është një "formim" shumë më i vonshëm në historinë antike të këtij rajoni. Emri i saj zanafillor ishte "Emathia" ose "Emathi" (Homeri - Iliada/XIV, 226). Për Strabonin (VII/fr.11) dhe Justinin (VII, I) Emathia fillimisht kufizohej me ultësirën e begatë bregdetare të luginës së poshtme të Haliakmonit. Por në epokën romake ky term përcaktonte të gjithë ultësirën e Maqedonisë së poshtme në perëndim të Aksios deri te kodrinat. Emathia ishte gjithashtu emri i një qyteti të Maqedonisë, të cilin Straboni e vendos buzë detit. Megjithatë, në identifikimin e këtij qyteti të kohës së Strabonit ka një luhatje midis dy qytetesh: ky ishte emri i lashtë i Thesalonikit (Selaniku) sipas Zonaras dhe Tit-Livit (43, 7–44, 44) ose sipas Tuqididit (IV, 107)

emri që mori Oisimi, koloni thesaliane, gjendet pranë Nea Peramos, port i vogël në jugperëndim të Kavallës. Për sa i takon popullsisë së lashtë të Emathias, Straboni pohon: "Popullsitë që ndajnë territorin e saj ishin epirotët, ilirët dhe mbi të gjitha botieanët ose botienët dhe thrakët". Numërimi i këtyre popujve "pellazgë" më bën ta dekriptoj këtë emër në bazë të gjuhës shqipe: "E madhia" që do të thotë "e madhja" dhe në kuptim më të gjerë "ultësira e madhe".

Kur studiohen me hollësi tekstet homerike shihet mirë se disa perëndi kanë qenë futur në "mitologji" shumë më pas Homerit. Megjithatë është më se e dukshme të shohësh te Poseidoni "mbrojtësin" e akenëve dhe, mbi të gjitha, stërgjyshin ose paraardhësin e shumë gjysmë-perëndive ose heronjve me zanafillë "të huaj", dhe në veçanti egjiptiane dhe fenikase.

Pra është e qartë se Homeri nuk ka qenë i pranishëm në lindjen e Greqisë stricto sensu dhe nuk i njihte të gjitha sa lidheshin më pas me qytetërimin grek dhe çfarë ishte thelbësore për Historinë antike dhe zanafillën e popullit grek. Kjo i jep të drejtë çështjes pellazge, për sa i takon krijimit relativisht të vonshëm të Heladës, rreth shekullit VIII para Krishtit. Si rrjedhojë, kjo hedh poshtë edhe më shumë mendimin që disa kanë në lidhje me ekzistencën më të hershme të pretenduar apo të lashtësisë së qytetërimit grek.

Thrako - ilirët, paraardhësit e drejtpërdrejtë të shqiptarëve të sotëm

Qysh në treqindvjeçarin e fundit të mijëvjeçarit të dytë, thrako-ilirët përfaqësonin një popullsi homogjene nga ana etnike dhe gjuhësore, pavarësisht disa ndryshimeve dialektore. Ky entitet i parafundit etnik i dalë nga Pellazgët antikë, nga epoka klasike deri në fund të epokës helene, përfshinte në thelb katër degë: ilirët (duke përfshirë aty dardanët), thrakët, epirotët dhe maqedonët. Por ky grup thrako-ilir

ishte i përbërë nga një mori emrash të vendosura nga fise të shumta, konkurrente apo kundërshtare, të shpërndara nga pak kudo nëpër Gadishullin Ballkanik, Egje, Azinë e Vogël dhe në rajonet danubiane: ja përse disa kanë besuar se bëhej fjalë për etni të ndryshme!

Vetëm një pjesë e ilirëve të Veriut, ndër të cilët autariatët e ardianët, si dhe ilirëve të Jugut, ndër të cilët labeatët, enkelenët, taulantët, partinët, dasaretët, atintanët dhe amantët (Shqipëria e sotme), dardanët, danteletët e triballët (kosovarët e sotëm), kaonët, molosët, dodonët dhe tesprotët (epirotët e sotëm), trakët ndër të cilët brigët, besët, orestët, peonët, edonët, pellagonët, penestët, linkestët dhe agrianët (shqiptarët e Maqedonisë së sotme) i kanë rezistuar asimilimit etno-kulturor dhe integrimit territorial në përfitim të pushtuesve të njëpasnjëshëm (grekë, romakë, bullgarë ose turq). Vetëm midis fiseve të tjera ilire, venetët, liburnët, istrianët, dalmatët, japodët dhe panonianët u integruan dhe u asimiluan nga popujt e tjerë, të tillë si romakë, sllavë (në veri ose në jug të Danubit) dhe hungarezët. Malësitë e pamposhtura dhe relievi tepër i thyer i Shqipërisë (lartësia mesatare është më e larta e Europës, rreth 700 m dhe malet më të larta kulmojnë pothuajse 2800 metra) dhe viset rreth saj (Kosovë, Maqedoni perëndimore dhe Mali i Zi) dhe Epiri (Greqia e veriut) i kanë bërë të mundur këtyre popullsive të ruajnë pothuajse të paprekura, kulturën, gjuhën, zakonet, doket dhe kostumet e lashta të tyre. Këto male kanë qenë një mbrojtje e vërtetë e gjuhës dhe e kulturës pellazge. Ja përse unë e cilësoj si fosile të gjallë gjuhën e sotme shqipe, pikërisht dialektin gegë të Shqipërisë së veriut.

Prandaj ilirët antikë, madje parahistorikë, jetonin në një hapësirë të stërmadhe: në të dy brigjet e Danubit që quhej Istros nga grekët - ky emër rrjedh nga gjuha shqipe, I shtri d.m.th i shtrirë, i madh - deri në kufijtë e Epirit dhe të kufirit verior të vargmalit të Pindit; nga pjesa perëndimore e Ballkanit deri në faqen lindore të Alpeve, madje në bregdetin italian të Adriatikut (nga Venetia deri në Mesapi duke kaluar nëpër Japigi); kufiri lindor me Thraken nuk ka qenë kurrë i përcaktuar

dhe as i njohur me saktësi, ka shumë të ngjarë për arsye të vështirësisë së dallimit të tyre nga ilirët. Këto dy etni ishin shumë të afërta si në rrafshin gjuhësor edhe në atë kulturor dhe morfologjik. Përveç kësaj, shumë toponime dhe oronime të Thrakes shpjegohen me saktësi nëpërmjet gjuhës shqipe, ndër të cilat emri i lumit të madh (430 km) që përshkon Bullgarinë dhe Greqinë për tu derdhur në detin Egje: Strimoni antik (në greqisht Strimonas) ose Struma (në bullgarisht), i cili rrjedh nga gjuha thrako-ilire e mbijetuar në gjuhën e sotme shqipe (gegërisht) "Shtrëmua" që do të thotë i shtrembër, gjarpërues.

Epiri (duke përfshirë Thesprotinë e lashtë, Molosinë dhe Kaoninë) kishte si kufij Ilirinë në veri, detin Jonian në perëndim dhe Greqinë në jug (gjiri i Ambrakisë) vargmali i Pindit në juglindje dhe në verilindje vendin e elimiotëve, eordëve dhe orestëve (popuj thrako-ilirë) dhe më tej në lindje Maqedoninë.

Trakët (duke përfshirë këtu dakët, getët, triballët dhe mesianët) zinin të gjithë pjesën lindore të Ballkanit deri në Detin e Zi, d.m.th. , sipas Strabonit, të gjithë pjesën juglindore të Gadishullit Ballkanik: në pjesën e saj më perëndimore, Thraka fillonte duke nisur nga lumi Strimon [Shtrem, shtremue, shtremon që në dialektin gegë do të thotë i shtrembër, i përdredhur, i devijuar, i shtrembëruar, si dhe folja me shtrembëru – në të vërtetë Strimon është një lumë tepër i përdredhur apo gjarpërues!], kufiri i të cilit vende-vende ka qenë shtyrë nga Maqedonët më në lindje në lumin Nestos; Danubi kufizonte pjesën e tij veriore dhe Pont Euksini (Deti i Zi) të gjithë pjesën lindore, pjesa perëndimore ishte e zënë nga ilirët dhe epirotët; grekët zinin jugun e Gadishullit Ballkanik.

Për sa i takon Greqisë, në epokën klasike (shekulli V para Krishtit) ajo fillonte në jug të Epirit, d.m.th nga gjiri i Ambrakisë deri në kepin Male (kulmi jugor i Peloponezit) dhe nga Deti Jonian deri në faqen jug-perëndimore të Maqedonisë, e thënë në vija të përgjithshme është një vijë që shkon prej gjirit të Ambrakisë deri në grykëderdhjen e Penesë

(rreth 400 km gjatësi dhe 300 km gjerësi) duke përfshirë kështu edhe Thesalinë, që dikur quhej "Pellasgiotidë" dhe përpara pushtimit helen, ashtu si pjesa tjetër e Greqisë, i përkiste pellazgëve. Ja çfarë pohon në lidhje me këtë historiani i shquar G. Gloc (Historia greke, PUF, 1938): "Greqia nuk është veçse një pjesë.....tokash të bëra greke. Ky është një vend shumë i vogël... . Të lashtët përfshinin aty Thesalinë, duke e përjashtuar si zakonisht Epirin dhe gjithmonë Maqedoninë, dhe me plot të drejtë Thraken. Pra, Greqia klasike është pothuajse tërësia e zonave që gjenden në jug të një vije që hiqet nga gjiri i Ambrakisë deri në grykëderdhjen e Penesë". Ky pohimi i fundit përputhet me ato të autorëve antikë, Eforit dhe Pseudo-Skilaksit. Kurse Straboni (libri VII, 7, 1) thoshte pothuajse 2000 vjet më parë: ja pra popujt [Ilirë] , të cilët e meritojnë të përmenden midis atyre që kanë si kufi Istros dhe malet e Ilirisë dhe të Thrakes dhe që zënë të gjithë bregun e Adriatikut qysh nga fundi i gjirit [Venetia] si dhe bregdetin të përcaktuar si i majtë i Pont-Euksinit (Detit të Zi), nga Istros (Danubi) deri në Bizant... Hekate i Miletit, për çështjen e Peloponezit thotë se ai ishte i banuar nga barbarët [Pellazgët] përpara se të banohej nga grekët. Madje mund të thuhet se e gjithë Greqia në kohë të lashta ka patur një popullsi barbare, nëse arsyetohet thjesht duke u nisur nga fakte të dëshmuara nga tradita... thrakët, ilirët dhe epirotët, deri në ditët tona [këtu bëhet fjalë për epokën e Strabonit (viti 58 Para Krishtit / 21, 25) pas Krishtit, d.m.th, fillimet e periudhës së pas Krishtit] që banonin përbri Greqisë. Dikur ishte edhe më e sigurt, se sa në kohën tonë, se ka qenë e banuar nga barbarët një pjesë e madhe e territorit që për momentin formon në mënyrë të pakundërshtueshëm Greqinë...".

Është pranuar prerë se ilirët, trakët, thesalianët e parë dhe fise të tjera të shumta të trungut pellazg zinin këtë krahinë, të paktën qysh në periudhën e Neolitikut. Por paleontologët pohojnë se ky territor i stërmadh ka qenë i banuar qysh në fillim të Kuaternarit. Përveç fshatrave buzë liqenit dhe objekteve të tjera prej guri të latuar apo të

lëmuar është periudha e Epokës së Bronzit, e cila na jep numrin më të madh të mbetjeve arkeologjike.

Homo Sapiensi, sigurisht ka shkelur në tokën e këtij rajoni, prej nga u shfaqën banorët e parë të Europës, historikisht të njohur si pellazgë (= shpellagi, kjo përkthehet në shqip "njerëzit e shpellave" - Zeusi, pellazgu sipas Homerit, cf Iliada XVI/234, a nuk kishte lindur në shpellë?); lelegët (= le lesh, njeri me qime - bëhet fjalë për njeriun-majmun?"); Ligurët (= lëkurë, njeri i mbuluar me lëkurë); Iberët (= i parë, nënkupton të parët që lanë grupin pellazg stërgjyshor për tu vendosur në atë që do të bëhej Iberia); frigjianët (= frikgji, "të ikurit nga frika" - pa dyshim rrjedhojë e një përmbysjeje të përbotshme ose krahinore); lisianët (= liqen, liqet, popull i detit, i liqenit ose thjesht i ujit), etj. E gjithë kjo familje e fiseve pellazge ka krijuar degën thrako-ilire dhe së fundi atë të shqiptarëve të sotëm. Këto etnonimi të formuara në mënyrë të veçantë nga epitete, a nuk zbulojnë një zanafillë të lashtë të të gjitha këtyre fiseve kaq të përcaktuara?

Gjithashtu, e gjithë kjo është vërtetuar nga gërmimet arkeologjike të kryera në Shqipëri, si p.sh. në jug të vendit (Sarandë) ku janë zbuluar vegla pune prej stralli që datojnë nga periudhat levaluaziane dhe musteriane. Qytetërimi eneolitik i zonave ilire të Maliq II, Nezir, Hisar, Glladnicë ose Ohri, p.sh. vijon drejtpërdrejt dhe pa shkëputje nga qytetërimi neolitik, të dhënat arkeologjike, antropologjike dhe paleontologjike të të cilit provojnë karakterin autokton të kësaj familje të madhe pellazge, që ka lulëzuar në Europën Kontinentale, në Azinë e Vogël, Kretë, Egjeu dhe të gjithë hapësirën mesdhetare.

Megjithatë, pjesa më e madhe e etnologëve, arkeologëve, parahistorianëve ose paleontologëve shqiptarë të pasluftës e trajtojnë territorin e Shqipërisë së sotme si djepin e etnisë ilire dhe e ngjisin atë deri në paleolitik, gjithsesi pa vendosur lidhje me qytetërimin danubian madje thesalian, megjithëse e thënë më saktë të dyja të përafërta me territorin e Ilirisë së ardhme! A të ishte për arsye partizane apo politike

(për të mos lënduar fqinjët jugosllavë dhe grekë) që këta dijetarë shqiptarë (të dalë nga një regjim udhëheqës, autoritar dhe despotik dhe që ka të ngjarë të ishin të detyruar të përshtatnin një ideologji të udhëheqësve të tyre politikë) nuk e kanë vendosur këtë lidhje të vërtetuar, megjithëse ky problem ka qenë studiuar në mënyrë të veçantë nga specialistë të shumtë evropianë? Ka të ngjarë, që, për të njëjtat arsye, këta dijetarë shqiptarë nuk i kanë çuar më tej kërkimet e tyre dhe, më saktë, hulumtimet mbi Pellazgët.

Shënojmë se territori i sotmë i Shqipërisë ishte për Ilirët antikë qendra e industrisë së tyre metalurgjike. Kjo zonë minerare, e pasur në mineral hekuri dhe bakri, ekziston ende edhe në ditët tona në krahinat e veriut të Shqipërisë (Mat, Mirditë, Kukës) dhe në jug (Korça). Megjithatë, është interesante të theksosh se austriakët e paraluftës i emërtonin farkëtarët e Austrisë së Sipërme (krahinë danubiane) me mbiemrin cilësor "ilirë"!

Autorë të shumtë, të dokumentuar mirë, kanë dhënë të vërteta drithëruese, duke pohuar se populli ilir apo pellazg pati luajtur një rol jo të vogël në lindjen e qytetërimeve të para dhe të atyre të juglindjes së Europës.

Ja çfarë thotë në lidhje me këtë Z. Majani (Fundi i "misterit" etrusk – Maluan/1970): "Ilirët ishin një popull proto-danubian. Ata bënin pjesë në popujt e një trungu, më saktë të lidhur nga një gjuhë bazë e përbashkët, se sa çdo gjë tjetër. Në këtë familje ishin të integruar, në shkallë të ndryshme, përbri ilirëve, në kuptimin më të saktë, epirotët, maqedonët, Thrakët, frigjianët, etruskët, venetët, liburnët, pisenianët, japigët, dardanët, trojanët, lidianët, kretasit pjesërisht, teukrët, filistinët, jebuzianët dhe të tjerë. Gjithsesi, tipari kryesor që dallon para së gjithash populisinë ilire në fjalë, sigurisht që është gjuha e saj... Shqipja e sotme ka ruajtur fjalët bashkëkohore të Iliadës dhe të Numa Pompilus... . Qysh nga antikiteti, gjuha lidiane, epirote dhe maqedone ia lanë vendin gjuhës greke. Vetëm ilirishtja e jugut (shqipja) i rezistoi".

Xhon Geipel (Antropologjia e Europës, 1971) deklaron se qysh në

epokën e hershme të Hekurit, Greqia ishte e zënë nga ilirët dhe shton: "Njerëzit e 'Halstatit' flisnin një formë të ilirishtes. Gjuha e farkëtarëve austriakë mendohet se ishte ilirishtja, gjuhë që i përket grupit indo-europian dhe fragmente thelbësore të të cilave mbijetojnë në gjuhën shqipe". Diku tjetër ai shton: "Nga veriu, Sllavët kapërcyen ultësirat hungareze, zbritën deri në lindje të Adriatikut dhe nëpërmjet luginave të Ballkanit deri në Greqi, ku arritën në fillim të shekullit VII pas Krishtit. Në Ballkan ata eliminuan dialektet e vjetra ilire, thrake dhe frigjiane të folura nga autoktonët, të cilëve iu imponuan gjuhët e tyre, forma të lashta të përziera të sllovenishtes, kroatishtes, serbishtes, maqedonishtes dhe bullgarishtes".

Xhorxh Puason pohon në librin e tij "Popullsia e Europës" (1939): "Diskutohet ende karakteri etnik i popullsisë Aunieticiene... Disa autorë shohin ndër këta proto-sllavët; kjo është ajo çfarë besonte Zaborovski dhe që ende mbështetet nga autorë të ndryshëm të racës sllave. Por roli i Aunieticienit në evolucionin e popullsive ariane [fjalë sinonim i indo-europianes] të Europës Lindore është shumë i rëndësishëm meqë mund t`i mvishet një populli i cili nga gjuha e tij ka lidhje të veçanta me Arianët e Azisë [populli sllav]. Mendimi më i përhapur është se ata do të jenë të trungut të Ilirëve. Njëkohësisht i nxjerrin pasardhës edhe venetët e verilindjes së Italisë, degë e ilirëve, si dhe venetët e brigjeve të Balltikut, që në këtë rast nuk do të kenë qenë Sllavë, por një popullsi më e hershme se mbërritja e Sllavëve në këtë rajon dhe që unë personalisht i trajtoj si trungu i letonëve lituanezë... Sidoqoftë, më duket se ky popull ka luajtur një rol të madh jo vetëm në zhvillimin e qytetërimit të Bronzit në Europë, por gjithashtu në formimin etnik të një numri popujsh arianë... Dhe mund të vijohet të besohet, së bashku me shumë parahistorianë, se prej detit Adriatik njohuritë mbi hekurin u zhvilluan në Iliri prej nga u shpërndanë më pas në pjesën tjetër të Europës Qendrore, Veriore dhe Perëndimore".

Filologu gjerman Krahe i vendos ilirët nga njëra anë midis Danubit të

mesëm, Italisë (venetët, japigët, pisenët, mesapët), Epirit dhe, nga ana tjetër, në Azinë e Vogël (i përfshirë qyteti i Trojës), në Kretë dhe në Palestinë.

Pik pranon se një popull në qendër të Europës kishte bërë përpara në Rusi deri në Kaukaz, ku kishte mësuar njohuri mbi hekurin dhe i pajisur me këtë metal të ri u kthye në Europën Qendrore duke krijuar kështu qytetërimin e Halshtatit. Ai mbështetet në shfaqjen në Rusi të objekteve të ndryshme prej bronzi të qendrës së Europës, pikërisht në Hungari, vend i zënë asokohe nga panonianët, të cilët ishin popull ilir.

N. Lahovari (Popujt evropianë, 1946) shënon se gjuhët baske dhe shqiptare ruajnë tipare të qarta të sistemit vigezimal, i cili është ligjësi në gjuhët paleo-kaukaziane, sumeriane dhe ato elamite. Megjithatë ai pohon se toponimia e Austrisë dhe e Gjermanisë jugore zbulon një popullsi etrusko-mesdhetare deri në Kolonjë (Gjermani) dhe në malësitë në veri të Meinit. Gjithashtu, ai vëren se në planin antropologjik shqiptarët janë populli më brakicefal i Europës, me një tregues cefalik më të lartë deri në 86/87. Straboni, në Gjeografinë e tij thekson se "Albanoi" ishte një fis "ilir".

Thomopulos (Pellazgjika), pohon se Shqiptarët janë pasardhësit e vërtetë të pellazgëve.

G. Batisti pohon nga ana e tij se "Ilirët danubianë ishin në zanafillë një popull para indo-europian dhe që gjuha e tyre i bashkëngjitej qendrës kreto-egjease, por që ka pësuar një mbivendosje dialektesh indo-europiane".

Man mendon se gjuha shqipe rrjedh nga ajo e Jafetit (biri i Noes), e cila do të ketë krijuar gjuhën sumeriane, elamite, aziatike dhe kaukaziane.

Në lidhje me këtë pohimin e fundit të Manit është interesante të vëresh që një emërtim "Peleg" është përmendur në Gjenezë (XI, 18): "E gjithë toka kishte një gjuhë të vetme dhe të njëjtat fjalë.... Sem krijoi Arpashad, dy vjet pas Përmbytjes, ky i fundit krijoi Shelah, i cili nga ana e tij krijoi Heberin, i cili krijoi Pelegun dhe ky krijoi Rehun... Terash, që do të krijojë Abraham, Nashor dhe Haran". Nuk dihet më shumë për këtë Peleg të përmendur në mënyrë misterioze në Bibël !

Barbarish (Albanika) u jep shqiptarëve zanafillë ilire, ashtu si edhe ligurve.

Norbert Jokl pohon: "Sidoqoftë ne vëmë re se trashëgimia gjuhësore, që vjen nga gjuhët e lashta të Ballkanit, si gjuha ilire dhe thrakishtja, është e lidhur ngushtë me gjuhën shqipe".

H. Shuhardt ka vënë në dukje analogji të dallueshme midis gjuhës shqipe-thrake-ilire dhe armenishtes së lashtë.

Buonamiçi pohon se ekzistojnë një numër i madh barasvlerash në rrafshin fonetik midis gjuhës etruske dhe gjuhës shqipe. Shqipja paraqet një lëndë të dobishme për përqasjen me etruskishten".

Miklosiç mendon se "në të gjithë Ballkanin janë shqiptarët që kanë ruajtur elementet glotologjike vendore".

Shnaider është i prerë në mendimin se Pellazgët nuk kanë qenë një racë e imigruar por autoktone, më e hershme se periudha kuaternare dhe se gjuha e tyre e ruajtur në një mënyrë pothuajse të paprekur, nuk do të ishte tjetër veçse shqipja e sotme. Ndër të tjera, ai pohon me këtë rast se shqiptarët nga fundi i shekullit XIX betoheshin ende mbi gurët. "Të mos harrojmë se Roma e kishte përshtatur këtë betim mbi gur, që pa dyshim e kishin sjellë etruskët, kjo degë e vjetër e pellazgëve perëndimorë".

Pol Guerin: "Pellazgët, banorët zanafillorë të Greqisë dhe të Italisë, duket se kishin ardhur nga Lindja dhe i përkisnin racës indo-europiane. Me të mbërritur në Danub, një palë kapërcyen këtë lumë dhe depërtuan në gadishullin helen, të tjerët u ngjitën përgjatë Savës, e cila i çoi në Itali. Prej aty, dy degë: njëra lindorja në Greqi, tjetra perëndimorja në gadishullin italik. Ka të ngjarë që Pellazgët ta kenë prekur Danubin rreth viteve 2000 para Krishtit".

Sipas Larive dhe Flëri, Pellazgët përbëjnë popullin të njohur si më i lashti i Maqedonisë, Greqisë dhe Italisë.

Hirt dhe Kreçmer pohojnë se gjuha maqedone ishte e një familjeje me atë ilire.

M.A. Piganiol vëren se etruskët kanë ndjekur me përpikëri rrugën e pellazgëve.

Haberlandt pohon se në Shqipëri gjenden pothuajse të gjitha kostumet që përdoren në Ballkan. Ai shton se ndikimi i popullsive të lashta thrako-ilire dallohet me lehtësi në kostume, në ritet dhe zakonet e Ballkanit, të Europës Qendrore, të Italisë së Jugut (nga Roma deri në Kalabri dhe në Sicili), të Epirit, të ishujve të Egjeut, të Thrakes, përreth Dardaneleve, nga Deti Marmara deri Galipoli dhe nga pak kudo nëpër Azinë e Vogël.

Ilirët e epokës klasike greke (shekulli V) tashmë ishin të njohur për karakterin luftarak dhe luftënxitës, madje gjaknxehtë (si pasardhësit e tyre, shqiptarët). Karakteri i tyre krenar, i pavarur, i panënshtrueshëm, i vrullshëm dhe rebel qysh nga kohërat e mugëtirës si dhe përçarja e tyre nuk kanë favorizuar për krijimin e një entiteti politiko-shoqëror. Megjithatë, infrastruktura dhe relievi i thyer i vendit nuk ka qenë i volitshëm për grumbullimin e fiseve të ndryshme të strukur në skutat e tyre malore. Nga ana tjetër, ajo çfarë tregon Herodoti (shekulli V para Krishtit) në lidhje me thrakët (popull pellazg i një trungu me ilirët) është shumë kuptimplote. Në të vërtetë, në librin e tij V, 3, Kërkimi ai pohon: "Populli thrak, pas indianëve, është populli më i shumtë në numër në botë. Nëse trakët do të kishin vetëm një prijës dhe nëse do të merreshin vesh midis tyre, ata do të formonin një popull të pamposhtur dhe sigurisht më të fuqishmin nga të gjithë popujt sipas mendimit tim; por kjo gjë është e pamundur dhe krejtësisht e paarritshme për ata, prej nga rrjedh edhe dobësia e tyre. Ata mbajnë emra të ndryshëm sipas krahinave, por pothuajse të gjithë kanë të njëjtat zakone".

Ja edhe mendimi i Tuqididit (IV, 126) në lidhje me Ilirët: "Këta barbarë ju frikësojnë sepse nuk i njihni... Është e vërtetë që afrimi i barbarëve ka përse t`i frikësoje ata që janë të informuar keq. Pamja që ofron moria e tyre është mbresëlënëse, me zor durohen ulërimat e tyre dhe ata kanë një mënyrë shumë kërcënuese të tundjes së armëve të

tyre në ajër... (IV, 125)... tregohet se ilirët e kishin tradhtuar Perdikasin dhe ishin vënë në shërbim të Arrhabaiosin - meqë gjithsecili i druhej ndërhyrjes së këtyre luftëtarëve të frikshëm, e gjithë bota ishte e mendimit që të luftonte në tërheqje (I, 24): "Epidamni... vendi përreth është i populluar nga barbarë të racës ilire, nga taulantët".

Në lidhje me karakterin luftarak të thrako-ilirëve – ja çfarë thotë Aleksandri, sipas biografit të tij Arrien (Anabase II, 7, 5): "Për ata që janë barbarë [jo helenofonë], ne radhitim thrakët, peonianët, ilirët, agrianët, popujt më të fortë dhe më luftarakë të Europës, kundrejt racave më të plogështa dhe më të buta të Azisë [persët]; ndër të tjera është Aleksandri që udhëheq kundër Dariusit". Aleksandri i Madh fliste dy dialektet e tij, me zanafillë maqedone dhe epirote (thrako-ilire).

Ja çfarë tregon Plutarku (Jeta e Aleksandrit V, 8): "Atëherë Aleksandri e fyeu: ja miqtë e mi, thotë ai, njeriu (babai i tij Filipi II) që përgatitej për të shkuar nga Europa në Azi dhe i cili, duke kaluar nga njëri shtrat në tjetrin, ra në kokërr të shpinës! Pas kësaj fyerjeje që e bëri, ngase e kishte zënë vera, ai mori nënën e tij Olimpia, e vendosi në Epir dhe vetë u tërhoq në Iliri [vend, gjuhën e të cilit ai fliste]". Polibi (Historia) i ka cituar së tepërmi ilirët. Ja disa pjesë. (II, 1, 2): Mbreti i ilirëve, Agroni, që ishte biri i Pleuratit, zotëronte në tokë dhe në det një fuqi ushtarake shumë më të madhe se ndonjë prej paraardhësve të tij... (II, 1, 3): Ndërsa këta të fundit (etolianët), duke parë atë që kishte ndodhur, ishin shastisur nga trimëria e jashtëzakonshme e ilirëve... (II, 1, 7): Kjo ekspeditë e ilirëve i habiti dhe i tmerroi popullsitë greke të vendosura ndër brigje... (II, 1, 11): Megjithatë, ilirët, duke i vendosur anijet e tyre katër me katër... i treguan krahët armikut të tyre, duke lehtësuar kësisoj sulmet e tyre. Por, ndërkohë, anijet akene, pasi ishin ngarkuar, u gjendën të bllokuara në një pozicion të vështirë, me majën e tyre të bllokuar te ana e një anije, tek e cila ishin bashkangjitur tri të tjera. Ushtarët që ishin në bord të këtyre të fundit lëshoheshin në urën, e sulmonin dhe dilnin fitimtarë falë epërsisë së tyre numerike... Duke

u krenuar për këtë fitore, Ilirët tashmë vijuan rrethimin e Korkyrës [Korfuzi] tërësisht me atë lehtësinë e tyre dhe sigurinë e suksesit... (V, II, 109): pra, duke vlerësuar se për këtë lloj shërbimi asgjë nuk e bënte përveç tipit të anijes që ndërtonin Ilirët, u vunë të ndërtoheshin njëqind lembo*), nismë e paparë në historinë e shtëpisë mbretërore të Maqedonisë..."

Apiani (vitet 95-160 pas Krishtit) pohon në lidhje me zanafillën e tribuve ilire (Luftërat Ilire, libri X, 2): "Thuhet se ky vend e ka emrin nga Iliri, biri i Polifemit. Ciklopi Polifem dhe gruaja e tij Galatea, kishin në të vërtetë tre djem: Keltin, Ilirin dhe Galin; të tre e lanë Sicilinë dhe mbretëruan ndër popujt, të cilët për këtë arsye u quajtën keltë, ilirë dhe galatë. Midis miteve të shumta, që kanë mbizotëruar ndër shumë popuj, është ky shpjegim që më duket më i pranueshmi. Iliri kishte gjashtë djem: Enkelin, Autariaeusin, Dardanin, Maedusin, Taulasin dhe Perrheabusin; ai kishte edhe vajza: Parton, Daorton, Dasaran dhe të tjera, prej nga erdhën taulantët, perrhaebët, enkelët, autariansët, dardanët, parthenët, dasaretët dhe darsët. Autariati kishte një djalë, Panoniusin ose Paeonin, ky i fundit kishte dy djem: Skordikusin dhe Triballin, prej nga rrodhën edhe dy kombet që mbajtën emrat e tyre. Por unë do t`ia lija këto çështje arkeologëve". Ky tekst është shumë bindës. Ai tregon shumë mirë (pesë shekuj përpara mbërritjes së sllavëve, bullgarëve dhe hungarezëve në Ballkan) numrin e madh të fiseve ilire që kanë jetuar në një territor shumë të gjerë, që shkonte nga brigjet e Danubit deri në kufijtë veriorë të Greqisë dhe nga Adriatiku deri në Detin e Zi.

Kështu, në lidhje me këta thrako-ilirë dhe pasardhësit e tyre shqiptarë, ngjarjet që ndodhën gjatë njëzet e pesë shekujve të kaluar vërtetojnë, mbi të gjitha, dëshminë e Herodoti, e cila merr këtu të gjithë vlerën e saj historike ... dhe profetike.

---

*) *lloj anijeje e kohëve të lashta*

Ilirët, ashtu si edhe vëllezërit e trungu të tyre, liburnët dhe venetët, ("Enetët e Herodotit" - I, 196/ V, 9) praktikonin prej një kohe shumë të gjatë piraterinë dhe i binin kryq e tërthor detrave të Botës sonë të Vjetër: Mesdheun dhe mbi të gjitha detin Adriatik, të quajtur fillimisht deti Jonian (deti "i onë" , që në shqip do të thotë "deti i jonë, deti ynë"



Antigonea (Gjirokastër: shekulli II para Krishtit), rrënoja të një shtëpie banimi me radhë kolonash
(sipas "Shqipëria arkeologjike" - Tiranë - 1971)

– kjo i frymëzoi më pas edhe romakët për ta quajtur "mare nostrum"). Ky det, pothuajse i përmbyllur, ishte i tyre dhe pa dyshim edhe streha e disa popujve të detit, ndër të cilët bënin pjesë filistinët, turshas (etruskët) dhe teukrët (trojanët).

Në të vërtetë, filistinët prej shekullit XII para Krishtit – kjo (filistinë) është etnonimi e pellazgëve (shpellagji, shpellash) i shtrembëruar nga ana fonetike nga hebrenjtë (peleshtim, "im" = prapashtesë tipike ebraike) si dhe nga egjiptianët (PLST = peleset, gjuha egjiptiane e vjetër kishte një alfabet të përbërë vetëm me bashkëtingëllore: Pe–Le–Se–T) – lanë Ilirinë e jugut ku gjenden toponime Palaiste (Epir) duke qëndruar në Kretë, përpara se të sulmonin në Egjipt, Qipro dhe të pushtonin atë që do të bëhej Palestinë. Një tjetër toponim mbështet praninë e filistinëve (pellazgëve) jo vetëm në Adriatik, por gjithashtu edhe në këtë rajon të ultësirës dhe të deltës së lumit Po: fossa filistina pranë qytetit Adria. Disa autorë të kohëve të sotme, ndër të cilët F. Altheim dhe V. de Vit, shohin aty praninë ose kalimin e filistinëve (popull thrako-ilir i mirëfilltë). Së fundi, mund të përmendim një tjetër toponim, Spina (shqipja e sotme gjithmonë e ka fjalën shpina, që do të thotë shpinë, kurriz): Spina, si të thuash, ka formuar pjesën e prapme (kurrizin) të Etrurisë (popull pellazg). E gjithë kjo vërteton praninë në epokën e hershme dhe të mesme, të pellazgëve dhe të thrako-ilirëve në këtë rajon. Gjithsesi, disa autorë të kohëve të sotme mendojnë që toponimia fossa filistina rridhte nga një emër i përveçëm "Filistos" (a bëhet fjalë me të vërtetë për ilirë helofonë apo të helenizuar?), historian i dëbuar nga Dionisi i Vjetër, tirani i Sirakuzës. Unë po ju kujtoj këto fjalë njëherësh profetike dhe kuptimplote të K. Otfrid Myler: "Sa me më shumë mendjemprehtësi të depërtohet në historinë e Greqisë, aq më shumë të tërheq vëmendjen elementi pellazg i sakrifikuar deri më tani".

Ekzistojnë ende sot mosmarrëveshje midis historianëve mbi një trung të përbashkët të etruskëve, ilirëve dhe pellazgëve. Por e gjithë kjo tashmë është thënë në shekullin VI para Krishtit nga Hekate i

Miletit, nga Hellanikosi i Mitilenit, Tuqididi (IV, 109) dhe mbi të gjitha nga Herodoti (I, 57): Tirrenët (etruskët) dhe Pellazgët bënin pjesë në të njëjtën tërësi etnike. Ja çfarë na thotë Dominik Brikel në librin e tij "Pellazgët në Itali" (Shkolla franceze në Romë, pallati Farneze-1984): "Tradita pellazge shfaqet aq e lidhur në zonën padane*) dhe ne do të kemi rastin ta vërejmë këtë në tërësinë e krahinave të tjera në praninë e etruskëve. Pellazgët janë të parët e etruskëve. Midis këtyre dy koncepteve ekziston vetëm një dallim kronologjik".

Megjithatë në shekullin VI dhe V para Krishtit, Hekate i Miletit, Feresidi dhe Hellanikos i Mitilenit hapësirën detare midis dy gadishujve (ballkanik dhe italik) e quanin me emrin "Gjiri Jonian". Pra ky det shtrihej nga gjiri i sotëm i Venecias deri në Kanalin e Otrantos. Por grekët morën termin "i onë" për të emërtuar shumë më vonë (rreth shekullit të Augustit) detin që gjendej në jug të kanalit të Otrantos, hapësira që gjendej midis Italisë jugore dhe Greqisë. Ky det përfshin ishujt e Korkyrës (Korfuzi), Leukadën, Itakën, Cefaloninë, Xantën dhe Kiterën. Gjithsesi, autorë të tjerë, si Pauzani (V, 22, 3 - VII, 14, 13), do të vazhdojnë, për arkaizëm, të përdorin termin Jonian për të emërtuar detin Adriatik. Ja përse kjo pjesë e detit quhet sot deti Jonian.

Na është thënë krejt e kundërta në lidhje me këtë det. Disa ia veshin këtë emër një Joniani i Isa apo Lisa (ishulli i sotëm i Vis-it, në hapësirën e Splitit në Kroaci). Lumi Adria tashmë njihej nga Hekate i Miletit. Sipas Teopompus "Adrias" (emër i qytetit në veri të grykës së lumit Po, skaji verior i Adriatikut) do t`i ketë dhënë emrin detit fqinj. Ai e njëjëson me Tartaron, i cili buron në jug-lindje të liqenit të Gardës dhe lag qytetin e sotëm të Adrias, zona e të cilit dhe emri përjetësojnë ato të qytetit antik (Straboni VII/I, 5, 9 - II 5, 20).

Askush nuk e ka zbuluar këtë hiatus*): ky det nuk mund të quhej me emrin e një Joniani të veçantë, siç kanë dashur të na bëjnë ta besojmë,

*) *Rajon në Italinë e veriut.*

apo me emrin e armiqve të betuar të dorianëve: jonianët. Pra nuk mund tu mvishet atyre pushtimi i këtij deti përreth bregut perëndimor të Peloponezit! Në të vërtetë, në shekullin VII dhe VI para Krishtit, pjesa më e madhe e jonianëve të dëbuar nga dorianët gjetën strehë në Azinë e Vogël, ku themeluan një qytetërim të shkëlqyer (Mileti, Efesi, Fose...), të cilin më pas e bartën në Greqi. Si rrjedhojë, nëse dorianët do të kishin qenë të bindur se emri i këtij deti rridhte nga ai i një Joniani ose nga emri etnik i jonianëve, ata pa dyshim nuk do ta kishin pranuar kurrë.

Një tjetër emër i shquar me zanafillë ilire është Egnatus, nga i cili ka marrë emrin via Egnatia (rruga Egnatia). Straboni (libri VII, 7/4, 7/8, fr. 10, 13, 21) është një nga autorët e rrallë që na zbulon kuptimin e emrit të kësaj rruge të famshme, të pagëzuar me emrin e shpikësit të tij Knaeus Egnatius, biri i prokonsullit Kajus. Kjo rrugë u ndërtua në vitet 146–120 para Krishtit. Emri Egnatius nuk shpjegohet me asnjë gjuhë tjetër, përveç shqipes; "i n`gjati" që do të thotë i madh, i gjatë dhe që na tregon se ky personazh kishte një "shtat" të madh ose nga një familje me shtate të derdhur

Kjo rrugë nisej nga Durrësi (pikë grumbullimi kryesore) dhe nga Apolonia (degëzimi dytësor). Këto dy rrugë bashkoheshin disa kilometra më tej (në Klodiana, Peqini i sotëm; kjo pjesë u quajt rruga e Kandavias) dhe formonte një të vetme deri në Bizanti, duke kaluar nëpër Thesaloniki*). Ky bosht rrugor lidhte provincat lindore të Perandorisë Romake me Italinë. Kjo ishte, si të thuash, përzgjatje e rrugës Apia, që lidhte Romën me Brindes (Brindisin) në bregdetin italian të Adriatikut, kundrejt Ilirisë së Jugut.

Gjurmët e para historike që na japin shkrimet ose epigrafet ngjiten deri në shekullin VII para erës sonë (shkrimi alfabetik shfaqet në Greqi

*) *hiatus - term në shkencën e gjuhësisë. Këtu në kuptimin e mangësisë.*
*) *Selaniku*

para fundit të shekullit VIII dhe, mbi të gjitha, në fillimet e shekullit VII). Në të vërtetë, Ilirët nuk e shkruanin më gjuhën e tyre: asnjë gjurmë e alfabetit pellazg e përmendur nga autorët më të lashtë, ndër të cilët Homeri, i cili fliste për një gjuhë të perëndive (Iliada I, 401, 406/ XVI 234). Kur ata deshën të rishkruanin gjuhën e tyre, huazuan në fillim germat e alfabetit të gjuhëve më të përdorura të epokës, ndër të cilat greqishtja dhe më pas latinishtja: epigrafet (nuk gjenden tekste të mirëfillta të shkruara) janë gdhendur me anë të dy alfabeteve. Por ilirët filluan ta ndërtojnë jetën e tyre politiko-shoqërore (paralelisht me Epokën e artë të Greqisë klasike) vetëm duke nisur nga shekulli V para Krishtit deri në vitin 168 para Krishtit, data e pushtimit përfundimtar të Ilirisë nga romakët, të cilëve gjithsesi u kishin dhënë më shumë se një duzinë perandorë dhe me dhjetëra gjeneralë. Në lidhje me këtë pikën e fundit, kujtoj se perandorët dhe gjeneralët e shumtë romakë kanë mësuar ose e kanë perfeksionuar artin luftarak në Ilirinë e Jugut (Shqipëria e sotme), në veçanti në Dyrrachium (Epidamni i lashtë, Durrësi i sotëm) dhe në Apolloni (Pojan i sotëm). Sipas Lukanit Cezari e zhvilloi në Durrës betejën e tij kundër Pompeit, përpara se ta mundte atë në Thesali, në betejën e Farsalës (viti 48 para Krishtit). Gjithashtu, Ciceroni u syrgjynos në Durrës. Katula e quante Durrësin taverna e Adriatikut.

Duke filluar nga pushtimi romak, ilirët, për t'i shpëtuar mizorive të hordhive shkatërrimtare të legjioneve romake, gjetën strehë në malet e tyre të paarritshme dhe ranë në një letargji të plotë. Ata do të rizgjohen vetëm në mënyrë sporadike për të luftuar kundër pushtuesve të njëpasnjëshëm. Ajo që duhet kujtuar është fakti se Iliria mbeti tërësisht jashtë qytetërimit grek.

Me fillimin e periudhës kristiane (Straboni në shekullin I para Krishtit, pastaj Taciti rreth viteve 55 para krishtit–120 pas Krishtit dhe Klaud Ptoleme rreth viteve 100–170 pas krishtit, gjenden midis përhapësve të tjerë të emrit Albanoi), të cilin të huajt – ndër të cilët grekët dhe romakët – do t'i quajnë ilirë, (të paktën ata që në strehët e

tyre malore u kishin mbijetuar pushtimeve të ndryshme) arvanos, arvanitis, albanoi, albani, arnaut, arbër, arbën, arven, arban, albën, alban, albanensis, albanais dhe të tjera variante. Albanoi-ët, të përmendur nga këta shkrimtarë antikë, zënë një rajon që gjendet sot midis Durrësit dhe Dibrës: zona e Krujës dhe ajo që gjendet midis lumenjve Mat dhe Erzen. Kryeqyteti antik i kësaj zone, sipas këtyre autorëve, ndër të cilët Ptolemeu, ishte Albanopolis (sot Zgërdheshi, jo shumë larg Krujës). Duhet saktësuar se shqiptarët asnjëherë nuk e kanë përdorur këtë emër për të emërtuar etninë e tyre: midis tyre ata e quajnë veten shqiptar, domethënë bir ose fëmijë të shqiponjës. Në lidhje me këtë shënojmë se ushtarët e Pirros (shekulli III para Krishtit) e quanin mbretin e tyre "Shqiponja" dhe një ditë vetë mbreti ia ktheu se ata ishin "fëmijët" e saj. Ekziston gjithashtu një tjetër interpretim i kësaj etnonimie: Shqiponja ishte një nga simbolet e Zeusit, perëndia pellazge, e mirëfilltë (cf. Homeri, Iliada XVI, 234). Shqiptarët do të kenë qenë pra "bij të Zeusit", pra "bij të Shqiponjës". Nga ana tjetër, perëndia e tyre e quajtur Zot, të kujton gjithashtu emrin hyjnor të Zeusit. Megjithatë, fjala Shqip, përpara se të bëhej etnonimia (Shqiptar) gjithmonë ka emërtuar "gjuhën shqipe" (gjuhë shqipe = gjuhë e pastër, e qartë).

Duhet shënuar se flamuri shqiptar (emblema e Skënderbeut në shekullin XV) kishte një shqiponjë dykrerëshe të zezë (e zeza simbolizon hidhërimin, fatkeqësitë dhe vuajtjet e popullit shqiptar); dykrerëshe sepse simbolizon gegët e Veriut dhe toskët e Jugut; në sfond është ngjyra e kuqe (e kuqe që simbolizon gjakun e derdhur nga Shqiptarët gjatë shekujve për të mbrojtur atdheun e tyre). Së fundi shënojmë se kjo emblemë (shqiponja) i rifilluar prej pushtuesve sllavë (më pas nga Austriakët dhe vendet e tjera të Europës) gjatë pushtimit të vendeve ilire, të cilat shtriheshin nga të dy brigjet e Danubit deri në Epir dhe nga deti Adriatik deri në Detin e Zi.

Përveç dinastive ilire, të përmendura në kronologjinë e këtij kapitulli, ekzistojnë ilirë të shquar që gjenden shumë rrallë të përmendur (edhe

si ilirë edhe si shqiptarë) në analët e historisë. Në të vërtetë, janë të shumtë ata që u shkombëtarizuan në mënyrë që të bënin karrierë në vende të tjera duke ofruar shërbimin e tyre ose duke shfrytëzuar cilësitë apo talentet e tyre në përfitim të kombeve të huaja. Ambiciozë, guximtarë, të zellshëm besnikë dhe nismëtarë, ata kanë ditur të shquhen apo të vlerësohen falë cilësive të tyre si udhëheqës, strategë ose takticienë si dhe nga personaliteti i fortë i tyre, ndjenja e tyre për miqësinë, mikpritjen dhe fjalën e dhënë (besa e famshme). Kësisoj, kjo i ka çuar të ushtrojnë funksione të larta ose të ushtrojnë zanate nga më të ndryshmet në vende të shumta (cf. lista e emrave të shquar).

Pra, kanë bërë karrierë (perandorë, gjeneralë mbretër, papë, guvernatorë, arkitektë, skulptorë, piktorë, mercenarë...) ndër grekët, romakët, venetët, bizantinët, turqit, egjiptianët (148 vjet dinasti shqiptare: nga Mehmet Ali deri te Faruku I) madje ndër francezët (nën Karlin VIII, Fransua I, Henri IV, Napolon Bonaparti...), ndër habsburgët (Maksimiliani I), ndër tudorët (Henri VIII), ndër burbonët (Karli III, mbreti i Spanjës dhe duka i Parmës), etj.

Në lidhje me këtë, ja disa vërejtje të Pukvilit, konsull i përgjithshëm i Francës në Janinë (Udhëtim në Greqi, Paris 1826): "Në të gjithë kohërat shqiptarët, të cilët mund të quheshin "pellazgë kaukazianë", themelonin koloni të tyre, pa u përzier me kombe të tjera dhe kalonin si mercenarë në shërbim të princave që donin t'i paguanin... Por shqiptarët janë të regjistruar si ushtarë mercenarë jo vetëm në Mbretërinë e Dy Sicilive; ata i sheh të përzier në luftërat tona civile, në kohën e fraksionit të Gyizeve dhe nën flamurin e vetë Henrit IV, të cilin pjesëtarët e lidhjes e qortuan se kishte marrë shqiptarë. Komini përmend me lëvdata kalorësinë e tyre të lehtë. "Ishin ata, thotë ai, njerëz trima edhe të fortë në luftë". Zhak de Volter (Rer.italic.script.t. XXIII) i paraqet si shkatërrimtarë. Ata gjenden në betejën e Fornusë kundër Karlit VIII, mbreti i Francës. Autori i Shekullit të Lugjit XV [Volteri, Përmbledhje e shekullit të Luigjit XV] na i paraqet të radhitur

nën flamurin austriak dhe "gjithmonë po aq ushtarë të mirë sa edhe paraardhësit e tyre".

Europa e gjuhëve

Perënditë, mbretërit, heronjtë, shenjtorët, papët ose figura të shquara me zanafillë pellazgo-thrako-ilire dhe shqiptare:

Greqia antike

■ Zeusi dhe perëndi të tjera të mitologjisë, ndër të cilat Rea, Afërdita, Hera, Artemisa, Hadesi, Mnemosini etj. Këto emra kanë kuptim dhe shpjegohen në bazë të gjuhës shqipe.

■ Akili (heroi më i madh i Iliadës, emri i tij shpjegohet nëpërmjet gjuhën shqipe).

■ Emrat e shumë heronjve dhe heroinave, ndër të cilët Agamemnoni, Menelau, Ajaksi, Aleksandri (Parisi), Uliksi (Odiseja), Penelopa, Kasandra, Amazonat, Dardani (biri i Zeusit dhe themeluesi i Trojës) etj.

■ Pirro I, Neoptolemeu (biri i Akilit), themeluesi i mbretërisë së Thesprotisë (që u bë më pas Epiri).

■ Pitagori i Samos (biri i një Tursani, Tirrhenian / Pellazg i Lemnos).

■ Aleksandri i Madh, i cili, përkrah gjuhës greke (lingua franka*) e epokës), nuk rreshti së foluri gjuhën e tij amtare (nëna e tij Olimpia ishte një princeshë epirote) dhe atë të babait (maqedonishten).

■ Pirro II (mbreti molos i Epirit : shqip quhet "Burri") i cili i ka dhënë pa dashje shqiptarëve etnoniminë e tyre Shqiptar (bij ose fëmijë të Shqiponjës). Ushtarët e tij epiro-ilirë e quanin atë Shqiponjë. Ai ua ktheu një ditë se ata ishin bijtë e tij ose "bijtë e Shqiponjës". Të mos harrojmë se ndër ilirët, shqiponja përfaqësonte simbolin e vetë etnisë së tyre. Përveç kësaj, Zeusi kishte si emblema shqiponjën, skeptrin, dhe vetëtimën. Flamuri shqiptar paraqet në një sfond të kuq një shqiponjë dykrerëshe (një kokë për Gegët e Veriut dhe një tjetër për Toskët e Jugut: dy elementet kryesorë përbërës të etnisë shqiptare) etj.

Roma antike

Etruskët, qytetërimi i parë i madh në Itali, përbënin degën perëndimore të pellazgëve. Romulusi shpjegohet me gjuhën shqipe: "rromulak" d.m.th. "ai që ka kokë të rrumbullakët" dhe në kuptimin më të gjerë, "brakicefal". Ndër të tjera, fjalë të shumta etruske shpjegohen falë gjuhës shqipe (afërsisht 250 fjalë të studiuara në kapitullin "gjuhësia"). Tradita etruske i vishte një jetëgjatësi prej 1000 vjetësh qytetërimin etrusk. Sipas traditës ajo duhet të jetë shuar ditën e vdekjes së Cezarit, në Idat e Marsit (15/03/44 para Krishtit), gjë që kujton ditën e mbërritjes së tyre në Itali në shekullin XI (rreth vitit 1044 para Krishtit). A të jetë kjo data e mbërritjes së tyre në Itali apo ajo e marrjes së pushtetit? Ka shumë të ngjarë që të jetë ngjarja e fundit,

---

* *Përzierje e gjuhëve greke, spanjolle, italiane franceze e përdorur në rajonin e Levantes*

e cila, sipas kërkimeve të shumta të mia në lidhje me këtë, (cf kapitulli mbi Etruskët), do të ishte më e pranueshmja, meqë autorët antikë grekë e ngjisin mbërritjen e tyre në Itali shumë më herët se sa shekulli XIII para Krishtit.

Perandorët romakë

51 - 96 Domitus Aureliani (Domitiani) - ilir.

235 - 238 Maksimin I (nga Mesia e Poshtme ose Ripa Thrasika). Ai rrjedh nga fisi trakas i Besëve. Disa autorë mendojnë që bëhet fjalë për një Got. Ai është perandori i parë i periudhës së quajtur "Anarki ushtarake" të shkaktuar nga ilirët.

249 - 251 Deciusi, i lindur në Bubalia (Panonia e Poshtme).

253 - 260 Valeriani, babai i Galianit (Etrusk), i lindur në Trakë.

260 - 268 Galiani (etrusk - mbiemër Egnatus e mbajtur nga nëna e tij).

268 - 311 Periudha e quajtur e "Perandorëve Ilirë". Por ka patur të tjerë dhe në veçanti në Perandorinë romake të Lindjes dhe në Perandorinë Bizantine.

268 - 270 Klaudi II (etrusk) i quajtur Gotiku.

270 - 275 Aureliani (ilir) - I lindur në Sirmium në Panoni - Restitutor orbis (Restauruesi i botës). Ngadhënjyesi i mbretëreshës Zenobë të Palmirës - rrethoi Romën me mure që ekzistojnë edhe sot - perandori i parë që u shenjtërua para vdekjes.

276 - 282 Probusi (ilir), i lindur në Sirmium në Panoni.

282 - 283 Karusi (ilir).

284 Numeriani (biri i Karusit).

285 - 287 Diokletiani (ilir), i lindur në Salone (Split) në Dalmaci, persekutoi të krishterët.

287 - 305 Maksimian I Herkuli (ilir), i lindur në Daia në Panoninë, bashkëpunëtor i Diokletianit.

306 Severi (Flavius Valerius Severus) - babai ilir i Kostandinit.
306 - 337 Konstandini I i Madh (ilir, i lindur në Nish).
363 - 364 Joviani (ilir).
364 - 375 Valentiniani I (ilir) i lindur në Kibala në Panoni.

375 - 392 Valentini II (ilir nga Panonia).

Perandorët Bizantinë

491 - 518 Anastasi I (ilir, i lindur në Durrës).
518 - 527 Justini I (ushtarak ilir) i lindur në Bederiana në Iliri.
527 - 565 Justiniani I, i mbiquajtur i Madhi (ushtarak ilir), i lindur në Tauresium në Dardani.
1081 - 1185 Dinastia e Komnenëve: 6 perandorë.

Papë

402 - 417 Inoçenti I (ilir, i lindur në Latium) - Papa i 40[të].
1700 - 1721 Klementi XI (Xhan Françesko Albani, familje e shquar me zanafillë shqiptare, ndër të cilët piktori Albane dhe kështjellarët e Vila Albanitnë Romë): Papa i 243[të].

Shenjtorë ose personalitete fetare

283 - 296 Shën Kajus ose Gajus (ilir nga Dalmacia).
316 - 397 Shën Martini = ilirian nga Sabaria në Panoni. Ky ushtar ilir i ushtrisë romake, në garnizon nw Amians ose ku ishte pagëzuar, sipas legjendws do ta ketë ndarë mantelin e tij me një të varfër. Ai ishte Peshkop i Turit në vitin 371. Varri i tij dhe bazilika ku prehej u bënë vend mbrojtje dhe pelegrinazhi më i nderuar në gjithë Galisw dhe më vonë kulti i tij u përhap në të gjithë Francën. Më shumë se 500 komuna

mbajnë emrin e tij . Ky emër dhe mbiemër është më i shpeshti në Francë, rreth 268000 kundrejt 111000 për Durand (statistika të vitit 1999). Ithtari i Shën Hilerit është mbrojtësi i mullisëve

347 - 420 Shën Jeronimi (ilir nga Dalmacia) - Përkthyesi i parë i Biblës në latinisht (autor i Vulgatës).

1910 -1997 Nënë Tereza, lindur me emrin Gonxhe Bojaxhi (Çmimi Nobel për Paqen në vitin 1979) Ajo i përkushtoi jetën e saj të varfërve të Indisë. * E fortlumturuar nga Gjon Pali II në Vatikan më 19/10/ 2003.

Emra të tjerë të shquar me zanafillë ilire dhe mbi të gjithë shqiptarë

* Spartak (viti 71 para Krishtit, gladiator me zanafillë thrake).

Shkrimtarë dhe humanistë me zanafillë shqiptare, në veçanti në Itali, ndër të cilët:

* Leonik Tomen (1456-1531).
* Marin Beçikemi (1468-1526), i quajtur nga Italianët Marino di Skutari d.m.th. "Marini nga Shkodra (qytet shqiptar)".
* Gjon Gazuli (Padova, Raguza).
* Mikel Barleti.
* Maksim Artioli.
* Mihal Aleksi.
* Mark Antoni Sabellico.
* Marin Barleti, biografi i Skënderbeut (shekulli XVI).
* Jeronim de Rada, arbëresh i Italisë së Jugut (1814-1903).
* Gavril Dara i Riu, arbëresh.
* Viktor Eftimiu, shkrimtar rumun me zanafillë shqiptare, lindi në vitin 1889 dhe vdiq në një kamp përqendrimi në Tergu-Jint etj.

Piktorë të shumtë, skulptorë, arkitektë, artistë... (në veçanti në Mesjetë; Rilindjen italiane të Viçensas, Padovas, Venecias; epoka bizantine, etj.) janë shqiptarë ose me zanafillë shqiptare, ndër të cilët:

* Jan Kukuzeli (rreth 1070 - 1075) mjeshtër i kishëzës në pallatin perandorak në Kostandinopojë. Kompozitor (muzikë fetare bizantine) me zanafillë shqiptare dhe shpikës i një shkrimi të ri (sistemi kukuzelian) dhe e "sistemit të rretheve" (raportet harmonike për gama të ndryshme). Muzikologjia moderne i detyrohet shumë atij.

* Miko Tivarasi (shekulli XV) arkitekti që konceptoi manastirin e famshëm të Dubrovnikut (Raguza).

* Andrea Aleksi (lindur në Durrës rreth vitit 1425) arkitekt, skulptor (kishëza e Shën Katerinës e Sebenikut në Dalmaci; bashkia e Splitit, bazilika e Shën Nikolës e ishullit të Rabit, baptisteri, pallati peshkopal dhe portiku i qytetit Trogir në veri të Splitit ... etj.

* Karpaçio Vitore (Viktor Karpaçi 1460-1525): një nga piktorët më të shquar, i quajtur "Shqiptari i Viçensas".

* Familje artistësh të quajtur "Shqiptarët e Urbinit", ndër të cilët Françesko Albaneze (1567-1611) dhe bijtë e tij; Gjon e Hieronim (Xhirolamo), të cilët me veprat e tyre zbukuruan Veneciën, Vinçencën dhe Padovën.

* Aleks Tarketa që gdhendi altarin e katedrales së Milanos (Altari shqiptar).

* Xhovani Batista Albanezi (rreth viteve 1573-1630).

* Françesko Albani, i quajtur Alban (1578-1660).

* Xhirolamo Albanezi (1584-1663).

* Onufri Nikollë, i mbiquajtur Onufrio, piktori më i madh shqiptar i ikonave (shekulli XVI).

* Dhimitri i Linit.

* Mihal (ose Mahal) i Jermës (rreth vitit 1662).

* David Selenica - ndërtoi kishën e Shën Kollit në Voskopojë.

* Vëllezërit Konstandin dhe Athanas Zografi (1744-1789),

specialist i pikturës fetare.

* Progon Zguri, arkitekt në zanafillë të ndërtimit të Shën Klementit dhe të Shën Mërisë së Ohrit.

* Pjetër Dahni, arkitekt.

* Aleksandër Moisiu (1879-1880/1935), artist, autor, komedian që ka luajtur në skenat e teatrove të shumtë europianë (i drejtuar në veçanti nga Maks Rainhardt në Teatrin e Berlinit)..

* Tefta Tashko Koço (1910-1947) këngëtare e shquar shqiptare që ka kënduar në operat e mëdha europiane, njihej me emrin "Bilbili i Shqipërisë".

Burra shteti, revolucionarë, gjeneralë, fisnikë ose familje mbretërore me zanafillë shqiptare:

* Lala Shahin Pasha (rreth vitit 1360) bejlerbeu i parë i Perandorisë, guvernatori i Rumelisë.

* Lala Mustafa Pasha, pushtues i venetianëve në Famagustë (Qipro) 1/08/1857.

* Engjëll de Komnen, me prejardhje nga familja fisnike shqiptare që emigroi në Francë në shekullin XV.

* Mërkur Bua, gjeneral kavalerie i ushtrisë franceze, nën Luigjin XII.

* Markezi i Shën Anzh (vdekur në Pavia 25/02/1575), pasardhës i drejtpërdrejt i Skënderbeut.

* Markezi d'Auleta i quajtur Anton Kastriot Skënderbeu.

* Helen d'Anzhu (Francë), gruaja e Tanush Topias, zot i viseve Durrës-Krujë.

* Gjeneral Arnault ("Arnaut" është emri që përdorin turqit për të emërtuar shqiptarët), në ushtrinë franceze nën Fransua I.

* Mehmet Pasha Arnaut (rreth vitit 1632), Veziri i Madh i Perandorisë Otomane.

* Qiprilliu (Köprülü), familje e rëndësishme turke me zanafillë shqiptare, pesë pjesëtarë të së cilës ishin Vezirë të Mëdhenj të

Perandorisë Otomane prej vitit 1656 deri në vitin 1710 dhe të tjerë që kanë qeverisur Turqinë deri në ditët tona.

* Fazil Ahmet Pasha, Vezir i Madh i Perandorisë Otomane (1661-1676).

* Mustafa Hysein, Veziri i Madh i Perandorisë Otomane.

* Mehmet Ali (1769-1849) mëkëmbës-mbreti i Egjiptit, themelues i një dinastie shqiptare që ka mbretëruar përreth 150 vjet, me shumë figura të shquara, ndër të cilët mbreti i fundit Faruk I që abdikoi në vitin 1952, pasgrushtit të shtetit të kryer nga një juntë ushtarake e drejtuar nga gjeneralët Neguib dhe Naser.

* Marko Boçari, hero i Pavarësisë greke (zanafillë epiro-shqiptare) dhe mbrojtës i Misolongjit (1786-1823).

* Gjika (Ghika), emri i një familjeje princërore rumune me zanafillë shqiptare, ndër të cilët Aleksandër Gjika (princi i Moldavi-Vllahisë - 1795-1862),Monsenjor Vladimir Gjika (1873/ 17-5-1954) dhe Elena Gjika (shkrimtare, poeteshë), e cila (rreth vitit 1866) nën pseudonimin "Dora d'Istria" bëri një studim të thellë për identitetin shqiptar nëpërmjet këngëve popullore.

* Konti Durazzo Jeronim, Luis, Fransua Jozef (1740-1809), urna që përmban zemrën e tij është vendosur në Panteon (Francë). Senator në Perandorinë e Parë. Emri i tij Durazzo është transkriptimi italian i emrit të portit shqiptar Durrës.

* Françesko Krispi (1818/1901), shok i Garibaldit, president i Këshillit italian(1887-1891).

* Mustafa Kemal, i quajtur, Ataturku (1881-1938), burrë shteti, themelues i Turqisë moderne (me zanafillë shqiptare nga e ëma), etj.

* Habib Burgiba, burrë shteti lindur në Manastir (Tunisi), është me zanafillë shqiptare nga nëna e tij. Ai pati interes të pwrcaktojë se emri i qytetit të lindjes është i njejtë me atë të qytetit Manastir (sot "Bitola") në Maqedoni, qytet ku kanë jetuar gjithmonë shumë shqiptarë.

Arkitektë të shquar të Perandorisë Otomane:

* Sinan Mimar (1489-1588) që ndërtoi xhaminë më të bukur të Stambollit (Sylejmanie, në vitet 1550-1557), xhaminë Shehzade të Stambollit, xhaminë Selimije të Edirnit (kryevepra e tij), xhaminë e Bardhë (Jeni Xhami) dhe rreth 360 monumente të tjera.

* Sedefqar Mehmet Biçakçi i Elbasanit, arkitekt i xhamisë së Hipodromit ose Atmejdan.

* Arkitektë shqiptarë, që kanë projektuar sistemet e akueduktëve (ujësjellësve) të Stambollit.

* Mehmet Aga që ndërtoi në vitet 1609 - 1617, xhaminë e rimët (Blu) të Stambollit ose xhamia e Sulltan Ahmetit.

* Mehmet Mustafa Aga dhe Hoxhë Kasem që ndërtuan xhaminë Valide të Sulltanijës së Gallatës (Stamboll -1873).

NB

- Shumë emra të tjerë ilirësh apo shqiptarësh të shquar kanë mbetur të panjohur. Këtu ne kemi përmendur vetëm ata, për të cilët burimet e informacionit janë më të sigurta. Natyrisht që ka të tjerë që unë nuk i di, që i njoh më pak ose që nuk i kam përmendur për mungesë të dhënash të sakta a të paverifikueshme. P.sh. në lidhje me Napoleon Bonapartin, me sa duket stërgjyshat e tij gjenovezë kanë qenë me zanafillë shqiptare. Disa tregues të fshehtë duket se e ravijëzojnë këtë: ai është i vetmi monark francez që ka krijuar një "Regjiment shqiptar" në mes të ushtrisë franceze (cf A. Bop – Shqipëria dhe Napoloni/ Hachette – 1914). Ai është marrë vesh me Ali Pashë Tepelenën (i quajtur gjithashtu Pashai i Janinës ose "Ali sëpata") dhe, në saje të këtyre marrëdhënieve, ky i fundit arriti të përfitojë në mënyrë të heshtur një farë imuniteti në këtë rajon ballkanik që tashmë ishte fuçi baruti. A ishte Bonoparti në dijeni të zanafillës së tij shqiptare? Shtojmë ndër të tjera se nipi i tij, princi Luiz-Lysieni Bonapart ka shkruar mbi Etrurinë dhe mbi të gjitha mbi shqiptarët (Shqiptarët në tokën e Otrantos/

Londër 1885)! Të mos harrojmë se Korsika ishte në varësi të etruskëve të famshëm, të cilët kanë lënë gjurmë të shumta në ishull: këngët polifonike, zakonet dhe doket (hakmarrja ...) ose karakteri i veçantë i korsikasve që përqaset me atë të shqiptarëve të sotëm. Një tjetër figurë e shquar nuk figuron në morinë e emrave të lartpërmendur: Pikaso. Ka të ngjarë, sipas disave, që stërgjyshërit e tij të kenë qenë shqiptarë me zanafillë nga Azia e Vogël perëndimore, ku ekziston gjithmonë një pakicë e fuqishme shqiptare (rreth 5 milion turq janë me zanafillë shqiptare). Është kjo gjithçka që mund të them lidhur me këto dy figura të shquara.

Maliq (Korçë): terakota e pikturuar — Neolitiku i vonshëm
(sipas "Shqipëria Arkeologjike" - Tiranë - 1971)

Parahistoria e Europës

Popujt e parë të trungut pellazg: Pellazgët, Ligurët, Lelegët, Karianët, Lisianët, Iberët, Egjeasit, Filistinët, Trojanët, Etruskët, Frigjianët, Thrako - Ilirët etj.

Zona danubiane, Mesdheu verior, Jug-Lindja dhe territori i Shqipërisë së sotme dhe në veçanti vendet përqark saj.

Shenja * = Mbetje rrënojash të gjetura në Shqipëri ose ngjarje që kanë të bëjnë me të.

700 000 - 120000

Bifasët e parë në Europë (Abevillien) - Përdorimi i zjarrit, vatrat e para: Shpella e Eskalës (rreth vitit 650 000), Terra Amata (rreth vitit 380 000) - Vendbanim në shpellë (Tautavel rreth vitit 450 000).

* Zonë ilire parahistorike e zbuluar: shpella e Kaprinas (sot në Kroaci) që daton qysh prej më shumë se 160 000 vitesh (epoka paramusteriane).

120 000 - 35000

Paleolitiku i mesëm - Njerëzit e parë modernë: Neandertal, Cro Magnon - Varrezat e para (Izrael, 100 000) - Pikturat e para në shkëmb (petroglife). Teh stralli (Levalluazian, rreth 60 000) - Motive të gdhendura (kockë e gdhendur në Bako Kiro në Thrakë rreth 50 000).

* Gjurmë të para njerëzimi të zbuluara në Ilirinë e Jugut (Shqipëria e sotme): Gajtan, Gruemir, Dukagjin, rrëzë malit Dajti (Veri); Xarë, Shën Mëri (Jug).

35 000 - 10000

Paleolitiku i hershëm - Solutrean, Magdalean, aurinjacian - Zhdukja e njeriut të Neandertalit (rreth 35 000). Shfaqja e Homo Sapiens (rreth 35 000).

Fundi i periudhës akullnajore (10 000) - Përdorimi i obsidianës*) - qelq i zi vullkanik i ishullit të Melos dhe i Anatolisë - (Shpella e Frankthit, në Ermioni rreth 11 000)- Lende lisi të pasura me amidon: ushqimi i popujve të parë evropianë. (Pellazgët = ngrënës të lendeve të lisit, sipas autorëve të parë të Greqisë antike !).

*) Xarë, Shën Mëri, Cakran, rrëzë Malit Dajt.

10 000 - 6500

Periudha pas - akullnajore - Fillesat e bujqësisë dhe të drithërave në Ballkan dhe në rajonin danubian (rreth 6500) - Poçeri me kordele (kultura danubiane) dhe Poçeri e pikturuar (rreth 6 000) - Shtëpitë e para me kashtë dhe mure të mbuluara me qerpiç (Nea Nikomedia - Ballkani i Jugut).

* Zona mesolitike të zbuluara në Shqipëri: Blaz I (krahina e Matit). Në Veri dhe në Vlushë I në Jug; shpellat e Fushë-Muhërit, Velça, Treni, Spileja etj.

6 500 - 2500

Neolitiku - Skulpturat e para prej guri në Ballkan (Lepenski Vir) - Shfaqja e ndërtimeve megalitike në Europën perëndimore (5 000/4 000).

Statujat e para në argjilë (kultura danubiane në rajonin e Hungarisë së Sotme / Sicegvar-Tuskoves). Fillimet e metalurgjisë në juglindje të Europës (në vitet 5 000-3

500) - Rrënojat e Sesklo, Dimini, Eretria.

Ndërtimi i shtëpive prej druri (Hornstat-Hornle / dru i vjetër: 3 586) - kultura e vreshtarisë në lidjën e Mesme rreth viteve 5 000 dhe prodhimi i verës rreth viteve 2 500. Përdorimi i arerës (parmenda zanafillore prej druri e tërhequr nga një gomar apo një ka, rreth viteve 4 000 - kulmi i qytetërimit danubian - Kulmi i qytetërimit minoan (Kretë, Siklada, rreth 2600/ 2000).

Përhapja e kulturës pellazge rreth vitit 2600 para Krishtit

* Zona neolitike të zbuluara në Shqipëri: I Lashtë = Kolsh I, Blacë II, Cetushi, Burim, Podgorë, Vashëtemi, Barç I, Vlushë II, Tren I. i Mesëm = Kolsh II, Blac III, Cakran, Dunavec. I Vonshëm = Maliq I, Barç II, Dersnik, Velçë, Kamnik.

* fshat buzë liqenit i zbuluar në Maliq.

2 2500 – 1 900

Eneolitiku - Epoka e Bakrit - Statuja mermeri (Sikladë, rreth 2500) - Të parat lidhje metalesh rreth 2000/1900 (bakër + kallaj = bronz) - Varna.

Shfaqja e dyndjes se parë të mbiquajtur indo-europiane (Helladikë e Lashtë II) - Helladikë e Lashtë III (rrënoja të Lernës) Qytetërimi danubian i Aunieticit (Unetic, rreth 1900/1450).Zbutja e kalit (rreth 2000, në Europën Juglindore) - Prodhimi i verës në Evropën juglindore (rreth 2000).

Monumente megalitike në jug të Britanisë së Madhe: Averbëri (2500), Stounhenxh (2100).

* Zona kalkolitike të zbuluara në Shqipëri; Nezir II, Bllac IV, Gradec, Burimas, Maliq II, Tren II.

1900 - 900

Antikiteti i Hershëm - Epoka e Bronzit - Kulmi i qytetërimit kreto-egjeas - Përgjithësimi i zbutjes së kalit - Gardhet dhe arëzat e para - (rreth1800) - Ndërtimi i pallateve të para (Kretë) - Shfaqja e shkrimit të mbiquajtur Lineari A (Kretë rreth 1650) - Qytetërimi danubian i Lusacës (Lausic, rreth 1450 - 1250) - Qytetërimi danubian i fushave të urnave (rreth 1250 - 900). Kulmi i qytetërimit të mbiquajtur mikenian (rreth 1450/1200) - shfaqja e linear B te Mikenianeve - Në jug të Gadishullit Ballkanik shfaqja e mbretërive të vogla të qeverisura duke filluar prej kalave të fortifikuara dhe pallatet, ka shumë të ngjarë pellazge (Mikenë, Argos, Tirinti, Tebë, Pilos...). Shpërthimi i vullkanit Santorini rreth 1656 sipas analizave të mbetjeve të Groenlandës dhe 1475 sipas vlerësimeve të tjera - Zhdukja e qytetërimit kretas rreth 1400 - Sikladika e lashtë: Mbetje të Milos, Paros (Parikia), Kea (Aghia Irini) - Shfaqja e objekteve të para metalike (rreth 1150).

* Zona të Bronzit (3 Epoka) të zbuluara në Shqipëri: Bronzi I = Shtoj, Dedaj, Gajtan I, Shkodër, Çinamak, Nezir IIIa, b, Pazhok, Maliq IIIa, Tren III, Luaras, Piskovë. Bronzi II = Nezir III c, Mat, Cetah II, Pazhok, Maliq III c, Vajzë,

Vodhinë, Çukë, Kajkaj. Bronzi III = Gajtan II, Çinamak, Kënetë, Pazhok, Gërmenj, Maliq IIId, Tren IV, Luaras, Piskovë, Badhër - Janë zbuluar në Shqipëri "tumule" të shumta (nga latinishtja "tumulus" d.m.th "kodrinë") disa prej të cilave arrijnë një diametër prej 15 - 30 metra. Ja dhe ato kryesoret :

* Kusha, Ivanaj, Golem, Krumë, Helshami, Çinamaku, Perlati, Laç, Bruçi, Urakë, Bushkash, Karica, Klosi në Veri; Pazhok, Kuç i Zi, Vodhinë, Bodrishta, Bajkaj, Vajza në Jug.
* Nekropole : Kalldrun (veriu i Shkodrës), Dushk (në veri të Lushnjës). *Zbulime objektesh që datojnë prej epokës së mbiquajtur mikeniane (thika, sëpata, maska, kordha, vazo, kocka....)

KRONOLOGJIA E GREQISË ARKAIKE, KLASIKE DHE HELENIKE

< 1200 **Periudha parahelene** : qytetërimet: egjeo- kretase, pellazge (mikenase).

1200 - 800 **Periudha e ndërmjetme** e quajtur "Shekujt e errët". Historia mbetet memece për këtë periudhë, e cila është objekt i kundërshtive të shumta.

800 - 479 **Periudha arkaike** e Greqisë stricto sensu.

800 - 750 Poemat epike (Homeri) - Hesiodi (rreth 700).

776 Lojërat e para Olimpike.

760 - 600 Shfaqja e shkrimit alfabetik. Lufta lelantine në Eube

midis Eretrias dhe Kalkisit. Fillimet migruese (koloni) në perëndim: Kumes (740), Sirakuzë (733), Korfuz (733), Selimonte (650), Apolloni (600), Massilia (600), Agrixhento (580) ... Fillimi i migracioneve drejt Lindjes: Sinop (650), Bizant (rreth 660), Sirene (630), Herakle i Pontit (560) ...

657 - 522 **Tiranitë kryesore - Korinth**: Sipselo (657-627), Periandër (627-585); - Sikione: Orthagora (650?), Klisthenë (600-570); - Megarë: Theagenë (650-600?); - Argos: Fidon (rreth 650); - Athinë: Pisistrat (561-527); - Milet: Amfitre (fundi VIII); Thrasibul (fundi VII); - Samo: Polikrat (532-522); - Efes: Pitagorë (rreth 600); Arhontat kryesore: arhont - mbret; polemarku dhe arhont eponim. Athina kishte nëntë arhontë, ndër më të famsh-mit ishin Soloni (594-593), Themistokliu (493), Aristidi (489), Euklidi sokratik (403 - 402).

640 Themelimi i Naukratis I, emporioni grek në Egjipt.

621 - 620 Drakon; legjislacioni kriminal.

508 Reforma e Klistenit, legjislator athinas.

499 - 494 Revolta Joniane (qytete greke në Azinë e Vogël).

490 - 479 Luftërat medike. Disfata Perse në Marato-në (490), në Salaminë (480), në Plate (479) dhe Mikala (479).

478 - 336 **Periudha klasike**

478 - 477 Konfederata athinase e Delosit.

478 - 431 Hegjemonia e Athinës.

454 Kalimi në Athinë i thesarit të lidhjes së Delosit.

447 - 438 Ndërtimi i Parthenonit nga Iktinos dhe Kalikrati.

443 - 429 Perikliu, zot i Greqisë.

431 - 404 Lufta e Peloponezit midis Spartës dhe Athinës - Rrënimi i Athinës.
430 - 426 Murtaja në Athinë.
403 Përshtatja e alfabetit jonian në Athinë.
404 - 371 Hegjemonia e Spartës.
373 Shkatërrimi i tempullit të Apollonit në Delfi.
362 Mantine: Sparta e mundur nga Teba. Vdekja e Epaminondasit.
351 Demosteni, armik i betuar i kolonializmit maqedon.
338 Beteja e Keroneit: Filipi II mund Greqinë.

336 - 146 Periudha helenistike
336 - 323 Mbretërimi i Aleksandrit të Madh.
280 Formimi i lidhjes Akene kundër Maqedonisë.
188 Futja në Spartë e lidhjes Akene.
148 - 146 Romakët pushtojnë Greqinë dhe Maqedoninë.

146 - 395 **Periudha Romake**
395 - 1453 **Periudha Bizantine**

KRONOLOGJIA E BOTËS KRETO-EGJEASE DHE MIKEANE

6500 **Ngulime neolitike në Knoso.**
4750 Kolonizimi i Cikladës.
3200 **Lindja e qytetërimit parahelen të sikladave:**
Të përbëra nga shumë ishuj, ndër të cilët Delos, Naksos, Paros, Melos (Milo), Andros, Siros, Thera. Por lulëzimi i këtij qytetërimi fillon me epërsinë e Melo, falë qelqit të zi (obsidianë). Në ishujt e tjerë të kësaj tërësie sikladike ishin në kulmin e lavdisë së tyre dhe të rëndësisë ekonomike: Naksos (zumpara - për lëmimin e mermerit -

plumb, argjend), Paros (mermer), Sifnos (ar, mermer). Poçeritë me larzim (flakada).

3000 – 2800 **Arritja e elementëve brakicefalë në Kretë.** Klanet dhe dinastitë lokale. Varret në Tolos. Pallati i parë i Mallias. Shfaqjae vazove të pikturuara dhe të pjekura. Troja I.

2400 – 2000 **Minoani i Lashtë** – Periudha para-palatiale në Kretë.
2300 – Kulmi i qytetërimit egjeas të Trojës II.
2200 - Kulmi i qytetërimit minoan.
Lidhje jo të drejtpërdrejta me Egjiptin nën dinastinë VIII. Ato u zhvilluan me të vërtetë në planin tregtar dhe artistik vetëm në dinastinë XVIII (1500 – 1380 para Krishtit). Prodhimi i bronzit me kallaj. Rënia e Tholos. Djegia e Trojës II.

2000 – 1580 **Minoani i Mesmë** – Epoka e pallateve të para të pafortifikuara (Knosos, Faistos) dhe pallati i dytë në Mallia. Kultet eksatike: vende të shenjta të natyrshme dhe Shpella të shenjta. Lineari A, shkrimi silabik zëvendëson atë me piktura(disku i Faestos gjuha e të cilit duket të jetë një proto – joniane, pra pellazgjishtja e lashtë). Kulmi i polikronit (Kamares). Katastrofa e përgjithshme dhe shkatërrimi i pallateve të para: fundi i Mallias. Në Egje është periudha e Sikladës së Mesme (2000-1700).

1580 – 1400 **Minoani i Vonshëm** - Kulmi i pallateve të reja (Knosos, Faistos, Hagia Triada).Hegjemonia e Thalasokracisë kretase. Epërsia e Knosos (1550 – 1450). Shpërthimi në Ishullin e Teras (1520 para Krishtit). Themelimi i Kidonias nga Minos (?) rreth 1450 – 1400.
Shfaqja e varreve në formë kupole. Shkatërrimi i Knosos dhe qyteteve lindore. Fundi i Thalasokracisë kretase.

	Rënia e Melos (mospërdorimi i obsidianas). Sikladika e Vonshme.
1400 - 1150	Kulmi i qytetërimit mikenas. Ndërtimi monumental i pallateve të fortifikuara me megaron (Mikenë, Tirinti, Pilos, Athinë). Prijësit mikenë bënin një jetë aristokrate të shfrenuar:festime, gjueti, luftëra, rrëmbime, plaçkitje. Mikena u bë qendra e botës egjease. Mikenasit përdornin Linearin A për të shkruar llogaritë e tyre mbi tabelëza argjile (Lineari B). Shkatërrimi i Trojës (1183 para Krishtit). Por mikenasit u zhdukën shpejt, pallatet e tyre shkatërruan (1150 para Krishtit?)

KRONOLOGJIA E ITALISË SË LASHTË

< 1000	**Qytetërimet: neolitik** (Molfeta, Stentinelo, Remedelo), Terramarrët (lugina e lumit Po) - Vilanovianët.
Shek. X - IX	**Mbërritja e Etruskëve** (shekulli XIII sipas Herodotit).
753	Themelimi i Romës prej Remus dhe Romulus (etruskë).
753 - 715	Romulusi (etrusk) mbret i Romës.
715 - 509	Periudha mbretërore "shtatë mbretërit legjendarë" në Romë.
715 - 673	Numa Pompulus (etrusk).
673 - 642	Tullus Hostilius - Horacët (romakë) mundën kuriasët (albinët).
640 - 616	Ankus Martius (sabin).
616 - 579	Tarkini i Lashtë (etrusk).
578 - 534	Servius Tullius.
534 - 510	Tarkini Madhështori (etrusk).
Shek. VI - V	Kulmi i qytetërimit etrusk.

509 - 27	**Periudha Republikane** Rënia e mbretërimit dhe themelimi i Republikës. Luftërat e Plebenjve kundër Patricëve. Mbizotërimi i Romës dhe ripushtimi hap pas hapi i gadishull Italik.
494 - 471	Krijimi i tribunëve të Plebeut.
406 - 396	Dhjetë vjet luftë me Veis-in (qytet etrusk).
343 - 341	Lufta I samnite.
340 - 338	Lufta latine.
336 - 304	Lufta e dytë samnite.
321	Fitorja e samnitëve mbi romanët.
310	Shpartallimi i etruskëve (liqeni Vadimon)..
295 - 290	Paqja me etruskët dhe samnitët.
285 - 282	Lufta kundër galëve.
280 - 278	Fitorja e Pirros: Heraklesi, Auskulum dhë Sicili.
275	Shpartallimi i Pirros në Benevento. Paqja në vitin 272.
264 - 241	Lufta I Punike kundër Kartagjenës. Roma pushton Sicilinë, Korsikën, Sardenjën dhe depërton në Galinë cizalpine.
229 - 219	Lufta I (229) dhe lufta II (219) kundër Ilirisë.
218 - 201	Lufta II Punike - Fitorja e Hanibalit (Trasimenë, Pulje). Fitorja e Skipionit në Afrikë (Zama -202).
215 - 205	Lufta I (215-205), lufta II kundër Maqedonisë (200-197).
200 - 190	Lufta kundër galëve në Italinë e Veriut.
172 - 168	Lufta III në Maqedoni, e kthyer në provincë romake.
168	Lufta III dhe e fundit kundër Ilirisë, e cila bëhet një provincë romake (prej Danubit deri në Epir).
149 - 146	Lufta III Punike - pushtimi dhe shkatërrimi i Kartagjenës.
146	Nënshtrimi i Greqisë - shkatërrimi i Korintit.

133 – 123	Reformat shoqërore: vëllezërit Tiberius, Kajus Grakus. Pushtimi i Spanjës.
106 – 86	Marius - shtatë herë konsull.
88 – 79	Sila mund Mitridatin – reforma e kushtetutës.
73 – 71	Revolta e skllevërve (Spartaku).
60	Triumvirati I: Pompeu, Krasusi dhe Cezari.
58 – 51	Lufta e galëve: Gergovi, Alesia (52); Galia e pushtuar.
44 – 27	Vrasja e Cezarit (44) – Triumvirati i dytë: Oktaviani (Perëndim), Antoni (Lindje), Lepidusi (Afrikë). Shpartallimi i Antonit dhe Kleopatrës (Aktium viti 31 para Krishtit). Pushtimi i Egjiptit.
27 - 476	**Periudha Perandorake** – Oktaviani bëhet Perandori i parë me emrin August, Odoakri (mbret gjerman i herulëve) me fundin e Perandorisë romake në vitin 476 pas Krishtit.

I.
SHQIPËRIA

HISTORIA MIJËVJEÇARE
(ETNI, VENDET PELLAZGE)

Çfarë është Shqipëria? Kush janë shqiptarët? Cilat janë zanafilla, historia, gjuha, kultura e tyre? Ne nuk gjejmë përgjigje koherente të bashkuara në një përmbledhje për të tilla pyetje, aq më pak në një tekst të vetëm. Në të vërtetë, këto përgjigje, në atë masë ku ato janë të sigurta, janë të shpërndara dhe të izoluara nga njëra-tjetra. Të rrallë janë ata që kanë marrë në konsideratë tërësinë e rezultateve të të gjitha studimeve që lidhen me problematikën që paraqesin Pellazgët. Mirëpo, krejt ndryshe me shtete të tjera të Europës, Shqipëria dhe shqiptarët janë të pandashëm dhe të pashkëputshëm: me etninë e tyre, gjuhën, kulturën, zakonet dhe doket e tyre, ata jetojnë në të njëjtin vend stërgjyshor qysh nga kohët parahistorike. Nuk ndodh e njëjta me grekët, romakët dhe etni të tjera shumë më të vonshme si sllavët, bullgarët (me gjuhën e tyre) ose finlandezët, estonezët, hungarezët dhe gjuhët e tyre finougore. Mundet, në mënyrë skematike dhe duke u bazuar në zbulimet paleontologjike, antropologjike dhe arkeologjike, të ravijëzosh gjurmët e zhvillimit të këtij populli qysh nga mugëtira e kohërave. Fakti që bie më shumë në sy është vijimësia etno-kulturore e zbuluar midis periudhave të ndryshme: paleolitiku, neolitiku, kalkolitiku, Epoka e

Bronzit, Epoka e Hekurit. Kjo nuk e pengoi, përbri një zhvillimi lokal dhe pikërisht pellazg, shfaqjen e prurjeve materiale të reja të mbledhura gjatë shtegtimeve të ndryshme të tyre ose afërsia më popujt e tjerë. Të mos harrojmë që njerëzit e kësaj epoke (nga Parahistoria deri në Perandorinë Romake) nuk e kishin nocionin e kufijve ashtu siç ai ekziston tani (në shekullin V para Krishtit, në epokën e artë të Greqisë ishte grek cilido që fliste greqisht). Aty mbizotëronin individi, klani, prijësi, shoqëria dhe toka, në të cilën ata jetonin me kulturën, gjuhën, zakonet dhe doket e tyre. Homo Sapiensi, i cili shkeli tokën e këtij rajoni ballkano-danubian, a ishte ky Homo-Pellazgu? Ua lëmë paleontologëve ta përcaktojnë dhe të thonë fjalën e fundit për këtë çështje.

Qysh nga fundi i shekullit XIX pjesa më e madhe e antropologëve kanë vërtetuar karakterin brakicefal madje hiperbrakicefal (kokë aq e gjerë sa e gjatë, d.m.th rrumbullake) të shqiptarëve, treguesi cefalik i të cilëve arrin 85-90, një nga më të lartët e Europës. Gjithashtu është pranuar njëzëri se ata kanë një planokcipitali (kaviteti i pjesës së poshtme dhe të pasme: kafka e pasme e shtypur).

Ja tri mendime të shkëlqyera në lidhje me etninë e **malësorëve me kokë rrumbullake**, të cilët do të kenë kolonizuar Lindjen e Mesme duke ardhur nga Ballkani, pra të një trungu me Pellazgët, një nga popujt më të vjetër të Europës. Aleksandër Moret (Historia e lashtë, Puf 1941): "Të parët mbërritën (njerëz të tipit alpin ose malësorë) besohet të kenë qenë elamitët dhe sumerianët, nga mijëvjeçarit V-VI ... Të tjerë brakicefalë nuk e kanë këtë hundë karakteristike, por thjesht paraqesin një kokë rrumbullake, hundë të drejtë dhe tipare tepër të theksuara; të tillë paraqiten disa sumerianë dhe banorët e Deltës së Egjiptit rreth viteve 3000. Malësorët janë shpikësit e mundshëm të metaleve (bakri dhe bronzi), në Lindjen e lashtë; nga ana tjetër ata futën përdorimin e kalit dhe të rrotës... Këto të dhëna përkojnë afërsisht me mbërritjen e malësorëve, të paktën të fiseve metalurgë të kësaj race në zonën lindore".

Zhak de Morgan (Njerëzimi parahistorik, Renaissance de livre, Paris 1921): "Ne kemi parë se nuk mund të thuhet asgjë për popullimin e ishujve të Lindjes mesdhetare, përpara kohëve kur territoret ishin të kolonizuara nga njerëz që zotëronin industrinë neolitike. Dokumentet më të lashta arkeologjike që ne zotërojmë në lidhje me këta kolonë na bëjnë të mendojmë se migracionet e tyre u bënë duke ardhur nga Europa kontinentale dhe në rrjedhën e mijëvjeçarit të katërt para erës sonë. Pastaj do të kenë luajtur rolin e tyre Pellazgët, duke sjellë me vete njohuritë për metalet. Duke pushtuar të gjithë Heladën Europiane, këto fise do të kenë përparuar deri në ishujt e territoreve aziatike.... Dy tipe janë të pranishme rreth mijëvjeçarit të dytë para Krishtit: njëri dolikocefal ... tjetri brakicefal, më i vonshëm që do të ketë qenë autori i kulturës mikeniane dhe do të ketë qenë nga një trung me fiset, të cilët në ato kohë banonin në Thrakë dhe në brigjet e Danubit. Këta kolonë, e thënë më saktë, nuk do të kenë qenë helenët, por thrako-frigjianët".

A. Severins (Greqia dhe Lindja e Afërme para Homerit, Bruksel 1960): "Përpara arritjes së hitites, popullsia e rrafshinës kapadokiane fliste gjuhën "hati". Ka të ngjarë se ishte ky emri që morën pushtuesit indo-europianë të ardhur nga Ballkani. Në Anatoli, këta të fundit janë mbivendosur ndaj popullit vendas pa e shkatërruar atë. Kjo ishte një gjuhë e vdekur, të cilën hititët nuk e kuptonin aspak dhe që mbijetoi në disa formula fetare".

Ja pra, me hollësi, tri etapat e etnogjenezës historike të këtij populli (Pellazg, Ilir dhe Shqiptar).

1) Pellazgët

Shqiptarët rrjedhin drejtpërdrejt nga ilirët dhe vetë këta, ilirët, janë trashëgimtarë të pellazgëve, të cilët Herodoti (VIII, 44) në shekullin V para Krishtit, i cilëson si autoktonë dhe pohon se kishin ardhur përpara grekëve në gadishullin Ballkanik dhe në Egje (I, 171, 173 - V, 26 - VII,

95). Ai me autorët e tjerë antikë pohon gjithashtu se Pellazgët janë zanafilla e themelimit të Athinës, për të cilën ndërtuan "pelargikon" (Herodoti V, 64), i pari mur rrethues fortifikues i Akropolit; se ata janë në zanafillën e etnisë joniane (Herodoti, I, 56, 57 VII, 94, 95): Pellazgët u bënë jonianë duke përshtatur gjuhën greke ("I onë" që do të thotë i jonë); se mbretërit dorianë ishin me zanafillë egjiptiane (Herodoti VI, 53 - Bibla/ I Makabe XII, 5 deri 23) dhe së fundi se Pellazgët u kanë dhënë grekëve perëndi të shumta (Herodoti II, 50, 51, 52, 146). Jonianët a nuk cilësohen si autoktonë (të lindur nga Toka)? Përveç kësaj, kjo a nuk shpjegon, pjesërisht, kundërshtinë e përjetshme midis jonianëve (pellazgë autoktonë, por të helenizuar) dhe dorianeve drejtues (pushtues semito-egjiptianë të Peloponezit, pra grekë të vërtetë)? Homeri në Iliadë (XVI, 234) a nuk thotë se Zeusi është "pellazg dhe dodonas" (Dodona, në Tesproti, ishte i pari vend i shenjtë parahelen kushtuar Zeusit)?

Emri Pellazg i është dhënë njëzëri këtyre popullsive parahelene nga autorët antikë. Megjithatë Herodoti (V, 26 - VII,94, 95- I,146- VIII,44) dhe Tuqididi (IV, 109 - I, 3) në epokën e tyre pohojnë (V para Krishtit) se Pellazgët zinin gjithmonë territoret e Greqisë kontinentale dhe të Egjeut. Disa pellazgë quheshin gjithashtu Pellazgë-Aigialenë, Pellazgë-Kranaenë, Pellazgë-Tirrhenë, Pellazgë-Tirrsenë/Tursanët ose Pellazgët e Arkadisë, Kretës ose të ishujve të Egjeut etj.

Rasti i Arkadisë është interesant për tu shënuar. Në të vërtetë shkrimet e lashta pohojnë se Pelasgos, heroi eponim i pellazgëve ka lindur në Arkadi dhe se dialekti arkadian është idioma më e lashtë e Greqisë antike. Ata e trajtojnë Arkadinë si gjysmë-pellazge. Arkadianët deri në epokën e Hekurit ruajtën një kulturë mikeniane. Kjo është krahina e vetme e Greqisë që ia ka dalë mbanë t'i ruajë dhe t'i formulojë si tradita stërgjyshore edhe shumë kohë pas pushtimit të helenëve. Deri në epokën e Herodotit (II, 171/ VIII, 73) në shekullin V para Krishtit, arkadianët në skutat e tyre malore jetonin krejt ndryshe nga grekët

dhe trajtoheshin si populli më i lashtë i Greqisë. Viktor Berardi pohon se kultet arkadiane nuk ishin me zanafillë helene. Në të vërtetë izolimi i këtij rajoni dhe relievi i tij i thyer të kujton shumë mirë rajonet në veri të Greqisë, ndër të cilat iliria është një shembull kuptimplotë. Ja përse Arkadia mbeti në pjesën më të madhe strehë ndaj pushtimit dorian dhe ruajti për një kohë të gjatë gjuhën, zakonet, mitet dhe kultet e saj. Dialekti arkadian nuk shfaqet në letërsi. Ai njihet vetëm nga mbishkrimet e ruajtura thjesht si një tjetër dialekt, ai qipriot. Në të vërtetë Qipro ka mbetur e izoluar dhe e mbrojtur ndaj ndikimit të pushtuesve helenë, të cilët e pushtuan shumë vonë. Përkundrazi, shumë kohë përpara mbërritjes së grekëve, ajo ishte e banuar nga mikenasit dhe filistinët (një popull i njëjtë), të cilit i përcollën gjuhën dhe kulturën e tyre. Ja përse dialektin arkadian e ngatërrojnë për atë qipriot dhe prej të cilit gjuhëtarët shpikën arkado-qiprioten, të cilin pa u turbulluar e emërtuan me "greqishte e lashtë" ose "mikenishte" (kjo nuk është gjë tjetër veçse "pellazgjishtja e lashtë", për ta dalluar nga dialektet e tjera greke (doriane, joniane, eoliane), të mbetura pak a shumë larg greqishtes së lashtë). Së fundi, shënojmë se heroi legjendar Evandri, i lindur në Arkadi, u nis në krye të një kolonie Arkadianësh për tu vendosur në Itali (Latium/Mali Palatin), rreth gjashtëdhjetë vjet para luftës së Trojës. Ai do tu ketë mësuar vendasve shkrimin, ligjet e reja dhe kultin e perëndive hyjnore.

Pellazgët e lashtë bënin pjesë në një familje të madhe etnike që lulëzonte anë e mbanë hapësirës mesdhetare : Lelegët, Ligurët, Karianët, Lisianët, Lidianët, Frigjianët, Filistinët, Jebusianët, Teukrët (Trojanët), Dardanët, Etruskët, Mesapët, Japigët, Japodët, Thrakët dhe së fundi Ilirët, duke përmendur këtu më të shquarit. Ende edhe sot shumë autorë (historianë dhe gjuhëtarë) ngulmojnë t'i copëzojnë këto etnonimi dhe t'i trajtojnë ato si etni të ndryshme. Në të vërtetë ata kanë rënë në grackën e një sllogani të lëshuar pak kohë më parë nga autorët e shekullit XIX, domethënë që emri "Pellazg" është një emër gjenerik, i cili

emërton popullsitë e shpërhapura në Greqinë parahelene dhe duke i shtuar për këto popullsi fjalën "të zhdukura".

Njëkohësisht, me asimilimin njëri pas tjetrit të disa fiseve të tyre të integruara krejtësisht ndër pushtuesit e rinj (grekë në Lindje dhe romakë në Perëndim), Pellazgët u tërhoqën (përgjatë gati dy mijë vjetëve) në skutat pak të arritshme apo aspak të arritshme dhe larg çdo qytetërimi (në Arkadi, malësitë shkëmbore të ishujve të Egjeut, Alpet shqiptare, Pindi etj.). Megjithatë në fund fare grupimet më të mëdha të tyre ishin trakët në lindje dhe ilirët në veriperëndim të Ballkanit: të parët u zhdukën qoftë nga asimilimi (nga grekët, bullgarët, serbët ose turqit) qoftë duke u integruar në hapësirën ilire dhe duke u bashkuar kështu me vëllezërit e së njëjtës racës ndër malësitë e ashpra të tyre. Ilirët, përkundrazi, janë të mbijetuarit e fundit të pellazgëve të tërhequr në skutat e malësive të tyre (Alpet e sotme shqiptare, Mali i Zi,Kosova, Maqedonia perëndimore, Epiri...) Gjithsesi, vetë emri i tyre e nxjerr në pah lashtësinë e tyre: fjala pellazgë në gjuhën shqipe shpjegohet me : njerëz të shpellave ose të guvave, apo shpellagji. Ky emër (rrënja shqip shpella = shpellë, guvë), përveç kësaj, i ka dhënë grekëve fjalën e tyre "spelaion" (guvë) prej nga vjen fjala jonë*) "speleologji". Mirëpo Zeusi ("pellazgu", sipas Homerit) a nuk kishte lindur në një shpellë në Kretë? A nuk u rrit ai nga kuretët ("ku rret, ku rretët, ku rrit, ku rritët", që në shqip do të thotë: "aty ku ai u rrit" duke nënkuptuar Zeusin), emër i cili ka dalë nga Kreta? Homeri në Iliada i quan Pellazgët hyjnorë, i citon në kampe të kundërta (akenët, danaenët, argjianët nga njëra anë dhe trojanët nga ana tjetër). Megjithatë ai ka bashkuar rreth trojanëve, aleatët që i përkasin në kuptimin e ngushtë të fjalës së njëjtës familje etnike. Në të vërtetë, nga ana e Azisë së Vogël ne gjejmë (sipas renditjes): trojanët, Pellazgët, dardanët, kaukonët, paflagonët, alizonët, mizianët, frigjianët, meonianët, karianët, lelegët, lisianët; nga ana e Ballkanit: thrakët, peonianët , ilirët dhe sikonët.

---

*) *Autori e ka fjalën për gjuhën frënge.*

Për sa u takon Grekëve, dhe për ta ravijëzuar nga vijnë ata, mund të themi se nga njëra anë "Jonianët" ishin pellazgë të helenizuar, gjë që është vërtetuar nga autorët antikë, ndër të cilët Herodoti (I, 57/ VIII, 44/ VII, 94, 95) dhe se nga ana tjetër, "Dorianët" (pakicat udhëheqëse, të cilat kanë qeverisur një popullsi pellazgo-ilire me zanafillë nga veriu i Greqisë – këta pra nuk janë Grekët që vijnë nga i famshmi Veri, siç kanë pohuar shpesh), që ishin Grekë të mirëfilltë, me zanafillë semito-egjiptiane (danaenë dhe kadmenë), pushtuan vendin e pellazgëve nga të cilët huazuan një pjesë të madhe të gjuhës së tyre dhe të kulturës së tyre.

Gjithsesi, ja edhe zanafilla e dy prej pushtuesve më të dëgjuar të vendit të pellazgëve të përmendur nga autorë të shumtë antikë (përveç Tuqididit shumë shovinist) ndër të cilët Hekate i Miletit, Eskili, Sofokliu, Hellanikosi i Mitilenit dhe Herodotit. Danaosi, biri i Belos (mbret i Egjiptit dhe vëlla i Agenorit, mbret i Fenikisë) dhe vëlla binjak i Egjiptos, pushtoi Peloponezin (Pellazgjinë e lashtë që kishte kryeqytet Argosin, ku mbretëronte Pelasgosi, heroi eponim i Pellazgëve) dhe u vendos në Argos. Nga Danaosi rrjedhin drejtpërdrejt Abas, Akrisios, Danae, Perseu, Alkmeni dhe Heraklesi. Kadmosi, biri i Agenorit (mbreti i Fenikisë) pushtoi nga ana e tij Beotinë dhe themeloi Tebën. Ky, sipas Herodotit (II, 49/V, 57, 58, 59), futi alfabetin fenikas në Greqi. Nga Kadmusi rrjedhin drejtpërdrejt Feniksi, Ciliksi, Semeleu, Dionisi, Europa, Laios dhe Edipi.

Këta dy monarkë të huaj dhe Pelopsi asirian kanë nxjerrë mbretër të periudhës monarkike të Greqisë arkaike (Kekropsi, Eriktoniosi, Erekteu, Tezeu etj.). Aty ende legjenda dhe historia bashkohen dhe përmbushen në mënyrë të përkryer. Aty, gjithashtu, gjendet hallka që i kishte munguar historianëve dhe gjuhëtarëve të shumtë.

Përveç faktit se Pellazgët ishin banorët e parë të Ballkanit dhe të Egjeut përpara mbërritjes së grekëve, dallohet edhe sot, dy mijë vjet më vonë, se etnonime të shumta, antroponime, teonime, toponime

ose oronime të Greqisë parahelenike dhe arkaike nuk shpjegohen aspak me greqishten, por me gjuhën e sotme shqipe, gjuhë që trashëgohet drejtpërdrejt nga thrako-ilirët, pasardhës të këtyre "Pellazgëve hyjnorë", e përsëritur kjo shumë herë nga Homeri në Iliada. Përveç kësaj, sot paleontologjia, arkeologjia, antropologjia, epigrafia apo fonologjia a nuk i kanë vërtetetuar të gjithë këta elementë historikë, gjysmë legjendarë dhe, mbi të gjitha, kanë mbështetur lidhje të shumta etno-gjuhësore?

2) Ilirët

Në Antikitet, ilirët dhe thrakët të shumtë në numër, të shpërhapur në të gjithë hapësirën ballkano-danubiane (Panoni, Karinthi, Istria, Veneti, Dalmaci, Japodi, Dardani, Thrakë, Daki etj.) qysh nga shekulli VII para Krishtit quheshin njëherazi "popuj të pavarur" nga autorët antikë, ndër të cilët më të dëgjuarit janë Hekateu i Miletit, Hellanikos i Mitilenit, Herodoti dhe Tuqididi. Nga ana tjetër ilirët cilësoheshin, në gjuhën e tyre, popull i lirë, i pavarur: bëhet fjalë për një epitet të kthyer në një emër gjenerik për të emërtuar këto popullsi të lira dhe të pavarura. Kështu për të huajt, në veçanti grekët, ky "emërtim" u kthye në një etnonimi. Përkundrazi të gjitha popullsitë pellazge quhen midis tyre me emrin e fiseve përkatëse, prej nga rrjedhin etnonimi të tjera të shumta.

Gjithsesi disa autorë shqiptarë janë përpjekur për të pohuar se emri i tyre ka si zanafillë fjalën Yll. Unë mendoj se ky përfundim është i gabuar sepse nuk mbështetet në asnjë të dhënë historike dhe se nuk gjendet kuptimi i pranueshëm. Në të vërtetë, është diçka e rastësishme të bazohesh vetëm në epitetin e përfshirë në emrin e mbretit ilir të quajtur Bardhyli d.m.th. Ylli i bardhë. Pra, nuk mund ta zbatosh për emrin Yll (d.m.th. "populli yll") dhe që nga ana tjetër nuk nënkupton ndonjë diçka të madhe. Përveç kësaj, ky mbret ka mbretëruar në shekullin IV para Krishtit, ndërkohë që ilirët ishin njohur si një popull i pavarur d.m.th. i lirë, shumë shekuj më parë. Pra gjuhësia vjen në

ndihmë të historisë për të vërtetuar një emërtim historik.

Prej shekullit VII para Krishtit deri në pushtimin romak (viti 168 para Krishtit) ilirët kanë ndërtuar mbretëri të vërteta dhe principata të shumta të përqendruara fillimisht në pallate të fortifikuara ose kala, pikërisht siç kishin bërë stërgjyshërit e tyre, të quajtur pa të drejtë mikenianë. Gjatë kësaj periudhe lavdie banorët e këtyre territoreve të stërmëdha, megjithëse të gjithë kishin dalë nga i njëjti trung etnik, ishin të ndarë në një numër të madh fisesh dhe klanesh, të cilët mbanin emra të ndryshëm. Gjithashtu kundërshtitë e tyre shekullore dhe rivalitetet e tyre të përhershme ishin zanafilla e shkrirjes së principatave apo e mbretërive kundërshtare. Këto shpërbërje për ata ka qenë shpesh të rrezikshme, madje fatale.Mbi të gjitha, në Ilirinë e Jugut, ku është parë të lindë njëfarë grumbullimi dhe bashkimesh fisnore, nganjëherë janë ndërtuar të tilla mbretëri si ajo e Grabos (vitet 440-423 para Krishtit), ajo e Bardhylit I (vitet 393/358 para Krishtit) i cili luftoi me Filipin II të Maqedonisë, ajo e birit të tij Kleitos (viti 335 para Krishtit) i cili luftoi me Aleksandrin e Madh, ajo e Pirros II (vitet 307-277 para Krishtit, mbreti molos i Epirit) i cili luftoi ngadhnjyeshëm ushtritë romake në Itali, si dhe ajo e mbretëreshës Teuta (vitet 231-229 para Krishtit) e cila u futi tmerrin radhëve të ushtrisë romake, apo ajo e Gentit (vitet 181-168 para Krishtit), mbreti i fundit i kësaj periudhe pararomake. Në të gjitha kohët, forcat e tyre detare të Adriatikut ishin tmerri i grekëve dhe në veçanti i fqinjëve përballë: romakëve. Duke u druajtur për një paqëndrueshmëri të sundimit të tyre, këto të fundit vendosën të ndërhyjnë për t'i dhënë fund këtyre piraterive, sulmeve ose provokacioneve të kryera nga këta popuj ilirë (liburnët, dalmatët, japodët ...). Tri lufta iu deshën romakëve për t'i mposhtur ilirët: vitet 229, 219 dhe 168 para Krishtit.

Kështu pas pesë shekujsh pushimi relativ, të gjitha vendet ilire u plaçkitën nga hordhitë romake (të armatosura të Pol Emilit). Ilirët u tërhoqën në malet e tyre të pamposhtura të Ilirisë së Jugut, ndërsa

mbisundimi i Romës mbeti në një brez të ngushtë bregdetar, madje i kufizuar në disa qytete në ultësirë. Ja përse ilirët u rigrupuan për tu strehuar në foletë e tyre të shqiponjave : malet e Alpeve dinarike dhe mbi të gjitha të Alpeve shqiptare (Mali i Zi, Shqipëria, Maqedonia perëndimore, Kosova) dhe malësitë e Epirit. Qysh prej asaj kohe, ata për shekuj me radhë zhvilluan luftëra guerile si dhe luftime të ashpra kundër pushtuesve të njëpasnjëshëm.

Pas pushtimit romak (viti 168 para Krishtit deri në vitin 395) territori i tyre shumë i madh (prej brigjeve të Danubit deri në Greqi dhe nga Adriatiku deri në Detin e Zi) u zvogëlua vajtueshëm. Siç shihet, pjesa më e madhe e popullsive ilire të Ilirisë së Veriut u asimiluan nga pushtues të ndryshëm të njëpasnjëshëm (sllavë, bullgarë, hungarezë ...) dhe pjesa më e madhe e atyre që shpëtuan u strehua në Ilirinë e Jugut. Ndër këto vende thrako-ilire të zëna nga sllavët, bullgarët ose hungarezët, kryesisht vetëm Dakia (Rumania e sotme) e populluar nga dako-getët (popullsi thrako-ilire) u romanizua në masë të madhe. Ja përse gjuha rumune është një përzierje e gjuhës thrako-ilire (disa thonë e trakishtes, gjë që në kuptimin e ngushtë është e njëjta) dhe e latinishtes. Në të vërtetë, ajo përmban më shumë se njëqind fjalë që shpjegohen me lehtësi nëpërmjet gjuhës së sotme shqipe (duke iu referuar studimit në lidhje me të).

Rreth shekullit II pas Krishtit, emri "Albanes" (nga emri i një fisi në qendër të Shqipërisë, i cituar nga Klaud Ptolemeu, Straboni..., Albanoi) u shfaq në skenën gjeopolitike të këtij territori kaq të lakmuar nga fuqitë e mëdha që kishin patur sukses dhe pak a shumë ishin vendosur aty: Romakët (më shumë se pesë shekuj), Bizantinët (pothuajse nëntë shekuj) dhe Otomanët (afërsisht pesë shekuj).

Qysh nga mbërritja e romakëve, Iliria (Iliria e Jugut) e thënë më saktë (Illyrii, proprie dicte, sipas Plinit të Lashtë dhe Pomponius Mela) hyri në një letargji të thellë dhe legjendare që zgjati rreth pesë shekuj. Pas mbizotërimit romak (168 deri 396, afërsisht 563 vjet) vendi ra (si

rrjedhojë e rënies së Perandorisë Romake dhe e copëzimit që vijoi më pas) nën goditjen e pushtetit administrativ të Perandorisë Bizantine (395 -1347, afërsisht 952 vjet). Pastaj pas rënies së Perandorisë Bizantine ishte radha e Otomanëve (1479-1908, afërsisht 429 vjet). Si rrjedhojë, shuma e përbashkët e pushtimit të huaj është 1944 vjet!

Gjatë pushtimeve romake, bizantine e turke këta iliro-shqiptarë u rizgjuan për të zbritur nga bastionet e tyre malore vetëm me qëllimin për të luftuar kundër mësymjeve sporadike dhe të ndryshme. Gjithsesi, duhet shënuar se tokat shqiptare shpesh ishin pushtuar, plaçkitur dhe copëzuar, por populli asnjëherë nuk ishte nënshtruar dhe nga kjo rrjedh edhe përjetësia e etnisë së tij, gjuhës dhe kulturës së tij, të cilat i kanë ndjerë shumë pak ndikimet e huaja: fakt ky, i vetëm në Europë. Përse, pra, ka ndodhur kjo përgjumje befasuese dhe e gjatë e një populli të lidhur kaq vendosmërisht me pavarësinë dhe kulturën e tij? Për mendimin, tim iliro-shqiptarët ishin mësuar tashmë me këtë topitje dhe e kishin vendosur për të bërë një jetë cubash në strehët e tyre të paarritshme, d.m.th të shkëputur nga shoqëria; duke jetuar në një autarki dhe duke patur gjuhën e tyre, kulturën mijëvjeçare, ligjësi zakonore drastike dhe një organizim klanor të palëkundur. Por kjo nuk i ndaloi aspak për të jetuar në fushat përreth, mbi të gjitha ndërkohë që ato ishin të qeverisura nga bashkatdhetarët e tyre të lidhur me administratën perandorake dhe ka të ngjarë se zotëronin pushtete të rëndësishme ose fare thjesht duke përfituar nga dashamirësia e pushtetit vendor perandorak. Në të vërtetë, të mbrojtur në malet e tyre të pamposhtura dhe nga bashkatdhetarët e pushtetit vendor, ata ka të ngjarë që të mos e kenë nevojën për të hequr dorë nga pavarësia e tyre. Kështu, të tërhequr në skutat e tyre malore ata jetonin në një farë autonomie, madje në mbretëri të vogla të pavarura. Gjithashtu, duhet shënuar se iliro-shqiptarë të shumtë u shkombëtarizuan, të cilët falë aftësive të tyre, forcës së karakterit ose talenteve të tyre, zunë vende të shquara në të dy Perandoritë që ndoqën njëra-tjetrën (Perandorë të

shumtë romakë dhe bizantinë, dy papë dhe një pafundësi gjeneralësh, guvernatorësh, piktorësh, skulptorësh, arkitektësh dhe fisnikë jo më pak të shquar.

Krejt ndryshe nga ajo që thuhet në lidhje me këtë, kjo letargji duket se ka qenë për pjesën më të madhe një siguri për ruajtjen pothuajse të pacënuar të kulturës, gjuhës dhe të zakoneve e dokeve të iliro-shqiptarëve. Në mënyrë paradoksale krenaria e tyre dhe shpirti i tyre kundërshtues dhe i pavarur, janë shfaqur vetëm për t'i bërë ballë kërkesës më urgjente: për të dërrmuar armikun dhe për të mos e lejuar që ta nënshtrojë. Në këtë epokë, vullneti për të krijuar një shtet kaloi në plan të dytë, sepse popullit i duhej të luftonte, së pari për të mbrojtur trojet e të parëve të tij si dhe për të mbrojtur vlerat e tyre tradicionale.

Nga fundi i Perandorisë romake dhe në fillim të erës bizantine, Ballkani vuajti në mënyrë sporadike nga sulmet e hordhive barbare të ardhura nga Lindja: hunët, avarët, alenët, sllavët, bullgarët dhe hungarezët, duke përmendur këtu vetëm më të rëndësishmit. Pushtuesit e parë që qëndruan gjatë janë fiset sllave që u shpërndanë nëpër Ballkan rreth vitit 580, ndërkohë që ushtritë bizantine ishin duke luftuar me avarët. Sipas Menandrit, numri i tyre arrinte 100 000 burra. Një tjetër shkrimtar, Jani i Efesit, bashkëkohës i Menandrit pohonte: "Ata rrënuan, dogjën, plaçkitën dhe pushtuan vendin [Illyricum] dhe u vendosën aty pa u druajtur, si të ishin në tokat e tyre". Sllavët, me kalimin e kohës do të gllabërojnë pak nga pak pjesën më të madhe të territorit të stërmadh thrako-ilir (nga Danubi deri në Epir dhe nga Adriatiku deri në Detin e Zi). Shumë ilirë, për t`i shpëtuar shtypjes sllave, u strehuan në malet e të parëve e të tyre. Pjesa tjetër u asimilua dhe u sllavizua plotësisht. Është kjo arsyeja përse te sllavët rigjenden kostume të shumta, zakone (rapsodi, midis tyre elemente kulturorë) si dhe disa mbetje gjuhësore ilire. Disa autorë sllavofilë mendojnë të kundërtën! Sa keq, sepse historia ja ku është për të kundërthënë se si sllavët, të ardhur në Azi, ishin një popull pushtues që kishin dëbuar

thrako-ilirët, populli autokton. Gjithsesi qytetërimi iliro-shqiptar, pavarësisht pushtimeve romake dhe bizantine, ndoqi dalëngadalë zhvillimin e tij, veç qytetërimit të ndodhur përbri të pushtuesve romakë dhe bizantinë. Kjo periudhë quhet Kultura e Komanit (rrënojat ekzistojnë ende në malësitë e veriut dhe në qendër të vendit). Nga udhëtimi i tij në veri të Shqipërisë, Degrandi solli në Francë objekte të shumtë që datonin nga kjo periudhë (Muzeu i Shën Zhermenit në Lajë).

Tashmë unë do të ravijëzoj vijimin e kësaj historie deri në Luftën e Dytë Botërore. Këtu nuk bëhet fjalë për të rithënë në detaje historinë e Shqipërisë së sotme, por për të vënë në dukje faza të ndryshme të zhvillimit politiko-shoqëror të popullit shqiptar. Tabela kronologjike e këtij kapitulli është përcaktuar deri në fund të shekullit XX me rënien e komunizmit.



Otomanët pas fitores së tyre mbi Selxhukët në vitin 1326.



Krahinat e Europës ende të pushtuara nga turqit në vitin 1878.

3) Shqiptarët: historia e Mesjetës deri në shekullin XX

Qysh në fillim do të hap një parantezë në lidhje emrin Shqipëri ose Shqiptar të përmendur nga Straboni (rreth viteve 58 para Krishtit deri 21/25 pas Krishtit) në shekullin I para Krishtit dhe Klaud Ptolemeu (rreth viteve 100-170 pas Krishtit). Ky rrjedh nga emri i një fisi ilir, Albanoi, që gjendej rreth qytetit Albanopolis (Zgërdheshi i sotëm në krahinën e Krujës). Nga ana tjetër, ende edhe sot një krahinë në veri të Tiranës (midis lumenjve Mat dhe Erzen) quhet Albëni (dialekti gegë) ose Arbëri (dialekti toskë). Por ky emër Albanoi me variantet e tij të ndryshme (Arbanites, Arvanites, Arvanitis, Arvanos, Arban, Arbani, Arbanon, Arnavut, Arnaut, Arbëri, Arbër, Arbëni, Arbën, Albën, Albanenses, Albani, Albanois ose Albanais) në të vërtetë filloi të përhapej atëherë kur territoret shqiptare u bënë fusha armiqësish dhe një zonë "bllokuese" midis Bizantit dhe pushtuesve të rinj sllavë, rreth fillimeve të shekullit VII të erës sonë. Shkrimtarë të shumtë të shekullit XI, ndër të cilët Mikel Ataliati dhe Zhan Skilces, e kanë dhënë gjerësisht këtë lloj përballjeje dhe kanë folur për këto fise malësore shqiptare. Këto janë kancelaritë anzhuane frenge (Karli I d' Anzhu, vëllai i Shën Luigjit, u shpall mbret i Shqipërisë në vitin 1272), të cilat në shekullin XII përçuan emrin Albanois ose Albanais, i cili u përhap me shpejtësi, si një re pluhuri nëpër Europë.

Pas zotërimit të Perandorisë Romake në fund të shekullit IV (në vitin 395 Shqipëria ra nën Perandorinë e Lindjes) vendet shqiptare ishin e para vënie peng midis Perandorisë Romake të Lindjes dhe më pas e Perandorisë Bizantine, nga e cila varej Shqipëria, dhe e pushtuesve të rinj të Azisë Qendrore, ndër të cilët Hunët e Atilës (434-453) dhe më në fund fiset sllave (rreth vitit 580), të cilët kërkonin të zmadhonin zotërimin e tyre në Ballkan. Në të vërtetë, përgjatë tetë shekujve, kanë qenë të shumta mësymjet serbe dhe bullgare, gjithsesi pa arritur të vijojnë në mënyrë të qëndrueshme.

Veç kuadrit të administrimit bizantin, disa qyteteve shqiptare, ndër të cilat Arqipeshkëvia e Durrësit (e quajtur "comes" në Ulqin, "prior" në Krujë dhe "primas ose proteion" diku tjetër) do tu jepej një pushtet administrativ vendor dhe do të formonin, si të thuash, "communae civitates" në krye të të cilave gjendeshin prijës të zgjedhur nga "consiliari" të dalë nga Kuvendet e qytetarëve. Gjatë gjithë epokës së Mesjetës këta prijës u përpoqën që ky pushtet vendor të respektohet njëherësh si nga sovranët e huaj edhe nga princat lokalë: siguria e një tradite të gjatë pavarësie dhe e zakoneve demokratike.

Përveç mësymjeve serbe dhe bullgare, venetët dhe normanët kishin vendosur të nguleshin në këtë vend. Të parët (Venecia ishte një zotërim bizantin prej vitit 579 deri në vitin 912) si fuqi ekonomike e mbi të gjitha detare, dhe të dytët për të shuar etjen e tyre prej pushtuesi (disfata të shumta: 1081, 1083, 1107 me Robert Gyiskard dhe Bohemondin më pas në vitin 1149 me mbretin norman Roxheri II i Sicilisë). Për arsye të vendndodhjes strategjike, Shqipëria shpesh u prek nga fuqitë perëndimore dhe në veçanti nga Kryqtarët, të cilët në udhën e tyre për në Jerusalem nuk hezitonin ta shkelnin vendin prej perëndimit në lindje dhe ta plaçkitnin (1096, Kryqëzata I - dhe 1270, Kryqëzata VIII dhe e fundit).

Nën pushtimin bizantin, iliro-shqiptarët filluan të bashkoheshin dhe të ndërgjegjësoheshin për rolin që ata mund të luanin në krijimin e një entiteti politik. Duke përfituar nga rënia e Bizantit, filloi të lindë një shoqëri feudale. Në të vërtetë, nga fundi i shekullit XII feudalët shqiptarët u ndanë dhe krijuan principata të pavarura. Kështu u krijua shteti i parë feudal, i cili kishte si qendër kryesore qytetin e Krujës, megjithëse themelimi i këtij qyteti ngjitet deri në shekullin VIII. Midis viteve 1190–1216 trojet shqiptare u qeverisën nga principata të pavarura. Progoni sundoi midis viteve 1190–1199, si dhe Arhonti i Durrësit, duke patur si kryeqytet Krujën. Ky qytet vazhdoi një traditë të lashtë të metropolit të vogël, ndërsa më pas, në shekullin XIV dhe në shekullin XV, do të luajë një rol thelbësor në historinë heroike të vendit. Ai do

të bashkojë rreth vetes pjesën më të madhe të fisnikëve më të mëdhenj të krahinave të ndryshme shqiptare. Kështu tregtia u shtri në të gjithë vendin dhe lidhjet diplomatike u vendosën me pjesën më të madhe të vendeve perëndimore, ndër të cilat Franca dhe Vatikani. Ja një shembull ndër të tjerët: nën sundimin e Luigjit XIV dhe shumë më pas, Franca siguronte nga Shqipëria pjesën më të madhe të drurit të nevojshëm për ndërtimin e anijeve.

Prej vitit 1257 deri në vitin 1258 popullsitë shqiptare u ngritën kundër bizantinëve. Populli shqiptar nuk rreshti së luftuar, jo për pavarësinë e tij në kuptimin e sotëm të fjalës (siç mund të mendohet, sepse ky nocion ka lulëzuar vetëm shumë më pas duke filluar nga Skënderbeu), por mbi të gjitha për lirinë e tij: të jetojë i lirë me kulturën, gjuhën dhe traditat e tij.

Në shekullin XIV filloi të shfaqej një pushtet i ri feudal: Topiajt në qendër (Krujë, Durrës dhe krahinat të përfshira midis lumenjve Mat dhe Shkumbin), Balshajt në veri dhe në Shkodër, Muzakajt dhe Shpatajt në jug. Pastaj shumë më vonë Kastriotët, Dukagjinët, Aranitët dhe të tjerë jo më pak të shquar, u dalluan në luftërat e tyre kundër turqve. Fatkeqësisht vringëllimat e armëve u dëgjuan jo shumë larg prej aty: otomanët tashmë ishin në kufijtë e Shqipërisë.

Në të vërtetë, pas rënies së Perandorisë Bizantine hordhitë shkatërruese të ushtrisë otomane u hodhën furishëm në Ballkan qysh prej fundit i shekullit XIV. Aty, sërish dhe më shumë se kurrë, shqiptarët iu kthyen strehëve të tyre në male për të organizuar dhe për të vazhduar luftërat e tyre të mundimshme për lirinë dhe pavarësinë e tokës së të parëve.

Turqit selxhukidë u zëvendësuan në vitin 1290 nga Osmanllinjtë, krijuesi i të cilëve ishte Osman I (Othman), që do të thotë fitimtari (1258–1324). Më 29/05/1453 sulltan Mehmeti II mori Kostandinopojën dhe i dha fund Perandorisë Bizantine.

Por pushtimi i Ballkanit filloi në vitin 1354. Një luftë e ashpër filloi

kundër thrakëve në lindje të Ballkanit (Galipoli), serbëve, boshnjakëve, bullgarëve dhe më pas hungarezëve. Një lidhje ballkanike anti-turke u mund më 28/06/1389 në Kosovë (Fusha e Mëllenjave). Sulltan Murati I gjeti vdekjen aty, i vrarë nga një shqiptar.

Rreth vitit 1385, ushtritë otomane filluan të rrënojnë territore albanofone të banuara nga katolikë në zonat e veriut dhe ortodoksë në ato të jugut. Ato do të pushtojnë qytetin e Shkodrës dhe të Ulqinit në veri. Pas një vijimësie sulmesh dhe pushtimesh, turqit përfunduan duke sulmuar qendrën e Shqipërisë dhe pushtuan Krujën në vitin 1415. Në vitin 1423 ata morën peng katër bijtë e Gjon Kastriotit (princi i Krujës dhe i Matit) një nga prijësit kryesorë ushtarakë të krahinës. Përpara nisjes së bijve si peng pranë Sulltanit në Stamboll, ai mori djalin më të vogël, Gjergjin, dhe e tërhoqi mënjanë për t'i treguar malet, luginat, lumenjtë dhe tokën e të parëve, duke i thënë : "Vështro biri im këtë tokë dhe Atdheun tënd dhe mos e harro kurrë". I rrethuar sërish nga Turqit në vitin 1430, atij iu desh të dorëzohej përpara numrit të madh të tyre dhe forcave të zjarrit.

Gjatë viteve të ekzilit, Gjergj Kastrioti (lindur në vitin 1405), u bë një kalorës i përkryer e trim, gjithsesi ishte i ushqyer me dashurinë për tokën mëmë dhe ruajti nostalgjinë për mëmëdheun e tij, duke shoshitur vuajtjet e të parëve të tij të shkaktuara nga pushtuesit e ndryshëm. Disa vite më vonë, falë zgjuarsisë së tij, karizmit, guximit, shpirtit të tij luftarak dhe bëmave të tij, Gjergji fitoi besimin e Sulltanit i cili e quajti SKANDER BEG (zoti ose senjor Aleksandër) d.m.th. "zotëri i denjë për bëmat e Aleksandrit të Madh". Në vitin 1443, Skënderbeu i shoqëruar nga treqind luftëtarë shqiptarë, braktisi ushtrinë otomane (të angazhuar kundër trupave hungareze të Huniadit) dhe hyri në atdheun e tij. Më 28 nëntor të po atij viti ai shpartalloi turqit dhe ngriti flamurin e kuq me shqiponjën dykrerëshe në majë të kalasë së Krujës, prej nga shpalli rivendosjen e principatës së lirë të Shqipërisë. Në vitin 1444 u krijua në Lezhë Lidhja Kombëtare, e cila ribashkonte princat e

të gjitha krahinave shqiptare. Në vitin 1451 Skënderbeu u martua me Donika Aranitin. Në pushimet e luftimeve kundër turqve, ai pati mundësinë të shkonte në ndihmë të trupave të mbretit të Napolit. Qëndresa dhe lufta e popullit shqiptar kundër turqve nën drejtimin e Skënderbeut qe fort e lavdishme. Kështu, gjatë njëzetepesë viteve, batalioneve turke, pavarësisht numrit të tyre të madh (nganjëherë deri në njëqindmijë burra) dhe fuqisë së tyre ushtarake, iu desh të tërhiqeshin e të thyheshin përpara rezistencës, këmbënguljes, guximit, dhe zotësisë strategjisë së pazakontë të ushtrisë së vogël në numër të Gjergj Kastriotit, trupat e së cilës nuk i kalonin të dhjetë mijë burrat. Kalaja e Krujës u muar vetëm pas vdekjes së Heroit (17/1/1468). Ardhja e Skënderbeut në krye të shtetit të ri shqiptar pati një jehonë të madhe dhe u vlerësua shumë nga Vatikani dhe fuqitë e mëdha europiane të kohës. Me bëmat e Skënderbeut, pas atyre të Akilit, Aleksandrit të Madh dhe të Pirros (bashkatdhetarët e tij pellazgë) u shkrua njëra nga epopetë më të bukura të historisë së hapësirës shqiptare. Fama e këtij princi trim arriti edhe në Francë, ku, për nder të tij janë shkruar një gjysmë duzine dramash. Zhak de Lavardë shkroi një biografi të shkëlqyer, (Historia e Gjergj Kastriotit, i quajtur Skënderbeu, mbret i Shqipërisë, 1576), e cila e frymëzoi Ronsardin në atë pikë sa kompozoi sonatën e mëposhtme (në frëngjishten e vjetër):

Sonet për Zhak de Lavardë, zot i Plesis-Burro

Epiri nuk ka vetëm kuaj të mirë,
Për të rrëmbyer çmimet e garave olimpike,
Por ka luftëtarë të një gjaku të lashtë,
Qe mburren se është ai i Akilit trim.

Ka Pirron, dëshmitar i plaçkitjeve të shumë qyteteve,
Dhe që në fund si varr pati murin e lashtë Argian,

Dhe Skënderbeun, plot urrejtje për popullin skith,
Që zhduku nga e gjithë Azia Ungjillin.

- O Epirot i madh! O Shqiptar trim!
Dora jote njëzetedy herë Turqit shpartalloi
Ti, tmerri i fushëbetejës së tyre, ti, tmerri i bedenave të tyre.

Ti do të kishe vdekur i përpirë nga Fati,
Nëse vepra e mençur e Lavardinit,
Nuk do të kishte rithënë betejat e tua, duke të dhënë kështu pavdekësinë.

Historia u përsërit edhe një herë. Me gjithë rezistencën e vendosur të këtij populli krenar dhe guximtar, turqit ia dolën mbanë të krijojnë pika kyçe dhe të vendosin guvernatorët e tyre, në krahinat më të arritshme të vendit. Gjithsesi, ata kurrë nuk arritën t'i pushtonin krahinat malore apo ato më pak të arritshme të Shqipërisë, vend i njohur si një nga më malorët në Europë.

Unë do të hap një parantezë në lidhje me ndikimin e diasporës shqiptare. Në të vërtetë duhet shënuar se Perandoria Otomane u la një autonomi të gjerë prijësve tradicionalë të fiseve dhe në veçanti fiseve gege në veri të Shqipërisë. Ata përfituan një lloj trajtimi favorizues, të njohur nën emrin e Tridhjetë qeverive (Hykumeti), të zbatuar në shumë vende, ndër të cilat Kurdistan, Armeni, Turkmenistan (krahina e Sivas dhe Adanas) dhe Shqipëri. Për një kohë të gjatë shqiptarët formuan një nga shtyllat kryesore të shtetit otoman (një numër të madh vezirësh të mëdhenj, vezirë, arkitektë, fisnikë, guvernatorë etj.) dhe arritën një trajtim të veçantë nga ana e sulltanëve të njëpasnjëshëm, të cilët i mbushën me privilegje për t'i afruar. Shumë më vonë ata gjithashtu luajtën një rol të madh në lëvizjen e "Xhon-Turqve" (rinia turkë) dhe në revolucionin turk -Nijazi- (1922), me Mustafa Kemal, i mbiquajtur

Ataturku, nëna e të cilit ishte me zanafillë shqiptare.

Të kalitur ndër pesëmbëdhjetë shekuj lufte çetash dhe betejash kundër pushtuesve të njëpasnjëshëm, me një guxim proverbial, me një dëshirë të fortë për të qenë të lirë, me një dashuri të pashuar për atdheun e tyre, shqiptarët kanë ditur ta ndalin shtypjen dhe t'i përballin rreziqet e këtij pushtimi të ri, i cili, pavarësisht disa periudhave qetësie, vazhdoi për pesë shekuj.

Por pushtimi otoman ishte ndryshe nga dy pushtimet e tjera (romak dhe bizantin) dhe pati pasoja të pallogaritshme për të ardhmen e vendit. Në të vërtetë, islamizimi i shqiptarëve (më shumë se dy të tretat e popullsisë) izoloi edhe më shumë vendin nga pjesa tjetër e Europës. Për këtë arsye, Fuqitë e Mëdha europiane të shekullit XIX dhe të fillimit të shekullit XX, nga frika se po shihnin të vendosej aty një shtet kryesisht i besimit islamik dhe për të përmbushur kërkesat e vendeve në kufi (kryesisht ato ortodokse) u përpoqën ta copëzonin këtë territor etno-fetar, madje ta ndajnë midis fqinjëve që ishin në kufi me të (Greqia dhe Serbia, në veçanti). Por falë Perandorisë Austro-Hungareze dhe forcës së atdhedashurisë të shqiptarëve, vendi i rezistoi të gjitha përpjekjeve që u bënë për ta shuar këtë entitet shqiptar: bastion i fundit i pellazgëve antikë.

Lufta për mbijetesë dhe identitet vijon përgjatë mijëvjeçarëve. Malet e pamposhtura të Shqipërisë kanë qenë fortesa dhe streha e fundit e një linje të gjatë fisnore prej popullsish parahelene: Pellazgët dhe pasardhësit e tyre thrako-ilirët, ndër të cilët shqiptarët e sotëm, janë të mbijetuarit e fundit. Vendi i tyre i stërmadh (nga Danubi deri në Epir dhe nga Adriatiku deri në Detin e Zi) u zvogëlua vajtueshëm në përfitim të pushtuesve të ndryshëm, kryesisht sllavë dhe grekë. Shqipëria dhe krahinat e saj në kufi përbëjnë sot mbetjet e fundit të këtij territori thrako-ilir dhe të popullit pellazg.

Gjithsesi, shënojmë se stërgjyshërit thrako-ilirë, Pellazgët dhe fiset nga i njëjti trung me ta, pra lelegët, Ligurët, frigjianët, thrakët, etruskët,

karianët, lisianët dhe egjeas të tjerë gjendeshin në kontakt të drejtpërdrejtë me popujt pushtues, por ata pjesërisht u përthithën ose u zhdukën nga pushtuesit e njëpasnjëshëm. Disa i mbijetuan zhdukjes së përgjithshme dhe mundën të ruanin kulturën, zakonet, doket dhe mbi të gjitha gjuhën e tyre duke gjetur strehë në vise të paarritshme, të ashpra dhe malore. Ata gjenden pothuajse krejtësisht të shkëputur nga qytetërimi përreth deri në përthithjen ose shuarjen e plotë, nën presionin e pabesë dhe asimilues të pushtuesve grekë. Gjithsesi, disa fise mbijetuan aty-këtu deri në një epokë të mëvonshme, madje edhe sot, në veçanti në disa ishuj të Egjeut, Arkadisë, Atikës, Thrakës lindore, Epirit, Maqedonisë etj.

Të tërhequr në strehët e tyre malore dhe larg qendrave kryesore të qytetërimit (Athina, Roma, Bizanti) dhe shtabeve ushtarake, thrako-ilirët dhe pasardhësit e tyre, shqiptarët, ndryshe nga të parët e tyre Pellazgët e lashtë, mundën ta mbrojnë një farë autonomie politiko - shoqërore - kulturore dhe të ruajnë thelbin e kulturës së tyre, pavarësisht pushtimeve të shumta dhe të ndryshme.

Së fundi, ajo që karakterizon më shumë këtë vend të vogël, është fakti se ai është sulmuar shumë herë, është rrënuar, plaçkitur dhe pushtuar, por populli i tij kurrë nuk është nënshtruar. Historia ja ku është për ta provuar këtë: pavarësisht të gjitha pushtimeve, këtyre ndarjeve apo aneksimeve, këtyre fatkeqësive apo sulmeve, shqiptarët gjithmonë ekzistojnë dhe vazhdojnë të ndjekin traditat si dhe një kulturë dhe gjuhë shumë herë mijëvjeçare.

Nga ana tjetër, edhe sot në agimin e shekullit XXI, shihet se shqiptarët (në Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi) nuk reshtin së kërkuari territoret e pushtuara (dikur nga popuj të ardhur në vende të tjera) ose të dhëna falë traktateve apo marrëveshjeve të detyruara nga Fuqitë e Mëdha të fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX.

Kjo vijimësi në këmbënguljen e tyre për të mbrojtur tokën e të parëve, ky shpirt luftarak për të mbetur të lirë dhe të pavarur, kjo

ndjenjë shqiptarie e pashuar apo kjo krenari e lindur sepse rrjedhin nga popullsi tepër të lashta ka pasur të vetmen rrjedhojë, atë të ruajtjes së gjuhës së tyre, unike në Europë, të etnisë së tyre (më brakicefaluëse në Europë), kulturës, zakoneve dhe dokeve si dhe të folklorit të tyre (rapsodë ose kostume me zanafillë ilire gjenden në vise të shumta ballkano-danubiane).

Kështu, me shumë lehtësi mund të vërejmë se pas më shumë se pesë mijë vitesh, pellazgjishtja e lashtë përjeton përgjithmonë në shqipen e sotme. Kjo e fundit është me të vërtetë një fosile e gjallë, dëshmi e asaj që dikur ka qenë gjuhë e popullsive parahelene përpara mbërritjes së grekëve më Ballkan, Egje, Azi e Vogël dhe ky popull i lashtë është gjithmonë aty i gatshëm, mbi shkrepat dhe trojet mijëvjeçare. Këtu po e mbyll parantezën.

Për sa i takon vijimësisë së historisë politike shënojmë se pas vdekjes së Skënderbeut, otomanët pushtuan zyrtarisht dhe për një kohë të gjatë Shqipërinë, qysh nga viti 1479 dhe deri në vitin 1908. Por lëvizjet për pavarësinë e vendit dhe luftërat kundër pushtuesit nuk reshtën aspak deri në fillim të shekullit XX. Një luftë e ashpër u zhvillua në vitet 1905-1912 deri në kryengritjen e përgjithshme të 28 Nëntor 1912, data e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, për të cilën Ismail Qemal bej Vlora ishte një ndër nismëtarët kryesorë. Nën mbrojtjen e Perandorisë Austro-Hungareze u krijua një shtet i ri në vitin 1913 dhe kufijtë e rinj u caktuan nga Konferenca e Londrës (29/07/1913). Por shqiptarët u ndjenë të zhgënjyer sepse Fuqitë e Mëdha kishin favorizuar Greqinë dhe Serbinë, pa mbajtur parasysh realitetin etnografik, megjithëse ky ishte shumë i qartë në të gjithë këtë rajon ballkanik.

Shqipëria mbeti pengu politik i Fuqive të Mëdha. Intrigat filluan nga të gjitha anët. Dolën në pah mosmarrëveshjet midis Austro-Hungarisë dhe Italisë. Shqipëria u bë fushëbeteja e tyre dhe vatra e ngatërresave ndërkombëtare. Në vitet 1912-1913 filluan Luftërat Ballkanike. Më 7 mars 1914 u vendos në Durrës (i caktuar nga Fuqitë e Mëdha si kryeqyteti i

Shqipërisë) Vilhelm fon Vid, princi gjerman që i përkiste familjes së mbretëreshës Elizabet të Rumanisë: ai ishte caktuar në krye të shtetit të ri shqiptar. Por pas marrjes së Vlorës nga kryengritësit shqiptarë, më 7 shtator 1914 princi e la me shpejtësi Shqipërinë.

Krijimi i shtetit shqiptar u pa me sy të keq nga grekët dhe serbët. Kundërshtitë hegjemonike ishin të tilla, saqë Shqipëria u bë një fushë e vërtetë beteje midis Austro-Hungarezëve dhe Italianëve. Në plan ndërkombëtar shpërtheu Lufta e Madhe (kjo luftë filloi më 28 korrik me deklaratat e luftës të Austrisë kundrejt Serbisë). Në tetor të vitit 1914 Italia pushtoi portin e Vlorës dhe ishullin e Sazanit.

Megjithatë marrëveshjet e lidhura nga Traktati i Londrës më 26/04/1915 parashikonin shpërbërjen e Shqipërisë (të këshilluar nga marrëveshje sekrete, sipas zbulimeve që vijnë nga burime bolshevike). Një numër sulmesh të njëpasnjëshme u kryen anembanë Shqipërisë: grekët pushtuan jugun e Shqipërisë; ushtria serbe sulmoi Shqipërinë qendrore dhe ushtria malazeze pushtoi Shkodrën; në vitin 1916 ushtria austro-hungareze pushtoi Shqipërinë veriore dhe ushtria italiane hyri në Gjirokastër. Pastaj ishte radha e ushtrisë franceze, e udhëhequr nga Franshet d'Esperei, i cili pushtoi qytetin e Korçës deri në vitin 1918. Më 10 janar 1916 u shpall Republika e Korçës nga Themistokli Gërmenji.

Më 18/01/1919 u hap në Paris "Konferenca e Paqes". Fillimi i kësaj periudhe të pasluftës u shpall në mënyrë të kobshme për territoret shqipfolëse: serbët pushtuan Kosovën dhe krahinat kufitare të pjesës lindore të Shqipërisë (sot bëjnë pjesë në Maqedoni) dhe më në fund malazezët pushtuan një pjesë të Shqipërisë së Veriut.

Në janar të vitit 1920 një komitet i bashkimit kombëtar u mblodh në Kongresin kombëtar të Lushnjës dhe një këshill regjence u vendos në Tiranë, e cila u bë zyrtarisht kryeqyteti i Shqipërisë. Më 5 qershor 1920 shqiptarët rrethuan italianët në Vlorë (Valona). Në gusht, italianët përfunduan duke nënshkruar një marrëveshje me qeverinë e Tiranës dhe pranuan të tërhiqen nga Vlora. Kjo fitore forcoi pozicionin

ndërkombëtar të Shqipërisë. Në dhjetor të vitit 1920 ajo u pranua në Lidhjen e Kombeve (Kombet e Bashkuara).

Në vitin 1921, Konferenca e Ambasadorëve, e mbledhur në Paris, miratoi kufijtë e rinj të Shqipërisë, të vendosura më parë nga Fuqitë e Mëdha. Por këto vitët njëzet ishin gjithashtu të vështirë; grekët i dhanë një goditje të fortë etnisë shqiptare të Epirit, duke transferuar në Turqi (kundrejt më shumë se një milion grekëve të Anatolisë, rrjedhojë e një pazari midis dy vendeve) me qindra mijëra shqiptarë, nën pretekstin se ata ishin myslimanë, pra turq. Ky spastrim etnik kaloi pa u vënë re në historinë e këtij rajoni (disa dhjetëvjeçarë më vonë Serbia përsëriti, por në mënyrë të përgjakshme, një tjetër "spastrim etnik" të shqiptarëve në Kosovë).

Traktati i Lozanës (1923) i ktheu kufijtë e Greqisë në ato të vitit 1912. Më 16 qershor 1924 Fan Noli (prift, poet, shkrimtar dhe përfaqësues i shqiptarëve në SHBA) nuk e njohu rezultatin e zgjedhjeve të dhjetorit të vitit 1923 (të arritur nga një koalicion në favor të Ahmet Zogut) mori pushtetin (grusht shteti me ndihmën e përkrahësve pro-komunistë) dhe përmbysi qeverinë e Vrionit. Disa muaj më vonë (dhjetor 1924) ai heq dorë nën presionin e lëvizjeve pro-zogiste.

Kështu Ahmet Zogu (Ahmet Bej Zogolli) mori pushtetin dhe u bë presidenti i republikës në vitin 1925. Më 27 nëntor 1926 ai nënshkroi paktin e miqësisë dhe të sigurisë me Italinë dhe më 22 nëntor 1927 ai nënshkroi paktin e dytë (traktati i aleancës mbrojtëse) me një vazhdimësi prej njëzet vjetësh. Më 25/08/1928 ai u shpall mbret i shqiptarëve me emrin Zogu I dhe e qeverisi vendin deri më 7 prill 1939 ditën e pushtimit të Shqipërisë nga trupat e Musolinit. Fatkeqësisht kjo periudhë e shkurtër nuk i dha mundësi mbretit të realizonte disa projekte të mëdha, të parashikuara për modernizimin e vendit. Ai u largua me familjen e tij për një kohë të gjatë në ekzil dhe fillimisht u vendos në Paris ku ndroj jetë me 9/04/1961.

Lufta e dytë botërore (1939/1945) e nisur nga Hitleri, shpërtheu më 1 shtator 1939 (pushtimi i Polonisë). Rezistenca filloi të organizohej

në të gjithë vendin. Më 8 nëntor 1941 u krijua në fshehtësi partia komuniste shqiptare. Forcat e lira jo-komuniste emëruan Shefqet Vërlacin si kryetar të qeverisë. Kjo qeveri jetëshkurtër u zëvendësua nga ajo e Mustafa Krujës.

Lufta kundër pushtuesit u ashpërsua dhe u përhap kudo në vend. Më 8 shtator 1943 Italia kapitulloi.

Komandanti italian refuzoi t'u dorëzohej forcave shqiptare. Pjesa më e madhe e ushtarëve italianë u dorëzuan te forcat naziste që hynë në Shqipëri. Gjithsesi, komunistët patën sukses dhe imponuan pushtetin e tyre në dëm të forcave të tjera të Rezistencës shqiptare (Legaliteti, Balli Kombëtar etj.).

Më 22 tetor 1944, në Beratin e çliruar, u krijua "Qeveria demokratike e Shqipërisë". Tirana u çlirua më 17 Nëntor 1944. Qeveria u vendos aty më 28 nëntor 1944. Shkodra, qyteti i fundit i mbajtur nga gjermanët, u çlirua më 29 nëntor 1944, dita e fitores përfundimtare mbi forcat pushtuese naziste.

Enver Hoxha, komandanti suprem i ushtrisë vendosi të dërgojë dy divizione për të ndihmuar Jugosllavinë e Titos në luftën e saj për çlirim kombëtar. Këto trupa u shpërndanë në Maqedoni, Kosovë, Mal i Zi dhe në Bosnjën e Jugut.

Lufta e Dytë Botërore përfundoi me rënien e Berlinit dhe kapitullimin pa kushte të Gjermanisë më 8 Maj 1945. Në Shqipëri u vendos pushteti komunist, që mori fund me rënien e komunizmit në të gjithë Europën Lindore, si dhe në Shqipëri (1990).

SHQIPËRIA: ASPEKTI I PËRGJITHSHËM

Vendndodhja gjeografike

Shqipëria gjendet në gadishullin e Ballkanit, midis Malit të Zi dhe Kosovës (krahinë autonome e Serbisë, sot nën mbrojtjen e Kombeve të Bashkuara) në veri dhe veri-lindje, Maqedonisë në lindje, Greqisë në jug dhe detit Adriatik e detit Jon në perëndim. Ajo është midis 390 38' dhe 420 39'gradë gjerësi veriore dhe 190 16' dhe 210 4' gjatësi lindore. Pozicioni i saj gjeografik është një nga më strategjikët në Europë: ajo përmbyll ngushticën e Otrantos (72 km) dhe është një urë kalimi midis Europës Perëndimore, Ballkanit dhe Lindjes.

Sipërfaqja e saj është 28 748 km katror. Gjatësia e përgjithshme e kufijve të saj është 1 272 km nga të cilat 472 km janë kufi detarë, 271 km me Greqinë dhe 529 km me Jugosllavinë dhe Maqedoninë. Me një vështrim, gjatësia e përgjithshme e saj nga veriu në jug është 340 km dhe gjerësia e saj nga perëndimi në lindje është 71/150 km. Në perëndim Shqipëria laget nga deti (pothuajse 37 % e perimetrit të përgjithshëm). Bregdeti paraqitet në dy aspekte: bregdeti Adriatik, më i gjati dhe që ka një lartësi të ulët dhe atë të bregdetit jonian që është shumë i thyer, ku malet bien thikë mbi det. Në këtë zonë detare gjenden tokat më

pjellore të vendit. Megjithatë disa fusha gjenden edhe në brendësi të vendit në formën e atyre pa dalje në det (fusha e Elbasanit dhe ajo e Dropullit) ose në formë ultësirash që datojnë qysh nga shembjet e tokave të periudhës së Kuaternarit (fusha e Korçës p.sh.). Në planin gjeologjik dallohen katër krahina natyrore: Alpet e Veriut (mali i Jezercës, i cili arrin deri 2 693 m) Malësitë e qendrës (krahinë e pasur me liqene tektonike), malësitë jugore (2 495 m në majën e Papingjit) dhe ultësira perëndimore (fusha, laguna, shtresa ranore, duna dhe plazhe me rërë të imët), hambari i vendit shtrihet përgjatë më shumë se 200 km nga veriu në jug dhe në disa pika depërton deri në 60 km në drejtim të lindjes.

Klima është e tipit mesdhetar në bregdet (adriatik dhe jonian) dhe kontinental në brendësi; temperaturat maksimale absolute të shënuara në verë janë +44 në pjesën perëndimore dhe në dimër -26 në pjesën malore ne lindje të vendit. Mesatarja vjetore e reshjeve është nga 1 350 mm (>2200 mm/vit në Alpet e Veriut).

Relievi është malor (rreth 76 % e vendit) në veri (Alpet shqiptare) dhe në jug dhe mjaft e sheshtë në perëndim (fusha dhe ultësira përgjatë bregdetit). Lartësia mesatare është 708 m, më e larta e Europës. Franca ka një lartësi mesatare të përgjithshme prej 342 m ose 297 m pa Korsikën. Mali Korab arrin lartësinë 2751 m (në verilindje të Peshkopisë në kufi me Maqedoninë dhe Kosovën): maja e tretë më e lartë e Ballkanit.

Pyjet zënë pothuajse 40 % të vendit. Vendi laget nga lumenj të shumtë, përroska dhe përrenj. Liqenet malore janë të shumtë: liqene akullnajorë (malësi të larta, liqene me zanafillë karstike (kodrina), liqene tektonike (Shkodra, Pogradeci, Prespa), liqene fushore (tip lagunash).

Ujërat e brendshme paraqesin rreth 1 350 km katror. Liqeni më i madh është ai i Shkodrës me një sipërfaqe prej 360 km katror, liqeni i Ohrit është liqeni më i thellë me 286 m dhe ai i Prespës është më i larti me një lartësi prej 853 metrash. Në krahasim liqenin Burzhet, më i madhi i Francës ka një sipërfaqe prej 43,3 km^2, një thellësi prej 145 m

dhe një lartësi prej 231 m. Drini (Shqipëria e Veriut) është lumi më i gjatë (280 km). Lumi Shkumbin (114 km) përshkon Shqipërinë nga lindja në perëndim dhe ndan Shqipërinë e Veriut nga ajo e Jugut: vijë ndarjeje midis dy entiteteve etno-dialektore (dialekti gegë në veri dhe ai toskë në jug). Lumenjtë e tjerë kryesorë janë: Drini i Bardhë, Mati, Ishmi, Erzeni, Buna në veri si dhe Semani i formuar nga Devolli dhe Osumi, Vjosa, Kalasa, Bistrica dhe Pavllo në jug.

Fauna e Shqipërisë është e larmishme dhe mjaft e pasur. Dallohen specie të shumta kafshësh të egra të tilla si rrëqebulli, ariu, ujku, dhelpra, çakalli, derri i egër, kamoshi, dreri, lepuri, lundra, Kunadhja si dhe zogj të egër (thëllëza, shkurta, turtulli, fazani) dhe shpendë ujorë (rosa, pata, pelikani, bajza etj.). Përveç Flora është e përbërë nga mijëra bimë përfaqësuese të pjesës më të madhe të florës ballkanike. Pothuajse 3 % e bimëve janë zanafillore dhe tipike të krahinave malore të brendësisë së vendit.

Shqipëria është një nga vendet e rralla të Europës që ofron një larmi të madhe relievi, klimash dhe peizazhesh në një hapësirë kaq të vogël. Kur në zonat veriore a në brendësi të vendit bie borë (në janar, shkurt) në fushat e Vrinës në jug vazhdojnë të vilen limonët dhe portokalliet!

Burimet ekonomike dhe industriale

Nëntoka e Shqipërisë, pavarësisht sipërfaqes së saj të vogël, fsheh burime të rëndësishme minerale, gati më shumë se tridhjetë lloje (lëndë djegëse, bituminoze dhe metale). Aty gjendet naftë (afërsisht 20 milion ton rezerva naftë) gaz natyror (prodhimi në vitin 1994: 52 milion m^3), linjit, krom (vendi i tretë në botë), bakër, nikel (vendi 17-të në botë)...

Industria hidro-energjetike është shumë e zhvilluar (eksportimi i energjisë elektrike në vendet fqinje). Për rezervat e saj hidro-energjetike Shqipëria vendoset në vend të dytë në Europë, pas Norvegjisë. Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 1993 ka qenë 3,43 miliard kwh, ndër të

cilat 95 % hidro-energjetike. Ekzistojnë industri të tjera: e naftës (rafineri), siderurgjike (uzina çeliku, farkëtari...), mekanike, ushqimore (përpunimi i panxharit të sheqerit, frutave etj.).

Disa linja hekurudhash (742 km në vitin 1996) lidhin Tiranën me Durrësin, Shkodrën dhe me Malin e Zi në kufi me një degëzim për në Milot dhe Klos, prej Durrësit në Vlorë nëpërmjet Kavajës dhe Fierit dhe nga Durrësi për në Pogradec nëpërmjet Elbasanit. Rrugët janë rreth 174 00 km (1995).

Bujqësia, blegtoria dhe peshkimi janë mjaft të zhvilluara. Aty kultivohen gruri, misri, panxhari i sheqerit, perime, pambuku, duhani, elbi, orizi, mashurkat (fasulet e thata përbëjnë një nga ushqimet kryesore të shqiptarëve), mani, vreshta, pemë frutore, etj. Kultura e ullirit është një nga më të vjetrat e Europës.

Këtu ushtrohet rritja e deleve, dhive, derrave, gjedhëve etj. Shfrytëzimi i pyjeve është shumë i rëndësishëm. Shqipëria eksporton bimë medicinale (më shumë se 3 200 varietete). Është për tu shënuar se industrializimi i vendit ka filluar në një shkallë të lartë vetëm pas Luftës së Dytë Botërore. Gjatë regjimit komunist shkëmbimet tregtare ishin të bazuara mbi këmbimin. Me ardhjen e demokracisë në vend në fillim të viteve '90 vendi ishte i detyruar të paguante në valutë për importet. Gjithsesi në fillim të shekullit XXI gjendja ekonomike mbeti mjaft e dobët.

Populsia dhe demografia

■ Shqipëria ka rreth 3 500 000 banorë sipas llogaritjeve të fundit (1995). Në vendet fqinje, ndër të cilat Mali i Zi, Kosova, Maqedonia dhe Greqia (Epiri, Rumeli, Atikë...) jetojnë bashkësi të vjetra shqiptare që arrijnë afërsisht 3 000 000 banorë.

■ Ekziston një përqendrim i fortë shqipfolësish ose turqish me zanafillë shqiptare në Turqi (më shumë se 4 000 000 sipas disa burimeve). Gjithashtu në Italinë jugore (Kalabri, Sicili, Molise, Abrucio..)

emigrantët shqiptarë, të quajtur arbëreshë janë vendosur qysh në shekullin XV, pas pushtimit të vendit të tyre nga otomanët.

■ Nëpër botë ekzistojnë bashkësi të shpërndara, më pak apo më shumë të rëndësishme: Shtetet e Bashkuara (më shumë se 400 000), Belgjikë, Zvicër, Australi, Lindja e Afërt (Siri, Liban), Egjipt etj. Bashkësia shqiptare në botë i kalon 10 000 000 vetë.

■ Siç e kemi parë në kapitullin e mëparshëm thrako-ilirët dhe shqiptarët kanë luzmuar kudo në botë qysh në Antikitetin e hershëm për të parët dhe në periudha pas Krishtit për të dytët. Kjo diasporë shumë vendeve i ka dhënë personalitete të shquara, ndër të cilët Aleksandrin e Madh, i mbiquajtur Maqedonasi, Pirro II i Epirit, priftëreshën e tempullit të Amonit në Siva (oazë në shkretëtirën egjiptiane në perëndim të deltës së Nilit), një faraon me zanafillë etruske, më shumë se dymbëdhjetë perandorë romakë dhe bizantinë, Spartakun, dy Papë (Inoçenti I, Klementi XI), Shën Jeronimin, një mori kardinalësh në Vatikan, Albanin (piktor i madh italian), arkitektin më të madh të Perandorisë Otomane, arkitekt Sinanin, mbretërit e fundit të Egjiptit (ka ekzistuar për 148 vjet dinastia shqiptare, deri në vitin 1952), Nënë Terezën dhe emra të tjerë jo më pak të shquar.

■ Kemi përpara një vend që ,me një anë, është i hapur në bregdet nga perëndimi (rrugë shkëmbimi, komunikacioni dhe depërtimi) dhe, në tjetrën anë, shumë i mbyllur në pjesën e tij lindore, pothuajse të paarritshme për të huajt dhe mbi të gjitha për pushtuesit, të cilët në të kaluarën kanë hasur në vështirësi shumë të mëdha për të depërtuar aty dhe akoma më shumë për t'u vendosur aty. Janë pikërisht këto fise malësore që e bënin të sigurt vijimësinë pellazgo - ilire, etninë dhe kulturën, zakonet dhe doket, folklorin dhe mbi të gjitha gjuhën.

■ Dendësia e popullsisë është 125,9 (banorë/ km^2). Në Francë dendësia është 106, 5 (në sipërfaqen e përgjithshme) Por në se mbahet parasysh fakti që popullsia franceze jeton në të vërtetë në 200 000 km^2 ky densitet shkon në 289. Krahasimisht ajo e Italisë është 1558.

■ Treguesi i lindjeve është 3,03 fëmijë për çdo grua (1990), përqindja (për 1000 banorë) e lindjeve është 23, 8, ajo e vdekshmërisë është 5,4 (vdekshmëria foshnjore = 28,3 për 1000 lindje). Jetëgjatësia është 70 vjet (burrat) dhe 76 (gratë). Treguesi i lindjeve në Francë është 1, 7 (1997), vdekshmëria foshnjore është 5 dhe jetëgjatësia është 78/82.

■ PNB*) është 670 $ (1995) në vit për një banor. Në Francë kjo është 24990$ (1995).

■ Qytetet kryesore të Shqipërisë (përllogaritje e vitit 1996) janë: Kryeqyteti, Tirana (350.000 banorë), Durrës (85.400 banorë), Elbasan (83.300 banorë), Shkodër (81.900 banorë), Vlorë (73.800 banorë), Korçë (65.400 banorë), Fier (45.200 banorë).

■ Tirana e ka marrë emrin e saj nga fjala Tirreni, emër që grekët i dhanë Etrurisë në Itali, vendi i etruskëve. Një nga dy dialektet shqiptare është toskërishtja e jugut (ajo e veriut është gegërishtja). Emri Toskë përqaset me emrin e Toskanës (krahinë në Itali), që është emri modern i Etrurisë së lashtë, popullsia e të cilës ishte me zanafillë pellazge: ishte Tuski për latinët, për grekët : Tursenët, Tirsenët ose Tirrenët dhe Tursha për egjiptianët.

■ Vendi është i ndarë në 26 rrethe.

■ Shqipëria sot nuk është shtet fetar por shtet laik. Komunistët në periudhën e pasluftës e kishin ndaluar ushtrimin e të gjitha feve dhe kishin shpallur ateizmin zyrtar. Shqipëria është e krishterë qysh në shekujt e parë (epoka e Shën Palit), por për shkak të pushtimit otoman në shekullin XV vendi u islamizua pak nga pak dhe arriti deri në 65 % të popullsisë përpara luftës së dytë botërore. Katolikët janë 12 % e popullsisë dhe ortodoksët 23 %.

■ Flamuri shqiptar formohet nga një shqiponjë dykrerëshe e zezë në një sfond të kuq.

---

*) *Të ardhurat vjetore.*

ASPEKTET ETNO - KULTURORE

Paleontologji, arkeologji, antropologji

Sipas hulumtimeve të fundit të kryera në Shqipëri njeriu ka banuar në gadishullin e Ballkanit qysh nga Paleolitiku. Pra, njeriu i shpellave ka banuar në këtë rajon dhe në veçanti në zonën bregdetare të Adriatikut (160 000 vjet: shpella e Kaprinas, sot në Kroaci). Studimet paleontologjike, arkeologjike ose epigrafike na lejojnë t'i vendosim gjurmët e para të qytetërimit rreth Neolitikut (8000 - 3000 vjet). Pellazgët (njerëzët e shpellave) dhe thrako-ilirët, pasardhësit e drejtpërdrejtë të tyre dhe stërgjyshërit e shqiptarëve, banonin në këtë rajon ballkano-egjeas, duke përfshirë Kretën dhe Azinë e Vogël, shumë më parë periudhës Eneolitike (3 000–2 000), siç e dëshmojnë gërmimet në Maliq, Kamnik, Nezir, Hisar, Ohër, Troja I dhe II. Autorët antikë grekë, ndër të cilët Hekateu i Miletit, Hellanikos i Mitilenit, Herodoti, Tuqididi, Efori, Diodori i Sicilisë ose Straboni, pohojnë se Pellazgët, popull barbar, d.m.th që nuk flisnin greqisht, zinin Thesalinë, Peloponezin, Azinë e Vogël, Kretën dhe ishujt e Egjeut shumë kohë përpara mbërritjes së akenëve (grekëve).

Në tarracat që lartësohen në të dy anët e rrjedhës së mesme të lumit Mat dhe në zonën e Çinamakut (në veri) si dhe në zonat e Pazhokut

dhe Kuçi i zi (në jug), arkeologët shqiptarë kanë zbuluar një mori tumulash dhe objekte të shumta, ndër të cilat armë prej bronzi (shpata, mburoja, parzmore, thika, kama, përkrenare ...) poçeri, qeramika, figurina ose punime kockash që datojnë në Epokën e Bronzit (e quajtur epoka mikeniane) madje të epokës neolitike. Ndërsa në varret e grave janë zbuluar zbukurime të shumta: komça, byzylykë, vathë, gjerdanë, karfica, kurora etj. Armët dhe stolitë prodhoheshin nga mjeshtërit farkëtarë, nga më të dëgjuarit të rajonit ballkano-danubian: pirustët.

Në Dodonë (kryeqyteti i kultit të pellazgëve) në Epir midis artefakteve të tjera janë zbuluar edhe një shpatë e tipit mikenian. Shënojmë gjithashtu se zbulimi i varreve shumë më të bukur pranë Trebenishtës (buzë Ohrit) ka nxjerrë skelete, të cilat kanë maska prej ari të tipit mikenian.

Së fundi rrënojat arkeologjike të Maliqit dhe të Trenit vërtetojnë karakterin ilir të qytetërimit të epokës së Bronzit në Shqipëri: vazo bashkëkohore me epokën e Bakrit, numri i të cilave shtohet në epokën e Bronzit. Përveç kësaj, format dhe motivet gjeometrike të këtyre vazove janë të karakterit tipik ilir. Janë zbuluar i njëjti tip artefaktesh në lokalitetet që gjenden në Jugosllavi, të tilla si zona e Zecovit dhe Ptujit.

Zharde pohon në lidhje me këtë: "Në epokën neolitike, një qytetërim i njëjtë që dëshmon të njëjtën qeramikë, shtrihet në të gjithë Greqinë e Veriut, nga rajoni i Orkomenës deri në kufijtë e Maqedonisë.... Këto populli me sa duket ishin – Pellazge. Ndërkohë që gjenden p.sh. figura të turpshme në shtretërit e kulturës së parë thesaliane, nuk duhet të lëmë pa përmendur se sipas Herodotit (III, 51) grekët e morën nga Pellazgët hermesin itifalik... Thesalia zor se është më greke se Etolia dhe Akarnania... Ashtu si Etolia dhe Akarnania është një krahinë kufitare, si të thuash një shteg midis Greqisë dhe botës barbare.... Për historianët grekë Greqia nga perëndimi fillonte në Akarnani (Efori, Straboni VIII, 1, 3), Epiri më në veri nuk bënte pjesë aspak në botën klasike.

Në planin antropologjik, shqiptarët karakterizohen nga një hiperbrakicefali ndër të cilat treguesi cefalik luhatet midis 85 dhe më shumë se 90. Megjithatë antropologët kanë zbuluar një planokcipitali (shtypje të pjesës së pasme të kafkës) në pjesën më të madhe të shqiptarëve (Toskë dhe Gegë). Sipas C. Stefanos "Epiri ka një tregues cefalik pothuajse të njëjtë me atë të shqiptarëve dhe në përgjithësi pjesa perëndimore e Greqisë paraqet brakicefali mesatare, madje nganjëherë edhe hiperbrakicefali".

Të gjitha studimet antropologjike të kryera qysh prej njëqind vjetësh vërtetojnë përkatësinë e etnisë të shqiptarëve të sotmë ndaj asaj të pellazgo-thrako-ilirëve të tjerë. Në të vërtetë studimi i kafkave të zbuluara në nekropolet antike pohojnë identitetin e karakterit të tyre brakicefalë reciproke dhe për arsye shumë të forta një vijimësi etnike, e cila shfaqet edhe në fusha të tjera, si në planin gjuhësor aq edhe në planin kulturor, historik dhe arkeologjik.

Gjuha, letërsia

Gjuha shqipe është gjuha më e vjetër e Europës. Ajo rrjedh nga gjuha ilire dhe ajo thrako-frigjiane (të një trungu me gjuhën etruske) gjuhë trashëgimtare e pellazgjishtes së lashtë, nga e cila grekët huazuan një pjesë të gjuhës së tyre, greqishten e lashtë. Nga ajo rrjedhin drejtpërdrejt gjuha joniane dhe ajo arkado-qipriote. Gjithsesi gjenden një numër i madh fjalësh të ndryshme si dhe oronime, toponime, antroponime ose teonime pellazge dhe thrako-ilire në gjuhë të ndryshme të vdekura apo të gjalla: hitite, etruske, latine, kelte, baske, armene, gjuhë të Kaukazit, gjuhë baltike, irlandishte e vjetër, anglishte, gjermanishte e hershme (cf studime gjuhësore të veprës që keni në dorë) etj.

Shqipja përbën një degë krejtësisht më vete të gjuhëve të quajtura indo-europiane dhe nuk rrjedh nga asnjë gjuhë tjetër e njohur.

Ne nuk zotërojmë gjurmë të ilirishtes së lashtë, përveç disa epigrafeve

të rrallë (transkriptime fonetike të gjuhës së tyre me anë të germave greke dhe më pas latine) të përbëra nga emra të përveçëm dhe toponime tipike ilire. Në të vërtetë prijësit ilirë përdornin greqishten dhe më pas latinishten (gjuhë ndihmëse) në marrëdhëniet e tyre me botën e jashtme, ndërkohë që populli fliste gjuhën e tij. Ky është një monument i madh apo gjurmë e prekshme që pellazgo-ilirët u lanë trashëgim brezave të ardhshëm: vërtet një fosile e gjallë. Z. Majani në lidhje me këtë pohon: "Gjithsesi shqipja është një gjuhë mahnitëse ku nganjëherë mjafton të përkulesh përdhé për të kapur një purtekëz ari ... filologjike. Është kjo gjuhë ku, pa mundimin më të vogël, nganjëherë ju bien në dorë zbulime: fjalë arkaike që janë bashkëkohëse me Iliadën dhe Numa Pompilius".

Siç e pamë në paragrafin e mëparshëm, ilirët ishin një popull autokton, të cilët kanë vazhduar në përjetësi kulturën, gjuhën dhe traditat e trashëguara të pellazgëve të lashtë. Ata ua përcollën këtë trashëgimi kulturore pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë: shqiptarëve.

Megjithëse nuk gjenden aspak gjurmë të shkruara të gjuhës shqipe përpara shekullit XIV, është i pakundërshtueshëm mendimi se shqiptarët e sotëm flasin të njëjtën gjuhë me stërgjyshërit e tyre, pavarësisht disa përpunimeve dytësore të pashmangshme që pësoi nga stuhitë e kohëve. Në të vërtetë, gjuhëtarët e parë të shekullit XIX, ndër të cilët Ksilander, Ramus, Shlaiçer dhe mbi të gjithë Franc Bop (Mbi gjuhën shqipe në lidhjet e saj të përafërsisë, 1854) kanë treguar se gjuha shqipe është dukshëm një gjuhë indo-europiane, por që nuk ka asnjë degëzim me këdo gjuhë tjetër të njohur.

Gjuhëtarë të shumtë e bashkëngjisin gjuhën shqipe me grupin indo-europian të Veriut të Europës për shkak të zhvillimit strukturor. Por këta të fundit janë të prerë: t'i bashkëngjitësh një gjuhë një familjeje ose një grupi gjuhësh nuk do të thotë se bëhet fjalë për një degëzim, por për një zhvillim strukturor. Kështu, në gjuhët indo-europiane të Veriut, germa o e shkurtër është shndërruar në a, ndërsa në gjuhët e Jugut është ruajtur germa o. Ja pra, për këtë arsye ata e bashkëngjitin

gjuhën shqipe te gjuhët e Veriut. Ja një shembull i qartë, fjala "natë": është natë (shqip), nacht (gjermanisht), naktus (lituanisht) për gjuhët e grupit të Veriut si dhe nox, noctis (latinisht), nuktos (greqisht) për gjuhët e grupit të Jugut. Raportet e gjuhës shqipe me gjuhët e Veriut të Europës kanë qenë studiuar nga gjuhëtarë të shumtë, ndër të cilët Pedersen, Hoger dhe albanologu i shquar Norbert Jokl. A nuk duket e gjithë kjo normale, kur dihet se rajonet e sipërme dhe të mesme të Danubit kanë qenë djepi apo vatra zanafillore e pellazgo-ilirëve, ose të paktën një nga etapat e shtegtimeve të tyre prej Atlantikut (viset baske) deri në Detin e Zi (Kaukazi)?

Xhon Geipel, midis autorëve të tjerë modernë, ka nxjerrë disa të vërteta të pakundërshtueshme në librin e tij "Antropologjia e Europës" (Një histori etnike dhe gjuhësore, Robert Lafont, 1971): "Pavarësisht sulmeve, shqiptarët ..... në të vërtetë, mbetën të izoluar në malësitë e thella të tyre dhe e ndjenë shumë pak ndikimin e pushtuesve, megjithëse një farë numri fjalësh greqisht, latinisht, sllavisht dhe turqisht kanë kaluar në gjuhën e tyre... Pushtimi sllav në Ballkan gjatë shekujve VI pas Krishtit solli zhdukjen e dialekteve shqip në rajonet e Bosnjës dhe Malit të Zi, por e thënë saktë, gjuha sllave nuk arriti kurrë të zinte rrënjë në Shqipëri... Gjuha shqipe trajtohet se ka një strukturë gramatikore dhe një farë fjalori të gjuhës thrako-frigjiane, e cila është zhdukur kudo në Ballkan". Dhe, për të përfunduar, ja çfarë thotë Norbert Jokl: "Në çdo aspekt vëmë re se trashëgimia gjuhësore, e përcjellë nga gjuhët e lashta të Ballkanit, si gjuha ilire dhe ajo thrake, është e lidhur ngushtë me gjuhën shqipe".

Gjuhëtari Meje (dhe të tjerë jo më pak të shquar) në librin e tij "Gjuhët indo-evropiane", duke mos mundur të vendosë zanafillën e vërtetë të pellazgëve dhe as karakterin pararendës të gjuhës së tyre, nuk ka mundur të vendosë lidhjen me gjuhën ilire dhe aq më pak me shqipen, po megjithatë edhe ai ka nxjerrë disa të vërteta befasuese: "Ilirët kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm, por ende të përcaktuar

keq, në qendër të Europës dhe kanë vepruar në tri drejtime: drejt botës gjermanike, me të cilën lidhjet dhe shkëmbimet kanë qenë të pareshtura; drejt Italisë, ku popuj të shumtë ilirë ishin vendosur (madje është hamendësuar edhe se populli i Umbrias kanë qenë një degë ilire)... ata gjithashtu duhet të kenë luzmuar në një periudhë të hershme në jug të Ballkanit, ku emra të shumtë vendesh shënojnë një kolonizim të lashtë ilir të mbuluar nga pushtimi helen. Duhen trajtuar gjithashtu filistinët si me zanafillë ilire, të cilët emërtuan Palestinën (greqisht: Palaistine). Rrënja dhe fjalëformimi janë emra të mirëfilltë ilirë". Gjithsesi, mbetet e turbullt çështja e pellazgjishtes së lashtë: "Krahinat që pushtuan grekët kishin qenë të banuara përpara mbërritjes së tyre nga populli prej një race të panjohur si dhe me një gjuhë të panjohur, për të cilët ne dimë vetëm emrat: Pellazgë, Lelegë, Karianë etj. Sipas mbetjeve toponimike të ngulimeve të tyre, këta popuj flisnin gjuhë jo indo-europiane. Në bazë të dëshmive të të lashtëve, gjuha pellazge (emër i paqartë që duket të ketë qenë përdorur për gjuhë të ndryshme para-helene) ishte ende në përdorim në shekullin V para Krishtit në bregdetin e Thrakes, në jug të Propontidës dhe në disa ishuj, Imbros, Lemnos, Samothrakë dhe deri në Kretë".

Për të përfunduar, ja dhe ky paragraf, ajo çfarë mendon Z. Majani në një studim të tij mbi Etruskët dhe fiset nga i njëjti trung Thrako-Ilirët: "Herodoti, sipas një tradite, e trajtonte Anatolinë si pikënisjen e etruskëve për në Itali. Rreth vitit 1300 para erës sonë, këto vende të Anatolisë ishin të populluara pjesërisht nga ilirët dhe thrakët të ardhur nga Ballkani. Kështu brigët maqedonë u bënë frigjianë në Anatoli. Dardanët ballkanas u vendosën në Troadë. Ata flisnin dialekte ilire: një gjuhë indo-europiane më vete, as greke as latine. Nga kjo shpjegohet përse latinistët dhe helenistët nuk kanë mundur ta deshifrojnë etruskishten. Ata e kërkojnë çelësin në këto gjuhë klasike. Mirëpo ai gjendet diku tjetër... Vetëm gjuha ilire na lejon të qarkojmë mjaftueshëm hapësirën e këtij hulumtimi, në mënyrë që të kapen afritë me gjuhën

etruske... Së fundi, burimi ynë kryesor, natyrshëm që mbetet gjuha shqipe, e vetmja gjuhë ballkanike e gjallë, baza e së cilës ka mbetur gjuha ilire". Në të vërtetë duhet shënuar që gjuhëtarët e parë të shekullit XIX dhe të fillimit të shekullit XX i kanë bazuar hulumtimet e tyre paraprake në veçanti në afrinë **SANSKRITISHT - GREQISHT - LATINISHT**. Ja përse edhe ky problem etno-gjuhësor ka mbetur në udhë pa krye, d.m.th. nuk ka mbajtur parasysh të qenit më e hershme e pellazgjishtes së lashtë kundrejt gjuhës greke, madje edhe asaj sanskrite dhe ndikimi i saj i sigurt mbi disa gjuhë të mëvonshme. Përveç të tjerave, në këtë pikën e fundit duhet shënuar roli që gjuha ilire ka ushtruar mbi gjuhët ballkanike.

Për sa i takon letërsisë shqipe, ajo është relativisht e vonshme. Shkrimet e para në gjuhën shqipe datojnë nga shekujt XIV dhe XV. Shkrimtarët e parë ishin Gjon Buzuku, Pal Engjëlli, Marin Barleti, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani. Gjithsesi, Bokardus, murg francez, vepra e të cilit, në mënyrë krejt paradoksale u shkrua nga Guljelm Adae (Arqipeshkvi i Tivarit), pohonte në vitin 1332: "Megjithëse kanë një gjuhë krejt ndryshe nga gjuha latine, shqiptarët në librat e tyre përdorin germat latine". Ky pohim na bën të mendojmë se kjo gjuhë ka qenë e shkruar shumë më parë se shekulli XIV.

Shkrimet e para shqipe shpesh kishin një karakter fetar (përkthime të Biblës, Mesharit etj.), ndonjëherë poetik ose liriko-epik dhe ndonjëherë didaktik (abetare, fjalorë...). Kjo zgjati deri në shekullin XVIII, pas islamizimit të vendit dhe shfaqjes së lëvizjeve letrare me ndikim oriental.

Romantizmi shqiptar u shfaq në shekullin XIX. Në këtë epokë shihet të lindë një letërsi e një niveli të lartë: Jeronim de Rada (Këngët e Milosaos), Naim Frashëri (Bagëti e Bujqësi - Lulet e Verës - Historia e Skënderbeut), Andon Zako Çajupi (Baba Tomorri). Kjo periudhë ka patur në veçanti: poetët lirikë (Ndre Mjeda, Asdreni, Zef Serembe, Gavril Dara, Mihal Grameno etj.); gjuhëtarët (Dhimitër Kamarda, Konstandin Kristoforidhi);

mendimtarë, eseistë, eruditë, ndër të cilët Naum Veqilharxhi, Teodor Haxhi Filipi dhe, mbi të gjithë, Sami Frashëri, i cili u bë ideologu i lëvizjes kombëtare shqiptare (Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet; vepër e quajtur "Manifesti i Rilindjes Shqiptare").

Pas Pavarësisë së vendit në vitin 1912, autorët shqiptarë vazhduan të frymëzohen nga "Rilindja Shqiptare". Por një letërsi me karakter patriotik, anti-feudal, revolucionar nisi me shkrimet e Fan Nolit (1882–1965), prift, shkrimtar, poet, publicist, eseist, përkthyes (Sheksipiri, Servantesi, Ibseni...) dhe historian (Skënderbeu). Fan Noli ishte gjithashtu kritik muzikor me "Bethoveni dhe Revolucioni Francez" që fitoi admirimin e Bernard Shout, Sibeliusit dhe Tomas Manit. Poezia lirike ishte gjithmonë e gjallë, falë poetëve Lasgush Poradeci dhe Migjeni (Vargjet e lira, 1935), dhe të tjerë jo më pak të shquar. Sa për poezinë liriko-epike ajo e arriti kulmin e saj me poetin-frat Gjergj Fishta (Lahuta e Malcis). Ky i fundit u vra gjatë luftës së dytë botërore dhe vepra e tij u ndalua nga komunistët për shkak se i përkiste etnisë gege të Veriut dhe, mbi të gjitha, për shkak të vrullit patriotik dhe çlirimtar të poemave të tij, të cilat binin ndesh me ideologjinë komuniste. Romani nuk mbeti pas me Foqion Postolin dhe Haki Stërmillin midis romancierëve të tjerë të shquar të kësaj epoke.

Pas luftës për çlirim kombëtar e luftës së dytë botërore u shfaq një brez i ri poetësh me Memo Meton (poet dëshmor), Kolë Jakovën, Llazar Siliqin, Aleks Çaçin, Shefqet Musarajn.

Letërsia shqipe e gjysmës së dytë të shekullit XX u pasurua nga një numër i madh autorësh liriko–epikë të një niveli të lartë: Dritëro Agolli (Devoll, Devoll, 1964), Ismail Kadare (Përse mendohen këto male, 1964), Llazar Siliqi (Prishtina, 1949), Fatos Arapi (Alarme të përgjakura, 1966), Kolë Jakova (Heronjtë e Vigut, 1953 – Cuca e Maleve, 1971), temat e të cilave frymëzoheshin nga vitaliteti historik i popullit shqiptar ku janë të shumta simbolet dhe metaforat poetike. Të mos harrojmë lëmin e novelës dhe të tregimit të ilustruar, të shkëlqyer, nga Dhimitër

Shuteriqi, Anastas Kondo ose Teodor Laço, duke përmendur këtu vetëm disa nga më të shquarit.

Më pas romani shqiptar zuri dalëngadalë një vend të rëndësishëm në letërsinë shqipe. Aty trajtohej fati i njeriut, mjedisi shoqëror dhe gjithçka që bënte pjesë në të, si raportet materiale dhe shpirtërore. Aty gjithashtu trajtohej e kaluara historike dhe kërkime perspektive në të ardhmen.

Kështu romanet e Ismail Kadaresë kanë patur një jehonë ndërkombëtare me "Gjeneralin e ushtrisë së vdekur", më pas "Daullet e shiut" dhe të tjera. Vepra e tij është e pashtershme, duke patur gjithmonë mjaft sukses. Autorë të tjerë, jo më pak të shquar, kanë patur gjithashtu sukses të madh, të tillë si Dritero Agolli (Komisari Memo), Jakov Xoxa (Juga e bardhë, Lumi i vdekur), Neshat Tozaj, Besnik Mustafaj etj.

Shënojmë se gjuha franceze ka lindur pas një ngjizjeje të gjatë, ku dygjuhësia vijoi afërsisht për pesëqind vjet (epoka galo-romake). Por Galët e braktisën gjuhën e tyre në përfitim të latinishtes. Mbërritja e Frankëve, popull gjermanik, e ndërlikoi edhe më shumë gjendjen. Gjuhëtarët i trajtojnë "Betimet e Strasburgut" të shpallura në vitin 842 nga dy nipat e Sharlemanjit (Luiz gjermaniku dhe Sharl tullaci) si shkallët e vërteta të lindjes së gjuhës frënge të shkruar. Megjithatë, qysh nga fundi i shekullit X frëngjishtja u bë gjuha e mbretit. Por ishte Fransua I, i cili në vitin 1539 nxorri Urdhëresën e Villers-Cotterets që paracaktonte përdorimin e gjuhës frënge në dokumentet zyrtare dhe në dokumentet e drejtësisë, duke zëvendësuar në këtë mënyrë gjuhën latine.

Për sa i takon letërsisë gojore në Shqipëri, ajo ngjitet deri në antikitetin më të hershëm dhe poemat e përmendura të Homerit, ja ku janë për ta dëshmuar këtë. Rapsodët ilirë vazhdojnë të jenë aktivë me artin e tyre poetik gojor në shoqërinë shqiptare. Kjo veçori tipike pellazgo-ilire u përçua gjithashtu te popujt sllavë që pushtuan Ilirinë nga fundi i shekullit VI pas Krishtit. Kjo traditë e pasur gojore gjendet gjithashtu në proverbat, fjalët e urta, elegjitë, këngët e akteve heroike

ose poemat e kreshnikëve, si në veri të Shqipërisë ashtu edhe në jug të saj. Në kulturën popullore shqiptare rigjendet gjithashtu tharmi i së kaluarës së saj mitike, legjendare dhe historike. Në zakonet fetare nuk mungon paganizmi, trashëgimi pellazge kjo, cilado qoftë feja që ushtrohet. Përveç kësaj, ende edhe sot feja për një shqiptar vlen më pak se shqiptarizmi i tij. Ja përse, pavarësisht ekzistencës së tri besimeve fetare (islam, ortodoks, katolik), në Shqipëri nuk ka patur kurrë as luftëra fetare as përplasje për shkak të ushtrimit të kultit; nuk është gjë e rrallë të shohësh myslimanët të respektojnë festat e të krishterëve si dhe anasjelltas!

Vaso Pashko (1825–1892), shkrimtar shqiptar i shekullit XIX, thoshte: "Feja e Shqiptarëve, është Shqiptaria". Gjithashtu ekzistojnë këngë historike, por që nuk shkojnë më tej se pushtimi otoman i fundit të shekullit XIV.

Tumulus ilir në Pazhok (Elbasan)
Epoka e Mesme e Bronzit

Poçe balte (Pazhok)
viti 1500 para Krishtit

Sëpatë bronzi
shqiptaro-dalmate (Shelcan)
Epoka e Bronzit

(Sipas "Shqipëria arkeologjike" – Tiranë – 1971)

Folklori shqiptar

Traditat popullore shqiptare kanë mbetur pak të ndjeshme ndaj prurjeve të jashtme, mbi të gjitha në krahinat malore të vendit. Larmia e këtyre traditave, dhe në veçanti larmia e kostumeve, këngëve dhe valleve është jashtëzakonisht e pasur. Ato pasqyrojnë zakonet e moçme të pellazgëve antikë dhe të pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë, thrako-ilirëve.

Folklori shqiptar është jo vetëm i pasur dhe i larmishëm, por formon një homogjenitet të tillë sa është befasues që të ketë arritur deri në ditët tona pa shumë stolisje dhe me shumë pak përpunime të shkaktuara nga kjo ekzistencë mijëvjeçare. Falë kësaj tërësie homogjene në kulturën popullore, të bashkuar me një lloj paprekshmërie të maleve të pamposhtura të Shqipërisë, vargu etno-kulturor i popullit pellazgo-ilir nuk është shkëputur dhe jeton përjetësisht në etninë e sotme shqiptare: ky popull i lashtë ka qenë mbrojtur nga shkombëtarizimi dhe nga shpërbërja e përgjithshme.

Kostumet kombëtare

Haberlandt [Die Volker Europas und ihre volkstümliche Kultur (Popujt e Europës dhe kultura e tyre popullore), Shtutgart - 1928] pohon: "Në Shqipëri gjenden pothuajse të gjitha kostumet që përdoren në Ballkan. Ndikimi i popullsive të lashta thrako-ilire dallohet lehtë në shumë kostume, zakone e rite të Ballkanit, Europës Qendrore, Italisë së Jugut (nga Roma deri në Kalabri dhe Sicili), përreth Dardaneleve, Detit Marmara, Thrakes, Epirit, ishujt e Greqisë dhe nga pak kudo nëpër Azinë e Vogël". Kjo që përshkruan Haberlandt pa e ditur, nuk është gjë tjetër veçse hapësira e madhe etnike e popullsive pellazge të Parahistorisë Europiane. Në të njëjtën hapësirë dhe në veçanti në Shqipërinë e veriut, baroni Franc Nopçe, etnolog hungarez, ka zhvilluar studime dhe hulumtime të shquara [Albanien, Bauten, Trachten und

Geräte Nordalbaniens (Shqiptarët, ndërtimet, kostumet dhe orenditë e Shqipërisë së Veriut, Laipzig 1925)].

Kostume të shumta përvijojnë një traditë shumëvjeçare. Në të vërtetë, disa veshje të veriut të Shqipërisë (Malësi) ngatërrohen me ato të mbajtura nga gratë e Etrurisë, Kretës ose Mikenës dhe që rigjenden në Ballkanin e pushtuar qysh në lashtësi nga popullsi me zanafillë pellazge, të tilla si thesprotët, panonianët, dardanët, triballët, dakët, mesianët, maqedonët ose ilirët (shumica e këtyre territoreve të zëna sot nga grekët, sllavët, bullgarët, hungarezët, turqit, ciganët...).

Shembulli më mbresëlënës është xhubleta, lloj kostumi i formuar nga një jelek i shkurtër (krahol), një përparëse, një copë e quajtur kërdhokël dhe nga një fund në formë kloshi të gjerë me pala të thella vertikale, gjë që dallohet shumë lehtë në ikonografinë etruske. Ky fund ishte i zbukuruar me kordele dhe me copa zhguni. Një tjetër kostum me zanafillë thrako-ilire është i përhapur në të gjithë Shqipërinë me variante lokale dhe rigjendet në Shpat, Mirditë, Dardhë, Mat, Zerqan ose Çermenikë. Me një fjalë, mund të themi se në Shqipëri çdo fshat i madh apo i vogël ka kostumin e tij.

Për sa u takon burrave, kostumet e tyre në përgjithësi mund të përmblidhen fillimisht me të famshmin tirq (emërtimi më i lashtë), që është një lloj pantallonash të ngushta (të zbukuruar me gajtan të zi në të dy anët dhe në brez) i prodhuar në të shumtën e rasteve me zhgun të leshtë të bardhë ose të zbërdhulët, që në veçanti mbahet nga shqiptarët e veriut dhe të Kosovës. Kjo veshje përvijon një traditë të vjetër pellazgo-ilire dhe mund ta ngatërrosh me braie*) e galëve. Përveç kësaj, kjo fjala e fundit shpjegohet nga thrako-ilirishtja brekë, brekushe. Tirqit vishen me një këmishë, një brez, një jelek (xhamadani) dhe një lloj tunike (xhurdi) të zezë. Këpucët e malësorëve të veriut quhen "opinga",

*) *lloj pantallona te galët dhe popujt gjermanikë.*

lloj këpuce sportive e thurur prej një cope të vetme lëkure, buzët e së cilës janë mbledhur dhe ngjitur te këmba duke formuar faqen e këpucës, e cila shtrëngohet përreth këmbës me disa rripa. Opingat mbaheshin kudo në të gjithë vendin. Përveç kësaj, në disa krahina, burrat mbajnë nganjëherë edhe dollakë.

Veshja më e spikatur e Jugut është fustanella e famshme, e cila vishet edhe nga epirotët e veriut të Greqisë. Është fjala për një lloj fundi burrash me rrudha dhe i kollarisur, shoqëruar me brezin dhe pantallonat deri te gjunjët. Një shembull i braies (tirq ilir) në Gali, kjo veshje çuditërisht gjendet edhe në Skoci (i famshmi kilt*)). Kjo të kujton gjithashtu kiloton bavareze. Ekzistojnë kostume të tjera burrash, ndër më të zakonshmit është ai i quajtur brekushe, një lloj pantallone prej leshi ose pambuku, shumë më i fryrë se tirqit. Edhe ato mbahen me këmishë, brez, jelek me mëngë apo pa mëngë.

Ja një tjetër veçori e lashtë: Shqiptarët, si ata të veriut dhe ata të jugut të vendit, kanë mbajtur gjithmonë një feste të bardhë ose të zbërdhulët (qeleshe) që ngjan me një lloj "pilos" antik (mikenian!): kjo të kujton festen frigjiane që gjendet në basorelievet e shumta të Antikitetit. Është me vlerë të vëmë në dukje se frigjianët ishin një popull me zanafillë pellazge dhe në veçanti thrake. Sipas rajoneve, kjo feste merr forma të shumta pak a shumë të hershme: gjysmësferike, tronkokonike (Alpet shqiptare të verilindjes, Mirditë, Mat dhe qendër) ose konike në pjesën tjetër të vendit.

Ky ndikim ka kapur si Veriun e Europës (Hiperboreanët e grekëve = Epër borët që do të thotë në shqip "ata që banojnë përtej borës) nëpërmjet keltëve, fis të një trungu me ilirët. Në të vërtetë, kostumet, disa rite dhe zakone (kelti, tiparet fizike...) si dhe mbetjet gjuhësore të Highlanders**) e galo-skocezëve gjenden në Shqipëri, provë e ekzistencës të një lidhjeje midis kulturës danubo-ilire dhe asaj kelte.

---

*) *Pjesë e veshjes popullore te skocezët, fund burrash me kuadrate dhe pala.*
**) *Malësorët.*

Sipas Apianit (Iliria 2, Maqedonia II) Keltos (etnonimi e keltëve), Ilirios (etnonimi e ilirëve) dhe Galos ose Galas (etnonimi e Galëve) janë vëllezër me prindër Galatean dhe Polifemin (ciklopi ose gjigandi i egër). Apiani e mbështet këtë legjendë të Theokritit (shekulli III para Krishtit / e gjashta dhe e njëmbëdhjeta Idile). Polibi pohon (Historia, II, 7, 5) se keltët dhe ilirët ishin nga i njëjti trung etnik. Në të vërtetë, lidhjet gjuhësore ekzistojnë midis gjuhës shqipe dhe gjuhëve me zanafillë kelte (galishtja, irlandishtja, anglishtja...) madje në disa raste edhe gjermanishtja. Simboli etnik (Breiz) te bretonët shpjegohet nga fjala shqip Bres (gegërisht) ose Brez (toskërisht) në kuptimin e brezit pasardhës. Fjalë të tjera ta kujtojnë këtë degëzim: door* (derë), hungry** (hangër), wail*** (vaj, vajtim), see **** (sy), bake***** (bukë), cow****** (kau) etj.

Vallet popullore

Një valle mitike është vallja gjithmonë e luajtur te shqiptarët e Kosovës: "pirrikja", e cila është valle luftëtarësh kretas, e krijuar nga kurretët (rojet mitike të Zeusit foshnjë) : Kosovarët ende edhe sot vallëzojnë me shpatat që i vringëllojnë në ajër. Në të vërtetë kurretët, të cilët i kanë dhënë emrin e tyre Kretës (Ku rretë, ku rretët, në dialektin gegë, do të thotë "ku u rrit", duke nënkuptuar Zeusin), luajtën një rol të rëndësishëm gjatë fëmijërisë së shkurtër të Zeusit: për të penguar Kronosin që të zbulojë vendin ku fshihej biri i tij, ata i fshihnin të qarat e foshnjës me vringëllimat e shpatave të tyre si dhe gjatë kohës që

---

*) *Këtu është fjala për shqiptimin e këtyre fjalëve që përkon me atë të gjuhës shqipe, pra dor (derë).*
**) " " ", *pra: hangri (hangër)*
***) "" ", *pra: ueil (vaj, vajtoj)*
****) """, *pra: si (sy)*
*****) """, *pra: beik (bukë)*
******) " "", *pra: kau (kau)*

pinte qumështin e Amalteas (dhia që ushqeu Zeusin e vogël: "e mielta" që do të thotë në shqip foshnja që "pi qumësht").

Dorianët, gjatë qëndrimit të tyre në Kretë, e shpien në Spartë këtë valle luftëtarësh. Aleksandri i Madh (një tjetër thrako-ilir i shquar) përpara se të lëshohej kundër persëve kërceu vallen pirrike. Jul Cezari, i cili qëndroi në Ilirinë e Jugut (Shqipëria e sotme) dhe i joshur nga kjo valle e bëri të njohur atë në Itali. Albanologu Thelloczi pohon se ilirët vallëzonin me shpatë në dorë, ashtu si bëjnë shqiptarët sot (në veçanti në Kosovë dhe në Shqipërinë e Veriut).

Aty has lloje të shumta vallëzimesh: çdo krahinë ka vallen e saj. Në Veri ekzistojnë valle që kërcehen me një valltar të vetëm, me dy ose me tre valltarë (dy burra dhe një grua ose dy gra dhe një burrë). Përveç kësaj, në malësitë e Shqipërisë së Veriut vallëzohet në heshtje logu (valle e "fushës së mbyllur"), pa shoqërim muzikor, por vetëm me ritmin e lëvizjeve trupore : vallëzim i lashtë me rezonanca antike të atyre kohëve kur vendi ishte vazhdimisht nën përgjim dhe ku duhej të ishe i matur për të mos tërhequr vëmendjen e pushtuesit të huaj. Në verilindje kërcehet kapuça dhe filxhani, lloje vallesh humoristike. Vallet në grup, të cilat në veçanti kërcehen nga katër valltarë, janë mbi të gjitha të përhapura në jug të vendit. Por rrotullorja, një lloj rrumbullake, kërcehet kudo në Shqipëri, natyrisht me disa variante. Tërkusalla kërcehet nga shqiptarët e Italisë (arbëreshët) dhe është fjala për një valle në grup dhe me figura të shumta.

Uniteti i traditës shqiptare gjendet në fushat folklorike, kulturore dhe artistike, ndër të cilat elementët e përbashkët të kujtojnë traditat e zakoneve të stërgjyshërve, bëmat heroike apo ngjarjet historike, etj.

Muzika dhe këngët tradicionale

Për sa i takon muzikës, trashëgimia pellazgo-ilire ka mbetur e gjallë në Ilirinë e Veriut (sot e pushtuar nga popullsitë me zanafillë sllave)

pastaj në Ilirinë e Jugut (Shqipëria e sotme dhe krahinat në kufi). Autorë të shumtë antikë dëshmojnë se mjeshtrit ilirë zinin një vend nderi në artin muzikor (liriko-epik), që nga antikiteti i hershëm (Iliada dhe Odiseja janë një shembull befasues). Kulti i muzave, legjendat dhe mitet, shumë të gjalla në Iliri i frymëzonin poetët epikë, rapsodët dhe bardët*) ose muzikantët shëtitës. Këngët epike dhe këngët e kreshnikëve të kënduara nga rapsodët shqiptarë ruajnë ashtu si në antikitet, kujtimin gojor të ngjarjeve heroike, individuale, familjare ose fakte historike. Ekziston një repertor i pasur lirik (këngë të larmishme) të kompozuara si këngë dashurie, fejesash, dasmash si dhe elegji të kënduara, këngë për fëmijë (këngë djepi), këngë për ngjarje të ndryshme (luftë, ekzil, revoltë, pavarësi...). Ekzistojnë gjithashtu këngë humoristike dhe satirike (bejte dhe shpoti). Së fundi këngët rituale nuk mbeten pas. Ato i gjejmë në veçanti në repertorin liturgjik të shqiptarëve katolikë dhe ortodoksë. Në Shqipëri çdo ngjarje festohej me një këngë.

Duke e skematizuar, themi se ekzistojnë dy lloje muzike tipike shqiptare: në veri muzika homofonike (gegët) me këngët e tyre karakteristike Majekrahi, dhe në jug muzika polifonike (toskët), me grupe këngëtarësh me dy deri në katër zëra. Këtu në mënyrë paradoksale gjejmë të njëjtën kundërshti që ndan dy komunitetet, të cilat përbëjnë etninë shqiptare (Toskë dhe Gegë), pamja fizike e të cilëve (më e vërtetë dje dhe gjithmonë e më pak sot, për shkak të përzierjeve të ndryshme ndëretnike ose të huaja) dhe dialektet janë gjithashtu të ndryshme!

Ja instrumentet me një tel ose me më shumë tela më të përdorura: çifteli, çiri, bakllama, jongari, kalushuni; dhe ato me hark: lahutë, lauri. Instrumentet frymore përbëhen nga lloje të shumta fyejsh me një ose me dy pipa (bicule), pipëz dhe instrumente të tjera si curle, gajde. Instrumentet me goditje janë: lodra, poçi, qypi, tumbullaci, dajrja, daullja. Duhet shënuar se polifonia pellazgo-ilire është përcjellë në

*) *Poet i lashtë kelt që këndonte bëmat e heronjve*

vendet ose ndër popuj të lashtë pellazgo-etruskë (Korsikë), pellazgo-iberikë (Vendet Baske) dhe pellazgo-ilirë (Epir).

Muzikologët modernë dëshmojnë se niveli artistik i këngëve shqiptare është një nga shembujt më karakteristikë të muzikës tradicionale ballkanike.

Mesjeta e Hershme duket se mbetet e heshtur në lidhje me historinë dhe muzikën e kësaj periudhe. Gjithsesi në shekullin IV një muzikant iliro-shqiptar, Niketa Ramezianes dallohet për kompozimin e hynit të famshëm "Te deum Laudamus" dhe të disa këngëve. Pastaj arrin pushtimi Bizant dhe kalojnë disa shekuj pa patur as edhe zbulimin më të vogël në këtë fushë. Megjithatë rreth viteve 1070-1075 Gjon Kukuzeli, lindur në Durrës, shfaqet si një mjeshtër i shquar në muzikën bizantine. Ai u bë mjeshtri i kishëzës në pallatin perandorak të Kostandinopojës, por u tërhoq në manastirin e malit Atos, ku iu përkushtua studimeve muzikore. Përveç talentit të tij si kompozitor, këngëtar dhe teoricien ai u dallua si reformator gjenial, i cili hapi rrugën drejt një zhvillimi të ri muzikor. Ai ishte kompozitori më i shquar muzikës fetare bizantine (psalme, lavde...).

Pushtimi otoman duket se nuk ka qenë aspak fatlum për lulëzimin e muzikantëve të rinj. Në shekullin XVIII veprimtaria muzikore fillon të zhvillohet falë krijimit të grupeve muzikore, bandave muzikore ose orkestrave simfonike. Vetëm arkivat kishtare kanë ruajtur gjurmë të kësaj veprimtarie muzikore ku zbulohet identiteti i disa himnografëve të tillë si Gjergj Papazimo, Grigor Manasi (shekulli XVIII) dhe Krisanthi Maditi, peshkopi i vjetër i Durrësit (fillimi i shekullit XIX). Ky i fundit u dallua në muzikë dhe muzikologji duke botuar studime mbi muzikën bizantine, duke krijuar koret kishtare dhe duke përgatitur ithtarë të shumtë. Një shkollë muzike u krijua në Shkodër në vitin 1878. Palok Kurti i kësaj epoke ka lënë disa kompozime vokale dhe instrumentale. Në shekullin XX Thoma Nasi u shqua për veprimtarinë e madhe muzikore dhe në vitin 1920 krijoi "Vatrën", ansambël orkestral

instrumentesh frymore. Në këtë periudhë Fan Noli, klerik, poet, burrë shteti dhe muzikant, kompozoi në ekzil poemat simfonike me tema tipike shqiptare. Ai botoi një studim muzikor me titull [Beethoven et la Revolucion française "Bethoveni dhe Revolucioni francez"].

Artet skenike dhe kinematografike.

Qysh prej vitit 1947 deri në vitet '60, regjimi komunist i dha një shtysë të re veprimtarive muzikore dhe artistike në Shqipëri: krijimi i orkestrës filarmonike, i liceut artistik, shkolla të shumta të mesme artistike dhe institutin e Lartë të Arteve, teatrin e Operës etj.). Kjo periudhë nxjerr kompozitorë të tillë si Kristo Kono, Prenk Jakova, Tish Daia, P. Dungu, Tonin Harapi, Nikolla Zoraqi, Kozma Lara, Aleko Prodani, A. Grimci, V. Nova, P. Gaci etj. Në vitin 1963 Tish Daia shfaqi baletin e parë shqiptar "Halili dhe Hajria" sipas dramës së Kolë Jakovës dhe me koreografi të Panajot Kanaçit, etj.

Në mars të vitit 1947 arrihet realizimi i filmit dokumentar të parë shqiptar: kjo është lindja e artit kinematografik në Shqipëri. Në vitin 1951 krijohet një studio kinematografike në Shqipëri "Shqipëria e Re". Filmi i parë me metrazh të shkurtër i titulluar "Fëmijët e saj" u realizua në vitin 1957 dhe filmi i parë me metrazh të gjatë "Tana" (sipas romanit të F. Gjatës) u realizua në vitin 1958.

Artet figurative, dekorative dhe arkitekturore.

Arti figurativ dhe arkitektura janë trashëgimtare të një tradite të lashtë autoktone që ngjitet deri te Pellazgët e lashtë dhe pasardhësit e tyre thrako-ilirë. Në fakt gërmimet arkeologjike kanë zbuluar objekte që shkojnë deri në periudhën neolitike (6 000 vjet para Krishtit): qeramikë antropomorfe, objekte kulti zanafillore (Cakran-Dunavac), orendi të pikturuara me motive gjeometrike (Maliq-Kamnik, të cilat

datojnë qysh nga neolitiku i vonshëm), objekte prej balte të pjekur (Maliq). Në Epokën e Bronzit ky art u zhvillua në vijimësi për të arritur në një përkryerje zanafillore (kupa me vegjë...) të cilat u përcollën ndër fiset ilire të Epokës së Hekurit. Tumulat e zbuluara nga pak kudo në vend dhe në rrethinat zbulojnë qeramika të shumta me forma të ndryshme (Barç, Pazhok, Kuç i zi...). Armët e zbuluara janë të gdhendura me motive antropomorfe. Përveç disa kolonive të pakta greke në bregdetin adriatik, ku është ruajtur karakteri i tyre helen (Durrës, Apolloni, Orikum, Butrint), ilirët nga ana e tyre kanë zhvilluar një art zanafillor: porta antike me hark të theksuar – (Çuka e Aitoit), portat gjigande (Dimal – Zgërdhesh), teatro, hipodrome (Amantia), varre monumentale (Selcë e Poshtme), statuja përkujtimore, armatime tepër të zbukuruara etj. Mozaiku më i lashte është zbuluar në Durrës (shekulli III para Krishtit).

Me ardhjen e kristianizmit, Mesjeta e Hershme zbulon thesare të rëndësishme paleokristiane (toka e mbuluar me mozaikë të bukur – që paraqesin bimë, lule, vreshta, zogj, peshq, bletë - nëpër bazilikat e para: Lin në brigjet e liqenit të Ohrit, baptisteri i Butrintit...). Por në Shqipëri shihet të rilindë një kulturë e shquar midis shekujve VI dhe VIII: ajo e Komanit. Kjo kulturë dallohet nga punimi i metaleve (bronz, argjend dhe ar), vathë, punime në kockë dhe objekte të tjera të zbukuruara me vizatime, të cilat tregojnë figurën e gruas, kalit etj.

Arkitektura mesjetare është e stilit bizantin në jug të vendit dhe e stilit romak në veri: katedralja e Perrhondit (shekulli XI), Kisha e Shën Nikollës në Mesopotam (shekulli XIII), Kisha e Shën Mërisë në Pojan (shekulli XIII), kisha e Shën Mëhillit dhe Kisha e Shën Triadës në Berat (shekulli XVI) etj. Gjenden ikona të shkëlqyera që datojnë nga shekulli XIII dhe XIV si dhe piktura murale (manastiri i Pojanit 1261–1328). Në vitin 1373, artisti Gjergj Araniti krijon epitafin e mbiquajtur epitafi i Gllavenicës, kryevepër me një vlerë shumë të madhe artistike dhe historike. Nganjëherë arti autokton shqiptar ndërthuret me stilin bizantin ose oriental.

Pushtimi turk, shumë shpejt e ndaloi pak zhvillimin kulturor dhe artistik në të gjithë vendin. Por duke filluar nga shekulli XVI lindi një lloj rilindje kulturore. Piktori i madh Onufri, me zanafillë nga Berati, i cili punonte në Elbasan, krijoi disa kryevepra dhe në veçanti pikturat murale dhe ikonat në Berat, Elbasan ose në Kostur të Greqisë. Biri i tij, Nikolla e zëvendëson (shekulli XVI dhe fillimi i shekullit XVII) dhe ndjek veprën e babait të tij. Ai ka realizuar afresket e manastirit të Shën Gjergjit të Arbanas në Bullgari. Në vitin 1726 David Selenikasi picturoi brendshmën e kishës Shën Nikolla në Voskopoj. Ndërsa Shpataraku realizoi në vitin 1744 ikonostasin e manastirit të Ardenicës. Në vitin 1770 Anastas Zografi pikturoi "Kryqëzimi" në Kishën Burimi i Krishtit, udhës duke shkuar për në Korçë. Pikturat e ikonostasit të katedrales së Elbasanit janë realizuar në vitin 1828 nga Mihal Anagnosti.

Vendet e kultit mysliman fillojnë e shfaqen në fillim të shekullit XVI: xhamia e Plumbtë në Shkodër (ndërtesë unike e ndërtuar me gur dhe me oborr të përmbyllur) është një imitim i artit arabo-mysliman (1774), xhamia e Et-hem Beut në Tiranë (1794), xhamia e mbretit në Elbasan (1492) xhamia e Mirahorit në Korçë (1496) dhe teqeja e Helvetisë në Berat paraqesin elemente të artit popullor shqiptar (shekulli XVIII).

Banesa tradicionale

Shtëpitë në krahinat malore të veriut të vendit janë të tipit alpin: në formë drejtkëndore, të ndërtuara me gur, me një çati me shumë pjerrësi të mbuluara me pllaka të mëdha guri. Në jug dhe në bregdet shtëpitë janë në përgjithësi të tipit mesdhetar. Ndërtesa më karakteristike në Shqipëri është Kulla, e cila sipas rastit dhe klasës shoqërore të pronarit mund të përcaktohet kështjellë, kryekullë, apo çiflig. Kjo lloj banese, e fortifikuar është tipike në veri të Shqipërisë dhe në veçanti në krahinat e Matit, Mirditës, Lumës, Kukësit ose në Kosovë. Shtëpitë borgjeze

(qytetare) datojnë nga shekulli XIX dhe hasen në qytetet e mëdha të Shqipërisë.

Në shekullin XVIII dhe XIX në Shqipëri dhe në veçanti në jug mori hov një arkitekturë zanafillore dhe popullore: Berati me shtëpitë e tij me çardak, katedralja (1850) dhe rrugët (shtruar me kalldrëm) e tij e bëjnë këtë qytet një muze të vërtetë arkitekture. Arkitektët, artistët dhe gdhendësit shqiptarë ishin të njohur në të gjithë Ballkanin. Duhet shënuar se në këtë epokë prodhimi i armëve ishte tepër i zhvilluar dhe gëzonte një famë të shkëlqyer: pistoletat, pushkët, jataganët me zbukurime të ndryshme dhe të realizuara në filigran në Shkodër, Prizren dhe Elbasan. Të gjitha zbukurimet me gurë dhe metal (ar dhe argjend) të kësaj periudhe ruajnë të njëjtat motive të kulturës shqiptare të Mesjetës së Hershme.

Doket dhe zakonet, kultura popullore dhe aspekte etnike

Përpara se të shpalosim aspektin etno-kulturor, është interesante të dimë se si të huajt i shihnin apo i gjykonin shqiptarët përpara Luftës II Botërore, d.m.th përpara ardhjes së komunizmit [përpara se komunizmi të kishte ideuar të famshmin njeriu i ri, kjo kulturë masash, të cilën pjesa më e madhe e vendeve të Lindjes (perdja e hekurt) u përpoqën ta nxitin gjatë pothuajse 45 vjetësh].

Në të vërtetë ekzistojnë disa ndryshime (me përjashtime) midis shqiptarëve të lindur pas luftës dhe atyre të lindur para ardhjes se komunizmit, rreth fundit të Luftës II Botërore. Të rinjtë nuk kanë të njëjtat vlera dhe orientime si të parët e tyre. Në edukimin dhe arsimin që ata kanë marrë, shumë pjesë të historisë, apo nocione të filozofisë, metafizikës dhe të fushave të tjera kanë qenë plotësisht të fshehura. Pesëdhjetë vjet komunizëm me gjithë atë që solli, shtrëngese ideologjike, mashtrime, kufizime, pengimi i lirisë (së fjalës së lirë, pronës private etj.) e kanë ravijëzuar individin dhe e kanë tjetërsuar nga ana shoqërore

dhe psikologjike mënyrën e të jetuarit dhe të menduarit ose të sjelljes: kjo është e qartë si drita e diellit dhe ne i kemi ndjerë qysh me rënien e komunizmit në fillim të viteve '90. Do të duhet shumë kohë që shqiptarët të rigjejnë, si të thuash, gjenet e tyre zanafillorë të vëna në përgjumje gjatë pesëdhjetë viteve të fundit.

Ja pra një shpalosje e vrojtimeve dhe e vlerësimeve të disa studiuesve (shekulli XIX dhe në fillim të shekullit XX) gjatë udhëtimeve të tyre të gjata në Shqipëri dhe nëpër krahinat shqipfolëse: të cilat edhe më shumë na japin në mënyrë konkrete të dhëna mbi shqiptarët e kohëve të moçme.

Berard (1893): "Ekziston në gadishullin Ballkanik një popull që kurrë nuk ka jetuar as vetëm, as për veten, por roli i tij përgjatë shekujve ka qenë që t`i japë pa reshtur kombeve fqinje lëndën humane. Shqipëria ka qenë burimi ku grekët dhe romakët, bizantinët dhe turqit kanë marrë njëri pas tjetrit. Herë-herë në formën e një lloji protoplasmik, dua të them në një masë jo të organizuar, raca shqiptare ka mbushur boshllëqet e krijuara nga luftërat ose nga rënia e botës orientale. Përkundrazi ndonjëherë ajo është lartësuar, është personifikuar si një njeri i madh, dora e të cilit, qoftë Mehmet Aliu, Skënderbeu, Pirro, Ali Pashë Tepelena, të përhapur në çdo skaj të botës dhe të cilët lanë vulën e tyre ndër popujt e përkulur përpara gjenisë së tyre".

Burkart (1921): "Në Ballkan, Shqipëria në pak kohë, me ndihmën pa interes të disa shteteve perëndimore, mund të vijojë udhën e saj dhe madje në pak kohë të rimarrë vendin e saj, të cilin furtunat e historisë së saj ia kanë rrëmbyer... Kam mbetur i befasuar nga lehtësia me të cilën jemi kuptuar, shqiptari dhe francezi. Shpirti i tyre është i një karakteri perëndimor, shumë i gjallë dhe shumë kureshtar, kanë karakter të sinqertë dhe gazmor, të gatshëm për të besuar dhe për të lidhur miqësi."

Gabriel Hanoto (1913) në parathënien e librit "Shqipëria e panjohur" të Gabriel - Luiz Zhare shkruan: "Ky popull gjithmonë i ri, është një popull shumë i lashtë".

Gabriel – Luiz Zhare: "Vendi dhe njerëzit të cilët kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në historinë tonë të së kaluarës, të sotmes dhe të së ardhmes, gjithsesi kanë mbetur të panjohur... Një popullsi luftëtare, energjike, e pavarur dhe e tërhequr, malësorë të shkathët dhe guximtarë, burra të gjithë të armatosur me pushkë... të cilët para çdo gjëje duan të jenë të lirë, të jetojnë sipas zakoneve të tyre tradicionale dhe t`i kundërvihen çfarëdo lloj pushteti të huaj... të tillë i shfaqeshin udhëtarit këta banorë të malësive të Shqipërisë së Veriut... dhe deri në vitin 1912 madje nuk ishin marrë vesh midis tyre, i tillë është ky komb me të cilin Turqisë iu desh të merrej për shekuj me radhë dhe me të cilin tashmë do t`i duhet të merret Europa – sepse në Shqipëri mbizotëron fryma kombëtare mbi gjithçka, madje edhe mbi fenë... ata janë ndryshe nga myslimanët dhe kjo racë e hedh poshtë aksiomën sipas së cilës "në Orient fetë janë kombe dhe kombet janë fetë".

Xhustin Godart (1922): "Fat i veçantë dhe tragjik; shqiptarët, viktimat shekullore, megjithatë të paepur, të Perandorisë Otomane nuk kanë qenë trajtuar si nënshtetas turq nga Fuqitë e Mëdha. Ata mund të thoshin sa të donin që kanë rezistuar shumë mirë mbizotërimit, duke ruajtur zakonet, fenë, gjuhën, racën, personalitetin dhe më në fund ajo që dallohet nga të gjithë të tjerat, por fuqitë e Mëdha e panë më të udhës që t`i shpërfillin, qoftë për t`i braktisur, qoftë për t`i zhvatur, qoftë për t`i dhënë si monedhë këmbimi atij që ka kërkesë të fortë ose atij qe jep çmimin më të mirë apo më të shtrenjtë në tregjet ndërkombëtare... Ajo do të tërheqë udhëtarë, turistë, artistë të të gjithë botës, miq të lirisë do të vinë këtu në shtegtim; vend i trishtë, i padrejtësisë dhe i vuajtjeve për shekuj me radhë, ajo do të bëhet toka e premtuar e optimizmit".

Rozher (1922): "Shpirti shqiptar, por jemi ne që kemi nevojë për trimërinë e tij, besnikërinë e tij... Respekti për fjalën e dhënë, besa, e ka bërë proverbiale ndershmërinë e shqiptarëve. Ata e trajtojnë mikpritjen si një rit të shenjtë. Ata nuk dinë si ta falënderojnë mikun që e ka nderuar duke kaluar pragun e shtëpisë së tyre".

Sipas Bihan: Tushët e Kaukazit kanë shumë përqasje me shqiptarët dhe në veçanti në zakonet e tyre stërgjyshore si dhe orenditë prej druri të disa fiseve gjeorgjiane ishin të ngjashme me ato të shqiptarëve".

Pukvil (1805): "Përveç trimërisë, gjë që është e natyrshme për shqiptarët, ata kanë edhe një karakter tepër të çiltër".

Dumon (1872): "... ata (shqiptarët) japin dhe harrojnë, marrin dhe përsëri harrojnë: të lumtur që japin dhe të lumtur që marrin". Dhe në lidhje me Epirin (1872): "Shihet kudo në Epir vetëm një lloj ndërtimi dhe këto janë muret të quajtura pellazge ose ciklopike. Në këtë krahinë ato janë më të shumtë se në çdo vend tjetër të botës së lashtë; për arkeologun paraqet një interes të madh një udhëtim në këto vise. Në një luginë të vetme të Paramithisë gjenden dhjetë ose dymbëdhjetë mure rrethues të këtij lloji. Ato, gjithashtu, janë po aq të shpeshta në të

MALIQ: Figurë në terakotë
(sipas "Shqipëria arkeologjike" - Tiranë - 1971)

dy brigjet e lumit Aous (Ahelous); në të gjithë Epirin numërohen me qindra. Kjo arkitekturë madje ka lënë qytete të tjera në këtë vend, si qyteti i Kastricës ku muret, rrugët, themelet e shtëpive na tregojnë se duhet të ketë qenë një qytet ciklopik... Shqiptari dallohet menjëherë: koka e vogël, hundë fine, sy të gjallë, të hapur në formë bajame, qafë të gjatë, trup të hollë, këmbë të gjata dhe të formuara, duke të kujtuar kështu tipin e grekut të parë, atë që statuja arkaike ka paraqitur në mermerët e Eginës".

Ja çfarë i shkruante Lord Bajroni më 11/11/1809 nënës së tij në lidhje me Ali Pashë Tepelenën: "... ka qenë një luftëtar i madh ... Bonaparti i dërgoi një kuti duhani me portretin e tij. Ai i përgjigjet se kutia e duhanit ishte shumë e mirë, por nuk donte të fliste për portretin sepse atij nuk i pëlqente asnjë tjetër më shumë se sa origjinali".

Dora d'Istria (1886, shkrimtare rumune me zanafillë shqiptare dhe që rridhte nga familja e shquar Gjika) shprehet: "Shqiptari ka një natyrë aristokrate".

D'Esturnel de Konstant (1920): "Shqipëria më duket ajo që është, një vend i braktisur nga qytetërimi, por i privilegjuar nga natyra".

A. Bop (Shqipëria dhe Napoloni, 1914): "Ishin harruar lidhjet e ngushta të viteve 1612-1619 të Dukës së Neversit të mbajtura me bejlerët shqiptarë, të cilët ai kishte kërkuar t`i stërviste në kryqëzatën e tij kundër turqve.... Nën mbretërimin e Luigjit XIV dhe Luigjit XV Franca kishte dërguar në Durrës një punonjës të konsullatës së Selanikut në mënyrë që të lehtësonte transportin e telegrameve të mbretit.... Dihet vetëm se arsenali i Tulonit merrte nga kjo krahinë e jugut të Shqipërisë drurët më të mirë që përdoreshin në ndërtimet e anijeve tona... Çfarë do të ishin bërë shqiptarët, në qoftë se projektet e ravijëzuara nëpërmjet një njohje kaq të plotë të karakterit oriental nga Donzeloti dhe nga Minoti të kishin arritur të realizoheshin, nëse garda shqiptare që ata patën ëndërruar për një moment t`ia jepnin Perandorisë të kishte qenë dekretuar? ... Letra e Minotit ministrit të Luftës: nëse kjo mënyrë ia

dilte mbanë, Perandori [Napoloni] nuk do të kishte patur pranë tij ushtarë më besnikë, më të përkushtuar, më të matur dhe më të palodhur... Më 25.12.1807 nën emrin "Regjimenti shqiptar", ai ngriti një trupë ushtarake që përfshinte tri batalione prej nëntë kompanish. Me një shtatmadhori prej 14 oficerësh dhe një numër trupash prej 3254 burra".

Po e përfundoj këtu këtë mori përshkrimesh me disa pjesë të nxjerra nga shkrimet shumë domethënëse të Albert Dymont të marra nga Revista e dy Botëve e datës 1/ll/1872:

"Nuk ka në Europë racë më të lashtë se shqiptarët. Asnjë dëshmi klasike nuk flet për epokën kur ata arritën në Ballkan: ata duhet të kenë qenë vendosur aty qysh në kohë shumë të hershme, përpara se pushtuesit sllavë të zbrisnin nga Danubi: ata, pa dyshim, kanë qenë aty shumë shekuj më parë... Nën këtë emër, Ilirë, ata përfshijnë popullsitë e shumta në numër që banonin në veri të Epirit, midis Adriatikut dhe Maqedonisë. Shqiptarët, të cilët dikur zinin hapësira shumë më të mëdha - në të vërtetë gjenden emra qytetesh që i përkasin gjuhës së tyre në zona ku shihen vetëm serbë ose bullgarë – janë mbetjet e fundit, sipas të gjitha gjasave, të kësaj popullsie zanafillore... Shqiptarët e malësive kurrë nuk i janë nënshtruar ndonjë të huaji. Grekët e lashtë i pushtuan vetëm skajet, atje ku ata kishin qytete të rëndësishme si Apolonia dhe Durrësi. Romakët i lanë këto fise të lira; as perandorët e Kostandinopojës as dinastitë e Rashive nuk patën pretendime për t`i qeverisur. Sot shqiptarët njohin pushtetin e Portës së Lartë, por jetojnë sipas mënyrës së tyre... Perëndia është një gjeni bamirës, por jo i një natyre të plotfuqishme: Perënditë mund të jenë të shumta; është kjo që shpjegon pavendosmërinë ndaj besimit fetar, gjë që të befason kaq shumë në Shqipëri, ku shpesh është e vështirë të dish nëse një banor është i krishterë apo mysliman. Nga kjo kuptohet edhe lehtësia me të cilën u kthyen në myslimanë gjysma e Pashallëkut të Shkodrës në shekullin XVI si dhe ndërrimet apo heqja dorë nga feja në një numër kaq të madh. Shqipëria është jofetare ose më mirë nuk mendon për

fenë... myslimanët shkojnë të vizitojnë priftin e krishterë, shkojnë në panegjirikët e Shën Gjergjit, mbi të gjitha në festën e Krishtlindjeve ndezin qirinj te Shën Nikolla... Me të mbaruar gostia, plaku merr guzlan dhe luan edhe ai ndërkohë që të rinjtë luajnë e ka kush e ka ose symbyllazi apo mblidhen për kolon, në këtë valle të lashtë ku burrat mbahen për dore dhe të japin idenë e kalimit të viktimave nëpër labirintin e Kretës. Kësisoj gjithçka të sjell kujtimin e përshkrimeve homerike... Dihet mjaft mirë se cila ka qenë historia e këtij populli; ai kurrë nuk është përzier apo mahnitur nga ndonjë racë tjetër, që më pas ta imitonte; nuk është parë kurrë për një kohë të gjatë që t`i imponohej ndonjë qytetërim i huaj... Në kapitujt e parë të këtyre studimeve, populli kaq i panjohur, i cili ruan imazhin më të plotë të asaj çfarë kanë qenë të parët e racës greke dhe latine, do të meritojë gjithmonë vëmendjen e historianit; ai do të mbetet si dëshmitar i gjallë i një të kaluare, për të cilën besohet se është zhdukur. Nëse është kështu në lidhje me zanafillat, shkenca duhet të mbetet për një kohë të gjatë e pasigurt, të paktën ajo të thotë se asnjë komb në Europë nuk ka zakone më të lashta; gjithashtu t`ua shpjegojë si çudi atyre që do të fillojnë t`i studiojnë si dijetarë të mirëfilltë se për këto fise të malësive mund të mendohet se kanë qenë mbetje të kësaj race misterioze të Pellazgëve, racë që e rigjejmë në lindjen e dy qytetërimeve më të larta të botës së vjetër [qytetërimi grek dhe ai romak], si të lindurit e parë nga natyra, fëmijët që do të krijojnë që në fillim, qysh se u davaritën mugëtirat e kaosit, pra ata që krijuan perënditë më të nderuara antike, Detin dhe kupën qiellore."

Ne kemi hedhur një vështrim të gjerë mbi disa tipare të karakterit ose mbi sjelljen e shqiptarëve dhe një pamje të përgjithshme mbi vendin dhe historinë e tij të lashtë, falë vrojtimit të vëmendshëm të udhëtarëve të shumtë të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX.

Nuk mund të flasësh për doket dhe zakonet pa përmendur të famshmin Kanun, një lloj ligji apo rregullash zakonore. Lek (Aleksandër) Dukagjini (shekulli XV), një fisnik bashkëkohës i

Skënderbeut, i përpiloi për t'i imponuar bashkatdhetarëve të tij një drejtësi dhe ligje të mirëfillta shqiptare dhe për tu bërë të mundur që t'i shpëtonin ligjit turk (sharia otoman). Kanuni u kodifikua në vitin 1913 nga murgu shqiptar Shtjefën Gjeçovi i urdhrit Françeskan. Ai përfshin 12 Libra dhe 1263 nene. Ky kanun, i quajtur dikur zakoni ose tradita e vjetër gojore, ishte në zbatim në veçanti në malësitë e Shqipërisë së Veriut (Malësi dhe Malësi e Madhe). U desh pra të bëhej me shkrim tërësia e normave, kodeve dhe zakoneve të të moçmëve (e llojit E Drejta Zakonore) që bën të mundur të vihet rregull dhe për të qeverisur të gjitha aspektet e jetës në malësi (mikpritja, familja, martesa, fejesa, vdekja, administrimi i pasurisë së përbashkët, organizimi shoqëror, krimet, hakmarrja etj.): një lloj kodi civil dhe penal i parakohshëm.

Gjithsesi, guri themeltar i këtij sistemi ligjesh zakonore është respekti për dinjitetin njerëzor dhe besa e famshme (respekti për fjalën e dhënë): Libri VIII i është kushtuar krejtësisht kësaj. Besa është e shenjtë te shqiptarët dhe shtrihej në fusha të ndryshme, siç ishin: lidhjet individuale ose të bashkësisë, kontaktet tregtare, huaja, depozitat, dorëzimi dhe bashkësia e pasurive, mbrojtja reciproke, marrëveshja për armëpushim, vënia në provë, kontrata me shkrim etj. Mosmbajtja e fjalës së dhënë rrezikon dëbimin, shkishërimin në rastet më të lehta ose dënimin me vdekje në rastet më të rënda. Kush dëbohej nuk mund të jetonte më në fshatin e tij. Duhet shënuar edhe një fakt shumë i rëndësishëm: kanuni nuk bën asnjë dallim mes burrave dhe as midis burrit dhe gruas: "çdo njeri është i barabartë para Zotit".

Të mos harrojmë hakmarrjen që është tipike në traditën shqiptare, e cila ka qenë përcjellë (për fat të keq) me kalimin e kohës në vendet e tjera ose popujt e rajonit (Kalabri, Sicili, Sardenjë, apo Korsikë). Në Kanun thuhet shprehimisht, se "fyerja ndaj nderit nuk shlyhet me të mira materiale, por me gjak ose me falje (e biseduar nga ndërmjetësit)". Hakmarrja është e kodifikuar me përpikëri nga një mori modalitetesh: p.sh. burri nuk duhet të vritet në prani të gruas së tij; vrasësi duhet të

jetë i pranishëm në varrimin e viktimës së tij; çdo burrë i familjes që ka arritur moshën për të mbajtur armën lejohet të kryejë hakmarrjen dhe kjo, hakmarrja, vijon deri në shtatë breza etj. Me pak fjalë, jeta njerëzore shlyhet nga një jetë tjetër njerëzore, e zgjedhur nga familja e agresorit

Ky Kanun është një traditë pothuajse unike në Ballkan. Qysh nga kohët më të hershme dhe deri në ardhjen e mbretit Zog në vitin 1928 (ai ia doli mbanë këtij veprimi të veshtirë) jeta e popullsisë ishte e organizuar nëpërmjet ligjeve zakonore, të përcjella gojarisht deri në shekullin XV dhe pastaj u transkriptua nga Lek Dukagjini, i cili i dha edhe emrin kanun (ky emër të kujton të drejtën "kanon" të të krishterëve). Gjithsesi ekzistojnë versione të ndryshme dhe në Shqipërinë e Jugut ky lloj corpus juris ose e drejta zakonore quhet "zakona" pra "zakoni traditat" (p.sh ai i Idriz Sulit) si dhe në veri qysh në kohën e Lek Dukagjinit ruan emrin "kanun" (p.sh. ata të Kurbinit, Bendes, Tamadhës, Martaneshit, Çermenikës, Dibrës), etj. Ky kanun i ka rrënjët në të kaluarën e largët të traditave pellazgo–ilire, të cilat vetëm Shqiptarët kanë mundur t`i ruajnë deri në ditët tona. As kristianizmi as islami, as komunizmi nuk mundën t`i fshinin ato. Në të vërtetë dyzetë e pesë vjet komunizëm kanë shënuar një ndalesë në këtë traditë të një epoke tjetër, por për fat të keq me rënien e autoritetit të Shtetit dhe zakoneve, pas rënies së komunizmit dhe falimentimit të sistemit ekonomiko–shoqëror, kanuni ka filluar të zbatohet dhe hakmarrja është rishfaqur në Shqipëri, në veçanti në Veri dhe Lindje të vendit.

Ja një tjetër traditë, mijëvjeçare, e vetme në Europë dhe që gjithmonë ka ekzistuar në Shqipëri, ajo e grave-burra dhe vajzave-djem, e thënë ndryshe e Amazonave të antikitetit parahelen. Përveç kësaj ky emër shpjegohet nëpërmjet gjuhës shqipe E ma zane d.m.th. ajo ose ai që kap apo zë rob!

Le të kthehemi për një moment në historinë legjendare të këtyre amazonave, grave luftëtare, gjahtare dhe gjithmonë me kalë, të mitologjisë parahelenike. Ato do të kenë jetuar në Azinë e Vogël, në

Thrakë dhe në Kaukaz (vend i banuar nga popullsitë e trungut pellazg). Grekët nuk e njohin kuptimin e saktë të emrit Amazonë dhe shpjegojnë nga ana fonetike [mazos = gji, amazos (a = parashtesë mohuese greke) = pa gji !] : "ato që nuk kanë gji apo që u mungon njeri gji ! Në këtë mënyrë ata kanë sajuar këtë legjendë, duke menduar se ato e prisnin ose e digjnin gjirin e djathtë për të lehtësuar përdorimin e armëve të tyre të luftës dhe në veçanti të harkut. Kjo është shumë e dyshimtë, për shkak se kryerja e këtij procesi barbar (prerja e gjirit) që përmban rreziqe të sigurta, të cilat midis të tjerave, septicemi*). Sa më shumë, në të gjitha paraqitjet figurative të Amazonave nuk dallohet asnjë gjurmë e ndonjë sakatimi të tillë.

Ato rigjenden tek Iliada e Homerit, ku janë aleate të trojanëve. Mbretëresha e tyre Pentesilea u vra nga Akili. Shënojmë kalimthi se trojanët, armiq të betuar të grekëve, ishin një etni me zanafillë pellazge ashtu si thrakët dhe frigjianët, edhe ata aleatë të trojanëve. Një legjendë e mëvonshme nxjerr se ato luajnë rolin e tyre në bëmat e Heraklit dhe të Tezeut. Aleksandri i Madh, i cili do ta ketë takuar mbretëreshën e tyre.

Në Shqipëri, qysh nga adoleshenca, një vashë mund të betohej për dëlirësinë dhe mund të hiqte dore nga të qenit femër. Kjo zgjedhje shpesh ishte e diktuar nga rrethanat shoqërore. Mund të bëhej fjalë për t'i shpëtuar një martese të lidhur, ose kishte vajza që rriteshin si djem nëpër familjet ku nuk kishte meshkuj. Në të vërtetë kanuni e vë si kusht se vetëm burrat kanë të drejtën e trashëgimit dhe mungesa e një djali të aftë për të marrë përgjegjësitë e çnderon familjen, prej nga krijohet mundësia që i lejon vashave të marrin armët, të bëhen kryetare familje dhe të kryejnë të gjitha funksionet tradicionalisht të lejuara vetëm për burrat. Ky ndryshim shprehej me një lloj maskimi të shoqëruar nga një ndryshim në mënyrën e sjelljes, të ecjes madje të kthimit të emrit në gjininë mashkullore. Ky ndryshim ishte i kuptueshëm, i pranueshëm dhe plotësisht i njohur nga mjedisi dhe i

*) *Helmim i gjakut*

pranueshëm nga kanuni, që vajza apo gruaja vepronte si burrë duke kryer të njëjtat detyra si dhe ushtronte të njëjtat përgjegjësi dhe të njëjtat funksione.

Proverba

Proverbat shprehin ndjenja nga më të ndryshmet dhe nganjëherë janë pasqyrimi i shpirtit të gjithë popullit. Zgjedhja që është bërë këtu, kuptohet se nuk është e plotë, por përcakton mbi të gjitha prirjen e shqiptarit ndaj ndershmërisë, ekzalton guximin dhe trimërinë nganjëherë me një frymë liriko-epike. Por më e shpeshtë është shprehja e një morali popullor mbushur me mosbesim, shpotitje, mençuri ku zbulohet një farë etike, drejtësie dhe ku ndihet një farë zgjidhje, pasqyrim i një varfërie të përhershme apo shekullore.

- Fëmija pa nënë si nata pa hënë.
- Të bësh e të zhbësh është një hiç.
- Barkmadh, trupvogël.
- Vetëm mali me mal nuk takohen.
- Budallenjtë janë të mençur për sa kohë që nuk kanë thënë marrëzira.
- Dardha e ka bishtin mbrapa.
- Fuçia bosh bën zhurmë më shumë.
- Druri i shtrembër është i mirë për tu djegur.
- Nga trëndafili lind gjembi, nga gjembi lind trëndafili.
- Burrë e grua, mish e thua.
- Trimi nuk di të gënjejë.
- Dy nuse në një derë dhe shkalla mbetet pa fshirë.
- Shumë zhurmë dhe pakëz punë.
- Bashkë me të thatin digjet dhe i njomi.
- Tjetrit shikoi punën dhe jo gunën.
- Bleta e di si bëhet mjalti.

- Fjala e dhënë mbahet.
- Moti duket qysh në mëngjes.
- I vuajturi e njeh vuajtjen e tjetrit.
- Ujët fle, armiku s'fle.
- Të ther natën dhe të qan ditën.
- Gënjeshtra i ka këmbët e shkurtra.
- Besa e shqiptarit si purteka e arit.
- Më mirë të dalë syri se sa nami.
- Besa e burrit e rëndë si guri.
- Kur qesh osmanliu, shqiptari vuan.
- Nga ferra e vogël del lepuri i madh.
- Sytë flasin më shumë se goja.
- Për njeriun e lumtur edhe gjeli i tij bën vezë.
- Priftin nuk e bën mjekra.
- Miku i mirë njihet në kohë të vështira.
- Plaga e rëndë shërohet, por jo emri i keq.
- Në fshatin e budallenjve, i zgjuari quhet për budalla.
- Kur bën dasmë i varfri çahet daullja.
- Njeriu pa mend është si një mal i zhveshur.
- Qeni leh atje ku ha.
- Kur je i ftuar te ujku duhet t'i bësh shoqëri qenit.
- Mendja s'blihet me para.
- Jo çdo gjë që fluturon hahet.
- E vërteta gjithmonë del në shesh.
- Edhe breshëri është i vlefshëm në kohë thatësire.
- Nëse pranon lëvdatat e armikut, prit qortimet e mikut.
- Kapiteni i mirë njihet në furtunë.
- Toka të jep shumë, por më shumë puna.
- Fjala tund malet.

Fetë

Shqiptarët, siç e kemi parë në kapitullin e mëparshëm, në përgjithësi janë një popull me bindje jo të forta fetare. Në të vërtetë, para Luftës feja trajtohej si diçka e dorës së dytë, madje si diçka jo e domosdoshme: shqiptarizmi dhe ndjenja kombëtare p.sh. ishin mbi gjithçka. Fetë (islamizmi, bektashizmi, katolicizmi, ortodoksia madje ebreizmi) jo vetëm që bashkëjetojnë në mënyrë paqësore por edhe respektohen në mënyrë të ndërsjellë, sikur të ishte fjala për një udhëheqje të vetme nën drejtimin e një Zoti të përbashkët (ndikim, i pavetëdijshëm ose gjenetik, paganizëm ose politeizëm i të moçmëve të tyre pellazgo-ilirë?). Ka të ngjarë që ata duhet ta kenë shpikur ekumenizmin përpara !

Myslimanët ishin rreth 65 % e popullsisë në fund të Luftës së Dytë Botërore, katolikët 12 % dhe ortodoksët 23 %. Myslimanët janë në pjesën më të madhe të ritit sunit. Megjithatë rreth 10 % e tyre kanë kaluar në sektin bektashian, një lloj riti shiit me ndikim të krishterë. Ky sekt i afërt me atë të jeniçerëve dhe dervishëve rufai, ka qenë krijuar nga Haxhi Bektashi, Vali me zanafillë nga Nishapuri. Vepra e tij kryesore është Vilajetnami (libri i shenjtë). Në shekullin XV ky sekt mori një zhvillim të madh. Por kjo lidhje përafërsie, ajo e jeniçerëve, u shpërnda nga Turqit në vitin 1826 dhe u ndalua plotësisht në vitin 1925. Qysh nga fillimi i shekullit XIX, emigracioni preku edhe kufijtë e perandorisë turke. Shqipëria u bë një vend i parapëlqyer. Ky sekt me rite prej elementesh të ndryshme dhe me rregulla të buta dhe që beson në metempsikozën nuk ndryshonte aspak midis feve tërhoqi një numër të madh shqiptarësh.

Ky sekt përfshin shumë lloje: helveti, rufai, saadi, kadiri, tixhani. Kreu hierarkik mbahet nga Dedeu i Madh, që zakonisht e ka rezidencën në Turqi. Në krye të zonave të këtij sekti gjendet një Dede që emëron zyrtarisht një Baba (megjithatë i përcaktuar nga besimtarët) për secilën

DISKU I
(sipas Evans)



Ana A

DISKU I
(sipas Evans)

Ana B

= Filistinë
= Pellazgë
= Peleshtim
= Peleset (PLST)

teqe. Në vitin 1923, gjatë Kongresit mysliman të Tiranës, bektashinjtë i shkëputën përfundimisht lidhjet e tyre me myslimanët sunitë. Qyteti i Krujës ka qenë i pari dhe më i rëndësishmi nga shtatë vendet e pelegrinazhit të Bektashinjve në botë sepse Sari Sadik, ithtar i Haxhi Bektashi, është varrosur aty. Nga viti 1924 deri në vitin 1967 Tirana ishte qendra botërore e Bektashinjve. Por pushteti komunist i dha fund këtij sekti. Më 29/12/1967, Shqipëria u bë përfundimisht një shtet ateist.

Kronologjia iliro - shqiptare dhe ngjarje të tjera historike

Kemi vërejtur se territori i Ilirisë së lashtë ishte i banuar qysh nga paleolitiku, siç e provojnë zbulimet arkeologjike dhe speleologjike: shpella e Kaprinas, që daton qysh prej 160 000 vitesh (sot gjendet në Kroaci), shpella e Gajtanit (pranë Shkodrës, në veri të Shqipërisë) dhe të tjera jo më pak të dëgjuara. Ja vijimi i kësaj historie:

Shenja * përcakton zonat arkeologjike të zbuluara në Shqipëri

I - Antikiteti i Hershëm: Epoka e Hekurit

1200 - 800	Disa arkeologë e quajnë këtë periudhë Epoka e Hershme e Hekurit. * Gajtan, Bardhoc,Shtoj,Kënetë,Çinamak,Melgush, Tren,Torovicë,Mat,Gërmenj,Belsh,Patos,Kuçi i zi, Baç,Vajzë * Rehovë,Benjë,Podan,Piskovë,Vodhinë,Bajkaji
800 - 650	Qytetërimi i Hekurit të Mesmë (Hekuri I sipas disa arkeolog).
650 - 450	Qytetërimi i Hekurit të Vonshëm. Këto dy periudha përkojnë me Qytetërimin e Halshtatit (krahinë e Danubit të Sipërm).

	Përdorimi i hekurit u përhap kudo në Europë. Ilirët janë trajtuar si pararendësit e këtij qytetërimi. Belsh, Mat, Kuç i zi, Çinamak, Margëliç, Borovc, Kalivë, Butrint
450 – 52	Qytetërimi i Hekurit II: Tena *Amantia, Dyrrachion, Apolonia, Klos, Butrinti, Damastion, Phoinicë, Çuka Ajtojtë, Olimpi, Gurzezë, Bilis, Zgërdhesh (Albanopolis) Persqop, Lissos, Antigonea

Për kujtesë:

1193 – 1183	Data e hamendësuar për luftën e Trojës (Troja VI/VII)
700 – 680	Dyndja e grekëve në Azinë e Vogël në veri – lindje fillimisht (rajoni i Trojës antike). Kjo luftë kundër vendasve (Pellazgë, Frigjianë, Karianë, Lisianë...) është në zanafillë të mbivendosjes së epopeve të lashta pellazge të marra dhe të përpunuara sipas nevojave të kauzës greke gjatë pushtimit të sulmuesve helenë. Kjo është Troja VIII e arkeologëve.
VIII deri 479	**Para Krishtit Periudha arkaike e Greqisë.**
478 – 356	**Periudha klasike e Greqisë.**
Shekulli V	**Epoka e artë e Greqisë** (Shekulli i Perikliut 495 – 429).
356 – 146	**Periudha helenistike** e Greqisë.
776	Fillimi i olimpiadave në Greqi.
753	Themelimi i Romës nga etruskët (Pellazgët).
660	Themelimi i Bizantit.
600	Themelimi i Marsejës.
509	Romakët çlirojnë Romën dhe themelojnë Republikën.
490 – 479	Luftërat medike.

490	Fitorja e grekëve në Maratonë kundër Medëve..
431 - 404	Lufta e Peloponezit.
404	Shpartallimi i athinasve para Spartës.
382 - 336	Mbretërimi i Filipit II të Maqedonisë (356-336).
356 - 323	Mbretërimi i Aleksandrit (III) të Maqedonisë, i mbiquajtur Aleksandri i Madh (336- 323).
717 - 709	Mbretërimi i mbretit frigjian Midas (zanafillë pellazge)- Emri i tij shpjegohet me anë të fjalës shqipe Mik dash(i) mik i dashit, (që nënkuptohet "Pan"). Në të vërtetë legjenda e Pan-it daton qysh prej epokës së Midas.

Prej shekullit VIII deri në pushtimin romak fiset thrako-ilire në Ballkan dhe në rajonet danubiane ishin të shumta në numër dhe më të rëndësishmet ndaheshin gjeografikisht si më poshtë:

*Iliria e Veriut: Panonianët, Venetët, Istrianët, Japodët, Liburnët, Breusët, Dalmatët, Autariatët, Triballët, Agrianët

*Iliria e Lindjes (ndër të cilat mbretëritë e Dardanisë, të Peonisë): Dardanët, Peonianët, Lincestët, Orestët, Elimiotët.

*Iliria e Jugut (Mbretëria ilire): Daorsët, Ardianët, Labeatët, Pirustët, Taulantët, Enkelët, Albanët, Penestët, Partinët, Bylionët, Amantët, Atintanët.

*Epiri (Mbretëria): Kaonët, Molosët, Tesprotët, Atamanët, Kasopeanët,Ambrakiotët, Dolopët, Dodonët, Pellazgët (sipas Herodotit).

* Thraka. Thrakët, Dakët, Getët, Brigët, Odomantët, Sikonët, Besët, Doberët, Edonët, Odrisët, Paitët, Bitinianët, Amazonat, Satrët, Trausët.

* Maqedonia: Maqedonasit, Pellagonët, Eordët, Prierët, Botianët.

* Thesalia: Lapithët, Perrhebët, Enianët, Magnetët, Pagasianët
* Fosida: Driopët

Përveç këtyre, sipas Herodotit, Aigialianët, Arkadianët, Kranaenët, Tirrenët e Kalkidikës, të Etrurisë, të Lemnosit, të Imbros dhe të Samothrakës si dhe Kaukonët ishin pellazgë.

VII - 168	**Shtete të pavarura : mbretëritë ilire dhe epirote**
VII	Galaurosi, mbreti i Taulantëve (sipas Polienit, 12). Pas mbretërimit të Galaurosit nuk ekzistojnë më gjurmë të shkruara, as gjeneanologji deri në shekullin V para Krishtit.
627	Themelimi i Epidamnit (Dyrrachion/Dyrrachium, Durrës) nga kolonët (tregtarë) korfiotë (nga Korfuzi).
588	Themelimi i Apolonisë (Pojan) nga kolonët korintas
589	Themelimi i Orikos (Orikum, Orik) nga kolonët eubianë.
Shekulli V	Federata e fiseve ilire ndër të cilat Enkelët, Taulantët, Ardianët, Kaonët, Molosët....
450 - 400	Themelimi i qyteteve të shumta ilire ndër të cilat Amantia, Klosi, Damastion,Butrinti Prerja e monedhës ilire.
440 - 423	Grabos I, mbreti i Taulantëve. Lufta civile në Durrës (437).
423	Sirrhas, mbret ilir. Arrhabaios, mbreti i Lincestëve (ilirë) luftoi lavdishëm Perdikas dhe Lakedemonianëve të Brasidas.
423 - 385	Mbretërimi i Taripit, mbreti i Molosëve. Koinoni (Lidhja) e Molosëve.

400 - 3oo	Federata e disa fiseve ilire: Ardianët, Kaonët, Taulantët, Enkelët, Molosët
393 - 358	Bardhyli I, mbreti ilir që bashkoi vendin. Duke filluar nga viti 384 para Krishtit, Ilirët kishin sovranitetin e tyre në një pjesë të mbretërisë së Maqedonisë. Mbreti Perdikas III vdiq në fushën e betejës duke luftuar me Ilirët (359). Lufta kundër Filipit II të Maqedonisë .
357	Grabos II, mbret ilir.
345	Pleurati, mbret ilir. Pleurias, mbreti ilir.
345 - 331	Mbretërimi i Aleksandër molosit në Epir.
344	Filipi II sulmon Dardaninë dhe Ilirinë.
335	Kleitos (biri i Bardhylit I) mbret ilir, lufton kundër Aleksandrit të Madh
335 - 300	Glaukias, mbret i Taulantëve.
300 - 270	Themelimi i qyteteve të Lisos dhe Antigoneas. Në 307 Pirro rimori fronin molos më ndihmën e Glaukias.
295	Bardhyli II, mbret i Ilirëve.
295-272	Mbretërimi i Pirros II, mbret molos i Epirit. Pirro mundi Romakët në Herakle (280) dhe në Auskulum (279) ku përdori elefantët e tij të famshëm. Ky sukses i fituar me kaq vështirësi është zanafilla e shprehjes "si fitorja e Pirros".
280	Monunios, mbret ilir.
270	Mitilos, mbret ilir. Lufta kundër Aleksandrit, bir i Pirros.
250 - 231	Agroni, mbret i Ilirisë dhe bir i Pleuratos.
232	Koinoni (Lidhja) e Epirotëve.
231 - 229	Teuta, mbretëresha e Ilirëve dhe bija e Agronit (biri i saj Pines ishte shumë i vogël për të qeverisur).

	Fitorja ilire në Medion kundër Etolianëve të Akarnanisë. Teuta pushton Foenice (Epir) - Ajo u mund në vitin 229 nga Romakët.
229 - 218	Demetrios i Farit, pasuesi i saj përpiqet të rifitojë pavarësinë, por u mund nga Romakët në vitin 218. Shtet vasal i aneksuar nga Maqedonët.
229	Lufta I iliro - romake.
219	Lufta II iliro - romake.
217- 205	Skerdiliaidas lufton kundër zotërimit maqedonas.
213	Filipi V i Maqedonisë ndërhyn në Iliri.
205 - 181	Pleurati, mbret ilir dhe biri i Skerdiliaidasit.
181 - 168	Genti, biri i Pleuratit, mbreti i fundit i ilirëve.
168	Lufta III iliro - romake: pushtimi dhe copëzimi i Ilirisë nga Romakët (Pol Emili).

Për kujtesë :

298	Galët në Maqedoni, Thrakë dhe Greqi.
278	Marrja e Delfit dhe pushtimi i Azisë së Vogël.
264 - 146	Luftërat punike (3) midis Romës dhe Kartagjenës.
241 - 224	Roma pushton Etrurinë.
146	Pushtimi i Greqisë nga Romakët.
52	Shpartallimi i Versingetoriksit nga Cezari në Alesia.
148	Formimi i provincës romake të Maqedonisë.
97 - 85	Shpartallimi i ekspeditave ushtarake romake në Dardani.
49 - 31	Iliria e jugut bëhet fushëbetejë për luftërat e Cezarit.
45	Romakët formojnë provincën Illyricum.
34 - 33	Ushtria e Oktavian Augustit pushton Dalmacinë.
30	Themelimi i kolonive romake në Durrës, Bylis, Butrint.

27 – 14	Mbretërimi i Augustit. **Iliria e vitit 168 para Krishtit deri në vitin 395 pas Krishtit bëhet provincë romake.**

II - Antikiteti i Vonë dhe Mesjeta deri në shekullin XV (Skënderbeu)

6 – 9	Revolta ilire, e drejtuar nga mbreti Baton kundër Romakëve.
101 - 107	Marrja e Dakisë nga Romakët.
166	Sulmet e Gjermanëve në Danub.
258	Frankët dhe Alamanët kalojnë Rinin dhe rrënojnë Galinë dhe Spanjën.
325	Këshilli i Nises.
375	Fitorja e Hunëve kundër mbretërive të Visigotëve dhe Ostrogotëve.
378	Visigotët pushtojnë perëndimin e Ballkanit.
390 - 405	Shën Jeronimi (ilir) përkthyesi i parë i Biblës në latinisht (Vulgate)*)
395	Ndarja e Perandorisë Romake – Iliria i takon Bizantit (Perandoria romake e Lindjes), Visigotët me Alarikun në krye pushtojnë dhe plaçkitin Ballkanin (Iliri,Maqedoni, Greqi). Diokletiani krijon prefekturën e Illyricum, Bizanti e ndan Ballkanin në 25 provinca, ndër të cilat katër janë ilire: Dardani, Epirus Vetus (Preveza), Epirus Nova (Durrës) dhe Prevalis (Shkodër).
395 – 1347	Iliria: Provincë bizantine
399	Kryengritja e Ilirëve kundër perandorit Honorus.
406	Suevët, Vandalët dhe Alamanët kapërcejnë Rinin. Në vitin 434 Atila bëhet mbret i Hunëve.
441	Hunët e Atilës sulmojnë Maqedoninë dhe Dardaninë (Kosova e sotme).

451	Ata luftojnë në Gali: Atila shpartallohet nga Teodori I dhe Aetius.
453	Vdekja e Atilës, tërheqja e Hunëve.
461	Ostrogotët pushtojnë Ballkanin.
476	Fundi i Perandorisë romake të Perëndimit.
529	Sulmi i Antëve.
540	Sulmi i Hunëve.
568	Sulmi i Lombardëve dhe Avarëve.
580	Ngulimet e para të disa fiseve Sllave në jug të Danubit (Iliria, Tharka dhe Maqedonia).
Shek. VI	Pasojë e frikës nga sulmet, shfaqja e fortifikimeve të shumta: numërohen rreth 167 në Ilirinë e Jugut.
602	Përmendja e fundit e emrit Ilir te "Mirakula Sancti Demetri" të Selanikut.
600-1000	Qytetërimi mesjetar i Arbërve ose Albën të mbiquajtur të Komanit (për arsye të rrënojave të gjetura në këtë qytet) : * Koman, Shurdhah, Lezhë, Krujë, Mat, Mirditë, Bukel, Pogradec, Rehovë, Piskovë, Butrint, Rapckë, Grabovë.
680	Proto-Bullgarët vendosen në Danub pasi kanë shpartalluar Bizantët: Krijimi i Perandorisë së Parë Bullgare.
711	Arabët pushtojnë Spanjën.
732	Ndarja e peshkopëve shqiptarë nga lëvizja romake.
756	Themelimi i Emiratit të Spanjës. Në vitin 800 Sharlëmanjë kurorëzohet perandor.
825	Myslimanët pushtojnë Kretën.
830-831	Arabët marrin Palermon.
845	Rrethimi i Parisit nga Vikingët.
846	Sulmi sarasin mbi Romën.

850	Arabët pushtojnë Korsikën.
851-1018	Mbizotërimi bullgar në Ballkan. Krijimi i Demës në Durrës dhe i Nikopolisit.
852-996	Pushtimi bullgar i një pjese të Albanisë.
Shek. IX	Pushteti bizantin mbetet tepër i rezervuar në Shqipëri deri në shekullin IX. Duke nisur nga kjo datë pushteti bizantin forcohet gjithmonë e më shumë nga frika e sulmeve që vinin nga Veriu.
863	Cirili dhe Metodi fillojnë të kristianizojnë Sllavët (Moravia e Madhe).
864	Khani i Bullgarëve, Borisi I bëhet ortodoks.
869	Marrja e Maltës nga Arabët.
885	Rrethimi i Parisit nga Normanët.
896	Hungarezët (Magjarët) kapërcejnë Karpatet dhe vendosen në rrafshinën danubiane.
900-972	Sarasinët në Provensë.
1040-1081	Emri "Albanais" fillon të përhapet në shkrimet bizantine, mbi të gjitha falë Mihal Ataliatit dhe Ana Komnenas.
1054	Skizmi midis Kishës së Lindjes (ortodokse) dhe Kishës së Perëndimit (katolike).
1081-1185	Dinastia bizantine e Komnenëve (zanafillë shqiptare).
1081	Robert Giskard bën sulmin e parë normand në Shqipëri.
1083	Normandët e mundur në Durrës.
1107	Sulmi i dytë normand në Shqipëri.
1108	Normanët lënë Shqipërinë.
1149	Trupat e Rozherit II mbret normand i Sicilisë, sulmojnë dhe plaçkitin disa qytete të bregdetit shqiptar, por munden dhe luftojnë duke u tërhequr pas ndërhyrjes së forcave bizantine në Durrës.

	Prej shekullit XII feudalët shqiptarë e ndajnë Shqipërinë qendrore në shumë principata.
1190-1199	Mbretërimi i Progonit, Arhondi i Arbërisë.
1198-1208	Mbretërimi i Gjonit, biri i Progonit.
1208-1216	Mbretërimi i princit Dhimitri.
1204-1318	Despotati i Epirit.
1257-1258	Kryengritja shqiptare kundër Bizantinëve.
1150	Themelimi i Moskës.
1158	Manuel Komneni pushton Antiokën.
Shek. XIII	Hegjemonia e Anzhevinë.
1204	Marrja e Kostandinopojës nga Kryqtarët.
1250	Mamlukët në Egjiptit.
1266	Karli I d' Anzhu, vëllai i Luigjit IX (Shën Luigjit) bëhet mbreti i Sicilisë (1266 – 1285).
1248-1254	Kryqëzata VII - Shën Luigjit në Egjipt, i shpartalluar nga Mansurah.
1270	KryqëzataVIII e fundit e organizuar nga Shën Luigji dhe Karli I d'Anzhu. Vdekja e Shën Luigjit në Tuniz.
1272	Karli I d'Anzhu shpall mbretërinë e Albanias ("Regnum albaniae").
1290-1299	Fillimi i dinastisë së Osmanlinjve që zëvendësuan Turqit selxhukide. Themelues kishin Osman I Gazi (Othman rreth 1258–1326) krijimi Emiratit të parë turk të pavarur në perëndim të Anadollit.
1291	Lindja e Konfederatës helvetike (Lidhja e përhershme: Uri, Shvic dhe Untervald). Rënia e Shën Zhan d'Akrit dhe fundi i Sirisë franke.
1304	Pushtimi i Durrësit nga Filipi i Tarentes – Rikrijimi i mbretërisë se Albanias.
1336	Kryengritja e malësorëve shqiptarë.

1334	Tanush Topia bëhet zot i Krujës dhe i krahinave që gjenden midis lumenjve Mat dhe Shkumbin; Balshajt në Veri; Muzakajt dhe Shpatajt në Jug.
1343-1347	Mbreti serb Stefan Dushani pushton Shqipërinë. Fundi i mbizotërimit bizantin.
1355	Krijimi i principatave të shumta shqiptare të pavarura.
1359-1388	Mbretërimi i Karl Topias.
1385	Karl Topia shpartallon ushtrinë e Balshës (fusha e Savrës/Myzeqe). Ushtritë otomane fillojnë të shkatërrojnë territorin shqiptar.
1362-1389	Mbretërimi i Muratit I.
1371-1375	Pushtimi i Serbisë nga Turqit.
1371	Shpartallimi i forcave aleate ballkanike kundër Perandorisë otomane (beteja e Maricas).
1387	Cari Lazar i Serbisë, Balshajt (Shqipëri) Gjergj Tirko (Bosnje) mundin Turqit në Plosnik.
28/06/1389	Në Kosove (Fusha e Mëllenjave) shpartallimi i koalicionit ballkanik kundër Turqve. Sulltani Murati I gjen vdekjen (u vra nga një shqiptar).
1389 - 1402	Ndërmbretërimi i Bajazitit I.
1393	Turqit sulmojnë Shkodrën dhe Ulqinin.
1394	Pushtimi i Bullgarisë nga Turqia.
1405	Lindja e Gjergj Kastriotit, i quajtur nga turqit Skënderbeu ("Zotëria Aleksandër", d.m.th. "i denjë për bëmat e Aleksandrit të Madh").
1413-1421	Mbretërimi i Mehmetit I.
1415	Turqit pushtojnë Krujën.
1417	Turqit pushtojnë Vlorën, Kaninën dhe Beratin.
1419	Turqit pushtojnë Gjirokastrën.
1423	Turqit marrin peng katër fëmijët e Gjon Kastriotit (babai i Skënderbeut)..

1430-1432	Gjon Kastrioti dhe Gjergj Araniti vihen në krye të kryengritjes së feudalëve shqiptarë kundër Turqve.
1433	Araniti mund ushtrinë turke (grykat e Labërisë).
1443	Skënderbeu kthehet në atdheun e tij. Flamuri i Kastriotit: (shqiponja dykrerëshe e zezë në sfond të kuq) valëvitet mbi kalanë e Krujës (28/11/1443).
1443-1468	Skënderbeu lufton me lavdi ushtritë turke gjatë 25 viteve. Për shtete të shumta në numër, Shqipëria bëhet roja e Europës Perëndimore.
1444	Kuvendi i Lezhës nën mbrojtjen e Skënderbeut. Në vitin 1445 turqit u mundën në Mokër dhe në Domosdovë.
1446	Turqit e mundur në Dibër. Në fillim të vitit 1448 Sulltan Murati II vjen vetë në krye të një ushtrie prej 100 000 ushtarësh dhe mundet nga Skënderbeu.
23/07/1448	Skënderbeu mundi Venecianët në brigjet e Drinit, në rrethinat e Shkodrës.
1421-1451	Mbretërimi i Muratit II.
1422	Rrethimi i Kostandinopojës.
1430	Otomanët pushtojnë Selanikun, 1446; Janosh Huniadi regjent i Hungarisë.
1451-1481	Mbretërimi i Mehmetit II.
1460	Pushtimi i Moresë.
29/05/1453	Rënia dhe marrja e Kostandinopojës nga turqit.
1450	Në Krujë shpartallimi i dytë i turqve të udhëhequr nga Sulltan Murati II.
1455	Shpartallimi i turqve në Berat.
1456	Shpartallimi i turqve në fushën e Oranikut, pranë Dibrës.
1457	Shpartallimi i turqve në Albulenë (80 000 turq kundër 20 000 shqiptarëve.)
1461	Skënderbeu shkon në ndihmë të mbretit të Napolit.

	Në krahinat e veriut sundojnë Dukagjinët, në qendër të vendit Kastriotët dhe në jug Aranitët.
1466	Shpartallimi i turqve në Krujë. Skënderbeu merr lëvdata nga Papa i Romës.
1467	Shpartallimi i turqve në Krujë.
17/01/1468	Vdekja e Skënderbeut
1474	Shpartallimi i turqve në Shkodër.
1476-1478	Rrethimi i Krujës nga Sulltan Mehmeti II.
1477	Shpartallimi i turqve në Krujë.
1478	Lek Dukagjini, pasuesi i Skënderbeut, i mundur nga turqit në Krujë.

III - Pushtimi otoman

29/05/1453	**Marrja e Kostandinopojës: rënia e Perandorisë Bizantine**
1479 deri 1908	Pushtimi përfundimtar i Shqipërisë nga turqit : fillimi i luftërave të gjata dhe të ashpra popullore.
1481	Me ndihmën e Ferdinandit të Sicilisë, Gjon Kastrioti (i riu) ringriti përkohësisht principatën e Kastriotëve
1485	Gjon Kastrioti (i riu) lë Shqipërinë dhe vendoset në Itali. Shqiptarë të shumtë, pjesa më e madhe nga jugu i Shqipërisë, emigrojnë në Itali (Kalabri dhe Sicili). Lulëzimi ekonomik dhe kulturor: shfaqja e shkrimtarëve të shumtë. Gjuha shqipe tashmë është shkruar nga ana fonetike qoftë në latinisht qoftë në greqisht, një murg francez i quajtur Brokardus pohon si provë në vitin 1332: "Shqiptarët, megjithëse kanë një gjuhë krejt ndryshe nga ajo e Latinëve dhe e Keltëve, në librat e tyre përdorin germat latine".
1431	Dënimi dhe ndëshkimi e Zhana d'Ark.
1462	Pushtimi i Bosnjës.

1477	Vdekja e Karl Temerarit.
1492	Kristofor Kolombo në Antile.
1498	Vasko de Gama zbulon rrugën e Indisë.
1499	Pushtimi i Lepantes.
1520-1566	Mbretërimi i Sulejmanit I (I mrekullueshmi).
1494-1506	Kryengritja e udhëhequr nga Gjergj Kastriotit (nipi i Skënderbeut). Krahina të shumta të Shqipërisë përfitojnë një farë autonomie ndaj pushtetit otoman kundrejt një haraçi simbolik. Aty bëjnë pjesë Mirdita, Mati, Malësia e Madhe, Dukagjini, Himara.

Shkrimtarët e parë, poetët dhe humanistët shqiptarë:

1462	Pal Engjëlli, Lekë Matranga përkthyen në dialektin toskë një katekizëm latin.
1508-1510	Marin Barleti shkruan (në Romë) në latinisht "Jeta dhe bëmat e Skënderbeut"
1555	Gjon Buzuku shkruan në dialektin gegë dhe boton "Missel" *)
1566-1622	Pjetër Budi, prift katolik shqiptar, hartoi një katekizëm dhe një ritual romak.
1606-1643	Frang Bardhi shkruan dhe boton fjalorin e parë latinisht-shqip (15 000 fjalë) dhe një apologji për Skënderbeun.
1625-1684	Pjetër Bogdani hartoi një trajtesë filozofike-teologjike dhe një gramatikë shqipe.
1516-1517	Pushtimi i Sirisë dhe Egjiptit nga Otomanët.
1516	Karl Kint bëhet mbret i Spanjës.
1521	Sulltan Sulejmani I "I Mrekullueshmi" pushton Beogradin.
1526	Sulmi mbi Hungarinë 1541: pushtimi i Hungarisë.

*) *Meshari*

1571	Flota turke mundet në Lepante (Spanjë, Venecia, Don Zhuani i Austrisë).
1609	Dëbimi i Maurëve të Spanjës.
1594	Princa dhe fisnikë të krahinës së Matit thërresin një kuvend të përgjithshëm (këshilli i luftës) për t'i kërkuar armë të huajve dhe ndihmë (më kot) vendeve perëndimore për të vazhduar luftën e armatosur kundër turqve.
Shek. XVII-XVIII	* Perandoria Otomane në grahmat e fundit: fillimi i rënies së saj
1632-1639	Krijimi i një shkolle fillore në Kurbin, pranë Krujës (1632) dhe të një lice në Blinisht, pranë Lezhës. Frang Bardhi boton një fjalor latinisht – shqip.
1740-1822	Ali Pashë Tepelena: një tjetër figurë emblematike e luftës së popullit shqiptar për pavarësi. Në vitin 1744, në Voskopojë themelimi i "Akademisë së Re".
1761	Grigor Durrsaku përkthen në shqip "Testamentin e Ri".
1767	Zëvendësimi i patriarkatit të Ohrit me atë të Stambollit.
4/07/1776	Pavarësia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
1783	Marrja e Krimesë nga Rusët.
14/07/1789	Rënia e mbretërisë në Francë – Revolucioni francez.
1785	Pasha Karamahmut Bushatlliu pushton Malin e Zi.
1786	Bashkimi i prijësve shqiptarë, malazezë dhe boshnjakë në Podgoricë :"Konfederata Ilire" e drejtuar nga Karamahmuti.
1788	Ali Pasha merr Janinën.
1797-1854	Naum Veqilharxhi pararendësi i "Rilindjes Kombëtare Shqiptare": Rilindja Kombëtare.
1769-1849	Mehmet Ali: fillimi (1805) i 150 viteve të dinastisë shqiptare në Egjipt (deri në vitin 1952: Faruku I, mbreti i fundit). Ai trajtohet si themeluesi i Egjiptit modern.

1809	Lord Bajron viziton Shqipërinë.
1863	Krijimi i Bankës otomane.
1869	Përurimi i kanalit të Suezit.
1814-1903	Jeronim de Rada: poet arbëresh i Italisë.
1820	Ali Pashë Tepelena i rrethuar në kalanë e tij të Janinës vdes në vitin 1822, si pasojë e sulmit të fundit të trupave turke.
1822	Kryengritja kundër turqve e drejtuar nga Zylyftar Poda.
1827	Turqit munden në Navarin nga një flotë franko-anglo-ruse.
1832-1837	Mehmet Ali pushton jugun e Anadollit dhe të Sirisë.
1833	Kryengritja në Shqipërinë qendrore dhe jugore kundër pushtimit turk; bashkimi i fisnikëve të krahinave kryengritëse në Berat për të shpallur pavarësinë administrative.
1835	Hamzë Kazazi në krye të një kryengritjeje në Shkodër.
1837	Forcat turke munden nga kryengritësit e Beratit.
1844-1912	"Rilindja Shqiptare" - Zgjimi i intelektualëve.
1845	Shtypja e alfabetit të dytë shqiptar të Naum Veqilharxhit.
1846-1900	Naim Frashëri: poet, mendimtar dhe patriot shqiptar.
1850-1904	Sami Frashëri: shkrimtar dhe erudit shqiptar.
1804-1815	Perandoria I nën Napoleonin I.
1830	Pavarësia e Greqisë, e çliruar nga zgjedha otomane. Në Francë, revolucioni i korrikut (27, 28, 29). Marrja e Algjerit nga Francezët.
1843	Marrja e Smalas të Abdel Kader nga duka i Aumalit.
1848	Revolucioni francez - abdikimi i Lui-Filipit.
1870	Lufta franko-gjermane — Shpartallimi francez në Sedan (01/09/1870).
1894-1896	Kryengritjet armene të shtypura nga forcat turke.
1869	Kryengritje të shumta kundër turqve: Shkodër, Tiranë,

Mat, Prizren, Pejë, dhe Gjakovë.
Krijimi i Vilajetit të Shkodrës.

1871-1940 Gjergj Fishta, prift katolik dhe poeti më i madh epik shqiptar.

1876 Nënshkrimi në Raihshtadt (Bohemi) i traktatit sekret midis Austro-Hungarisë dhe Rusisë për ndarjen (midis tyre) të gadishullit ballkanik në rastin kur do të prishej "status quo".

1876-1877 Gërmimet e para në Dodonë (vendi i parë i shenjtë parahelen në Greqi që u përkiste Pellazgëve) të ndërmarra nga Karapano.

1877 Protokolli i marrëveshjes i nënshkruar në Londër për njohjen e kombeve të ndryshme të përfshira në Perandorinë Otomane me përjashtim të kombit shqiptar.
Greqia merr Thesalinë dhe jugun e Epirit.
Krijimi i komitetit qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare nën presidencën e Abdyl Frashërit (1839/1892) Ky komitet i mbledhur në Stamboll kishte midis të tjerëve nga Pashko Vasën, Sami Frashrin, Jani Vreton, Zija Prishtinën.

03/03/1878 Traktati i Shën Stefanit i jep fund luftërave ruso-turke (i rishikuar më 16/06 nga Kongresi i Berlinit). Krijimi i shtetit Bullgar. Ky traktat i jepte disa territore shqiptare Bullgarisë (Kumanovë, Kaçanik, Tetovë, Kërçovë, Gostivar, Dibër, Strugë, Pogradec, Korçë etj.) Serbisë (një pjesë të Sanxhakut të Prishtinës deri në rrethinat e Gjilanit dhe Mitrovicës) dhe Malit të Zi (Plavë, Guci, Vermosh, Kelmend, Krajë, Anamal, Hot, Grudë, Tivar, Ulqin). Kongresi i Berlinit ndan përfundimisht nga Shqipëria një pjesë të madhe të territorit të saj të lashtë në përfitim të Serbisë dhe të Malit të Zi.

10/06/1878	Formimi i Lidhjes së Prizrenit: organizimi politik i krijuar me nismën e një komiteti të fshehtë të përbërë nga patriotë të shquar shqiptarë ndër të cilët Abdyl Frashëri dhe Sami Frashëri, Pashko Vasa dhe Jani Vreto. Një memorandum që shpall pavarësinë iu drejtua Sulltanit si dhe Fuqive të Mëdha të kohës.
23/07/1880	Në Gjirokastër Abdyl Frashëri boton Programin e tij kombëtar dhe përgatit themelet e një shteti të ri të lirë dhe të pavarur.
1878	Pavarësia e Serbisë, Malit të Zi dhe e Rumanisë. Autonomia e Bullgarisë.
1881	Perandoria otomane i jep Greqisë Thesalinë dhe një pjesë të Epirit.
07/03/1887	Krijimi i shkollës së parë shqipe në Korçë.
1899	Kongresi i Pejës bën thirrje për mobilizim të përgjithshëm të territoreve shqiptare.
1902	Kryengritja kundër turqve në Mirditë (Shqipëria e Veriut). Fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX: zhvillimi i kulturës shqiptare me personalitete të shquara të kombit: Kostandin Kristoforidhi, Thimi Mitko, Naum Veqilharxhi, Jeronim de Rada, Pashko Vasa, Spiro Dine, Zef Jubani, vëllezërit Frashëri (Abdyl, Naim dhe Sami), Andon Zako Çajupi etj.

IV - Shqipëria e çliruar nga zgjedha otomane — Shqipëria moderne (shekulli XX)

1908	Kongresi i Manastirit - Fillimi i punimeve për njëjësimin e alfabetit shqiptar (toskë dhe gegë) dhe krijimi i alfabetit përfundimtar me 36 germa, të marra nga alfabeti latin. Revolucioni Xhonturk në të cilin merr pjesë Ataturku

	dhe me të bashkohen personalitete shqiptare dhe turke me zanafillë shqiptare.
01-10-1909	Krijimi i shkollës së parë Normale në Elbasan.
28-11-1912	Pavarësia e Shqipërisë nën drejtimin e Ismail Qemal Vlorës. Deri në fund të Luftës së Parë Botërore fati i Shqipërisë varej nga Fuqitë e Mëdha në Ballkan: pavarësia e saj u mohua, madje u kërcënua.
1912-1913	Dy luftërat Ballkanike në përfitim të Greqisë, Bullgarisë dhe Serbisë, territoret e të cilave u zmadhuan në kurriz të Shqipërisë. Serbia pushton Kosovën dhe Maqedoninë. Greqia pushton Epirin dhe merr Gjirokastrën.
30-05-1913	Konferenca e Londrës. Fuqitë e Mëdha caktojnë kufij të rinj për Shqipërinë. Një shtet shqiptar, megjithëse tepër i sakatuar (gjysma e territorit etnik) lindi mes vështirësish: disa muaj më vonë shpërtheu Lufta I Botërore duke e kthyer Ballkanin dhe Shqipërinë në një fushë të madhe beteje. Shqiptarë të shumtë, për t'i shpëtuar shtypjes serbe, emigruan në Turqi e Egjipt, në Lindjen e Afërme etj.
7/03/1914	Princ Vidi i emëruar zyrtarisht "Mbret i Shqipërisë" (Marrëveshja e Konferencës së Londrës).
3/09/1914	Një kryengritje popullore dëbon Princ Vidin nga Shqipëria (Durrës).
1914-1918	Lufta I Botërore.
1914	Jugu i Shqipërisë pushtohet nga trupat greke. Italia pushton ishullin e Sazanit dhe portin e Vlorës. - Emigrimi i shqiptarëve të shumtë nga Kosova drejt Turqisë. – Kolonizimi hap pas hapi i Kosovës nga Serbia.
1915	Ushtria serbe sulmon Shqipërinë qendrore dhe ushtria malazeze pushton Shkodrën.

1916	Ushtria Austro - Hungareze pushton Shqipërinë e Veriut. Ushtria italiane hyn në Gjirokastër. Ushtria franceze pushton Korçën.
10/12/1916	Shpallet "Republika e Korçës" nën drejtimin e Themistokli Gërmenjit.
Qershor 1917	Në Gjirokastër, gjenerali Ferrero shpall pavarësinë dhe bashkimin e Shqipërisë nën mbrojtjen e mbretit të Italisë.
1918	Ushtria franceze e drejtuar nga Franchet d'Espere pushton për shumë muaj qytetin e Korçës. Krijimi i "Komitetit të mbrojtjes kombëtare të Kosovës". Fillimi i lëvizjes së "Kaçakëve".
19/11/1918	Në Kongresin e Tiranës shqiptarët shpallin zbatimin e marrëveshjeve të vitit 1913 dhe denoncojnë një marrëveshje sekrete (të nënshkruar në Londër më 26/04/1915) të zbuluar nga sovjetikët dhe grekët. Kjo marrëveshje parashikonte copëtimin e plotë të Shqipërisë.
1915-1916	Beteja e Dardaneleve.
Tetor 1917	Revolucioni Rus.
25/10/1918	Bolshevikët marrin pushtetin në Rusi.
01/12/1918	Krijimi i një mbretërie të Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve.
1918-1922	Arratia e Mehemetit VI. Abdyl Mexhidi merr titullin Kalif, i fundit i dinastisë otomane.
29/10/1923	Shpallja e Republikës Turke (Ataturku).
1924	Vdekja e Leninit.
19/01/1919 dhe	Konferenca e Paqes në Paris. Kolonizimi nga Serbia Mali i Zi i një pjese të madhe të territoreve shqiptare (Kosovë dhe pjesërisht në Mal të Zi dhe Maqedoni)
28/06/1919	Traktati i Versajës. Krijimi i Lidhjes së Kombeve (SDN sot ONU).

1920	Tirana zgjidhet kryeqytet i Shqipërisë. Traktati i Sevrës. Hapja e Kongresit të Lushnjës. - Esat Pashë Toptani vritet në Paris. - Ndërhyrja e ushtrisë jugosllave në Shqipëri. Pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Çlirimi i Vlorës. Largimi i italianëve. "Dekreti mbi kolonizimin e krahinave jugore" e shpallur nga mbretëria serbo-kroato-sllovene. Në të vërtetë është fjala për toka shqiptare të pushtuara.
1921	Konferenca e Ambasadorëve (Paris) miraton kufij të rinj të Shqipërisë të vendosur më parë. Formimi i qeverisë së Hasan Prishtinës. Revolta e Gjon Markut në Mirditë (Shqipëria e Veriut).
1920-1921	Spastrimi etnik në Epirin e Jugut: Greqia shpërngul më shumë se 400 000 shqiptarë në shkëmbim të 1 000 000 grekëve të Turqisë (nën pretekstin se ishte fjala për "myslimanë", nënkuptohet "turq"!).
1922	Ahmet Zogu u bëhet president i Këshillit.
1923	Traktati i Lozanës i kthen grekët në kufijtë e tyre të vitit 1912. A. Zogu detyrohet të japë dorëheqjen.
1924	Fan S. Noli (poet, shkrimtar, përfaqësues i shqiptarëve të SHBA, në parlamentin shqiptar) formon një qeveri të re. Serbët kryejnë plaçkitje dhe vrasje në Kosovë. A. Zogu merr pushtetin. Revolta popullore kundër regjimit.
1925	A. Zogu u bë president i Republikës.
22/11/1927	Aleanca e nënshkruar me Italinë për një vijimësi prej njëzet vitesh.
01/09/1928	A. Zogu shpallet "Mbret i Shqiptarëve".
1931	Mbretëria jugosllave shpall ligjin mbi kolonizimin e krahinave jugore.
1937	Klubi kulturor serb i Beogradit vendos një projekt për

shpërnguljen e detyruar të shqiptarëve të Kosovës dhe të Maqedonisë drejt Turqisë dhe Shqipërisë.

1938 Marrëveshja turko-jugosllave për kalimin e shqiptarëve në Turqi.

29, 30/09/1938 Konferenca e Munihut.

07/04/1939 Premtja e shenjtë (e zezë) - Italia sulmon dhe pushton Shqipërinë. - Largimi i Zogut I. - Italia sulmon me një armatë të madhe kundër Shqipërisë: 50 000 burra, 200 luftanije, 600 avionë. Ushtria shqiptare e përbërë nga 15 000 burra, për më tepër e drejtuar nga instruktorë italianë, nuk mund t'i rezistoje forcave italiane. Viktor Emanueli III merr kurorën mbretërore të Shqipërisë.

23/08/1939 Pakti i mossulmimit gjermano-sovjetik (Ribentrop-Molotov).

28/10/1940 Pas ultimatumit të saj, Italia sulmon Greqinë duke u nisur nga Shqipëria: por grekët përfundojnë duke pushtuar Gjirokastrën dhe Dyzet Shenjtorët (Sarandën).

1941 Gjermania pushton Jugosllavinë. Një pjesë e tokave shqiptare të Kosovës ribëhen shqiptare.

08/11/1941 Krijimi i Partisë Komuniste Shqiptare.

16/09/1942 Krijimi i "Frontit nacional-çlirimtar" në Pezë.

1943 Italia nënshkruan kapitullimin dhe lë Shqipërinë. Gjermanët pushtojnë Shqipërinë (11/09/43).

02/02/1943 Sovjetët fitojnë lavdishëm kundër ushtrive gjermane në Stalingrad.

06/06/1944 Zbarkimi i Aleatëve në Normandi.

29/11/1944 Çlirimi i plotë i Shqipërisë nga forcat e vetme të rezistencës popullore. Kjo luftë shkaktoi humbjen e rreth 28 000 shqiptarëve, që për rreth 1 000 000 banorë janë pothuajse 3% e popullsisë së përgjithshme. 22 000 parti-

	zanë shqiptarë ndihmojnë Jugosllavët në luftën e tyre kundër nazistëve.
8/05/1945	Rënia e Berlinit. Kapitullimi pa kushte i Gjermanisë.
11/01/1946	Shpallja e Republikës Popullore të Shqipërisë. Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit shpallen krahinë autonome Republikës Popullore të Serbisë. Territore të tjera shqiptare ndahen midis Maqedonisë dhe Malit të Zi.
14/03/1946	Zbatimi i Kushtetutës Shqiptare.
1948	Shqipëria i bashkohet Rezolutës informative të partive komuniste dhe të partive punëtore. Ngatërresa me Jugosllavinë.
1951	Përndjekja ndaj besimtarëve.
1955	Shqipëria pranohet në Kombet e Bashkuara. Traktati i Varshavës i ratifikuar nga Shqipëria.
25/05/1956	Vizita zyrtare në Tiranë e Nikita Hrushovit.
10/09/1960	Spastrimi në gjirin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës. Ramiz Alia bëhet sekretar i Partisë.
09/04/1961	Vdekja e Zog I, ish mbretit të Shqipërisë, në Paris.
26/04/1961	Konflikti me B. Sovjetik. Moska tërheq teknikët e saj dhe ndërpret çdo bashkëpunim me Shqipërinë.
10/12/1961	Shkëputja e marrëdhënieve diplomatike me BRSS.
1961	Aleanca me Kinën.
1966	Plenumi IV i Komitetit Qendror të PPJ dënon dhunën kundër shqiptarëve të Kosovës nga forcat e sigurimit jugosllav. Aleksandër Rankoviç shkarkohet nga funksionet e tij.
29/12/1967	Kushtetuta e re: Shqipëria bëhet zyrtarisht shtet ateist.
1968	Manifestime anti-serbe të shtypura me dhunë nga forcat serbe të Prishtinës. Shqipëria heq dorë nga Traktati i Varshavës.
1970	Elektrifikimi i plotë i Shqipërisë.

1972	Dialekti toskë zyrtarizohet si gjuhë zyrtare.
1973	Trazirë në Plenumin IV të Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë që mbështet luftën e klasave. Arrestime të shumta dhe burgosje të drejtuesve të kulturës.
1974	Nën pushtetin e Titos, Kushtetuta jugosllave i jep një autonomi të gjerë shqiptarëve të Kosovës, i kthyer në një element konstituiv i Federatës Jugosllave. Plenumi V i Komitetit Qendror të PPSH vendos zhdukjen fizike të drejtuesve të shumtë ushtarakë.
1975	Plenumi VII rifillon politikën e saj të spastrimit.
1977	Shkëputja e marrëdhënieve diplomatike me Kinën. Shqipëria denoncon doktrinën e "Tri Botëve".
07/07/1978	Ndalja e çdo ndihme ekonomike nga Kina.
28/12/1978	Kuvendi Popullor miraton një Kushtetutë të re: Shqipëria do të quhet tashmë "Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë".
15/04/1979	Një tërmet i tmerrshëm trondit Shqipërinë: 100 000 të pastrehë dhe 17 000 shtëpi e ndërtesa të shkatërruara.
1980	Vdekja e Josif Broz Titos.
1981	Manifestime masive në Kosovë që kërkojnë rivendikimin e statusit të Kosovës Republikë: politika jugosllave i shtyp ato egërsisht.
18/12/1981	"Vetëvrasja" (?) e Mehmet Shehut, kryeministër i Shqipërisë.
14/01/1982	Adil Çarçani emërohet kryeministër.
11/04/1985	Vdekja e Enver Hoxhës (lindur më 16/08/1908). Zëvendësohet nga Ramiz Alia (lindur më 18/10/1925).
01/02/1987	Ramiz Alia zgjidhet President i vendit.
28/08/1987	Gjendje lufte me Greqinë, e cila ka shpallur rivendikimet e saj ndaj Korçës dhe Gjirokastrës.

1989	Milosheviç heq statutin e autonomisë së Kosovës dhe përforcon pushtetin e serbëve.
09/11/1989	Rënia e Murit të Berlinit.
1990	Fundi i diktaturës komuniste dhe fillimi i demokracisë në Shqipëri — Reforma të shumta (pranimi me ligj i pronës private). Në Kaçanik zbatimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Eksod i shqiptarëve të shumtë drejt Perëndimit.
11/12/1990	Rivendosja e sistemit të pluralizmit. Krijimi i Partisë Demokratike më 12/12.
20/02/1991	Përmbysja e statujës së Enver Hoxhës në Tiranë.
1991	Shqiptarët e Kosovës shpallin pavarësinë e tyre me anë të referendumit. Bashkimi Europian njeh shpërbërjen e Shtetit federal jugosllav.
15/03/1991	Rivendosja e marrëdhënieve (të shkëputura qysh në vitin 1939) me SHBA.
30/04/1991	Ramiz Alia rizgjidhet President i Republikës.
12/06/1991	Partia e Punës (ish komuniste) shndërrohet në "Partia Socialiste e Shqipërisë".
22/10/1991	Parlamenti shqiptar njeh "Republikën e Kosovës, shtet sovran dhe të pavarur", si dhe qeverinë e tij të përkohshme të drejtuar nga Bujar Bukoshi.
06/04/1992	Dorëheqja e Ramiz Alisë.
09/04/1992	Sali Berisha zgjidhet President i Republikës.
16/12/1992	Shqipëria, kandidate për në NATO.
25/04/1993	Vizita e Gjon Palit II.
20/11/1993	Leka I dëbohet nga Tirana.
24/10/1994	SHBA heqin embargon e shitjes së armëve kundrejt gjashtë vendeve të Lindjes, ndër të cilat edhe Shqipëria. Traktati i bashkëpunimit dhe miqësisë (Francë-Shqipëri).
05/01/1995	Manovrat e para detare me SHBA.

27/10/1996 Fitorja e Demokratëve në zgjedhje bashkiake.
15/01/1997 Falimentimi i firmave piramidale (VEFA e të tjera, 300 000 viktima).
24/07/1997 Rexhep Mejdani pason Sali Berishën në Presidencë.

"Kosovarët dhe Serbët":
historia e dy popujve fqinje, por krejt të ndryshëm.

Janë të shumtë ata që nuk e njohin apo e njohin në mënyrë të gabuar historinë e Kosovës dhe të Shqipërisë, por edhe ato të vendeve të tjera ballkanike, ndër të cila edhe Serbia. Ja përse, aty-këtu përhapen të pavërteta të panumërueshme, informacione të shtrembëruara dhe kësisoj të gabuara ose të gënjeshtërta. Për të kuptuar më mirë se çfarë po ndodh në këtë fillim të shekullit XXI, unë do të përmbledh shkurtimisht historinë e lashtë dhe të vonshme të këtij rajoni të mbiquajtur "fuçi baruti" qysh nga shekulli XIX. Fillimisht, përpara se të kaloj njëri pas tjetrit elementet thelbësore (historike, kulturore, etnogjuhësore...), të cilat bien në sy ndërsa studion me hollësi historinë e ndërthurur të Serbëve dhe të Kosovarëve në veçanti si dhe të Ballkanit në përgjithësi, le të shqyrtojmë shkaqet e konfliktit që përfshiu Jugosllavinë në fund të shekullit XX.

Atëherë si arriti Serbia në këtë krizë të fanatizmit etno - fetar dhe antagonizmit shekullor me popullsinë shqiptare të Kosovës? Për të kuptuar se çfarë ka ndodhur, duhet ngjitur shumë lart në histori. Kjo është një nga rajonet e vetme të Europës ku kaosi etno-kulturor mbretëron qysh nga shekulli XVI i erës sonë. Qysh prej qindra vitesh prozelitizmi*) fetar dhe ekzaltimet e pareshtura patriotike të drejtuara nga priftërinjtë ortodoksë, më pas nga shumë poetë popullorë dhe së fundi nga intelektualët sllavofilë, ngulitën dy lloje mitesh: fillimisht atë të "tokës së shenjtë", "që iu përket" atyre, ndërkohë që është fjala për popullsi të imigruara shumë vonë (shekulli VII i erës sonë) në

Ballkan dhe të vendosur këtu dhe rreth kishave dhe manastireve të tyre (të kthyera më vonë në vende të shenjta të vërteta) pas krishterimit të tyre, duke filluar nga shekulli IX nga vëllezërit Ciril dhe Metode. Si rrjedhojë këta të fundit u bënë apostujt e ortodoksisë botërore. Më pas "shpartallimi" i Serbisë në vitin 1389 nga Turqia në Kosovë (beteja e ashtuquajtur e Fushës së Mëllenjave) ku krejt ndryshe nga sa e parashtrojnë serbët, këta të fundit nuk ishin të vetmit që morën pjesë në këtë betejë të madhe kundër turqve, pasi midis luftëtarëve të tjerë kishte shqiptarë, hungarezë dhe bullgarë. Përveç kësaj kemi sërish rastin të shënojmë se gjatë kësaj beteje të famshme, Sulltani turk i kësaj periudhe, Murati I (1362–1389), u vra nga një luftëtar shqiptar dhe jo serb! Turqit më pas e pushtuan Ballkanin për pesë shekuj me radhë. Kështu ngjarja e fundit (shpartallimi në Fushën e Mëllenjave u shndërrua nga Serbët në "simbol kombëtar". Ja pra se si ata përfunduan duke formuar këtë parullë të dyfishtë, e cila e ktheu Kosovën njëherësh në "djepin kombëtar" të tyre dhe "mitin kombëtar" të tyre). Është fjala për dy parime të mbështetura nga ultranacionalizmi serb, i cili përvijon këtë reminishencë të një epoke tjetër! Është për të ardhur keq kur në fillim të shekullit XXI vëren që serbët ende jetojnë me mitet e tyre, dogmat fetare, simbolet kombëtare, me emblemat që u ka kaluar koha dhe me të kaluarën e tyre të largët: vatër e përjetshme e të gjitha llojeve të diskriminimit. Le të shohim tashmë më nga afër misteret e historisë të këtyre popujve fqinjë, por gjithsesi krejt të ndryshëm.

Le të fillojmë me serbët. Askush nuk mund të mos e dijë se historia e tyre është relativisht e vonshme në raport me atë të shqiptarëve të Kosovës, zanafilla e të cilëve ngjitet deri te Pellazgët parahelenikë. Shkrime të shumta antike, arkeologjia, paleontologjia, antropologjia, etnologjia, toponimia, gjuhësia dhe studime të ndryshme moderne dëshmojnë të vërtetën historike të pellazgëve të lashtë dhe pasardhësit e tyre thrako-ilirët, ndër të cilët shqiptarët, kosovarët dhe epirotët janë pasardhësit e fundit. Shkatërrimi shumë i vonshëm i arkivave të Kosovës

(shkatërrimet dhe djegiet sistematike të bëra në mars dhe prill të vitit 1999) kanë për qëllim të fshijnë të gjithë kujtesën stërgjyshore të kosovarëve dhe të zhdukin prova të shumta historike dhe dokumente kompromentuese për serbët. Por kjo tentativë nuk e fsheh dot aspak historinë e popullit kosovar, që gjendet në dokumente të tjera dhe manuale historike, të cilat ekzistojnë në vende të shumta, ndër të cilat Franca.

Nga shekulli I dhe II të erës sonë, duke ardhur nga stepat ruse ose të Azisë Qendrore, tributë e ndryshme sllave fillojnë të dynden drejt Europës Lindore dhe pastaj Europës Qendrore. Ata përparojnë pa u trembur drejt Perëndimit, por shpejt do të tërhiqen dhe do të detyrohen nga gjermanët të fushojnë në veri të Danubit dhe në Karpate. Të joshur nga pasuria e tokës ballkanase, disa fise të quajtura më vonë Sllavë të jugut, ndër të cilët Serboi, rreth vitit 580, kapërcejnë Danubin me dyndje të njëpasnjëshme, duke depërtuar fillimisht nëpërmjet inkursionesh sporadike dhe pastaj shkallë-shkallë përfundojnë duke u vendosur në luginat e Danubit të poshtëm dhe në veçanti në atë të Savës. Rreth vitit 635, serbët u vendosën në Thesali, pastaj në rajonin e Moravës jugore. Fise të tjera u lëshuan më pas për të pushtuar perëndimin, d.m.th. brigjet e Adriatikut të banuara kryesisht nga popullsi ilire (Venetët, Istrianët, Japodët, Liburnët, Dalmatët, Autariatët, Panonianët ...) Në të vërtetë përpara mbërritjes së sllavëve, popullsitë e trungut thrako-ilir zinin një territor tejet të madh, që shtrihej nga Danubi deri në Epir nga njëra anë dhe nga Adriatiku deri në Detin e Zi nga ana tjetër. Grekët, nga ana e tyre, zinin pjesën jugore të gadishullit ballkanik.

Por nën presionin në rritje të lëvizjeve të popullsive sllave, të gjithë këta popuj ilirë përfunduan qoftë duke u integruar me pushtuesin, qoftë duke vazhduar të jetojnë në tokat e tyre stërgjyshore ku gjenden ende edhe sot (Kosova, Mali i Zi, Maqedonia), qoftë duke gjetur strehë përfundimisht në malet e tyre të pamposhtura të vargmalit dinarik dhe Alpet e Ilirisë së Jugut (sot "Alpet shqiptare"), pranë fiseve të tjera

ilire të një trungu (Shqipëria e sotme). Qysh me mbërritjen e tyre, Sllavët e Jugut (Serbët, Sllovenët, Kroatët, Boshnjak-Herzegovinët...) u ndanë fillimisht gjeografikisht. Kroatët dhe sllovenët zunë rajonet e veriut dhe të perëndimit të Ballkanit, territore nën zotërimin e Perandorisë së lashtë Romake të Perëndimit, ndërkohë që serbët u vendosën në territoret e Perandorisë së Lindjes. Kjo do të shpjegojë më vonë përkatësinë fetare të secilit prej këtyre grupeve, por këtij qytetërimi iu desh rreth dy shekuj për tu shfaqur. Midis të gjitha fiseve sllave, fisi serb (Serboi) ishte më fitimtari. Ata u krishtëruan në shekullin IX nga dy priftërinj grekë sllavofolës, Cirili dhe Metodi. Këta të fundit përkthyen Biblën në gjuhën sllave, fillimisht duke nisur me gërmat e vogla të alfabetit grek, i cili u quajt glagolitik, pastaj cirilik pas përdorimit të germave të mëdha të shtypit, gjithashtu greke. Në periudhën e këtyre priftërinjve, peshkopata e Ohrit u bë një vatër e rëndësishme e kulturës greko-sllave. Ajo u zëvendësua nga patriarkati i Reçit i krijuar në vitin 1346. Por Sllavët e Jugut dallohen midis tyre nga fetë përkatëse: Kroatët dhe sllovenët pranuan fenë e Perandorisë së Perëndimit (riti romak) d.m.th nga katolicizmi, ndërsa serbët nga ortodoksia, atë të Perandorisë së Lindjes (riti bizantin). Së fundi një numër i madh i bosnje-hercegovinasve (katolikë ose ortodoksë) u kthyen në myslimanë nën pushtimin otoman.

Megjithatë ndërmjet shekujt IX dhe XV serbët krijuan disa principata, ndër të cilat ajo e "Raš, Raška ose Rashi" (Serbia e vjetër) në krahinën e Novi Pazarit (në veri të kufijve të Kosovës) dhe ajo e dinastisë së "Nemaniç", themeluesi i së cilës ishte Etian Nemanja, i cili mbretëroi në vitet 1171–1196. Kisha kombëtare serbe u themelua në vitin 1219. Shën Sava, vëllai i Stefanit II arriti të bënte bashkimin kombëtar. Megjithatë mbretëria serbe arriti nën mbretërimin e Stefan IX, Uroš IV Dushani, i quajtur i Madhi (1308–1355), në vitin 1346 u shpall car i të gjithë serbëve, grekëve, bullgarëve dhe shqiptarëve nga patriarkati i Peç-it.

Mbretëria e fundit serbe u zhduk në vitin 1459. Gjuha serbe rrjedh

nga sllavishtja e vjetër, vetë kjo me zanafillë aziatike. Por ekzistojnë kundërshti në lidhje me zanafillën, si atë gjuhësore dhe atë etnike të Sllavëve. Disa pohojnë zanafillën e tyre alanike, alarodiane apo indo-iraniane. Sllavishtja është një nga gjuhët e fundit të shfaqura në Europë rreth shekullit V, si sllavishte perëndimore (polonisht, kashube, çekisht, sllovakisht) dhe ajo lindore (ruse, ukrainase, bjelloruse) dhe nga fundi i shekullit VI (Danubi i poshtëm) sllavishtja jugore (Ballkani rreth shekullit VII), ndër të cilat serbishtja, kroatishtja dhe sllovenishtja. Gjuha maqedone, nëndialekt që rrjedh nga serbishtja dhe bullgarishtja, është shumë më e vonshme. Gjuha boshnjake në pjesën më të madhe rrjedh nga serbishtja. Të gjitha dialektet sllave do të jenë formuar duke u nisur nga një nënshtresë azianike (stepat ruse, Azia qendrore, Iran ose Baktrianë), e cila do të ketë pësuar ndikime të forta vendore si pasojë e shtegtimeve të shumta të hordhive të para sllave, të mbërritura më vonë prej skajit lindor të Europës (shekulli I dhe II i erës sonë). Këto ndikime i kanë ushtruar kryesisht duke filluar nga gjuhët baltike apo kelto-gjermane dhe ato të dialekteve të vjetra ballkanike, të tilla si ilirishtja, trakishtja ose dako-gete. Gjuha sllavone është gjuha e parë sllave "e shkruar" rreth shekullit IX dhe X.

Megjithatë gjuhëtarë të shumtë, jo vetëm sllavofilë, gjejnë mënyrën për të nxjerrë në pah gjuhën sllave në çdo studim të tyre gjuhësor ose ta marrin si "referim" serioz, madje me të njëjtën shkallë barazie me gjuhët e tjera, dukshëm më të lashta, si gjuha greke, latinishtja ose gjuha kelte! Ky gabim i rëndë ka si zanafillë përzierjen ose mbivendosjen e gjuhëve të shumta si në rrafshin kronologjik edhe në atë të zanafillave: një mishmash i vërtetë. Kësaj i shtojmë dhe njohjen jo të mirë të gjuhës shqipe dhe mospranimin e të qenit të saj nga një trung me pellazgjishten e lashtë dhe pasardhëset e saj të drejtpërdrejta: gjuha frigjiane, tharke, ilire. Gjuha shqipe është mbiquajtur gjuhë indo-europiane, ndërkohë që ajo rrjedh nga pellazgjishtja e lashtë, gjuhë parahelene madje para-indo-europiane. Ajo është një gjuhë e mirëfilltë europiane, krejt ndryshe

nga gjuha sllave. Pellazgjishtja e lashtë dhe etruskishtja kanë ndihmuar në formimin e gjuhëve greke dhe latine. Shqipja përbën një degë të vetme dhe krejt më vete në tërësinë e gjuhëve të folura qysh në kohë të hershme në Europë. Në zanafillë kjo gjuhë ngjitet tek ajo e përdorur nga thrako-ilirët, pasardhës të drejtpërdrejtë të pellazgëve Ajo në të vërtetë ka mbetur e paprekur që nga koha e pushtimit romak të territoreve ilire në vitin – 168 para Krishtit, sepse duke filluar nga kjo epokë pjesa më e madhe e ilirëve u strehua në malet e tyre të pamposhtura, duke ruajtur kështu fondin gjuhësor të pellazgjishtes së lashtë, të cilën pjesa më e madhe e gjuhëtarëve (ata që nuk e njohin) e trajtojnë ende si një gjuhë të zhdukur! Ekzistenca e toponimeve të shumta, të përhapura nga Pirenejtë deri në Kaukaz, shpjegohet me lehtësi falë gjuhës së sotme shqipe dhe moria e antroponimeve, eponimeve, oronimeve, etnonimeve që gjenden në mitologjinë të mbiquajtur greke, të cilat gjuha shqipe arrin t`i deshifrojë me lehtësi, vërtetojnë të qenët nga një trung të pellazgjishtes së lashtë dhe gjuhës shqipe. Plus kësaj, shtojmë se Sllavët e Jugut (serbët, kroatët, sllovenët...) gjatë fqinjësisë së tyre të gjatë me popullsitë autoktone ilire, kanë asimiluar pjesërisht kulturën (gjuhën, epopetë, zakonet, kostumet) e popujve ilirë.

Serbët zunë rrënjë në Kosovë vetëm nga fundi i shekullit XIII, në një mjedis të populluar në pjesën më të madhe nga shqiptarët. Turqit e kanë sunduar këtë vend duke filluar që nga fitorja e tyre në Kosovë në vitin 1389. Ky mbizotërim do të vazhdojë afërsisht për pesë shekuj. Megjithatë turqit filluan t'i islamizojnë në masë popujt e rajonit vetëm nga shekulli XV dhe pikërisht boshnjakët dhe shqiptarët. Duke e njohur shumë mirë karakterin e shqiptarëve tejet krenarë, të pavarur, besnikë dhe luftarakë, turqit vepruan me shkathtësi për t'i kthyer në fenë e Islamit: ata i lanë të lirë të punonin tokat e tyre, të përdornin gjuhën e tyre dhe kulturën e tyre dhe mbi të gjitha për të mbajtur armët. Një fjalë e urtë shqiptare në lidhje me këtë thotë: A nuk gjendet pranë

shpatës së tij feja e shqiptarit? Për më tepër shqiptarët (krejt ndryshe nga serbët) nuk kanë qenë kurrë fanatikë ndaj fesë, ka të ngjarë për arsye të traditave të tyre pagane të trashëguara nga pellazgo - ilirët antikë. Në Shqipëri apo gjetiu, shqiptarët kurrë nuk janë grindur për shkak të përkatësisë së tyre fetare (katolicizmi, ortodoksizmi ose islamizmi). Kjo prirje vazhdon ende edhe sot. Në këto kushte shqiptarët u mjaftuan me një "tutelë administrative" turke, e cila nuk i pengonte aspak që të ekzistonin si shqiptarë: ata e kanë ruajtur shqiptarizmin e tyre.

Kjo liri, sado relative, nuk i pengoi shqiptarët të rebeloheshin shumë herë deri në pavarësinë e tyre (28/11/1912). Në të vërtetë, një nga episodet më të shquara të luftërave të tyre kundër zgjedhës otomane ndodhi gjatë mbretërimit të Gjergj Kastriotit (1405–1468) i mbiquajtur Skanderbeg. Megjithatë kjo nuk i pengoi disa shqiptarë, të cilët nga karizma e tyre ose nga aftësitë e tyre të arrinin deri në funksionet më të larta të Perandorisë Otomane, të tillë si gjeneralë të shumtë, admiralë, guvernatorë ose fisnikë (vetë Ataturku kishte prejardhje shqiptare)! Përveç kësaj, për shkak të cilësive të tyre kavalereske dhe pasionit të tyre për zanatin e armëve, shqiptarët gjenden kudo nëpër Europë (në ngjarjet dhe ushtritë e shumë mbretërve). Në të vërtetë Fransua I kishte në shërbim të tij një gjeneral të quajtur Arnaut, që nuk ishte emri i tij i vërtetë por një emërtim gjinor, me të cilin turqit emëronin në përgjithësi shqiptarët: Arnaut (ndryshim i emrit të huazuar nga greqishtja në format Arvanitis, Arvanos ose Arvanite, që emëron shqiptarët në përgjithësi). Napolon Bonaparti krijoi një regjiment shqiptar, nga i cili dolën heronj të shumtë të pavarësisë greke, ndër të cilët Marko Boçari, shqiptari suljot (Epiri i Jugut). Por shqiptarët e kësaj epoke shpesh kanë bërë karrierë të tillë siç janë tri arkitektët, të cilët kanë ndërtuar ndërtesa me famë: arkitekt Sinani (xhamia Sulejmanie, Shehzade në Stamboll dhe ajo e Selimje në Edirnë), Mehmet Aga (xhamia Blu në Stamboll)dhe Mehmet Isai (Taxh Mahal, në Indi) etj. Një nga shqiptarët më të shquar, jashtë Turqisë ishte Mehmet Ali

Pasha, i cili la në Egjipt një dinasti prej afërsisht 150 vitesh, nga e cila mbreti Faruk I ishte i fundit që u dëbua nga revolucioni egjiptian në vitin 1952. Duke mbetur tek njerëzit e shquar, të mos harrojmë që shqiptarët, përveç kardinalëve të shumtë, i kanë dhënë Vatikanit Papën e 40-të dhe të 243-të: Papa Inoçenti I u zgjodh në vitin 401 dhe Klementi XI u zgjodh në vitin 1700. Shën Jeronimi ishte me zanafillë ilire. Së fundi, shënojmë (për të kuptuar më mirë karakterin artificial dhe oportunist të kthimit të shqiptarëve në fenë islamike) se në fillimet e periudhës kristiane, pjesa më e madhe e tyre (pjesa tjetër e popullsisë kishte mbetur pagane) u krishtërua në shekullin II, d.m.th më shumë se shtatë shekuj para serbëve!

Cilët janë stërgjyshërit e kosovarëve? Shqiptarët e sotëm rrjedhin drejtpërdrejt nga Ilirët dhe Kosovarët nga Dardanët (Dardanos është stërgjyshi i Trojanëve). Këta dy popuj vëllezër bënin pjesë në një tërësi etnike tejet të madhe të quajtur "thrako-ilire", e cila rridhte drejtpërdrejt nga Pellazgët dhe Lelegët, nga të cilët gjithashtu rridhnin nga Trakët, Teukrët (Trojanët), Frigjianët dhe Ligurët. Këta pellazgë (të paktën 3000 vjet para Krishtit dhe që ka shumë të ngjarë të rridhnin nga popullsitë autoktone të periudhës Neolitike) janë përmendur midis popujve të parë që pushtuan atë vend që më vonë do të bëhej Greqi, si dhe Azinë e Vogël dhe ishujt e Sikladës dhe të Egjeut, përpara mbërritjes së Grekëve siç e pohojnë edhe autorët më të lashtë antikë (Hekate i Miletit, Herodoti, Helanikos i Mitilenit, Tuqididi..). Etruskët bënin pjesë në të njëjtin grup etnik. Në të vërtetë Herodoti (1, 57, 94) dhe Tuqididi (IV, 109), duke përmendur vetëm dy më të shquarit, i përqasin Pellazgët me Tursenët, Tirsenët ose Tirrenët. Pitagora ishte biri i një pellazgo-turseni të Samos! Italia e jugut ishte gjithashtu e populluar nga popuj të shumtë me zanafillë pellazge, ndër të cilët Japigët, Mesapët, Daunianët apo Pisenianët. Megjithatë, duhet shënuar se ilirët dhe trakët i kanë dhënë Romës perandorë të shumtë, ndër të cilët Aureli, Probusi, Diokletiani, dhe Konstandini si dhe perandorë të shumtë bizantinë,

ndër të cilët Anastasi, Justini dhe Justiniani. Të gjitha këto dhe shumë tregues të tjerë që për mungesë vendi nuk mund t`i përmend këtu, dëshmojnë vërtetësinë historike të pellazgëve dhe të pasardhësve të tyre ilirëve dhe si rrjedhojë të shqiptarëve. Ndërkohë që serbët, të cilët kërkojnë zotërimin e Kosovës, mbërritën në Ballkan vetëm rreth shekullit VII pas erës sonë dhe se qytetërimi i tyre në të vërtetë u zhvillua vetëm ndërmjet shekujt IX - XIII.

Ilirët bashkëkohës të grekëve të epokës klasike (shekulli V para Krishtit), ishin një popull i cilësuar "i pavarur" (i lirë, siç e kemi parë tashmë). Në të vërtetë autorët antikë grekë i quanin ata "fise të pavarura" me cilësimin "Barbarë", d.m.th. që nuk kanë pësuar ndikim nga gjuha dhe kultura greke. Grekët themeluan shumë pak zona tregtare, ndër të cilat Epidamni, Apolonia dhe Orikos në bregdetin ilir të Ilirisë së Jugut, jo larg kolonisë së tyre të Korfuzit. Por ata nuk ndërmorën aventura përtej qytetit të Epidamnit (Durrësi i sotëm). Sipas Polienit (IV, I), mbreti i parë ilir i përmendur ndër shkrimet antike ishte Galauros (shekulli VII para Krishtit). Por duke nisur nga shekulli IV para Krishtit flitet për disa mbretër ilirë, ndër ta Bardhyli, Glaukias, Agroni, Pleurati, Genti (mbreti i fundit ilir i shekullit II para Krishtit) dhe mbretëresha e shquar Teuta (shekulli III para Krishtit) emri i së cilës, emër tipik ilir rrjedh nga Teutame ose Teutamos, babai i mbretit të Pellazgëve, Letos i përmendur nga Homeri (Iliada II, 840-843). Të mos harrojmë që heronj të shumtë, perëndi ose mbretër që disa i trajtojnë si grekë janë në të vërtetë me zanafillë pellazge ose thrako-ilire, të tillë si Zeusi, Afërdita, Artemisa, Akili, Olimpia, Aleksandri i Madh, Pirro ... madje Athina! As edhe ky emër nuk mund të shpjegohet me anë të gjuhës greke, por vetëm me anë të gjuhës shqipe. Në të vërtetë "e thana" ose "E thëna" nënkupton "premtimin". Ky shpjegim është vërtetuar në mënyrë jo të drejtpërdrejtë nga Herodoti (I, 57 - VIII, 44), i cili pohon se banorët e parë të Athinës ishin Pellazgët, të cilët ndërtuan murin rrethues të Akropolit ("pelargikon") dhe se Pellazgët

u quajtën "jonianë" [në shqip "I oni" dmth. "i jonë"] pasi përdorën gjuhën greke. Përveç kësaj te Homeri, Zeusi cilësohet si Dodonas dhe pellazg (Iliada XVI, 234), etj! Plus kësaj shtojmë se toponime të shumta të Europës dhe të Azisë së Vogël shpjegohen falë gjuhës shqipe.

Ilirët, intra muros, njohën një farë fame politike deri në vitin 168 para Krishtit. Në këtë periudhë e pushtuan romakët, e plaçkitën dhe copëzuan territoret ilire që ishin katandisur si mos më keq. Më pas gjendja u përkeqësua me rënien e Perandorisë Romake në vitin 476 dhe më pas gjatë Perandorisë Bizantine. Në këto periudha të turbullta përfituan Sllavët, të cilët në shekullin VII pushtuan Ballkanin.

Në planin etnik, morfologjik dhe antropologjik, shqiptarët (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi apo Epiri) dallohen qartë nga fqinjët e tyre sllavë dhe grekë. Shqiptarët e veriut quhen "gegë" dhe ata të jugut "toskë".

Secili nga këto grupe ka dialektin e tij. Shqiptarët kanë veçorinë se kanë një brakicefali (kokë aq e gjerë sa edhe e gjatë) dhe planokcipitali (kaviteti i prapmë i kafkës) tepër të theksuar. Gegët e Veriut, ndër të cilët bëjnë pjesë kosovarët, janë në përgjithësi trupmëdhenj dhe bardhoshë, krejt ndryshe nga grekët që janë më trupvegjël dhe më ezmerë. Nga ana tjetër fjala "gjigand" në greqisht (ghias, ghigas) rrjedh nga fjala shqip Gegë, Gegës. A nuk ishin trupmëdhenj dhe bardhoshë Akili dhe Menelau? Ky rajon me reliev të thyer, ka qenë më pak i prekur nga një përzierje racash, krejt ndryshe nga zonat në kufi të Greqisë apo ato të gjendura në boshtet e mëdha të komunikimit Lindje-Perëndim. Ja përse bazat e gjuhës shqipe kanë mbetur të mbrojtura nga ndërhyrjet e huaja dhe nga përzierjet e mëdha gjuhësore. Shqipëria ka ruajtur pothuajse të paprekura gjatë më shumë se njëzetepesë shekujve në malet e pamposhtura të Alpeve shqiptare: një fosile e gjallë! Pra kjo është një gjuhë autoktone krejt ndryshe nga ajo sllave, gjuhë azianike (Azia Qendrore, Iran ose Baktrian), e cila bën pjesë në gjuhët e fundit të shfaqura në Europë bashkë me gjuhën bullgare dhe atë hungareze (magjare).

Për të përfunduar na duhet të kujtojmë se zanafilla e drejtpërdrejtë e krizës së sotme i ka rrënjët në krijimin shtetit federal jugosllav në vitin 1946, i cili mblodhi etni të shumta antinomike në një komb të vetëm, të përbërë nga gjashtë Republika: Serbia me dy krahinat e saj autonome (Vojvodina dhe Kosovë- Metohi), Sllovenia, Kroacia, Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi. Pastaj trazirat e para të mëdha filluan me shpërbërjen e kësaj federate në vitin 1990. Sllovenia, Kroacia dhe Maqedonia shpallën pavarësinë e tyre. Në vitin 1995 marrëveshja e Deitonit e përfunduar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës i dha fund luftës midis serbëve, kroatëve dhe boshnjakëve. Megjithatë Serbisë i mbetet Mali i Zi dhe provinca e Vojvodinës, ndërsa Kosova kalon nën administrimin e Kombeve të Bashkuara.

Por për sa i takon Kosovës (provincë e populluar deri në 90 % nga shqiptarë) gjendja u përkeqësua në vitin 1989, kur Milosheviçi anuloi në mënyrë të njëanshme statutin e saj (të dhënë nga Tito në vitin 1974) të krahinës autonome. Gjatë dhjetë viteve, nën drejtimin e udhëheqësit të tyre paqësor Ibrahim Rugova, kosovarët të privuar nga të drejtat e tyre civile më elementare i rezistuan në mënyrë paqësore pushtimit serb: ata krijojnë rrethet-e mbijetesës-paralele. Përfundimisht kjo gjendje e dyfishtë krijoi një radikalizëm në gjirin e nacionalistëve kosovarë. Rugova politikisht shtyhej nga krahu i tij i majtë. Kështu u krijua Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Pas afërsisht një vit lufte të armatosur klandestine, një rreze shprese u shfaq në horizont me hapjen e bashkëbisedimeve të Rambujesë (6-20 Shkurt të vitit 1999). Por sa keq, aty nuk pati kurrfarë marrëveshje, secila nga pjesët u ngul në pozicionet e saj. Pas kësaj humbjeje, perëndimorët i kthyen kundërshtarët pa i dhënë të drejtë asnjërit dhe duke u dhënë atyre një shans të fundit në Paris (15-18 Mars). Por më kot, diskutimet dështuan sepse serbët hodhën poshtë ardhjen e forca të huaja në territorin e tyre për garantimin e një autonomie të mirëfilltë të Kosovës dhe si rrjedhojë refuzuan të firmosnin protokollin e marrëveshjes, gjithsesi të sigluar

në minutën e fundit nga kosovarët më 18 mars 1999.

Është për të ardhur keq kur konstaton që në këtë tragjedi të tmerrshme e gjithë bota u tall prej Milosheviçit, i cili duke përfituar nga "pauza" e Rambujesë i dha dorën e fundit përgatitjeve për "spastrimin etnik", gjë që kishte një kohë të gjatë që ishte përpunuar. Kokëfortë që në fillim, më tepër nga mbështetja popullore e paprecedent në historinë europiane (asnjë diktator nuk ka patur një bekim kaq të njëzëshëm), ai krijoi reaksione ndërkombëtare, mori paralajmërime nga Kombet e Bashkuara dhe kërcënime prej NATO, e cila më 24 Mars përfundoi duke hedhur forcat e saj balistike dhe ajrore kundër vendndodhjeve ushtarake të vendit, pikave strategjike dhe disa infrastrukturave, në mënyrë që të dobësonte kapacitetin e tij dëmtues. Fatkeqësisht nën presionin e ushtrisë dhe plaçkitjeve të milicisë serbe (masakra, dhunime kolektive, shtëpi të shkatërruara dhe të djegura, kërcënime për uri etj....) kosovarët përfunduan duke marrë arratinë, me qindra e mijëra prej tyre lanë tokën e të parëve dhe u shpërndanë nëpër botë.

Ajo çka është më paradoksale në këtë luftë etnocidi, është se ndërsa për Perëndimorët, madje për shumë kombe demokratike, Milosheviçi është një kriminel lufte, për një numër të madh serbësh dhe për disa komunistë të vjetër të papenduar ai ishte dhe mbetet figura e patriotit, madje e heroit! Ja se si ky popull arriti të përqafojë tezat e këtij diktatori dhe kasapi të Ballkanit, për të cilin për fat të keq nuk ishte hera e parë.

Për sa i takon "spastrimit etnik" duhet shënuar se bëhet fjalë për një ideologji që është shpalosur në katër faza në vijimësi: veçoria etnofetare ka krijuar një nacionalizëm të shfrenuar të drejtuar nga priftërinjtë e parë ortodoksë, rapsodët e vjetër popullorë dhe intelektualët modernë (faza e parë, e fshehtë dhe përthithëse), teoricienët (faza përgatitore), drejtuesit e pushtetit (faza e ndërmjetme, ndër të cilët bënte pjesë Milosheviçi dhe ushtarakët e tij) dhe ekzekutuesit (faza e fundit, e ndërmarrë nga ushtria dhe milicia speciale me ndihmën aktive ose

joaktive të një pjese të popullsisë). Mbështetja morale popullore e dhënë Milosheviçit përcakton më së miri një herezi kolektive të shkaktuar nga kjo pavetëdije kolektive, e krijuar fshehtas përgjatë shekujve. Milosheviç është serbi i fundit që zbatoi këtë doktrinë të spastrimit etnik. periudhën midis Kjo tezë ishte përpiluar në vitin 1936 nga Çubrilloviçi, ku parashikohej dëbimi i shqiptarëve dhe kalimi e tyre masiv në Shqipëri dhe Turqi. Kjo temë rinisi në vitin 1939 nga Ivo Andriç dhe më vonë nga Dobriça Kosiç. Në të vërtetë në këtë periudhë pati shpërngulje masive të popullsive të Kosovës drejt Turqisë. Gjithsesi, në fillim të shekullit (vitet 1922–1926), ishin të parët grekët që kaluan në spastrim etnik. Në të vërtetë ata kryen një deportim të detyruar të rreth 450 000 shqiptarëve (myslimanë) të Epirit të jugut në këmbim kundrejt grekëve të "dëbuar" (ortodoksë) të Azisë së Vogël. Ky "pazarllëk" i urryer midis Greqisë dhe Turqisë ka kaluar në heshtje në të gjithë manualet e historisë. Nuk flitet më as për gjenocidin e një milion e gjysmë armenëve të masakruar nga turqit në vitin 1915, pikërisht në emër të kësaj politike dhe fetare! Madje fenomeni u përsërit disa vite më pas kundër ebrejve nën regjimin nazist.

Fatkeqësisht ky indoktrimin ultranacionalist, ashtu siç e kemi parë, është i ngulitur thellë në ndërgjegjen e shumë serbëve qysh prej shekujsh. Le të shpresojmë që populli serb do të zgjohet dhe do të kuptojë se ka qenë tmerrësisht i manipuluar nga doktrinistët shovinistë dhe ultranacionalistë të së djeshmes dhe së sotmes.

Histori e shkurtër e Sllavëve të Jugut

Është e qartë se tributë "sllave" me siguri që nuk mund t`i lidhësh me një kulturë arkeologjike të përcaktuar përpara shekullit V të erës sonë. Vetëm me këtë datë, grupet e para të Sllavëve, të identifikuar arkeologjikisht u shfaqën në Ukrainë dhe në Rusi (p. sh. në zonat moçalore të Pripetit). Në këtë epokë fillon ekspansioni i Sllavëve drejt

Europës lindore dhe qendrore pastaj më vonë drejt Adriatikut dhe Ballkanit. Por disa flasin për ta në rrjedhën e dy shekujve të parë të erës sonë. Në të vërtetë historianët e shekullit I pas Krishtit në veri të Kaukazit, në Sarmatie deri në Urale shënojnë popujt si më poshtë: Serbois, Serbis (serbët), Subenois (sllovenët), Horoavis ose Harvats (kroatët), Szici (çekët) ... Disa historianë dhe gjuhëtarë pohojnë se sllavët e parë të shfaqur në verilindje të Kaukazit ishin një popull aziatik që flisnin një gjuhë alarodiane të grupit vanik (rajoni i liqenit Van). "Harvatët" (Kroatët e ardhshëm) ishin të një trungu iranian (emri i tyre nënkupton në persishten e vjetër "Aleatë") ata kanë emigruar nga veriu i Detit të Zi deri në Europën Qendrore, ku themeluan shtetin e "Kroacisë së bardhë" në rajonin e Krakovisë.

Plini I Lashti, Taciti dhe Ptolemeu i quanin sllavët "Venedis": që nuk ka të bëjë fare me Venetët, të cilët ishin të trungut ilir. Këtu ngjashmëria është vetëm fonetike sepse në të vërtetë bëhet fjalë për një deformim të emrit "Vendes" (emërtim gjermanik) i gjuhës sllave, por identiteti kulturor ishte gjermanik ose i gjermanizuar : prej nga vjen edhe ngatërresa e madhe midis Venetëve dhe Vendes. Taciti i vendos sllavët në lindje të Karpateve. Në shekullin VI pas Krishtit, Prokopi dhe Jordani përmendin "Sklavenois" të vendosur në Danubin e poshtëm pastaj në Alpet lindore. Ata u vendosën në territoret e braktisura nga Gjermanët (Obodritë, Sorbë, Pomeranë...). Por ata hyjnë në historinë e këtij rajoni vetëm në epokën karolingiane. Në të vërtetë Sharlëmanjë, në vitin 805, ndërton "Limes Sorbicus", vijën kufitare të kalimit të frankëve lindorë. Paralelisht me këtë mësymje mbi territoret e pushtuara më parë nga gjermanët, ata u ngulën në një rajon të përfshirë midis Danubit dhe Savës dhe në perëndim deri në veri të Ilirisë.

Në shekullin VII (rreth vitit 635) të erës sonë Ballkani ishte bërë pre e hordhive sllave. Nikolas Lahovari (Popujt europianë, 1946) mendon se serbët u vendosën përfundimisht në rajonin e Moravës, në luginën e Danubit dhe në verilindje të Serbisë së sotme vetëm nga shekulli XII

pas Krishtit dhe se Kroatët e kapën shumë më vonë Adriatikun. Për sa i takon hungarezëve, ata janë me zanafillë "magjar". Ata kanë zënë territorin e "Panonisë" antike. Panonianët ishin një fis ilir. N. Lahovari na thotë në lidhje me ta: "Rreth vitit 800 (pas Krishtit) gjenden ende magjarët midis Donit dhe Vollgës. Nën presionin e nomadëve të tjerë, peçenegëve, hungarezët të ndarë në shtatë fise, me të cilët u bashkuan edhe tri fise turko-tartare, kabarët, u vunë dalëngadalë në rrugë drejt perëndimit.. Në çerekun e tretë të shekullit IX ata gjenden në Besarabi. Ndërkohë perandorët e Bizantit, të shqetësuar nga përparimi i bullgarëve, fuqia e të cilëve ishte asokohe në kulmin e saj dhe që kishin bashkuar një pjesë të Panonisë me Khanatin e tyre danubian, kërkuan ndihmën e magjarëve kundër këtyre trupave të rrezikshme fqinje. Hungarezët, aleatë të bizantinëve, kësisoj depërtuan në Panoni nëpërmjet qafave të Karpateve të Veriut në vitin 896 dhe shpejt i dhanë fund mbizotërimit bullgar në veri të Danubit dhe pushtuan territoret ku paraardhësit e tyre dhe një pjesë e degës së tyre, avarët, kishin mbretëruar dhe ku kishin lënë pasardhës të shumtë, pavarësisht shpartallimit të tyre nën goditjen e frankëve..."

Sipas Jordanesit politika e perandorit Justinian do të ketë ndihmuar në tërheqjen e këtij pushtuesi të ri. Në luftë me popujt gjermanikë, në Itali dhe gjetiu, në të vërtetë ai mendoi të gjente aleatë me vlerë dhe një kundërpeshë të nevojshme te sllavët dhe i thirri ata për ndihmë. Këta nxituan të vinin për ndihmë, por në vend që të luftonin gjermanët bënë atë që bënin gjermanët: pushtuan edhe ata tokat e perandorisë.

N. LAHOVARI pohon nga ana e tij: "E gjithë bota sllave, kaq sa ekziston, bazohet sot më shumë madje edhe se bota anglo-gjermane ose latine, në një bazë gjuhësore". E. PITARD (Racat e Historisë) nga ana e tij vëren: "Ne mund të pohojmë dhe në këtë pikë nuk duhen parë gabim se nuk është në baza etnike ajo çfarë sot mban emrin e rusëve - nuancat e ndryshme - dhe të polakut, të cilat u morën nga Sllavët e Jugut, ata midis tyre nuk kanë asnjë bashkësi zanafille ... dhe do të

ishte shumë e vështirë që "Sllavët e Veriut"... t`i quaje si vëllezër të një gjaku me këta popuj".... M.R. Sauter (Racat e Europës) pohon nga ana e tij: "Zanafilla e sllavëve, popull indo-europian, është ende e mistershme. Ka të ngjarë që misteri vjen pjesërisht nga moria e kësaj zanafille. Sido që të jetë, ky popull ka nisur të dallohet ndërmjet shekujt II – V pas Krishtit".

Përsa i takon Rusëve, për ta unë nuk do të bëj ndonjë studim të hollësishëm sepse janë pak larg nga rajoni që më intereson në veçanti: Ballkani dhe Europa Qendrore. Vatrat zanafillore të pellazgëve të lashtë, ilirëve dhe trakëve. Do të citoj thjesht këto dy thënie të antropologut dhe paleontologut M.R. SAUTER (Racat e Europës, 1952): "Duhet të pajtohëmi me mendimin e Kun se "Rusia" është një vend i ri nga pikëpamja e migrimeve dhe të pushtimeve humane, ndërsa e krahasojmë me pjesën tjetër të Europës: nga fenomenet demografike ajo ngjan me saktë me SHBA dhe Kanadanë"; d.m.th. që imazhi racor i popullsive të saj është plot me shndërrime... Gjuhëtarët pranojnë se gjuhët sllave, ashtu si e gjithë pjesa tjetër e gjuhëve baltike (letonishtja dhe lituanishtja), përbëjnë një grup relativisht të largët nga grupet e tjera indo-europiane të folura në Europë..."

Pra është e sigurt se sllavët nuk janë një popull **his**torikisht antik. Siç është vërejtur, ata janë njohur shumë vonë. Ne nuk gjejmë as edhe një gjurmë në antikitet, mbi të gjitha në rajonin e pushtuar sot nga Sllavët e Jugut: serbët, kroatët, sllovenët, boshnjakët, maqedonët dhe më në fund bullgarët, të fundit që arritën dhe që janë etnikisht të ndryshëm. Në të vërtetë bullgarët janë me zanafillë turko-mongole ose turaniane. Ata përdorën gjuhën sllave me disa nuanca dhe përqafuan fenë ortodokse (atë të serbëve, nënkuptohet). Por gjuha bullgare kaloi nivelin e gjuhës letrare vetëm në shekullin XIX. Bullgaria, e cila në antikitet zihej nga thrakët, pas pushtimit romak, u pushtua në masë nga sllavët, të cilët i imponuan asaj gjuhën e tyre dhe për më tepër ia imponuan atë një tjetër pushtuesi, bullgarit të ardhur nga stepat ruse.

Mësymjet e hunëve, bullgarëve dhe të avarëve duket se kanë qenë një faktor vendimtar i ekspansionit sllav, i cili si pasojë e shkatërrimeve të bëra nga hordhi të ndryshme në Europë gjeti një terren pjesërisht të përgatitur.

Qytetërimi i Sllavëve të Jugut ka gjurmë njëherësh nga një fond i lashtë sllav dhe i traditave vendase të rajoneve që ata pushtuan, në veçanti ato thrako-ilire. Gjuhët që i rezistuan pushtimit të sllavëve në Ballkan janë shqipja (bastioni i fundit i Ilirisë antike dhe e vetmja gjuhë parahelenike e krahinës), gjuha magjare në Hungari (ka të ngjarë sepse është më i vonë dhe më pas se gjuha sllave), rumanishtja (gjuhë romane me prurje thelbësore dako-gete të trungut ilir) dhe sigurisht edhe gjuha greke. Xhorxh PUASON në librin e tij "Popullsia e Europës" pohon: "Çështja e zanafillës dhe e zhvillimit të sllavëve është një nga më të errëtat të historisë dhe të parahistorisë... Në arkeologji, karakteri i tyre i mirëfilltë shfaqet vetëm në atë që quhet qytetërimi "Burguolls", i cili daton shumë shekuj pas erës sonë".

Ja çfarë na thonë F. GIRAND dhe J. SHMIDT (Mite dhe Mitologji) në lidhje me sllavët: "Vetëm në Kiev dhe në bregdetin e detit Baltik (në ishullin Rugen) gjenden te sllavët gjurmë të një hierarkie pak a shumë të përcaktuar të perëndive fuqiplota, me disa idhuj, priftërinj dhe rite. Në tërësi, mitologjia sllave nuk ka mundur të gjejë një shprehje materiale të mjaftueshme për tu saktësuar në figura të përcaktuara. Ajo mbeti e paqartë dhe e pasaktësuar ashtu si peizazhi i pjesës më të madhe të zonave të banuara nga raca sllave".

Gjuha sllave përfshin tri grupe kryesore:

1) Nën termin "sllavishtja lindore" gjenden të grupuara gjuhët e folura në ish-Bashkimin Sovjetik : rusishtja e madhe (Velkorus) ose letërsia ruse mori mjetin e të shprehurit. Rusishtja e madhe është gjuha më e përhapur e këtij rajoni lindor të Europës, pas gjermanishtes;

"rusishtes së bardhë" (bjellorusishtes) dhe "Rutene" ose rusishtja e vogël (gjuha ukrainase, ruteniane, maloruse).

2) Grupi sllav perëndimor përfshin në thelb tre popuj: Polakët, Çekët dhe Sllovakët.

3) Grupi sllav jugor përfshin Serbët, Kroatët, Sllovenët, Boshnjakët, Hercegovinët, Malazezët, Maqedonët dhe Bullgarët.

Por sllavët në shekullin IX pas Krishtit përshtatën alfabetin "cirilik" të shpikur nga dy vëllezërit të lindur në Greqi (Selanoki) : Cirili (829–869) dhe Metodi (825–885). Për nevojat e ungjillëzimit të tyre në vendet sllave, ata përkthyen në gjuhën sllave Biblën, fillimisht me "germa të vogla" të alfabetit grek gjë që çoi në alfabetin glagolitik që e merr emrin nga fjala "glagol", e cila në sllavishten e vjetër do të thotë "fjalë". Kjo ende përdoret nga katolikët dalmatë nëpër librat e tyre liturgjikë. Më pas bëhet ai "alfabeti cirilik" i krijuar duke u nisur nga "gërmat kapitale greke". Në shekullin XVIII Pjetri i Madh reformoi alfabetin joliturgjik që dallohej prej atij të përdorur nga Kisha. Shënojmë se mbretërit e Francës merrnin bekimin në Reims, mbi një ungjill të përkthyer me germa glagolitike nga Shën Jeronimi (me zanafillë ilire)! Në këtë epokë, besimi i ri i krishterë mbështeti shkrirjen e elementëve etnikë dhe atyre kulturorë heterogjenë. Krishterimi solli me vete një nivel më të lartë qytetërimi. Në fushën e fesë, traditat kulturore krijonin një konfiguracion të përbërë. Rajonet që e ndjenë më shumë ndikimin austriak u kthyen në katolikë (Sllloveni, Kroaci) dhe në këtë rast përshtatën alfabetin latin për të shkruar gjuhën. Sllavët e tjerë të jugut, të hapur ndaj ndikimit grek dhe rus, në pjesën më të madhe përqafuan fenë ortodokse. Më pas në shekujt XIII dhe XV sundimi otoman futi fenë myslimane në Bosnje, Kosovë dhe Maqedoni si dhe në pjesën e mbetur në Shqipëri dhe pjesën skajore lindore të Thrakës (sot "Turqia Europiane"). Për sa i takon Ciganëve dhe Vllehve, ata kanë mbërritur në Ballkan nën Perandorinë Bizantine dhe më pas nën otomanët. Ata përdorën gjuhën e vendit ku u ngulën prej kohësh të hershme.

Kjo përmbledhje në lidhje me sllavët ka të bëjë më shumë me Sllavët e Jugut, të cilët ndërmjet shekujt VII - XII, pushtuan pjesën më të madhe të Ballkanit, në veçanti territoret e banuara qysh në mugëtirën e kohërave nga pasardhësit e pellazgëve: thrakët dhe ilirët. Këto territore u katandisën keq e më keq nga pushtimet e njëpasnjëshme dhe sllavizmi i pjesës më të madhe të vendbanimeve të para dhe më të lashta të këtij rajoni. Në të vërtetë i vetmi që ka mbijetuar është territori i Shqipërisë së sotme, pa llogaritur krahinat ilire në kufi, të marra nga vendet fqinje, ndër të cilat Serbia, Maqedonia dhe Greqia. Kjo gjendje është miratuar nga traktate të shumta të ratifikuara në shekujt XIX dhe XX: në dëm të popullit të lashtë shqiptar, i vetmi para grekëve, i cili ka zënë një territor stërgjyshor qysh më shumë se 4000 vjet më parë. Sllavët dhe bullgarët janë popujt e fundit, të cilët kanë pushtuar këtë rajon iliro-shqiptar. Në të vërtetë për sa i takon Shqipërisë, turqit nuk e pushtuan "etnikisht" por "nga ana administrative dhe ushtarake" duke e islamizuar pjesërisht dhe me kalimin e kohës. Nga kjo nuk duhet të nxjerrim përfundim e nxituar se për këtë arsye turqit kanë "përzier" pjesën më të madhe të popullsive ballkanike. Elementi etnik nuk hyri aspak në lojë. Shqiptarët e islamizuar, rreth 70 %, kanë ruajtur "genet" e ilirëve të lashtë të tyre, karakteret e tyre, traditat, kulturën, gjuhën, kostumet dhe kanë ruajtur të njëjtën morfologji fizike. Boshnjakët kanë qenë tepër të islamizuar nga turqit por në planet etnike, fizike dhe morfologjike ata nuk përqasen aspak me turqit! Gjenden "biondë dhe trupmëdhenj" të shumtë në numër, njëherazi te shqiptarët dhe boshnjakët, karakteristika etnike që nuk gjenden te turqit, të cilët janë trupvegjël dhe zeshkanë. Në të vërtetë shqiptarët në planin etnik janë të "tipit dinarik" dhe në një numër më të vogël janë të "tipit alpin" ose alpino-dinarik. Për sa u takon turqve, ata në pjesën më të madhe janë të "tipit mesdhetar" i theksuar, pavarësisht përzierjes shumë të madhe të racave. Gjithsesi vetëm rajonet kufitare të Turqisë Europiane (skaji juglindor i Trakës antike) kanë pësuar përzierje të shumta racash dhe

kanë favorizuar ngulitjen e turqve të imigruar (Maqedoni, Bullgari dhe Dobrudja rumune). Makiavelizmi dhe shovinizmi i serbëve duan të na bëjnë të besojmë se FEJA = RACËN ! Me sa di unë, turqit, iranianët, afganët, sudanezët ose senegalezët nuk janë "Arabë" : ata janë "myslimanë", kjo është e gjitha. Të jesh "mysliman" nuk është KOMBËSI. Megjithatë është kjo ajo që e ka bërë "ideologjinë serbe" ta cilësojë "kombin boshnjak" "MYSLIMAN" dhe kjo vetëm për të shuar etjen e ultranacionalizmit, shovinizmit dhe racizmit. Përfundimi i kësaj politike dhe i kësaj ideologjie është konkretizuar në "etnocidin" mizor në Bosnje, në një luftë të provokuar nga serbët dhe që vazhdoi deri në vitin 1991 dhe përfundoi me marrëveshjen e Deitonit më (21/11/1995). Qysh me anulimin (23/03/1989) nga Milosheviç të autonomisë së dhënë në vitin 1974 nën regjimin e Titos, Kosova nuk ka reshtur së qeni objekt represionesh të dhunshme serbe, të cilat i privuan shqiptarëve të drejtat e tyre civile më elementare.

Së fundi (janar–prill 1999), nacionalizmi i shfrenuar dhe shovinizmi etno–fetar në Serbi kanë qenë kaq evidente sa çështja e "zanafillave" është në kulmin e saj dhe gjithmonë aktualitet: kjo u pa me "spastrimin etnik" në Bosnje dhe ende e shohim në Kosovë, ku popullsia shqiptare nga ushtria dhe milicia serbe u deportua, u dëbua nga toka e tij stërgjyshore dhe toka u dogj me zjarr e me hekur dhe u la me gjak.

Le të përmbledhim historinë e këtij problemi: Në shekullin IX pas Krishtit, Cirili dhe Metodi (priftërinj grekë) kanë ungjillëzuar të gjithë Ballkanin dhe krishtëruan të gjithë popullsinë sllave të krahinës duke krijuar një Ungjill të përkthyer në gjuhën sllave, falë një alfabeti të ri që rridhte drejtpërdrejt nga greqishtja. Ata ngritën këtu "peshkopata", ndër të cilat më e shquara ajo e Ohrit (qytet, në kufirin lindor të Shqipërisë) pastaj ai i Peçit dhe të tjerë. Ja përse "të gjithë sllavët e botës" e trajtojnë këtë "tokë" (në zanafillë "iliro–shqiptare") si vendi i "stërgjyshërve" të tyre dhe "djepi i qytetërimit të tyre"; ndërkohë që është evidente se Kosova, veriu dhe perëndimi i Maqedonisë kanë qenë

të populluara nga ilirët dhe trakët qysh nga kohët më të hershme. Kjo krahinë ka qenë quajtur "DARDANI" (në shqip = "Vendi i dardhave") qysh në antikitetin e hershëm deri në pushtimin romak. Ja përse serbët, vetëm për të përligjur këtë aneksim, e trajtojnë se Kosovarët (shqiptarët e Kosovës) mbërritën aty nga Shqipëria që gjendet në kufi në shekullin XIV gjatë kohës së pushtimit turk! Disa sllavë madje guxojnë të thonë se bëhet fjalë për një popullsi me zanafillë turke! Besimi i tyre i gabuar është i dukshëm. Kjo gjendje u përkeqësua për shkak të proselitizmit fetar dhe mbi të gjitha për shkak të shovinizmit të disa shkrimtarëve tendenciozë që kanë mburrur këto lloj të pavërtetash dhe vijojnë ta bëjnë këtë pa u druajtur.

Pjesa më e madhe e studimeve arkeologjike, antropologjike, paleontologjike, epigrafike, onomastike, toponimike dhe etnologjike provojnë se Kosovarët gjenden aty ku janë sot, të paktën qysh për më shumë se 3000 vjet dhe jo si në rastin e Sllavëve vetëm qysh në shekullin VII pas Krishtit.

Nga të gjitha popullsitë ilire të sllavizuara, duke filluar nga shekulli VII deri në shekullin XII pas Krishtit, janë Malazezët që kanë më shumë "përafërsi etnike" me shqiptarët: Ata janë trupmëdhenj, truplidhur dhe morfologjia e tyre si dhe karakteri i tyre përqasen me ato të "gegëve" të veriut të Shqipërisë ("gjigandët" e mitologjisë). Malazezët, ashtu si shqiptarët kanë treguesin cefalik më të lartë në Europë (hiperbrakicefali të theksuar: 85/90). Prova të tjera të sjella në veprën që keni në dorë e vendosin përkatësinë e kosovarëve dhe dibranëve të Maqedonisë në etninë thrako-ilire.

Së fundi, për të përfunduar këtë kapitull mbi sllavët, do të përmendja këtë thënie të rëndësishme të KUN: "As gjuha, as feja, gjithsesi as tipi i përgjithshëm i qytetërimit nuk ka kurrfarë lidhje me problemin racor në Jugosllavi, meqenëse në brendësi të kësaj mbretërie gjendet pika e përqendrimit të të gjithë zonës dinarike". Ne do të shohim në shtesën e këtij kapitulli ngjarjet kronologjike të ndodhura në rajonin e Ballkanit

dhe në veçanti atë të pushtuar nga Sllavët e Jugut.

Nuk mund ta mbyllim këtë kapitull për sllavët pa folur për hunët, avarët dhe alaenët. Të gjitha këto fise aziatike u lëshuan për pushtime drejt perëndimit dhe janë zanafilla e popujve të shumtë të Europës Lindore (popullsitë Fino - ugore, sllave, magjare...) pak a shumë të përzier me popullsitë autoktone të veriut, të qendrës dhe të jugut të Europës (gjermanët, keltët, ilirët).

Pasi u dëbuan nga Kina, hunët (popull kalorësish, nomadë të Azisë qendrore dhe të jugut të Siberisë) depërtuan në stepat e Rusisë së Jugut. Sipas historianit Halfen, në fillim të shekullit V ata themeluan një perandori të stërmadhe që zinte gjysmën e Europës: Nga Kaukazi deri në Elbë. Është interesante të vëresh në manualet e historisë se gjithçka që njihet për hunët, është ATILA mizor dhe gjakatar! Për shkak të natyrës së tyre nomade për ata ishte e vështirë të krijonin ngulime. Për të vendosur pushtetin e tyre ata ndërmerrnin sulme të shpejta dhe të përgjakshme. Në vitin 451, ushtritë e bashkuara të Aetius (Romak) dhe të Torismond (Visigot, biri i Teodorik I) i zmbrapsën sulmet e Atilës (rreth viteve 395–453) në fillim në betejën e Orleanit pastaj asaj të mbiquajtur Fushat "katalonike" (Trojane). Por me vdekjen e tij perandoria e Hunëve u shpërbë. Vetëm disa grupe nomade vepronin në Ballkan duke ngritur shqetësimin dhe duke shtuar tensionin në Perandorinë e Lindjes. Të tjerë u rigrupuan në rrafshinat ruse, ku themeluan shtete të reja. Sa për Hunët "Heftalitë" ose "Cvetahuna", nuk ishte fjala për proto-mongolë ose proto-turq, por thjesht për iranianë.

Avarët, në shekullin IV përsëritën aventurën e hunëve, pjesët mbetura të të cilëve ata i kishin asimiluar. Pas shkatërrimit të perandorisë së tyre nga turko - tartarët në vitin 552, ata u përhapën në masë në Europën lindore. Të vendosur në fushën danubiane dhe në fushat e Tiscas, të përforcuar nga hunët dhe bullgarët, ata ndërmorën qysh në mes të shekullit VI një mësymje në krahët e perandorive të Romës dhe të Bizantit dhe formuan një bashkësi me "Sklavenois". Ata

u mposhtën nën goditjet e Sharlëmanjë (791–796).

Alenët janë përmendur për herë të parë në shekullin I nga Seneka në tragjedinë e tij "Tieste". Në shekullin III ata kanë lënë gjurmë në lindje të Donit, në Kazakistan, në veri të detit Aral. Por disa historianë i trajtojnë ata se bënin pjesë në etninë e Sarmatëve. Amnien Marcellin, historian i shekullit I pohon në lidhje me alenët: "Ata janë të bukur dhe trupmëdhenj dhe flokët e tyre vijnë në ngjyrë të verdhë.. Kanë një vështrim më tepër luftarak sesa mizor... Për shpejtësinë e sulmit dhe karakterin luftarak ata nuk bien poshtë hunëve". Alenët ngjasojnë se kanë qenë tepër të përafërt me aorsët. Këta të fundit mbretëruan në Azinë qendrore rreth shekullit I dhe II. Emri alain (AL`LAN'AI) do të ketë zëvendësuar atë të aorsëve (AN`TS`AI). Nga fundi i shekullit I ata u përhapën drejt rajoneve pontike dhe Krimesë dhe u ngulën në rajonin e Dnjeprit. Nën shtytjen e Hunëve ata u dyndën nëpër Europën perëndimore. Në vitin 380 lokalizohen në Panoni. Në vitet 406–408 kapërcejnë Galinë dhe kalojnë në Spanjë dhe në Afrikën e veriut (rreth vitit 429). Ne gjejmë gjurmë të kalimit të tyre në Gali nëpër toponimet e mëposhtme: Alinkurt, Alenjë, Alenvil, Alen, Alenë, Alinktum, Alan ...! Gjenden gjithashtu në Poloni, në Kaukaz dhe në veri të ish - Jugosllavisë. Ja përse autorë të tjerë pohojnë se serbët dhe kroatët nuk duhet të jenë me zanafillë sllave por "alanike". Përsa i takon gjuhës sllave ajo bën pjesë në gjuhët e quajtura indo-europiane të grupit azianik. Këto të fundit janë të tipit "Satem" me përjashtim të gjuhës tokariane. Në Europë pjesa më e madhe e gjuhëve janë të tipit "Centum". Ky përjashtim i gjuhës sllave shpjegohet nga shfaqja më e vonë e sllavëve në Europë. G. Puason në lidhje me këtë pohon: "Disa dijetarë të ndryshëm, pikërisht ata sllavë, mbështetin se ekzistenca e popullsive sllave në lindje të Europës është shumë e lashtë, por të dhënat e parahistorisë nuk janë aspak të favorshme për këtë mendim". Gjithmonë ka specialistë të shumtë që e trajtojnë se djepi i gjuhëve sllave ngjan të jetë i lokalizuar në rajonin e moçalishteve të Pripetit,

dikur i quajtur Poldezi dhe që sot bën pjesë në Rusinë të quajtur e bardhë. Ja çfarë na thotë G.Puason në lidhje me zanafillën e sllavëve: "Por nuk është më e thjeshtë dhe më e mundshme të pranojmë se Sarmatët e Kaukazit janë me të vërtetë sllavë dhe se e kanë përfunduar sllavizimin e rajonit të Pripetit, të filluar tashmë nga Skithët. Ata do ta kenë sjellë në Europë këtë veçori gjuhësore të asimilimit të tingujve guturale*), të panjohur deri atëherë në grupin arian të Europës siç jam përpjekur ta paraqes sipas Filiponit; përkundrazi, ajo është pikërisht në grupin aziatik".

Xhon Geipel (Antropologjia e Europës), të cilin unë nuk e mbështes gjithmonë në disa nga pikëpamjet e tij, bën një analizë shumë të drejtë për sa i takon etnisë së sotme që gjendet në Shqipërinë e Veriut, në Mal të Zi dhe në një pjesë të Bosnjës dhe zanafilla e së cilës ngjitet deri tek Ilirët; kjo analizë vërteton atë çfarë unë kam pohuar në një paragraf të mësipërm, d.m.th. tipin e tyre dinarik, hiperbrakicefalinë e tyre dhe zanafillën e lashtë e etnisë së tyre: "Prejardhja e mundshme e individëve trupmëdhenj që jetonin në perëndim të Ballkanik mund të ravijëzohej me saktësi. Malazezët dhe një numër i boshnjakëve dhe shqiptarëve numërohen midis më të mëdhenjve dhe më të fortëve nga banorët e Europës. Në disa pjesë të Malit të Zi, shtati mesatar është nga 1,75 deri 1, 85 cm d.m.th e njëjtë me atë të shumë islandezëve dhe skocezëve të malësive. Megjithëse malazezët dhe boshnjakët sot flasin dialekte sllave, nuk ka pikë dyshimi që të parët e tyre kishin një trup të lidhur në Ballkan, shumë kohë përpara epokës se depërtimit të gjuhëve sllave që përcaktohet duke filluar nga shekulli VI pas Krishtit. Rajone të shumta ballkanike mbeten edhe sot shumë të vështirë për tu depërtuar. Aty gjenden bashkësi të panumërta të luginave, ku njerëzit jetojnë në një izolim relativ si ndërmjet fshatrave ashtu edhe në lidhje me botën e jashtme. Me të drejtë mund të hamendësojmë se në enklava, individët

*) *grykorë*

e fortë dhe trupmëdhenj duhet të kenë jetuar të izoluar qysh prej kohësh të motshme dhe madje qysh në epokën akullnajore.... Disa popullsi malësorësh pas vargmalit dinarik (Shqiptar dhe Malazez) janë të fundit ndër Europianët, të cilët i kanë nofullat të mbivendosura njëra mbi tjetrën në mënyrë të përpiktë, d.m.th. kur mbyllet goja dhëmbët e sipërm dhe të poshtëm vihen në kontakt të përkryer. Kjo vendosje dhëmbësh mbeti karakteristikë e Europianë të shumtë (ashtu si edhe sot të gjuetarët dhe njerëzit që jetojnë nga vjelja e bimëve) deri në Mesjetë". Midis argumenteve të tjera, kjo vërteton ekzistencën e mëparshme të Ilirëve dhe Shqiptarëve në këtë rajon si dhe zanafillën gjysmë shqiptare të Malazezëve (të sllavizuar duke filluar nga shekulli X pas Krishtit). Përveç kësaj Kun mendon se "gjuhët indo-europiane kanë qenë përdorur dikur nga një tip i vetëm race, sidoqoftë i përbërë dhe se ky tip racor ishte një paraardhës nordik". Kun shton më në fund se elementi nordik rigjendet, duke mbizotëruar kësaj here te Gjermanët e parë, ashtu si te Ilirët e Parë". Ja përse në një kapitull kushtuar keltëve dhe një tjetër gjermanëve, unë pohoj disa ngjashmëri midis gjuhëve të tyre dhe gjuhës së sotme shqipe. Së fundmi, kjo vërteton tipin nordik ose dinarik të heronjve të Homerit: biond, të fortë dhe trupmëdhenj. Si rrjedhojë kjo vërteton gjithashtu dekrip timin gjuhësor të emrave të Mitologjisë nëpërmjet gjuhës së sotme shqipe. Kjo gjithashtu vlen edhe në kuptimin e shkrimeve të Herodotit, duke pohuar që Pellazgët ua përcollën Grekëve emrat dhe hyjnitë e tyre. Kjo alkimi u ka shpëtuar gjuhëtarëve të shumtë, antropologëve, etnologëve ose helenistëve të shquar !

Dhe disa fjalë për Bosnjë - Hercegovinën, meqenëse sot ajo është një shtet krejtësisht më vete, pasi ka kaluar një periudhë lufte tragjike. Në të vërtetë nuk ka "etni" boshnjake në kuptimin e plotë të fjalës sepse bëhet fjalë për popullsi të përziera të Sllavëve dhe të Kroatëve. Megjithatë një shtet i pavarur u krijua aty me gjithë të mirat apo të këqijat në vitin 1322. Por vendi ra nën sundimin turk deri në vitin

1878: Traktati i Shën Stefanit (03/03) dhe traktati i Berlinit (13/07). Në vitin 1918 Boshnjakët vendosin të bashkohen me serbët. Këtu po ndalem sepse objekti i këtij libri nuk është të ravijëzoj historinë e të gjithë popujve të rajonit ballkanik, por thjesht për të vendosur faktet thelbësore që kanë përvijuar "zanafillat" e popujve që e formojnë atë. Për më tepër sepse problemi i "zanafillave" përbën edhe sot një konflikt të përhershëm: secili kërkon që t`ia veshi vetes stërgjyshërit "e lashtë, prestigjiozë dhe ka shumë të ngjarë autoktonë"!

Historia e Europës lindore jo vetëm që është e ndërlikuar dhe e ndërthurur, por ajo është e ngatërruar nga burime të shumta informacionesh kontradiktore. Shpresoj se e ardhmja dhe kërkimet e së ardhmes do të na sqarojnë edhe më shumë. Po e përfundoj këtë paragraf me thënien e M.R. Sauter: "Sidoqoftë disa gjurmë mongoloide të bartura nga Hunët, Avarët pastaj Magjarët janë ngulitur me shpejtësi në masën e bardhën". Unë mendoj që shenja shumë e theksuar e kalimit të tyre në këtë pjesë të Europës, gjendet mbi të gjitha të sllavët e vërtetë (p.sh. një pjesë e madhe e rusëve), disa bullgarë dhe magjarë, ndër të cilët tipat fizikë janë të lehtë për tu dalluar.

Sa për Skithët, popull antik që zinte rajonin veri-perëndimor të detit të Zi, do tu kushtoj një paragraf të veçantë në veprën time të ardhshme. Në të vërtetë nuk mund të trajtohen Skithët si të ishin stërgjyshërit e sllavëve vetëm sepse kanë banuar në territoret ku sot banojnë sllavët; në të njëjtën mënyrë Ilirët, të shfaqur përpara mijëvjeçarit të parë para Krishtit, nuk mund të jenë stërgjyshërit e serbëve, kroatëve ose sllovenëve, të arritur në këtë rajon në shekullin VI/VII pas Krishtit ! Megjithatë duhet shënuar se ilirët janë shumë më të lashtë se Skithët. Nga ana tjetër nuk mund të trajtohet se bullgarët janë pasardhës të Thrakëve antikë vetëm sepse kanë zënë territoret e tyre nga shekujt VII/VIII pas Krishtit, ndërkohë që Thrakët kanë qenë vendosur aty shumë më parë Luftës së Trojës. Sidoqë të jetë Historia referon por nuk shpik.

Sllavët: kronologji e shkurtër e ngjarjeve kryesore, zanafillave deri në shekullin XV

Shekulli I dhe shekulli II pas Krishtit:

Sllavët e parë nisin të shfaqen në Europën lindore dhe në veri të Kaukazit (brigjet e Donit dhe buzë Detit të Zi). Këta janë nomadët ose barinjtë që jetojnë në fise. Ata u ngulën më shumë midis Karpateve, Vistulit dhe Pripetit.

Grupet sllave ndahen kështu :

Perëndim: Polakë, Çekë, Sllovakë, Sorabë.

Lindje: Rusë, Bjellorusë, Ukrainas (ose Rutenë).

Jug: Sllovenë, Serbo – kroatë, më vonë disa marrin emra Maqedonë, Boshnjakë dhe Malazezë.

Gjuha slavone (sllavishtja e vjetër), gjuhë e shkruar e sllavëve, është dëshmuar vetëm nga fillimi i shekullit IX

Shekulli IV - VI

Në shekullin VI Prokopi dhe Jordanes flasin për Sklavenoi që banojnë në Danubin e poshtëm. Ata vendosen në Saksoni, midis Elbës dhe Saalës, ku deri në shekullin VII quhen Sorabë. Fise të ndryshme sllave shfaqen: Oboritë, Sorbë, Vendë (të quajtur gabimisht Venedë ose Venetë) dhe Pomeranë. Gjithsesi, Çekët hynë në histori vetëm nga epoka karolingiane. Fillimi i ekspansionit sllav në Europën lindore dhe qendrore (në lindje të Karpateve deri në Urale, Danubi i poshtëm). Serbët e vendosur në fillim në veriperëndim të Kaukazit (popull azianik që flet një gjuhë alarodiane të grupit vanik) vendosen në Saksoni.

395: Vdekja e perandorit Theodhos: ndarja e Perandorisë midis bijve të tij, Arkadius (Lindje) dhe Honorius (Perëndim).

Shekulli VII - VIII

Serbët fillojnë të vendosen në Ilirinë e Veriut, ndër të cilat Panoni dhe Dalmaci, edhe në Thesali, Maqedoni, në veri të Drinit dhe përhapen nga pak kudo nëpër Ballkan. U deshën dy shekuj për të ngulur aty, deri në epokën e krishterimit të tyre në shekullin IX.

Një pjesë e Serbëve ose Sorabë mbeti vasale i mbretit të Frankëve.

Krijimi i një principate sllovene: Shteti Karantanija.

Stërgjyshërit e Kroatëve, Harvatët, vendosen në Krakovia, rreth mesit të shekullit VII. Rreth shekullit VIII pas sllavizimit të tyre, ata ngulen në Panoni dhe në Dalmaci. Bullgarët të mbërritur në shekullin VIII në rajonin e Ballkanit nisin të sllavizohen me shpejtësi.

Përpara se të vendosen përfundimisht aty, ata kishin krijuar (veriu i Thrakisë) shtetin e parë sllavo – bullgar në vitin 681 nën mbretërimin e Khan Asparuk. Në të vërtetë Bullgarët, të dalë nga fiset Hunë, tërhiqen në stepat e Rusisë jugore dhe përzihen me Ujgurët duke themeluar një perandori bullgare që arriti kulmin e saj nën Kufrat (vdiq më 679). Kazarët e shkatërrojnë këtë mbretëri. Një pjesë e Bullgarëve themelojnë një shtet mbi Danub, një tjetër në Vollga. Mongolët e zhdukin në shekullin XIII. Pjesa tjetër mbeti nën Kazarët. Prej viteve 701 - 796 Karolingianët mposhtën Avarët. Këta të fundit u zhdukën rreth vitit 822.

Shekulli IX

Viti 805:

Sharlëmanjë ndërton "Limes sorbicus" (vijën kufitare midis lëvizjeve të Frankëve lindorë). Lidhja e fiseve të Sllavëve të jugut shndërrohet në principatën e RAŠ (Rasa, Rasha, Raska ose Rashi). Cirili dhe Metodi, dy murgj grekë sllavofolës krijojnë "alfabetin glagolitik", i cili u thjeshtëzua dhe më pas u quajt "cirilik". Krishterimi i Serbëve (të bashkangjitur Perandorisë bullgare). Peshkopata e Ohrit bëhet një qendër e rëndësishme fetare, më pas vatra e kulturës greko – sllave.

Nga fundi i shekullit IX: shfaqja e Magjarëve (Hungarezëve). Arpad, prijësi i fiseve hungareze kapërcen qafën e Karpateve në vitet 895 - 896. Ai mbretëroi në "gjarpërimet e Karpateve". Kështu Hungarezët vendosen hap pas hapi në luginat e Transilvanisë dhe të Danubit të Mesëm. Në vitin 830 Voislav bëhet Zhupani i madh i Serbëve. Boris i Bullgarisë bëhet i krishterë (viti 864). Kristianizmi i Bullgarëve (864 - 865). Themelimi i Kishës së parë lindore autoqefale. Krishterimi i grupit rus.

862 - 912 : dinastia e Princave të Novgorodit të Kievit
893 - 1018 : perandoria e parë Bullgare
896 : fitorja e Simeonit të Madh (Khan i Bullgarëve) kundër Bizantit

Shekulli X - XV :
902 - 908
Hungarezët zhdukin shtetin sllav të Moravisë së Madhe (Bohemë, Moravi, Silezi dhe rajoni i Krakovias).
913
Simeoni I i Madh rrethon Kostandinopojën për t'u kurorëzuar aty Perandor i Bullgarëve. Lindja e shteteve kombëtare.
Simeoni I i Madh shpallet Car në vitin 921.
Tomislav krijon një shtet kroat në vitin 925. Biri i tij Dragoslav bëhet mbret i Kroacisë.

912 - 1157
Dinastia e dukëve të Mëdhenj të Kievit.
Nën sundimin e Simeonit (893 - 927), biri të Boris I (852 - 889), Bullgaria bëhet e pavarur, pas shpartallimit të ushtrive perandorake në vitin 896. Në vitin 924 Serbët bëhen vasalë të Bullgarëve.
Aneksimet bullgare përzmadhojnë Perandorinë.
Shpartallimi i Hungarezëve nga Otoni i Madh, mbreti i Gjermanëve,

më 10/08/955 në Lehfelf (pranë Augsburg). Qysh atëherë ndikimi i Sllavëve fqinjë favorizon ngulimin e Hungarezëve.

973

Themelimi i Peshkopatës së Pragës.

948

Themelimi i Dioqezave të Havelberg, Brandeburg dhe Oldenburg.

966

Pagëzimi i Dukës Miesko të Polonisë (960 - 992), themeluesi i dinastisë së Piastëve.

Etnia polake veçohet në gjirin e bashkësisë sllave.

988

Pagëzimi i princit të madh rus Vladimir I (980 - 1015).

997 - 1014

Mbretërimi i Samuelit (Bullgari).

Shekulli X

Hungarezët shkatërrojnë Moravinë e Madhe dhe aneksojnë Sllovakinë, e cila u bë Hungaria e Sipërme. Themelimi i arqipeshkvive të Gnesen (1000) dhe Grau (1001): Kishat polake dhe hungareze i shpëtojnë ndikimit gjerman. Në vitin 1003 Hungarezët pushtojnë Transilvaninë. Në vitin 1018 Bizanti mund Bullgarinë dhe e mban të pushtuar deri në vitin 1185 : fundi i Perandorisë së parë bullgare. Në shekullin X princat serbë vendosen në Dioklea (Mali i Zi). Përpjekja e Mikelit të Zetës për krijimin e një shteti. Formohen fise të tjera. Vllahët emigrojnë në verilindje (kullotat e Nishit). Shpartallimi i Bizantinëve nga Turqit në Melasgerd (1071). Stefan Voislav lufton kundër Grekëve (1040).

1054 - 1074

Mbretërimi i Pjetri Kreshimir IV. Në vitin 1102 fisnikëria njohin sovranitetin hungarez.

1091

Peçenekët munden nga Aleks Komnena (beteja e Levunoit).

1166 - 1371

Dinastia serbe e Nemaniçit, ndër të cilët Stefan Nemania (1168 - 1196). Biri i tij, Stefani I Nemanijç e pason atë. (1196 - 1227). Zhvillimi i serbëve nën tutelën bizantine.

Në vitet 1186 dhe 1241, dy Carë sundojnë në Bullgari: Gjon Aseni dhe Gjon Aseni II.

Perandoria e dytë bullgare: 1187-1393.

1219: Themelimi i Kishës kombëtare serbe - Shën Sava, vëllai i Stefanit II, arrin bashkimin kombëtar.

1189

Stefan Nemanja ia bashkëngjit Zetën Rashës.

1238 - 1240 : Mongolët mundin Rusinë.

1242

Rusi Aleksandër Nevski ndal kalorësit "Porte-Glaive".

1296

Përmendet për herë të parë Crna Gora (emri serb i Malit të Zi).

1317 - 1505

Dinastia e princave të mëdhenj të Moskës.

1320 - 1333

Ladislas I Lokietek rindërton bashkimin e Polonisë.

1331 - 1355

Stefani Dushan IX kurorëzohet në Shkup perandor i Serbëve, Grekëve, Bullgarëve dhe Shqiptarëve. Kulmi i Perandorisë serbe.

1355 -1367

Mbretërimi i Stefan Uroshit V. Feudalizimi i Perandorisë dhe krijimi i principatave (Despotateve).

Fundi i dinastisë së Nemaniçit.

Lazari i Rashës lufton më kot me Turqit.

1371 - 1396

Pas betejës së Maricas (1393) aneksimi hap pas hapi i Bullgarisë nga Turqit.

15/06/1389

Shpartallimi i Serbëve nga Turqit në Kosovë (Fusha e Mëllenjave). Turqit në Sofia (1382) dhe në Tërnova (1392).

1396

Fundi i Bullgarisë së pavarur. Mbizotërimi turk deri në 1878.

1396 - 1878

Mbizotërimi turk në Serbi

Shekulli XIV - XV

Fillimi i dallimeve midis Rusëve - të Vegjël (ose Ukrainasve), Bjellorusëve dhe Rusëve - të Mëdhenj.

1422 : Rrethimi i parë i Kostandipojës nga Turqit.

1443-1468: Kryengritja kombëtare në Shqipëri kundër Turqve (Gjergj Kastrioti, i mbiquajtur Skënderbeu).

29/05/1453:Rrethimi dhe marrja e Kostandinopojës;

Fundi i Perandorisë së Lindjes.

1452 :Rënia e despotatit: Shteti i fundit serb.

1878:Traktati i Shën Stefanit (3 mars) dhe Kongresi i Berlinit (13/06 - 13/07): Serbia, Mali i Zi, Bullgaria dhe Rumania bëhen shtete të pavarura.

(sipas "Shqipëria arkeologjike"- Tirana – 1971)

III

PELLAZGËT DHE GJUHA E TYRE

Kemi mbërritur kështu në çështjen thelbësore, e cila shpesh ka qenë anashkaluar për arsye të njohjes së gabuar ose të mosnjohjes së fenomenit pellazg si dhe mospasjes apo pamjaftueshmërisë së studimeve specifike apo të sakta në lidhje me historinë dhe gjuhën pellazge. Shumë pak autorë modernë e kanë prekur dhe ata që e kanë prekur janë shumë larg me përfundimet e tyre, qoftë se nuk kanë qenë të një mendimi, qoftë se e kanë hedhur poshtë ose nuk kanë qenë të aftë të luajnë rolin e tyre përpara historisë së ngritur dhe mjaftueshmërisë së përhershme, autoritarizmit ose sektarizmit të një numri të madh specialistësh ose studiuesish.

Atëherë, çfarë gjuhe flisnin Pellazgët? Përpara se t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje është e udhës të kalojmë me një vështrim të shpejtë disa të vërteta fillestare të dhëna nga një numër autorësh antikë dhe disa autorë të kohëve të sotme, të cilët në mungesë të hulumtimeve specifike, të hollësishme si dhe të përgjigjeve bindëse janë përpjekur nëpërmjet analizash të hollësishme madje këmbëngulëse të arrijnë të depërtojnë në misterin e pellazgëve. Do të vihen në dukje faktet e mëposhtme :

- Autorët më të lashtë antikë (kronologjikisht shumë më pranë Pellazgëve se sa të tjerë që kishin jetuar për një kohë të gjatë pranë tyre të tillë si p.sh. Dionisi i Halikarnasit, Polibi ose Straboni) pohojnë me Hekaten e Miletit, Hellanikos i Mitilenit, Herodoti apo Tuqididi në krye, se "Pellazgët banonin në këtë vend që do të bëhej Greqia përpara mbërritjes së Helenëve"; se Pellazgët flisnin një gjuhë barbare, d.m.th. jo greke, se ata ishin me zanafillë të një etnie joniane meqenëse Herodoti na thotë (VIII, 44 I, 56 - VII, 94, 95), banorët e parë të Athinës (ky emër shpjegohet vetëm nga gjuha shqipe "E thana" që do të thotë "premtimi": qytet i paracaktuar nga fati - nënkuptohet - i Pellazgëve) ishin Pellazgët që ndërtuan murin e parë rrethues të Akropolit të saj

(pelargicon) dhe se me mbërritjen e Helenëve përdorën gjuhën e këtyre të fundit dhe u quajtën Jonianë (në shqip "I onë, I oni" nënkupton "i jonë").

- Formimi i gjuhës greke u bë hap pas hapi nëpërmjet ekspansionit territorial të pushtuesve helenë. Këta të fundit përfunduan duke asimiluar një pjesë të madhe të gjuhës së popullsive autoktone të nënshtruara, e thënë ndryshe Pellazgët. Ja përse ne shohim të shfaqen shumë dialekte në hapësirën e pushtuar më parë nga Pellazgët, të cilët disa parapëlqejnë t'i quajnë Mikenianë (emërtimi artificial i shpikur nga arkeologët modernë) ose popullsi egjease, parahelene : dialekti jonianë në Atikë, Eube, Azi e Vogël (Joni), disa ishuj të Egjeut; arkado-qipriot në Arkadi, Qipro dhe Pamfili; eolian në Thesali, Beoti, Azi e Vogël (Eolidë), ishujt në verilindje të Egjeut, ndër të cilët Lesbos; dorian në Fosidë, ndër të cilët Delfi, në Lokridë, Etoli, Doridë etj.

- Kur dihet se Jonianët janë Pellazgë të kthyer në "jonianë" duke pranuar gjuhën e pushtuesve helenë (Herodoti I, 56, 57; VIII 44; VII 95) dhe se Arkadianët (Arkadia është një nga vatrat e Pellazgëve ku sipas Homerit duhet të ketë lindur Zeusi - "pellazgu"), Insularët e Egjeut dhe Eolianët (Herodoti VII, 95) janë gjithashtu Pellazgë, nuk mund të mos na shkojë mendja për pellazgjishten e lashtë, gjuhë e popullsive të nënshtruara nga pushtuesit helenë. Në të vërtetë është pranuar që dialekti arkado-qipriot është më i lashti ndër dialektet greke dhe se dialekti jonian është më i afërti më të. Përveç kësaj gjuha e Homerit cilësohet jonishtja e vjetër dhe grafia e teksteve homerike është joniane.

Kështu të gjithë këta tregues të shumtë vërtetojnë ndërfutjen e kësaj pellazgjishteje të lashtë, në formimin pikërisht të dy dialekteve më të vjetër grekë (arkado-qipriot dhe jonian). Gjuhëtarët modernë e trajtojnë "mikenianen" parahelene si gjuhën mëmë të këtyre dy dialekteve. Por sa keq, ata nuk kanë bërë asnjë përqasje midis kësaj mikeniane hipotetike dhe pellazgjishtes së lashtë, nga e cila kanë dalë thrako-ilirishtja dhe ajo frigjiane. Përveç kësaj janë të shumtë ata që as nuk kanë ditur as nuk kanë mundur të vendosin një farë përputhje (pasi e kanë studiuar në mënyrë të gabuar dhe veçanërisht dialektin gegë të Shqipërisë së

Veriut) me gjuhën e sotme shqipe, e vetmja që ka shpëtuar nga kjo gjuhë mëmë parahelene. Në të vërtetë në lidhje me këtë ja edhe mendimi i dy gjuhëtarëve të shquar francezë.

P. Shantëren (Morfologjia historike e greqishtes C. Klinckseck, 1964): "Në pamje të parë, dialekti mikenian radhitet përbri dialekteve që i kemi quajtur jugorë, d.m.th. tërësia e formuar nga dialekti jonianoatik dhe arkado-qipriot... Kështu, dialekti mikenian mund të përfaqësonte një gjendje të lashtë të dialekteve jugore që krijuan atë arkado-qipriote dhe joniano-atike... Vetëm duhet shënuar se dialekti shumë arkaik mund të paraqesë disa tipare shumë të lashta që gjenden gjithashtu në dialektin eolian... Mirëpo historianët i kërkojnë gjuhëtarëve të zbulojnë disa gjëra të prehistorisë së Helenëve, ndërsa gjuhëtarët nga ana e tyre për të shkoklavitur faktet e ofruara nga dialektologjia do të kenë nevojë për të dhëna historike bindëse".

A. Meje (Një vështrim i shkurtër mbi historinë e gjuhës greke – Klinckseck, 1965): "Nuk dihet asgjë për gjuhët e folura në gadishullin grek përpara dyndjes helene. Pellazgët nuk janë vetëm një emër... Qytetërimi që ndikoi mbi atë grek është qytetërimi i botës egjease, për të cilin nuk njihet gjuha... Por nuk duhet t`i veshim indo-europianes atë që ka mundësi të jetë më saktë egjease... Gjithsesi huazimi i alfabetit fenikas dëshmon, pse jo, një ndikim të fortë të Fenikasve ndaj Helenëve, të paktën bëhet fjalë për një paralelizëm zhvillimi".

- Arkeologjia, midis zbulimeve specifike, na nxjerr në dritë ngjashmëri të shumta midis ndërtimeve të ndryshme parahelene, të fortifikuara, të quajtura ciklopike ose pellazge, të shpërndara në vende mjaft të largëta nga njëri-tjetri: Greqia kontinentale (Mikenas, Asrgos, Tirinti...), Azia e Vogël, Lindja e Afërme, Italia, Kreta etj. Kërkimet paleontologjike dhe arkeologjike dëshmojnë se popullsitë neolitike madje paleolitike banonin në Greqi dhe mbi të gjitha në Shqipërinë e sotme, ku janë zbuluar zonat neolitike dhe paleolitike ndër të cilat ajo e Xarës, Shën Mërisë dhe Dajtit, fshatra ndër të cilët ai i Maliqit dhe rajoni i liqenit të Prespës dhe Ohrit, gjurmë që datojnë nga periodat

neolitike dhe eneolitike ndër të cilat ajo e Pazhokut, Maliqit, Nezirit dhe Burimasit në Shqipëri, Glladnicë dhe Hisar në Kosovë dhe zona të pasura në metale në veri të Shqipërisë, ndër të cilat ajo e Mirditës, Mat, Kukës, Kosovë dhe Dibër në Lindje dhe ajo e Korçës në Jug. Përveç kësaj, këto rajone të fundit ishin të njohura nga punimet e metaleve, ndër të cilat bakri, bronzi dhe më pas hekuri.

Homeri pohon në Iliadë (XVI, 234) se "Zeusi është dodonas dhe pellazg". Ai i cilëson pothuajse gjithmonë Pellazgë hyjnorë, të cilët i vendos në të dy kampet (trojan dhe akeo-danaen). Rapsodi ynë i shquar nuk i përmend aspak Helenët dhe as si "popull" grek as si "komb" grek. Për të përcaktuar Grekët e ardhshëm ai përmend vetëm Akenët, Danaenët dhe Argianët. Por kur thellohen dhe kalohet në studime të hollësishme, analizat dhe kërkimet zbulojnë se Akenët kishin një zanafillë të turbullt (Silisiane, të Lindjes së Afërme?), se Danaenët ishin semito-egjiptianë, Kadmenët fenikas, Pelopidët nga Lindja e Afërme (Asirianët ?) dhe Argianët ishin veçse banorë të Argos (Pellazgë të kthyer në "danaenë" gjatë pushtimit të qytetit nga Danaos Egjiptiani); se mbretërit dorianë shpallnin me krenari zanafillën e tyre semitike (Herodoti VI, 53 dhe Testamenti i Lashtë, I Makabes XII, 19-23)...

Shqiptarët dhe stërgjyshërit e tyre thrako-ilirë nuk janë marrë parasysh nga një numër i madh historianësh e parahistorianësh, arkeologësh, etnologësh ose gjuhëtarësh, madje edhe në një prani gjeografike dhe historike të përhershme në Ballkan dhe shumë herë mijëvjeçare dhe mbi të gjitha një gjuhë të trajtuar si gjuhë e vetme në Europë dhe që përbën një degë me të ndër gjuhët e mbiquajtura indo-europiane. Edhe më keq akoma: duke mos e mësuar dhe studiuar atë, gjuhëtarët e kanë lënë mënjanë.

Duke u nisur nga një numër postulatesh dhe duke u bazuar mbi elemente të vlefshme, të dhëna nga historiografia e Greqisë antike, më është dashur të ndërmarr studime të shumta dhe hulumtime, të analizoj, kritikoj, të qëmtoj, "të lexoj me hamendësim" nëpër shkrimet më të lashta, në thelb greqisht dhe latinisht - dhe t`i drejtohem një

dokumentacioni serioz dhe të sigurt në fusha të ndryshme. Ja pra udha e mbushur me të papritura, rrugëtimi intelektual dhe përqasja shkencore, të cilat më kanë lejuar të konceptoj më mirë shtrembërimet, të papriturat dhe pamjen e fshehur të historisë parahelene.

Studimet dhe hulumtimet të kryera në disiplina të shumta (histori e lashtë, arkeologji, antropologji ose etnologji) të paraqitura në veprën që kemi në dorë dhe në atë që do të dalë se afërmi (Greqia parahelene : Pellazgët ose zgjidhja e një enigme) përbëjnë një punim të stërmadh, duke sjellë një sqarim të ri dhe elemente të reja për sa i takon vërtetësisë historike të Pellazgëve dhe pasardhësve të tyre të sotëm, Shqiptarëve. Gjuhësia me në fund ka përsosur të dhënat që gjenden aty: përpara shfaqjes së Grekëve në shekullin VIII para Krishtit, aty ekzistonte një qytetërim që unë do ta quaja pellazg, në mungesë që t'i ktheja emrin e tij të vërtetë dhe që disa e kanë quajtur deri më sot "egjeo-kretas, mikenian ose parahelenik". Ky qytetërim kishte gjuhën e tij : pellazgjishtja e lashtë, nga e cila gjuha shqipe e sotme është e vetmja gjuhë e mbijetuar në Europë.

Pa gjuhën shqipe, me të vërtetë një fosile e gjallë, pa zbulimin e monumenteve parahelene të gjetura njësoj në vende të shumtë të pellgut mesdhetar, pa morinë e toponimeve të sotme të përhapura nëpër Europë dhe Azinë e Vogël dhe që deshifrohen falë gjuhës shqipe dhe së fundi pa përmendjen e Homerit, i cili pohon se Zeusi ishte pellazg si dhe pohimet e autorëve të tjerë antikë ndër të cilët Herodoti dhe Tuqididi, sipas të cilëve Pellazgët ishin banorët e parë të Greqisë përpara mbërritjes së Grekëve dhe që flisnin një gjuhë barbare, ne pa asnjë dyshim do të vazhdojmë t'i trajtojmë Grekët jo vetëm qytetëruesit e parë europianë por vazhduesit e qytetërimeve që i patën paraprirë ata.

Në të vërtetë aty është pika e dobët: aty ka një shkëputje në periudhën e quajtur "Epoka të errtë" (1200–800/750) dhe "periudha arkaike" (800/750–480) të Greqisë, e thënë më saktë dhe shumë më parë në atë të quajtur "mikeniane" (1450–1200). Pra, përveç huazimeve gjuhësore, nuk zbulohet ndonjë vijimësi historike, as kulturore, as tradicionale, as e kulteve midis pushtuesve të parë Helenë dhe paraardhësve të tyre.

Në të vërtetë kjo vijimësi ka të bëjë vetëm me dëshmitë e vetme të një kaluare të lavdishme d.m.th. të fiseve të ndryshme autoktone të trungut pellazg të zmbrapsur nga mësymjet helene nëpër strehët të izoluara ose të paarritshme (Arkadi, Epir, Maqedoni, Iliri...). Midis këtyre fiseve, të mbetura veç qytetërimit grek, vetëm Ilirët (stërgjyshërit e Shqiptarëve dhe Kosovarëve të sotëm) dhe Epirotët mundën të ruajnë trashëgiminë e tyre kulturore dhe gjuhësore, të cilët kishin rënë në përgjumje gjatë më shumë se 25 shekuj, falë strehimit të tyre në malet e pamposhtshme. Këtu unë nuk do të rinis studimet dhe analizat e paraqitura shumë herë në lidhje më këtë temë në veprën e titulluar ("Greqia parahelene: Pellazgët ose zgjidhja e një enigme"), por do ta drejtoj lexuesin në paragrafë të ndryshëm që flasin për këtë.

Vetëm do të shënojmë se Grekët kanë arritur në një vend (që më vonë u bë Greqia), i populluar në mënyrë të veçantë nga fise të ndryshme pellazge dhe aty kanë futur prurje kulturore krejt të ndryshme madje të reja: patriarkatin, djegien e kufomave, ndërtimin e tempujve, shkrimin alfabetik me zanafillë fenikase, të cilit ata i shtuan zanoret, heqjen e mbretërimit, shfaqjen e perëndive të reja ndër të cilët Dionisi, një art të ri luftarak (hoplitat, falangat...), amfiktoninë*), polisin, kolonizimet, krijimin i një forme të re qeramike etj. Në planin mitologjik, kulturor si dhe gjuhësor ata kanë bërë huazime të mëdha nga Pellazgët autoktonë. Ja përse ne i rigjejmë sot edhe emrat e perëndive dhe të heronjve si dhe emra të vendeve, të cilët shpjegohen jo nga gjuha greke por nga gjuha shqipe dhe në veçanti nga dialekti gegë i Shqipërisë së Veriut. Grekët i kanë ruajtur ato të paprekura falë logografëve dhe autorëve antikë, të cilët i kanë përjetësuar ato përfundimisht duke i transkriptuar fonetikisht (njëlloj) në shkrimet e tyre.

Deri më sot, përveç shkrimeve të mbiquajtura të Linearëve A dhe B, të cilat fatkeqësisht nuk janë tekste letrare si dhe të shkrimit etrusk (stela e Lemnosit, midis epigrafëve të tjerë antikë), ne nuk zotërojmë

*) *Deputetët e shteteve, të cilët formonin këshillin*

asnjë tekst që të jetë tipik pellazg (Mikenianët dhe Etruskët, gjithsesi janë etni të trungut pellazg). Por Pellazgët i kanë lënë, grekëve në mënyrë të mjaftueshme, një pjesë të gjuhës dhe të trashëgimisë së tyre kulturore dhe atë të kultit, të cilët shpesh kanë marrë me përpikëri emrat e vendeve apo të perëndive pellazge: ne madje mund të dallojmë midis asaj që u përket grekëve dhe asaj që ishte tipike parahelene, pra pellazge. Pra, me të drejtë kjo është ajo që ka qenë fshehur dhe që i ka shpëtuar shumë parahistorianëve, historianëve dhe gjuhëtarëve. Është ruajtur madje mirë të shqiptuarit e kësaj fjale të paracaktuar nga fati: Pellazg apo pellazgjik. Është parapëlqyer të thuhet "parahelenë, para indo-europianë, mikenianë, egjeas ose egjeo-kretas"! Madje është pohuar se të gjitha këto popullsi parahelene si dhe gjuha e tyre ishte "zhdukur" plotësisht. Në këtë mënyrë nënkuptohet se mbyllet debati duke thënë "përveç greqishtes jo shpëtim", duke përjashtuar kështu gjithë këtë vullnet të dobët për të hulumtuar ekzistencën e një gjuhe trashëgimtare të kësaj të folure qysh përpara shfaqjes së Grekëve. Trajtohet se bëhet fjalë për një përvojë të pandryshueshme dhe të papërsëritshme: me pak fjalë, një fjalë e Ungjillit të pakundërshtueshëm! Kështu pjesa më e madhe e dijetarëve, të bindur se Grekët ishin pasardhësit e parahelenëve (egjeo-kretas dhe mikenianë), e kanë trajtuar Linearin B, që pretendohet të quhet mikenian, si një variant grek të Linearit A, linear kretas. Kështu bëhet me lehtësi një përzierje midis Akenëve dhe Mikenëve. Për më tepër, duke mos ditur se gjuha e sotme shqipe, në veçanti dialekti gegë, është e vetmja gjuhë trashëguese e kësaj që rrjedh drejtpërdrejt nga Thrako-Ilirët dhe nga ana tjetër duke qenë fshehur fakti se Grekët kanë bërë huazime të shumta nga pellazgjishtja e lashtë, ata kanë shpallur se "Lineari B" mund të jetë vetëm një formë e lashtë e gjuhës greke. Përveç kësaj, çudia është se gjuha greke e lashtë është më afër dialektit gegë të sotëm se ndaj gjuhës së sotme greke! Për të mos thënë pastaj se kjo greqishte e lashtë, e pretenduar, ishte pellazgjishte e pastër, meqenëse kjo gjuhë trajtohej nga të lashtët si një gjuhë barbare (jo greke), por edhe se kjo greqishte e lashtë kishte bërë huazime të shumta në gjuhën

pellazge. Përveç kësaj rajonet që bënin pjesë në Greqi stricto sensu, Arkadianët, të strehuar në malet që ishin të vështira për tu arritur, kanë ruajtur për një kohë shumë të gjatë ritet dhe zakonet, kulturën dhe gjuhën e stërgjyshërve të tyre të lashtë Pellazgë. Përveç kësaj, ja përse disa pohojnë se gjuha arkadiane ishte më e lashta nga dialektet që kanë ndihmuar në formimin e gjuhës greke, ndër të cilat dialekti eolian, jonian dhe dorian ishin dialektet kryesore. Më vonë kur ra Qipro në zotërimet greke, dialektin arkadian u zëvendësua me dialektin qipriot (i trashëguar gjithashtu nga Pellazgët e lashtë, të quajtur të gjithë së bashku Mikenë), i cili për shkak të izolimit të tij i rezistoi për një kohë të gjatë ndikimit grek, përveç dialektit arkadian. Ja përse disa gjuhëtarë kanë krijuar këtë idiomë të katërt, të cilën ata e quajnë arkado-qipriote. Për fat të keq ky i fundit me ngritjen në pushtet të grekëve u zëvendësua dhe u përzje në masën e tri dialekteve të tjerë, ndër të cilët dialekti jonian mori një rëndësi të madhe.

Përse dialekti gegë është më pranë greqishtes së lashtë? Sepse pellazgjishtja e lashtë, falë Thrako-Ilirëve, pasardhës të drejtpërdrejtë të Pellazgëve të strehuar dhe të izoluar në malësitë e të parëve të tyre është përvijuar te shqiptarët e sotëm (Shqipëria e Veriut dhe Kosova). Këta e kanë ruajtur këtë gjuhë të paprekur. Nga ana tjetër dialekti toskë e ka ndjerë shumë më tepër ndikimin e mëvonshëm të kulturës greke (stricto sensu). Mirëpo Gjigandët (Gigas) e mitologjisë, të mbiquajtur greke, janë shkrirë me Gegët e Shqipërisë se Veriut. Në të vërtetë, sipas mitografisë, Gjigandët gjithmonë jepen me malet e Veriut të Greqisë. Kjo revoltë e Gjigandëve kundër Zeusit dhe perëndive të Olimpit është një legjendë pas-homerike që krahasohet me një episod historik: një përpjekje e malësorëve barbarë (jo helenë) për të pushtuar bastionet që u ishin marrë vëllezërve të tyre të një trungu (Pellazgëve) nga pushtuesit e parë helenë. Një tjetër legjendë, revolta e Aloadëve (vëllezërit binjakë: Efialtësi dhe Otosi) është një version popullor (simotër) i revoltës së Gjigandëve. Përveç kësaj legjenda na thotë se Gjigandët, të lindur nga Gaia (Ge, "dhe" toka) dhe nga gjaku i Uranit,

janë qeniet e para dhe janë shumë më të mëparshme se perënditë. Të gjitha këto luftëra dhe luftime vdekjeprurëse (Titan - Zeus / Gjigand - Zeus, Ciklopë, Kronos/ Uliksi - Polifemi, etj.), të mbiquajtura legjendare, në të vërtetë kanë lidhje me kalimin nga qytetërimi Pellazg në atë Helen: luftëra për pushtet midis qytetërimit (grek) dhe atij barbar (pellazg). Këto luftime, të nisura nga mësymjet helene, gjithashtu lidhen me kundërshtinë e dy sistemeve: matriarkal (Pellazgët) dhe patriarkal (Grekët). Në lidhje me këtë shënojmë se në vendin e shenjtë në Pito, ku u vendos Apoloni dhe përpara se të merrte emrin e Delfit, aty strehohej perëndesha Gaia (Gè - "dhe"). Së fundi shënojmë se në gjuhën pellazge Gaia ose Gè (toka, bija e Kaosit, madje nëna dhe gruaja e Uranit) u zëvendësua shumë herët me pellazgo-kretasen Rea (" e reja" e cila më vonë u helenizua). Titanët, Gjigandët, Ciklopët dhe Hekatonkirët simbolizojnë forcat e furishme të natyrës.

Pauzani (VIII, 1, 2) pohon se Pelasgos (heroi eponim i Pellazgëve) ishte "i pari njeri", që do të thotë qartë se një etni, e cila rridhte nga një qytetërim neolitik dhe prehistorik mbijetoi në Arkadi deri në periudhën klasike. Kjo vërteton gjithashtu atë që kanë pohuar autorët e parë antikë grekë në lidhje me Pellazgët, të tillë autorë si Hekate i Miletit, Hellanikos i Mitilenit, Herodoti ose Tuqididi: banorët e parë të vendit që do të mbante emrin HELLADË ose GREQI. Një tjetër fakt mbështet lashtësinë dhe vërtetësinë historike të Pellazgëve: Pellazgët qysh në kohë të hershme janë njohur si ngrënës të lendeve të lisit. Mirëpo ne e dimë që "lisi" ishte pikërisht simbol i Pellazgëve : në Dodonë, kryeqyteti i kultit të Pellazgëve, orakulli i interpretonte gjërat falë fëshfëritjeve (zëri i Zeusit) të gjetheve të lisit. Gjithashtu ne e dimë se lendet e ngrënshme ishin ushqimi kryesor i botës së lashtë përpara se të shfaqej gruri. Përveç kësaj Pellazgët ushtronin sakrificat njerëzore, zakon i mirëfilltë i njerëzve të parë. Titani Ofion do të ketë mbretëruar në Olimp me Eurinomin (që do të thotë "udhëtare e madhe" në greqisht dhe "vashëz me famë" në shqip) përpara shfaqjes së perëndive. Mirëpo legjenda e Ofionit është lidhur me mitin pellazg të Krijimit. Athene

(XIV, 45, 639, 640) pohon se Pellazgët praktikonin flijimin për "Pelorian" dhe se të gjithë Pellazgët kishin lindur nga Ofioni, ai vetë një "Pelor" (i njëjësuar me një gjarpër të magjishëm). Fjala e fundit a nuk shpjegohet vetëm nëpërmjet gjuhës shqipe "Pjellor" (rrjedh nga folja me pjellë = me lind, me kriju) që do të thotë edhe pjellor, prodhues d.m.th. ai që krijon, prodhon?

Grekët e parë mbërritën në Pellazgji me gjuhën dhe kulturën e tyre dhe i nënshtruan popullsitë autoktone të trungut pellazg (Pellazgë, Thrakë, Frigjianë, Lidianë, Maqedonas dhe Tesprotë, duke përmendur vetëm më të njohurit) dhe përthithën një pjesë të madhe të gjuhës, kulteve dhe kulturës së tyre. Ndërsa ata që u veçuan nga përzierja kulturore dhe mbizotërimi grek kanë ruajtur origjinalitetin, zakonet e tyre të lashta dhe një pastërti shumë të madhe gjuhësore. Kjo është më se e dukshme: gjuha shqipe është "fosile e gjallë" e kësaj pellazgjishteje të lashtë.



Albanopolis (Zgërdhesh): muri rrethues
dhe tri kulla vrojtimi të shekullit IV para Krishtit
(sipas "Shqipëria arkeologjike" - Tirana - 1971)

Gjuha : paraqitje dhe mendime të përgjithshme gjuhësore

Disa (për të mos thënë pjesa më e madhe) e gjuhëtarëve (gjuhësia, disiplinë moderne, e cila daton vetëm qysh prej shekullit XIX!) kanë menduar për një heterogjenitet të gjuhëve të botës mesdhetare dhe në veçanti atë egjease, ndërkohë që në fillim ishte fjala vetëm për fise me emra të ndryshëm - dhe jo në thelb të ndryshëm – që përdornin të njëjtin fond gjuhësor në dialekte të ndryshme. Le të merremi vesh për fjalën "dialekt": bëhet fjalë për të njëjtën gjuhë që përparon në mënyrë të pavarur me risitë e saj, specifikat e saj apo përvojat e saj zanafillore në një rajon të përcaktuar ose një vend të veçantë. P.sh. haseshin në detin Mesdhe ose në veçanti në detin Egje, popuj të shumtë: Pellazgët, Lelegët, Karianët, Lisianët, Teukrët, Etruskët, Ligurët, Liburnët ose Ilirët duke përmendur këtu vetëm ata më të shquarit. Kjo duket se i ka ngatërruar specialistët (gjuhëtarë, etnologë, arkeologë, prehistorianë ose historianë). Ata kanë menduar për popuj të ndryshëm, ndërkohë që ishte fjala për një popull të vetëm me emërtime të ndryshme dhe dialekte të shumtë!

Ja çfarë na thotë një nga pionierët e gjuhësisë moderne, Antuan Mejet në veprën e tij "Hyrje në studimin krahasues të gjuhëve indo-europiane": "... dy gjuhë janë quajtur të një trungu kur ato rezultojnë njëra dhe tjetra nga dy evolucione të ndryshme të së njëjtës gjuhë të folur qysh më parë".

Por vetë Meje si dhe paraardhësit e tij, dhe akoma më shumë ithtarët e tij, pothuajse nuk e kanë njohur pellazgjishten e lashtë, e cila përfshinte dialekte të shumtë, ndër të cilët dialektin thrako-frigjian, ilir, epirot dhe shqipen e sotme. Më të paktë të numër janë ata (të disiplinave shumë të ndryshme), të cilët kanë bërë përqasje etnike ose gjuhësore midis këtyre fiseve të ndryshme dhe që kanë folur të njëjtën gjuhë: që është mjeti i vetëm për një kuptim më të mirë të këtij fondi gjuhësor ose të paktën për "lokalizimin" e tij midis gjuhëve të para indo-

europiane (disa refuzojnë në mënyrë kategorike ta krahasojnë "pellazgjishten" me indo-europianen!). Pothuajse shumica e gjuhëtarëve të dëgjuar nuk kanë bërë përqasjet e nevojshme si dhe krahasimet e domosdoshme, nga njëra anë të "pellazgjishtes së lashtë", thrako-frigjianes, ilirishtes, etruskishtes, shqipes së sotme dhe nga ana tjetër gjuhëve të tyre idhull, të mbiquajtura indo-europiane, ndër të cilat gjuha greke, latinishtja, dhe sanskritishtja. Duket qartë se ata janë përpjekur të studiojnë dhe të krahasojnë atë që ata njohin më mirë d.m.th. gjuhën greke, latine, kelte, gjermanike apo sllave, duke përmendur këtu vetëm ato më të njohurat dhe që në raport me gjuhën pellazge ishin vetëm gjuhë të mëpastajme dhe përveç kësaj janë relativisht më të vonshme. Megjithatë Ksilander, Ramus Rask, Shlaiher apo Franc Bop kanë paraqitur zanafillën indo-europiane të gjuhës shqipe. Madje Bop pohon se "gjuha shqipe nuk ka asnjë lidhje zanafillore me asnjë gjuhë tjetër". Nënkuptohet që nuk ka lidhje, meqenëse bëhet fjalë për një nënshtresë të lashtë, nga e cila vetëm një gjuhë ka mbijetuar. Ky pohim i Bopit ka qenë me vend, përveç kësaj ai ka qenë jo shumë larg ndër meditimet dhe studimet e tij me qëllim që të gjejë afritë e dukshme që ekzistojnë midis pellazgjishtes së lashtë, thrako-ilires dhe shqipes. Gjithashtu edhe ithtarët e tij kanë klasifikuar këtë gjuhë veç dhe ç kanë lënë mënjanë.

Gjithsesi latinistë të shumtë pohojnë se gjuha latine dallohet nga të folurat e tjera italike, vetëm nga fillimi i shekullit VI para Krishtit dhe vetëm në shekullin III epigrafi arkaik mori një zhvillim të vërtetë si dhe latinishtja mori statutin e saj të të folurit mbizotërues (cf. Dangel, Historia e gjuhës latine). Alfred Ernout (Elementet etruske të fjalorit latin, 1930) shprehet në lidhje me latinishten dhe huazimet e saj etruske: ".... Pasuria e elementeve etruske në fjalorin latin; përkundrazi, autorët latinë nuk duan ta pranojnë ekzistencën e kaq shumë fjalëve etruske".

Përsa i takon gjuhës greke, në të vërtetë shkrimi i saj alfabetik është shfaqur vetëm nga mesi i shekullit VIII para Krishtit dhe dokumentet

"letrare" nuk dolën në dritë para shekullit VI! Severini pohon këtë në lidhje me gjuhën greke: "Mirëpo në kohën e lashtë fjalori grek përmbante një mori fjalësh që nuk shpjegohen aspak as me gjuhën greke as nga ndonjë gjuhë tjetër të njohur indo-europiane: ato janë të huazuara nga popullsitë parahelene, të cilat tashmë ishin të vendosura në këto vise... U shqyrtuan në fillim emrat e përveçëm gjeografikë dhe të njerëzve, emra që më mirë se emrat e përbashkët, kanë ruajtur kudo kujtime shumë të hershme të një të kaluare të pashkruar". Në të vërtetë si në planin e antroponimeve dhe atë të toponimeve jo vetëm të Ballkanit por edhe të rajoneve të tjera, të tilla si Azia e Vogël, Kreta, Italia, Alpet dhe rajoni danubian, gjuha shqipe arrin të dekriptojë emra të shumtë të përveçëm dhe emra vendesh.

Kështu greqishtja dhe latinishtja i morën respektivisht gërmat e tyre në shekullin VI dhe III para Krishtit. Kjo mbështet faktin se gjuha greke dhe latine janë gjuhë pas-pellazgjike dhe nuk mund t'i paraqitësh si "etalone" dhe t'i referosh për çfarëdo.

Pjesa më e madhe e gjuhëtarëve, përkundrazi, i kanë studiuar gjerësisht dhe në mënyrë metodike gjuhët sllave, të cilat nuk mund të trajtohen si të lashta, meqenëse bëhet fjalë për gjuhë edhe më të vonshme (shekulli VI dhe shekulli X pas Krishtit për gjuhët sllave të jugut)! Ndërkohë që gjuha ilire, një nga më të lashtat të Europës është pothuajse plotësisht e panjohur, ashtu si edhe trashëguesja e saj e drejtpërdrejtë, gjuha shqipe. Për këtë qëndrim të padrejtë, të bazuar keq, absurd dhe që konsiston si i thonë një fjale, të vendosësh parmendën para qeve d.m.th të vendosësh gjuhën greke dhe latine para "pellazgjishtes" unë do të thoja këtë: është sikur të trajtosh katin e dytë ose të tretë të një ndërtese të madhe sikur të ishin themelet e saj të vërtetë! Është e vërtetë që populli ilir ka jetuar në një gjendje komatoze qysh prej vitit 168 para Krishtit kur hordhitë e armatosura romake e pushtuan dhe e copëzuan territorin e tij të stërmadh që shkonte nga brigjet e Danubit deri në Epir dhe nga dy brigjet e Adriatikut deri në Thrakë. Kujtoj

edhe një herë se ky popull gjeti strehë në malet e të parëve të tij, male të paarritshme, duke ruajtur kështu gjuhën dhe traditat e tij gojore. Por fatkeqësisht, pavarësisht çfarë kishte patur në antikitet, kulturën dhe shkrimin e tij, ai nuk ka patur një "traditë të shkruar" deri në shekullin XIV, madje deri në shekullin XV të erës sonë.

Për tu rikthyer në temën time fillestare, të fillimit të këtij kapitulli, këtu më poshtë do të jap tekste të nxjerra nga një prej pionierëve të gjuhësisë që provon se me sa shpërfillje dhe mungesë njohurie ai ka trajtuar problemet gjuhësore, pa ndërmarrë paraprakisht hulumtime të thelluara dhe të studiuara "me themel" të elementëve të ndryshëm që të ndihmojnë në njohjen e disa gjuhëve të lashta.

Meje (Gjuhët e botës) pohon në lidhje me gjuhët parahelene: "Rajonet që zunë grekët (emri indigjen: Helenë) ishin të banuara përpara mbërritjes së tyre nga popullsi të një race dhe gjuhe të panjohur dhe për të cilën ne dimë vetëm emrin: Pellazgë, Lelegë, Karianë, etj. Sipas gjurmëve të mbetura toponimike të ngulimeve të tyre, këta popuj flisnin gjuhë jo indo-europiane. Sipas dëshmive të të lashtëve, pellazgjishtja (emër i paqartë që duket të ketë qenë përdorur për gjuhë të ndryshme parahelene) ishte ende në përdorim në shekullin V para Krishtit në brigjet e Thrakës dhe në jug të Propontidës dhe në disa ishuj si Imbros, Lemnos, Samothrakë dhe deri në Kretë. Në Prezos (Kreta lindore) janë gjetur disa mbishkrime me germa greke por në një gjuhë të panjohur, e cila pa dyshim rrjedh nga "Eteokretasit".

Pjesa më e madhe e ithtarëve të tij i kanë trajtuar thëniet e Mejes dhe ato të gjuhëtarëve të tjerë sikur të jenë thënie të sigurta të pakundërshtueshme, pa u shqetësuar fare për rëndësinë e këtyre thënieve.

Në të njëjtin libër Meje shton në lidhje me gjuhën ilire: "Në veriperëndim të gadishullit të Ballkanit dhe duke bërë një farë lidhjeje nëpër kontinent midis botës greke, botës italike dhe asaj gjermanike, në periudhën e antikitetit shtrihej grupi i madh ILIR. Ky është grupi që njihet shumë pak. Disa mbishkrime shumë të shkurtra shpesh të

katandisura në emra të përveçëm dhe të deshifruar keq, disa shënime shpjeguese si dhe një numër mjaft i madh emrash njerëzish dhe vendesh janë gjithçka që ka mbetur. Ilirët kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në qendër të Europës, por ende të përcaktuar jo mirë dhe të cilët kanë vepruar në tri drejtime: kundrejt botës gjermanike me të cilën lidhjet dhe shkëmbimet kanë qenë të pafundme; kundrejt Italisë ku popuj të shumtë ilirë janë vendosur (madje supozohet edhe se Umbrët ishin një degëzim ilir); kundrejt botës helene, ku pushtimi dorian duhet të ketë shtyrë elementet ilire. Ky grup gjuhësh, përveç gjuhës ILIRE (nga e cila ka një mbishkrim në alfabetin grek, të përbërë nga tri fjalë, të gjetur pranë Shkodrës, në Shqipëri), përfshinte gjuhën venete (rreth 200 mbishkrime në shkrimin "etrusk-verior", në shekujt VI para Krishtit dhe I pas krishtit në rajonet e Estit, Mantovas, Padovas dhe Triestes si dhe në luginën e Plavës) dhe rreth shekullit VIII para Krishtit dhe e sjellë në Italinë e jugut mesapishtja, gjuha e Japigëve (rreth 200 mbishkrime të shkurtra në alfabetin grek, në Pulia dhe Kalabri, duke filluar nga shekulli IV). Toponimia dhe onomastika tregojnë se Ilirët ishin shumë të përhapur në veri-perëndim dhe kanë lënë gjurmë të shumta të ngulimeve të tyre në vendet gjermanike. Gjithashtu duhet të kenë qenë në lulëzim qysh në kohë të hershme në jug të gadishullit të Ballkanit, ku emra të shumtë të vendeve shënojnë një kolonizim të lashtë ilir të mbuluar nga pushtimet helene. Gjithashtu ka të ngjarë se duhen trajtuar si të një zanafille ilire edhe Filistinët, të cilët i dhanë emrin Palestinës (greqisht Palaistine)".

Dhe Meje (Gjuhët e botës) për të përfunduar në lidhje me gjuhën shqipe thotë: "Shpesh është menduar se shqipja e sotme (emri vendas Shkip; etnik shkiptar) është vijimi i ilirishtes së lashtë. Kjo nuk është e sigurt, madje as që rrjedh nga një gjuhë e të njëjtit grup. Por është pozicioni i saj gjeografik që e radhit në këtë vend. Midis dialekteve indo-europiane, gjuha shqipe është njohur shumë më vonë: dokumentet e para në formë dorëshkrimesh janë një formulë pagëzimi sipas ritit

romak (1462) dhe një fjalor i vogël i hartuar nga Arnold fon Harf i Kolonjës (1496); tekstet e para të shtypura janë libri i lutjeve dhe meshari të përkthyera nga Gjon Buzuku (1554–1555), vepra – katekizma, rituale etj – të Pjetër Budit (1618–1621) dhe një fjalor latinisht-shqip (Romë, 1635). Shkrimi romak u përdor pasi u përdor për toskërishten alfabeti grek..."

Së fundi, te "Hyrje në studimin krahasues të gjuhëve indo-europiane", ja paragrafi i vetëm kushtuar nga Meje gjuhës shqipe: "Gjuha shqipe është njohur vetëm duke filluar nga shekulli XV dhe në format e mbërritura në një gjendje shumë të përparuar zhvillimi: një pjesë e madhe e fjalorit përbëhet nga fjalë të huazuara nga latinishtja, greqishtja, turqishtja, sllavishtja dhe italishtja".

Këto tekste të Mejesë përfaqësojnë pikëpamjet më "në modë" dhe përbëjnë një provë të dukshme të mosnjohjes pothuajse të plotë, nga pjesa më e madhe e gjuhëtarëve, të Pellazgëve, Thrako-Frigjianëve, Ilirëve dhe pasardhësve të tyre, Shqiptarëve.

Nëse analizohen tekstet e Mejesë, të përmendura më sipër, vëren kundërshti të mëdha, mospërputhje apo paaftësi.

1) Ai i trajton me të drejtë Pellazgët si një popull parahelen, i cili ka banuar në vendin që do të bëhej Greqi, por iu mohon atyre të gjithë tërësinë etnike dhe gjuhësore përderisa pohon se emri "pellazg" ishte vetëm një emër gjenerik i përdorur për të emërtuar gjuhë të shumta parahelene.

Kjo provon se nuk është marrë mundimi të ndërmerren hulumtime dhe studime serioze mbi këto gjuhë të lashta, të lëna mënjanë.

Gjithsesi, ai pranonte se në shekullin V para Krishtit "gjuha pellazge" flitej gjerësisht në rajone të shumta të Greqisë. Këtu paradoksi dhe kundërshtia, ka të ngjarë për shkak të mosnjohjes nga ana e tij të gjuhëve të afërta me pellazgjishten e lashtë, flasin qartë. Së fundi, sepse si mund të ishte "pellazgjishtja" një emërtim gjenerik që emërton gjuhë të shumta dhe mbi të gjitha "të panjohura" ose të pakuptueshme, ndërkohë që bëhej fjalë pikërisht për një dhe "vetëm" një gjuhë, bashkëkohëse e

Herodotit, e folur nga fise të shumta në dialekte të ndryshme? Ai përmend mbishkrime me germa greke por "në gjuhë të panjohur", të cilën për thjeshtësi ai ia vesh gjuhës eteokretase! Përveç kësaj, madje edhe në ditët tona, kur një gjuhëtar pengohet nga zanafilla e një gjuhe, ai e shpall ipso facto "gjuhë e panjohur" ose "e zhdukur"! Si mundet që Pellazgët, Lelegët, ose Karianët (popuj të një trungu, shumë të lashtë dhe tepër të cituar nga autorët e parë antikë) mund të jenë "popullsi e një race dhe gjuhe të panjohur" ndërkohë që gjuha e tyre ende përdorej në disa rajone të Greqisë, Egjeut, Azisë së Vogël, Italisë dhe Kretës, jo vetëm në shekullin V para Krishtit por edhe deri në një epokë edhe më të vonshme?

2) Ai i përmend Ilirët dhe u cakton atyre, jo pa arsye, një territor shumë të madh në kufi me botën greke, italike dhe gjermanike. Ai i jep një rol nga më të shquarit, nga Gjermania deri në Peloponez (me sa duket bashkë me Dorianët) dhe nga Italia në lindje të Ballkanit. Ai madje i lidh, me të drejtë, si të një trungu me Filistinët. Por atëherë si mund të shpërfillet gjuha e një populli kaq të rëndësishëm, kaq të njohur, si ky që përshkruan ai? Në mungesë të hulumtimeve të hollësishme ai thjesht mjaftohet duke pohuar se ky "grup i stërmadh etnik është nga ata që njihen më pak"! Përse ai dhe ithtarët e tij të shumtë nuk kanë kërkuar ta njohin më mirë? Këta dijetarë të shquar nuk mund ta humbin kohën e tyre duke u marrë me një etni dhe një gjuhë që ata e trajtojnë, pa dyshim, si të përbërë dhe hibride! Pra kjo fiasko është rrjedhojë e rrezikshme dhe pothuajse e përgjithshme për punimet e këtyre gjuhëtarëve, të cilët janë të prirur vetëm ndaj gjuhëve të shkruara dhe të njohura (sanskrite, greke, latine, kelte, gjermanike, sllave, etj...).

3) Meje, në të dy librat e tij që kam cituar, i kushton gjuhës shqipe vetëm njëzet rreshta, të cilat qoftë edhe të thëna kalimthi janë shumë pak në raport me "studimet e tij gjuhësore". Kulmi është kur ai vetë dyshon për përkatësinë e gjuhës shqipe ndaj gjuhës ilire. Meje e pranonte haptas mosnjohjen e tij të plotë për gjuhët e trungut pellazg d.m.th

thrako-frigjianen, ilirishten dhe shqipen. Si shumë të tjerë përpara dhe pas tij ai nuk dyshoi as edhe për një çast në fund të fundit se shqipja është e vetmja gjuhë mbijetuese europiane nga këto gjuhë që pretendohen se janë "të zhdukura". Do të doja të dija se si dhe në çfarë mënyre dhe në çfarë baze materialesh këta gjuhëtarë të parë kanë mundur të shpallin drejtpërdrejtë se gjuha greke dhe pastaj ajo latine janë gjuhët stërgjyshore të gjuhëve tona moderne perëndimore? Ndërkohë që në zanafillë të këtyre dy gjuhëve ka qenë gjuha etruske, pellazge, thrako-frigjiane dhe më pas gjuha ilire. Ata shpesh janë lejuar, pa të drejtë, të pohojnë që kjo apo ajo gjuhë ishte ose nuk ishte gjuhë indo-europiane! Përveç kësaj, kur flitet për gjuhën indo-europiane duhet ditur se nuk është fjala për një gjuhë të mirëfilltë dhe se kjo fjalë që përcakton një grup gjuhësh të folura në Europë (greqisht, latinisht, gjuhët kelte, gjermanike, romake dhe sllave) dhe në Azi (iranishte e lashtë, sanskritisht, tokariane...) dhe lidhjet që ekzistojnë midis tyre, është pra një shpikje e mirëfilltë e gjuhëtarëve të parë dhe filologëve të shekullit XIX. Megjithatë, ata pothuajse e kanë bërë "gjuhë mëmë"!

Gjuha greke e ka marrë emërtimin e saj si indo-europiane vetëm falë prurjes gjuhësore të përbërë nga një numër i shumtë elementesh pellazge. Në të vërtetë një keqkuptim shumë i madh mbijeton ende sepse historianë të shumtë, arkeologë, ose gjuhëtarë ngulmojnë të besojnë se stërgjyshërit e Grekëve vinin nga "Veriu i Greqisë". Çdo historian apo hulumtues, i denjë për emrin e tij, e di mirë se në veri të Greqisë ekzistonin popuj të shumtë që rridhnin nga i njëjti trung etnik. Bëhet fjalë për Dardanët, Peonianët, Tesprotët (të kthyer më vonë në Epirotë) dhe Ilirët. Këta të fundit si tokë zanafillore kishin rajonet danubiane të qendrës së Europës dhe kanë lulëzuar në perëndim dhe në jug të Europës. Ne e dimë se Ilirët dhe Thrako-Frigjianët përbënin dy degët më të rëndësishme etnike të Pellazgëve parahelenë. Të gjithë autorët antikë të shekullit VI dhe V para Krishtit ndër të cilët Hekate i Miletit, Herodoti dhe Tuqididi kanë pohuar se Pellazgët ishin një

popull autokton dhe barbar (dhe me gjuhë jo greke) që banonin në këtë vend përpara mbërritjes së Grekëve. Atëherë si mundet që Grekët ta kishin zanafillën nga një rajon ku nuk flitej gjuha greke? Kjo ideologji ishte fakti i disa autorë pas-klasikë, që u përpoqën ta fshehin zanafillën semito-egjiptiane të disa prej mbretërve dhe heronjve e tyre. Megjithatë ne dimë se disa grekë, të tillë si Jonianët ishin Pellazgë "të helenizuar" gjatë kolonizimeve greke (cf Herodoti I, 56 – VIII, 44). Kjo të kujton atë që ndodhi në Malin e Zi, ku populisia iliro-shqiptare u sllavizua nga kolonët Serbë, si edhe gjetkë pjesa më e madhe e Ilirisë Antike duke nisur nga shekulli VII pas Krishtit: në se bëhen hamendësime për këtë realitet nuk do të vihej në dyshim zanafilla iliro-shqiptare e Malazezëve si dhe përafërsitë e shumta etnike dhe kulturore midis Boshnjakëve që janë të një trungu me ta, kroatëve ose sllovenëve edhe vetë këta iliro-shqiptarë.

Grekët, duke arritur në këtë vend që do të mbante emrin e tyre, gjetën aty popullsitë autoktone dhe një gjuhë barbare të trungut pellazg. Këta pushtues bartën gjuhën e tyre semito-egjiptiane që u përzje dhe u mbivendos ndaj asaj pellazge të lashtë. Homeri përmend praninë e Pellazgëve në Thesali, Arkadi, Kretë dhe Trojë. Hesiodi pohon se sipas renditjes kronologjike, Pellazgët tashmë ekzistonin kur mbërritën "Akenët" dhe "Dorianët". Shënojmë se prijës të shumtë ose mbretër "të huaj" ishin në krye të qyteteve apo shumë viseve: Danaos Egjiptiani në Argos prej nga ai dëboi ose nënshtroi Pellazgët. Kadmos Fenikasi në Tebë, Minies (?) në Orkomenë, Kekrops Egjiptiani në Athinë, Pelopsi që vinte nga Azia e Vogël në Peloponez dhe të tjerë, Kodros ose Melantos... Përsa u takon Ilirëve asnjë autor antik nuk e ka mohuar ekzistencën e këtij populli, as të qenit nga një trung me Thrakët ose me Pellazgët. Liburnët, Enetët (Venetët e ardhshëm) dhe Dalmatët, me vëllezërit e tyre të racës ilire bënin pjesë në të gjithë këtë tërësi të Thalasokracisë mesdhetare, ndër të cilët me të shquarit ishin Pellazgët, Filistinët, Teukrët, Trojanët, Turshas (Etruskët), Eteokretasit dhe të tjerë Popuj të Detit.

Në lidhje me Thalasokracinë po japim këtu atë çfarë thotë d'Arbua de Jubainvil: "Marina kaq e mburrur e Grekëve ishte vetëm një vijimësi e marinës së Pellazgëve, të ndëshkuar nga shpartallimi për të mbetur në harresë. E njëjta gjë mund të thuhet për arkitekturën, skulpturën dhe poçerinë. Helenët pushtues filluan duke jetuar nëpër shtëpitë e ndërtuara për aristokracinë e mundur pellazge nga muratorët dhe skulptorët pellazgë dhe kur këtyre pushtuesve iu deshën shtëpi të tjera, ishin sërish muratorët pellazgë që i ndërtuan ato.. Dhe megjithatë, pa dashur të pushtohemi nga pamjet, pa dashur të kufizohemi në kuadrin politik, do të shkojmë deri në fund çështjeve dhe do të depërtojmë deri në realitetet e jetës do të mund të themi se ishte marina pellazge, e cila në shekullin V para Krishtit ende mbizotëronte në detin Egje nën emrin marina greke."

Gjuha shqipe, nëpërmjet gjuhës pellazge, thrako-frigjianes, etruske dhe ilire, është gjuha më e lashtë në Europë, pra ka "ekzistuar" para greqishtes, latinishtes ose keltishtes. Për më tepër ne nuk mund të pohojmë të kundërtën. Do të shohim pak më tej, në veprën që keni në dorë, përputhjet gjuhësore që "pellazgjishtja" ka patur me gjuhët e Europës danubiane ose egjease. Ende guxohet të thuhet se është fjala për një gjuhë të përbërë nga gjuhë të shumta të tjera! Pavarësisht kësaj, gjuhëtarët nuk e njohin mirë faktin se kjo gjuhë është unike dhe krejt më vete në klasifikimin e gjuhëve të quajtura indo-europiane.

Gjuha shqipe, ashtu si pjesa më e madhe e gjuhëve të botës, në të vërtetë ka trashëguar fjalë që vijnë nga vende të ndryshme me të cilat ajo ka qenë për një kohë të gjatë në marrëdhënie të ngushta. Madje në mënyrë të ndërsjellë ka marrë fjalë fillimisht me zanafillë pellazge të shndërruara nga greqishtja ose latinishtja! Por fondi gjuhësor i kësaj gjuhe është ai fond, i cili në Europë ka ruajtur numrin më të madh të termave ose rrënjëve tipike pellazge.

Çdo gjuhë ka rrënjët e saj, fonetikën, sintaksën dhe gramatikën e saj, të cilat ndikimet gjuhësore të huaja nuk mund t'i ndryshojnë. Në

këtë sens krahasohen gjuhët dhe jo nga numri i fjalëve të futura apo të huazuara. Mirëpo krejt ndryshe me traditën gojore parahelene, tekstet e shkruara greke, pra me zanafillë më të vonshme dhe si rrjedhojë pas-homerike, të cilat nuk përmbajnë funksione dhe as atribute të lidhura me perënditë. Ne e gjejmë shpjegimin e tyre në vetë emërtimin e antroponimeve te "Zemërimi i Akilit" dhe në "Kthimin e Uliksit" (epopetë e para të traditës gojore). Falë gjuhës shqipe ne arrijmë t'i përkthejmë. P.sh. Odhys.. eus = Udhës (Udhëtar); Aspeit... os = A'shpeit (i shpejti) ose Akhile.. us = Aq i lehtë, duke përmendur këtu vetëm dy nga heronjtë më të shquar të Homerit: Odisean dhe Akilin. Poemat homerike përbëhen nga rrëfenjat e epokave të ndryshme: periudha mikeniane ose egjeo-kretase, periudha parahelene (Epokat e errëta) dhe epoka arkaike (fillimi i qytetërimit helen). Por pjesa më e madhe e ngjarjeve të referuara stricto sensu janë të pandashme me periudhën homerike. Këto poema përmbajnë një mori epitetesh të "natyrës", të zanafillës tipike parahelene: Akili i shpejti, Akili këmbëlehti, Mikenët me rrugë të mëdha ose Mikenët mbuluar në ar, etj...

Finlei dhe Snodgras pohojnë se nuk ka asgjë të përbashkët midis Greqisë së Homerit dhe Greqisë parahelene. Metrika e Homerit duket e pazbërthyeshme me anë të ritmit normal të gjuhës greke. Përveç kësaj disa gjuhëtarë pohojnë se zanafilla e hekzametrit nuk është me zanafillë greke. Shumë autorë të kohëve të sotme mendojnë se deri në Epokën e Bronzit nuk ka patur shkëputje me të kaluarën dhe se shkëputja e vërtetë filloi me mbërritjen e Helenëve. Në të vërtetë pushtimi helen dhe fillimi i helenizimit të popullsive pellazge kanë filluar me atë që është quajtur pa të drejtë "dyndja doriane" që disa e krahasojnë me "Kthimin e Heraklidëve". Qysh nga shekulli VIII gjithçka ndryshoi në këtë rajon. Sipas disa arkeologëve, popullsia e Atikës do të jetë katërfishuar në vitet 800–750 para Krishtit, d.m.th. për pesëdhjetë vite. Lëvizjet migruese fillojnë në vitet 775 para Krishtit, në epokën kur "polis" është një shtet në embrion. Nga fundi i shekullit

VIII u zhvillua një art i ri lufte: shfaqja e "hoplite"*) (këmbësoria e ushtrive greke). Një erë e re kulti filloi për Greqinë. Nuk ekzistojnë ngjashmëritë e përkryera midis Panteonit mikenian dhe atij të Greqisë historike. Ikonografinë mikeniane që parapëlqente figurën "femërore" (matriarkatin) e pasoi figura "mashkullore" (patriarkati). Këto janë fillimet e vërteta të qytetërimit grek.

Pushtimet e reja dhe ngulimi i etnive të reja në Greqi kanë maskuar atë çfarë ekzistonte përpara mbërritjes së tyre, çka mund të krahasohet me Egjiptin e sotëm të mbiquajtur arab dhe mysliman. Megjithatë, arabët e kanë pushtuar këtë vend vetëm në shekullin VIII të erës sonë. Më parë dhe gjatë afërsisht 2500 viteve, një tjetër etni, një tjetër kulturë, një tjetër gjuhë dhe një tjetër besim lulëzonin aty.

Le të kthehemi te gjuha greke. Gjithçka që u shpjegua dhe për të cilat u vunë bazat nuk i ka penguar disa gjuhëtarë ose deshifrues të

MAT: Kostum popullor

*) *këmbësoria e Greqisë së lashtë*

gjuhëve të lashta të përpunojnë hamendësitë e tyre dhe të imponojnë përfundimet e tyre apo diktatin e tyre. Një farë Mikel Ventri, i cili në vitin 1935 iu vu punës të deshifronte Linearin B, një shkrim nga fundi i periudhës mikeniane. Ventri bazohet vetëm dhe në mënyrë të veçantë në gjuhën greke apo më saktë në "greqishten e lashtë": Asnjë krahasim (kjo as që i shkon ndër mend) me gjuhët parahelene, të tilla si pellazgjishtja e lashtë apo ndonjë gjuhë tjetër e një trungu (shqipja) apo çfarëdo lloj gjuhe anatoliane të tillë si p.sh. gjuha hitite. Por Ventri nuk njihte as pellazgjishten e lashtë dhe as ndonjë gjuhë tjetër të një trungu, të tillë si ilirishtja ose shqipja e Veriut (dialekti gegë) dhe shqipja e jugut (dialekti toskë) dhe megjithatë ka gjetur përqasje midis gjuhës greke dhe Linearit B. Si mund të gjenden përqasje midis një gjuhe greke që ka lindur vetëm në shekullin VIII para Krishtit dhe gjuhës të Linearit B që do të jetë folur nga Mikenët qysh nga shekulli XV deri në fund të shekullit XII para Krishtit? Aq më tepër kur disa pohojnë se përpara mbërritjes së Grekëve, Pellazgët zotëronin vendin që do bëhej Greqia (cf. autorët antikë)! Të gjithë gjuhëtarët ose helenistët që njohin ose kanë nocione mbi albanologjinë, pohojnë se ekzistojnë analogji të shumta midis "greqishtes së vjetër" dhe dialektit të Shqipërisë së Veriut, "gegërishtes", e cila ende trashëgon terma dhe fjalë të shumta parahelene (pellazge) të trashëguara më vonë nga gjuha greke. Se në ç' mënyrë gjuha greke (gjuhë e mëvonshme se gjuha pellazge) ka huazuar kaq shumë nga pellazgjishtja e lashtë, për këtë detyrimisht Ventri mund të gjente vetëm "përqasje" midis gjuhës greke dhe Linearit B. Ky deshifrim i trashë dhe ky pseudozbulim i japin edhe më shumë rëndësi mbështetësve të "lashtësisë" të qytetërimit grek, duke e përzmadhuar edhe më shumë hapësirën e tij. Dhe deri më sot është kjo ideologji që mbisundon në mjediset helenofile dhe ato të historiografisë së Greqisë së lashtë.

Ka ende kohë për t'i riparë nga fillimi deri në fund të gjitha nocionet e sotme mbi atë që quhet gjuhë indo-europiane. Me qëllim që të çojmë përpara njohuritë tona mbi gjuhët parahelene dhe bazat e gjuhësisë

moderne është e domosdoshme që çdo hulumtues të mësojë pikësëpari gjuhën shqipe, më në veçanti fondin e saj të lashtë, ilirishten, të përfaqësuar nga dialekti gegë (dialekti i Shqipërisë së Veriut), në vend që të kufizohet vetëm në gjuhën greke, latine, kelte, gjermanike, sanskritishte etj. Shënoj së fundi se gjuha shqipe megjithëse shkruhet me germa latine, sot është pranuar se është me zanafillë ilire dhe si një gjuhë krejtësisht më vete, e cila ka ruajtur karakterin e saj zanafillor parahelen.

Indo-europianizmi

Siç e kemi parë tashmë, nocioni i "gjuhës indo-europiane" nuk nënkupton pa tjetër etni indo-europiane. Përveç kësaj, ky nocion është krejt i turbullt dhe arbitrar dhe është vetëm një "neologjizëm" i krijuar nga hamendësimet, përfytyrimet apo fantazia e disa filologëve dhe gjuhëtarëve të shekullit XIX. Kundërshtitë rreth zanafillës së popujve europianë ekzistojnë ende. Këto kanë variuar me kalimin e kohës dhe çdo tezë apo hipotezë ka zgjatur vetëm për njëfarë kohe dhe është rrëzuar nga një antitezë ose hipoteza të reja, të cilat autorët dhe ithtarët e tyre i kanë besuar ose ende i besojnë se janë më të mirat ose më të pranueshmet! Sa shumë dijetarë kanë thirrur si teveqel "eureka"!

Në të vërtetë deri më sot asnjë dijetar nuk ka mundur të shpalosë prova të pakundërshtueshme mbi zanafillën e popujve indo-europianë. Ka një paqartësi të plotë për shkak të pistave të shumta të gabuara dhe të huazuara qysh me lindjen e gjuhësisë moderne, arkeologjisë, etnologjisë dhe antropologjisë: një hamendësim, një pistë apo një zbulim rrëzon një tjetër! Për të njohur të vërtetën ose të paktën për t'iu afruar asaj më shumë, disa dijetarëve iu mungon ndonjë apo shumë hallka në vargun e madh dhe të gjatë të popujve të Europës.

Përpara shfaqjes së shkrimit dhe të epigrafisë (sumeriane rreth vitit 3200 para Krishtit, egjiptiane rreth vitit 3000 para Krishtit, hitite rreth mijëvjeçarit II, fenikase të dëshmuar rreth shekullit IX para Krishtit,

alfabetit grek rreth shekullit VIII, por shkrimet e para të dëshmuara rreth shekujve VII dhe VI, latinishtes rreth shekullit VI por shkrime të dëshmuara në shekullin III, etj.) përveç gravurave në shkëmb dhe të disa shenjave simbolike të shpërndara dhe pak domethënëse, ne nuk kemi asnjë provë të shkruar në lidhje me historinë e popujve të parahistorisë. Kjo arrihet a posteriori dhe shumë më vonë, kur të lashtët na zbulojnë një pjesë të historisë së tyre dhe të legjendave të së kaluarës. Për sa i takon këtyre të fundit, ato rrjedhin nga një traditë gojore e përcjellë nga një brez në tjetrin dhe shpesh të shndërruara ose të shpërfytyruara për shkak të kohës që ndan faktet e së kaluarës nga regjistrimi nëpërmjet të shkruarit; pa folur për manipulimet ose fshehjet e ndryshme (antike apo moderne), të cilat e kanë errësuar edhe më historinë e lashtë të popujve europianë.

Hulumtuesit modernë, në kërkimet e tyre duhet të bazohen në shkrimet antike, analizat e bëra nga autorët e lashtë ose modernë si dhe mbi kërkimet e realizuara nga hulumtues të tjerë në fusha krejt të ndryshme, të lidhura me temën e trajtuar dhe në veçanti gjuhësia, historia e lashtë, arkeologjia, antropologjia, etnologjia, toponimia, onomastika, qeramikologjia, paleontologjia, etj.

Megjithatë studimet themelore të gjuhësisë moderne bazohen në metodat krahasuese dhe përputhjet gjuhësore midis pjesës më të madhe të gjuhëve të Europës (greqisht, latinisht, keltisht, gjermanike, romake, sllave, etj.) edhe shumë gjuhe të Azisë (sanskrit, avestik, iranian, tokarian, etj)si dhe me lidhjet ose ngjashmëritë që ekzistojnë midis kulturave të tyre. Pra duhet provuar të përcaktohen analogjitë e ndryshme midis disa gjuhëve në mënyrë që të njihet uniteti i tyre i lashtë dhe për t'i rilidhur këto gjuhë me popullsitë e përcaktuara. Gjithmonë është kërkuar djepi i këtyre gjuhëve, por kundërshtitë janë të tilla sa është e vështirë t'i pajtosh të gjitha këto mendime: lokalizimet shkojnë nga Baltiku deri në Azinë qendrore, duke kaluar nga rajonet danubiane, stepat ruse, Ballkani, Azia e Vogël dhe Egjeu!

Por që të mund të kemi një gjykim të drejtë, të paanshëm, në mungesë të atij të përkryer dhe për të përcaktuar një vijimësi homogjene dhe të ndërlidhur duhet të kesh në zotërim maksimumin e elementeve bindës, të pakundërshtueshëm ose të paktën prova të prekshme ose hamendësitë e provave të mbështetura nga analistë të thelluar si dhe elemente të reja të provuara dhe mbi të gjitha burime të sigurta dhe të kontrollueshme.

Fatkeqësisht nuk ndodh kështu për shumicën e hulumtimeve apo studimeve shpesh të fshehura nga mungesa e saktësisë apo të përpikërisë ose së fundi të devijuara nga ndërhyrja e elementeve ideologjikë, apo tendenciozë.

Cilat janë tezat e ndryshme ose hipotezat në lidhje me zanafillën e popujve indo-europianë? Ja pra një përmbledhje e shkurtër, ku unë me gjithë dëshirë kam eliminuar hipoteza nga më fantazueset.

Para së gjithash po shënoj se pionierët e gjuhësisë moderne dhe themeluesit e saj të shkulit XIX janë si më poshtë: Sosyr, Ankëtil-Dyperon, Uilliam Xhons, Fridrih fon Shlegel, Franc Bop, Ramus C. Rask, Jakob Grim, August Shlaiher, Adalbert Kyhn, Adolf Piktet, A.F.Pot, Marcel Breal, Maksimilian Myler, Gustav Mejer, Pol Kreçmer, etj. ... Në gjysmën e parë të shekullit XX midis gjuhëtarëve më të shquar janë Antuan Meje, Albert Karnoi, Hans Krahe, Norbert Jokl, Vitore Pizani, Xhakomo Devoto, Dumezil etj....

1) Teoria e parë doli në shekullin XIX me punimet e para të realizuara nga themeluesit e gjuhësisë. Ajo solli proto indo-europianen e Azisë (Rrafshina e Palmirit, Baktrian etj.). Vetëm me shfaqjen e arkeologjisë dhe të antropologjisë, gjuhëtarët filluan të ravijëzojnë zgjidhje të tjera dhe koncepte të reja.

2) Teoria tjetër, e kundërt me hipotezën e mëparshme: "Indo-Europianët" do të kenë rrjedhur nga popullsitë europiane parahistorike (drejtimi i migracionit: Europë - Azi). Gjithsesi kjo teori nënkupton tri variante:

- Zanafilla nordike (Skandinavi, Gjermania veriore, Lituani ose Poloni). Disa nga ithtarët e saj kanë qenë ideologët e parë të "Indo-Gjermanizmit", tezë nacionaliste e "racës ariane" (tezë ekstremiste) që mbrohej nga August Fridrih Pot, Jozef Artur de Gobino, Adolf Pikte, Maks Myler, Karl Otfrid Myler,Viktor Hehn, Ludvig Gaiger, Karl Penka etj. Teoria nordike klasike (jo raciste) ndahet *grosso modos*, në dy teza ndër të cilat një ishte plotësisht nordike (veriu i Gjermanisë, Skandinavisë) dhe tjetra vendosej midis "nordikes" dhe "danubianes" (Gjermania e mesme dhe rajonet balto-sllave). Këto dy teza janë mbrojtur nga, Gustav Kosina (në versionin e tij të parë) J. Teilor, Herman Hirt, Mateus Muh, Harold Bender, Osmund Mengim, Xhakomo Devoto, Julius Pokorni, Stjuart E. Man, Hans Krahe, Janosh Makai, Vitold Mancak.

- Zanafilla danubiane (Bavari, Gjermania e Jugut, rajoni danubian perëndimor dhe qendror); është kultura neolitike e quajtur "Europa e Vjetër". Ajo mbështetet në një material arkeologjik shumë të pasur dhe mbrohet nga Mateus Muh, G. Kosina, (versioni i dytë), P. Xhill, Kreçmer, N. Lahovari, Ernst Mejer, P. Thieme, R.A. Krosland, Xhakomo Devoto, Ram Kandra, Igor Diakonof.

Kjo tezë mbrohet nga arkeologë të shumtë, etnologë dhe gjuhëtarë. Ajo ka meritën se bazohet në elemente të shumta arkeologjike të bashkëlidhura dhe të përbashkëta për rajonet danubiane, ballkanike egjease dhe anatoliane dhe në një material gjuhësor të rëndësishëm, në veçanti toponimik. Unë mendoj se këta "Danubianë" bënin pjesë në degën perëndimore të një "grupi" që mbetet ende për t`u ripërcaktuar. Kjo degë do të ketë krijuar kulturën e "Helladikës së lashtë III" dhe që rreth vitit 2300 para Krishtit do të ketë depërtuar në Ballkan, Egje dhe Anatoli (Pellazgë, Thrako-Frigjianë, Hititë, të gjithë të dalë nga grupi "pellazgjik i lashtë"). Dega "tjetër" do të ketë qenë orientale dhe do të ketë depërtuar në Azi, nëpërmjet Kaukazit dhe do të ketë qenë zanafilla e formimit të elitave të Kasitëve dhe Hurritëve. Disa autorë i

bashkëngjisin këta të fundit me të famshmit "Arias". Emër me zanafillë sanskrite që duket të ketë emërtuar "Indo-Europianët" lindorë dhe të Iranit e të Indisë, karakteristikat etnike dhe fetare të të cilëve janë tepër të ndryshme me ato të degës perëndimore të Indo-Europianëve.

- Zanafilla pontike (jugu i Rusisë, Ukraina, veriu i Kaukazit) të mbrojtur nga Oto Shrader, S. Rainah, Sigismond Zaborovski, Albert Karnoi, Harold Pik, Gordon Çaild, Ernst Vahle, Georges Puaso, H. Jensen, Benvenist, Kristofer Houks, Stjuart Pigot, Aleksandër Brjusov, Pia Lavioza-Xamboti, Fric Shahermejer.

3) Një tjetër teori që del nga arkeologa lituane Marija Aljeikaite Gimbutas: ajo privilegjon "kulturën e stepave ruse të quajtura të Kurganëve". Edhe në këtë rast është arkeologjia që i vjen në ndihmë gjuhësisë. Gimbutasi bazohet në pjesën më të madhe në kërkimet arkeologjike të ish - BRSS, punimet e së cilës mbetën pothuajse të panjohura për dijetarët perëndimorë, për shkak të mungesës së dokumenteve të përkthyera. Kjo tezë konsiston në trajtimin e kulturave të Rusisë jugore si një tërësi kulturore homogjene dhe e vazhdueshme gjatë një periudhe shumë të gjatë (Neolitike/Epoka e Bronzit). Këto kultura do të jenë përhapur drejt Lindjes d.m.th. drejt Azisë dhe drejt perëndimit duke përthithur kulturën danubiane të "Europës së Vjetër". Nga kjo "shkrirje" do të ketë lindur një kulturë e re e përzier.

Kultura matriarkale e rajoneve danubiane, sipas protagonistëve të kësaj teorie do t'i ketë hapur rrugë përparimit të popujve të stepave të mbiquajtur "Kurganë", të cilët vijnë nga Azia qendrore dhe shkallë-shkallë drejt perëndimit (Baltik dhe deti i Veriut) dhe drejt jugut (Danubi dhe veriu i Detit të Zi). Këta popuj të stepave, të kulturës patriarkale, do të kenë qenë "bartësit" e gjuhëve indo-europiane në Europë!

Kjo teori, e cila pajton dy kultura të ndryshme dhe dy teori të kundërta duket pakëz e njëanshme dhe jo shumë larg "tezës" nacionaliste dhe në veçanti sllavofile. Ky diversion në misteret e parahistorisë, nëpërmjet rikoshetës, a është e destinuar të provojë se

shoqëria "patriarkale" e mbiquajtur "akene" (në kundërshti me atë pellazge, të quajtur "matriarkale" kishte lidhje të ngushta me këtë popull të stepave? A nuk fshihen në këtë mënyrë plotësisht ndërfutjet semito-egjiptiane në qytetërimin pellazg, nga përzierja e të cilit kanë lindur Akenët ose Helenët? Vetë këta teoricienë pohojnë që këta popuj të stepave ruse, bartës të "kulturës indo-europiane" gjatë udhës që bëjnë kanë gjetur populsi të tjera jo indo-europiane të vendosura në kontinentin e vjetër, të tillë si Ligurët, Iberët, Sikulët, Etruskët, Pellazgët, etj! Atëherë cilët të tjerë trajtojnë ata si indo-europianë!

Megjithatë Marija Gimbutasi e emigronte popullin e saj të Kurganëve drejt Europës perëndimore me tri dyndje të njëpasnjëshme, të cilat shkonin nga viti 4400 deri 2900 para Krishtit. Këto të dhëna do të kenë qenë rezultat i përcaktimit të një datimi të stilit "Karbone 14 i rikalibruar"*) i kryer duke i shtuar një mijëvjeçar datave klasike, të cilat tashmë janë trajtuar si tejet të pasigurta dhe arbitrare!

Gi Reshet në veprën e tij "Fjalori i arkeologjisë", ka patur një reflektim të drejtë në lidhje me këtë teori: "Teprimi në këto hipoteza, si në planin kronologjik edhe në atë të shtrirjes së Kurganëve, e bën teorinë më pak të besueshme, sa mund ta hedhin poshtë në të gjithë tërësinë e saj". Megjithatë kjo teori u rimor qysh atëherë nga H. Tomas, Draga/Garasanin, Kard, Tovar, Bokoni, Sherrat, Diebolt., Dumezil, Parpola, Serxhënt, Malori, Kortlandt, Maknik, Kosko, Huld, Bader, Harman etj.

Për mendimin tim kjo ka ndodhur nga Perëndimi, d.m.th. nga Ballkani këta "indo-europianë" kalojnë në Azinë e Vogël dhe jo nga Kaukazi ose "stepat ruse". Në të vërtetë autorë të shumtë janë të të njëjtit mendim me mua, d.m.th se këta "indo-europianë" ishin me zanafillë thrako-frigjiane, d.m.th. pellazge. Të tjerë pohojnë se në këtë valë emigrimi bënte pjesë elita e popullit hitit.

---

*) *Karboni 14 është izotopi radioaktiv i karbonit me anë të të cilit përcaktohet datimi i mbetjeve arkeologjike apo drurit etj.*

4) Një teori e katërt, më hibride dhe pak a shumë e bashkëlidhur, bazuar në të qenët njëherësh kulturë danubiane e "Europës e vjetër" dhe kulturë e "Kurganëve", pohon se proto indo-europianët ishin njëherësh popuj të Europës danubiane dhe ata të stepave ruse dhe se këta të fundit të kenë krijuar një degë iraniane të proto indo-europianëve, ndër të cilët pasardhësit do të kenë qenë Skithët. Kjo tezë ka qenë ajo e Marija Gimbutas gjatë hulumtimeve të para të saj! Kjo teori u zhvillua nga autorë të tjerë ndër të cilët Trubeckoi (1939), Bosh - Gimpera (1961/64), Uord Gudinaf (1970) Aleksandër Hoysler (1981) dhe shumë hulumtues të tjerë rusë ndër të cilët Borkoski (1930), Pasek (1941/45), Grakov (1971), Kuzmina (1985/88) ose Telegin (1990).

5) U shtuan edhe dy teza të tjera : zanafilla anatoliane (Kolin Renfru) dhe zanafilla jug-kaukaziane (Gamkrelize, V. Ivanov).

Bernard Serxhënt (Indo-Europianët, Pajot /1955) - faqe 397-400) ithtar i teorisë së Gimbutasit na thotë: "Së fundi, që të trajtohen zanafillat e përpikta, të përcaktuara nga kërkimet arkeologjike, të kulturave të Gjermanëve, Grekëve, Balto-Sllavëve, Indo-Iranianëve, Thrakëve, gjithmonë duhet drejtuar në zonën e stepave, në kulturën e Kurganëve, ndërkohë që për Anatolianët, Keltët, Ligurët, Italikët, vetë kulturat e stepave japin elementin sintezë të popujve, element që është në zanafillën e tyre. Kjo konvergjencë është e dukshme: përveç asaj të Kurganëve aty nuk ka kulturë parahistorike që të përkojë me shpërndarjen e popujve të gjuhës indo-europiane, të nisur nga një qendër e përcaktuar. Lidhjet e vërejtura midis grupeve indo-europiane dhe grupeve të tjera gjuhësore shkojnë në të njëjtin drejtim, sido që janë më pak vendimtare (sepse më parë duhen njohur mirë gjuhët e zhdukura të Europës para indo-europiane për të hedhur poshtë provën). Sidoqoftë këto lidhje bëhen me shumë gjuhë të Lindjes dhe të Europës ose të Azisë Perëndimore. Pra është e logjikshme të identifikohen Indo-Europianët në fazën që i paraprin dhe në fazën e shpërhapjes së tyre, me qytetërimin e Kurganëve... Njëherësh është ende objekt diskutimesh

– me kulturën e madhe neolitike me zanafillë danubiane, Kuseteni-Tripolje, që mbulon Rumaninë dhe Ukrainën perëndimore datohet faza e Kurganëve I qysh nga fillimi i mijëvjeçarit V përpara Krishtit. Dhe në faqen 404 ai shton: "Indo-europianizimi i Europës së lashtë fillon në mijëvjeçarin V".

B. Serxhënt, ashtu si mendojnë mësuesit e tij, është kategorik për sa i takon ekzistencës më të hershme të popujve të stepave (Kurganët) në ndërtimin e etnive dhe gjuhëve indo-europiane: "nuk ka tjetër", thotë ai (me pakëz arrogancë). Përveç kësaj ai nxjerr një rezervë, të cilën gjithsesi nuk e gjykon shumë vendimtare: "më parë duhej të njiheshin mirë gjuhët e zhdukura të Europës indo-euroipane për të arritur kundërprovën". Nuk ka patur as studime serioze dhe për më tepër kundërprova! Nëse të gjithë teoricienët do të kishin mësuar gjuhën shqipe (gjuhë pellazge dhe parahelenike, jo e zhdukur) ata sigurisht do t`i kishin rishikuar pikëpamjet e tyre. Fatkeqësisht nuk ka ndodhur edhe nuk ndodhët kështu.

Në të vërtetë disa autorë modernë (gjysma e dytë e shekullit XX numëron shumë pak albanologë ndër të cilët pjesa më e madhe nuk janë me zanafillë shqiptare) nuk e zotërojnë plotësisht gjuhën shqipe (mbi të gjitha dialektin gegë, duke përjashtuar dijetarët e regjimit komunist shqiptar) dhe nuk i njohin lidhjet e saj me pellazgjishten e lashtë, ilirishten, trakishten ose etruskishten dhe janë bashkuar verbërisht me teoritë që bazohen mbi elemente të bazuara keq, të rreme ose thjesht të pjesshme. Këtu nuk do të analizoj apo të përmend të gjitha kontradiktat e ndryshme, gabime faktesh apo të gjykimit.

Nuk mjafton të përsëritësh pohimet e disa autorëve në modë, pa ditur paraprakisht të marrësh masat paraprake të nevojshme apo pa i provuar ato në mënyrë serioze apo qoftë t'i verifikosh. Janë të shumtë arkeologët, historianët ose gjuhëtarët e shquar, të cilët janë lejuar të gjykojnë, të pohojnë ekzistencën e provave apo mos ekzistencën e provave të prekshme apo të bëjnë të besosh për zgjidhje të

pakundërshtueshme ndërkohë që në të vërtetë është fjala për përfundime personale apo partizane që të çojnë në përfundime të rastit duke të dhënë përshtypjen e një kohezioni të përkryer.

Ja një shembull i mungesës së verifikimit dhe përqasjes midis disa etnive ose gjuhëve: na pohohet se gjuha etruske nuk përqaset me asnjë gjuhë tjetër "indo-europiane" të njohur. Disa specialistë kanë nxjerrë shpejt përfundimin se kjo gjuhë nuk ishte "indo-europiane" dhe për të shuar problemin kanë shpallur se bëhej fjalë për një gjuhë parahelene, para indo-europiane ose "gjuhë e zhdukur" (termi i kohës). Megjithatë pjesa më e madhe midis tyre ndajnë të njëjtin mendim për të pohuar se Etruskët janë me zanafillë nga ishujt në veri të Egjeut dhe brigjet e veriperëndimit të Anatolisë (Troada e lashtë) ose të Lidisë. Ata nuk mund të bëjnë ndryshe sepse Hekate i Miletit (shkuli VI para Krishtit) dhe vetë Herodoti (shekulli V para Krishtit) pohojnë se Tirrenët (Etruskët) kishin emigruar në Itali gjatë shekullit XIII për arsye të një zie buke që kishte pllakosur Lidinë. Autorë të tjerë antikë vërtetojnë mendimet e Herodotit (I, 57, 94). Vetë këta autorë pohojnë se ishujt e Lemnosit, Imbros, Samos dhe të Lesbos ishin të banuar nga Pellazgo-Tirrenët. Tuqidid (IV, 109) pohon se këta Pellazgë banonin qysh në kohë të hershme në Lemnos dhe në Atikë". Përveç kësaj në Lemnos, të pushtuar vetëm në fund të shekullit VI nga Greku Miltiadh (cf. Herodoti VI, 140) u zbulua stela e famshme që mban emrin e tij. Kjo stelë e gdhendur në gjuhën lemniane ngjan për çudi me stelën arkaike etruske të Aule Feluske. Sipas autorëve të shumtë, kultura e Lemnianëve është e afërt me atë të Trojanëve. Etruskët njiheshin nga Egjiptianët nën emrin "Tursha", etni që bënte pjesë në "Popujt e Detit", ashtu si edhe vëllezërit e tyre të një trungu "Filistinët". Shumë gjuhëtarë i trajtojnë gjuhët "anatoliane" si të ndryshme nga Etruskishtja dhe pellazgjishtja e lashtë, ndërkohë që autorë të shumtë antikë ndër të cilët Hekate i Miletit, Helanikos i Mitilenit, Herodoti apo Tuqidid pohojnë afrinë etnike midis Pellazgëve, Etruskëve, Thrakëve,

Trojanëve, Moskëve, Frigjianëve ose Lidianëve. Përveç kësaj, disa thonë që gjuha lidiane është një dialekt anatolian i afërt me gjuhën hitite. Por askush, për mungesë studimesh të zgjeruara dhe të hollësishme, nuk ka guxuar t`i drejtohet verifikimeve apo përqasjeve midis këtyre popujve të ndryshëm, as nuk ka bërë aluzionin më të vogël për përputhjet e shumta gjuhësore që ekzistojnë midis këtyre gjuhëve të ndryshme. A të jetë kjo për shkak të numrit tepër të madh të këtyre fiseve dhe të etnonimeve të tyre të ndryshme? A është thjesht për arsye të mosnjohjes së këtyre gjuhëve? Ky gabim kolektiv të çon në rrugë pa krye. Në lidhje me këtë është thënë krejt e kundërta.

Ja edhe një herë ajo çfarë mund të lexohet në lidhje me Pellazgët në "Indo-Europianët" e Bernard Serxhent: "Autorët të cilët e kanë studiuar këtë "gjuhën" e fundit kanë zakon ta quajnë "pellazgjishtja" për shkak të traditave greke që i bëjnë Pellazgët një popull kryesor në Greqi: por Pellazgët në të vërtetë janë një popull shumë i përcaktuar, i shoqëruar shpesh me Tursenët, ka të ngjarë të njëjtë me Filistinët dhe përdorimi i emrit të tyre për të emërtuar një popull kryesor grek është një përgjithësim poetik pa prova; pra, në mënyrë absolute duhet të përjashtohet përdorimi i këtij termi ngatërrues (Bernard Serxhent: Indo-Europianët, 1995, faqe 141)". Dhe të thuash se me kësi lloj mendimesh disa autore (dhe ithtarët e tyre) bëjnë historinë!

Ja pra se si prej një kohe të gjatë varrosen nga injoranca pothuajse totale, Pellazgët dhe popujt që lidhen me ta. Vepra që keni në dorë, në pjesën më të madhe është e destinuar të sjellë pakëz dritë mbi këta popuj dhe këtë gjuhë, njëherësh të njohur keq dhe të nënvleftësuar, në mënyrë që të rivendosim të vërtetën në lidhje me vërtetësinë historike të popullit dhe të gjuhës pellazge, falë provave të qarta, studimeve të thelluara, analizave të shumta dhe së fundi për të eliminuar ose për të diskreditуar arsyetime të ngjashme me ato që vërejtëm.

Për aq kohë sa disa autorë nuk do të jenë të bindur se "grupi gjuhësor" anatolian ka dalë nga ai i rajoneve ballkanike madje danubiane, për aq

sa ata nuk do ta njohin gjuhën pellazge si bazën e gjuhëve europiane (greqishtja, latinishtja...) dhe për aq sa ata nuk do ta pranojnë të qenët e Shqiptarëve nga një trung pellazgo-ilir, historia e këtij rajoni do të mbetet e errët madje e mbushur me dyshime dhe njëanshmëri.

Kemi parë në kapitullin e mëparshëm se sa mahnitshëm Meje e shpërfill gjuhën shqipe dhe nuk bën as edhe verifikimin më të vogël apo përqasje midis gjuhëve të trungut pellazg, të tilla si pellazgjishtja, thrakishtja, ilirishtja, gjuhët anatoliane dhe gjuhës shqipe. Megjithëse ky ishte një nga gjuhëtarët më të shquar të fillimit të shekullit XX.

Po rinis leximin e librit "Indo-Europianët" të Bernard Serxhënt, më saktësisht në lidhje me ilirishten dhe gjuhën shqipe (faqe 41): "Çfarëdo qoftë ideja e supremacisë gjermanike, me gjithë kortezhin ideologjik që e shoqëroi, përfundoi dhunshëm në vitin 1945... Nga pena e gjuhëtarit të madh Hans Krahe mund ende të lexohet në vitin 1949 se "Ilirët"- entitet së tepërmi artificial dhe i mbivlerësuar nën shkrimet e tij, ashtu si ai vetë duhet ta ketë konceptuar disa vite më vonë - kanë pushtuar Europën dhe kanë sjellë aty "gjakun nordik" ripërtëritës (Krahe, 1949, 14, 15): sidoqoftë e gjithë kjo është një fantazi. Këta ilirë mitikë janë këtu reflektimi i dobësuar i Gjermaneve dhe Indo-Gjermanëve të epokës së madhe të nacionalizmit gjerman" (faqe 93): "Gjuha shqipe i bashkëngjitet të njëjtit grup ashtu si gjuha sllav dhe baltike, duke qenë pak më shumë se ky këtu apo ai atje". Pastaj (faqe 94): "Territori i gjuhës shqipe përkon gjerësisht me atë të ilirishtes së lashtë dhe natyrshëm është mbajtur nga të gjithë si një burim të dhënash dhe në veçanti nga tërësia e specialistëve shqiptarë si pasardhëse e kësaj gjuhe. Kjo megjithatë nuk është aspak diçka e sigurt. Janë rreth pesëmbëdhj i etë shekuj midis këtyre "dokumenteve" të fundit mbi gjuhën ilire dhe shkrimeve të para në gjuhën shqipe, pesëmbëdhjetë shekuj gjatë të cilëve ka patur lëvizje të rëndësishme të popujve brenda Ballkanit. Përkimi i vendndodhjes nuk provon asgjë... ajo çfarë tregon se bartësit e

gjuhës shqipe janë të mbivendosur ndaj një popullsie me të hershme sllave - pra që ngulimi i tyre është i mëvonshëm se Mesjeta e Hershme"....

Kjo gjë te ky autor përcakton një injorancë të plotë jo vetëm të historisë së Shqiptarëve dhe të territorit të të parëve të tyre por edhe të gjuhës shqipe në veçanti dhe të gjuhësisë në përgjithësi. Sepse në fund të fundit libri i tij a nuk flet për gjuhësinë? Disa e trajtojnë gjuhën shqipe me zanafillë "indo-europiane" dhe e radhitin atë në një grup unik dhe krejt më vete (në mungesë të njohurive më të mira për të!) dhe për më tepër pohojnë se ajo rrjedh drejtpërsëdrejti nga ilirishtja e lashtë. Por B. Serxhent duhet t`i ketë njohur shumë pak "klasikët" e tij dhe nuk i ka thelluar studimet e tij dhe duket se nuk i ka verifikuar burimet e tij. Megjithatë, duke e lexuar atë, vërej se ai dukshëm priret nga kauza "sllave". Shihet mirë se ai është "alergjik" ndaj gjithçkaje që nuk është me zanafillë "Kurgane apo sllave". Përveç kësaj a nuk pohojnë disa Sllavë se Shqiptarët janë me zanafillë turke? Si mund të thuhet me zë të lartë një anormalitet i tillë, d.m.th. se Shqiptarët kanë arritur në Ballkan pas Sllavëve d.m.th. në "Mesjetën e Hershme" dhe se nuk kanë pasur kurrë dalje në detin Adriatik (Ilirët dhe Liburnët a nuk ishin zotë të vërtetë të Adriatikut deri në shekullin II para Krishtit?) dhe së fundi të hedhësh dyshim mbi zanafillën e tyre ilire? Ndërkohë që populli ilir zinte pak a shumë një territor që shkonte nga brigjet e Danubit deri në Epir dhe prej dy brigjeve të Adriatikut deri në Trakë! Ajo që autori ynë nuk di, është se janë pikërisht Sllavët ata që i dëbuan prej andej dhe i zmbrapsën në strehët e tyre malore të sotme (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni). Gjithashtu ai nuk e di apo shpall se nuk e di se masa e stërmadhe e Ilirëve (Panonia, Liburnia, Istria, Dalmacia, Dardania...) ka qenë e asimiluar dhe e sllavizuar nga fiset sllave ndërmjet shkulit VI edhe IX "pas" Krishtit. Ilirët që i kanë rezistuar këtij sllavizimi u strehuan në malet e tyre të lartë të pamposhtshme të Alpeve shqiptare dhe rajoneve përreth. Kështu ata mundën të ruajnë pothuajse të paprekur gjuhën, kulturën dhe zakonet e tyre. Por B. Serxhent duket

se nuk e di fare se shoqëria e pushtuesve sllavë ka qenë e padepërtueshme nga ndikime të ndryshme të popullsive autoktone ilire. Ja çfarë thoshte në vitin 1929 Haberlandt (Popujt e Europës dhe Shtutgardi i tyre kulturor - popullor): "Në Shqipëri gjenden pothuajse të gjitha zakonet që qarkullojnë në Ballkan. Ndikimi i popullsive të lashta thrako-ilire është i thjeshtë të dallohet ndër shumë kostume, rite e zakone të Ballkanit, të Europës Qendrore, të Italisë së Jugut (nga Roma deri në Kalabri dhe Sicili) përreth Dardaneleve, detit Marmara deri në Galipoli, Thrakë, Epir, ishujt e Greqisë dhe nga pak kudo në Azinë e Vogël, deri në vitin 1925 (për Greqinë) daton shkëmbimi i popullsive midis Greqisë dhe Turqisë". Dhe së fundi ja çfarë pohon Xhon Geipel (1969): "Shqiptarët pavarësisht pushtimeve .. në të vërtetë mbetën të izoluar në malet e thella të tyre dhe e ndjenë shumë pak ndikimin e pushtuesve, megjithëse një farë numri fjalësh greqisht, latinisht, sllavisht dhe turqisht kanë kaluar në gjuhën e tyre. Shtrirja sllave në Ballkan gjatë shekullit VI pas Krishtit çoi në zhdukjen e dialekteve shqiptare në rajonet e Bosnjës dhe Malit të Zi, por e thënë saktë, gjuha sllave nuk zuri kurrë rrënjë në Shqipëri.... Ashtu si fqinjët dhe vëllezërit e tyre të së njëjtës racë, Malazezët dhe Boshnjakët që tashmë flasin serbisht, Shqiptarët dhe mbi të gjithë Gegët që ishin më të izoluarit përbëjnë në mënyrë tipike një popull trupmadh, me kokë të rrumbullakët, me fytyrë të gjatë dhe me hundë përpjetë. Të gjithë këta individë dhe gjigandët e Jugosllavisë përvijojnë dukshëm një tërësi tiparesh fizike vendore jashtëzakonisht të lashta". E gjithë kjo flet shumë dhe i jep përgjigje pa dredhia thënieve të rrema të një farë numri autorësh, e pakta tendenciozë ose të indoktrinuar.

Asnjë historian me nivel, nuk mund ta mohojë mbërritjen më të vonshme të Sllavëve në Ballkan: ata shfaqen rreth shekullit VI pas Krishtit apo më saktë shekulli VII pas Krishtit, ndërkohë që emri i Ilirëve (Peonianët e Homerit), stërgjyshërit e drejtpërdrejtë të Shqiptarëve është dëshmuar qysh prej shekullit VI para Krishtit nga

historianët më të lashtë dhe gjeografë grekë të tillë si Hekate i Miletit, Hellanios i Mitilenit, Herodoti, Tuqididi, Polibi, Straboni dhe të tjerë jo më pak të shquar.

Me duhet një libër i tërë për të kapur pikë për pikë gabimet, pohimet e rreme, të pavërtetat, manipulimet ose anormalitetet që mbushin disa manualë.

Ne jetojmë nën diktaturën e numrit më të madh. Në të vërtetë sa t'i largohesh formulës "i rregullt nga ana gjuhësore", del si figurë e një komiti ose trajtohesh si "persona non grata", i papëlqyeshëm.

Tashmë i mbetet brezave të rinj t'i ndërmarrin këto beteja të ashpra, duke nisur me pushtimin e kësaj të vërtete të patjetërsueshme (të paraqitur gjerë e gjatë në këtë vepër) dhe për ta rivendosur kudo ku do të jetë e nevojshme. Këtu unë po le një boshllëk me qëllim që gjuhëtarët e rinj të mund të rregullojnë shënjimet dhe të ritrajtojnë disa teza që e kanë çuar gjuhësinë në këtë rrugë pa krye ku ajo gjendet sot.

"Indo-europianizmi?"*

Gjuhësia moderne ka mbetur në qorrsokak për shkak të një ideologjie kokëforte, e cila jo vetëm që nuk po i rivë në diskutim apo nuk po i ripërtërin tezat (dogmat?) e përpunuara prej fundit të shekullit XIX, por nuk denjon as të vërë gjërat në vend. Ajo vazhdon të bazohet në themele që kanë mbetur të pandryshuara qysh në fillesat e kësaj disipline relativisht të vonë, të cilët bazohen në hollësi të mirëfillta gjuhësore apo shpesh të rastësishme që nuk e njohin apo nuk marrin mundimin ta njohin historinë dhe zanafillën e popujve që flasin apo kanë folur gjuhë, të cilat ata gjithmonë nuk i kanë identifikuar mbi baza reale.

Në të vërtetë unë mendoj se do të duhej të ritrajtoheshin disa teza dhe të shkohej më tej me një rishikim të themeleve kryesore të kësaj disipline, me qëllim që të spastrohen hulumtimet mbi "Gjenezën e gjuhës së folur". Kjo punë do të duhej të bëhej në mënyrë të ndërgjegjshme dhe kolegjialisht, pa ndjenja personale, pa shovinizëm, me paanshmëri, pa dogmatizëm dhe me ndihmën e disiplinave të tjera, me qëllim që një gjuhë, një dialekt, një nënshtresë apo thjesht një fjalë të vendoset në kontekstin e saj historik dhe mbi të gjitha atë kronologjik. Ky rishikim është i domosdoshëm duke patur parasysh studimet e fundit dhe hulumtimet e realizuara në fusha të lidhura ngushtë, të tilla si historia e lashtë, arkeologjia, etnologjia, antropologjia ose paleontologjia. Në të vërtetë këto hulumtime, ndaj të cilave unë kam dhënë ndihmesën time modeste nxjerrin në pah rendin që është pranuar në përgjithësi apo rendin e vendosur.

Kështu, e thënë saktë, del që historia e Greqisë është relativisht e

*) *Kjo pjesë është një dokument shtesë i këtij libri i botuar nga autori më 20 prill 2006*

vonë: askush nuk e provon ekzistencën e kësaj Greqie (ajo histori që ne kemi mësuar në shkollë apo në universitet) përpara shekullit VIII para Krishtit, gjë që e ul shumë kronologjinë e historisë së lashtë greke. Kjo nuk është litotë[1] që përdoret kur thuhet se pushtuesit grekë kanë pushtuar një vend, i cili nuk ka qenë i tyre dhe që e thënë me saktësi u përkiste Pellazgëve, një popull autokton, të cilin ata e nënshtruan dhe prej të cilit kanë huazuar pjesën më të madhe të kulturës së tyre (mitologji, poema epike, rapsodë) dhe mbi të gjitha gjuhën e tyre (në fillim joniane dhe arkado-qipriote dhe më pas doriane). Ja pra edhe "gjuha e tyre"! Pellazgët e quajtur edhe "popuj të Detit, Egjeanë, Mikenë ose Filistinë" (dhe me një mori fisesh, ndër të cilët Karianë, Lisianë, Ligurë, Iberë, Kaukazianë, Thrakë, Tirrenë, Frigjianë, Trojanë, Dardanë, Ilirë, Epirotë, Maqedonë... dhe më vonë Keltët etj.) zinin një pjesë të madhe të Europës qendrore dhe jugore, më saktë të Azisë së Vogël, të Iberisë dhe të Kaukazit.

Pasardhësit e vetëm të Pellazgëve në Europë janë Shqiptarët e sotmë, gjuha e të cilëve (nënkuptohet, me përjashtim të fjalëve të futura apo neologjizmave të huaja) flitet sot ashtu siç është folur qysh prej më shumë se 3000 vjetësh! Në të vërtetë falë maleve të tyre të pamposhtura, të qenit luftëtarë, guximit, krenarisë, vullnetit për të mbetur të lirë dhe të pavarur, si rrjedhojë të "izolimit të tyre" (për të vetmen herë diçka përfituese!) shqiptarët kanë mundur të ruajnë pothuajse të paprekur etninë e tyre (populli më "brakicefalik" i Europës), gjuhën e tyre (një lloj "fosile e gjallë"), kulturën, doket dhe zakonet dhe mbi të gjitha kostumet e tyre që gjenden kudo në vendet e lindjes europiane. Kështu, kjo gjuhë parahistorike (pellazgjishtja e lashtë prej nga gjuha shqipe) arrin të deshifrojë apo të dekriptojë sot toponime të shumta dhe oronime në Europë, Azi e Vogël, Kaukaz, madje në Azi si dhe të

[1] *Figurë retorike që përdoret për të zbutur shprehjen e një mendimi.*

shpjegojë pjesën më të madhe të antroponimeve, tonimeve, eponimeve të mitologjisë të mbiquajtur greke dhe të poemave të mbiquajtura homerike!

Autorët antikë grekë na kanë lënë shkrime domethënëse, të cilat provojnë se Grekët ishin një popull pushtuesish që pushtuan "vendin, i cili do të bëhej Greqia" dhe se Pellazgët ishin 'banorët e parë të vendit". Midis autorëve të tjerë të lashtë grekë, Hekate i Miletit, Hellanikos i Mitilenit dhe mbi të gjitha Herodoti e kanë thënë qartë se Jonianët ishin Pellazgët e kthyer në grekë pasi ishin helenizuar. Herodoti pohon gjithashtu se mbretërit Dorianë (dhe jo populli, i cili ishte me zanafillë ilire) pohonin se ishin me zanafillë egjiptiane. Megjithatë Tuqididi, më shovinisti nga autorët grekë, pohonte se Pelopsi (fjalë që në greqisht do të thotë "fytyrë e ndotur" – aluzion për çehren e tij të zeshkët – i ka dhënë emrin e tij Peloponezit) ishte "një i huaj i ardhur nga Azia". Përveç mbretërve të Athinës (Kekropsi, Eriktonios, Erekte, etj.), perëndive (Poseidon, Dionisi...), gjysmë-perëndive apo heronjve (Perseu, Herkuli...), të gjithë me zanafillë egjiptiane, duhet kujtuar se Kadmos (fjalë që rrjedh nga semitikja kadem " ◻◻ = ky që mbërrin, mbërritësi, pra imigruesi apo pushtuesi), që ishte themeluesi i Tebës greke, dihet mirë se ka qenë një fenikas i mirëfilltë (ai që do të ketë sjellë nga Feniki "alfabetin" e famshëm). Gjithashtu është për tu shënuar se tempujt e parë të ndërtuar me "gurë ndërtimi" (sipas Egjiptianëve, Asirianëve...) janë ngritur në Greqi dhe në Sisili vetëm duke filluar nga shekulli VII para Krishtit sipas shkrimeve, Polisi, Amfiktioni etj. Asgjë me të vërtetë e "lashtë" në këtë histori greke, të cilën në mënyrë të gabuar e kanë ngjitur deri edhe më tej se shekulli XXV para Krishtit! Për sa i takon linearit B, ky nuk ishte gjë tjetër veçse "pellazg", nga i cili rrjedh gjuha joniane dhe arkado-qipriote! Së fundmi duhet shënuar se "dialekti" dorian ka dalë nga popullsi ilire të nënshtruara (Periekët, Hilotët, Penestët...) nga pushtuesit e parë Dorianë (Helenët e vërtetë). Ja pra, me pak fjalë zanafilla semito-

egjiptiane e Grekëve, pohim (prova dhe referenca në mbështetje të saj) që ravijëzohet në dy librat që kam botuar.

Një tjetër mospërputhje (nëse guxoj ta quaj kështu), madje gabim fatal për sa i takon të kuptuarit të zanafillës së gjuhëve: krahasohet gjuha balto-sllave, serbo-kroatishtja dhe bullgarishtja (gjuhët e fundit të shfaqura në Europën lindore pas shekullit VII pas Krishtit!) me gjuhët e tjera ballkanike shumë më të lashta (shqipja është një gjuhë autoktone që ngjitet deri më lart se periudha Neolitike), greqishtja (gjuhë që ngjitet deri në shekullin VII para Krishtit dhe e shkruar vetëm nga fundi i shekullit VII dhe më e shumta në shekullin VI), latinishtja (gjuhë e shkruar vetëm duke filluar nga shekulli III para Krishtit) apo gjuha rumune (gjuhë me zanafillë thrako-ilire, mbi të cilën ka patur një ndikim të madh latin për arsye të pushtimit të gjatë romak). Në të gjitha këto studime nuk është patur aspak parasysh të qenët e kahershme dhe vërtetësia historike e secilës prej këtyre gjuhëve. A mund të thuhet sot se një fjalë e tillë e lashtë latine ka një zanafillë franceze (gjuha romane e mëvonshme)? Sigurisht që jo sepse është fjala vetëm për të kundërtën. Është e pamohueshme që në çdo gjuhë ekzistojnë fjalë të futura (continuum e për shkak të pushtimeve të përkohshme apo përfundimtare, nga kontaktet e përhershme, migracionet e ndryshme dhe shkëmbimet e ndryshme tregtare ose kulturore) por secila nga këto gjuhë sapo t'i qëmtojë apo t'i heqë fjalët e futura dhe neologjizmat e huaja që e prishin, ruan një fond të pastër gjuhësor që e dallon nga të tjerat dhe mbi të gjitha na bën të mundur të fiksojmë, të mbështesim apo të vendosim specifikën e saj apo origjinalitetin e saj.

Gjuha greke nuk është kaq e lashtë sa kanë dashur të na bëjnë të besojmë qysh prej 2500 vjetësh.— Në të vërtetë një tjetër gabim ka hedhur rrënjë në të trajtuarit në planin historik në lidhje me të qenët të kahershëm të Grekëve duke i përqasur ata me hipotetikët "Mikenë" (XVI/XII para Krishtit), të cilët nuk kanë ekzistuar kurrë me këtë

emër (të shpikur nga arkeologët modernë, ndër të cilët Shliman). Megjithatë historianët e parë grekë (Hekate i Miletit, Helanikos i Mitilenit, Herodoti dhe Tuqididi) i kanë cituar Pellazgët si një popull që i ka paraparirë Grekët (të quajtur ndryshe "Mikenë" të autorëve modernë!). Përkundrazi si dhe në mënyrë paradoksale, autorët modernë nuk kanë dashur të besojnë në të vërtetën historike apo unicitetin e popullit pellazg: "emër gjenerik që emërton popullsi të ndryshme dhe të zhdukura pa lënë gjurmën më të vogël historike dhe aq më pak gjuhësore! Megjithatë, midis autorëve të tjerë të lashtë, Herodoti pohon se ata u kanë lënë trashëgim grekëve një pjesë të madhe të gjuhës së tyre, të mitologjisë dhe të kulturës së tyre. Homeri tek Iliada a nuk i cilëson Pellazgët si "Hyjnorë" dhe gjuhën e tyre "gjuha e Perëndive"?

Atëherë përse kalohen në heshtje të gjithë këta tregues, prova apo argumente të prekshme? Vetë këta autorë modernë a nuk e kanë zbuluar gabimin monumental të Tuqididit, të krijuar nga një tregues të paktën interesant dhe ekuivok, i cili ka bërë të besohet se ky "pushtimi dorian" hipotetik (përveç kësaj asnjë gjurmë arkeologjike nuk është zbuluar në atë periudhë) kishte ndodhur 80 vjet pas luftës së Trojës (Troja VI/VII e arkeologëve) d.m.th. në shekullin XII! Pra, Tuqididi ka kapërcyer shend e verë "katër shekujt e errët" (1200-800 para Krishtit), ku historia dhe aq më pak shkrimi apo arkeologjia, e thënë më saktë nuk na sjellin as provën më të vogël të ekzistencës së një kulture greke të tillë siç ka ekzistuar në fillim të shekullit VIII para Krishtit: një shkëputje e qartë midis dy qytetërimeve të ndryshme! Përkundrazi "80 vitet" e Tuqididit duken të sakta nëse mendohet se e vetmja luftë e Trojës që mund të ketë egzistuar (arkeologjia ja ku është për ta pohuar) është ajo e pushtimit të Azisë së Vogël (Eolida) nga Grekët e parë rreth vitit 680 para Krishtit. Pra nuk është rreth 1100 (1183-80) kur Dorianët do të jenë shfaqur për herë të parë (në Greqi stricto sensu) por rreth viteve 600 para Krishtit (680 – 80 = 600). Në të vërtetë kjo përkon me citimet e para të emrit të "Dorianëve" (të cilin Homeri nuk e njeh) prej Pindarit

dhe Eskilit në shekullin VI! Lufta e famshme dhe hipotetike e Trojës (1193-1183), datë e nxjerrë nga Eratosteni, nuk ishte gjë tjetër veçse ajo e Illionit, të pushtimit grek të Eolidës në shekullin VII para Krishtit! Illion (Tyroja VIII e arkeologëve) është emri që Grekët i kanë dhënë qytetit të Trojës (fjalë që rrjedh nga fjala shqipe "troja" që do të thotë "troje të të parëve"...). Kësaj i shtojmë se prijësit dorianë rridhnin nga një etni semito-egjiptiane dhe jo nga një popull i ardhur nga veriu i Ballkanit. Ngatërresa vjen nga kjo thënie e nxjerrë nga Aristoteli. Si rrjedhojë është populli i nënshtruar, i cili ka qenë i trungut ilir, nënkuptohet i ardhur nga Veriu i Greqisë: Periekët, Hilotët, Penestët... Një tjetër ngatërresë: Grekët me të mbërritur në vendin që quhej "Pellazgji" kanë përshtatur dhe kanë përpunuar, pas pushtimit të tyre, një poemë të vjetër që trajtonte dasitë midis fiseve pellazge të rajonit të Trojës në Azinë e Vogël. Në të vërtetë në fillim të shekullit VII, përveç pushtimit të tyre të rajonit të Trojës (të kthyer në Eolidë më pas), Grekët kanë përvetësuar historinë e kësaj poeme epike (të kthyer në "Iliadë", titull i nxjerrë nga emri - "Illion" - të cilin ia kanë dhënë qytetit të "Trojës") Sa për Pellazgët, Jonianët dhe Dorianët, Herodoti kishte plotësisht të drejtë. Në të vërtetë sot apo nesër gjithçka përfundon gjithmonë duke dalë në shesh e vërteta!

Pra nuk ka asnjë lidhje, asnjë vijimësi midis këtyre "katër shekujve të errët" (1200-800) dhe qytetërimit të mëpastajmë grek stricto sensu (duke filluar nga vitet 800 para Krishtit). Atëherë, si mund të përligjen që "të mbërriturit më pas" do të thotë "të ekzistuarit më përpara"? Përveç kësaj në vitin 1952, Ventriks dhe Kadvik e kanë çuar edhe më tej duke pohuar që lineari B ishte greqishtja e lashtë: merret vesh që ata nuk e dinin se pellazgjishtja e lashtë ekzistonte shumë përpara shfaqjes së greqishtes dhe gjithashtu nuk e dinin trashëgiminë e tyre kulturore të përcjellë te Grekët. Kështu lineari B nuk ishte gjë tjetër veçse pellazgjishtja e lashtë, tek e cila gjuha greke ka bërë huazime shumë të

mëdha. Ja përse e gjithë bota është përfshirë në këtë gabim, i cili për një kohë të gjatë ka parapirë të gjitha hulumtimet për këtë çështje.

Kështu Grekët kanë mbërritur rreth shekullit VIII para Krishtit në një rajon (Greqia e ardhshme, Egje, Azi e Vogël), të cilin e nënshtruan: popullsitë barbare (ato që nuk flasin greqisht), të cilave ata u huazuan një pjesë të madhe të kulturës së tyre, gjuhës, miteve madje u uzurpuan të kaluarën e tyre të lavdishme.

Iliada dhe Odisea nuk kanë qenë gjë tjetër veçse dy poema epike pellazge, të shndërruara dhe të manipuluara për t'i shërbyer 'kauzës greke", d.m.th. në përfitim të pushtuesve të rinj helenë. Sllavët, një mijë vjet më pas kanë ndjekur të njëjtin proces: të mbërritur në shekullin VII pas Krishtit ata kanë huazuar nga popullsitë autoktone (Ilirë, Thrakë, Dardanë, Triballë, Dakë, Getë, Panonianë, Venetë, Dalmatë, Istyrianë, Pellagonë, etj.) një pjesë të madhe të kulturës së tyre (rapsodët, kostumet, zakonet etj.) dhe të gjuhës së tyre.

Kur mendoj se ende edhe sot shqipja klasifikohet në grupin "balto-sllav" më ngrihen qimet e kokës përpjetë! Është e qartë që gjuhëtarët jo gjithmonë e kanë kuptuar ose nuk janë gjithmonë të bindur se pellazgo-shqipja shtrihej në një pjesë të madhe të Europës: nga Atlantiku (Baskët) deri në Detin e Zi (Kaukazianët, Armenët) dhe nga dy brigjet e Danubit (madje edhe më në Veri meqenëse gjenden fjalë lituaneze dhe kuptime të shpjegueshme nëpërmjet shqipes) deri në detin Egje (Kreto-Mikenët). Përveç kësaj disa gjuhëtarë, ndër të cilët Hirt dhe Shrader midis autorëve të tjerë modernë kanë nxjerrë hipotezën e ekzistencës të një gjuhe të vetme "europiane" të folur nga Atlantiku deri në Kaukaz dhe në Azinë e Vogël. Por për të gjitha këto arësye askush nuk ka mundur ta identifikojë këtë idiomë zanafillore. Pra këtu ka një hiatus[2)] të madh, gabime të shfaqura si dhe keqkuptime të dukshme në lidhje me çështjen e ideologjisë indo-europianiste.

[2)] *Ndërprerje, shkëputje*

Në studimet gjuhësore, fonologjike, sintaksore ose etimologjike duhet të krahasohet ajo që është e krahasueshme. Kështu a posteriori madje a contrario pohohet p.sh. që një aksh fjalë është me zanafillë greke, latine apo sllave, ndërkohë që ajo ka një zanafillë aborigjene, e cila rrjedh nga një nënshtresë parahelene, pra thrako-ilire: kjo është ajo që unë quaj pellazgo-shqipja. Kush do të dyshonte që fjalë të shumta, toponime, oronime, teonime, antroponime ose eponime madje fjalë të vjetra greke apo latine janë me zanafillë pellazgo-shqiptare? Në të vërtetë ja një listë jo e plotë e këtyre fjalëve të panumërueshme, të cilat shpjegohen në mënyrë të veçantë nga gjuha e sotme shqipe. Për arsye të numrit të madh të tyre natyrisht që nuk është fare fjala për "përputhje të rastësishme": monument, speleolog, hipos, skeptër, toraks, barkë, Talasa, Odise, Atridi, gjigand, perandor....; Homeri, Athina, Mikenë, Korinti, Argos...; Olimpi, Pelion, Strimon, Emathi, Dardani, Karpate, Bukuresht, Bizant, Kretë, Qipro...; Zeus, Kuretë, Afërditë, Athina, Era, Rea, Korë, Tetis, Kronos, Promete, Apollon, Artemis, Hadi...; Homeri, Akili, Uliksi, Penelopi, Telemaku, Menelau, Agamemnon, Ajaksi, Romulus, Pirros...; Epiri, Maqedoni, Graikos (emri i një fisi epirot i dhënë gabimisht Helenëve nga Romakët!), Pellazgë, Kranaenë, Lelegë, Molosë, Masilia (Marsejë) dhe madje emri i Sllavëve etj! Kjo është bindëse!

Fatkeqësisht gjithçka që nuk mund të shpjegohet nëpërmjet greqishtes, nga pjesa më e madhe e shumicës së shpjeguesve të sotëm është trajtuar si "parahelene e zhdukur", "para-indo-europiane", "proto-indo-europiane" ose thjesht "jo-indo-europiane"! Gjuhëtarët nganjëherë kanë ndjekur pohime të gabuara, tendencioze, shoviniste, pak të ndërgjegjshme ose të rreme të disa teoricienëve, historianëve dhe arkeologëve modernë, d.m.th. që Pellazgët (populli "i zhdukur"!) janë 'zhdukur pa lënë pasardhës të drejtpërdrejtë ose trashëgimtar etno-gjuhësor". Kjo ndodh jo sepse nuk janë gjetur gjurmë të shkruara të deshifrueshme në lidhje me pellazgjishten e lashtë dhe aq më pak

shkrime të lashta shqip (gjuhë që ka nisur të ketë një letërsi të shkruar vetëm duke filluar nga shekulli XIII) por hidhet poshtë, në grup, fakti që ky popull parahelen ka lënë gjurmë gjuhësore (gojore: pellazgo-shqipja), një trashëgimi kulturore (futja e hekurit në Europë, mitologjitë, pjesë të gjetura megalitike, tolos, fshatrat buzë liqenit, zakone, kostume, etj.) dhe etnike (shqiptarët e sotëm, etnia më brakicefale e Europës). Ja përse nuk kanë shkuar më tej hulumtimet duke ndalur prerazi çdo hulumtim në lidhje me këtë çështje. Unë mendoj se është koha për të hapur debatin, me qëllim që të vëmë gjërat në vend dhe për t'i vijuar më tej hulumtimet si dhe studimet serioze dhe objektive. Për të përfunduar mund të thuhet se Grekët ishin tinëzarë me damkë dhe manipulues të shkathët të historisë ballkano-egjease, të historisë dhe të zanafillave të tyre.

Ja përse ka ardhur koha që t'i rishikojmë njohuritë tona mbi gjuhësinë moderne. Tashmë le të shohim se cilat janë mangësitë kryesore?

* Studimet gjuhësore, janë kufizuar në thelb nga ana e specialistëve në shqyrtimin "teknik" të secilës prej gjuhëve të përafërta;

■ Këto studime janë mjaftuar në shënimin e një tërësi faktesh, ndër të cilat shënohen përputhjet pa shpjeguar shkakun.

■ Ato i kushtohen epifenomeneve pa i prekur kurrë në thellësi realitetet e gjuhës.
■ Ato bien në një masë të formës për të hulumtuar dallime të vogla të hollësisë pa dhënë një kuptim të vërtetë gjuhësor.
■ Ato përpiqen që të ngrenë një unitet abstrakt duke vendosur një teori të tillë vijimësie, të tillë si e hamendëson "komparatizmi", etj.

E gjitha kjo ndodh në një mjedis të mbyllur pa komunikuar me jashtë si dhe "jashtë kontekstit historik apo zanafillor dhe mbi të gjitha kronologjik, thelbësor për çdo gjuhë të studiuar. Pra duhet saktësuar shkalla e huazimit të një gjuhë në raport me një tjetër, të identifikohet vërtetësia historike dhe kronologjia e elementëve gjuhësorë që kanë luzmuar në këtë apo atë rajon dhe sesi një gjuhë e ardhur që ka asimiluar një nënshtresë më të lashtë është zëvendësuar apo mbivendosur ndaj gjuhës autoktone, etj. Në të vërtetë studiohet zanafilla e një fjale të një gjuhe të përcaktuar ose veprohet duke bërë një krahasim me një apo shumë gjuhë të tjera, pa bërë kujdes për kontekstin e tyre mjedisor dhe renditjen kronologjike të shfaqjes të këtyre gjuhëve në një hapësirë të dhënë. P.sh. le të marrim sllavishten e jugut të shfaqur në Ballkan rreth shekullit VII pas Krishtit. Kjo gjuhë vihet me të njëjtën shkallë barazie me gjuhët e tjera më të lashta, të tilla si gjuha shqipe ose rumanishtja! Pohohet që një aksh fjalë është me zanafillë sllave ndërkohë që ajo rrjedh nga një gjuhë autoktone më e lashtë. Në të vërtetë Sllavët e jugut (Serbët, Kroatët, Sllovenët) dhe Bullgarët kanë mbërritur më vonë në Ballkan (> shekulli VII pas Krishtit) dhe gjuha e tyre (Slavon) ka qenë shkruar (alfabeti cirilik) vetëm rreth shekullit XI, falë dy priftërinjve me zanafillë greke Cirili dhe Metodi. Po kështu edhe me hungarishten (gjuhë fino-ugrore ashtu si estonishtja, finlandishtja, madje edhe turqishtja) e cila është shfaqur në Ballkan vetëm rreth shekullit XI. Duhet shënuar që Bullgarët (etni uralo-turaniane dhe më në mënyrë të veçantë ugrore) kanë përfunduar duke marrë gjuhën e Sllavëve ndërkohë që janë të ndryshëm nga ana etnike por gjithsesi të ardhur ashtu si edhe ata nga rajonet aziatike. Si rrjedhojë, të gjithë këta popuj nuk janë me zanafillë indo-europiane por aziatike. Në këto kushte gjëja më e vogël që duhet respektuar është shkalla kronologjike si dhe zanafilla e çdo gjuhe. Sllavët, Bullgarët dhe Hungarezët megjithëse nga ana statistikore tejet më të shumtë në Ballkan sesa Shqiptarët dhe Rumunët dhe megjithëse zënë hapësirën më të madhe (në kurriz të

popullsive të lashta thrako-ilire) kanë trashëguar fjalë apo shprehje të popujve që ata kanë nënshtruar si dhe kanë asimiluar një pjesë të madhe të kulturës së tyre (ndër të cilat kultura e Rapsodëve, disa doke dhe zakone dhe mbi të gjitha kostumet). Në të vërtetë i gjithë rajoni ballkano-danubian, përpara mbërritjes së popujve të rinj (duke filluar nga shekulli VII) ishte pushtuar nga popujt thrako-ilirë, ndër të cilët Panonianët, Venetët, Liburnët, Istrianët, Dalmatët, Dardanët, Getët, Dakët, Triballët, Thrakët, Ilirët, etj. Kjo e ka çuar edhe më tej absurditetin duke krijuar një "kompleks ballkanik" ku rigjenden gjuhët autoktone dhe shumë të lashta përbri gjuhëve të mëvonshme dhe pak a shumë të përziera! Ajo që quhet përzierje e gjuhëve ballkanike nuk është gjë tjetër veçse një mbivendosje apo ndërvendosje gjuhësh të mëvonshme (të mbërritura më vonë në Ballkan dhe Europën Lindore), të cilat kanë përthithur apo asimiluar dialektet lokale autoktone. Ja përse gjuhëtarët kanë krijuar një mishmash të pashoq, ku ata përziejnë gjithçka: të lashtën dhe të mëvonshmen, autoktonin dhe të imigruarin apo pushtuesin. Kjo madje ka krijuar një grup të ri gjuhësh 'balto-sllave"! Ndërkohë që ekziston një nënshtresë shumë e lashtë, e cila është me zanafillë pellazge dhe në veçanti thrako-ilire që ka depërtuar në të gjitha këto gjuhë. Pellazgjishtja ka luzmuar deri në Veri të Europës. Në të vërtetë lituanishtja dhe letonishtja kanë ruajtur disa fjalë të vjetra pellazge. Gjithsesi le të shtojmë se "fonetika" ruse është jashtëzakonisht pranë fonetikës së Shqiptarëve!

* Për pjesën më të madhe gjuhëtarëve, gjuha greke dhe latine janë bërë guri themeltar, të cilat maten madje edhe me sanskritishten, avestiken ose tokarianen. Janë krahasuar fjalë greke dhe latine me ato të gjuhëve të tjera europiane, bazat e të cilave në të vërtetë rrjedhin nga greqishtja dhe latinishtja, pa dyshuar se vetë këto dy gjuhë kanë dalë nga pellazgjishtja (greqishtja) dhe etruskishtja (latinishtja). Për ta kryer këtë kanë ndërtuar pjesë-pjesë një pseudo-proto-gjuhë! Është zbuluar

që disa fjalë të hapësirës "europiane" ngjajnë aq sa mund t'i ngatërrosh me fjalë sanskrite, pra "indiane". Kësisoj, në mënyrë arbitrare kanë shpallur që bëhej fjalë për një fond të përbashkët, i cili shumë shpejt u emërtua me emrin "índo-europian". Gabimi themelor gjendet me të vërtetë aty, sepse ky fond i përbashkët nuk është ai që mendohet, por ai i një proto-gjuhe të vërtetë, d.m.th. të një gjuhe-mëmë. Le të rinisim rrjedhën e historisë. Përveç faktit që greqishtja në pjesën më të madhe rrjedh nga pellazgjishtja e lashtë, gjuha greke stricto sensu ka qenë shkruar vetëm rreth shekullit VI para Krishtit. Latinishtja (që rrjedh nga etruskishtja dhe greqishtja) ka qenë shkruar vetëm rreth shekullit III para Krishtit! Së fundmi, sanskritishtja ka qenë shkruar vetëm në shekullin VI para Krishtit, pra një gjuhë "bashkëkohore" me greqishten. Gjithashtu është harruar se në fillim (15 000 deri 10 000 para Krishtit?) do të ketë ekzistuar një gjuhë e vetme në sferën europiane dhe ka të ngjarë euro-lindjen – e afërme. Disa pohojnë që Sumerianët ishin një popull jo-semit me zanafillë nga Ballkani. Prijësit Hititë (dhe jo populli "hati") nga ana etnike ishin të përafërt me Trojanët, Thrakasit ose Frigjianët, d.m.th. një popull pellazg. Populli i famshëm i "malësorëve me kokë të rrumbullakët" (d.m.th. brakicefalë) të cilët kanë shkelur tokën e Lindjes së Mesme rreth viteve 4000, a nuk kishte dalë nga i njëjti rajon ballkano-danubian?

* Gjithsesi nëse në mënyrë paralele me studimin gjuhësor, studiohet dhe kryhen hulumtime të ndryshme në fusha të tjera të përafërta (histori e lashtë dhe arkeologji, antropologji, paleontologji, etnologji, mitologji, etj.) bëhet e dukshme që një gjuhë kryesore apo zanafillore flitej në Europë nga një popullsi parahistorike autoktone (homo pelasgus?) siç e kam shpjeguar më lart. Fatkeqësisht gjuhësia ka mbuluar kritere të shumta thelbësore dhe mbi të gjitha historike, arkeologjike dhe kronologjike. Në të vërtetë është bërë shumë pak kujdes për ngjarjet historike të epokave që kanë të bëjnë me përdorimin e sanskritishtes

dhe të greqishtes, dy "gjuhë të shkruara" pothuajse bashkëkohore.

Për mua dhe për arsye të studimeve dhe hulumtimeve të ndryshme që kam realizuar si dhe provave të prekshme që kam sjellë për këtë çështje, kjo proto-gjuhë nuk mund të jetë gjë tjetër veçse ajo e Pellazgëve, popull parahistorik (ngrënës të lendeve të lisit, pemës të cilën si rrjedhojë ata e kanë nderuar dhe të cilën shumë më vonë Druidët - keltë të mirëfilltë - e kanë nderuar gjithashtu) i vërtetuar njëzëri nga autorët antikë. Homeri në Iliadë, a nuk i cilëson pellazgët "hyjnorë" dhe gjuhën e tyre "gjuha e Perëndive"? Ky popull, vatra e të cilit ka mbetur gjithmonë në rajonin (Ballkan), sot hapësira e kufizuar në Shqipëri, Kosovë, pjesa më e madhe e Malit të Zi, e Maqedonisë dhe e Epirit, ku gjendet kryeqyteti i lashtë i kultit të Pellazgëve (Dodona), është shpërhapur shkallë-shkallë nëpër Europë, Azi e Vogël madje edhe më tej. Kësisoj kjo gjuhë është copëzuar në dialekte të shumtë, të cilët kanë evoluar me kalimin e kohës në gjuhë të dallueshme, të veçuara nga njëra-tjetra, si në një lloj mikrokozmosi. Kjo nuk ka penguar që fjalë të shumta të lashta të përvijojnë deri më sot. Në të vërtetë disa fise (Baske, Kaukaziane, Armene...) e kanë lënë shumë shpejt vatrën e tyre zanafillore për tu izoluar në vende malore me reliev të thyer apo të paarritshëm. Vetëm popullsitë shqiptarofolëse, gjuha zanafillore e të cilëve nuk është bjerrë, kanë mbetur në mjedisin natyror (toka e të parëve të tyre) dhe kanë patur vetëm disa ndikime të lehta të huaja. Përveç kësaj, a e kanë patur parasysh gjuhëtarët se kanë ndodhur migrime të ndryshme, fillimisht duke u nisur nga Europa drejt Azisë nëpërmjet Azisë së Vogël (në këtë epokë nuk ka patur ngushtica - Bosfor dhe Dardanele - sepse kalohej më këmbë nga Europa në Azi, pra të dy kontinentet kanë qenë të bashkuar)? Më vonë rreth viteve 4000 para Krishtit një tjetër dyndje u drejtua për nga Azia (disa toponime dhe oronime aziatike shpjegohen me anë të shqipes, ndër të cilat "Himalaja", "Malazia"...) Së fundmi, vala e fundit e migracionit me një shtrirje të madhe, u krijua me pushtimet e Aleksandrit të Madh

(Aleksandri III i Maqedonisë) që shkon nga Mesdheu deri në luginën e Indusit. Pra, nuk është për tu habitur që fjalë ilire të kenë udhëtuar duke depërtuar në gjuhët sanskrite, avestike, tokariane apo perse, madje edhe gjuhë të tjera që ende mbeten për tu zbuluar. Midis të tjerash nuk është marrë në konsideratë edhe lloji i kriterit.

* Në të vërtetë, gjuhëtarët duke krijuar dogmën e "indo-europiuanizmit", pa dyshim që nuk kanë patur parasysh lëvizjet e ndryshme të popullsisë (flukset migratore), të cilat kanë ndodhur prej Perëndimit (zona ballkano-egjeo-danubiane) për në Lindje (Malazi, Himalaja: toponime dhe oronime të shpjeguara nëpërmjet gjuhës shqipe!) Këto lëvizje të njëpasnjëshme do të kenë ndodhur duke filluar nga mijëvjeçari i katërt, madje më herët, dyndja e fundit e të cilëve ka ndodhur në shekullin IV para Krishtit gjatë një ekspeditë ushtarake të Aleksandrit të Madh, ushtria e madhe e të cilit (37 200 njerëz) përbëhej 2/3 nga Maqedonë, Epirotë, Thrakë, Agrianë, Peonianë dhe Ilirë (pra 24 600 ushtarë, të gjithë të dalë nga i njëjti trung pellazg) dhe vetëm më pak se 1/3 (pra 12 600) ishin Grekë (sipas Arrianit, biografi i Aleksandrit të Madh). Pas vdekjes së Aleksandrit (emër që shpjegohet nëpërmjet shqipes "ka le si andërr" ose "Ai leu si në andërr", - ëndrra që pa nëna e tij kur ishte shtatzanë) të gjitha trupat e tij u shpërhapën në të gjithë rajonin, deri në kufijtë ekstremë të Azisë. Të gjithë ushtarakët e kësaj ekspedite nuk u kthyen në vendlindjet e tyre: ata krijuan trungun e tyre dhe përhapën kulturën dhe gjuhën e tyre nëpër të gjithë Orientin, prej Azisë së Vogël deri në Himalaja (mal maja) duke kaluar nëpër Persi, Baktrianë, Afganistan dhe luginën e Indusit. Shumë vonë është zbuluar një etni në një zonë malore, e cila gjendet midis Afganistanit dhe veriut të Pakistanit: etnia "Burrush", gjuha e të cilëve "burushaski" është e përafërt me gjuhën e sotme shqipe! Gjithashtu disa fjalë të dala nga "pellazgjishtja e lashtë" gjenden jo vetëm në greqishten e lashtë por edhe në sanskritishten madje edhe në tokarianen dhe ka të ngjarë

në idioma apo gjuhë të folura në këto zona aziatike, të cilat unë nuk i njoh pasi nuk kam mundur t'i studioj. Pra nuk ka dyshim për ndikimin egjeo-ballkano-danubian në këto hapësira të stërmëdha, sa në planin kulturor aq edhe në atë etno-gjuhësor. Gjuhëtarët duhen të ndalen gjatë këtu dhe të mendojnë mbi besueshmërinë e vendosjes në baza të shëndosha të disa teorive, të kthyera në teori të pandryshueshme (pa kundërshtuar asnjë, pa i rivënë në debat, pa i rishikuar) qysh nga fundi i shekullit XIX.

* Kështu gjuhëtarët nuk e kanë marrë parasysh ekzistencën e "pellazgjishtes së lashtë" dhe as faktin se ajo është paraardhësja e gjuhës së sotme shqipe. Ata e kanë trajtuar se kjo pellazgjishte ka qenë një gjuhë parahelene "e zhdukur" dhe se patjetër ky emër ka qenë një emër "gjenerik" dhe se Pellazgët nuk ishin gjë tjetër veçse një konglomerat popujsh të të ndryshëm. Ndërkohë që në të vërtetë bëhej fjalë për një popull të vetëm me fise të ndryshme, të cilët mbanin emra të ndryshëm! Siç do ta vërejmë, kombi pellazg përpara mbërritjes së Grekëve përbënte një tërësi etnike dhe gjeografike të madhe që shkonte nga Atlantiku (Baskët) deri në Kaukaz (Shqiptarët dhe Iberët e Kaukazit) si dhe në Azinë e Vogël (Hititë, Frigjianë, Trojanë, Moskë, Lidianë, etj.) Nëse nuk mbahen parasysh këto të dhëna të reja, gjuhësia moderne do të mbetet gjithmonë në qorrsokak

* Një tjetër mospërputhje (nëse guxoj të shprehem kështu), madje gabim fatal përsa i takon të kuptuarit të zanafillës së gjuhëve: krahasohet gjuha balto-sllave, serbo-kroatishtja dhe bullgarishtja (gjuhët e fundit të shfaqura në Europën lindore pas shekullit VII pas Krishtit!) me gjuhët e tjera ballkanike shumë më të lashta (gjuha shqipe është një gjuhë autoktone që ngjitet edhe më tej se Neolitiku), greqishten (gjuhë që shkon deri në shekullin VIII para Krishtit dhe më herët), latinishten (gjuhë e shkruar duke filluar nga shekulli III para Krishtit) ose

rumanishten (gjuhë me zanafillë thrako-ilire, tek e cila ka ndikuar së tepërmi ndikimi latin për shkak të pushtimit romak për një kohë të gjatë). Në të gjitha këto studime nuk është patur fare parasysh të qenët e kahershme si dhe vërtetësia historike e secilës prej këtyre gjuhë të studiuara. A mund të thuhet sot se një aksh fjalë latine ka një zanafillë franceze (gjuhë romane e mëvonshme? Sigurisht që jo, pasi bëhet fjalë vetëm për të kundërtën. Megjithatë kështu ka ndodhur (dhe kjo vazhdon) midis gjuhës shqipe nga njëra anë dhe greqishtes, latinishtes, baltikes, sllaves, serbo-kroatishtes, bullgarishtes ose rumanishtes nga ana tjetër. Është e pamohueshme që në secilën nga këto gjuhë ekzistojnë fjalë të futura (continuum për shkak të kontakteve të përhershme, migracioneve të ndryshme dhe shkëmbimeve të ndryshme tregtare dhe kulturore), por secila nga këto gjuhë sapo t'i spastrojë apo t'i heqë fjalët e futura dhe neologjizmat e huaja që e mbytin, atëherë ruan një fond të vetin gjuhësor, i cili ndryshon nga të tjerët dhe mbi të gjitha na lejon të fiksojmë, të mbështesim apo të vendosim specifikën apo origjinalitetin e saj.

* Është krijuar jo vetëm fjala "indo-europiane" por i shtohet edhe fjala "jo-indo-europiane". Në të vërtetë disa shkojnë deri aty sa të pohojnë se pellazgjishtja (madje etruskishtja) ishte një gjuhë jo-indo-eureopiane. Ndërkohë që nuk dinë asgjë për këtë gjuhë! Në të kundërt, të gjithë janë gati të shpallin njëzëri se gjuha shqipe është një gjuhë "indo-europiane" megjithëse e klasifikojnë si një gjuhë krejt "më vete". Ja përse e kanë lënë mënjanë. Çfarë dykuptimësie dhe çfarë paradoksi! Një tjetër veçori: i kanë ndarë gjuhët e mbiquajtura indo-europiane në dy kategori "centum" (kur fjala "cent" fillon nga tingulli K = kmtôm) dhe "satem" (kur fjala "cent" fillon me një tingull fishkëllor S = satam, satem), metodë që ka si pikësynim dallimin centum/satem me qëllim që të dallojë gjuhët. Por kjo metodë e bazuar në evolucionin e tingullit K është edhe më e kundërshtuar. Në të vërtetë ky lloj gabim metode

është një shkak i mishmashit të sotëm gjuhësor. Për të përfunduar vërej se duke filluar nga të gjithë këta elementë heteroklitë dhe pak bindës, është fantazuese madje utopike të duash të rikthesh një gjuhë indo-europiane të përbashkët. Atë e bazojnë mbi gjuhët e lashta të vdekura (sanskrite, avestike, tokariane, greqishte e lashtë, latine etj.) dhe nuk bënë kujdes as edhe për një moment të vetëm që një gjuhë shumë më e lashtë mund të flitej edhe në ditët tona: pellazgjishtja, bazat strukturore të së cilës i ka ruajtur vetëm shqipja dhe mbi të gjitha një mori fjalësh të vjetra.

Siç e kemi vërejtur ka qenë gjithmonë e padrejtë dhe arbitrare të shpallurit nga dijetarë të shumtë (ku përzihen të gjitha disiplinat) se gjuha e Pellazgëve (disa e quajnë "gjuhë parahelene") ishte zhdukur pa lënë as edhe gjurmën më të vogël. Gjithsesi kjo "pellazgjishtje e lashtë" na ka lënë trashëgim jo vetëm gjuhën shqipe por edhe fjalë të ndryshme (gjuhët greke dhe latine), antroponime (mitologji) dhe mbi të gjitha toponime dhe oronime (në të gjithë Europën qendrore dhe jugore) të ngulitura në shkëmbinjtë e tyre, trojet, malet apo lumenjtë që mbetën ashtu siç kanë qenë qysh prej periudhave të mugëtirës. Është ky element pellazg, të cilin gjuhëtarët dhe specialistët e tjerë e kanë fshehur: ata kurrë nuk e kanë futur atë në propozimet e tyre për rindërtimin e të kaluarës historike dhe etno-gjuhësore të Europës. Fatkeqësisht duke u nisur nga kjo futje në rrugë të gabuar e gjithë bota është përfshirë nga kjo ideologji indo-europianiste. Kjo vazhdon pa ndonjë linjë tjetër procesi.

Përputhjet gjuhësore pellazgo-shqiptare

Këto përputhje rigjenden në emrat e perëndive, perëndeshave ose të heronjve legjendarë (antroponime), heronjve themelues të qyteteve (eponime) ose emra vendesh gjeografike (toponime), emra të etnive të ndryshme (etnonimi) ose emra të përbashkët, të cilët na i zbulojnë tekstet antike dhe më në veçanti Iliada dhe Odiseja. Pjesa më e madhe e këtyre emrave kanë qenë marrë njësoj gjatë transkriptimit të tyre në gjuhën helene, të rrëfenjave të para parahelene të traditës gojore. Por Grekët duke mos njohur zanafillën e pjesës më të madhe të këtyre emrave, nuk janë bërë merak për kuptimin e saktë të secilit prej tyre dhe nganjëherë atyre u kanë vënë përbri një tjetër emër të shkruar ndryshe dhe duke patur në gjuhën e tyre të njëjtin kuptim (tautologji) ose më saktë ata shpesh kanë shpikur tërësisht një tjetër emër, duke iu larguar kështu kuptimit zanafillor (i interpretuar dhe i transkriptuar nga ana fonetike në gjuhën greke). Një rast i tillë është ai i emrit të "Akilit", të cilin Grekët e kanë shpjeguar me "shumë i madh" (Aspeitos) por që në shqip do të thotë "i shpejti" (Asht `shpeit ose I shpeiti, fjalë që del nga rrënja "Shpejt"). Mund të vërehet me lehtësi se gjuha greke është larg kuptimit të saktë të emrit të Akilit, kuptim që na është dhënë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë nga Homeri. Në të vërtetë Homeri e cilëson pothuajse kudo dhe gjithmonë në poemat e tij të famshme si "hyjni" dhe gjithashtu "të shpejtë" ose "Akil këmbëlehti"! Duhet shënuar që në pesëdhjetetetë citimet në lidhje me identifikimin e Akilit, tetëmbëdhjetë midis tyre kanë pasur nocionin e "shpejtësisë"!

Pra, gjuha shqipe arrin të dekriptojë gjithçka që duket e paqartë dhe jo e saktë në greqisht ose gjithçka që disa autorë e trajtojnë se ka dalë nga një gjuhë "parahelene e zhdukur" (nënkuptohet që kjo do të rregullonte shumë gjëra). E njëjta mund të thuhet për Uliksin (Odisean), emri i të cilit në gjuhën pellazgo-shqipe do të thotë "udhëtar". Ky emërtimi i fundit përkon krejtësisht jo vetëm me atë që bëri Uliksi

gjatë dhjetë viteve, "udhëtar" ose aventurier pas luftës së Trojës, por në thelb të vetë kësaj epopeje që lidh një histori "udhëtimesh" dhe aventurash. Shumë të tjera përputhje të të njëjtit lloj mbështesin këto përputhje gjuhësore dhe duke u shtuar pohime të tjera të mbështetura nga disiplina të ndryshme, provojnë vërtetësinë historike të Pellazgëve dhe mbi të gjitha përkatësinë e gjuhës së sotme shqipe ndaj pellazgjishten e lashtë. Të dy heronjtë kryesorë të Iliadës dhe të Odisesë, falë emrit të tyre respektiv, ka shumë të ngjarë që të kenë një zanafillë pellazge. Ja pra shembujt e shumtë të ngjashëm lista e të cilëve nuk është e plotë.

Shënim : Me qëllim që të lehtësojmë shqiptimin e emrave apo fjalëve shqip dhe për të ruajtur fonetikën e tyre zanafillore nganjëherë unë e kam "frëngjisuar" transkriptimin e tyre dhe ndër modifikimet e tjera "j" shqipe do të bëhet "i". Pastaj me qëllim që të shmang përsëritjet e fjalës (gegë) dhe (toskë) të treguara midis thonjëzave do të thotë që respektivisht bëhet fjalë për "dialektin" gegë të Shqipërisë së Veriut dhe "dialektin" toskë të Shqipërisë së Jugut. Nga ana tjetër "gj" (germë e alfabetit shqiptar) duke u gjendur në disa fjalë shqipe shqiptohet "j" (flitet për "j" frëngjisht), si p.sh. emri Shpellagji = "Shpellaji". Përveç kësaj në pjesën më të madhe të rasteve nëse u shtojmë fjalëve pellazgo-shqiptare prapashtesat tipike greke US, EUS, OS, EOS, AS, EAS, IS ose ES", marrim emërtimet pellazge të transkriptuara me saktësi në gjuhën greke qysh nga antikiteti.

I - Studime krahasuese dhe përputhje gjuhësore të përgjithshme

BARKA = bark

Latinët e kanë huazuar këtë fjalë qoftë nga Pellazgët e Italisë (Japigët, Mesapianët, Pisetianët, etj.) qoftë nga Etruskët. Në të vërtetë kjo fjalë rrjedh nga pellazgo-shqipja "bark". Prej nga vjen zanafilla e fjalës barka (barque në frëngjisht) forma e së cilës ngjan më së miri me barkun.

BRINDIA = Bri ose brini, qytet i Ilirisë antike, gjendet në rajonin e sotëm të Bosnjës. Ky emër rrjedh nga gjuha shqipe "bri, brini", gjithashtu "brinja".

BRINDISI = Brin'dashi

Port i Italisë në bregdetin perëndimor të Adriatikut dhe që gjendet përballë brigjeve shqiptare. Qysh nga antikiteti i hershëm jug-lindja e Italisë ka qenë e populluar nga "Mesapët dhe Japigët", dy etni thrako-ilire të trungut pellazg. Pra nuk është për tu çuditur që ky emër mund të shpjegohet me anën e gjuhës shqipe se sotme: "Brin dashi ose Bri dashi" që në kuptimin e gjerë të fjalës mund të nënkuptojë "qyteti në formën e brirëve të dashit" ose "bregu në formën e brirëve të dashit" ose sipas një tjetër legjende të lidhur me dashin ose me brirët e tij.

BUÇEFALË = Buç e falë

Ky është emri i kalit ose më mirë i pelës së Aleksandrit të Madh. Ky emër shpjegohet plotësisht nga gjuha shqipe: Buçë e falë, në dialektin gegë ose "Bushtër e falë" në dialektin toskë. Kjo do të thotë edhe "Pelë e ofruar" edhe "femër e sertë e dhënë dhuratë". Ndërkohë që në gjuhën greke përkthehet "koka e kaut"! Sot këto dy fjalë "Buçë ose Bushtër", në të dy dialektet e gjuhës shqipe do të thonë "femër e përdalë", "grindavece" ose "grua e sertë". Në të vërtetë askush përveç Aleksandrit të Madh nuk mund ta zbuste këtë kafshë të famshme, kafshë e cila ishte e sertë kundrejt çdo personi tjetër. Gjithçka të bën të mendosh se ajo duhet të jetë një pelë, ashtu siç na e jep gjuha shqipe.

BERRE = Berr

Rajon i pellgut të Berrës në grykën e Ronit, qysh në antikitet njihej për mbarështimin e "deshve". "Berr" në gjuhën shqipe do të thotë "dash"! Pra ka qenë "pellgu i deshve", d.m.th. "pellgu ku pinin ujë deshët si dhe viset ku kullotnin". Kjo fjalë pellazge ka qenë e përhapur

në të gjithë zonën nën ndikimin e "Ligurve" dhe "Ilirëve", popuj të trungut pellazg. Në të vërtetë e rigjejmë te baskët ("barro" = lloj dashi"), në Zvicër në Kantonin e Friburgut, jo larg Bullit ku gjenden "kullotat e Berras", dikur shumë të pasura me kope deshësh. Kjo fjalë ka të njëjtin kuptim edhe në dialektin provensal, gaskon, lombard, piemontez. Megjithatë në Zvicër, Shqipëri dhe Rumani, një lloj djathi deleje rrjedh nga kjo fjalë. Pra, është fjala për një rrënjë arkaike para indo-europiane që ka dhënë derivate të shumta të pahapura në një pjesë të madhe të Europës.

BORA = Bora, borë

Në mitologjinë, të mbiquajtur greke, Bora do të thotë "era e veriut". Pambarimisht është gjithmonë ky veriu i famshëm (jo vetëm "veriu" i Greqisë por mbi të gjitha "veriu i Epirit" d.m.th. Iliria, vend "i të ftohtit, i dëborës dhe i Gjigandëve)", që rivjen si një lajtmotiv. Kjo fjalë përkon me fjalën shqipe "borë". Sipas Tit Livit një mal i Maqedonisë quhej "Bora". Ka të ngjarë se bëhej fjalë për për një reminishencë të lashtë të një mali "të mbuluar me dëborë". Është e vështirë që të pranosh se ky toponimi i fundit "Bora" të jetë huazuar nga fjala "Boreas" ("erë e veriut", në greqisht).

BUKAREST = Bukur esht

Ky emër rrjedh nga shqipja "Bukur esht (toskë) ose Bukur asht (gegë) apo më gjerë "qyteti më i bukur". Është për tu shënuar se "Dakia" (emri i lashtë i Rumanisë) ishte pushtuar nga Romakët, ku edhe përhapën kulturën latine. Kjo është arsyeja përse Rumania bënte pjesë në hapësirën e gjuhëve të quajtura romane. Por për sa i takon zanafillës së saj, mund të themi se ajo ruan ende fjalë të shumta që rrjedhin nga zanafillat e saj të lashta "thrako-ilire", pra pellazge. Në të vërtetë ky rajon, ashtu si pjesa më e madhe e jugut të Europës ishte e zënë nga

Pellazgët dhe më në veçanti nga dy popuj të një trungu: Getët dhe Dakët.

BYZANCE = Buzë asht

Ky qytet vjen nga emri i pellazgo-shqiptar "Buzë asht" (gegë) ose Buzë ësht (toskë). Kjo e shpreh mjaft mirë sepse Bizanti (Stambolli i sotëm) gjendet buzë një kepi të dalë (i dalë mbi det) dhe ngjan me një gojë ("dy buzë").

DELOS= Diell = DIEL ..OS

Ishulli i Sikladave (në kohë të lashta quhej Ortigia) ku lindi Apoloni. Aty gjendet gjithashtu vendi i shenjtë më i lashtë i Apolonit ku edhe zuri fill orakulli i parë kushtuar diellit. Mirëpo Diell, Dielli është fjalë shqipe. Diel, gjithashtu në shqip, është dita e diel "dita e perëndisë Diell". Në të vërtetë dielli ishte një nga atributet kryesore të Apolonit. Disa autorë nuk lenë pa e përqasur Apolonin, perëndinë diellore siro-babilonase, Shamash, e cila në gjuhën semitike do të thotë "diell"! Përkundrazi Grekët Delos quajnë "rrëzëlluesi".

DIMALUM = Dy male

Qytet i Ilirisë antike. Kjo fjalë do të thotë "dy male ose dy malësi". Ky qytet ka të ngjarë të ketë qenë i vendosur midis dy maleve".

DIPHTERE = Dy ftyra

Librat e parë jonianë përmbanin "dy sense, kuptime apo figura", d.m.th. gjuha dhe fjala (ajo që është e qartë) nga njëra anë dhe ajo që është e shkruar (sekrete, sepse nuk kuptohej nga e gjithë bota në atë kohë dhe lexohej vetëm nga të diturit). Mirëpo në shqip Dy ftera (gegë) ose Dy ftyra (toskë) do të thotë "dy figura, dy fytyra": d.m.th fjala (e qartë) dhe e shkruara (sekret). Përkundrazi Grekët e shpjegojnë emrin "me membranë, lëkurë" ose është "shkruar mbi lëkurë". Nga gjuha

shqipe ka kaluar në turqisht dhe në arabisht "defter" = fletore" !

EPIMANES = I pa men, I pa menës

Për shkak të sjelljes së habitshme apo të çuditshme, Polibi (XXVI, I) e emërtoi Antiokosin IV (mbreti i Sirisë 175–164) "Epimanes", që në greqisht do të thotë "i pamend apo i dalldisur". Mirëpo në shqip I pa menës, I pa men (gegë), I pa mend (toskë) do të thotë "pa mend, pa zgjuarsi ose jo i ekuilibruar" apo "ai që ka humbur arsyen"!

Getët = Shi ... gjetë

Populli thrak pranë Dakëve (stërgjyshërit e Rumunëve), arma e preferuar e të cilëve ishte shigjeta. Herodoti në lidhje me këtë na thotë (IV, 94): "I njëjti popull i kthen përgjigje bubullimave dhe vetëtimave duke lëshuar shigjeta drejt qiellit për të kërcënuar perëndinë e tyre – sepse besonin se nuk kishte perëndi tjetër përveç perëndisë së tyre". Mirëpo emri i Getëve shpjegohet falë gjuhës shqipe: "Shigjetë".

GRAICOI, GRAECI, GRAIA = Gruja, Grua, Gruë, Gra

Ky emër i dalë nga "kulti i Greseve" ose "plakave" emërtonte "adhuruesit" e këtij kulti, që i përmbaheshin sistemit "matriarkal", pra pellazg. "Graikoi" ishin fqinjët e Helenëve të parë, të cilët përfunduan duke u asimiluar dhe duke u detyruar të marrin kultin "patriarkal" të Helenëve. Janë Romakët ata, të cilët gabimisht i quajtën Helenët "Graeci", gjë që krijoi emrin "Grekë"!

KARPATE = krep, Karp, Karpët, Krepët

Vargmalet e Europës qendrore të formuara nga formacione rrudhosjeje prej shkëmbi ranor ose rreshpor. Kjo fjalë, pa asnjë dyshim, rrjedh nga rrënja pellazgo-shqiptare "Krep, Karp" që do të thotë "shkëmb", shumësi i të cilave janë "Krepët dhe Karpët". Nga kjo fjalë pellazge rrjedh edhe një fjalë tjetër shqip "Shkrep" që ka të njëjtin

kuptim. Këto fjalë janë zanafilla e fjalës latine "Skarpus", prej nga rrjedh fjala frëngjisht "escarpé-i rrëpirët, i thiktë ".

MARSEILLE = Masilia = mar sjellia

Ky është emri i lashtë i Marsejës. Ky port i madh ka qenë i njohur në antikitet për aktivitetet e tij tregtare me të gjitha vendet e pellgut mesdhetar. Ky emër çuditërisht gjen një rezonancë fonetike të pakundërshtueshme në gjuhën shqipe: "Marr siella" që do të thotë "marr e sjell". Është kryekëput zanafilla e fjalës sonë moderne "import-eksport"!

MOTTA, MUOITTA = Matia, Mat

Në Alpet italiane emrat Mota, Muota do të thotë "gëmushë ose shkurrnajë". Megjithatë shënojmë se Dionisi i Halikarnasit flet për një qytezë umbriane me emër "Matia". Në Shqipërinë e Veriut një krahinë malore, e njohur për gëmushat dhe shkurrnajat e saj quhet "Matia, Mati, Mat".

MATIENES = Matianë

Popull i lashtë i Azisë së Vogël. Ky emër rigjendet te "Matianë", banorët e krahinës së lartpërmendur (Matia, Mat).

PELLA = Pella, pellë, Pelë, pela

Kryeqyteti i Maqedonisë së shekullit V deri në vitin 168 para Krishtit, data e fitores romake në Pidna. Ky toponim interpretohet gjithashtu në tri mënyra të ndryshme, të cilat gjithsesi të çojnë në të njëjtin përfundim, pra janë konvergjente. a) "Pellë, Pella" (gegë), Pylla (toskë) që do të thotë pyll. b) "Pella", thuhet për një lopë apo dhi që pas lindjes prodhon qumësht. Kjo fjalë rrjedh nga "piell" pra pjell. c) "Pelë, pela", pra pela. Mirëpo ne e dimë që Thesalia dhe viset përreth saj kishin një tokë shumë pjellore ku rriteshin gjedhët dhe delet dhe në veçanti racat

e kuajve. Kuajt e Thrakës, të Emathisë (emri i lashtë i Maqedonisë) dhe mbi të gjitha të Thesalisë ishin të mirënjohur kudo nëpër botën antike. Te Filistinët e lashtë (tjetër popull pellazg) ekzistonte një qytet me emrin "Pella".

ROME = ROMULUS = Romulak (gegë)

Qytet antik i themeluar nga Remus dhe Romulus, por ku vetëm ky i fundit bëhet mbret pasi vrau vëllain e tij. Emri "Romulus" rrjedh nga gjuha shqipe "Romulak" që do të thotë "i rrumbullakët" dhe më gjerë do të nënkuptonte "dikush me kokë të rrubmbulaktë". Ne e dimë shumë mirë që kultura Etruske është zanafilla e qytetërimit romak. Pra, nuk është për tu çuditur që emri Romulus ashtu si dhe morfologjia e tij të jenë me zanafillë etruske, pra pellazge. Në të vërtetë Etruskët bëjnë pjesë në familjen e madhe pellazge që lulëzuan në të gjithë hapësirën mesdhetare. Pjesa më e madhe e antropologëve pohojnë se Pellazgët, Thrakët, Ilirët apo Shqiptarët e sotëm janë trajtuar midis popujve më "brakicefalë" (treguesi cefalik mbi 85) të Europës. Prej nga vjen ngjashmëria midis emrit Romulus dhe fjalës pellazgo-shqiptare Romulak dhe kjo ngjashmëri antropologjike (rrumbullakësia e kafkës) që i karakterizon këto etni. Përzierja e racave në këtë epokë ishte e rrallë.

TIRANA = TYRRHENIA, TURAN

Emri i kryeqytetit të Shqipërisë e ka zanafillën nga Etruria ("Tyrrhenia") ose Turan", perëndesha Venus, e cila zë një vend të dukshëm në kozmogoninë etruske.

TOSKANA = TOSK

Tashmë e kemi parë që Shqiptarët e jugut quhen në gjuhën e tyre "Toskë" dhe se romakët i quanin Etruskët "Tusci" (shqiptohet "Tuski") dhe Etruria sot quhet "Toskanë".

II - Emra të popujve (etnonimi), toponimi dhe fjalë të ndryshme apo emra me zanafillë pellazge

ATHENES (Athina) = E THENA, E THANA

Qyteti më me prestigj i Greqisë antike shqiptohet në greqisht "Athina" (si "th" angleze). Deri më sot askush nuk ka mundur të shpjegojë zanafillën e këtij emri as në gjuhën greke as në ndonjë gjuhë tjetër të njohur. Mirëpo ky emër shpjegohet falë gjuhës shqipe "E thana" (gegë) ose "E thëna (toskë) që do të thotë premtim dhe më gjerë "qyteti i premtuar Pellazgëve". Në të vërtetë kur iu referohesh teksteve antikë vërehet që ky qytet ishte "qyteti i Pellazgëve", pelargikoni (muri rrethues i Akropolit) i të cilit është ende i dukshëm në ditët tona. Herodoti (I, 56, 57, 58 / VIII, 44) dhe Tuqididi (I, l, 3), duke cituar vetëm dy historianët më të lavdishëm të antikitetit grek, pohonin në lidhje me këtë: Pellazgët e zinin këtë vend që do të bëhej Greqia, përpara mbërritjes së Helenëve. Për Herodotin VIII, 44/ V 64, 137) dhe Skimnosin e Kios, Athina është një qytet i mirëfilltë pellazg.

KARIAN–, KAR

"Kar" është eponim i i Karianëve, popull parahelen i cili ka dalë nga i njejti trung etno-gjuhësor. Duke ardhur nga ishujt e Egjeut, kryesisht nga ishullli i Kretës, ata u vendosën kryesisht në pjesën jugperëndimore të Azisë së Vogël. Gjithsesi vendi i tyre u pushtua nga Dorianët. Ata U helenizuan në shekullin IV para Krishtit.

Ky eponim "Kar" ngatërohet me shqipen "Kar" (dialekti geg) dhe "ker" (dialekti tosk). Kjo përputhet jo vetwm me emrin e popullit karian por edhe me një zakon që ishte vetëm i tyre: të ngrinin "statuja itifalike", një lloj monumenti ku kolona katërkëndore kishte një "penis" të ngritur të perëndisë Hermes (Mërkuri i Romakëve) dhe më vonë të perëndive të tjera. Ky monument i "shenjtë" shërbente si një pikë për të hequr kufijtë. Herodoti (II, 51) pohon në lidhje me këtë: "Athinasit

[të dalë nga Pellazgët] ishin të parët që bënë statuja itifalike sepse i kishin mësuar nga Pellazgët. Ja edhe një tjetër provë që vërteton se Athinasit (Jonianë) dhe Karianët ishin të afërt me Pellazgët e famshëm! Së fundi shënoj se emri i Karianëve nuk shpjegohet aspak nga gjuha greke. Helenët janë përpjekur ta interpretojnë emrin e Karianëve me anë të gjuhës së tyre nëpërmjet "djaloshë me flokë të qethur"! Nuk ka nevojë për komente.....

KRANAENËT = Krena, Krenar

Kështu quheshin Pellazgët e Athinës (Herodoti VIII, 44) para se ta pushtonin Grekët. "Krena, Krenar" në shqip do të thotë "prijës ose njeri krenar dhe i lavdishëm". Kjo fjalë rrjedh nga rrënja "kre" (gegë) ose krye (toskë) që do të thotë "kokë".

DALMATË = Delmat

Zonë e lashtë e Ilirisë në bregun lindor të Adriatikut. Ky emër rrjedh nga gjuha shqipe "delmë" që do të thotë "dele" dhe delmat "delet" dhe me gjerë do të nënkuptonte "vendin e deleve".

DARDANI = Dardhë

Në antikitet ekzistonin dy "Dardani": ajo e Ballkanit dhe ajo e Troadës në Azinë e Vogël. Ajo e Ballkanit zinte në *grosso modo* vendndodhjen e Kosovës së sotme. Dardanët e trungut pellazg e kanë bërë të përjetshme ngushticën e Dardaneleve, e cila mban edhe sot këtë emër. Qysh nga antikiteti i hershëm kjo zonë njihej për pemishtet, ku ato të dardhave ishin të shumta. Sigurisht kjo është arsyeja që u quajt "vendi i dardhave". Këta Dardanë do të kenë qenë zanafilla e qytetërimit trojan. Në të vërtetë sipas legjendës, "Dardanos", lindur në Samothrakë (ishull pellazg, përpara pushtimit shumë më të vonshëm nga Grekët), ishte biri i Zeusit dhe i Elektrës. Ai emigroi në Azinë e Vogël me vëllain e tij, Jason. Ai u prit nga Teuker, i cili i dha vajzën e

tij për gruan (Batela ose Batieia). Ai ishte themeluesi i qytetit të Dardanisë dhe ka të ngjarë i qytetit të Trojës. Traditat italike e nxjerrin se rrjedh nga "Korintos", princ etrusk i Kortonës. Edhe nëse do të ishte me zanafillë etruske apo jo, kjo nuk ndryshon asgjë në zanafillën e tij pellazge, meqenëse edhe Etruskët ishin nga i njëjti trung etnik.

DOBERET = Dibër, Dibranët

Populli i lashtë thrak. Sot ekziston në një zonë kufitare në verilindje të Shqipërisë, një zonë e quajtur "Dibër, Dibra", banorët e së cilës quhen "Dibranë".

ETRURI, Etruskë = Tosk, Tuski

Grekët e epokës klasike i quanin "Tirrenë" ose "Tirsenë, Tursanë ose Turrenë" (Thyrrhenos, Tyrsenos). Italiotët i quanin Tursa-co-s, ndërsa Latinët Tuski, Etruski, çka krijoi "Toskana" në Itali dhe "Tosk" në Shqipërinë e jugut. Çuditërisht rigjendet në skandinavishten e vjetër forma "Thurs", e cila në legjendat e vjetra gjermanike emërton një popull "Gjigantësh", paraardhës të Gjermanëve në këto vise! Herodoti pohon që Etruskët kanë emigruar drejt Italisë nga fundi i shekullit XIII para Krishtit dhe se Tirrenos ishte biri i mbretit Lidian Atis, ai vetë biri i Manes (I, 7, 94). Tekstet egjiptiane i quajnë "Turshas", emër me të cilin ata emërtojnë një nga Popujt e Detit. Antiklidi dhe Straboni pohojnë prerë se Etruskët ishin Pellazgë. Shumë dijetarë fillojnë të parashtrojnë gjithmonë e më shumë zanafillën pellazge të Etruskëve. Megjithatë, pavarësisht kësaj, kundërshtitë ekzistojnë në lidhje me zanafillën e tyre, pasi disa etruskologë refuzojnë me këmbëngulje t`i trajtojnë se janë nga trungu pellazg, si zanafilla e Lidianëve, Frigjianëve ose Thrako-Ilirëve. Teopompu dhe Aristokseni pohojnë se Pitagora (shëkuli VI para Krishtit) i lindur në Samos, ishte bir i një "Turseni" (Etrusk) nga Lemnosi, i vendosur në ishullin Samos për arsye të punëve të tij.

ILIRI, ILIRË = I lirë

Është një nga degët etnike më të rëndësishme të Pellazgëve. Dega tjetër është ajo e Thrakëve. Ilirët ishin trajtuar nga Grekët si një popull i pavarur, i cili nuk u nënshtrua kurrë nga Grekët, pavarësisht tri apo katër "banakëve tregtare" që ata zotëronin në Iliri. Mirëpo "i lirë" është fjalë e mirëfilltë shqipe.

LARISA = Laris, Larës, Lar

Emër që e mbajnë qytete të shumtë pellazge (Thesali, Azi e Vogël, Kretë, Lesbos, Itali....). Më e famshme ishte Larisa ("Pelasgjis" antik) kryeqyteti i Pelagiotidës në Thesali, zonë pellazge e mirëfilltë, e njohur për mbarështimin dhe stërvitjen e kuajve. Gadishulli i Ballkanit ishte dikur i populluar nga popullsi të trungut pellazg: Pellazgë, Trakë, Ilirë, Tesprotë, Brigjë (të kthyer në Frigjianë kur kalojnë në Azinë e Vogël) ose Dardanët, duke përmendur këtu vetëm më të shquarit. Këta popuj dallohen nga ndërtimet ciklopike të quajtura gjithashtu pellazge, nga kultura e drithërave, stërvitja e kuajve, censi*), monedha ose teknikat metalurgjike. Mirëpo fjala "Laris" në shqip do të thotë "kal i përhimët" (femërore Larisa"). Kjo rrjedh nga rrënja "Lar, Larë" që do të thotë "njollë" në lëkurën e kafshëve dhe jo "Lar" (princ, mbretëreshë) si duan ta shpjegojnë disa. Përveç kësaj kalaja e Argos quhej "Larisa". Homeri (Iliada II, 840) përmend një Larisa në Troadë (seli Pellazgëve të drejtuar nga Hipotosi). Straboni pohon se të gjitha Larisat gjendeshin në tokat lymore: me lym, tokë e pasur. Ai përmend katërmbëdhjetë të tilla dhe Stefani i Bizantit numëronte dymbëdhjetë. Mirëpo këto toka a nuk janë ato më të përshtatshme për rritjen dhe stërvitjen e kuajve? A nuk ishte Thesalia shumë e dëgjuar për rritjen dhe stërvitjen e kuajve? Për Homerin a nuk ishin Thrakët dhe Frigjianët rritësit dhe stërvitësit e shkëlqyer të kuajve? A. Zharde shprehet në lidhje më këtë: "Toponimia i ka ruajtur

*) *Taksë e paguar në atë kohë, e nevojshme për të qenë zgjedhës apo i zgjedhur*

ende gjurmët e kësaj: emri Larisa që gjendet shumë herë në Greqi, Europë dhe Azi, duket se i përket këtyre gjuhëve të zhdukura ...."

LELEGËT = Le lesh

Emër i lashtë i Karianëve dhe banorëve të Kretës përpara vendosjes së tyre në ishujt dhe në Azinë e Vogël. Mirëpo emri "Leleg" shpjegohet me gjuhën shqipe "Le lesh" ose "le me lesh" që do të thotë "i lindur me qime" apo njeri "leshtor". Meqenëse është fjala për një popull shumë të lashtë ne mund të mendojmë që këta Lelegë apo njerëz – ishin një lloj antropoidësh ose njerëz parahistorikë të Epokës së Gurit.

LIBURNI, Liburnët = le burrë

Popull ilir që ka banuar në veri të Adriatikut. "Le burrë" është fjalë e mirëfilltë shqipe që do të thotë i lindur i seksit mashkull. Nga kjo fjalë rrjedh "Burrni" (gegë) ose "burrëri" (toskë).

LIGURI, Ligurë = Lëkurë

Popull i lashtë i vendosur në bregun mesdhetar, midis Marsejës dhe Pizës me zanafillë nga Azia e Vogël (Herodoti VII, 72). Herodoti pohon se "Ligurët" banonin në luginën e Ronit (V, 9, VII, 72). Ky emër gjen dy rezonanca gjuhësore në gjuhën shqipe: "lëkurë", në këtë rast "njerëz të mbuluar ose të veshur me lëkurë" dhe "le gur" që do të thotë "të lindur në shkëmbinj". Rigjendet kështu e gjithë hierarkia e zhvillimit dhe themelimit të grupeve të para njerëzore: njerëz me qime, njerëz leshtorë (Lelegët), njerëz të shpellave (Pellazgët), njerëz të shkëmbinjve ose njerëz të veshur më lëkurë (Ligurë), të gjithë këta të dalë nga i njëjti trung etnik!

LISIA, LISIANË = Liqe, Liqen

Popull i lashtë me zanafillë nga Kreta, e cila dikur ishte e populluar tërësisht nga barbarët (Herodoti I, 173) d.m.th. nga fise "jo Greke".

Maliq: sëpata dhe çekiçë (guri) – Epoka e bakrit.
(sipas "Shqipëria arkeologjike"- Tirana – 1971)

Ata janë gjithashtu të njohur me emrin "Luku", një nga "Popujt e Detit". Mirëpo "liqen" është fjalë e mirëfilltë shqip. "Lisianët" do të kenë qenë kenë "popull i liqeneve" pra të ujit, si rrjedhojë të detit. Mesdheu, një det i mbyllur a nuk është një liqen i madh?

MAQEDONI, MAKEDON, Maqedonas = Ma qe dhen

Maqedonasit ishin një popull "thrako-ilir" i trungut pellazg përpara se të asimiloheshin nga Grekët. Autorë të shumtë grekë kanë kërkuar tu japin Maqedonasve një "zanafillë" greke. Në të vërtetë Herodoti (VIII, 137) rrëfen se mbretërit e parë të Maqedonisë ishin më zanafillë greke dhe me saktë "dorianë". Heroi eponim i Maqedonisë është

"Makedon" ose "Maqedon" (Herodoti, I, 56). Zanafilla e këtij emri është gjithsesi, shumë e debatuar. Por Herodoti, pa dashje na jep çelësin për këtë. Ai tregon historinë e tri vëllezërve që u larguan nga Iliria dhe arrijnë në Maqedoninë e Epërme: Gauanes, Aeropos dhe Perdikas. Ata hyjnë në shërbim të mbretit të vendit. Njeri ruante kuajt, tjetri qetë dhe i fundit bagëtinë e imët. Më vonë, Perdikasi, i cili ishte më i vogli mori pushtetin në Maqedoni. Pra, është ai që fiton: ai që ruante. Mirëpo është e dukshme përputhja midis tri vëllezërve që "ruajnë kuajt, qetë, deshët dhe dhitë" dhe emrit "Makedon ose Makedoni": "Ma kuaj qe dhen"(ruajnë kuajt, qetë dhe deshët, d.m.th bagëtinë e imët dhe të trashë) shprehje që më të shumtën e kohës ndryshoj (Ma qe dhen). Kjo çuditërisht ngjan me "Makedon".

Përputhje gjuhësore: Mitologji
(perënditë, perëndeshat, heronjtë.....)

AKILI = Aspeitos = Asht'shpejt, A'shpejt

Plutarku pohon (Pirro I 1, 2) se Tesprotët (Epirotët e sotëm) në gjuhën e tyre e quanin Akilin "Aspeitos". Përveç kësaj ky emër do të thotë "i shpejti", fjalë që rrjedh nga rrënja pellazgo-shqipe "shpejt". Grekët kanë dashur ta shpjegojnë këtë emër me gjuhën e tyre me fjalët "i papërshkrueshmi, shumë i madh" (cf. Aristotel fr. 563 R) ndërkohë që Aspeitos përkon krejtësisht me epitetet e përdorura shumë herë nga Homeri në Iliadë: "i shpejti", Akili me këmbë të lehta" etj. Megjithatë Grekët e quajnë "Akileus"(="pa buzë"). Ndërkohë që në shqip nënkupton "Aq i lehtë". Ky Easid është biri i Thetis ("deti" fjalë e mirëfilltë shqip), më e shquara e Nereidave dhe e Pelesë, mbreti i Ftias në Thesali (Argosi Pellazg). Ky hero legjendar, prijësi i Mirmidonëve nderohej në Thesalinë pellazge (atë të Homerit, e kthyer më vonë në "Pellagoitidë"), pastaj në Tesproti ("Pellazgjia" e lashtë).

AMALTE = E mielta

Është emri i dhisë "ushqyesja" e Zeusit. Ky emër "miel" që do të thotë "me mjel" ka krijuar "mjelm" d.m.th. "gji; sisë lope". Si rrjedhojë "E mielta" do të thoshte "ajo që ka qenë mjelë apo pirë" dhe më gjerë "ajo që ka pirë Zeusi".

AFRODITE = Afër dita

Lindja e Afërditës perëndesha e Dashurisë, Bukurisë dhe dëshirës është shumë e diskutueshme. Dihen dy versione. Versioni i parë është ai i Homerit që pohon se ajo është bija e Zeusit dhe e Dionesë. Sipas versionit të dytë ajo ka lindur nga deti e zhytur në gjakun e organeve seksuale të sakatuara të Uranit. Ky gjak ka mbarsur detin dhe Afërdita ka dalë nga brenda një dallge, e bardhë dhe e bukur në formën e shkumës: Afërdita, "e lindur nga shkuma e detit". Në vendet mesdhetare çdo ushqim që vinte nga deti në tokë trajtohej si afërdi....tase. Legjenda na thotë se ajo fluturonte në ajër e shoqëruar me pëllumbat dhe harabelat të njohur për gjëra të turpshme (shthurje). Brezi i saj magjik i bënte të dashuroheshin të gjithë ata që e merrnin këtë brez. Ajo ishte bashkëshortja e Hefaistos dhe zonja e Ares-it. Ajo nderohej në Siri dhe në Palestinë me emrin Ishtar, Astarte ose Ashataroth. Një tjetër kult i rëndësishëm gjendej në Pafos (në jug të Qipros). Ajo lindi dy fëmijë të famshëm Eros dhe Anteros. Emri i saj gjen rezonancë në gjuhën shqipe: "Afër ditës", pra pranë ditës dhe në kuptim më të gjerë "ajo që është e bukur si dita apo si agimi, ajo që shkëlqen si drita e diellit".

APOLLON = shiko PAN

ATRIDES = Atrët

Është emri që morën pasardhësit e familjes së Atres, biri i Pelopsit dhe Hipodamisë. Fëmijët e tyre më të famshëm ishin Agamemnoni dhe Menelau, që u quajt më vonë "Atrides". Sipas legjendës, "Pelopia",

gruaja e tretë e Atreut i dha emrin e saj Peloponezit. Mirëpo fjala "Atrides" rrjedh drejtpërdrejt nga gjuha pellazgo-shqiptare "at, atë" dhe numrit shumës Atrët, që do të thotë "të parët, të afërmit, familja".

AJAKS = Gjakës, Gjakësorë

Ky është emri i dy heronjve legjendarë. I pari Ajaksi, biri i Telamonit (mbreti i Salaminës) dhe i trajtuar si luftëtari më i guximshëm pas Akilit gjatë luftës së Trojës. Por pas vdekjes së këtij të fundit, ai dhe Odiseja u ndeshën për armët e heroit të madh. Ishte Uliksi që i mori ato. Atëherë Ajaksin e kapi dalldia dhe doli natën nga tenda e tij dhe theri të gjitha deshët që gjendeshin përreth duke kujtuar se po vriste luftëtarë. Sa për Ajaksin e dytë, biri i Oiles, mbreti i Lokrianëve i mbiquajtur "i vogli" jo vetëm në raport me Ajaksin e "madh" por edhe për shkak të trupit të tij më të vogël. Edhe ai u dallua për trimërinë e tij dhe mizorinë në luftimet kundër Trojës. Por mbi të gjitha, ai bëhet fajtor për sakrilegjin kundrejt Athinës. Pra kemi vërejtur se bëhet fjalë për Ajaksin e parë ose të dytë, të cilët si njeri dhe tjetri simbolizojnë "mizorinë dhe gjakun e derdhur". Mirëpo në shqip kjo na zbulon pikërisht këtë aspekt mizor dhe gjakatar: "Gjaks ose Gjakës" nënkupton "vrasës" dhe "Gjakësor" !

ALEKSANDRI = Ka le andër

Ky emër është bërë i shquar falë Parisit, i quajtur ndryshe Aleksandër, biri i Priamit (mbreti i Trojës) dhe i Hekubës. Këtë emër mbajtën më vonë në mënyrë të veçantë princat e linjës mbretërore dhe me zanafillë pellazge, të tillë si Aleksandri III i Maqedonisë, biri i Filipit II dhe Olimpias, princesha epirote. Legjenda e parë ka të bëjë me Paris/ Aleksandër, hero trojan dhe pellazg. Nëna e tij Hekube, kur ishte shtatzënë pa në ëndërr se ishte mbarsur me një pishtar që flakërinte dhe që dogji të gjithë qytetin e Trojës. Duke dyshuar për një paralajmërim të keq ajo e la atë në malin Ida. Ai u rrit nga bariu Agelaus. Më vonë duke zbuluar zanafillën e tij, ai u kthye pranë babait të tij në

pallatin e Trojës. Profetja "Kasandra", motra e tij e njohu menjëherë. Pa dyshim, bariu që e rriti i kishte dhënë emrin "Paris". Ai mori emrin Aleksandër ka shumë të ngjarë si rrjedhojë e një britme të motrës së tij Kasandra: "ai që ka lindur si në ëndërr", ëndrra e Hekubesë! "Ka le si andërr". Një tjetër legjendë "ëndrrash" është e lidhur me lindjen e Aleksandrit (shiko "Maqedoni"). "Ai që mbron burrat" është nga ana fonetike shpjegimi në greqisht!

ARES = Erz

Biri i Zeusit dhe Erës. Ai është perëndia e luftës dhe e mundjes dhe i përket brezit të dymbëdhjetë perëndive të Olimpit. Kjo perëndi, mbrojtëse e Trojanëve nuk pëlqehej nga Grekët. Kulti i tij, i sjellë nga Thraka, vend i stuhive, kuajve dhe luftëtarëve nuk ishte shumë i përhapur në Greqi. Vetëm gratë tërhiqeshin nga pamja burrnore e tij, ndër të cilat perëndesha Afërditë. Kodrina ku ai u gjykua sepse kishte vrarë birin e Poseidonit, Halirrotiosin, quhej Aerofag. "Lufta", për të cilën Ares ishte perëndia, a nuk simbolizonte nderin ose "luftën për nderin". Gjuha shqipe na e vërteton këtë nga fjala "Erz, Erez" që do të thotë "nderi".

KASSANDA = Qes andërr, Qes andërra

Bija e Priamit (mbreti i Trojës) dhe Hekubeas. Ajo mësoi nga Apoloni "dhuntinë e parashikimit të së ardhmes".

Emri i saj shpjegohet në mënyrë të përkryer falë gjuhës shqipe: "qes andërr ose qes andërra (gegë), çfarë nënkupton "ajo që shpjegon ëndrrat".

KORE = korr, korra

Perëndesha e të Korrave, bija e Demetrës. Perëndesha e grurit dhe e mbirjes së tij. Grekët e shpjegojnë këtë emër me "vashëz e re", ndër kohë që në gjuhën shqipe rrjedh nga folja "korr" (me korr) dhe fjala e

prejardhur "Korra, të Korrat. Kora u rrëmbye nga Hadi që e çoi në mbretërinë e përtejme. Pas këtij rrëmbimi ajo mori emrin Persefoni dhe atributet e saj u përpunuan: ajo u bë mbretëreshë e hijeve. Kjo legjenda e fundit ka të ngjarë të jetë tepër e vonë, d.m.th. me zanafillë greke. Përveç kësaj, vetë emri i Persefonit nuk shpjegohet nga gjuha pellazgo-shqiptare. Gjithsesi është e shoqëruar me nënën e saj, Demetrën në misteret e Eleuzës.

KRONOS = Koh ro, Koh ron

Titani, djali më i ri i Uranit dhe i Gaias (Gaea, e quajtur gjithashtu Gé) është bashkëshorti i Reas dhe babai i Zeusit. Nën mbretërimin e tij lindi epoka e artë ose e njerëzimit. I lidhur me motrën e tij Rea, ai pati tri vajza (Hestia, Demetra, Era) dhe tri djem (Hadi, Poseidoni dhe Zeusi). Kronos jepet i shoqëruar me një korb. Më pas paraqitej i armatosur me një kosë duke personifikuar kështu kohën (Kronos). Mirëpo Kronos shpjegohet shumë mirë me gjuhën shqipe: "Koh ro (gegë), "Koh ron" (toskë) që shpjegohet saktësisht "Koha jeton", d.m.th. në kuptim më të gjerë "Koha jeton dhe vijon në përjetësi". Është pikërisht ky emër nga rrjedh edhe fjala "kronologji".

KURETËT = Ku rret, ku rritët

Kuretët ishin rojet e Zeusit fëmijë dhe një nga popujt e parë të Kretës. Nga ky emër rrjedh ai i KRETËS, vendi ku Zeusi "u rrit". Mirëpo në shqip shprehja e zakonshme "ku rret" (gegë) ose "ku rritet" (toskë) do të thotë aty ku rritet, ku është rritur, edukuar". Rrënja "rret ose rrit" ka krijuar fjalën "rretia ose rritia" që do të thotë "rritje, edukim". Në epokën e Homerit (Iliada IX, 529, 533, 588) "Kuretët" e Akarnanisë dhe të Etolisë ishin Pellazgë. Për më hollësi drejtohuni te Pellazgët.

CYCLOPES, KUKLOPS = Sy Kokë, Sy kap

Përsa u takon këtyre qenieve përrallash me një sy në mes të ballit, ekzistojnë katër legjenda të dëgjuara:

-Ciklopët Uranianë, të lindur nga bashkimi monstruoz i Gaias (Toka) dhe Uranit (Qielli).

-Ciklopët farkëtarë.

-Ciklopët ndërtues (Muret që mbajnë emrin e tyre dhe që ende dallohen në Mikenë, Tirinti ...).

- Ciklopët barinj. Këta janë përshkruar nga Homeri: njerëz të shpellave, të egër, antropofagë, gjigandë pa besë dhe iman, mbarështues të kopeve të deleve. Të parët janë më shumë të përmendur. Te Hesiodi ata janë trajtuar si zotë të shkreptimës (një nga "atributet" e Zeusit). Ata janë tri: Brontesi bubullima, Stereopes vetëtima dhe Arges shkreptima. Ata bashkë me Titanët dhe Hekatonkirët simbolizojnë forcat e furishme të natyrës. Por Ciklopët gjithashtu janë trajtuar ndër "njerëzit e parë të shpellave". Pra zanafilla e tyre përqaset me atë "Kuretëve". Ja çfarë na thotë H. D`Arbua de Zhybenvil: " Kuklopes ose Ciklopët e Homerit i përkasin racës zanafillore, të cilën arkeologët e emërtojnë banorët e shpellave.... Ciklopët nuk kishin të njëjtën fé me Grekët". Fjalët "sy" dhe "kokë" janë fjalë të mirëfillta shqip, pra d.m.th. "sy i vendosur mbi kokë" dhe në kuptimin më të gjerë "mbi ballë". Sa për fjalën "kap" edhe kjo është shqip "kap, kuptoj "dhe si rrjedhojë "sy kap" apo "syri që kap, kupton". Përsa u takon "Ciklopëve ndërtues" ata na kanë lënë trashëgim zanatin ciklopik. Ky term arkitekturor klasifikohet i pari nga ana kronologjike. Sipas një legjende (e ndryshme nga ajo e Homerit, Ciklopët më zanafillë nga Lisia do të kenë ndërtuar të gjithë monumentet parahistorike të Greqisë (muret ciklopike ose pellazge), të Azisë së Vogël dhe të Italisë. Më të njohura janë muret e ledheve rrethuese të Mikenës, Tirrintit dhe Athinës (Pelargikon). Ndërkohë në greqisht kjo fjalë do të thotë "sy rrumbullak" !

DEMETER = Dhé - motër

Bija e Kronos dhe e Reas, ka qenë një hyjni e rëndësishme e "tokës të lëruar dhe pjellore", çfarë ajo mishëronte si dhe më në veçanti kokrra

gruri. Kujtojmë kalimthi se Pellazgët janë të parët që sollën kulturën e drithërave në Europë. Gjithashtu perëndesha e frutave dhe e të gjitha pasurive të tokës, ajo ishte simbol i qytetërimit antik: begatia e të korrave dhe e zhvillimit ekonomiko-shoqëror. Kulti i saj u ruajt në disa rajone të Greqisë antike, në veçanti në Arkadi, ku Pellazgët ruajtën për një kohë më të gjatë traditat e tyre. Një legjendë tregon se Demetra kishte mbërritur në Greqi nëpërmjet Kretës. Grekët e quanin "Nëna e tërashërës". Gjithsesi të lashtët, të gjithë njëherësh e cilësonin Perëndesha – Tokë ose Toka – Mëmë. Shpjegimi shqip i mësipërm është më se i qartë: "Dhé - Motër" që do të thotë "Toka – Motër". Është me vend të shënohet përputhja e kuptimeve midis Demetër (perëndeshë e kulturës dhe e mbjelljes) dhe bija e saj Kore (perëndesha e të korrave): ajo që "mbjell" nëna dhe ajo që "korr" bija!

EPIMETEA E pa me thanë

Ky titan është biri i Jafetit dhe Klimenës dhe vëlla i Prometeut. Ky i fundit i kërkoi të refuzonte çdo dhuratë të Zeusit. Por ai nuk guxoi të refuzonte Pandorën për grua. Mirëpo në shqip "E pa me thanë" ose "thënë" (toskë) = pa premtuar ose "ajo çfarë nuk është thënë apo premtuar".

EURINOMA = E re me namë (shiko (Ofion)

Bija e Oqeanit dhe e Thetys (deti), ajo është një nga hyjnitë e para të mitologjisë. Me Titanin (ose gjarprin) Ofion ajo sundoi në Olimp përpara shfaqjes së Perëndive. Nga Zeusi ajo kishte "Karitët" ose (Gracët) dhe "Asopos" perëndi-lumë. Ajo konsiderohej si "perëndeshë - Hënë", krijuesja dhe që e quanin "udhëtarja e madhe". Në shqip emri i saj përkthehet "E re me namë", pra "Vashëz e mirënjohur".

GEANTS (GJIGANDËT) = Gigas, gias = gegë

Sipas legjendës "Gjigandët" lindën nga bashkimi i Tokës dhe Tartarit, vendbanim i Titanëve. Robert Greiv (Mitet greke) na thotë në lidhje

me këtë: "Ngjarja historike që është në bazë të revoltës së "Gjigandëve" si dhe të revoltës së Aloadëve, e cila është trajtuar si një legjendë simotër, duket të jetë një përpjekje e malësorëve jo helenë për të marrë disa fortesa helene; ajo i bën jehonë shpartallimit të tyre përballë aleatëve të Helenëve... Luftimi vdekjeprurës ka të ngjarë se ka të bëjë me dy sistemet e kundërta, sistemin patriarkal dhe atë matriarkal, që kishin përhapur pushtuesit helenë". Gigët, në greqisht "i lindur nga toka" (në shqip "Gji dhés" = "të afërm" të tokës ose "i lindur në gjirin e tokës") përmban një formë tjetër Gigas (Gjigant): në mitologji Gjigandët shpesh janë të shoqëruar me malet e Greqisë së Veriut.

Sipas Homerit "Gjigandët" ose "Gias" banonin përtej maleve Akrokeraune (veriu i Epirit), i emërtuar nga Grekët me "lart dhe rrufe", pra Akro.. Keravnos. Këta dy shembuj janë thelbësorë jo vetëm për të shpjeguar këtë legjendë por për të mbështetur vërtetësinë historike të Pellazgëve. Në të vërtetë "Gigas, Gias" nuk janë gjë tjetër veçse një etni pellazge e Ilirisë së Jugut (Shqipëria e sotme) dhe që ende edhe sot e quajnë "Gege". Këta malësorë të veriut të Shqipërisë janë trajtuar (ashtu si dhe malazezët, etni shqiptare "e sllavizuar") si më trupmëdhenjtë dhe truplidhurit e Ballkanit në raport në Grekët që janë më trupvegjël dhe më të imët. Përsa i takon "Akrokeravnos" kjo fjalë rridhte nga pellazgo-shqipja "Krue" (Krye), "kokë" (pika më "e lartë" të individit) dhe "Kirova, kirue" (pastroj) që formon fjalën "kros" (gegë) që do të thotë "tullac". Kjo do të thotë: "male të lartë ku kreshtat e zhveshura (nga dëbora?) ose "male të qëruara". Gjë që shpjegohet mjaft mirë sepse mbi majat e larta bimësia nuk i reziston dot të ftohtit dhe dëborës. Në veri të Epirit, në Alpet Shqiptare, Grekët vendosnin kufijtë, kurrë ndonjëherë të kapërcyeshme, të territoreve të tyre. A ishte ky shkak i maleve të paarritshme apo nga supersticioni apo më saktë sepse aty ishte strofull e "Gjigandëve dhe mostrave"? Historiani Gloc saktëson se "Greqia klasike kufizohet me vendin përtej linjës që

shkon prej gjirit të Ambrakisë deri në grykën e Peneas". Në të vërtetë sipas autorëve antikë "bota greke" ndalte në kufijtë e Ahelout. Zonë që të nxjerr "matanë".

HADI = Ha deks, Ha vdeks

Biri i Kronos dhe Reas, Hadit i ra në pjesë zotërimi sovran mbi botën e nëndheshme. Ai është zot i "botës së përtejme" dhe i "Mbretërisë së të vdekurve". Ai paraqitet në fund të botës së përtejme mbi një fron duke mbajtur një skeptër në dorë, me të cilin ai sundon pa mëshirë shpirtrat e vdekur. Grekët e kanë përkthyer emrin e tij "i padukshmi", ndërkohë që në gjuhën shqipe Ha deks (gegë) ose ha vdeks nënkupton "ai që ha të vdekurit".

HERA = Era

Bija e Kronos dhe e Reas, e cila u martua me Zeusin, vëllain e saj. Ajo lindi në ishullin e Samos ose sipas një legjende tjetër në Argos. Por ajo u rrit në Arkadi nga Temenos, biri i Pelasgosit (heroi eponim i Pellazgëve). Ajo trajtohej bashkë me Zeusin si sovrane e vërtetë e Olimpit. Më afrimin e saj të gjithë perënditë ngriheshin. Ajo mbretëronte në një fron të artë, përbri Zeusit. Ajo simbolizonte martesën dhe ishte mbrojtëse e pjellorisë se çiftit. Atributet e saj janë skeptri (në majë me një qyqe, me sa duket) dhe diadema. Grekët e shpjegojnë emrin e saj me "tokë" dhe që cilëson zonjën mbrojtëse, ndërsa romakët me "zotëri" (nga latinishtja Herus). Sipas disa autorëve, emri i saj paraqet zanafillën e saj nga një "Herva" (mbrojtëse). Të tjerë, rrënjën ia bashkëngjisin fjalës Hera në sanskritisht svar (qiell). Grekët e shpjegonin emrin e saj me fjalën "tokë" dhe e cilësonin si një zonjë mbrojtëse dhe romakët për "zot" (nga latinishtja Herus). Shqipja duket më e pranueshme: "Era". Ky shpjegim është në harmoni të përkryer me një nga atributet e Heras.

HESIONA = E zanë

Ekzistojnë dy versione në lidhje me këtë. Në versionin e parë ajo është një Oqeanidë, bashkëshorte e Prometeut. Në versionin tjetër ajo është bija e Laomedonit. E lidhur me zinxhir pas një shkëmbi në brigjet e Trojës, krejt e zhveshur dhe e zbukuruar me bizhuteritë e saj dhe për jetën e saj i detyrohet Heraklesit që e zgjidhi nga zinxhirët. Emri i saj shpjegohet në mënyrë të përkryer në gjuhën shqipe: E zanë (gegë) ose E zënë (toskë), pra në të dy dialektet "e kapur".

LAERTI = Le urtë

Mbreti i Itakës, biri i Akrisios dhe babai i Uliksit. Ai mori pjesë në ekspeditën e Argonautëve. Gjatë mungesës së birit të tij ai u tërhoq me urtësi dhe bëri një jetë të vetmuar. Emri i tij shpjegohet me gjuhën shqipe "i lindur i matur ose i virtytshëm".

MNEMOZINA = Mousai = Men mësoi

Bija e Uranit dhe Gaias (Gaea), ajo është perëndesha e kujtesës. Kjo Titanidë lindi nëntë Muzat. Ajo paraqitet duke mbajtur veshin me dorën e djathtë. Grekët e quajnë "Mousai". Emri i saj përkthehet me fjalën shqipe "Men mësoi", "Men me mësue (gegë) ose "Ment Mësoi" që do të thotë "inteligjencë apo të mendosh për të mësuar", duke simbolizuar kështu kulturën.

ODISE = Odhysseus = Udhës, Udhësi

Përveç atyre që kam thënë në fillim të kapitullit duhet shtuar që Uliksi (Odhysseus), pasi kishte luftuar për dhjetë vjet, u nis ndër aventura për dhjetë vjet të tjera. Penelopa, gruaja e tij, e priti gjatë 20 viteve të luftimeve dhe të shtegtimeve të ndryshme. Por Uliksi është edhe më i njohur për aventurat dhe "udhëtimet" e tij. Madje është vetë emri i tij që na e zbulon këtë: Udhës, Udhësi, Udhëtar që rrjedhin nga fjala shqipe "udhë". Uliksi eshtë ëmri i latinëve. Edhe ky ëmer shpjegohët nga fjala shqip : "ulicë" d.m.th "rrugë e vogël" !

URANI = U vranë, vranësi

Ai është njëkohësisht biri dhe bashkëshorti i Gaias (Gaea), Toka – Mëmë. Është çifti i parë, i cili lindi një brez perëndish dhe djajsh. Është perëndia më e lashtë e Kozmogonisë. Ai është babai i Titanëve, Ciklopëve dhe Hekatonkirëve. Grekët e përkthejnë emrin e tij "qiell me yje". Përkundrazi në shqip kjo do të thotë "qiell i ngarkuar, qiell i vranët ose "mot i rënduar".

PARIS = shiko Aleksandër

PENELOPA = Penë*) e lyp

Bija e nimfës Periboea dhe Ikarios, vëllai i Tindarit. Ajo është gruaja e të famshmit Odiseja (Uliksi). Gjatë mungesës së bashkëshortit të saj edhe për të shmangur pretenduesit e mundshëm për martesë ajo vuri në zbatim një strategji: ajo shpalli se së pari duhej të përfundonte endjen e qefinit të vjehrrit të saj, Laertit. Por natën ajo e zhbënte atë që kishte bërë ditën: kjo do të zgjasë për 20 vjet. Emri i saj shpjegohet mjaft qartë në gjuhën shqipe: "Penë e lyp", që do të thotë "Ajo që ka nevojë për fill". Grekët e shpjegojnë me "ajo, fytyra e së cilës është e mbuluar me një vello". Penelopa është epiteti që jepet sepse në të vërtetë ajo quhet "Arnea ose Arnakia" (ajo që "arnon " ?).

PROMETHE = Prue me dhe

Prometeu, biri i Japetit (ngjashmëri e çuditshme me "Jafetin" e Biblës) dhe i Klimenës si dhe një nga shtatë Titanët, formëzoi me argjilë dhe ujë Panopean, njerëz me imazhin e Perëndive. Athina i dha jetë këtij krijuesi të racës njerëzore. Grekët e quajnë "parashikuesi". Mirëpo gjuha shqipe është shumë shpjeguese për këtë: "Prue me dhé (gegë = e sjellë bashkë me tokën"!

---

*) *Penë = peri, filli*

REA = Re, Reja

Bija e Gaias (ose Gaea) dhe Uranit, ajo është bashkëshorte e Kronos dhe nëna e Zeusit. Kjo perëndeshë është mjaft e njohur me zanafillë pellazgo-kretase e marrë nga Grekët gjatë pushtimit të vendit të Pellazgëve. Ajo u krahasohej me Sibelën frigjiane, "Nëna e Madhe" ose "Nëna e Perëndive". Ajo adhurohej në Perëndim, në Azinë e Vogël dhe në Lindjen e Afërme. Titanida Rea ishte gjithashtu nëna e gjashtë kronidave: Demetra, Hestia, Hera, Hadi, Poseidon dhe Zeus. Rezidenca e saj vendosej në përgjithësi në "Taumasion", në Arkadi. Grekët duket se e shpjegojnë emrin e saj nëpërmjet një shtrembërimi të fjalës Era që do të thotë Tokë (në gjuhën greke). Ndërkohë që në gjuhën shqipe rrënja është gjithsesi homonimi "re" prej nga rrjedh "reja" dhe "nusja, bashkëshortja". Midis Uranit (U vranës, Vranësi = tokë apo qiell i rënduar) dhe bijës së tij Rea (Reja) ekziston një përputhje mjaft e përkryer. Nga ana tjetër mund të thuhet se ajo ishte gjithashtu "bashkëshortja" e Kronos, babai i Zeusit.

THALIE = Tallie (Talje) : muzë e Komedisë

TARTARI = Terr - Terr

Ky vend i nëndheshëm gjendet në fund të botës së përtejme. Pra është humnera, bota e errët që rrethon një ledh të trefishtë të bronztë. Ky është vendi i ndëshkimit apo burgu i perëndive të brezit të parë. Kjo fjalë shpjegohet mjaft mirë me gjuhën shqipe: "Terr terr", pra "Terri i terreve". Një tjetër fjalë që rrjedh nga kjo është fjala "ters" që do të thotë "fatale, e kobshme". Kjo paraqitje fjalësh është mjaft domethënëse.

TELEMAKU = Të leu mec

Biri i Odisesë dhe i Penelopës. I lindur pas nisjes së babait të tij, ai mbeti vetëm me nënën e tij në Itakë. Ky emër i shqiptuar nga Penelopa gjatë kthimit të Odisesë shpjegohet nga gjuha shqipe "Të leu mec ose

Të leu mëz", gjë që do të thotë "të ka lindur djalë". "Mec" (gegë, krahina e Matit) do të thotë "djalë" dhe "mëz" në toskërisht.

THEMIS = Të mys

Bija e Uranit dhe e Gaias. Ajo bën pjesë në brezin e perëndive kryesore. Ajo është një nga bashkëshortet e Zeusit si dhe nëna e nimfave të Eridanit, të Moirës, të Orëve dhe sipas disa autorëve nëna e Hesperidave. Për Homerin ajo është personifikimi i vetë rendit të vendosur, të ligjeve dhe të drejtësisë. Paraqitet me një peshore dhe një lloj shpate në duar (emblema të mirëfillta të drejtësisë). Sytë e saj të lidhur simbolizojnë paanshmërinë e (dënimeve) të saj. Mirëpo emri "Themis" shpjegohet në mënyrë të përkryer në gjuhën shqipe me "Të mys" (gegë) ose "Të mbys" (Tosk) dhe në kuptimin më të gjerë të fjalës "Unë vendos drejtësinë" ose "Keni kujdes! Me shpatën time unë mund të vras këdo që bën faj". Siç e pamë shpata (që vret) është një nga simbolet e Temisit.

THETYS = Deti

Bija e Uranit dhe e Gaias, e cila zë një nga vendet e para midis perëndive kryesore të Mitologjisë. E bashkuar me Oqeanin ajo lindi Oqeanidat. Ajo është zanafilla e krojeve dhe burimeve. Pra ajo është simboli i "ujit". Mirëpo emri i saj përkon nga ana fonetike me fjalën e sotme shqipe "deti".

TETIS = Deti

Bija e Nereas dhe e Dorisit. Ajo është më e shquara nga "Nereidat" (perënditë detare). Ajo lindi Akilin me baba Pelean, mbreti i Ftias në Thesali. Emri i saj lidhet gjithashtu edhe me fjalën Deti (në shqip) që simbolizon ujin ose detin. Plus kësaj bëhet fjalë për një "Nereidë", d.m.th për një hyjni detare.

TALLIA (Talleia) = Tallia

E trajtuar si një muzë fshati me emrin "Taleia", fillimisht ishte një nimfë e dashur për Zeusin. Më pas u bë muza e Komedisë dhe e Poezisë. Ajo paraqitej me tiparet e një vajze gazmore me kurorë lerthi, në dorën e djathtë veroren dhe në dorën e majtë maskën e Komedisë. Emri i saj shpjegohet shkëlqyeshëm me shqipen '"tallia, tallie (talllje).

ZEUS = Za, Zani (gegë), Zë, Zëri (toskë)

Përpara se të siguronte pushtetin mbi perënditë e tjera, Zeusi ishte perëndia e qiellit dritëplotë, i fenomeneve atmosferike (retë, shirat, erërat, bubullimat). Në lidhje me të thuhej "Zeusi hedh shiun apo bubullin".

Nga Homeri dhe Hesiodi ai merr rolin më të shkëlqyer midis perëndive të Olimpit dhe një vend mbizotërues në kozmogoninë mitologjike. Disa thonë se emri i Zeusit të kujton rrënjën sanskrite "Dyaus" që do të thotë "dita" (latinisht dies). Megjithatë Homeri pohon se "Zeusi është pellazg dhe dodonas" (Iliada XVI, 234). Vendi më i lashtë i kushtuar Zeusit nga Pellazgët është vendi i shenjtë i Dodonës, në Tesproti ("Pellasgjia" e lashtë e quajtur "Epir" pas shekullit V). Në Dodonë gjendej në lis i shenjtë, fëshfëritjet e gjetheve të të cilit shpjegoheshin nga orakulli si të ishin "zëri" i Zeusit. Atributet e Zeusit janë Shqiponja, Shkreptima dhe Skeptri. Përveç kësaj kush thotë shkreptimë thotë "bubullimë" pra "zhurmë" ose "zë".

Kështu emri i "Zeusit" shpjegohet nga gjuha shqipe "Za, Zani". Me mbërritjen e Helenëve ky orakull e humbi rëndësinë e tij për arsye të lartësimit të orakullit të Delfit, vendi i shenjtë (i Apolonit) "grek". Duhet shënuar që në Shqipëri perëndia quhet Zot në të gjitha fetë. Përveç kësaj shprehja "par Zeus" "për Zotin" përdoret gjithmonë. Porfiri (Jeta e Pitagorës) na thotë se Pitagora përdorte fjalën "Zan" për të emërtuar Zeusin!

Bust i një femre të quajtur Bilia (emër tipik ilir)
Shekulli II/III i erës sonë
(sipas "Shqipëria arkeologjike" – Tirana – 1971)

ARGIANË = Arxhi

Argianët, banorë të Argos (kryeqyteti i Argolidës) ka të ngjarë të kenë qenë argjendarë të zotë në një rajon, pa dyshim i pasur në ar. Përveç kësaj maskat prej ari, të zbuluara në varret e Mikenës e dëshmojnë këtë. A nuk flet Homeri për "të pasurën Mikenë apo Mikena e pasur në ar" (Iliada XI, 46; Odiseja III, 305, etj.) Mirëpo e dimë se Pellazgo-Ilirët ishin "metalurgë" të shkëlqyer dhe me famë. Megjithatë emrat Argianë dhe Argos rigjenden në shqipen e sotme: Arxhi që do të thotë "argjendar" dhe Arka, Arkët (analogjia me Arkadia), pra arkë ose arkat. Në të vërtetë fjala "ar" në shqip dihet që është ari, term që u përcoll te Latinët qoftë nga Etruskët (metalurgë të tjerë të trungut pellazg) qoftë nga popullsi të tjera pellazge të Italisë së lashtë (Japigët, Mesapët ..). Përkundrazi ar në greqisht quhet "Khrusos". Në latinisht ari quhet "arum", në gotisht "gulth" dhe në gjuhën avestike "zarania". Në sanskritisht "arh" do të thotë "vlerë" ose "ajo çka vlen" dhe "arhat" do të thotë "njeri me vlerë apo me merita".

ARIMASPET = Ari me shpue

Sipas Herodotit bëhet fjalë për një popull mitik që ka banuar në veri të Skithisë (III, 116 - IV, 13, 14, 27).

Ja çfarë thotë ai për këtë popull (III, 116): "Është e sigurt që në veri të Europës gjenden shtresat më të rëndësishme të arit. Nga vjen ky ar? Nuk mund ta përcaktoj. Thuhet që Arismaspët, njerëzit me një sy, e kan nxijerr grifonëve*) ; por unë nuk dua ta besoj që ekzistojnë njerëz me një sy dhe pjesa tjetër ta kenë si gjithë të tjerët. Sido që të jetë këto rajone skajore që përfshijnë midis tyre pjesën tjetër të botës, duket të zotërojnë të vetmit gjithçka që është më e bukur dhe më rrallë për ne". Pastaj në një paragraf tjetër ai shton (IV, 17): "Këta janë Isedonët që flasin për njerëz me një sy dhe për grifonët roje të minierave të arit;

*) *Grifon - Kafshë mitike me trup luani dhe kokë e krahë shqiponje*

Skithët i ruajnë mes tyre të dhëna të tilla dhe ne i kemi marrë nga Skithët dhe përdorim një fjalë skithe kur flasim për Arimaspët: thuhet në gjuhën skithe që "një" do të thotë "arima" dhe "spou" do të thotë "sy".

Çfarë përfundimi duhet të nxirret nga kjo? Arimaspët duket se kanë qenë "ndërmjetës" për të transportuar arin e vendit të Grifonëve. Mirëpo gjuha shqipe na jep një interpretim shumë më realist dhe shumë më të pranueshëm se ai i Skithëve, të cilët duket se kanë patur një përqasje 'fonetike' me gjuhën e tyre dhe që (i kanë humbur) ende po humbasën ata , të cilët nuk e dinë gjuhën shqipe. Në të vërtetë "Ari me shpue" do të thotë: "ari që dërgohet, që transportohet, që shoqërohet"! Pellazgët nëpërmjet Etruskëve ka të ngjarë t`ia kenë përcjellë latino-romakëve emrin e arit, i cili në latinisht thuhet "arum", ndërkohë që Grekët e quajnë "khrusos". Në gjuhën gotike quhet "gulth", në islandishten e vjetër "gold", në sllavisht "zlato" dhe në gjuhën avestike "zarania".

ARVENËT = Etni gale më zanafill kelte

Emër i lashtë i galëve të rajonit që më vonë u quajt "Auvergne" (Overnj). Versingetoriksi ishte një Avern (banor i Auvergne). Mirëpo ky emër krahasohet kryekëput me emrin që Grekët u japin shqiptarëve: Arvanitë, Arvanitis, Arvanos. Emërtimi i fundit rrjedh nga një këmbim i përhershëm midis "v" dhe "b" nga njëra anë dhe "c" dhe "g" ose "l" dhe "r" nga ana tjetër. Megjithatë në dialektin "gegë" të veriut të Shqipërisë "r" e dialektit "toskë" të jugut shndërrohet praktikisht në "n". Në rastin e fundit gjejmë emrin e Shqiptarëve:

Arven = Arvenes = Arbën = Arbon

Arbëri = Albëni = Alpëni, prej nga vjen emri "Albanie"

Arbënesh = Arbëresh (Shqiptarët e sotëm të Kalabrisë)

Arvanites (ose...tis), Arvanos (greqisht) = Arvanites = Albanites = Albanoi

I njëjti fenomen i këmbimit ndodh edhe në frëngjisht me fjalët "pelenirage" ose "pérégrination"!

Pesë argumente të tjerë, të shtuara tek analizat e tjera, në një tjetër kapitull të veprës që keni në dorë, e përforcojnë tezën e të qenit nga një trung të kelto-galezëve dhe të Ilirëve (djepi stërgjyshor i tyre është rajoni i Danubit të sipërm) ose gjurmë të huazimeve të kelto-galezëve të bëra tek Ilirët.

Galët, pantallonat e tyre të famshme i quanin "braie"*) (nga rrjedh fjala e jonë "debraille**) dhe frëngjishtja e vjetër "braiel", që do të thotë brezi i braie*)). Mirëpo edhe sot ende Shqiptarët i quajnë pantallonat "brekë , brekushe".

b) Druidët e quanin ujin "uscias", mirëpo në shqip dihet që i thonë "ujë". Megjithatë banorët e Auvergnes e quajnë ujin "ujë" dhe shumësi i saj në shqip është "ujera". Banorët e Auvergnes "uïrre" i thonë verës së ngrohtë që i shtohet ujit të vakët dhe që hidhet një lloj gajdeje për të penguar forcimin e lëkurës!

c) Druidët (në gjuhën gale "druis" dhe në gjuhën irlandeze "drui") bënin pjesë në një shtresë të trashëguar klerikësh, që ushtronin traditat fetare të keltëve, fqinjë të drejtpërdrejtë të Ilirëve në rajonin e Austrisë së sotme dhe në jugperëndim të Gjermanisë. Disa përputhje janë mjaft befasuese. Në të vërtetë "Druis" ka shumë të ngjarë të rrjedhë nga fjala shqip "dru" ose "dushk". Përveç kësaj përputhjeje gjuhësore duhet kujtuar që Pellazgët vendin e shenjtë kryesor të tyre e kishin në Dodonë, në Tesproti (e quajtura në kohë të lashta Pellazgjia), ku gjendej orakulli më i lashtë me zanafillë pellazge të periudhës parahelene. Aty "Selloi" (priftërinjtë e Zeusit) shpjegonin "zërin" e Zeusit falë fëshfëritjes së gjetheve të "lisit të shenjtë". Mirëpo lisi trajtohej prej pjesës më të madhe të kronikanëve antikë si "perëndia fuqiplote" e Galëve. Kjo pemë e

*) *Braie - Lloj veshje disi e ngjashme me brekushet e Shqipërisë së Mesme dhe sidomos tirqit të Shqipërisë së veriut.*

**) *Debraille - Autori e ka fjalën për gjuhën frënge*

shenjtë nderohej në të gjitha krahinat e Galisë. Galët nuk kryenin asnjë rit të shenjtë pa u kërkuar ndihmë gjetheve të lisit. Sipas Plinit të lashtë (Historia e natyrës, XVI, 249) vendi i kultit të Druidëve gjendej në mënyrë të veçantë në drurët e lisave! Për këta, prania e veshtullës në lisa dëshmonte praninë e Zotit të tyre. A nuk ka një lidhje më se të qartë të kulteve të Zeusit në Dodonë dhe riteve kelte të Druidëve?

d) Disa autorë antikë të shekullit III dhe II para Krishtit pohojnë se fqinjët e drejtpërdrejtë të Arvernesve, Eduenët (Burgonjë dhe Morvan), ishin të një trungu me Romakët e hershëm (pa dyshim që bënin aluzion për Etruskët) dhe kishin si zanafillë të përbashkët rajonin e Trojës në Azinë e Vogël. Ata do të kenë qenë Arvernët (Masiv qendror dhe në veçanti Auvergne), pasardhësit e një etnie të trungut pellazg. Janë të dukshme përputhjet gjuhësore që e dëshmojmë këtë gjerësisht.

e) Së fundi, zoti i përbashkët për të gjithë këta galezë është "Teutates", babai i popullit. Tashmë kemi parë që ky emër është tipik ilir dhe se haset në emra të shumtë të përveçëm në të gjitha krahinat e banuara nga Ilirët. Mbretëresha e Ilirisë "Teuta" mori pushtetin në vitin 231 para Krishtit, pas vdekjes së bashkëshortit të saj Agron.

HELENA = E lëna

Bija e Zeusit dhe e Ledas. Gjithsesi një legjendë rrëfen se babai i saj i njohur zyrtarisht ishte Tindari, mbreti i Spartës. Por sipas legjendës më të përhapur ajo ishte gruaja e Menelaut dhe u rrëmbye nga Parisi, biri i Priamit, mbreti i Trojës. Ky do të ketë qenë shkaku i shpërthimit të Luftës së Trojës. Por pas luftës, Menelau duke llogaritur që Trojanët nuk do ta mbanin Helenën u nis për ta marrë në Egjipt. Një tjetër legjendë na thotë se Menelau e rigjeti në Trojë. Por rrëfenja e fundit ishte krijuar vetëm për të shpëtuar sedrën e Menelaut të pafat! Ky fund i Helenës është dhënë në mënyra krejt të ndryshme. Një legjendë tregon se Helena pas vdekjes së bashkëshortit të saj iu bashkua yjeve të qiellit me Dioskurët. Së fundi, sipas një tjetër legjende ajo u bashkua me Akilin

në ishullin e Fatlumëve ose e dëbuar nga Lakedemoni ajo u tërhoq në Rod, ku u var në një pemë me urdhër të mbretëreshës Polikso. Ja pra se çfarë dihet nga kjo Helenë enigmatike. Emri i saj është shumë më pak enigmatik se sa mendohet sepse sipas pellazgo-shqipes shpjegohet me shumë lehtësi: "E lëna" ose "E lana", pra "ajo që braktiset"!

MOLOSËT = Malësor, Malësi

Sipas legjendës "Molosi" është biri i Neoptolemeut dhe nipi i Akilit. Nëna e tij, Andromaka është një robinë trojane, me të cilën Neoptolemi (biri i Akilit) u martua pas marrjes së Trojës. Hermioni xheloze, gruaja shterpë e Neoptolemeut, e përndoqi Andromakën dhe birin e saj. Molosi i dha emrin e tij popullit të Molosëve si dhe vendit të tyre Molosia. Një legjendë me zanafillë greke tregon që nëna e tij u martua me mbretin e Epirit, Helenos (vëllai i vogël i Hektorit) të cilin e pasoi. Gjithsesi malësorët e lashtë, Kaonët, Emathianët dhe Tesprotët rridhnin nga i njëjti trung etnik me ata që në shekullin V para Krishtit u quajtën: Epirotë dhe Maqedonë. Për më tepër, vendi i shenjtë kryesor i kultit dhe ai politik i Pellazgëve dhe i Akilit, "Dodona", gjendej në këtë rajon. Mirëpo emri "Molosë" shpjegohet falë gjuhës shqipe që na zbulon midis të tjerave fakte të ngjashme, pothuajse gjithçka që është fshehur nga Grekët: fjalët "Malësor" dhe "Malësi". Fjala Malësi përkon jo vetëm me emrin e Molosisë së lashtë por edhe me infrastrukturën e saj: "vend malor". Ky popull vendosi mbizotërimin e tij në një pjesë të Epirit prej vitit 430 - 350 para Krishtit, përpara se të kalonin nën kontrollin e Maqedonisë.

MOSQUES = Mushkë

Popull i lashtë i Azisë së Vogël, pranë Frigjianëve dhe Thrakëve. Të lashtët i quanin "Mushki" (Asirianët), Moski (Latinët) dhe të tjerë "Moskhi". Ata përmenden në Bibël me emrin "Mesek". Homeri i cilësonte Frigjianët dhe Thrakët (të dy popuj pellazgë) si "zbutës të

kuajve". Në të vërtetë "mushkë" është një fjalë shqipe që përkon mjaft mirë me fjalën "Mushki".

PELAGONET = Pellg, Pellgjët

Bëhet fjalë për një popullsi thrako-illire që ka banuar në rajonin e liqeneve (Ohër dhe Prespa) në lindje të Shqipërisë se sotme. Parahistorianët dhe arkeologët modernë i kanë lokalizuar fshatra në këtë rajon. Mirëpo pellg në gjuhën shqipe nënkupton një sipërfaqe me ujë. Pra bëhet fjalë për banorë të liqeneve, pellgjeve ose moçalishteve. Shënojmë kalimthi se Pellazgët ishin një popull jo vetëm kontinental por edhe "popull i detit", d.m.th. detar ose "i ujerave". Shënojmë me këtë rast se në Bibël ekziston (Gjeneza,10, 15) një pasardhës i Noes i quajtur "Peleg" dhe për të cilin nuk dihet as edhe një gjë tjetër. Megjithatë Bibla pohon se nga pasardhësit e Noes lindën "popujt e ishujve" (Kreta, Siklada dhe Egje). Është fjala për bijtë e "Javanit", biri i "Jafetit": Elisha, Tarsis, Kitim, Dodamin. Në tri emrat e fundit dallohen ato të Tirsenëve, Kretasve dhe Dardanëve (Gjeneza, 10, 4). Emri i Javan (Jonian?) i kohës së Sargonit II (mbreti i Asirisë prej vitit 722–705 para Krishtit) dhe Ezekiel (profeti hebre që ushtroi detyrën e tij në vitet 593–571) do të ketë emërtuar për herë të parë banorët e ishujve të Egjeut dhe të Siklasës.

PELLAZGËT = Pellagji, Pyllagji, Shpellagji...

Të gjithë autorët antikë janë të një mendimi për t'i trajtuar PELLAZGËT si një popull parahelen, i cili ka banuar në territore që u quajtën më vonë "Heladë" (Greqi) si dhe Ballkan, brigjet perëndimore të Azisë së Vogël, ishujve të Egjeut dhe Italisë. Por fakti më i rëndësishëm sot është se gjuha e lashtë e Pellazgëve mbijeton nëpërmjet gjuhës ilire, tharke dhe së fundi gjuhës shqipe. Të gjithë ata që nuk kanë bërë ndonjë përqasje me këta katër popuj të dalë nga i njëjti trung etnik janë ngatërruar dhe si rrjedhojë janë gabuar rëndë. Në të vërtetë

përveç emrit të Pellazgëve që shpjegohet mjaft mirë (dhe me shumë mënyra përkuese) falë gjuhës shqipe, pjesa më e madhe e etnonimeve, eponimeve, toponimeve dhe emrave të perëndive ose të perëndeshave të Iliadës dhe të Odisesë, të paktën ato të pjesëve të para dhe më të lashta të këtyre poemave, janë të shpjegueshme ose të interpretueshme falë shqipes së sotme dhe jo greqishtes.

Është interesante të vëresh që në çfarëdo mënyrë qoftë, emri PELLAZGË shpjegohet qartë falë gjuhës shqipe, e vetmja gjuhë e mbijetuar nga pellazgjishtja e lashtë. Në të vërtetë emri "PELLAZGËT' shpjegohet në katër mënyra të ndryshme, por që gjithsesi shkojnë drejt së njëjtës pikë: Pellagji ("pellë, Pyll), Shpellagji ("shpellë"), Pelagji ("Pelë") dhe pjellë Argët ("pjella e Argianëve"):

a) Pellagji nënkupton "burra ose njerëz të pyjeve", fjalë e përngjitur që rrjedh nga fjala "pellë" (në dialektin gegë do të thotë pyll) dhe "gji" (njerëzia, njerëz, lloj). Kjo fjalë ka krijuar Pelion, mal në Thesali (vend i mirëfilltë pellazg) i mirënjohur se ka qenë shumë i pyllëzuar. Ja çfarë thotë Homeri në lidhje me "Pelion" (Odiseja XI, 316): "Ata donin të mblidhnin Osan mbi Olimp dhe mbi Osan Pelionin më shkurrnaja të harlisura me qëllim që të ngjiteshin drejt qiellit". "Pelion" formohet nga dy fjalë pellazgo-shqipe "Pellë" dhe "i onë" (Pellë e onë) që do të thotë "pylli ynë", nënkuptohet pylli i Pellazgëve, sepse ishin këta banorët e këtij pylli, të cilët edhe emërtuan kështu.

b) Shpellagji, Shpellash do të thotë "njerëz të shpellave apo të guvave", fjalë e përngjitur që rrjedh nga "shpellë" (shpellë, guvë) dhe nga "gji" (njerëzia, njerëz, gjini, lloj). Kjo fjalë është zanafilla e fjalës "speleologji". Megjithatë ende edhe sot në krahinën e "Matit", në Shqipërinë e Veriut (gegë) "shtëpia" quhet "shpej" si dhe "shpi" në krahina të tjera të Shqipërisë së Veriut (dialekti gegë) dhe së fundi "shtëpi" në Shqipërinë e Jugut (dialekti toskë) Është e qartë që dialekti i veriut përqaset më shumë me pellazgjishten e lashtë. Është interesante të shënosh që një fjalë kaq e lashtë të ketë mbijetuar kaq e gjallë deri në

ditët tona për të emërtuar atë që është shumë e rëndësishme për një qenie njerëzore: shtëpia. Ka edhe fjalë të tjera të tilla si bukë, ujë, [në shqip "ujë"; kjo rrënjë ka dhënë Ujësi = Oasis (Oaz) apo fjala mal !]. Por mbi të gjitha duhet shënuar që "Kuretët", ushqyesit mbrojtës të Zeusit-foshnje ishin banorët e parë të Kretës (të emëruar "banorët e guvave"), të cilës i dhanë emrin e tyre këtij vendi. Ata shpesh ngatërroheshin me "Koribantët" dhe "Daktilët". Sipas legjendës Kuretët, Daktilët dhe Koribantët kishin pasur si vendbanim të parë Malin Ida në Kretë. Aty u lind e u rrit Rea.

c) Pelagji nënkupton "njerëz me pela" ose "njerëzit mbarështues të pelave" ose "mbarështues pelash", fjalë gjithashtu e përngjitur që rrjedh nga "pelë" dhe nga "gji" (njerëzia, njerëz, gjinì). Kjo fjalë ka krijuar një nga kryeqytetet me të shquara të Maqedonisë: Pella. Në të vërtetë të gjitha këto vende, është fjala për Thesalinë, Emathinë (emri i lashtë i Maqedonisë), për Thraken ose Frigjinë, njiheshin për rritjen dhe stërvitjen e kuajve. Shënojmë se të gjitha këto vende ishin vende të trungut pellazg.

d) Pjellë Argët ose pjellë-arxhit që do të thotë "pjella e Argos". Legjenda thotë që mbreti i fundit i kryeqytetit të Argolidës (Argos) ishte Pelasgos. Ky u dëbua nga Danaos Egjiptiani, pushtuesi i vendit. Populli i këtij të fundit ishin Danaenët, të përmendur nga Homeri përkrah Akenëve dhe Argianëve në fushën kundërshtare përballë Trojanëve.

Çfarë lidhjesh ka midis këtyre katër termave? Të katër termat mund të përkojnë krejtësisht me atë që në vijimësi ishin PELLAZGËT: njerëz të pyjeve (racat e para njerëzore ose antropoidët*) jetonin në pyje), njerëz të shpellave (njerëzit që strehën e parë e gjetën në shpella), njerëz mbarështues të pelave, një tjetër përparim i bërë njerëzit e parë mbarështues të kafshëve shtëpiake të tilla si gjedhet, deshët dhe në veçanti kuajt. Mirëpo Pellazgët, Thrakët, Frigjianët, Trojanët ose

*) *Quheshin njerëzit që jetonin në pyje.*

Moskët (Mushki), falë Homerit ne i njohim se kanë qenë "zbutës të kuajve". Së fundi, përparimi i fundit është ai që i takon krejtësisht Pellazgëve si përhapës të bujqësisë, shpikës të ujitjes, ndërtues të qytezave të fortifikuara (mure të quajtura pellazge apo ciklopike ndër të cilat ato të Mikenës, Tirintit ose ai i quajtur "pelargikon", muri rrethues i Athinës), krijues të metalurgjisë, themelues të mbretërive, nismëtarë të qytetërimit. Kjo vërteton gjithashtu praninë e Pellazgëve në Argos, ndër të cilët heroi ose perëndia eponime ishte Pelasgos, mbreti i fundit i Pellazgëve, i cili u dëbua nga pushtuesit Danaenë.

Por është terma e dytë (b) që për mendimin tim përkon më mirë me Pellazgët. Në të vërtetë banorët e parë të Kretës, të cilës i kanë dhënë emrin e tyre, ishin Kuretët [shqip "Ku u rretë", ku rretët (gegë), ku rritët ose "ku u rritë"(toskë), nënkupton Zeusin], njerëzit e shpellave që rritën ZEUSIN - foshnje! Gjithashtu nga emri i Pellazgëve ("Shpellagji") banorë të shpellave, rrjedh edhe emri "shtëpi" në shqip dhe në veçanti shqiptimi në dialektin gegë: shpej (shtëpi, banesë), deformim fonetik dhe reminishencë e fjalës arkaike "shpellë"!

Qysh nga antikiteti emri i Pellazgëve vijon të ngjallë kundërshti të shumta. Është përpjekur t'i gjendet një "etimologji" e volitshme! Straboni dhe Hesikiusi shpjegojnë që ky "popull shëtitës" ka qenë quajtur "Pelargos" nga emri "lejlek", zogj shtegtarë. Disa e kanë përqasur nga ana fonetike me fjalën "Pelagos" që do të thotë "det i hapur", nga pelos ose pellos (i zi) ose argos (i bardhë) sepse Pellazgët mbanin mantel bardhë e zi si dhe nga pelaso (përqas, mbërrij), plaso (endem), pellos, pelios (e përhime), polios (gri) ose palaj, Palas gai (i lindur nga toka). Madje është menduar për fjalën pellazgo-shqipe plak, plakon, plakun. Hesikuisi pohon që Pelagonët do të thoshte "Plak" dhe emërtonte Pellazgët e Maqedonisë së lashtë. Së fundi Armenët (pellazgo-frigjianë), kanë ruajtur fjalën "arg, az-k" (komb, popull), prapashtesë që jep në mënyrë të saktë termin e përdorur nga grekët "pel-asg-os" = popull i shpellave (shpellë - arg + os)!

PERRHEBET = PERRHAEBI, PERRHAIBI = Pelagiotët

Popull i Thesalisë, sipas Homerit (II, 749, 750). Perrhebët dhe Lapidët, në epokën e Strabonit ndanin Pelasgoitidën, d.m.th, luginën e poshtme të Peneas, lumi kryesor i Thesalisë. Sipas Simonidit, Perrhebët ose Perrhaibët e Olimpit janë quajtur "Pelasgiotidë". Në të vërtetë sipas Hekateut të Miletit, Helanikosit të Mitilenit dhe Ptolemeut, Thesalia quhej "Pelasgiotidë".

PHILISTINS = "PLST" = PELESHET = PELISHT... IM = Pelagit

Ky popull duket plotësisht të jetë i trungut pellazg. Vetë forma e emrit të tij është një provë e qartë. Përveç kësaj, autorët antikë pohojnë se Filistinët, të nisur nga Thesprotia (të quajtur në kohë të lashta "Pelasgji" dhe duke filluar nga shekulli V-IV pas Krishtit u quajt "Epir") kishin për bazë "Kretën" përpara se të niseshin të sulmonin Egjiptin dhe ngulimit të tyre përfundimtar në Lindjen e Afërme. Ky emër "Filistin" nuk është gjë tjetër veçse një variant i emrit "Pellazgë": Pelasg ose Pelast për Grekët, Pelishtim për Hebrenjtë dhe Peleset, Peleshet ose Pelast për Egjiptianët (rezultat i shqiptimit të bashkëtingëlloreve PLST), Palastus për Asirianët etj., Megjithatë ne shënojnë se rrjedha e poshtme e Po-së quhej "Filistina fosa" (cf Althaim). Te Sikanët (popull i lashtë i Sicilisë) rigjendet një formë e ngjashme: Palaïstine (cf Ribezzo). Një nga specialistët e kohëve të fundit, historian izraelit T. Dotan, pohon se Filistinët ishin një popull i trungut thrako-ilir.

FRIGJIANË = Frigji, Frikgji

Popull thrako-ilir i trungut pellazg që kanë banuar në Azinë e Vogël. Mbreti i tyre, më i shquar ishte Midas": "Mik dashi" = miku i cjapit ose dashit d.m.th. i "Panit". Në të vërtetë Pani, hyjni e nderuar në veçanti në Arkadi paraqitej me kokë dhe këmbë cjapi dhe me një kraharor leshtor të një njeriu. Sipas autorëve antikë "Brigjët" (popull "thrak" duke kaluar nëpër Azinë e Vogël morën emrin "Frigjianë".

Kjo mund të shpjegohej sipas mënyrës së mëposhtme: katastrofa të shumta (përmbytje lokale, tërmete, shembje...) ndodhën midis viteve 2000 dhe 1500 para Krishtit (ka të ngjarë edhe më vonë) në rajonin e Egjeut. Mirëpo kjo "reminishencë" e katastrofës iu ngjit emrit të Frigjianëve: "Frikgji" ose "Frigji" (Frig ose Frik dhe gji = gjini fisnore) që në shqip "njerëz të frikës", d.m.th. "të shpëtuarit nga përmbysja". Ky do të ketë qenë rasti për "Brigjët": të zënë në panik ata kaluan në bregun tjetër të Helespontit d.m.th. nga Thraka në Azinë e Vogël dhe u quajtën "Frigji".

Herodoti (II, 2) na rrëfen një histori të faraonit Psametik I (663–609) para Krishtit për të mësuar se cili ishte populli më i lashtë në botë: "ai vendosi t`i një linte një bariu dy të sapolindur, fëmijë të zakonshëm, për t`i rritur në stallat e tij në kushtet e mëposhtme: askush - urdhëroi ai - nuk duhet të shqiptojë as edhe një fjalë përpara tyre; ata do të qëndrojnë vetëm në një kasolle të vetmuar dhe në orën e caktuar bariu do tu çojë atyre dhitë dhe do tu jepte qumështin e tyre deri sa të ngopeshin si dhe të gjitha përkujdesjet e nevojshme. Nga këto masa dhe urdhra Psametik donte të kapte fjalën e parë që do të shqiptonin fëmijët kur ata të kalonin moshën e belbëzimeve të pakuptueshme. Dhe kështu ndodhi: gjatë dy viteve bariu kreu detyrën e tij, pastaj një ditë kur ai hapi portën dhe hyri në kasolle, fëmijët u hodhën drejt tij dhe shqiptuan fjalën "bek-os" duke e kapur për duarsh. Kur e dëgjoi për herë të parë këtë fjalë bariu nuk bëri asgjë, por meqenëse sa herë që ai shkonte, ata e përsëritnin pa pushim, atëherë njoftoi zotërinë e tij dhe me urdhrin e tij i shpuri fëmijët përpara tij. Psametiku i dëgjoi fëmijët dhe kërkoi të pyetej se kujt populli i përkiste fjala bek-^{os}: kësisoj zbuloi se kjo fjalë te Frigjianët do të thoshte bukë. Egjiptianët përpara një prove të tillë u përulën dhe pranuan se Frigjianët ishin më të lashtë se ata". Kjo fjalë "bekos" është vërtetuar nga mbishkrimet frigjiane. Megjithatë Hiponaksi i Efesit tregon se kjo fjalë përdorej në Qipro për të emërtuar bukën. Mirëpo edhe 2600 vjet pas kësaj ndodhie egjiptiane

kjo fjalë gjithmonë ka emërtuar "bukën": në të vërtetë Shqiptarët e quajnë "bukë, buka". Nëse fjalës bukë i shtojmë prapashtesën e zakonshme os marrim fjalën "bukos". Rumunët i quajnë disa drithëra ose ushqime "bukate". Baskët dhe Kaukazianët i quanin "vaktet" Bukera - bukra. Shënojmë gjithashtu se qysh nga shekulli XII Frigjianët ndërtuan mbretëritë më të fuqishme, sovranët e së cilës mbanin në mënyrë alternative emrat e Gordias dhe të Midas (emër tipik pellazg). Asirianët i quanin Frigjianët "Mushku", d.m.th. "Moskët", një tjetër popull që rrjedh nga i njëjti trung pellazg dhe shpesh ngatërrohet me Frigjianët. Këta dy popuj ishin të njohur, që nga antikiteti i hershëm si "stërvitës" të kuajve dhe "kalorës" të shkëlqyer. Një fis kaukazian (Kolkida e lashtë përkon me Gjeorgjinë e sotme) gjithmonë ka qenë quajtur në shekullin V "Mes`ki", që nga të gjitha gjasat ngjan të ketë patur zanafillë frigjiane ose "moske". Pushtimi i Çimerëve në shekullin VII e katandisi Frigjinë në principata të vogla që iu bashkëngjitën Lidisë nga Kresusi. Ajo tashmë pati fatin e kësaj të fundit përpara se të binte nën zgjedhën e perandorisë Perse.

THRACES - Trakët, Trashë (të), i trashë

Kjo është një nga dy degët kryesore të Pellazgëve. Traka sipas Strabonit (libri VII) kufizohej nga Danubi në veri, deti Egje në jug, Helesponti në juglindje, në jugperëndim lumi Strimon (nën mbretin Filipi II), lumi Nestos (nën Aleksandrin e Madh) dhe ishte si kufi midis Maqedonisë dhe Ilirisë në perëndim, aty ku kufiri kurrë nuk ka qenë i vendosur mirë dhe i njohur me saktësi. Sipas Herodotit (V, 3): "Pas Indianëve, Thrakët janë populli më i madh në botë. Nëse Trakët do të kishin një prijës të vetëm dhe do të merreshin vesh midis tyre, ata do të formonin një popull të pamposhtshëm dhe sigurisht më të fuqishmin e të gjithëve sipas mendimit tim". Në shqip kemi fjalën i trashë (i fortë, i bëshem, trupmadh = ndjenjë që i përshtatët ma tepër këtij emri) por që në një sens talljeje ka kuptimin i trashë nga trutë, apo e kundërta e kuptimit "i qytetëruar".

Zbukurime ilire të zbuluara në tumulat në Kuç i zi (Korçë), shekulli VIII para Krishtit
(sipas "Shqipëria arkeologjike"- Tiranë - 1971)

AMAZONE = E ma zanë

Legjenda e Amazonave është shumë e ngatërruar dhe madje ngjall shumë kundërshti. Nuk dihet me saktësi vendi i zanafillës së tyre. Spekulimet në lidhje me këtë janë të shumta. Disa i tregojnë me zanafillë nga Kaukazi, por të vendosur në Azinë e Vogël, kryeqyteti mbretëror i të cilit ishte Themiskiri (në brigjet e Termodonit në Kapadokia) dhe

disa të tjerë i nxjerrin nga një rajon që gjendet në perëndim të Egjiptit, të cilin të lashtët e quanin Libia, sidoqë ky emër ishte gjenerik dhe emërtonte Afrikën në tërësinë e saj. Gjithashtu thuhet në brigjet e lumit Tanais në Skithi

Sipas legjendës Amazonat dalloheshin për natyrën e tyre luftëtare dhe ishin të parat që përdorën kavalerinë. Ato e përshkonin Azinë e Vogël dhe viset përreth duke jetuar me plaçkitje, rrëmbime dhe dhunime. Të mbrojtura me mburojë, me një helmetë dhe lëkurë dhish, ato kalëronin në mënyrë të mahnitshme. Ato kishin tmerr nga burrat, por një herë në vit ato bashkoheshin me fqinjët e tyre, Gargarenët vetëm për të shtuar racën e tyre, por foshnjat mashkull ato i vrisnin. Si perëndeshë idhull ato kishin Artemisën. Atyre iu atribuohej themelimi i shumë qyteteve: Efesi, Smirna, Sirena, Mirina, Tiba, Sinopi, Pafos. Mbretëreshat e tyre më të famshme ishin Hipolita dhe Pentesilea. Shënojmë gjithashtu se Amazonat erdhën në ndihmë të Trojanëve kundër Grekëve.

Në lidhje me etimologjinë e emrit të tyre grekët e nxjerrin se rrjedh nga "a mazon": "a" (pa) dhe "mazos" (gji), d.m.th. "pa gji", sepse besonin se ato e prisnin (ose e digjnin) gjirin e djathtë me qëllim që të qëllonin më mirë me hark! Por askund në statujat greke nuk dallohet ndonjë sakatim i tillë. Sipas një burimi armen ky emër do të ketë nënkuptuar "gra të hënës".

Por asnjë etimologji nuk duket e pranueshme. Megjithatë në se futim "testuesin" shqiptar vërehet një farë ngjashmërie me atributet e Amazonave ose të paktën një aspekt të mënyrës së tyre të jetesës: "E ma zanë" në dialektin gegë të Shqipërisë së Veriut, do të thotë "ajo që kap dhe mban të burgosur". Fjala "zanë" rrjedh nga "zanie, zania" d.m.th. grindje, gjullurdi ose robëri. Përveç kësaj emri Hesiona rrjedh nga e njëjta rrënjë: robina! Legjenda të shumta përplasen në lidhje me zanafillën e tyre fisnore. I quajnë bija të Ares dhe të Najadës*) Harmoni ose bija të Afërditës ose bija të Otresë dhe kjo vetë bijë e Ares.

---

*) *Janë hyjni mitologjike të lumenjve dhe burimeve.*

ARTEMIS = Arë të miel

Sipas legjendës më të zakonshme, pranohet për Artemisën (Diana e Romakëve) se është bija e Zeusit dhe e Letos dhe motra binjake e Apolonit. Ajo është Feba rrëzëlluesja (drita hënore), përballë vëllait të saj Apolon-Febusi rrëzëlluesi (drita diellore). Ajo nuk ishte perëndeshë e Hënës por ishte në krye të lindjeve njëkohësisht me Ilithian. Roli i perëndeshës së Hënës ra në Selenë, por në Eleusis ajo trajtohej si bija e Demetrës dhe mbrojtëse e natyrës së egër dhe tokave pjellore.

Etimologjia e emrit të saj mbetet e turbullt madje e errët për pjesën më të madhe të specialistëve. Gjithsesi Grekët kanë menduar ta nxjerrin se emri i saj rrjedh nga një mbiemër (Artemis) që do të thotë "shëndoshë e mirë" ose "me shëndet të plotë" me kuptimin e "asaj që shëron të sëmurët". Të tjerë emrin e saj e bashkëngjisin nga ana fonetike me fjalët "Artemes" (me konstrukt të fuqishëm). "Artamis" i Spartiatëve (ajo që pret, copëton), "arkhox" (ariu) ose "ortix" (shkurta) në kujtim të lindjes së saj në ishullin e Ortigias. Por asnjë etimologji nuk merr parasysh cilësinë e saj, atributet e saj ose karakterin e saj kompleks. Megjithatë gjuha shqipe e shpjegon shumë më mirë se gjuha greke: "Ar të miel" që do të thotë "arë e mbjellë", gjë që na bën të mendojmë për cilësinë e saj si perëndeshë ushqyese. Kjo cilësi përkon krejtësisht me Artemisën e Eleuzit (e shquar për kultin e saj të Demetrës dhe misteret e saj), e trajtuar si bijë e Demetrës (Seres te Romakët), perëndeshë e vjeljeve, e grurit, e begatisë së arave, pjellorisë dhe "kryezonja" e bujqësisë në përgjithësi.

Artemis, perëndeshë e "harkut të argjendtë, Shigjetare, me fizionomi të sigurt dhe perëndeshë e papërlyer" (Homeri) ka qenë fillimisht një Perëndeshë e të ushqyerit, e natyrës, e dëlirësisë dhe e pyjeve. Ashtu si vëllai i saj Apoloni ajo ishte e armatosur me një shportë për shigjetat dhe një hark ("Apollusa". Shkatërruesja). Ajo kishte si simbol një arushë dhe nderohej në Arkadi. Sipas një legjende tjetër, simbolet e saj kryesorë

ishin palma, dreri dhe bleta. E quanin "e virgjëra gjuetare" dhe trajtohej si simboli i rinisë, natyrës dhe e gjuetisë. Ajo zotëronte pushtetin për të përhapur epidemi dhe për të shëruar sëmundjet. Ajo krahasohej me perëndité e tjera që mbajnë emrat: Artemisa e Efesit, Artemisa Tauriane, Artemisa Didtina, Artemis Ortia, Toantea, Hekate ose Britomartis (perëndesha e hënës në Kretë). Ajo ishte gjithashtu perëndesha e njohur e Amazonave të famshme. Fosenët e Marsejës e trajtonin si "kryezonjën" e tyre. Por ajo adhurohej në të gjithë Greqinë (Spartë, Karia, Olimpia, Athina, Egina dhe mbi të gjitha Delos) dhe Azia e Vogël, Kreta, Italia e jugut. Gjatë luftës së Trojës ajo u radhit përkrah Trojanëve. Kjo është ajo çfarë ne dimë për këtë perëndeshë parahelene dhe tipike pellazge.

HERMES = "Err mes (gegë) ose "Err mbys" (toskë)

Hermesi, biri i Zeusit dhe i Majas, lindi në një shpellë të malit Silenë në Arkadi. Hermesi (Mërkuri i Romakëve) është një hyjni pellazge shumë e lashtë me zanafillë thrake (etni pellazge) dhe e nderuar në veçanti nga barinjtë e Arkadisë. Atributet e tij kryesorë janë si më poshtë: perëndia e dymbëdhjetë e Olimpit, korrier dhe kasnec të perëndive të tjera, perëndi e barinjve dhe e mbarsjes së kafshëve, udhërrëfyesi i shpirtrave të të vdekurve deri në banesën e tyre të fundit, perëndi e udhëve, e kufijve dhe e udhëtarëve, padron i tregtarëve dhe i hajdutëve, etj. Por pushtimi dorian e dobësoi disi prestigjin e tij dhe e përpunoi karakterin e tij fillestar. Ja përse atributet e tij janë të shumtë dhe shpesh kontradiktore. Sido që të jetë ai është një perëndi mendjehollë, i shkathët dhe ndihmëtar. Atij i vishet shpikja e lirës.

Disa e nxjerrin emrin e tij me prejardhje nga gjuha vedike "Sarameja", perëndi e stuhisë ose e agimit! Të tjerë e përqasin me fjalën greke "ormi" (ideja e lëvizjes), "erai" (gur, shkëmb), "herma"(grumbull gurësh për të caktuar kufijtë e një vendi) ose nga folja "erionai" (me mbrojt). Përsa i takon gjuhës shqipe, ajo e shpjegon mirë një nga funksionet

fillestare të perëndisë: udhërrëfyesi i shpirtrave të vdekur në banesën e tyre të fundit, d.m.th. për në errësirë. Mirëpo "err mes" në dialektin gegë të Shqipërisë së Veriut kjo do të thotë "ai që vret errësirën", në kuptimin më të gjerë d.m.th ai që ia del mbanë, ai që sfidon errësirën.

Një tjetër fjalë që shoqëron shpesh emrin e Hermesit është ai i Trismegistës (Hermes-Trismegiste) dhe shpjegohet mjaft mirë falë gjuhës shqipe: "kris me gishta" që do të thotë "ai që lëshon tinguj me gishta". Gjithsesi Grekët e shpjegojnë nga ana fonetike emrin e tij me "tri herë më i madh". Por legjenda tregon se Hermesi pasi kishte vjedhur qetë e Apolonit gjeti një breshkë dhe e përdori në vend të arkës së "rezonancës" për të krijuar një lirë edhe me ndihmën e zorrëve që tendosi. Për të përhapur veglën e tij. Apoloni ra në ujdi për të shkëmbyer qetë e tij me lirën, të cilën Hermesi ia dha Apolonit.

HIPOS

Kjo fjalë në greqisht do të thotë kalë. Mirëpo sigurisht që kjo fjalë rrjedh nga fjala pellazgo-shqip "hip". Në të vërtetë për të emërtuar kalin gjuha shqipe ka ruajtur formën më arkaike të belbëzimeve të para të njeriut parahistorik: "kal". Njohja e kalit nga ana e Grekëve është arritur nëpërmjet Pellazgëve (Thrakët, Thesalianët, Frigjianët, Moskët..): tashmë kali ishte kafshë e zbutur dhe shtëpiake, d.m.th. i hipshëm". Pra, Grekët gjatë mbërritjes së tyre në gadishullin do ta kenë emërtuar hip ... os : ai që hipët". Kjo "folje" përfundoi duke u dhënë grekëve "emrin" e kalit ndërkohë që Shqiptarët kanë ruajtur formën e tij arkaike: kal.

HOMERI = O merë, O mirë!

Kjo thirrje admiruese, tipike pellazgo-shqiptare do të thotë "sa bukur, sa këndshëm"! Ky interpretim përmbush tezën e atyre që mendojnë se Homeri kurrë nuk ka ekzistuar, se Iliada dhe Odiseja janë vetëm poema parahelene të kënduara nga brezi në brez nga rapsodë anonimë. Në të

vërtetë ne mund të mendojmë se këta poetë epikë, rapsodë ose këngëtarë popullorë në epokën pellazge (meqenëse të lashtët na thonë se Pellazgët "zotëronin vendin që do të bëhej Greqi, përpara mbërritjes së Helenëve": nuk mund ta anashkalosh këtë pohim të njëzëshëm) kanë përcjellë gojarisht epopetë e lashta që u morën nga Helenët kur ata mbërritën në vendin e Pellazgëve dhe këto epope i përshtatën, i përpunuan dhe më në fund i transkriptuan në gjuhën e tyre duke ruajtur termat dhe emrat që nuk i kuptonin, të tilla si ato të perëndive dhe të toponimeve pellazge. Pra, ata do t`i kenë dëgjuar këta poetë epikë të recitojnë epopetë e tyre dhe njerëzinë që të thërrasë "O merë" (dialekti gegë i Shqipërisë së Veriut, sepse në jug thuhet O mirë)!

LAPITHES = Lap, Lapët, Lap, Labër

Popull parahelen i Thesalisë, e cila quhej Pellazgiotidë dhe ishte një rajon i banuar nga malësorët Perrhebë dhe nga Lapidët. Mbreti i tyre më i shquar ishte Piritosi, biri i Zeusit ose i Iksionit. Kryeqyteti i saj ishte Girton, emër tipik pellazg që ndeshet shpesh në të gjithë rajonet ballkano-egjease, Azinë e Vogël dhe Italinë e Jugut. Piritosi në luftë me gjysmë-vëllezërit e tij Centaurët, i mundi ata. Ata u strehuan në Epir. Emri Lapidë mbijeton ende edhe sot në jug të Shqipërisë. Në të vërtetë një pjesë e banorëve të perëndimit të Epirit verior (në Shqipërinë e sotme) quhen Lab, Labër në dialektin toskë. Por Gegët e Shqipërisë së Veriut i quajnë (Lap, Lapët). Ata kanë ruajtur shqiptimin e lashtë sepse dialekti gegë ishte më i përdorur në kohët e Pellazgëve të lashtë, siç e provojnë dekriptimet e shumta që gjenden në veprën që keni në dorë. Rotacizmi*) i dialektit toskë është më i afërt me Etruskishten, një tjetër dialekt pellazg.

PALAMEDE = Para mendë

Biri e Nauplios dhe i Klimenës (bija e mbretit Katre i Kretës) ky

*) *Term i përdorur në gjuhësi.*

hero karian i luftës së Trojës u akuzua në mënyrë të padrejtë për tradhti nga Odiseja i cili e dënoi me vrasje me gurë. Sipas disave Palamedi (zgjuarsia ose maturia e lashtë, sipas Grekëve) është trajtuar si shpikësi ose përhapësi i të gjithë arteve të qytetërimit. Sipas disa të tjerëve ai do të ketë shpikur faret, gurët e peshës, artet gjimnastikore, diskun, njëmbëdhjetë bashkëtingëlloret e alfabetit (ndër të cilat "Y", që ai e formoi u frymëzua nga fluturimi i patave të vendosur në formën Y), astronominë dhe për të ndihmuar që të kalonin kohën përpara Trojës lojëra të ndryshme. Emri i tij shpjegohet nëpërmjet gjuhës shqipe Para mendë që do të thotë "para mençuri" ose "përtej mençurisë" (Paramendim).

PAN = Tan

Kjo perëndi (e shpërfytyruar me kokë dhe këmbë cjapi), e nderuar në veçanti në Arkadi (zonë e lashtë pellazge), fillimisht është trajtuar si roje i bagëtisë së imët (dhitë dhe deshët) dhe mbrojtës i barinjve. Gjatë periudhës klasike ai u nderua në të gjithë Greqinë nën atribute të reja: Perëndi e mbarsjes dhe e fuqisë seksuale, shërues, profet dhe mbi të gjitha shpikës i fyellit baritor (Sirinksi). Nën ndikimin e filozofisë neo-platoniane ai u shoqërua me konceptin e pjellorisë gjë e që e bëri perëndi "tërësore" pothuajse universale, të cilën Grekët e emërtojnë nën formën "Pan", d.m.th. "gjithçka". Pikërisht ky, është një shtrembërim "fonetik" i pellazgjishtes "Tan" (gegë) që do të thotë "gjithçka". Kjo "rilindje" e perëndisë nën atributet e reja është tipike greke dhe ngjitet deri në epokën në të cilën u shfaqën Helenët. Përveç kësaj, kulti i lashtë i Panit ka qenë për një kohë të gjatë i kufizuar në malësitë e Arkadisë dhe vetëm në epokën e luftërave medike (pak para betejës së Maratonës), ai depërtoi në Atikë. Ai arriti të "adhurohej" në të gjitha rajonet e Greqisë. Pani i Thesalisë u quajt "Ariste" (shumë i mirë) dhe ai i Misisë në Azinë e Vogël, u quajt "Priape". Pindari në lidhje me këtë na thotë: "Aristea u soll pas lindjes nga Hermesi të Gaea dhe Horët, të cilat e

ushqyen me nektar dhe ambrozi*) dhe e shndërruan në Zeus, perëndi e përjetshme dhe në Apolon, perëndi, mbrojtës i kopeve, i gjuetisë dhe kullotave. Kjo legjendë më bën të mendoj për Eduard Shnaider që e ngjiste Panin deri në epokën e mbretit frigjian "Midas" (Frigjianët flisnin gjuhën e Pellazgëve: "Mik dash ose dashi" kur do të jetë zhvilluar një garë midis Panit, satirit Marsias dhe Apolonit që ishte bërë bari i Admetit (mbreti i Ferës në Thesali) pasi u dëbua nga Zeusi. Midas u caktua si arbitër për këtë garë fyejsh. Si rrjedhojë garës së hapur kundër Apolonit nga dy barinj të tjerë, Midasi u habit apo u befasua nga rezultati, do të ketë pyetur njerëzit e tij në gjuhën e tij, pellazgjishten: "A po luan tan me arsye", d.m.th në gjuhën pellazgo-shqipe: "A kanë luajtur me arsye apo ashtu si duhet?". Nga kjo frazë, sipas Shnaiderit, u nxorën emrat e tre barinjve dhe gjithashtu konkurrentë: Apoloni (A po luan), Pan (Tan) dhe Marsias (me arsye)! Midas do të ketë patur një mendim të pagjykuar mirë që e shpalli Marsiasin si fitimtar. Ky vendim do ta ketë zemëruar Apolonin, i cili do t`i ketë shtyrë Midasit "vathët e gomarit". Duke mos njohur emrat e tyre të vërtetë, vetëm epitetet e tyre kanë mbijetuar falë kësaj fraze të famshme të Midas!

Nëse ky pohim vërtetohej, këto epitete dhe në veçanti ai Apolonit, do të datonin në Epokën e Midas, d.m.th. rreth fundit të shekullit VIII. Pra kjo datë do ta bënte Apolonin një perëndi mjaft të vonshëm edhe ka të ngjarë të të njëjtës epokë me Dionisin! Kjo do të përkonte me kolonizimet e para greke të bregut lindor të Azisë së Vogël dhe do të përkonte me pjesët më të vonshme të Iliadës, të cilat janë shtuar ose janë përzier me "Zemërimin e Akilit" (pjesa më e lashtë e poemës ku gjenden pjesa më e madhe e përputhjeve gjuhësore, të cilat rrjedhin nga "pellazgjishtja"). Kjo datë përkon njëkohësisht me pushtimin e vendit të shenjtë të Pitos (i bërë me këtë rast "Delfi") nga Apoloni dhe me shfaqjen e "sundimit të kultit patriarkal" i cili zëvendësoi atë

*) *Është ushqimi i perëndive të Olimpit, i cili i bën ata të pavdekshëm.*

(matriarkal) të Pellazgëve autoktonë (tokë tonë!), të nënshtruar apo të mundur nga Helenët e parë. Gjithsesi një gjë është e sigurt, Apoloni në Iliadë merr kryekëput anën e Trojanëve! Kjo do të provonte përafërsinë e tij etnike me një popull të Azisë së Vogël i cili do t`i jepte më shumë qëndrueshmëri legjendës së Midas, ajo e fundit të shkulit VIII para Krishtit. Përveç kësaj ai shpesh mban epitetin "Lisian"! Homeri shpesh bënte aluzion për talentet e tij prej "muzikanti"! Çfarë ngjashmërie me legjendën e Midas!

Çdo themelim qyteti, përveç Greqisë kontinentale, duhej pa tjetër të merrte miratimin e Delfit, vendi i shenjtë i Apolonit! A nuk del edhe një herë vërtetimi i pushtimeve të mëdha greke të Azisë së Vogël (Troadë) në shekullin VII para Krishtit?

Apoloni trajtohej nga Grekët si një gjeni artist i vendit të tyre dhe simboli i bukurisë, rinisë dhe përparimit. Por ka të ngjarë që kjo ka qenë marrja nga ana e Grekëve e një perëndie të lashtë parahelene të quajtur Apolon, siç na e zbulon kjo legjendë e famshme e Midas. Por historia e Apolonit është e ngatërruar me imazhin e historisë greke!

APOLLONI sipas legjendës të pranuar në përgjithësi, është një nga dymbëdhjetë perënditë e Panteonit të mitologjisë. Ai është bir i Zeusit dhe i Letos (Latone te Latinët) bija e Febës (hëna) dhe Keos (mençuria) dhe lindi (i lindur para kohe, shtatë muajsh) në Delos, ku u ushqye me nektar dhe ambrozi nga Perëndesha Temis. Ai është vëllai i Artemisës. Sipas Homerit, i cili e cilëson "shkatërrimtari", ai do të ketë lindur në Lisi (i quajtur Lisigjeni). Por Efesianët mburren duke e nxjerrë se ka lindur në Ortigia pranë Efesit (Taciti, Analet III, 61).

Pra, pak pas lindjes së tij (perënditë rriten shpejt !), brenda disa ditësh ai u bë adoleshent dhe u pajis me një shportë shigjetash dhe shigjeta dhe u nis me karrocën e tij për në vendin e Hiperboreanëve (Delos ishte qendra e një kulti shumë të lashtë hiperborean) ku qëndroi një vit. I bukur dhe joshës ai pati aventura të panumërta dashurish, me nimfa të shumta ndër të cilat Koronis, e cila i dha një djalë Asklepion

(Eskulapi); Aria i dha Miletosin; Sirena që i dha Aristenë: Evadne që i dha Iamosin (perëndi e shquar dhe prijës i Jamidëve të Olimpit); Melia që i dha Ismenosin: Driopea që i dha Amfisosin, i cili themeloi qytetin e Oetas dhe të Kreusas, bija e Erekteut (mbret i Athinës) e cila u bashkua me Apolonin në një shpellë për të lindur Jonin, stërgjyshi i Jonëve.

Në Delfi, si i thonë një fjale, ai filloi karrierën. Jo larg prej aty, në një shpellë të Parnasit, ai vrau gjarprin Piton. Ky i fundit ishte një mostër që para lindjes së Apolonit kishte përndjekur nënën e tij Leto, e cila u strehua në Delos (ishull grek emri i të cilit shpjegohet falë gjuhës shqipe: "diell").

Në Delfi fillon edhe historia helene. Paralelizmi mund të duket befasues, por në këto legjenda, të cilat në të vërtetë nuk janë gjë tjetër veçse një histori e vërtetë por e poetizuar ose e romanizuar, mund të lexohet shpesh me qartësi dhe nganjëherë drejtpërdrejt historia e ngjarjeve që ndodhën gjatë pushtimit të vendit të Pellazgëve nga Grekët. Në të vërtetë Apoloni zuri vendin e shenjtë të Pitos (i vetmi emër që njihte Homeri) kushtuar Perëndeshës – Mëmë ose Delfinë në aspektin e saj profetik. Përveç kësaj legjenda e Titios, sipas së cilës ai përpiqet të dhunojë Leton, nënkupton një kryengritje të dështuar të malësorëve të Fosidas kundër pushtuesve. Ky mit të kujton dhunimin e Demetrës nga Poseidoni gjatë pushtimit të Athinës nga populli i Poseidonit dhe poshtërimin e perëndeshës pellazge. Sipas Robert Grave, fitoret e Apolonit mbi Panin dhe Marsian përkujtojnë pushtimet helene të Frigjisë dhe të Arkadisë si dhe zëvendësimin e instrumenteve me tela në këto rajone, me përjashtim të fshatarëve. Në Delfi, pushtuesit Helenë shkatërruan gjarprin e orakullit të shenjtë (Pitonin) dhe vendosën aty kultin e perëndisë së tyre, Apolon Sminthiani (Apolon – mi, epitet që duket se ka lidhje me një kult semito-kananean). Ky i fundit pa dyshim që ishte themeluesi i Delfit, të cilit Homeri, nuk ia njihte emrin. Në të vërtetë ky Apolon Smintheios (nga "miu") kishte si simbol një mi-shërues, ashtu si Esmuni, perëndia shëruese kananeane. Pushtuesit

helenë e përshtatën për të identifikuar Apolonin, Horus hiperboreanin. Miti i Pitonit që përndiqte Leton është i ngjashëm me atë të Setit që përndjek Isisin. Në të vërtetë Apoloni hiperborean do të ketë qenë një Horus grek. Shënojmë që Dorianët dhe Miletianët pretendonin se Apoloni ishte stërgjyshi i tyre, të cilin ata e nderonin me përkushtim. Krijimi i legjendave të reja (tipike greke) dhe gjeneanologjitë e ndryshme pasqyrojnë në mënyrë të përpiktë themeluesit e parë të qyteteve greke, të kolonive të tyre si dhe shfaqjen e etnonimive të para dhe eponimive të para greke: këtu, me që ra rasti, bëhet fjalë për Miletos (Milet), Sirenën (Sirena në Libi), Iamos dhe të tjerë Amfisos..!

Atributet e Apolonit janë të shumta dhe të ndërlikuara. Ai para së gjithash është perëndi e dritës dhe e diellit. Gjithashtu është perëndi apo hyj i profecisë. Përveç kësaj ai është krahasuar me perëndinë diellore asiro-babilonase "Shamash ose Shamas" ("dielli" në gjuhën semitike), e cila gjithashtu zotëron këto dhunti. Ai gjithashtu është njëherësh perëndia bari dhe perëndia muzikant, perëndi e këngës dhe e lirës si dhe perëndi e ndërtimit dhe kolonizimit . Në lidhje me pikën e fundit, Kalimaku na sqaron disi: "Apoloni pëlqente ndërtimin e qyteteve, ku ai i ndërtonte vetë themelet".

Disa e trajtojnë atë si një perëndi diellore të ardhur nga Azia perëndimore (Azia e Vogël, Lindja e Afërme), disa të tjerë e trajtojnë si një hyjni hitite dhe, së fundi, të tjerë si një perëndi fushash me zanafillë nga veriu i Greqisë dhe perëndia kryesore e Dorianëve. Fatkeqësisht për mbështetësit e doktrinës nordike të zanafillës së Greqisë asgjë nuk bën të mundur ta vendosësh zanafillën e Apolonit në veri të Europës: as lindja e tij, as atributet e tij dhe as pjesa më e madhe e legjendave që lidhen me të.

Shihet mirë që figura e Apolonit si dhe atributet e tij janë të vështira për tu përcaktuar dhe, për më tepër, janë në kundërshti me njëra-tjetrën: kundërshtitë janë të tilla sa ato krijojnë kontradikta shumë të qarta. Vetë emri i Apolonit nuk ka mundur deri më sot të gjejë një etimologji

të sigurt. Homeri e cilëson "shkatërruesi". Emrit të tij i bashkëngjitet një folje e vjetër (Apello) që do të thotë "largoj, shtyj" ose rrënja "abol" që do të thotë mollë, ose i bashkëngjitet një formë e lashtë e foljes "me shkatërrue" (Apollumi ose Apollunai), çka është edhe etimologjia e pranuar më gjerësisht. Disa autorë modernë e përqasin emrin e tij me fjalën anglisht "Apple" (mollë) duke e bërë një perëndi zanafillore të "pemishteve të mollëve"! Gjithsesi legjenda e Apolon-Pan-Marsias-Midas nuk është edhe aq absurde sa mendohet.

PARIA =Parë, Para

Kjo nimfë u bashkua me Minosin. Bijtë e saj kolonizuan Parosin dhe më pas si rrjedhojë u vranë nga Heraklesi. Grekët e quajnë "e lashta". Kjo fjalë ngjan se më saktë rrjedh nga fjala e rrënjës shqipe "parë", pra ajo që krijoi "e para" apo "stërgjyshja". Sunduesja e parë e Minos?

OPHION

Përpara GJITHËSISË ishte Kaosi dhe nga ky Kaos vërshoi krejt e zhveshur EURINOMA. Sipas legjendës ajo lindi nga bashkimi i Oqeanit dhe Tetis. Kjo ishte krijesa e parë në një gjithësi ku nuk kishte as perëndi dhe as priftërinj. Në një botë ku femra sundonte mbi burrin dhe ku ekzistonte vetëm një perëndeshë universale. Era, gëlltitja e fasuleve ose e një insekti (të gëlltitur pa dashje), trajtoheshin si elementet e parë krijues. Burri mbeti në hije, në një rol dytësor dhe trashëgimia kalonte nëpërmjet linjës së nënës (ngjashmëria me shoqërinë matriarkale të Pellazgëve parahelenë). Gjarpërinjtë trajtoheshin si mishërimi i të vdekurve.

Eurinoma ndau Detin nga Qielli dhe vallëzoi hareshëm ndër valët. Ajo u bashkua me Titanin OFION dhe bashkë me atë mbretëroi mbi Olimp përpara shfaqjes së perëndive. Kur aty mbërritën Kronosi dhe Rea si dhe vargu i tyre i perëndive, ata i dëbuan dhe i hodhën në det

ose, sipas një version tjetër, në Tartar (Terr-Terr). Por Zeusi do ta ketë joshur dhe do ta ketë bërë nënë të Karitëve (Grakët) dhe perëndilumë Azopos. Rrethanat e këtij takimi kanë mbetur të panjohura. Për Grekët, Eurinoma (udhëtarja e madhe) ka qenë emri i perëndeshës po aq sa edhe Hëna e dukshme. Gjuha pellazgo-shqipe e interpreton me "Vashëza e mirënjohur" (E RE ME NAM).

Një tjetër version i kësaj legjende është lidhur me mitin pellazg të krijimit të botës dhe ky OFION apo BORE i famshëm nuk ishte gjë tjetër veçse gjarpër dhe ka të ngjarë mishërimi i tij. Versioni i fundit tregon se Eurinoma ndërkohë që valëzon ndër valët e detit drejtohet nga jugu dhe duke bërë këtë rrugë ndeshi dhe u njoh me erën. Ajo u kap nga kjo erë e veriut, u fërkua ndër duart e saj dhe ja ku u shfaq gjarpri Ofion. Ky për të përmbushur dëshirat e saj, u rrotullua përreth gjymtyrëve të saj hyjnorë dhe u bashkua me të. Kështu era e veriut e quajtur edhe Borea u bë mbarsëse dhe ja përse pelat kthejnë vithet ndaj erës dhe lindin mëzat pa ndihmën e asnjë hamshori (cf. Plini, Historia e natyrës IV, 35 VIII, 67 - Homeri XX, 223). Në të njëjtën mënyrë Eurinomea u bë nënë. Pastaj, duke marrë formën e një pëllumbi, ajo klloçiti mbi dallgë dhe bëri Vezën Universale. Ajo i kërkoi Ofionit të rrotullohej shtatë herë rreth vezës derisa të ngrohej dhe të hapej për të lindur fëmijët e saj: diellin, hënën, planetët, yjet, tokën me malet, lumenjtë, pemët, bimët dhe të gjitha gjallesat (cf Apoloni i Rodit - Argonautët / I 496, 505 - tzetzes/Likofron, 1191).

Eurinoma dhe Ofioni zgjodhën Olimpin si vendbanim të tyre. Por duke parë Ofionin që mburrej se ishte krijuesi i universit, Eurinoma e zemëruar i shtypi kokën me thembrën e saj, i theu dhëmbët dhe e dëboi në thellësitë e tokës. Pastaj ajo krijoi shtatë planetë të fuqishme (Diellin, Hënën, Marsin, Mërkurin, Jupiterin, Venusin, dhe Saturnin) dhe u veshi respektivisht perënditë dhe perëndeshat e reja, si më poshtë: Teia dhe Hiperioni, Feba dhe Atlasi, Dione dhe Kriosi, Metisi dhe koeosi, Themisi dhe Eurimedoni, Tetisi dhe Oqeani dhe së fundi

Kronos dhe Rea. Por njeriu i parë ishte PELASGOSI që lindi në Arkadi. Njerëz të tjerë e pasuan, të cilëve ai u mësoi të ushqeheshin me lende lisi, të prisnin rroba prej lëkure dhe u mësoi artin e ndërtimit të kasolleve (Homeri, Iliada, V, 898 - Apoloniosi i Rodit, II 1232 Apollodori I, 1, 3 - Hesiodi, Teogonia 133 - Aristofani, Zogjtë, 692) etj. Sipas Athenesë (XIV, 45, 639, 640) Pellazgët të lindur nga Ofioni, që ishte një Pelor, ushtronin flijimin e "Peloria". "Pelor" rrjedh nga fjala pellazgo-shqipe "Pjellor".

Legjenda e Eurinomas dhe e Ofionit, bashkangjitur argumenteve historike dhe gjysmë legjendare, analizave kritike të teksteve të lashtë dhe mbijetesën e një gjuhe që rrjedh drejtpërdrejt nga gjuha e lashtë pellazge, në këtë rast gjuha shqipe, provon lashtësinë dhe vërtetësinë historike të PELLAZGËVE si dhe epërsinë e elementit pellazg në ndërtimin e qytetërimit helen. Është e pamohueshme që Grekët kanë huazuar nga ata, që i gjetën në këto vise, emrat e perëndive, perëndeshave, heronjve si dhe emra vendesh, të cilat i transkriptuan

Muzeu arkeologjik dhe etnografik - Tiranë

në gjuhën e tyre ashtu siç mundën dhe duke mos pasur mundësi t'i kuptojnë e interpretojnë ato nga ana fonetike sipas gjuhës së tyre, greqishtes. Për më tepër, Herodoti na thotë se Pellazgët nuk i emërtonin hyjnitë e tyre me emra të përveçëm. Në të vërtetë pohimi i historianit të madh vërteton se: pjesa më e madhe e emrave të zbuluar nga Iliada dhe Odiseja si dhe nga Teogonia e Hesiodit janë vetëm epitete për të emërtuar cilësi morale ose fizike. Ja disa shembuj tashmë të përmendur në veprën që keni në dorë dhe që kanë të bëjnë pikërisht me "Mitologjinë" të mbiquajtur greke:

Zeus = Za, zëri.
Thalia = Tallia (përqeshje). Musë e "Komedisë" !
Akili = Aq i lehtë - Aspeitos = A'shpejt .
Agamemnoni = E ka menue (gegë: ai që e ka menduar), Menelau = Men e la (gegë: ai që ka humbur arsyen, si pasojë e rrëmbimit të Helenës).
Uliksi, Odiseja = Udhësi, Udhëtar.
Laerti = Le urtë.
Ajaks = Gjaksi, gjakësor.
Priam = Pri Jam: jam prijësi.
Enea = E neu (gegë: ai që kuptoi.. "kauzën" trojane).
Penelope = Penë e lyp (ajo që kërkon fill).
Thallie = tallje
Telemak = Te leu mec (të ka lindur djalë).

Homorafet dhe Homofonet te Homeri.

Te Iliada dhe Odiseja unë kam zbuluar njëqindenjëzetenëntë (129) emra të përveçëm dhe toponime që kanë saktësisht të njëjtën ortografi (homografe) dhe të njëjtin shqiptim (homofone). Këta emra, që shkojnë nga dyfish deri në pesëfish, gjenden njëherësh te Trojanët dhe te Akenët

(Danaenët ose Argianët). Mirëpo ato janë përmendur gjashtëdhjetë e pesë (65) herë te Trojanët dhe gjashtëdhjetë e katër (64) herë tek Akenët.

Ndër këto 129 herë, tetëdhjetë (80) janë të dyfishta, pra të barabarta ndër të dy fushat (2 x 40): njëzet e shtatë (3 x 9) janë të trefishta, ndër të cilat gjashtëmbëdhjetë te Trojanët dhe katër te Akenët, dhjetë janë të pesëfishta (5 x 2) ndër të cilat gjashtë te Trojanët dhe katër te Akenët. Pra në total gjashtëdhjetë e pesë herë (65) për Trojanët dhe gjashtëdhjetekatër herë (64) për Akenët.

Këto antroponime dhe toponime në pjesën më të madhe mbeten ekuivoke sepse gjenden në të dy kampet dhe të çorodisin për më tepër se shpesh ato kanë dalë nga gjuha pellazge (emra të shpjegueshëm falë gjuhës së sotme shqipe dhe jo gjuhës greke). Në këtë studim shumë terma kanë të bëjnë me heronjtë më të shquar të Iliadës, ndër të cilët Akili dhe Menelasi te Akenët ose Hektori te Trojanët. Në të vërtetë një nga kuajt e Akilit quhet "Pedasos" dhe me këtë emër emërtohet edhe një "qytezë" në Troadë si dhe një tjetër në Meseni. "Ksantos" është njëherësh emri i një kali të Akilit dhe emri i kalit të Hektorit dhe gjithashtu i një luftëtari trojan. "Podarge" është njëherësh emri i një kali tjetër të Hektorit dhe i kalit të Menelaut si dhe emri i një shtrige që lindi kuajt e Akilit. Dhe së fundi, emri "Selleis" është njëherësh emër i një lumi të Thesprotisë dhe një lumi të Troadës. Në të njëjtën mënyrë "Ahelos" është emri i një lumi që gjendet midis Etolisë dhe Akarnanisë dhe emri i një lumi të Azisë së Vogël (pranë malit Sipila, në Lidi).

Në një tjetër kapitull do të shohim sa të shumta janë ngjashmëritë midis toponimeve pellazge, gjeografikisht të largëta nga njëra tjetra gjenden të shpërhapura në të gjithë hapësirën mesdhetare, Ballkan, Azi e Vogël, Iberi, vendin e lashtë të Kanaanit, Palestinë, madje Indi dhe në Azinë juglindore.

Përveç të gjithë këtyre emrave të përbashkët si për Trojanët dhe për Akenët të jepet mundësia të vëresh se "hyjnitë" Pellazge te Homeri gjenden në të dy kampet e kundërta dhe se perëndia e tyre e përbashkët

është Zeusi "dodonas dhe pellazg" (Iliada XVI, 233, 234). Mirëpo Dodona gjendet në Tesproti, e cila në kohë të lashta quhej "Pellazgji". Nga ana tjetër lumi homerik "Selleis" (Iliada II, 659, xv, 531), i cili sipas Homerit rridhte në Tesproti përqaset me "Selles", interpretuesit e orakullit të Zeusit në Dodonë (Iliada XVI, 234, 235). Mirëpo ky rajon i Epirit quhet "Souli ose Suli" (çka përqaset me Selleis ose Sellët), prej nga kishte zanafillën një nga heronjtë e pavarësisë greke, Marko Boçari me zanafillë epiro-shqiptare d.m.th. "suliotë".

Përveç kësaj, në një kapitull tjetër tashmë unë kam kryer një studim gjuhësor krahasues në lidhje me antroponimet, eponimet dhe emrat e hyjnive prej nga del që midis të tjerave, emrat e dy heronjve më të shquar të epopeve homerike shpjegohen falë gjuhës shqipe dhe jo asaj greke. Në të vërtetë Aspeitos (i quajtur kështu nga bashkatdhetarët e tij tesprotë) ka dalë nga pellazgjishtja e lashtë "Ash`shpeit" që do të thotë "i shpejti" epiteti ("Akili këmbëlehti, i shpejti") i përdorur tetëmbëdhjetë herë nga Homeri. "Akileus" është emri që i kanë veshur Grekët, gjithashtu i shpjegueshëm me anë të gjuhës shqipe ("aq i shpejtë, aq i lehtë"). Përsa i takon Uliksit, emri i tij tek Odiseja është "Odhyseus" që në shqip do të "udhëtari" apo "udhësi". Përveç kësaj nga toponime të ndryshme, më shumë se njëqind emra të mitologjisë së mbiquajtur greke, janë të shpjegueshme falë gjuhës shqipe.

Nën dritën e këtyre të dhënave të reja nga të gjithë mund të parashtrohej pyetja e mëposhtme: nëse Zeus Dodonasi si dhe të gjitha etnitë e tjera të një trungu (Trojanët, Frigjianët, Dardanët, Ilirë apo Thrakët) kishin dalë nga i njëjti trung pellazg dhe meqenëse edhe vetë Grekët e pranonin si një popull që kishte qenë para tyre nder viset që "do të bëhej Greqia", atëherë, kush dreqin ishin këta Grekë? Helenët nuk ka mundësi të rrjedhin nga Pellazgët sepse këta të fundit ishin një popull barbar dhe nuk flisnin gjuhën greke (cf Herodoti VIII, 44; I, 56 deri 58; II, 50 deri 54; VII, 94, 95). Duke lënë mënjanë Jonianët që ishin Pellazgë të kthyer në Helenë, të cilët përdornin gjuhën e këtyre

të fundit (cf Herodoti VIII, (44/I,56,57), ata (Helenët) mund të ishin veçse populli pushtues i vendit të Pellazgëve. Pasi u nënshtrua nga Helenët vendi përfundoi duke u quajtur përfundimisht Heladë. Është ky pushtim (dhe jo lufta hipotetike e Trojës e zhvilluar në shekullin XIII dhe XII!) që lidhin njëherësh me Iliadën e dytë (ajo e pushtimit të Troadës, e kthyer në Eolidë në shekullin VII dhe ajo që është zhvilluar midis fiseve pellazge në një epokë të hershme) si dhe Odisesë (ajo e shekullit VIII e konkretizuar me kolonizimin e rajoneve perëndimore të Greqisë, Korkyras dhe jugut të Italisë). Megjithatë në Iliadë dhe Odise nuk bëhet asnjë dallim midis Trojanëve dhe Akenëve. Krijohet përshtypja se bëhet fjalë për një popull të vetëm: Homeri (ose logografët e mirënjohur) përdori një legjendë të lashtë pellazge që e mbivendosi ndaj një më të vonshme, e cila ka të bëjë me pushtuesit e parë grekë (Akenët dhe Danaenët), të cilët më vonë do të mbanin emrin Helenë. Në të vërtetë Homeri nuk e njihte emrin dhe qytetërimin e tyre sepse ata u shfaqën vetëm pas tij.

Të gjitha këto ndërlikime të ndryshme dhe këto stërhollime të emrave pellazge dhe shpjegimi i tyre falë gjuhës shqipe provojnë se Helenët kur mbërritën gjetën aty një popull autokton, i cili kishte gjuhën e tij, kulturën, heronjtë, mitet dhe kozmogoninë e tij, të cilat ishin krejt të ndryshme nga të tyret. Pra ata kanë "përzier" kulturën e tyre me këtë trashëgimi parahelene, pa arritur të kapnin kuptimin e saktë të huazimeve të ndryshme të tyre. Ato përdorën epopetë e lashta dhe të shquara pellazge për të krijuar të tjera, të cilat i kanë transkriptuar në gjuhën e tyre dhe të cilat i kanë përshtatur në pushtimet e para të tyre. Ja përse Iliada dhe Odiseja nxjerrin mjaft kundërshti dhe paraqesin shumë kontradikta, gabime historike dhe anakronizma, pa folur për manipulime ose manovra të tjera të dyshimta dhe mbi të gjitha për krijimin e një morie gjeneanologjish, heronjsh eponimë dhe të dhëna tërësisht të falsifikuara, të destinuara për të ngatërruar pistat dhe për t`ia veshur lavdinë e së kaluarës të Pellazgëve, për t`i dhënë lavdi

historisë së tyre (që po lindte) dhe për të shtyrë që të besosh lashtësinë e popullit grek në të gjithë rajonin nga veriu i Greqisë kontinentale deri në Kretë dhe nga Korfuzi deri në Azinë e Vogël. Vepra që keni në dorë i heq mistifikimin historisë greke dhe sjell një sqarim të ri.

Ja një skemë shembull i emrave të përsëritur shumë herë nga Homeri në veprën e tij Iliada (me germa) dhe Odiseja (me thonjëza).

Ahelou = lumë në Greqi midis Etolisë dhe Akarnanisë.
" = lumë i Lidias.
Adraste = mbret i Argos dhe Sikonës.
" = biri i Meropsit, prijës trojan.
" = luftëtar trojan i vrarë nga Patrokli.
" = " i zënë nga Menelau dhe i vrarë nga Agamemnoni.
" = luftëtar trojan i vrarë nga Patrokli.
Adrastrea = qytet i Misias.
Agelaos = biri i Fradmonit, luftëtar trojan i vrarë nga Diomedi.
" = biri i Damastorit, mtonjës i Penelopës (Odiseja).
Alastor = luftëtar pilian.
" = luftëtar lisian i vrarë nga Uliksi.
Amfion = luftëtar epean.
" = bir i Zeusit dhe Antiopës (Odiseja).
Antifate = luftëtar trojan i vrarë nga Leonteusi.
" = mbreti i Lestrigonëve.
" = bir i Melampusit, baba i Oikles (Odiseja).
Antifos = biri i Thesalosit.
" = biri i Talamenit dhe perëndeshës së liqenit Gigea (Meonianë).
" = biri i Priamit .
" = shok i Uliksit, bir i Egjiptos (Odiseja).
" = itakas, mik i Uliksit.

Aretos = bir i Nestorit (Odiseja).
" = luftëtar trojan.
Kromios = bir i Neleas, Piliani (Odiseja).
" = biri i Priamit.
" = luftëtar lisian.
" = " trojan i vrarë nga Teukrosi.
" = " lisian.
Deukalion = biri i Minosit, baba i Idomenës.
" = luftëtar trojan i vrarë nga Akili.
Elatos = luftëtar trojan i vrarë nga Agamemnoni.
" = mtonjës i Penelopës i vrarë nga Eumedi.
Efiri = qytet në Tesproti.
" = emër i lashtë në Korint.
Euridamas = fallxhi trojan.
" = mtonjës i Penelopës (Odiseja).
Hipodami = gruaja e Piritosit.
" = hërbëtore e Penelopës (Odiseja).
" = bijë e Ankisës, gruaja e Alkathos.
Hipotosi = bir i Lethosit, prijës i Pellazgëve.
" = biri i Priamit.
Likurgu = biri i Driasit.
" = mbret i Arkadisë.
Melanip = luftëtar aken.
" = luftëtar trojan.
" = " "
" = " " , bir i Hiketaonit.
Oenomaos = luftëtar aken i vrarë nga Hektori.
" = " trojan i vrarë nga Idomeni.
Oilea = babai i Ajaksit dhe Medonit.
" = luftëtar trojan i vrarë nga Agamemnoni.
Oresti = biri i Agamemnonit.

" = luftëtar trojan i vrarë nga Hektori.
" = " " i vrarë nga Leonteusi.
Orsiloku = " aken.
" = " trojan.
" = bir i Idomenës (Odiseja).
Pedasos = qytet i Mesenisë.
" = " i Troadës.
" = kali i Akilit.
Pisandri = luftëtar trojan i vrarë nga Agamemnoni.
" = " " i vrarë nga Menelau.
" = prijës mirmidon, bir i Maemalos.
" = mtonjës i Penelopës (Odiseja).
Podarge = kali i Hektorit.
" = shtriga që krijoi kuajt e Akilit.
" = kali i Menelaut.
Selleis = lumë i Troadës.
" = " i Thesprotisë.
Selles = interpretues pelazg të Zeusit në Dodonë.
Teba = qytet i Silisisë.
Tebes = qyteti i Beotisë (Odiseja).
Tebes = qytet i Egjiptit.
Toas = prijës i Etolianëve.
" = mbret i Lemnesit.
" = luftëtar trojan, i vrarë nga Menelau.
Ksantos = kali i Hektorit.
" = " i Akilit.
" = luftëtar trojan.

Përputhjet pellazge dhe thrako-ilire: të hasura në toponime të ndryshme, etnonimi ose antroponime si dhe ngjashmëri të tjera gjuhësore në Europë dhe në të gjithë pellgun mesdhetar.

*Amantia = qytet i Ilirisë në jug të Shqipërisë së sotme.
= qytet I Italisë (Brutium).
*Ardenicë (mal në Shqipëri) = Ardennes, masiv malor (Belgjikë, Francë, Luksemburg).
*Arisba (ë) = qytet i Azisë së Vogël, në Helespont.
*Arisbé = qytet që gjendet buzë Selleisit, jo shumë larg minierave të arit të Astiras, të cilat shfrytëzoheshin nga familja e Priamit, mbreti i Trojës. Pra ishte "vend i arit". Mirëpo "Ar ish ba" (gegë) dhe "Ar ish bë" (toskë) në gjuhën shqipe do të thotë "ai që është bërë ar".
*Arisba (os) = qytet i Lesbos.
*Arisbè (os) = lumë i Trakës, Arsia (lumë në Istria).
*Arz (Arzen) Erz (Erzen) = lumë në Shqipëri.
*Arrëz = shtatë qytete me të njëjtin emër në Shqipëri.
*Arras = qytet në veri të Shqipërisë (veri-perëndim të Peshkopisë).
*Arras = qytet në veri të Francës.
*Assos (Epir) = Asos në Misia (Azi e Vogël).
*Bantia (Iliri) = Bantia (Appulia).
*Burina (bourina) = burim (burim në ishullin i Lesbosit) = burima ("burim" në gjuhën shqipe).
*Brigi (Thesali/Trakë) = Frigji (Azi e Vogël).
*Butua (Iliri) = Butuntum (Pulia), Budua (Spanjë).
*Malet Bulsinius (Iliri) = Volsinia (Etruri).
*Butua (Iliri) = Butuntum (Apulia) Budua (Spanjë).
*Butrotum = Butrinti i sotëm në jug të Shqipërisë.
*Butrotus = lumi i Italisë (Brutium).
*Kaonët (Epir).
*Konët (Kalabri).

*Dardanie (Iliri - Kosova e sotme).
*Dardania (Troada).
*Dordhanai (Kreta e lashtë).
*Dardi (tribu e Italisë së lashtë).
*Daunienë (Iliri).
*Dauniens (Japiga, Italia e Jugut).
*Elimeia (Maqedoni).
*Elimes (Siçili) = popull i një trungu me Trojanët.
*Enkelanai (qytet etrusk).
*Enkelenët (popull ilir).
*Galabria (Iliri).
*Kalabria (Itali jugore).
*Labria (Shqipëri).
*Gergitha (Troadë).
*Girgisha (Kanaanë).
*Gordion (Frigji) = Gortina (Kretë), Gortinia (Maqedoni), Girton (Thesali), Gurta (Hititi).
*Himarë (Shqipëri) = Himere (bregu verior i Sicilisë).
*Hiamon (Troadë) = Hiameia (Meseni).
*Ibar = degë e Moravës.
*Ibar = fjalë që në gjuhën baske do të thotë luginë.
*Iberët =Emri i etnisë më të lashtë në Spanjë.
*I parë = i pari, i lashti, në gjuhën shqipe.
*Ebre = Lumë në Spanjë.
*Ubar, ubarre = Fjalë që do të thotë lumë në gjuhën baske.
*Ida = mal në Kretë.
*Ida = mal në Troadë.
*Japodët (Iliri) = Japigët dhe Japigionët (jugu i Italisë).
*Iebusa ose Jebusa = (Jerusalemi i lashtë) i vendit të Kanaanit.
*Japudët = popull antik i Troadës.

*Illion (Troadë) = Ilion është emri i dy qyteteve në jug të Beratit në Shqipëri. Ky emër shpjegohet falë gjuhës shqipe : Yll i ion (Ylli i jonë).
*Issos = emër i lashtë i Lesbos, të populluar fillimisht me popullsi të trungut Pellazg.= qytet i Azisë së Vogël i mirënjohur nga beteja e Aleksandrit të Madh.= qytet ilir i Adriatikut.
*Kria (qytet në Lisia) = Kruja, qytet në Shqipërinë e veriut.
*Kerea (Keretes= qytet kretas sipas Polibit.
*Larissa = kryeqytet i Thesalisë, "Pellasgis" antike. Straboni përmend katërmbëdhjetë Larisa të ndryshme.
Larissa = qytet i Troadës.
Larisa = qytet i Kretës dhe i Kampanisë në Itali.
Larissa ose Larisa = Akropoli i Argos.
Larisos = lumë i Elidës.
Larsa = emër i një qyteti sumerian që lidhet me atë të Isinit; për këto dy qytete debatohet trashëgimia e Urit rreth viteve 2000 para Krishtit.
*Liburni (Iliri) = Liburnion (mal në Italinë e jugut).
Liburna (krahinë në Genës).
Libourne (Girondë, Francë).
*Lissus= qytet në Iliri, sot "Lezha" në Shqipëri.
*Lissus= komunë në Siçili.
*Maléa (kep i Lakonisë në Greqi) = Maléa, -kep i ishullit Lesbos.
*Mésia (Thrakë) = Misia (Azi e Vogël).
*Messapion, mal (Greqi) = Mesapët (popull ilir në Italinë e jugut) = Mesapos (Kretë).
*Molosses (popullsi Epirote) = Malësor (malësorët në Shqipërinë e veriut).
*Naro (Iliri) = Nar (Etruri).
*Narona (Iliri) = Narnie (Etruri).
*Olympi = është mali më i lartë në kufirin verior të Greqisë antike. Ky emër (Olumpos në greqisht) nuk ka arritur kurrë të shpjegohet me anë të greqishtes. Mirëpo ky emër rrjedh nga shprehja pellazgo-shqipe

"O i lumtë, O i lumtun, i lumtur". Me fjalë të tjera lumturi: Olimpi a nuk ishte "banesa e perëndive fatlume"?
*Paleastaei (Epir) = Palaesation, Pulisatae (Kretë).
Penestaei (Thesali) = Palaisten (Sikanët/Itali), Pranaeste (Itali) – Palestinë (Lindja e Afërme).
*Pedasos = qytet në Troadë.
= " në Meseni.
= në Iliadë emër Trojan, ka të ngjarë ai i një prifti të Lirnesos në Troadë.
= emri i një prej kuajve të Akilit.
*Pedasa= kryeqytet i lashtë i Lelegëve.
*Pedicum (Venetët)= Poedikuli (në Italinë e Jugut).
*Picentio (Iliri) = Picentini (Itali).
*Picentum (Istria) = Picenum (Itali).
*Plakia (Frigji) = Placentia (Italia e Jugut) = Plakia (Greqi).
*Rhesus = Mbret i Thrakës.
*Rhësus = lumë që rrjedh në afërsi të Trojës.
*Skamandra (Lumë i Troadës) = Skamand, lumë që lag Segestën, qytet i themeluar nga Trojanët.
*Segestion (Iliri)= Segesta (Sicili), Segesta (Itali e Veriut), Seges.
*Segestica (Iliri) = Segeste (Nimes).
*Spina = (qytet në grykën e lumit Po, themeluar nga Pellazgët).
"Shpina" në shqip do të thotë "shpinë, kurriz" apo pjesa e prapme. Në të vërtetë ky qytet përbënte pjesën e pasme të vendit të Etruskëve, të cilët kishin bregun perëndimor, detin Tirrenian dhe në kurriz Spinan (Etruria padovane) d.m.th Lindja, Adriatiku – deti i Ilirëve – vëllezërit e tyre të një race.
*Strymon = Lumë në Trakë.
*Strymon = babai i Priamit (Mbret i Trojës).
*Tergeste (Iliri) = Tragurium (Dalmaci).
= Tergolape (Noricum).

= Thegesta (Veriu i Afrikës), Opitergium (Itali).
*Thrakë = Terash: bir i Jafetit, sipas Biblës.
*Troja (Troie) = Trojani, qytet në Shqipëri.
*Tosk (Shqipëri e Jugut) = Toskana (Etruri).
*Ulkenion (Iliri) = Ulqin, qytet shqiptar, pushtuar nga serbët e Malit të Zi.
= Ulcisia Kastra (Panoni).
*Ulcinium= Ulci (Lukani, Itali).
*Valbonë, Valbona = (lumë në Shqipërinë e Veriut).
= Valbonne (Alpet buzë detit jug-lindjës Francës dhe në Ain).
= Valbonnais (Isera, Francë).
*Venetët= Popull ilir në veri të Adriatikut (vend që gjendej midis Triestes dhe Venecias. Kjo fjalë nënkupton në shqip "vendas, autoktonë, banorë të vendit; Vendës, Vendët.
*Volkae Palus (Iliri) = Volci (Etruri) = Volcei (Picentum).

Parashtesat dhe në veçanti prapashtesat tipike pellazge:

Ekziston një numër i konsiderueshëm emrash dhe fjalësh të lashta që nuk shpjegohen as nga greqishtja dhe as nga latinishtja dhe që disa i kanë përcaktuar të një gjuhe para indo-europiane të zhdukur, ndërkohë që zanafilla e tyre është kryekëput pellazge dhe fondi gjuhësor i së cilës nuk është zhdukur aspak meqenëse dhe mbijeton në gjuhën e sotme shqipe, fosile e gjallë e asaj që ishte gjuha parahistorike e Europës. Ja, midis shumë të tjerash disa shembuj të shpjegueshëm falë gjuhës shqipe:

Naxos (naks = gjaknxehtë, idhnak); Nemesis (nem, nam = me nam, por gjithashtu mallkoj, mallkim); Distos ne Eube (dyst, dystë); një seri emrash që kanë si bazë rrënjën "Pyl" ose "Pel" që do të thotë pyll në gjuhën pellazgo-shqipe: tri qytete me emrin Pilos (Elidë, Trifili dhe Meseni: kjo e fundit ka qenë në Iliadë qyteti i Neleut, që ishte themeluesi), Pilenë (Etoli), Pelion (mali i Thesalisë); nga rrënja "farë"

nga e cila rrjedhin: Farae (qyteti Kretës), Farai (qytete të Mesenisë, Akaia dhe Beoti); Iolkos në Thesali dhe Ialisos në Rod (Ialli. Jalli - pellg, fushëgropë, legen), etj...

Është e dobishme të shënohet që rrënjë të shumta, ndajshtesa dhe në veçanti disa prapashtesa kanë mbetur deri në kohët e sotme të pashpjegueshme nga disa gjuhëtarë, të cilët për mungesë të aftësisë për t'i interpretuar sipas gjuhës greke i kanë trajtuar si me zanafillë parahelene, para indo-europiane ose të dala nga një gjuhë e zhdukur, sipas tezës së përjetësuar. Disa e kanë shmangur shqiptimin fjalës Pellazgët ose "pellazgjik". Megjithatë gjithë këto formime gjuhësore të lashta janë të përbashkëta për rajone të të shumta, të cilat gjeografikisht janë shumë të shkëputura, por të banuara nga populli që kanë qenë nga i njëjti trung etnik. Ngjashmëritë gjuhësore (fonetike, sintaksore ose semantike) janë aq të shumta dhe të rëndësishme sa nuk mund të trajtohen si "përputhje të rastit". Sipas gjuhëtarit të shquar H. Krahe (Fjalor i emrave të përveçëm të ilirishtes së vjetër), prapashtesa (mbaresa emrash, toponimesh ose oronimesh) "st, ru, ina, ona, a", janë të lidhura me të njëjtin grup etno-gjuhësor (Pellazgët, Etruskët, Ilirët, Ligurët dhe dialekte të tjera para-ariane të Mesdheut).

Ja një listë jo e plotë e antroponimeve, etnonimeve, toponimeve dhe fjalëve të tjera pellazgo-liguro-trako-ilire të ndajshtesave ose prapashtesave të mëvonshme dhe në formën emërore ose kolektive por që përfundojnë me: anda, enda, inda, onda, endo:

Alabanda, Karianda, Labranda, Alinda, Arikanda (Karie, Lisi); Pasanda (Troadë, Adramition): Laranda, (Likaoni); Isionda, Isinda, Oinoanda (Pisidi); Soanda (Kapadosi); Thrianda, Kadianda, (Lidi); Kalinda, Alananda, Arikanda,; Saranda (Shqipëri); Pramanda (Epir);

Pa nyejt e prapavendosura a, i o, me të cilat përfundojnë këta emrat e fundit, normalisht prapashtesat e tyre shkruhen me andë ose endë.

Grekët i kanë shtuar prapashtesën e tyre karakteristike "os" prapashtesave jo shquese me zanafillë pellazge, të përmendura më sipër të tilla si andë, indë (të shndërruara nga Grekët në inth) ose endo që kanë krijuar emrat e helenizuar si më poshtë: Korint -os (Korinthi), Eakinth- os, Kerinth- os, Lebinth- os, Piranth- os, Nadiand- os, Aspend- os, Kamind- os, Pirind- os...

Krejt ndryshe nga termat e mësipërme nuk duhen ngatërruar dy rrënjët pellazge të mëposhtme që kanë formuar antroponime të shumta, eponime dhe toponime: andërr (gegë, që do të thotë ëndërr) dhe "andej". Këto rrënjë rigjenden pra në emrat e mëposhtëm: Andr os (ishull grek), And orre (Principatë), Andir os (degë e lumit Skamandër në Troadë), Andeira (qytet i Troadës që u përkiste Lelegëve, sipas Strabonit), Antandr os (formë e helenizuar e Antandeira, qytet i Troadës)...

Sipas Pauzanit, Lelegët (popull pellazg), mbretëruan gjatë shumë brezave në Amiklea, kryeqyteti i lashtë i Lakonisë. Polikaoni, djali i dytë i Leleksit (heroi eponim i Lelegëve) do të ketë themeluar një mbretëri të re, të quajtur Meseni sipas emrit të gruas së Mesenit. Midis qyteteve të tjera ai do të ketë ndërtuar Andanian, e cila do të bëhej kryeqyteti i mbretërisë. Straboni gjithashtu ka folur për këtë në librin e tij VIII. Ky qytet, themeluesi legjendar i të cilit ishte një farë Kaukon, ka qenë i famshëm për misteret e tij.

Emra të tjerë të bazuara në rrënjët "ande, anda, ando" rigjenden te Keltët e Galisë: Andegavi (sot "Angers, Anjou"); Andarta (perëndeshë bretone, emër i rigjetur në mbishkrimin e Dies); Andomatunum (qytet i Galisë belge), etj. Disa gjuhëtarë e nxjerrin rrënjën anda nga gjuha

baske dhe andar nga gjuha kataloneze dhe nga gjuha provensale anar, i cili shpreh idenë e lëvizjes, të ecjes.... Ja përse disa e nxjerrin se kjo rrënjë rrjedh nga latinishtja ambulare (me shëtit) ose ambitare (që nuk ka ekzistuar kurrë), aditare (ec drejt) ose ante (përpara)! Greqishtja nuk na sqaron ndonjë gjë më shumë: andros do të thotë mashkull, burrë!

Vetëm gjuha shqipe na sjell shpjegime të pranueshme. Në të vërtetë përveç fjalës andërr që do të thotë ëndërr, e cila të bën të mendosh për vendin e ëndrrës, rrënja anda shpjegohet nga fjala e shqipes së sotme "andej". Kjo fjalë ka të ngjarë të jetë formuar nga folja ashtë (me qenë, dialekti gegë) dhe nga fjala ndej ("ndej" = midis ndër) ose nda (e ndarë, e shkëputur) që janë bashkangjitur me kalimin e kohës ka dhënë "a` ndej" pastaj "andej". Kuptimi i kësaj fjale duket i qartë: ai që mbetet i ndarë, andej ose mbetet atje poshtë ose larg me idenë e diçkaje të mëposhtme në vijim: ata që janë tanët dhe mbeten të ndarë dhe që kanë mbetur larg, në një tjetër vend ose në këtë qytet të largët ose këta që janë tërhequr në vendet e largëta, etj.

briga:

Kjo rrënjë është tipike iliro-shqiptare, e cila rrjedh nga breg, bregu, brega dhe shumësi i të cilës është brigje si dhe kodrina dhe brinja mali. E gjejmë në formimin e një farë numri toponimesh në Europë :

Bregeuz (Austri); Breganson (Var, Francë) si dhe Brest (Bretanjë) dhe Bri (g)anson (Alpet e Sipërme, Francë). Rigjendet gjithashtu në Spanjë, kjo rrënjë në toponime të shumta me tingëllim ilir dhe shenja dalluese pellazge e së cilës duket e pakundërshtueshme, por që disa e nxjerrin si keloto-galeze (pa dyshim sepse nuk e njohin gjuhën pellazgo-shqipe) :

Deobriga, Lakobriga, Juliobriga, Segobriga, Mirobriga, Talabriga.....
Kjo rrënjë shpesh ka qenë ngatërruar prej gjuhëtarëve të ndryshëm,

të cilët duke mos e njohur gjuhën pellazgo-shqipe, kanë gjykuar se fjala greke pirgos, që do të thotë "fortesë", ka qenë zanafilla e formimit të rrënjës briga dhe të fjalës gjermanike burg (në zanafillë "vend i fortifikuar mbi një kodrinë"), e cila në kuptimin më të gjerë ka dhënë berg (mali). Ata gabohen së tepërmi sepse janë Grekët, ata që e kanë huazuar këtë fjalë nga pellazgjishtja e lashtë "burg" (ngjashmëria me fjalën gjermane "burg" është më se e qartë). Duke i shtuar kësaj prapashtesën e tyre të parapëlqyer "os" Grekët kanë krijuar pyrgos (fortesë). Kjo fjalë për shkak të udhëtarit dhe duke qenë e shkëputshme do të ketë hyrë në formimin e një farë numri emrash qytetesh të fortë. Burg dhe Pyrgos kanë përfunduar në fjalën briga. Në të vërtetë për shkak të evolucionit të gjuhës disa forma të lashta kanë pësuar modifikime fonetike ose sintaksore, kanë krijuar disa elizione silabike*) ose shkëmbimesh të tjera të ndryshme. Nëpërmjet Keltëve (fqinjë të Ilirëve në Danubin e Sipërm) fjala briga rigjendet te Galët në toponime të ndryshme: Sadobriga (emër i Sevresit), Volobriga (emër i Valabreges), etj.

Ona, onna:

Aeonna, Salona, Narona, Scardona, Alvona (Thesali, Dalmaci, Iliri); Verona, Albona, Arona, Ascona, Dertona (Itali); Dodona (Epir); Valona, Valbona, (Shqipëri); Garona (Garone në Gironde), Valbonna (Manastiri i Valbonës në Gand; Valbona në Alpet e buzë detit; Valbonez në Isërë) ...

aska, asko, oska, osko, uska, aska, laska (tepër të shumtë në numër):

Liguria = Nevi-aska, Tule-laska, verag-laska,Vine-laska - Pellgu i Rinit = Urn-aska, karan-uska - Tiroli perëndimor = Mal-osko - Korse = Venzol-aska, Feki-asko, Pruçin-aska, Çipron-asko - (Rajoni i Bastjas) =Pal-aska, Bart-aska (Rajoni i Kalvit) = Popol-aska, Kaposki-aska, Velp-

*) *Janë apostrofime rrokjesh*

laska (Rajoni i Kortes) = Ara-gnasko (mal), Sal-aska, Fiçem-aska, Akel-aska, Mor-aska (Rajoni i Ajaçios) - Piemont = Air-aska, Arri-aska, Balbi-asko, Kamili-aska, Vil-asko, Burri-aska, Kambi-aska - Lombardi = Karizi-aska, Fabi-asko, Livr-asko, Vidol-asko, Grasi-aska

Në Francë prapashtesat pellazgo-ligure aska dhe osko, me kalimin e kohës janë shndërruar respektivisht në asque, usque dhe osque ose osc: Gordol-asque (degë lumi e Vezubi), Valm-asque (degë lumi e Brague) Bri-asque (pyll i rajonit të Grasës), Gre-asque (Gryka e Ronit), Pel-asque (Alpet buzëdetit), Curi-usque (Alpe e Poshtme); Man-osque (Alpe e Sipërme, Provansa), Venas-que (Vaukluzë), Ven-osc (Isere), Flai-osc, Kanj-osc (Var)...

Est, esta, este, esti, ist, ista, iste, isti (tepër të shumtë në numër):

Al-est (Alais, në Francë), Seg-este (Nimes), Terg-este, Big-este (Iliri), Andr-esti (Pirene), Berg-ista, Bel-ista (Iberi), Ram-ista (Panoni), Burd-iste (Thrakë), Seg-esta (Iliri, Liguri, Siçili), Bukur-esti (emri i Bukureshtit), Markul-esti, Fet-esti, Ploi-esti (Rumani) ...

estaei, aestai, istae, istai:

Apen-estaei (fis në jug të Italisë), estaei (Thesali), Pala-estaei (fis Epirot, ka të ngjarë me prejardhje nga emri i Filistinëve), Kurr-estaei (Maqedoni), Pran-aeste (Italia qendrore), Kalar-istae (Panoni), Or-estaei ose or-estai (fis në Maqedoni), etj.

Issa :

Larissa (Thesali, Kretë, Azi e Vogël), Antissa, Lissa, Potaissa (Daki e veriut), Evissa (Korsikë), Galbissa, Sotaissa (Sardenjë), Masinissa (Afrikë e veriut), etj.

Eu, eus : Akileus, Odiseus, Tideus, Atreus...

Kjo prapashtesë ka paraprirë mbaresën tipike greke "s", e shtuar më pas si rrjedhojë e mbërritjes së Helenëve në gadishullin ballkanik dhe

që rigjendet ende edhe sot në formimin e fjalëve, foljeve dhe emrave shqip, të tillë si emri Ndre (i pashquar) = Ndreu (i shquar); dhé = dheu; pre (gegë = me pre)... Shënoj kalimthi se emri grek me zanafillë epirote (pellazge) Papandreu (në greqisht (Papanderou) bazohet në të njëjtin fenomen të mëparshëm (Papa..ndre, Papa .. ndreu = baba Ndre)!

ra... ara, ura:

Stu-ra (dy lumenj në Piemont), Ju-ra (Francë dhe Zvicër), Du-ra (Tur, degë e lumit Rin), Mu-ra (La Mure në Francë), Ru-ra (degë e lumit Rin), Sa-ra (La serre gegë e Oisës), Su-ra (degë e Dromës), Ta-ra (Terain degë e Oisës) etj.

Në prapashtesat e mësipërme gjejmë fjalën ujera, shumësi i fjalës ujë. Pra, në të gjitha këto terma ka nocionin e ujit. Në të njëjtën linjë idesh, ekziston një tjetër fjalë shqipe "ura".

Maliq: maket furre për pjekjen e qeramikës. Epoka e bakrit.
(sipas "Shqipëria Arkeologjike" - Tiranë - 1971)

Ndikimet e pellazgjishtes së lashtë
në gjuhën greke, latine dhe gjuhët e tjera.

Le të shqyrtojmë fillimisht ndikimet e shumta të pellazgjishtes së lashtë apo thrako-ilires në dy gjuhët më të mirënjohura europiane: greqisht dhe latinisht. Sot këto gjurmë janë ende për tu korrigjuar në fjalorin e këtyre dy gjuhëve. Të gjitha këto fjalë që ne do të studiojmë këtu i kanë mbijetuar ndryshimeve të shumta, përzierjeve apo shkatërrimeve të ndryshme gjuhësore. Pra ato kanë kapërcyer, pa pengesa më shumë se tridhjetë shekuj.

Unë nuk do të zgjatem në forma të ndryshme gramatikore apo sintaksore të përbashkëta, jo vetëm në gjuhën greke dhe latine, por edhe në gjuhë të tjera të mëvonshme europiane, madje të Azisë perëndimore, të cilat as do të na sillnin ndonjë gjë domethënëse as do të na sqarojnë njohuritë për zanafillën e gjuhëve më të lashta dhe fjalëve të tyre, të cilat kanë arritur të mbijetojnë. Këtë detyrë po ia le gjuhëtarëve specialistë të lëmit të gjuhësisë.

Këto mbetje gjuhësore janë tri llojesh. Pikësëpari ato kanë të bëjnë me toponimet dhe oronimet. Janë fjalët më të vjetra, të cilat ne i njohim sepse kanë të bëjnë me emërtimet e lashta të përdorura nga popujt e parë të Europës për të emërtuar një mal, pyll, shkëmb, kep, luginë, det, liqen apo pellg, rrjedhë uji, vend i banuar (fshat, qytet..), etj. Këto emra janë më të lashtët, të cilët përcillen nga brezi në brez dhe janë të ngulitura përgjithmonë në kujtesën e njerëzve.

Më pas vijnë emrat e përveçëm, të cilët na i jep onomastika e teksteve greke të autorëve antikë (Homeri, Hesiodi, Arkiloku, Hekateu i Miletit, Herodoti, Helanikosi i Mitilenit, Tuqididi...) të tilla si antroponime dhe eponime, emra të hyjnive (teonime) dhe emra të popujve (etnonime).

Së fundi fjalë të vjetra të llojit të përgjithshëm, shumë prej tyre mjaft të ndjeshme ndaj ndryshimeve që kanë të bëjnë me jetën e përditshme:

me pi, me ngrënë, me fjet, me bë, me sjell ... qielli, toka, retë, shiu... fusha, drithërat, metalet etj. Pjesa më e madhe e fjalëve kanë kaluar në shumë gjuhë, popullsitë e të cilave kanë kaluar nga afër apo nga larg popujve të Europës të dalë nga një trung i vetëm etnik (i llojit Homo-pelasgus!) të tillë: Pellazgët, Lelegët, Ligurët, Karianët, Lisianët, Egjeasit (Tirreno-Etruskë, Eteokretasë..), Fillistinë, Thrakë, Frigjianë, Trojanë (Dardanë, Teukrë..), Ilirë (Autariatë, Dasaretë, Enkelë, Dardanë, Panonianë, Venetë, Liburnë..), Tesprotë (Epirotë, Molosë, Kaonë...), etj. Përveç kësaj në planin antropologjik të gjithë këta popuj kishin një karakter brakicefal tepër të theksuar, d.m.th. kishin kokë të rrumbullakët (aq të gjerë sa edhe të gjatë) pra e kundërt me dolikocefale (kokë vezake ose në formën e topit të ragbisë). Ky fenomen brakicefal rigjendet te shqiptarët e sotëm, pasardhës të vërtetë të Pellazgëve në Europë.

Pra këtu nuk është fjala të shpjegojmë të tilla përputhje me sanskritishten dhe gjuhë të tjera relativisht të vonshme të mbiquajtura indo-europiane ose indo-iraniane ose të tilla të tjera me rregulla (gramatikore, sintaksore, apo fonetike) që shpesh me kalimin e kohës janë modifikuar për shkak të lëvizjeve të popullsive ose kanë ndjerë të papriturat e përmbysjeve gjuhësore të krijuara mjaft vonë nga pushtime të ndryshme.

Në të vërtetë, duke mos dashur të bëj një kurs të lartë të gjuhësisë, gjë që nuk është aspak qëllimi i veprës që keni në dorë, kam ndërmarrë studime krahasuese dhe hulumtime etno-gjuhësore, të cilat më kanë mundësuar hyrjen në burimet e vetë gjuhëve të vjetra, t'i analizoj si ka qenë, falë konfrontimeve të ndryshme, krahasimeve, përputhjeve dhe nganjëherë disa kontradiktave të dukshme dhe falë asaj çfarë zotëron gjuha shqipe dhe mbi të gjitha të dialektit të saj geg, e cila është idioma më e vjetër e dalë drejtpërdrejt nga gjuha thrako-ilire dhe si rrjedhojë nga pellazgjishtja e lashtë. Përveç kësaj dialekti geg paraqet përafërsi të shumta me greqishten e lashtë si në planin leksikor, atë sintaksor gjithashtu edhe atë fonetik.

Është pikërisht kjo pellazgjishte e lashtë, e cila nuk ka qenë marrë në konsideratë. Me saktë i është dhënë një rëndësi e jashtëzakonshme Mikenëve (emër i shpikur nga arkeologët), ndërkohë që disa kanë pohuar se "Pellazgët i kishin paraprirë Grekët në vendin që do të bëhej Greqi". E kanë trajtuar Linearin B (varianti i dalë nga Lineari A, linear kretas) si një gjuhë proto-greke, ndërkohë që deshifrimet e Ventris dhe Kadvik (1952-1964: Knossos, Mikenë, Pilos, Tebë..) nuk kanë sjellë veçse terma që kanë të bëjnë me listat e përllogaritjeve të prodhimeve të ndryshme tregtare, lista inventarësh, të cilat nuk kishin asgjë letrare: pra ato nuk mund të na japin të dhëna për jetën shoqërore, ekonomike ose politike, për gjuhën dhe as për zanafillën e këtyre popujve. Ja përse është ngjitur historia e Greqisë deri te Mikenasit. Deshifruesit tanë të shquar dhe ithtarët e tyre nuk e kanë patur parasysh se bëhej fjalë për një gjuhë parahelene, pra jo greke, meqenëse Grekët nuk ekzistonin ende dhe ndër të cilët ne nuk kemi as edhe një lloj gjurme përpara shekullit VIII para Krishtit. Nëse mund të gjenden disa fjalë që në dukje të bëjnë të mendosh për greqishten, është se shumë më vonë kjo e fundit ka bërë huazime shumë të mëdha në pellazgjishten e lashtë. Megjithatë kjo gjuhë nuk është "zhdukur", siç është përsëritur shpesh në të gjithë manualet e historisë dhe komentarët* e historisë antike, por ajo ka lenë gjurmë të mëdha jo vetëm në gjuhën e sotme shqipe, pasardhësja e saj nëpërmjet thrako-ilirishtes, por gjithashtu në pjesën më të madhe të gjuhëve indo-europiane.

Pra është hallka pellazge që ka munguar në hulumtimet e kryera deri në ditët tona. Në të vërtetë teoritë e gabuara, pistat e gabuara ose gabimet e vlerësimit, të cilat nëpërmjet specialistëve të parë të gjuhësisë moderne u janë transmetuar ithtarëve të tyre dhe që duke i ripërsëritur pafundësisht me kalimin e kohës u pranuan dhe më në fund u trajtuan si fakte të përcaktuara. Përveç kësaj një tjetër mangësi ka pllakosur të

*) *Shënime sqaruese*

gjitha këto studime dhe hulumtime: etni-gjuhësia dhe kronologjia e saj. Në të vërtetë janë ngatërruar elementet gjuhësore të mëvonshme me ato më të lashta. Gjithashtu është bërë një projektim a posteriori e elementeve pak a shumë të dhëna nga autorë antikë, pa vendosur kronologjinë e tyre të vërtetë apo iu verifikuar burimin. Në nivelin e komentarëve të ndryshëm ka patur pasaktësi të mëdha sepse është nisur mbi bazën e interpretimeve dhe të rindërtimeve jo shumë bindëse. Unë nuk mund të rri pa kujtuar se duhet bërë kujdes kur të lashtëve iu atribuohen ide moderne.

Prandaj po paraqes studimin që ka të bëjë me "fjalët", të cilat kanë qenë huazuar prej gjuhës greke, latine dhe gjuhë të tjera europiane më të vonshme nga pellazgjishtja e lashtë ose thrako-ilirishtja.

Pra, po rinis analizën për tri burimet kryesore gjuhësore që përforcoi me elemente të tjera bindëse, argumentimin tim mbi vërtetësinë historike të pellazgjishtes së lashtë dhe lidhjen e saj të ngushtë me shqipen e sotme, "fosile e gjallë" e asaj që ka qenë gjuha parahelene e vendit, të cilin Grekët do ta quanin "Heladë" (rreth shekullit VIII madje shekulli VII para Krishtit), të cilën Romakët do ta quanin "Graecia" (Greqia) rreth shekulli IV–III para Krishtit. Do të kujtoj këtu vetëm elementet më domethënës. Për më shumë hollësira lexuesit do t`i duhet t`i referohet kapitujve të ndryshëm të lidhur me përputhjet gjuhësore.

I – Antroponimet, teonimet, eponimet, etnonimet

Le të fillojmë me perëndinë më të dëgjuar, të cilën Grekët ua morën Pellazgëve: Zeusin. Ky emër ka qenë komentuar për një kohë të gjatë në bazë të emrit të Perëndisë fuqiplotë të Panteonit olimpian. Autorët grekë nuk kanë kërkuar të njohin zanafillën e emrave të mitologjisë së tyre, aq më tepër që ata nuk ishin gjuhëtarë (shkencë moderne e shfaqur në shekullin XIX të erës sonë). Pra ata kishin trashëguar një farë numri të emrave të perëndive pa arritur të kuptojnë domethënien dhe për të

cilat dhanë interpretimet e tyre, duke i përqasur ato nga ana fonetike me fjalorin e tyre (grek). Janë vetëm gjuhëtarët dhe helenistët modernë, të cilët kanë vendosur ta shpjegojnë zanafillën e tyre nëpërmjet krahasimeve me gjuhë të tjera (shpesh të dala nga e njëjta stampë) dhe në veçanti me sanskritishten, e trajtuar nga gjuhëtarë të shumtë si njehsori Gaiger për të gjitha gjuhët e mbiquajtura indo-europiane, ndërkohë që kjo gjuhë në raport me pellazgjishten e lashtë është tepër e vonshme. Pra gjendemi përpara një dileme të çuditshme: interpretimi që bëjnë Grekët dhe ai i bërë nga autorët modernë, mbi të gjitha në planin e një zanafille gjuhësore.

Përsa i takon Zeusit, elementi thelbësor i zanafillës së tij etnike, përveç përputhjeve gjuhësore me shqipen e sotme dhe epiteteve të shumta të Homerit, duke i cilësuar Pellazgët hyjnorë, është një frazë e përmendur në Iliadë (Kënga XVI, 234), e cila provon zanafillën pellazge (e vetmja fraza e shpëtuar nga ndërfutjet e ndryshme dhe që i ka shpëtuar manipulimeve të logografëve grekë); "Akili - ; Zeus mbret, Dodonasi, perëndi e hershme, Pellazgjiku, i cili mbretëron mbi Dodonë, në këtë vend të ashpër të Sellëve, të profetëve me këmbë të palara kurrë dhe që flenë përdhé!" Grekët kanë dashur ta lenë në heshtje këtë, qoftë edhe se nuk e kanë kuptuar domethënien, meqenëse do të quheshin autoktonë (të lindur nga toka) pra pasardhës të Pellazgëve. Ndërkohë që të gjithë autorët e fundit të Greqisë arkaike (shekulli VI para Krishtit) dhe të epokës klasike (shekulli V dhe IV para Krishtit) kanë pohuar se Pellazgët ishin banorët e parë të Greqisë "përpara mbërritjes së Grekëve" dhe se gjuha e tyre nuk ishte greqishtja, pra ishte një gjuhë barbare.. Prandaj nuk mund të ishin "autoktonë" dhe as me prejardhje nga Pellazgët. Ja çfarë na thotë në lidhje me këtë Herodoti (I, 57, 58): "Cila ishte gjuha e Pellazgëve? Nuk mund ta them me siguri; por nëse lejohet të hamendësosh në bazë të pasardhësve të sotëm të Pellazgëve, të vendosur në Krestoni, mbi Tirrenët (ata që dikur ishin fqinj të popullit që ne e quajmë Dorian dhe që banonin në vendin që ne e quajmë

Thesaliotidë) dhe të Pellazgëve që kanë themeluar Plakinë dhe Skilakën mbi Helespont (ata që dikur kanë banuar me Athinasit) dhe sipas shumë të tjerëve të përmendur, gjithashtu pellazgjikë, megjithëse kanë ndërruar emrin, mund të them, duke e gjykuar nga këta popuj, se Pellazgët flisnin një gjuhë barbare. Pra nëse nuk është e njëjtë kjo për gjithë racën Pellazge, populllit të Atikës i cili është Pellazg, i është dashur të ndërrojë gjuhën duke u kthyer në popull Helen". Këto linja mendimesh janë të qarta si drita e diellit. Ja përse emri i Zeusit në thelb shpjegohet falë gjuhës shqipe dhe jo me anë të gjuhës sanskrite, greke apo ndonjë gjuhe tjetër ashtu si edhe do ta përcaktojmë.

Διος (Dios) është qoftë interpretim fonetik i emrit të Zeusit (Δευς) të bërë nga Helenët e parë pas pushtimit të vendit të Pellazgëve, qoftë edhe një emërtim i mëvonshëm. Gjuhëtarët shpejt i kanë bërë një përqasje me sanskritishten Dyaus, prej nga vjen latinishtja Deus (Zoti) dhe dies (ditë). Tashmë kam folur për Zeusin në kapituj të shumtë. Këtu thjesht do të kujtoj dy legjendat e njohura për vendlindjen e tij: njëra nxjerr si vendlindje të tij Kretën (Mali Ida ose Dikte) dhe tjetra e nxjerr vendlindjen e tij jo shumë larg malit Lice në Arkadi: në secilin rast të dy këto vende ishin të populluara gjithashtu nga Pellazgët. Për ta shpëtuar nga tërbimi i Kronos, nëna e tij Rea e lau në lumen Neda dhe ia dha Tokës Mëmë (Gaea), e cila e dërgoi në Kretë në malin Dikte sipas disave, në malin Ida sipas disa të tjerëve) ku ajo ua besoi kujdestareve të sigurta, nimfave Adrastea dhe Ida, bija të mbretit të Kretës, Meliseus. Ato e vunë në një djep të artë. Adrastea për ta argëtuar i bëri si dhuratë një sferë të formuar me rrathë të artë". Kuretët arritën të mbulojnë të qarat e foshnjës falë vringëllimave të armëve të tyre dhe në mënyrë që Kronosi të mos ta dëgjonte ekzekutuan një vallëzim luftëtarësh (që më vonë u bë Pirrika dhe që vallëzohet ende sot në Shqipëri). Zeusin e ushqeu dhia Amaltea.

Në këtë rast, unë do të mjaftohesha me këtë shembull të lindjes së Zeusit. Në të vërtetë gjithçka rrethon historinë e lindjes së tij provon

karakterin pellazg të Zeusit dhe të Panteonit të tij olimpian: të gjitha emrat që figurojnë në paraqitjen gjeneanologjike të mëposhtme shpjegohen me lehtësi me anë të gjuhës së sotme shqipe.

- Kronos = Koh ro, Koh ron = koha që vazhdon në vijimësi; ai apo Kronosi që rendit kohën. Kjo fjalë është në zanafillë të fjalës "kronologji" (shkenca e kohërave, renditjes dhe datave të ngjarjeve historike). Kronos është një figurë mitologjike. Rrallë ka qenë objekt i ndonjë kulti fetar dhe është Saturni te Romakët.

- **Rea** = Re, Reja = Në gjuhën shqipe ekzistojnë dy homonime; njeri do të thotë "me re, qiell i mbuluar me re" dhe tjetri "nusja, bashkëshortja (e reja)". Emri i babait të saj Uranos në gjuhën shqipe do të thotë "U vranë (s) = qiell i vranët", ndërkohë që te Grekët do të thotë "qiell me yje". Emri Rea, bija e "qiellit të vranët", në gjuhën shqipe është më pranë domethënies të babait të saj. Përkundrazi Grekët e shpjegojnë emrin nëpërmjet një shtrembërimi të fjalës åñá (era, në greqisht) që do të thotë tokë. Por Rea ishte një hyjni e mirëfilltë pellazgo-kretase.

- **Gaea,** Gaia = Dheja, dhé = Toka; Gji, gjija, gjini (gegë) = Ge, qoftë në shqip "gjiri, apo gjinia (fisi)".. toka që të ushqen. Ky emër ka një tjetër ortografi Gé. Kjo ka të ngjarë të lidhet me një shtrembërim fonetik të pellazgo shqipes "dhé" (th në gjuhën angleze). Në të vërtetë emri Gaea sipas kozmogonisë se Hesiodit personifikonte tokën "Toka gjatë formimit". Gaea është trajtuar nga të gjithë si një hyjni tipike pellazge.

- **Zeusi** = Za, Zani, Zë = zëri (i Zeusit). Në të vërtetë zëri i Zeusit paraqitet me anën e fëshfëritjes së gjetheve të shenjta të lisit të shenjtë të Dodonës (kryeqyteti i kultit të Pellazgëve) në Tesproti (i bërë më vonë Epir). Është orakulli më i shenjtë i antikitetit, i cili pas mbërritjes së Grekëve u zëvendësua me atë të Delfit, i cili u bë vendi i parë i shenjtë grek (shekulli VIII-VII para Krishtit). Vendi i vetëm vend i shenjtë i orakullit, i denjë për emrin e tij, i përmendur nga Homeri është ai i Dodonës. Ai nuk ka përmendur atë të Delfit (vetëm një herë

te Odiseja IX, 581 por bëhet fjalë për një ndërvendosje). Ai ka përmendur emrin e Pitos shkëmbor (vend i shenjtë kushtuar Febos, i gjendur në viset e Delfit të ardhshëm). Nuk ka më përmendje të Olimpit (orakull i Zeusit) as të Lojërave Olimpike. Arsyeja e mungesës së këtyre ngjarjeve është se ato kanë qenë më të vonshme se Homeri. Përsa i takon emrit zanafillor të Zeusit ne zotërojmë një dëshmi vendimtare, atë të Porfirit (Jeta e Pitagorës). Ja mbishkrimi, thotë ai, që Pitagora gdhendi në varrin e Zeusit: Pitagora për Zeusin... "këtu prehen eshtrat e Zan, i cili quhet Zeus". Pitagora ishte një pellazgo-tirrenian nga Samosi. Pra Pitagora del se e njihte gjuhën e të parëve të tij, meqenëse e njihte emrin pellazg Zeus si Za, Zan, Zanë (dialekti geg). Te emrin "Zeus" gjuhëtarët kanë kujtuar se kanë zbuluar fjalën sanskrite Dyaus...Pita (Zoti i gjithëfuqishëm, zoti qiell). Është i famshmi "Zeus pater", i shndërruar nga Latinët në Dius ose Deus pater dhe më pas në "Iupiter" pra Jupiter (Zoti baba)! Është një nga ankesat kryesore etno-gjuhësore që mund t`i bëhen gjuhësisë moderne madje duke prekur edhe vetë zanafillën e mitologjisë greke. Në dialektin toskë thuhet "zëri, zë".

- **Adraste** = A drashtë, E drashtë = ajo që frikësohet, që ka frikë (nga Kronos).

- **Ida** = I dha = Ajo që i ka dhënë (Zeusit). Ida është emri i dy maleve, njeri në Kretë dhe tjetri në Troadë edhe ky një tjetër vend pellazg. Në të vërtetë Trojanët rrjedhin nga Dardanët, popull thrako-ilir i Ballkanit. Rigjenden në veri-perëndim të Azisë e Vogël (në veçanti në Troadë) dhe në Kretë përputhje toponimike të përbashkëta për të dy vendet.

- **Kuretët** = Ku rret, Ku rretet (gegë); Ku rrit, Ku rritet (toskë) = aty ku u rrit (Zeusi). Prej kësaj rrjedh emri i Kretës vend ku "u rrit Zeusi". A nuk kanë pohuar autorët antikë se Kuretët ishin banorët e parë të Kretës?

- **Amaltea** = E mielta (E mjelta) = Ajo që ka mëkuar, apo që i ka dhënë qumështin e saj (Zeusit).

- **Meliseus** = Malësiu = Ky emër rrjedh nga një prej fjalëve më të lashta "mal" pra mali. Ka të ngjarë të bëhet fjalë për një "mbret i malësive" (mbreti i Idas?) ose mbret malësor. Në shqip "malësi" do të thotë vend me male dhe "malësor" është diçka që ka të bëjë me malin apo "Malësiu, malësori" dihet që është banori i maleve.

Është e qartë që gjithçka që ka të bëjë me Zeusin, me hyjnitë e lashta kryesore dhe me fenë pellazge të trashëguar nga Grekët shpjegohet falë gjuhës shqipe. Me këtë rast meqë po flasim për Zeusin, është interesante të shënojmë që fjala "skeptër" shpjegohet me anë të gjuhës shqipe. Në të vërtetë kjo fjalë vjen nga ajo fjalë që emërton skeptrin e Zeusit, një lloj shkopi që ka në krye një kokë shqiponje. Shkreptima dhe shqiponja, dy emblemat e gjithëfuqishme të Zeusit. "Sqep shqiponje" dihet se në shqip thuhet sqep, skep. Në fillim skeptri ka të ngjarë të jetë quajtur "Skep" nëpërmjet shtrembërimit fonetik sipas vetë natyrës të gjuhës greke, pra skep... tron (άχηπτρου). Përveç kësaj fjala spelaion (fjala zanafillore e fjalës "speleologji"), që do të thotë shpellë në greqisht, nxjerr zanafillën e Pellazgëve (Njerëz të Shpellave), emri i të cilëve shpjegohet me anë të gjuhës shqipe Shpellagji, rrënja e së cilës është "shpella". Disa malësorë të Shqipërisë së Veriut (krahina e Matit, p.sh.) e quajnë shtëpinë e tyre "shpeja", reminishencë e banesës së tyre parahistorike! Prapashtesa greke "ion" është tipike pellazge (i onë = i jonë, që na përket ne, siç është edhe rasti i detit jonian, det i Pellazgëve dhe më pas i Ilirëve) siç do ta vërejmë në një nga paragrafët e mëposhtëm.

Mirëpo ne e dimë se Zeusi ka lindur në një shpellë dhe se lindja e tij sipas legjendës ndodhi në Arkadi ose në Kretë. Me anë të silogjizmit Pellazgët (Njerëz të shpellave) janë pra njerëz të Zeusit (të lindur në një shpellë) d.m.th pasardhës të tij. Për më tepër Shqiptarët e sotëm e

quajnë vetëm "bij të shqipes". Kjo nuk ka asgjë për tu çuditur meqenëse të gjithë tekstet antike provojnë se Zeusi ishte Pellazg, se Pellazgët ishin banorët e parë të Greqisë, të cilët ua përcollën Grekëve fenë e tyre dhe një pjesë të madhe të trashëgimisë së tyre kulturore, madje edhe atë gjuhësore. Unë do të shtoja një tjetër element domethënës që na jep Pauzani (I-VI, 16, 5) duke na treguar një variant tjetër të emrit të Zeusit: Zotos. Në të vërtetë nëse nuk marrim parasysh prapashtesën e famshme dhe patjetër të domosdoshme greke "os", atëherë zbulojmë rrënjën Zot. Sot në Shqipëri perëndia thuhet edhe Zot, cilido qoftë besimi fetar i banorëve të saj (katolikë, ortodoksë ose myslimanë). Së fundi, do të shënoja që në gjermanishten e vjetër ka një tjetër variant të emrit të fundit Ziu, Got (i kthyer në Gott): krahasuar me Zan dhe Zot. Emri i fundit ka të ngjarë të jetë një shtrembërim i mëvonshëm i fjalës za, zan, zani, kuptimi i së cilës në gjuhën shqipe (zëri) është ruajtur gjatë tri mijëvjeçarëve. E vërteta historike e Pellazgëve dhe vijimësia e gjuhës së tyre janë të pamohueshme edhe nëse nuk iu pëlqen atyre për të cilët skepticizmin e barazojnë me kokëfortësinë e tyre. Shpresoj që vepra që keni në dorë tu japë atyre sqarimet e nevojshme dhe do t'ua bëjë të mundur ta shohin në një kënd më të mirë vështrimi historinë parahelene.

Lloji i shembujve të lartpërmendur nuk mungon. Gjithsesi në këtë kapitull, me qëllim që të mos bëj shumë përsëritje do të kufizohem për të sjellë shkurtimisht disa elemente thelbësore, për të cilët ju do të gjeni hollësira në kapitujt që trajtojnë "përputhjet gjuhësore".

* Promete, Titan, biri i Jafetit dhe i Temis-it është ai që formëzoi me argjilë, njerëzit me figurën e Perëndive ("Prue me dhé = e sjellë me dhé) ndërkohë që Grekët e interpretojnë emrin e tij me "parashkuesi"; Akili (Aspeitos = Asht'shpeit = "i shpejti"); Afroditë (Afër dita = ajo çfarë është afër ditës, pra drita, agimi); Hera (Era = era, një nga atributet e Herës); Demetra perëndesha e grurit dhe e mbirjes së tij (Dhé motër

= tokë-motër? Nënë; toka që të ushqen); Kore, perëndesha e të korrave dhe bija e Demetrës (Korr, Korra = korrësja; ajo u quajt më vonë Persefoni dhe i kaloi ditët e fundit të saj pranë Hadit në botën e përtejme); Hadi (Hades) perëndia e të vdekurve dhe e botës së përtejme (Ha dekës ai që ha të vdekurit); Ares (Erz = nderi "bej luftë" do të thotë të mbrosh "nderin"); Apolon ("A po luan" = a po luajnë... ky emër ka dalë nga një frazë e Mbretit Midas gjatë garës të muzikës midis Apolonit, Marsias dhe/ose Panit); Artemis, motra binjake e Apolonit (arë të miell = arë e mbjellë); Tetis, Nereidë dhe më e shquara e perëndive detare (Deti); Menmozina, nëna e Muzave (Men mësoi = ajo që u mëson kulturën apo që është e zgjuar); Menelau (Men e la = ai që ka humbur mendjen); Agamemnoni (E ka menue = ai që e ka menduar, shqyrtuar); Laerti, babai i Uliksit dhe i matur, i urtë (le urtë = ka lindur i urtë); Uliksi/Odiseja, i famshëm për udhëtimet e tij (Udhësi = udhëtar); Telemaku (Të leu mec = thirrja e Penelopës në mbërritjen e Uliksit; "të ka lindur djalë!"); Penelopa (Penë e lyp = ajo që nevojë për fill); Titans (Të tan= të gjithë); Hesiona, e lidhur me zinxhirë nga babai i saj Laomedoni, mbreti i Trojës (E zanë = e zëna, e kapura); Ajaks (A Gjakës = gjakësor, vrasës); Atrides "pasardhësit" e Atres, "familja" e Atresë (Atrët = prindërit, familja); Olimpia (O e lumta = e lumja); Aleksandër (Ka le si n` andërr = ai që ka lindur si në ëndërr), etj.

***Kranaenët,** Pellazgët e Athinës (Krena, Krenar = prijës ose njerëz krenarë dhe të lavdishëm); Dalmatët, popull ilir i bregut lindor të Adriatikut (Delmat, Delmatët = delet, rritësit e deleve): Pella, kryeqyteti i Maqedonisë (Pela, pelë; Thesalia, Maqedonia dhe Traka ishin të famshme për rritësit e kuajve); Romë, qytet i themeluar nga Romulus (Romulak në dialektin geg do të thotë "i rrumbullakët, ai që ka kokë të rrumbullakët"); Tirrenos është biri i mbretit lidian Atis; Tirana, kryeqyteti i Shqipërisë (Tirrenia është emri grek i Etrurisë;

Turan është një mbretëreshë etruske; Tuski është emri latin i Etruskëve; Tusculum është emri i një qyteti antik të Italisë që gjendej në rajonin e Maleve Albine dhe Tosk është emri që mbajnë sot Shqiptarët e Jugut); pra Tirrenos, Tirrenia, Turan, Tuski, Tusculum, Tosk e Tirana janë të lidhura ngushtë me vetë zanafillën etno-gjuhësore, Lelegët është emri

Vlorë: statujë (guri) gruaje në kostum ilir , shekulli II - III i erës sonë.
(sipas "Shqipëria Arkeologjike - Tiranë - 1971)

i lashtë i Karianëve, banorë të lashtë të Kretës dhe të ishujve të Egjeut përpara se të kalonin në Azinë e Vogël (Le lesh, Le me lesh = të lindur me qime ose njerëz leshtorë); Ligurët, popull i lashtë i Mesdheut perëndimor (veri-perëndim i Italisë, Franca juglindore deri në luginën e Ronit), emri i këtij populli tjetër pellazg shpjegohet gjithashtu nëpërmjet gjuhës shqipe = Lëkurë, likurë = "lëkura" dhe më gjerë "njerëz të veshur me lëkurë"; Liburnët, popull ilir (Le burrë = i lindur burrë, i lindur trim); emri i Epirit (në greqisht Epeiros) shpjegohet me gjuhën shqipe Epër, Epëri (rrënja e emrit Epir pa prapashtesën greke "os"), që do të thotë "i epërm, lart, në lartësi" në lidhje me Greqinë e gjendur më poshtë etj.

II - Toponimet dhe oronimet

Nga të gjitha fjalët parahelene, toponimet dhe oronimet janë ato që i kanë rezistuar më mirë të gjitha shkatërrimeve dhe modifikimeve gjuhësore. Në të vërtetë ato gjithmonë janë të lidhura fort me malet e tyre të pavdekshme, shkrepat, liqenet, rrjedhat e ujerave, pyjet, tokat etj.

Deri më sot të gjithë autorët modernë (historianë, arkeologë, parahistorianë, helenistë, gjuhëtarë..) kanë dalluar se emrat e tyre nuk mund të shpjegohen as nga gjuha greke as nga gjuha indo-europiane, të tilla si fjalët Athinë, Mikenë, Tirinti, Korinti, etj. Duke mos njohur zanafillën, kulturën dhe qytetërimin e Pellazgëve, gjuhën e tyre si dhe prejardhjen ata kanë shpallur se bëhej fjalë për një "popull që u zhduk pa lënë as edhe gjurmën më të vogël"! Kësaj i thonë të djegësh etapat. Në të vërtetë kjo është një nga arsyet e qorrsokakut ku kanë ngelur tri disiplinat më të shquara të historisë së lashtë të popujve europianë: historia, arkeologjia dhe gjuhësia.

Ja disa nga toponimet dhe oronimet më kryesore si dhe domethënia e tyre që del nga gjuha shqipe. Shënoj se në të vërtetë pjesa më e madhe

e këtyre emrave ka qenë trajtuar gjerë e gjatë në kapitujt e shumtë në lidhje me përputhjet gjuhësore.

Për të sqaruar më shumë, unë do t'i ndaj të gjitha këto emra (toponime, oronime) në tri tërësi të mëdha gjeografike, ndër të cilat më e rëndësishmja lidhet me Greqinë :

a - Greqia, stricto sensu, deti Egje dhe Mesdhetar lindor.

b - Ballkani, Azia e Vogël dhe zonat lindore.

c - Itali, Mesdheu perëndimor dhe Europa Perëndimore.

a - Greqia, stricto sensu , deti Egje dhe Mesdhetar lindor.

* Athina (Athenai, Athene, Athana, Athanai dhe së fundi Athinai) = E thana ose E thëna do të thotë në shqip "premtimi, e parathëna". Këtu kjo nënkupton qytet "i paracaktuar" për Pellazgët (cf. Herodoti I, 57, 58; VIII, 44). Ky qytet, qytet i mirëfilltë pellazg banohej nga Pellazgët përpara mbërritjes së Helenëve. Rrënojat e murit që rrethon Akropolin e tij, "pelargikon ose pelasgicon" muri rrethues i mbiquajtur pellazg (cf. Herodoti V, 64) janë më se të dukshme.

* Tirinti (Tirins) = qytezë legjendare e periudhës parahelene e njohur për fortesën dhe muret e saj rrethues gjigandë të mbiquajtur ciklopikë apo pellazgë. "Tirinti me mure të fortë" na thotë Homeri (Iliada II, 559). Ajo bashkëshoqërohej me Mikenën mitike si dhe me legjendën e Heraklit. Emri i saj nuk shpjegohet aspak me greqishten. Tirsenët, Tursanët, Turshas, Tirrenianët, Tuskët, Tusk, Tuskis. ("Etruskët" dhe të vetmit të shpëtuar me këtë emër: "Toskanët" e Italisë dhe "Toskët" e Shqipërisë) ishin të njohur si ndërtues të shkëlqyer të mureve, fortesave dhe të gjitha llojeve të fortifikimeve. Mirëpo rrënja pellazgo-shqipe "thur" dihet që do të thotë "thur përqark me mure rrethues" dhe si rrjedhojë ne kemi "thurës, Thurrësit" (ndërtuesit e mureve rrethuese, ndërtues të mureve të vendeve të rrethuara) prej nga vjen greqishtja

tyrsis (Τυρσις) që do të thotë "kullë, fortifikim". Latinët si rrjedhojë kanë fjalën e tyre "turris" (shumësi "Turres") që do të thotë "ndërtesë e lartë, pallat i fortifikuar, kullë". Nuk ka asnjë dyshim që Tirinte (Tirins) ka qenë "qytezë e fortifikuar" ose "e rrethuar me mure"; qyteti "me mure të fortë" i Homerit.

*Korinti (Korinthos) = rrënja e këtij emri rigjendet në foljen pellazgo-shqipe korr, korra, korrin që do të thotë "me korr" dhe të Korrat (të), pra të korrat. Në të njëjtën linjë mendimesh do të shtoja fjalën "Juillet" shqip është muaji "Korrik" (muaj i korrjeve). Korinti, një nga tri qytezat më të rëndësishme të Greqisë antike (pas Athinës dhe Spartës) dhe një nga fuqitë e para detare me Athinën dhe Eginan, ishin të njohura për qeramikën e saj, industrinë e bronzit, dy portet e saj, Diolkosin e tij, fushat e saja pjellore dhe kulturat e saj të drithërave. Përveç kësaj, në anën veriore të Akrokorintit arkeologët kanë nxjerrë në dritë një vend të shenjtë kushtuar Demetrës (perëndesha – Tokë-Mëmë e grurit dhe e mbirjes së tij) dhe Koré (perëndesha e të korrave). Gjithashtu nuk ka dyshim që Korinti është kësisoj "qyteti i Korés" qyteti i drithërave, i "fushave pjellore" dhe i të "korrave".

*Mikena (Mykenai) = Është qyteti më i shquar i përmendur nga Homeri në Iliadë. I vendosur në verilindje të fushës së Argos, ajo ishte mbretëria e heroit homerik Agamemnoni. Homeri e cilëson si "qyteti plot ar, i pasur në ar, Mikena e madhe, e pasur". Gjithashtu ky emër nuk shpjegohet nga greqishtja. Rrënja Myk ose Mik që paraqitet në fillim të fjalës në greqisht (si tek emri i ishullit Mykonos në Kretë, Mykenai në Kretë, Mykarna në Etoli ose Mykalessos në Beoti), paraqet në gjuhën pellazgo-shqipe një fjalë të vjetër që nuk gjendet në asnjë gjuhë tjetër: fjalën Mik. Ka shumë të ngjarë të ketë qenë "qyteti mik" ose "Aleati i Argosit" në luftën kundër Trojës. Argosi ka qenë një nga kryeqytetet e para të Pellazgëve, në të cilin mbreti Pellazg, u rrëzua

nga froni i rrëmbyer prej pushtuesve të parë të huaj të vendit të tij: Danaenët me në krye Danaos (semito-egjiptian, vëllai i Egjiptos). Le të shënojmë me këtë rast se Homeri përballë Trojanëve përmendte vetëm emrat e Danaenëve, Akenëve dhe Argianëve. Në të vërtetë Greqia (Heladë) si e tillë nuk ekzistonte ende në kohën e Homerit.

*Pylos = qyteti legjendar i Neleas dhe birit të tij Nestor, hero homerik. Aty gjithashtu gjendet ashtu si në Mikenë, Tirint ose Argos i njëjti lloj "pallat-fortesë" dhe të njëjtat mure të ndërtuara me blloqe të stërmëdhenj guri. Arkeologët kanë zbuluar aty tabelëza të shumta të gdhendura nga Lineari B. Gjithsesi po shënojmë tri Piloset e vetme të Greqisë gjenden në Peloponez (dikur i quajtur Pellazgji): në Trifili (Pylos i Homerit) në Meseni dhe në Elidë. Emri Pylos rrjedh nga shqipja "pyll" që do të thotë pyll dhe jo "portë" (gjë që nuk ka asnjë domethënie praktike) siç sugjerojnë disa nga gjuhëtarët që bazohen në një fjalë greke Πύλαι Pylai, Πυλη ose Pylë). Në të vërtetë Grekët e kanë trashëguar nga një emër pellazg, të cilin nuk e kanë kuptuar dhe do ta kenë interpretuar nga ana fonetike me gjuhën e tyre.

I njëjti fenomen pas-homerik (meqenëse Homeri nuk e njihte termin "Thermopyles") u përdor shumë vonë për emrin "Thermopyles" (Θε ρμο - Πυλαί), grykë e famshme (midis Malit Oeta dhe gjirit maliak) dhe rruga e hyrjes midis Thesalisë dhe Lokridës. Ky emër në greqisht do të thotë "portat flakadan". Termi i fundit është emërtuar edhe për shkak të burimeve të ngrohta që ndodhen jo larg prej aty. Fosidianët për të penguar përparimin e Thesalianëve, rreth shekullit VI para Krishtit kishin ndërtuar një mur fortifikues. Sipas Herodotit (VII, 176) bëhej fjalë për një mur me dy porta. Ky mur, një barrikadë e vërtetë, duket të jetë në zanafillë të emërtimit "Portat". Emri pellazg "Pyllë, Pylla" do të thotë "pyll" prej nga rrjedh "pyll në burimet e ngrohta" (Thermopyles). Ky binte pikërisht mbi gjirin maliak. Përveç kësaj fjala e fundit (maliak) rrjedh nga një prej fjalëve më të vjetra

pellazgo-shqiptare "Mal", gjë që shpjegohet me lehtësi nëpërmjet "gjirit të Malit" ose "Malit Oeta". Ja përse Grekët që kanë trashëguar këta dy emra (Pyllë dhe Mal-iak) dhe duke mos ditur domethënien zanafillore, e kanë ruajtur të paprekur grafinë e së dytës dhe kanë modifikuar kuptimin e së parës duke e quajtur Pylai (porte/portat).

Ja përse kjo fjalë e përbërë (Thermopiles) duket ekuivoke madje e pakuptueshme: "porta të ngrohta" është pra një term i papërshtatshëm. Sido që të jetë ky emërtim "porta të ngrohta" është i vonshëm dhe dëshmon për një interpretim tipik grek dhe provon karakterin e saj pas-homerik.

Këto dykuptimësi të gjuhës përkthehen nganjëherë nëpërmjet përsëritjes të të njëjtit kuptim të të njëjtës fjalë ose të një fjale të shkruar ndryshe në dy gjuhë të dallueshme. Ky është rasti për disa emra të lashtë vendas, të cilat popullsitë e imigruara i kanë shndërruar në fjalë të tyre duke iu bashkangjitur emrat e tyre (tautologji). Në të vërtetë Grekët me mbërritjen e tyre në vendin e Pellazgëve kanë gjetur të gjitha llojet e emërtimeve të përdorura nga popullsitë autoktone. Prandaj u kanë bashkangjitur fjalët e tyre këtyre termave të lashta. Ja disa shembuj të këtyre emrave pleonastikë. Çuditërisht në epopetë homerike ne gjejmë dy nga fjalët më të lashta pellazge: "mal" dhe "gur" të bashkangjitura me fjalë tipike greke "oros" (mal) për fjalën e parë dhe "petros, petra, petrai" (gur, shkëmb) për të dytën. Tek Odiseja (III, 287; IV, 514) zbulohet emri i përbërë "Maleaion oros" (Mal Mali) që gjithashtu është një variant i emrit të kepit të Lakonisë, të quajtur gjithashtu nga Homeri Maleion dhe Meleian (Odiseja IX, 80; XIX, 187) dhe që Tuqididi e quan (Malee). Pra aty bëhet fjalë për një tautologji të përkryer: mal dhe oros kanë të njëjtin kuptim.

Tek Odiseja gjejmë gjithmonë "Gyrai petrai, Gyras petras, Gyro petra" (IV, 500-509); gyr (pellazgjisht gur) dhe "petra, petras, petrai" fjalë greqisht kanë të njëjtin kuptim, gjë që nxjerr mosnjohjen e emrit

pellazg "gur, guri", Grekët i kanë shtuar emrin e tyre "petra, petras, petrai". Kjo lloj tautologjie, e cila përdor emërtime pellazge haset edhe në vende të tjera ndër të cilat Franca (Malmont në Var: "mal" në gjuhën pellazge dihet që është Mal ashtu si dhe fjala mont frëngjisht rrjedh nga latinishtja "mons, montis") kështu edhe në Gjermani (Malberg: "mal" në gjuhën pellazge dhe "berg" që do të thotë mal në gjuhën gjermane). Përveç pellazgjishtes gjenden tautologji të tjera si kjo p.sh. e Val d`Aran ("aran" në gjuhën baske do të thotë luginë, gjithashtu edhe "val" ka kuptimin luginë) në Pirenejtë spanjollë, aty ku buron Garona. Në ishullin e Kios ekziston "burimi bourina". Mirëpo "burim, burimi, burima" dihet që në gjuhën pellazgo-shqipe është "burimi". Në këtë rast ka gjithashtu "përsëritje të së njëjtës fjalë" në dy gjuhë të ndryshme qoftë edhe "burim burimi", etj.

Tautologjitë e krijuara nga Grekët provojnë se me mbërritjen e tyre në gadishullin ballkanik, Egje dhe Azi e Vogël, Helenëve të parë iu është dashur qysh nga fillimi të asimilojnë apo të dekriptojnë gjuhën dhe emërtimet e ndryshme të vendeve dhe të perëndive si dhe emrat e përveçëm dhe të përbashkët të popullsive pellazge vendase.

E gjithë Greqia është e mbushur nga ky lloj dykuptimësi siç do ta vërejmë pak më poshtë.

Këtu do të rinis shkurtimisht studimin e fjalëve të vjetra pellazge, rrënjët e të cilave janë ruajtur me modifikime të lehta të sjella nëpërmjet shtimit të prapashtesave tipike greke. Bëhet fjalë për oronime dhe toponime të shumta nga më të shpeshtat, të përmendura që emërtojnë malësinë, malin dhe atë çfarë është e lartësuar nga ana gjeologjike të tilla si kodra, pllaja ose shkëmb i thepisur (Mal); pyll, pyllishte (Pyll, Pel, Pell); guri shkëmb (Guri dhe shtrembërimi i tij në greqisht në Gyr); vend i rrethuar, mur rrethues dhe më gjerë "qytezë e fortifikuar ose e rrethuar me mur rrethues" (Garth, Gart, Gurth, Gurt). Bëhet fjalë për fjalët më të vjetra europiane të ruajtura në gjuhën e sotme shqipe dhe ka të ngjarë se ngjitën deri në parahistori qysh në belbëzimet

e para të gjuhës. Ato janë marrë dhe ruajtur pothuajse të paprekura nga popuj të ndryshëm imigrues, të cilët i kanë pasuar ndër territoret të banuara fillimisht nga etnitë e trungut pellazg (Pellazgët, Ligurët, Lelegët, Karianët, Trojanët, Etruskët, Frigjianët, Thrakët, Ilirët etj.)

Ja pra lista jo e plotë e toponimeve kryesore dhe e oronimeve të një zanafille pellazge. Këtu bëhet fjalë vetëm për ato që kanë lidhje me Greqinë stricto sensu, Egjeun dhe Mesdheun lindor.

Akaje
* Pellene (qytet sipas Herodotit I, 145),
Arkadi.
* Malea (lokalitet, sipas Pauzanit VIII, 27/3, 5), Maloitas, Malus (lumenj, sipas Pauzanit VIII 36/1, 2), Maleatis (rajon pranë Megalopolit).
* Gortis (qytet).
* Gortinios (lumë).
Argolidë
* Një vend i shenjtë i Apolon Maleates që gjendej në rajonin e Epidaurit. Sipas Theokritit një nga Hamadriadat (nimfat e pyjeve të bashkuara me pemët) quhej Malis (ose Melis); Malos, bashkëshorti i Muzës Erato dhe mbret (Epidauri).
* Gurra (malësi), Gurra (qytet në verilindje të Peloponezit).
Lakoni
* Kepi Male (Malea, Maleaion oros) Apolloni Maleates, Maleagonos (atdheu i Silenës sipas Pindarit), Malicina ose Malitsina (fshat); Malthi (qyteti malor në Meseninë e Epërme).
Meseni
* Mali (fshat).
* Pylion (një nga gjashtë lokalitet që formonin rajonin e Pylos), Pyla (lokalitet)
Atikë.
* Malia Zonia (mal). Bëhet fjalë për një transkriptim pothuajse të përkryer të "Mali i Zonjës" të Shqipërisë
* Pylli (lokalitet)
" Gurra (burim)
Beoti
* Pyle (lokalitet pranë Tebës).
Etoli

* Malësi (lokalitet); Males (vëllai i Titormons, sipas Herodotit VII, 27).
* Pylene (lokalitet, sipas Homerit II, 639).
* Gyron (Mal)
Epir
* Maluni, on (lokalitet).
* Molosia (pjesë e Epirit). Ky vend malor e ka mjaft të përshtatshëm emrin e tij: Malësi në gjuhën pellazgo-shqipe dihet që është "Vend malor" dhe malësor "banor i maleve".
* Gurra (lokalitet në rajonin e Janinës)
Lokrida.
* Molos (lokalitet jo larg gjirit maliak).
* Kirtona (fshat malësor, sipas Pauzanit IX, 24/4, 5)
Maqedoni.
* Pylaia (fshat në rajonin e Thesalonikit), Pylorgi (lokalitet, rajoni i Pelas), Pyle (lokalitet në veri në rajonin e Florinës), Pyle (lokalitet).
* Gortinia (qytet)
Malidë
* Përveç emrit të këtij rajoni (Thermophyles) që e ka zanafillën nga mal, ekziston një lumë i quajtur Melas (Herodoti, VIII, 198, 199)
Pelagonia (vend i banorëve të "pellgjeve" dhe "liqeneve").
* Pylon, qytet i përmendur nga Straboni (VII, 7, 4) dhe që gjendet në Via Egnatia (d.m.th."rruga e gjata", emër tjetër i shpjegueshëm me anë të gjuhës shqipe egnatia = e gjata, nën kupton rrugën, në dialektin geg "enjata", por ajo gjithashtu rrjedh nga emri i krijuesit të kësaj rrugë dhe që ishte fisniku më i lartë i rajonit Cnaeus "Egnatius" (I gjati), emër me zanafillë ilire kuptimi i të cilit është Cnaeus "i madhi" dhe që duhet të ketë qenë trupmadh), pra rruga midis qytetit të Ohrit, buzë liqenit që mban të njëjtin emër dhe Herakleia antike (sot Bitola). Ky qytet sipas Strabonit ndante Maqedoninë nga Iliria dhe gjendej në një rajon malor dhe me liqene të mëdhenj (liqeni i Prespës është me i larti dhe më i thelli i Europës) Së fundi, emri "Pelagones" pa dyshim ka dalë nga Pellazgo-shqipja "pellg" që do të thotë edhe "pellg edhe ujëra të thella".
Thesali
* Malia (qytet antik, sot "Lamia"), Gjiri Maliak, Malloia (qytet). Malias dhe Meleis ose Malieis (antroponime).
* Pelion (mal), Pyle, Pylli (lokalitet).
* Gurra (mal), Gurra (fshat në rajonin e Larisas).
* Gyrton, Gyrtonë (qytet i Pellasgiotidës)

Thrakë
* Melas (gjiri "Melas Sinus", gjiri Saros - midis Thrakës dhe Kersonesës - sipas Strabonit (VII, 7/4; fr 51, 52, 53, 57) dhe Herodotit (VII, 58); Melas (lumë, sipas Herodotit VII, 58)
*Pylaia (lokalitet në rajonin e Aleksandropulit)
Orestia ose Orestida e Epirit (Tuqididi II, 80)
* Ky rajon i banuar qysh në kohë të hershme nga popullsi pellazge (Orestët, Molosët, Epirotët) u quajt Amfilokë pas pushtimit të krahinës nga Amfilokos, biri i Amfiaros, themeluesi i Argos të Amfilokisë dhe i quajtur gjithashtu "Argos Orestikon". Në vitet `20 arkeologët zbuluan në Dodonë (Epir) një mbishkrim (pllakë ortogonale prej bakri) që datonte prej shekullit IV para Krishtit, ku mund të lexoheshin dy emra që na interesojnë këtu: "Gyras Argeios". Orestët ishin të afërt me Molosët, popull pellazg i mirëfilltë. Molosë rrjedh nga fjala Mal, i cili ka dhënë edhe shqipen Malësor dhe Malësi. Gyras ose Guras Argeios do të thoshte pra malet e Argos orestike ose të Molosëve. Ekzistonte gjithashtu një lokalitet i Arkadisë (vend tjetër i lashtë pellazg) i quajtur Orsteion (sipas Herodotit) ose Orsetidë (sipas Tuqididit).
Astypalaia (ishull i Sikladave)
* Ky ishull quhej dikur Pyllaia
Kefaloni (ishull jonian)
* Pylaros (port), Pylareon (lokalitet)
Korfuz (ishull jonian)
* Pylides (një nga tri krahinat e mëdha malore të ishullit).
Gyaros: emër i lashtë i një prej Sikladave. Ky ishull sot quhet Giaros
Eube (Ishull i Egjeut).
* Pyll, Pylli (lokalitet)
Idhra ose Hydra (ishull i Egjeut)
* Gurri-Mathi (lokalitet); ky emër ka mbetur i paprekur sepse shkruhet pothuajse fjalë për fjalë ashtu si në gjuhën shqipe Gur i Madh!
Lesbos ose Mitilenë (ishull i Egjeut i quajtur dikur Pellasgjia).
* Malea (kep), Malia (majë mali), Apolon Maloeis (Herodoti III, 3), Malia (tjetër kep).
* Pyllaion (mal)
Karpatos (ishull në Egje)
* Emri i këtij ishulli shpjegohet nëpërmjet pellazgo-shqipes "karp, karpë" që do të thotë "shkëmb" dhe më gjerë ishull "shkëmbor" (e njëjta zanafillë pellazge për emrin e vargmalit të "Karpateve" në Ballkan).
* Malos ose Malios (mal në veri të ishullit).

Melos
* Ishull i Sikladave (Herodoti VIII, 46, 48)
Mikonos (ishull i Sikladës)
* Gyraiai, Gyrai (Giretë e Homerit IV, 500-509). Bëhet fjalë për "shkëmbinjtë" që gjenden, sipas disave, jo larg Mikonos ose midis këtij dhe ishullit fqinjë të Paros dhe sipas disa të tjerëve pranë ishullit Eube. Ka të ngjarë që më saktë është fjala për versionin e parë. Aty Ajaksi i Oilesë (prijës lokrian që kthehet nga Troja) mbytet nga përplasja e furishme e dallgëve mbi këta shkëmbinj. Poeti Arkilok i Paros e ka përmendur emrin Gyrai pa fjalën që e shoqëron petrai. Ai është i vetmi që nuk ka bërë të njëjtën tautologji si autorët e tjerë. Në Kretë kjo tautologji ("Gyrai petrai") ka krijuar një neologjizëm që emërton çdo "ishull shkëmbor që del mbi sipërfaqen e detit": "Gyropetra"
Samothrakë
* Ky ishull ka qenë quajtur Melitë sipas Strabonit (VII, fr. 50a).
Siros (ishull i Sikladave)
* Malia(fshat)
Tenedos (ishull turk i Egjeut)
* Malus, lokalitet që sipas Strabonit, që kap lumen Karesus, i cili buron në malësitë përreth.
Tenos ose Tinos (ishull i Sikladave).
* Gyras (mal, masiv malor).
Qipro
* Pyla (lokalitet), Pyla ose Pylas (kep), Pyleion (kep).
* Karpathos, pjesë e dalë shkëmbore në lindje të ishullit : karp, karpë, që në pellazgo-shqipen do të thotë "shkëmb" (e njëjta grafi me atë të ishullit Karpatos dhe atë të vargmalit Karpateve ose Karpateve të Balkanit).
Kretë
* Malia ose Mallia (qyteti i tretë i madh antik pas Knosos dhe Faestos), Malla, Males (lokalitete), Malion (gji deti). Maleci ose Maletsi (kep), Maliotis (përrua), Malles (fshat), Mallia (fshat).
* Mali Modhi (një nga majat e malit Dikte). "Madh, i Madhi dihet që në gjuhën pellazgo-shqipe është i "madh": a nuk ishte kjo maja e madhe, lartësia e madhe, mali i madh"?
* Gyropetra (qytet aktual), grafi kretase e Gyrai petrai që përbën të njëjtën tautologji që tregohet nga Homeri.
* Gortys ose Gortinë është emri i një qyteti të shquar antik parahelene (Agii Deka i sotëm) që gjendet rrëzë malit Ida nga shpati i tij jugor. Aty Zeusi e pleksi Europën nën rrapin gjithmonë të gjelbër.....

* Gortymaia (fushë e vogël në rrethinat e Gortys).

B - Ballkan, Azia e Vogël dhe zona të ndryshme lindore të Azisë.

Afganistan
* Guristan (vend shkëmbor ose me gurë), rajon malor i Afganistanit. Shënojmë se çuditërisht Armenët i quajnë Shqiptarët "Aghvank"! A janë afganët pjesërisht pasardhës të një etnie të vjetër pellazge (sigurisht që nuk bëhet fjalë për të kundërtën)? Për të ditur këtë duhet të vendoset të studiohet me themel gjuha, kultura, zakonet dhe historia antike e këtij vendi.
Azia e Vogël lindore.
* Gurta (qytet antik hitit).
Azia lindore
* Malasia, Malaysia (Malaisie).
* Himalaya (majë mali, më e larta në botë).
* Malabar (bregu malor në jug-perëndim të Dekanit).
Atarnanie (Azi e Vogël).
* Malene (lokalitet, sipas Herodotit VI, 29)
Bullgaria (Ballkan)
* Malevica ose Malevitsa (maja e malit Rila me lartësi 2730 m)
Kapadokë (Azi e Vogël)
* Malatya (Melitena antike). Ky qytet gjendej në Kapadokian lindore, në kufirin e sotëm të Kurdistanit turk.
Silisi (Azi e Vogël)
* Mallos (fshat i Malësisë)
Kolkidë (jugu i Kaukazit)
* Male (qytet)
Eolida (Azi e Vogël)
* Malene (lokalitet)
Frigji
*Gordium (kryeqyteti)
Indi
* Malloi, hero dhe luftëtar indian (Arrien, Anabazë VI, 6/1). Ka shumë të ngjarë të bëhej fjalë për një malësor dhe luftëtar të Indisë, ku Pellazgët kanë lulëzuar duke lënë një pjesë të madhe të kulturës së tyre, çka ka të ngjarë të jetë ripërtërirë në kulturën vediko-sanskrite ose të paktën ka ndikuar së tepërmi dhe ka krijuar toponime të shumta deri në Lindjen e Largët

(Himalaya, Malasia).
* Guraioi Indoi (fis malësor indian, vendi i të cilit laget nga "Gureos", përrua me guralecë) ky emër është treguar nga Arrien, historiani i Aleksandrit të Maqedonisë (Anabazë IV, 25/ 6, 7). A mos ishte ky emër që oficerët e Aleksandrit (në pjesën më të madhe Maqedonët, Ilirët, Agrianët...flisnin gjuhën pellazge) i kanë dhënë këtij fisi indian apo ka qenë emri i një etnie pellazge të indianizuar? Vetëm se një gjë është e sigurt, fjala Gur (shkëmb, gur, guralec" nuk është as greke, as latine as indiane. Megjithatë fakti që ushtarët e Aleksandrit duke kapërcyer përroin Gureos ose Guraios, ishin bezdisur nga "gurët çakëll" të mëdhenj të rrumbullakuar nga gërryerja e ujit ("gur" është një nga fjalët më të vjetra pellazge) vërteton përkatësinë e këtij emri me onomastikën e Pellazgëve.
* Matsya tribu (cf Mati në Shqipëri dhe Matianë në Azinë e Vogël).
Lindja e Afërme
* Pella (qytet i Palestinës, sipas Polibit VII, 70). Ky emër, i njëjtë me atë të kryeqytetit mbretëror të Maqedonisë shpjegohet nëpërmjet pellazgo-shqipes Pella (dialekti geg). Kjo nuk është për tu çuditur sepse Filistinët ishin Thrako-Ilirë pra Pellazgë. Përveç kësaj, emri "Peleshtim" që Hebrenjtë iu dhanë atyre nuk është gjë tjetër veçse një deformim fonetik i fjalës "Pelasgi". Të famshmit "Peleshet, Peleset" të Egjiptianëve.
Troada (Azi e Vogël)
* Gargar (një nga majat e malit Ida në Troadë). Këtu bëhet fjalë për një fenomen unik: përsëritja e të njëjtit emër në të njëjtën gjuhë. Në të vërtetë "Gur - gur".

C - Italia, mesdhetare perëndimore, Europa Perëndimore

Etruri (Tirrenia)
* Maleos, bir i Pelasgos, sipas Strabonit
* Gortinia (qytet)
* Kortona "
* Gurasion, sipas Diodorit të Siçilisë (XIX, 109), aty u zhvillua një betejë midis Romakëve dhe Etruskëve të Volsinisë
Europa qendrore
* Malului, mal i Transilvanisë perëndimore
* Pilna, lokalitet pranë Bryksit
Europa e Jugut
* Malmont (Draguignan,Francë)

* Malh (lartësi shkëmbore e Pirenejve)
* Malos, Malda (fshat malor, në veri të Tarragonës)
* Malaga (Andaluzi , Francë)
* Pirenej = Pyl e ne = "mali ynë" në gjuhën shqipe, (cf/Baskët = etni pellazge).
Itali (përveç rajoneve të Etrurisë)
* Krotone (qytet i Italisë jugore)
* Malis, në Siçili nimfa Hamadriada e pyjeve dhe maleve
Maltë
* Emri i këtij ishulli është pa asnjë dyshim me zanafillë pellazge. Në të vërtetë bëhet fjalë për një ishull "malor". Fjala "mal" e dëshmon këtë.

Kam zbuluar në Enciklopedinë e Madhe Greke (gjeografia e lashtë - Athinë 1932) një paragraf në lidhje me fjalën "Pylai, Pyllai", e cila siç e kemi vërejtur përbëhet nga rrënja pellazgo-shqipe "pyl, pyll". Është saktësuar që kjo fjalë është përdorur nga vende të ndryshme për të emërtuar rrugët e vështira për të shkuar në male dhe në veçanti përmes vendeve malore të tilla si në Greqi (Termopilet), në Babiloni, në Elam, në Persi, në Kaukaz, në Silisi dhe në Shqipëri. Nuk ka asgjë për tu çuditur për këtë: janë vende në të cilat Pellazgët e kanë shkelur tokën qysh nga mijëvjeçari i katërt deri në pushtimin e Aleksandrit të Madh në shekullin IV para Krishtit! Është e sigurt që autorët e kësaj flete enciklopedike kanë qenë të dokumentuar më së miri, të pajisur me manuale të burimeve serioze.

III - Fjalë të vjetra të tipit të përgjithshëm

Në kapitullin I dhe II kemi vërejtur (Ndikimet e pellazgjishtes së lashtë), sa të shumta janë huazimet (antroponimet, toponimet, oronimet) e marra nga gjuha pellazge njëherësh në Europë, Azinë e Vogël dhe në Azi (mbi të gjitha perëndimore).

Tashmë do të shqyrtojmë ndikime të tjera gjuhësore, mbi të gjitha të tipit të përgjithshëm. Këto janë të dallueshme në fjalorin e përditshëm të

shumë gjuhëve, ndër të cilat gjuha greke, latine dhe si rrjedhojë edhe në fjalorin e disa gjuhëve të dala nga të dyja këto, ndër të cilat frëngjishtja.

Mbi të gjitha kjo nënshtresë pellazge gjendet në vende të shumta të Europës, në Azinë e Vogël dhe në Kaukaz. Të gjitha këto fjalë të vjetra i kanë mbijetuar ndikimeve të ndryshme të huaja, modifikimeve të shumta dhe përzierjeve të ndryshme gjuhësore. Sa keq, autorë të shumtë modernë, duke mos e njohur apo duke njohur jo aq mirë gjuhën shqipe dhe mbi të gjitha dialektin e saj verior kanë besuar plotësisht se është kjo e fundit (gjuhën shqipe) që i ka huazuar këto fjalë nga gjuhët e tjera dhe pikërisht nga gjuha greke dhe latine, madje sllave e cila për më tepër është edhe një nga gjuhët e fundit që kanë hyrë në Europën lindore, rreth shekullit VII "pas Krishtit". Gjuha sllave, në veprën që keni në dorë, nuk është objekt i ndonjë studimi të veçantë për shkak të zanafillës së saj të vonshme si dhe të ndikimeve të ndryshme që ka pësuar nga gjuhë të tjera, ndër të cilat thrako-ilirishtja, paraardhëse e gjuhës së sotme shqipe.

Prandaj të gjithë këta dijetarë gjuhëtarë me një të rënë të lapsit kanë përjashtuar jo vetëm vërtetësinë historike të Pellazgëve por edhe vijimësinë e gjuhës së tyre nëpërmjet pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë Thrako-Ilirëve dhe Shqiptarëve të sotëm. Ja përse në këtë fushë të përpiktë (po e shënoj edhe një herë më shumë) Historia parahelene dhe Gjuhësia kanë mbetur në udhe pa krye.

Pra këtu është fjala për një studim krahasues që ka lidhje me ngjashmëri të ndryshme ose përafërsi gjuhësore midis pellazgo-shqipes dhe gjuhëve të shumta, ndonjëherë të huaja për sferën pellazgo-thrako-ilire. Pjesa më e madhe e këtyre fjalëve (duke përfshirë disa toponime dhe antroponime, të cilat nuk kanë qenë studiuar më parë në këtë vepër) kanë të bëjnë me latinishten, greqishten sepse disa gjuhë të tjera ndër të cilat gjuha etruske, ilire, baske, armene, anglo-saksone, kelte ose gjermanike do të jenë objekt studimi krahasues i hollësishëm në kapitujt e ardhshëm.

Këtu nuk është fjala për teori personale laboratorësh pa baza dhe as për përputhje të rastit. Pohoj, së bashku me Beonlev se "fjala, me të vërtetë i përket gjuhës në të cilën ajo nuk gjendet e izoluar, ku bën pjesë në të gjithë familjen e termave, nga të cilat njëra palë shpjegon tjetrën". Megjithatë historianë të shumtë dhe gjuhëtarë kanë nxjerrë mendime ose i renditin njëra pas tjetrës hipotezat krejt të përshtatshme, por sa keq që nuk ka patur radhitje, nuk kanë qenë shpalosur ose nuk kanë qenë "të pranuara bashkërisht" në këtë rreth të ngushtë specialistësh universitarë. Midis këtyre autorëve guximtarë dhe mendjemprehtë, pikësëpari mund të përmendim Severin (Greqia dhe Lindja e Afërt përpara Homerit, Brukseli 1960) i cili pohon: "U shqyrtuan fillimisht emrat e përveçëm gjeografikë dhe të njerëzve - të cilët më mirë se emrat e përbashkët ruajnë kudo kujtimin e një të kaluare tejet të hershme të pashkruar... Secili nga këta emra është formuar duke nisur nga një rrënjë (Kor-, Zak-, Pam-,..) të pashpjegueshme nga gjuha greke: ne përballemi me një gjuhë parahelene të përhapur gjerësisht në të gjithë Mesdheun lindor... Tri nga prapashtesat tona të bashkangjitura të njëjtit element rrënjësor "Myk" gjithashtu të pashpjegueshëm nga gjuha greke: ja përse bindesh se një gjuhë e madhe parahelene, të cilën ne e quajmë "egjease", është folur në një epokë të mugët në të gjithë këtë pjesë të botës.. Duke e krahasuar etruskishten e padepërtueshme dhe idiomën jo më pak misterioze, të përdorur në mbishkrimet e Lemnosit, specialistët kanë zbuluar përputhje të çuditshme.... Ka qenë e mundur të rindërtohen disa grimca të një gjuhe tirsene që flitej në mijëvjeçarin e dytë dhe që i ngjante shumë gjuhës tonë "egjease".... Meqë të gjitha këto fjalë nuk e kanë kapur greqishten e kohës së Etruskëve të Italisë, duhen parë huazimet ndaj kësaj gjuhë egjease, ku gjuha tirsenase është vetëm një variant. Ja ku jemi në pikën vendimtare... Pol Kreçmeri shkurtimisht për t`i dhënë një emër, gjuhën pellazge e bashkëngjiti pikërisht me gjuhën etruske".

Buonamiçi pohon nga ana e tij: "Ekuivalenca të shumta të lëmit

fonetik ekzistojnë midis etruskishtes dhe gjuhës shqipe. Shqipja paraqet një material të dobishëm krahasimi me etruskishten". Xhon Geipel (Antropologjia e Europës, Robert Laffont, Paris 1971) pohon: "njerëzit e Halstatit" flisnin një formë të gjuhës ilire. Gjuha e këtyre farkëtarëve austriakë mendohet se ishte gjuha ilire që i përkiste grupit indo-europian dhe fragmente thelbësore të së cilës mbijetojnë ende në gjuhën shqipe". Man mendonte se gjuha shqipe ka dalë nga Jafeti, i biri i Noes dhe se krijoi gjuhën sumeriane, elamite, azianike dhe kaukaziane. Mikloshi nga ana e tij shprehet: Në të gjithë Ballkanin janë Shqiptarët që kanë ruajtur numrin më të madh të elementeve glotologjike aborigjene".

Midis autorëve bashkëkohorë do të përmendja pikësëpari Fernand Brodel (Kujtime të Mesdheut, de Fallois, Paris 1998); "Këta popuj zanafillorë të Egjeut (Pellazgët e traditës greke) kanë lënë jo më pak gjurmë të thella. Analizat e gjuhëtarëve në lidhje me këtë janë të prera. Të ardhurit më të vonshëm, nëse e ruajtën gjuhën e tyre, bënë shumë huazime nga gjuha e të mundurve. Kësisoj gjuha greke trashëgoi përfundimisht një numër të konsiderueshëm fjalësh që për atë ishin të huaja. Këtë e thonë toponimia dhe onomastika, madje qartë si drita e diellit: qytete kaq të shquara si Korinti, Tirinti, Athina ose mali i Parnasit, në majë të orakullit të Delfit dhe në zemër të vetë Heladës, e cila është "kërthiza e botës", nuk kanë emra grekë. Nuk janë aspak grekë disa emra heronjsh homerikë, Akili, Uliksi (Odiseja) sa keq!... Edhe më kuptimplote është zanafilla jo greke e fjalëve të shumta në lidhje me bujqësinë: gruri, vreshtat, ullishtat, trëndafili, jasemini, zambaku, manxurana. Apo në lidhje me lundrimin: arti i lundrimit është një nga dhuratat më të vyera se vreshtat dhe ullishtat që Helada jo Greke u bëri këtyre pushtuesve indo-europianë, të huaj për detin: as thalassa, as pontos nuk janë me zanafillë greke !"

Më tej, Klod Borën pohon në librin e tij interesant "Grekët dhe Mesdheu lindor (PUF, Nouvelle Clio, Paris 1997): "Në Greqi, të gjitha këto krijime letrare që përbëjnë poezinë epike janë vepra të një autorësie

tejet të pasigurt... Ekzistenca – vetë mbizotërimi i mirëfilltë – i një kulture gojore në Greqi deri në fund të shekullit VI nuk ka lënë pa u nxjerrë gabimet e eruditëve të mësuar më shumë me dokumentin e shkruar... Ndërkohë që dihet se sa shkrime të denja për këtë emër, nëse arrijmë të bëjmë krahasimin, përbëjnë më të rrallat përpara luftërave medike... Ndoshta duhet kërkuar në popullsitë shqiptare dhe të Kosovës, trashëgimtare të popullsive të lashta ilire.. Vijimësia e një poezie epike të traditës gojore shqiptare deri në fillim të shekullit XX... Në fakt, kjo zgjedhje date që rrotullohet rreth viteve 1200 para Krishtit tregon se erudicioni modern është sjellë përqark së njëjtës pikë, i ngecur në qerthull nga një ripushtim i rremë i së kaluarës mitike, i përpunuar gjatë rrjedhës së shekujve nga dijetarët e kujdesshëm antikë për tu dhënë bashkëkohësve të tyre zanafilla njëherësh të largëta dhe të pranishme... [shënimi faqe 34]... Shfaqja e një tematike trojane nuk kërkon automatikisht mbishkrimin e saj në kuadrin e një gjeografie të përcaktuar dhe reale. Kjo përplasja e fundit mund të jetë futur shumë "vonë" (ndoshta në shekullin VI....). Është ky boshllëk që kërkonte të mbushte aq sa të mundte erudicioni antik... Është e pamundur që ndihmesa frigjiane dhënë qytetërimit grek të mos ketë qenë thelbësore, meqenëse edhe vetë të Lashtët pranojnë ta njohin".

Mund të përmend shembuj të tjerë të shumtë por edhe kjo është më se e mjaftueshme. Sidoqë të jetë kjo është kuptimplote dhe nuk ka nevojë për komente. Sa keq që këta dijetarë të shquar nuk e kanë mësuar apo studiuar me themel gjuhën shqipe, as nuk kanë bërë përqasje midis "gjuhës parahelene ose egjease të zhdukur" dhe gjuhëve që kanë dalë nga "pellazgjishtja e lashtë", të tilla si ajo thrake, frigjiane, ilire, etruske dhe shqipja e sotme: pa dyshim do të kishin arritur në të njëjtat përfundime me ato të nxjerra nga vepra që keni në dorë.

Ja pra një listë jo e plotë e huazimeve të bëra nga pellazgjishtja e lashtë, gjuhë që parapëlqej ta quaj për volitshmëri dhe me një fare logjike gjuha pellazgo-shqipe. Por përpara se të nis këtë listë do të përmend

fjalët frëngjisht të njohura, të na vijnë qoftë nga gjuha greke qoftë nga latinishtja, të cilat nuk të lenë vend për të dyshuar për zanafillën e tyre pellazge.

Baleine - balena

Karakteristikë e balenës, gjitari më i madh detar i sotëm, është koka e madhe ose balli. Emri grek i saj është "phaleina" ("b" nuk ekziston në gjuhën greke, shpesh e zëvendësuar nga digama "mp" dhe nganjëherë nga deformimi "ph" ose "v") prej nga vjen latinishtja "balaena, ballaena, ballena ose ballo". Në të vërtetë latinët e ruajtën "b" për shkak të pranisë së pellazgo-etruskishtes dhe të alfabetit të tyre, të cilin e kishin huazuar nga Etruskët dhe jo nga Grekët. Prej nga përfundimisht ka dalë edhe frëngjishtja "baleine". Por zanafilla e kësaj fjale është pellazgo-shqipja "ballë". Frigjianët, popull pellazg i quanin "Ballën" ata që ishin në krye, në ballë ose ata që ishin në radhët e para të "ballit". Përveç kësaj, vendi i Triballëve, quhej popull ilir "Triball" (në rajonin danubian të Beogradit të sotëm) d.m.th "Tri ballet" ose "tri malet". Për krahasim, pellazgo-shqipja "ballë" ka kaluar në fjalën "baleine". Mund të bëjmë një paralelizëm me fjalën "tetard" (larvë e amfibëve me "kokë" të madhe), zanafilla e së cilës ngjitet deri në shekullin XIII me kuptimin me "kokë të madhe"; pothuajse tridhjetë shekuj shkëputjeje frëngjishtja ka vijuar të njëjtën proces (e bazuar kjo në vrojtime) në krijimin e fjalëve apo emrave të tyre!

Barque - barkë

Kjo fjalë në frëngjisht është huazuar nëpërmjet provensales së vjetër nga latinishtja e vonë barca (barga), emër i dëshmuar qysh në shekullin III të erës sonë. Nëse shqyrtohet mirë kuptohet qartë që një "barkë" ka një formë "të barkut" d.m.th. "të rrumbullakuar". Zanafilla e kësaj fjale është pellazge dhe jo greke apo egjiptiane (?) siç është prirja për të na bërë ta besojmë një gjë të tillë. Kjo është krejt normale meqenëse

Grekët me mbërritjen e tyre në këtë vend që do të merrte emrin e tyre, kanë gjetur në viset e pushtuara një popull autokton: Pellazgët, nga të cilët ata huazuan një pjesë të madhe të gjuhës, kulturës, miteve dhe kulteve të tyre. Këta Pellazgë për t`i dhënë një emër barkës që krijuan, i mveshën emrin "bark", d.m.th. në pellazgo-shqipen "barku". Me kalimin e kohëve Shqiptarët kanë shndërruar "b" e fjalës "bark" në "v" pra "varkë" e cila ende sot ka kuptimin "bark". Përkundrazi, fjala "bark" është ruajtur në kuptimin e saj zanafillor. Pra, falë ekzistencës të kësaj të fundit arrihet të dekriptohet zanafilla e fjalës "barkë".

Biere...boisson....boire - birrë pije me pi

Këtu bëhet fjalë për një huazim nga hollandishtja e re: "bier". Kjo pije e fermentuar dhe e athët me kulpër ka zëvendësuar "cervoise" (nga latinishtja Cervisia dhe kjon vetë me zanafillë galeze). Gjithsesi, pavarësisht të tjerave që ka mundur të nxjerrë deri më sot, fjala "bière" rridhte nga latinishtja "bib ere" (me pi). Përsa i takon greqishtes, ekuivalentja është "pino, pinein". Aty gjithashtu, një fjalë kaq jetike si ajo që emërton "të pirët" ose "veprimin e të pirit" i përket vetëm fondeve të lashta të gjuhësisë: atij të Pellazgëve të parë, banorë të jug-lindjes europiane përpara mbërritjes së Grekëve. Në të vërtetë pellazgo-shqipja ka fjalën e saj "pirja" (pija) dhe "pi". Fjala e fundit bën pjesë në morinë e fjalëve njërrokëshe të belbëzimeve të para të gjuhës pellazge, të cilat u pasuan me krijimin e foljeve të përpunuara: pi, ha, pa, ba (me bë), ba (me mbajt), ra, ma (me mbajt), dha, sha (me shajt), tha etj.

Braiesbraguette - brekëbrekushe.

Kjo fjalë, me zanafillë galeze emërton një lloj pantalloni të ngushtë që mbajnë Galezët, Gjermanët dhe popuj të tjerë nordikë. Në dialektin breton kjo thuhet bragou. Por duke filluar nga shekulli XII Romakët e përshtatën njëlloj pantalloni më të gjerë të quajtur braca. Pastaj ka qenë fjala brago në gjuhën e vjetër provensale. Në shekullin XVI u

shfaqën fjalët brague, braguier dhe braguette dhe më pas të gjithë fjalët e prejardhura brayer, brayette, embrayer, embrayage, desembrayer, debrayer dhe debrayage. Ja pra çfarë na tregojnë enciklopedia dhe manualet etmiologjikë. Por askush nuk ka bërë as edhe përqasjen më të vogël me fjalën pantallona të ngushta që mbajnë Shqiptarët e veriut (gegët) si dhe Thrako-Ilirët: " brekë, brekushe". Sot, në shqipen e sotme ka edhe kuptimin e fjalës mbathje.

Epine dorsale - shtyllë kurrizore

Epine (gjembi), fjalë e huazuar nga latinishtja Spina. Përsa i takon fjalës Spina, ajo u shfaq në shekullin XVI, me latinishten e vonë "spinalis, spinal" (shtyllë kurrizore) dhe në shekulllin XIX "cerebro-spinal" (në lidhje me trurin dhe palcën kurrizore). Ky emër është emri tipik pellazgo-shqiptar "shpina" . "Spina", një nga qytetet më të vjetra të veriut të Italisë së lashtë u krijua nga Pellazgët e parë që mbërritën me Evandrin, Pellazgu i Arkadisë. Ky qytet pa dyshim përbënte një nga bazat kryesore "të pasme", d.m.th. të shtyllës kurrizore të Etruskëve, popull i të njëjtit trung me Pellazgët.

Genou - gju, gjuri

Kjo fjalë na vjen drejtpërdrejt nga latinishtja "genu", i cili rridhte sipas disa gjuhëtarëve prej greqishtes "gonia" (këndi) dhe "gonu" (gjuri) ose nga gjuha hipotetike indo-europiane "gen" (sanskritishtja = janu; persian = z an u; hitite = kenu...). Një fjalë kaq e rëndësishme siç ishte pjesa e trupit, mund të kishte veçse një zanafillë të hershme. Pellazgo shqipja ka fjalën e saj "gju, gjun" (geg).

Monument - monument = mani ment

Një tjetër fjalë interesante që nuk mund të kalojë pa u vënë re për shkak të simbolit që përfaqëson: t'i lerë brezave të ardhshëm kujtimin e një hyjnie, heroi, personazhi të rëndësishëm ose të një ngjarjeje falë

ngritjes së një ngrehine, të një vepre të skalitur, të një mauzoleu etj. Ky lloj veprimi është pasuri e popujve të qytetëruar ose që supozohen të tillë. Në të vërtetë Pellazgët (popull parahelen, i cili mund të quhet gjithashtu "mikenian", "egjeo-kretas"...) ishin jo vetëm një popull i qytetëruar (ata i përcollën qytetërimin e tyre Grekëve pasi këta të fundit i nënshtruan përfundimisht Pellazgët), por gjithashtu i lanë trashëgim brezave të ardhshëm vetë emrin e këtij veprimi bujar të mishëruar te "monument": mani men. Mani ment (dialekti geg i Shqipërisë së veriut) do të thotë "mbani mend"! Grekët me siguri e kanë huazuar këtë fjalë (μνημείοη) nga Pellazgët. Prandaj Latinët e kanë kthyer në monimentum, pastaj monumentum dhe që më në fund ka dhënë fjalën tonë frengjisht "monument". Kështu në këtë emër gjendet vetë emri i objektit të vet: kjo fjalë është njëherësh "emër" dhe "epitet". Çuditërisht, Shqiptarët të cilët për shkak të rreziqeve u strehuan në malet e tyre të pamposhtshme dhe që mbetën për një kohë të gjatë larg jetës qytetëruese si rezultat i pushtimeve të ndryshme të vendit, shumë herë gjatë mijëvjeçarëve e kanë huazuar nga Latinët këtë fjalë të të parëve që pa dyshim i përket trashëgimisë së tyre gjuhësore; ata do të duhej të thonin "maniment" në gjuhën e tyre të sotme, fjalë e cila qysh prej mijëvjeçarësh nuk ka ndryshuar as edhe një gërmë!

Oasis

Kuptimi akademik i kësaj fjale është si më poshtë: cilido rajon, (apo vend), i izoluar në një shkretëtirë apo në një hapësirë të thatë ku prania e ujit bëhet e domosdoshme për jetën, bimësinë, rritjen e kafshëve etj.

Pra ekzistenca e një oazi është e lidhur me praninë e ujit. Në ditët e sotme manualët etimologjikë ose enciklopeditë pohojnë se ky emër u shfaq në Francë për herë të parë rreth vitit 1561 të erës sonë dhe se më vonë u rrallua deri në vitin 1766. Ata shtojnë gjithashtu se kjo fjalë e nxjerrë nga gjuha egjiptiane rrjedh nga latinishtja e vonë. Gjithsesi si shumë fjalë të tjera të lashta, kjo fjalë ka qenë e njohur qysh nga autorët

e parë klasikë të antikitetit dhe kësisoj nga Pellazgët. Në të vërtetë duhet të jetë përhapur veçse në epokën e Aleksandrit të Maqedonisë. Në të vërtetë këtij i është kushtuar një vend i shenjtë i tempullit Ammon (orakull i famshëm i trajtuar si 'dublanti' i atij të Pellazgëve në Dodonë, cf. Herodoti II, 54-57) në një oaz të shkretëtirës libike në perëndim të Egjiptit dhe që quhet në ditët tona Sivah. Aleksandri, i cili fliste gjuhën pellazge (ishte një pellazg i mirëfilltë nga nëna e tij epirote dhe Pellazge e helenizuar nga babai i tij maqedonas) duhej ta njihte këtë emër "oasis". E pra na thuhet se kjo fjalë është me zanafillë nga gjuha egjiptiane! Nëse rrjedh nga gjuha egjiptiane moderne d.m.th. gjuha arabe, atëherë nuk mund të ketë zanafillë faraonësh. Unë mund të flas me njohuri të plota sepse gjuha arabe është një nga tri gjuhët që kam mësuar qysh se kam lindur, sëbashku me frëngjishten dhe gjuhën shqipe. Pas kërkimesh të shumta kam zbuluar që fjala egjiptiane "uaha" ose "oaha" është krijim tipik egjiptian. Në të vërtetë, manualët gjuhësorë arabë pohojnë se emri oaha (njëjës) ose oahat (shumës) ka qenë futur në gjuhën arabe nga egjiptianët e kohëve moderne. Megjithatë emri arab në konceptimin e tij të vërtetë për të emërtuar një "vend të mbuluar nga një bimësi e dendur dhe që ka ujra" është rauda (njëjës) dhe riad (shumës)... Emri egjiptian uaha a mos është një shtrembërim i madh i oazit tonë? Sido që të jetë ky emër shpjegohet në mënyrë të përkryer nga pellazgo-shqipja "ujësi" qoftë edhe në transkriptimin fonetik "oujësi". Kjo fjalë në pellazgo-shqipen do të thotë "vend, vendth që ka ujë". Mbi të gjitha a nuk është fjala për ujin pa të cilin nuk do të kishte oaz? Fatkeqësisht kur Shqiptarët dolën nga përgjumja e tyre shekullore për të hyrë në qytetërim dhe deshën të shkruanin në gjuhën e të parëve të tyre ata e huazuan nga gjuha greke dhe latine (të kthyera në gjuhë të qytetërimit) një grup fjalësh të modifikuara ose plotësisht të shndërruara, por që gjithsesi i përkasin trashëgimisë kulturore dhe gjuhësore të Pellazgëve d.m.th. të parëve të tyre. Me që është rasti, Shqiptarët oazin e quajnë "oazë", ndërkohë që do ta quanin ujësi, fjalë stërgjyshore që gjithsesi ekziston gjithmonë në gjuhën e tyre!

Olivier, olive = Ullishtë, ulli

Është fjala për një nga fjalët më të vjetra të njerëzimit. Në mënyrë paradoksale ky emër nuk rrjedh as nga latinishtja as nga greqishtja. Disa pohojnë se zanafilla e tij është parahelene. Kur dihet se Parahelenët ishin Pellazgë nuk mund të rrish pa kërkuar ndihmën e gjuhës shqipe. Në të vërtetë "ulli, ullia" është emri i ullishtes dhe i ullirit. Ulliri dhe ullishtja në greqisht thuhen "elas, elai, elaia". Latinishtja e ka kthyer në "oliua" pastaj "oliva", prej nga rrjedhin emra të tjerë të huazuar nga gjuhët romane. Meje në lidhje me këtë thotë (Skemë e historisë së gjuhës latine. Klincksieck, Paris 1977): "Emri grek për vajin dhe ullirin janë të një zanafille "egjease"... Rasti i oliua, oleum tregon se huazimet e latinishtes në gjuhën greke janë pjesërisht ato fjalë që vetë greqishtja i ka huazuar nga bota egjease". Po shtoj paragrafin në vijim të Meje (Vështrim mbi historinë e gjuhës greke, Klinscksieck, Paris 1965): "Se sa janë të panjohura gjuha apo gjuhët e qytetërimit "egjeas" nuk ka as edhe një mjet që të shtjellojë atë që greqishtja ka huazuar nga kjo anë. Por nuk duhet t`ia mveshim indo-europianes atë që ka mundësi të jetë më saktë egjease". Meje si dhe shumë gjuhëtarë e ka kuptuar mirë se gjuha greke kishte huazuar një numër të madh fjalësh me zanafillë siç i quajnë ata parahelene, egjease, jo indo-europiane ose gjuhë parahelene e zhdukur (të katër emërtimet ngatërrohen dhe bashkohen). Fatkeqësisht, megjithëse e njihnin paraekzistencën e qytetërimit pellazg, nuk kanë bërë as edhe një përqasje midis gjuhëve pellazgjishte e lashtë, etruskishte, frigjiane, thrake, ilire dhe shqipen e sotme. Për më tepër ata nuk e njohin fare gjuhën shqipe dhe dialektin e saj geg.

Sanitas

Në latinisht kjo do të thotë "shëndet" (i trupit) si dhe gjendje e shëndetshme në humor të mirë ... Ndërsa "hygieia" do të thotë në greqisht "gjendje fizike" dhe "eleksia", "të jesh me shëndet të mirë". Në shqip "santé" është "shënet" në dialektin geg, gjë që padyshim ka krijuar në latinisht "sanit (as)".

Sceptre = Skeptri

Në latinisht kjo fjalë është sceptrum dhe në greqisht skeptrikos, skeptrikoi, skeptron. Kjo fjalë bën pjesë në një nga fjalët kryesore të zanafillës pellazge. Në të vërtetë "skeptri" i Zeusit ("pellazg" të Homerit) formohej nga një lloj shkopi, në njerin nga skajet e tij kishte një "kokë ose sqep shqiponje" (simbol i 'autoritetit'). Mirëpo "skep, sqep" dihet që në në shqip do të thotë sqepi i shqiponjës ose të një zogu në përgjithësi, ndërkohë që sqepi i zogut në gjuhën greke është "stoma". E. Benveniste (Fjalori i institucioneve europiane, II–. Editions de Minuit, 1969) pohon në lidhje me këtë: "Në serinë e termave që kanë të bëjnë me mbretin dhe mbretërinë, duket e drejtë të futësh emrin e një prej shenjave më të volitshme për funksionin mbretëror, skeptrin që është emërtuar në greqisht me "skeptron" (σχηπτρου) . Kjo nuk është termë europiane: në fakt është e kufizuar vetëm në greqisht. Zeusi e jep si simbol të legjitimitetit me ata që ai i përcakton të flasin në emër të tij". Përfundim që flet vetë!

Speleologie = Speleologjia

Rrënja speleo bën pjesë gjithashtu në fondet e vjetra gjuhësore të Pellazgëve. Frëngjishtja e ka trashëguar drejtpërdrejt nga greqishtja spelaion (shpellë) të cilës i ka shtuar logos (shkencë). Nga kjo rrjedh fjala latine spelunca (shpellë). Në të vërtetë kjo fjalë është thelbësore sepse hyn në përbërjen e etnonimisë së Pellazgëve, emër që do të thotë njerëz të shpellave apo "shpellagji". Ende sot, në gjuhën shqipe i thonë "shpellë". Gjithsesi "nocioni" i "shpellës apo guvës" është ruajtur në emrin që disa Shqiptarë të veriut (në veçanti në krahinën e "Matit") kanë për "shtëpinë": shpej, e cila rrjedh nga fjala shpellë (reminishencë e banesës së tyre të lashtë)!

Statue

Kjo fjalë rrjedh nga latinishtja statua dhe stare (me qëndru në këmbë) dhe nga greqishtja statos (ai që është në këmbë, i fiksuar) dhe më gjerë

kemi anorias, antos, agalma (mbi të gjitha për një statuje perëndie) dhe akhema, atos (shtati). Kjo fjalë e fundit rridhte nga fjala semitike (arabe): kama, ukama (me u ngrit, me u drejtu, me qendru në këmbë). Në shqip kemi fjalën shtat. Por për të thënë me qenë më këmbë në gjuhën shqipe thuhet "rri" ose "qëndroj në (më) këmbë". Disa thonë që fjala "statue" (statujë) rrjedh nga fjala indo-europiane "sta" (me qëndru në këmbë). Por ç`është kjo gjuhë indo-europiane? Kjo ka ekzistuar vetëm në komentarët e gjuhëtarëve të shekullit XIX.

Securité = siguri

Një tjetër fjalë e rëndësishme. Frëngjishtja e ka trashëguar nga latinishtja 'securitas, securus'. Në latinisht kemi "siguro". Greqishtja, ka një tjetër fjalë tipike greke "adeia" (siguri) dhe "asphales" (pa rrezik). Latinishtja rrjedh pa asnjë dyshim nga shqipja "si gur". Përveç kësaj nga fakti që Pellazgët dhe pasardhësit e tyre "betoheshin mbi gur", fjala "si gur" është një fjalë që do të thotë "e fortë si guri" dhe më saktë kishte vlerën e diçkaje "të fortë dhe të sigurt". Sot a nuk themi në



Kompleksi ballkano-danubian (e vijëzuar)
Sipas J.P. Mallory (Në kërkim të Indo -Europianëve - Seuil / 1997)

gjuhën tonë popullore "është prej betoni" që do të thotë "e fortë si beton" dhe që në fund të fundit do të thotë "e sigurt".

Thoraks = toraksi

Kjo fjalë na vjen drejtpërdrejt nga gjuha greke "thorax, Thorakos". Zanafilla etimologjike e kësaj fjale gjendet në pellazgo-shqipen: "thurr, thurrës, thurrim me kuptimin e të thurrurit rreth e qark për tu mbrojtur". "Thorax" a nuk mbron organet tona kryesore (zemrën dhe mushkërinë)?

Caerimonia

Kjo fjalë në latinisht do të thotë "respekt fetar, nderim i thellë, kult, ceremoni". Në pellazgo-shqipen kemi fjalën "kremt, kremtë" (festë) dhe "kremtoi" (me festu, me kremtu). Gjuha hitite (e një familjeje me pellazgjishten e lashtë) ka fjalën "karimi" (tempull) dhe gjuha etruske ka "caerimo". Për arsye të traditave të kultit shumë të zhvilluara te Etruskët, për shkallën e tyre të qytetërimit, për të qenët të një familjeje me Pellazgët dhe ekzistencën e tyre të mëparshme historike, sigurisht që nuk janë Latinët ose Romakët në zanafillë të kësaj fjale pellazge.

Captus, Captivus

Latinishtja "captus" do të thotë 'veprimi i kapjes, të marrjes apo të fitimet" dhe "captivus" do të thotë "i burgosur, i kapur, i mundur". Shqiptarët nuk ka mundësi ta kenë huazuar nga Latinët një fjalë kaq thelbësore në gjuhën e tyre. Për më tepër gjuha shqipe rrjedh drejtpërdrejtë nga pellazgjishtja e lashtë dhe ka ruajtur fondin e saj më të lashtë gjuhësor. Mirëpo në gjuhën shqipe "kap" do të thotë "me kap, me marr, me zë, me pushtu". Kjo rrënjë pellazgo-shqiptare madje është përdorur për "constipé" = "kaps" që do të thotë mbetesh kapsë! "Captus, captivus" duken të izoluara në gjuhën latine ndërkohë që në gjuhën shqipe "kap" nuk mbetet e tillë. Për më tepër që në latinisht "me marr" thuhet "prehendere, apprehendere" dhe "me kap" thuhet "decipere, fallere, excipere".

Caput

Qysh prej më shumë se një shekulli, të gjithë gjuhëtarët kanë shqyrtuar zanafillën (e vonë) të kësaj fjale në gjuhën latine që do të thotë "kokë". Në këtë gjuhë, ashtu si edhe për "captus" bëhet fjalë për një fjalën që bën pjesë morinë e belbëzimeve të para të njeriut prehelen. Latinët e kanë huazuar fjalën caput nga etruskët ose nga popuj të tjerë pellazgë që kanë banuar rreth Latiumit. Në të vërtetë "kokë" në gjuhën pellazgo-shqipe është kaptinë, kaptenë (dialekti geg i veriut) që më vonë ka dhënë në gjuhën anglo-saksone fjalën "captain" (kapiten) dhe në gjuhët romane "capitaine, capitano, capitao ... dhe capo (prijës)". Kokë në gjuhën shqipe përdoret më shumë në dialektin tosk dhe gjuhën e shkruar të sotme ndërkohë që fjala kaptenë është kaluar si "fjalë folklorike" ose term "geg i papërdorshëm". Në sanskritisht "kokë" thuhet "kapucchalam" dhe në greqisht "kephalë" dhe "kara".

Kranion

"Kranion" (te Homeri "kraiaino", që është kthyer më vonë në kraino, është gjithashtu një fjalë e dëshmuar te poetët tragjikë grekë me kuptimin "mbretëroj") që do të thotë në greqisht "kafkë". Me sa duket rrjedh nga "kara" (kokë) e cila ka krijuar kraino me kuptimin "kryër, përfunduar" dhe gjithashtu "me komandu". Helmeta quhet "kranos". Çuditërisht ekziston një tjetër fjalë e papërdorur për të thënë "kokë": "kras, kratos". Në sanskritisht kemi "sirsan". "Tullac" thuhet në greqisht "phalakros". Përsa i takon latinishtes kafka quhet "calva, calvae" prej nga "calvus" (tullac) dhe prej së cilës në frëngjisht kemi "calvitie". Gjithashtu është pellazgjishtja e lashtë që na ofrohet për deshifrim nëpërmjet gjuhës shqipe të sotme. Në të vërtetë rrënja zanafillore gjendet në gjuhën shqipe "kre" (geg=koka, kafka) dhe në dialektin tosk "krye" (kreu) dhe të gjithë emrat e prejardhur "krenar"; për ta përqasur me kuptimin tjetër guximtar, kapadai, "kreshtë", "kreh", "kros" ("tullac" në dialektin geg). A nuk gjendet fjala e fundit në

prapashtesën e fjalës greke "phalakros" (tullac)? Këtu nuk do të debatoj në lidhje me të gjitha shpjegimet që janë sjellë për këtë fjalë dhe që janë të shumta. Vetëm do të shënoj se gabimi i kryer nga gjuhëtarët ka qenë ai i trajtimit të sanskritishtes dhe të greqishtes (baza e studimeve dhe hulumtimeve të tyre) si gjuhë më të lashta se gjuha shqipe, kjo e fundit e nënvleftësuar madje e trajtuar si një sasi e vogël (disa e trajtojnë madjé si një gjuhë hibride ose pa zanafillë të saktë!) ndërkohë që ajo është trashëgimtarja e drejtpërdrejtë e pellazgjishtes së lashtë.

Far, Farina

Fjala "far" do të thotë në latinisht "grurë" e cila nëpërmjet metonimisë ka krijuar "farina" (miell). Por zanafilla e kësaj fjale është mëse e dukshme: "farë" është fjalë e gjuhës pellazgo-shqipe. Pra "gruri" i Latinëve domethënë "far" është "prodhim" i "farës". Pra nga metonimia e parë vjen emri i grurit te Latinët, nga e cila rrjedh latinishtja "farina". Ndërkohë që në pellazgo-shqipen fjalën "grunë" (geg) e huazuan Latinët dhe e kthyen në "granum". Sipas shpjegimit akademik të dhënë nëpër manualet gjuhësorë "granum" do të thotë "çdo kokërr që përmban kalliri i drithërave". Si rrjedhojë është fjala për "kokrrën" e drithërave dhe në këtë rast për grurin.

Në të njëjtën mënyrë far/farina është pellazgo-shqipja "miell" ("me mbjell" në dialektin geg) që ka krijuar fjalën "miell". Pra edhe në këtë rast bëhet fjalë për "farën". Kjo bazë gjuhësore zanafillore nuk është aspak befasuese për arsye të afrisë midis Etruskëve dhe Latino-Romakëve për shekuj me rradhë. Gjithsesi një tjetër qytetërim vjen dhe ngatrërron pistat gjuhësore. Kjo sepse "me mbjell" në latinishten klasike i thonë "serere" dhe në latinishten e vonë "seminare" dhe mbjellja thuhet "sero", "semen" (latinishtja klasike) ose "sementia" (latinishtja e vonë). Ndërkohë që në greqisht thuhet "speiro" për foljen "me mbjell" dhe "sperma" për "mbjelljen". Ka të ngjarë nga shkrirja e "p" (ose nga zvetënimi i gjuhës) që "s(p)eiro" do të ketë qenë në zanafilën e latinishtes "sero" e cila është përhapur në shumë gjuhë indo-europiane.

Granum

"Granum" në latinisht do të thotë "kokërr" dhe gruri është "far, frumentum, framentum"; në greqisht "sitos", "pyros" (grurë), "zeiai" (grurë), "karpoi, demetros"(drithëra), "kokkos" (fara e një bime) dhe "sperma" (farë), "speiro" (me mbjell); në irlandishten e vjetër "gran"; në gotishten "kaurn"; në sanskritisht "dhanas" (grurë, kokërr); në gjermanisht "korn"; në anglisht "grain"; në italisht "grano, chicco"; në spanjisht "grano".

Në pellazgo-shqipen i thonë "grunë" (dialekti geg). "Graine, semence" kanë në shqip të njëjtin kuptim: "farë". As në greqisht as në indo-iranianen nuk ekzistojnë ekuivalente të latinishtes "granum" që bën pjesë në fjalorin e Europës perëndimore dhe veriore dhe që pa dyshim është huazuar në një kohë shumë të hershme nga popullsitë pellazgo-danubiane, ndër të cilat gjuha shqipe e sotme ka ruajtur rrënjën zanafillore. Gjithsesi shënojmë se autorët antikë pohojnë që në rajonin ballkano-danubian, Pellazgët ishin zanafilla e bujqësisë si dhe e elementeve të tjerë qytetërues, ndër të cilët ujitja, përdorimi i metalit, ndërtimet ciklopike etj.

Sclavus, slavus

Kjo fjalë vjen nga latinishtja mesjetare. Kjo fjalë është në zanafillën e frëngjishtes "esclave" me kuptimin "ai që nuk është në kushte të lira ose ai që është në varësi të një zotërie i cili e ka blerë ose e ka kapur". Ja shpjegimi akademik.

Disa pohojnë se në rajonin kufitar të Italisë verilindore, një pjesë e popullsive që në kohën tonë quhen "sllave", kishin përfunduar në skllavëri pak pas mbërritjes së tyre, rreth shekullit VII pas Krishtit. Te Romakët, zotër të rajonit (Venetie dhe Istria, të cilat bënin pjesë në provincat ilire të Romës) kjo fillimisht ka krijuar fjalën sclavus pastaj slavus. Por kjo fjalë duket të ketë qenë formuar në rajonin e Venecias (Venetët ishin një popull ilir cf, Herodoti, I, 196). Mirëpo në shekullin II para Krishtit ne e dimë që Romakët i kishin pushtuar të gjithë

territoret e banuara nga Ilirët, ndërsa Sllavët arritën në këtë rajon vetëm në shekullin VII pas Krishtit. Në këtë epokë të mëvonshme, në rajonin e Venecias gjithmonë mbijetuan populsi të trungut ilir, të nënshtruara pushtetit të Romës dhe nganjëherë duke mbështetur kauzën e saj (perandorë të shumtë romakë ishin me zanafillë thrako-ilire). Mirëpo meqë asnjë qytetar romak nuk mund të ishte skllav, atëherë kjo fjalë nuk mund të kishte zanafillë latine. Pa dyshim që është një krijim vendas i marrë më pas nga Romakët. Në të vërtetë ne e kemi shpjegimin në gjuhën pellazgo-shqiptare "ska llaf", fjalë që ka kaluar në fjalë të përngjitur "skllaf". Kjo do të thotë "ai që nuk ka të drejtën e fjalës", pra nuk ka lirinë për të folur ose për të vepruar dhe si rrjedhojë "i privuar nga liria".

Kjo përputhet krejtësisht me kuptimin e fjalës "skllav apo skllavëri". Për të kujtuar shënojmë që Grekët nuk kanë patur fjalë për të shënuar skllavërinë. Për këtë rast ata përdornin fjalë të huaja ose emrin e të huajve që kishin rënë në skllavëri. Është rasti i fjalës "doulos" (fjalë e huaj e leksikut pellazg), e cila sipas disa gjuhëtarëve do të jetë me zanafillë jo greke. Grekët, shumë më vonë, në epokën bizantine krijuan sipas modelit të mëparshëm fjalën "sklavenoi" dhe fjalën e prejardhur etnike "sklavoi". Në këtë mënyrë bota perëndimore përshtati përfundimisht fjalën "skllav" dhe si rrjedhojë emrin "Slave". Unë po e përfundoj këtë paragraf me këtë frazën kuptimplote të nxjerrë nga libri i Emil Benvenistë (Fjalori i institucioneve europiane, Edition de Minuit, Paris 1969) : "Nocioni i skllavit nuk përmban një emërtim unik: as për tërësinë e gjuhëve indo-europiane as edhe për grupe të shumta dialektore".

Hippos

Kjo fjalë do të thotë "kalë". Te Homeri, Frigjianët dhe Thrakët (popuj pellazgë) njiheshin si rritës dhe stërvitës të shkëlqyer të kuajve. Hippos rrjedh nga fjala pellazge e lashtë (hip) siç edhe do ta vërejmë më tej...

Le të shohim fjalën kalë edhe në gjuhë të tjera. Sanskritishtja ka

fjalën "asvas", avestistike "aspa" dhe latinisht "equus". Por latinishtja, gjuha e popullit, ka përshtatur fjalën "caballus", e cila fillimisht do të thoshte "kal i dobët" (e huazuar nga një gjuhë "jo indoeuropiane" sipas gjuhëtarëve) dhe që ka eliminuar klasiken "equus" (kalë). "Caballus" ka sjellë fjalën italiane "kavalo" dhe atë franceze "cavalier" (fjala "cheval" [kali] më saktë rrjedh nga galishtja). As gjuha greke, as ajo latine nuk e kanë huazuar emrin e kalit nga një gjuhë e mbiquajtur indo-europiane, ashtu siç e pamë. Në të vërtetë, nëse vendosim të futemi në gjuhën pellazgo-shqiptare, vërejmë qartë që këto dy gjuhë, secila në mënyra të ndryshme, i kanë përdorur këto dy fjalë pellazgo-shqipe: gjuha greke fjalën "hip" dhe latinishtja fjalën "kal, kalë". Përse? Ja edhe shpjegimi.

Grekët, të cilët mbërritën më vonë në gadishullin e Ballkanit, në vendin e pushtuar gjetën kalorës të shkëlqyer të cilët ua mësuan atyre zanatin e rritjes dhe stërvitjes së kuajve si dhe artin e të "të hipurit në kalë". Për t`i dhënë një emër kalit të tyre ata huazuan nga autoktonët foljen "hip" dhe "hipia, hipja". Në këtë mënyrë ata cilësonin "atë që hipën" = "hip...os" ("os" dihet që është prapashtesa e mirëfilltë greke).

Por ka të ngjarë (për arsye të të qenit afër me Etruskët) latinët krijuan fjalën "ca(b)all(us)" për të emërtuar kalin e tyre: një emër që rrjedh drejtpërdrejt nga pellazgjishtja e lashtë "kal, kalë" dhe që bën pjesë në fondin më të lashtë gjuhësor.

Ialysos

Qytet që gjendet në verilindje të ishullit të Rodit bashkë me tri nga qytetet më të lashtë të ishullit: Lindos (juglindje) dhe Kameiros (perëndim). Ishulli ishte pushtuar nga Mikenianët (Pellazgë) qysh nga shekulli XV para Krishtit. Nuk ka pse të habitemi që ky emër shpjegohet nëpërmjet gjuhës pellazgo-shqipe "ialli" (jalli) që do të thotë "pellg, fushëgropë". Emrat e dy qyteteve të tjera janë gjithashtu të shpjegueshëm me anë të gjuhës pellazgo-shqipe: Lindos përqaset me "Lind, Linda, Lindja" (lindja e njeriut, lindja e diellit, lindja si pikë

horizonti) dhe Kameinos që përqaset me "ka maré" (geg), pra vend me maré (lloj shkurreje). Gjithsesi një tjetër fjalë, gjithashtu, përkon me Kameiros por që kërkon të vërtetohet apo të mbështetet me anë argumentesh të lidhura me një apo disa ngjarje apo fakte historike, të lidhura me nocionin e "marrëzisë" ose të "turpit" të përmbyllura në pellazgo-shqipen "ka marré" (ekzistenca e budallallëkut ose e marrëzisë) ose "ka marré, ka marri" (që do të thotë "ka turp" në dialektin geg).

Pharae, Pharai

Pharae është emri i një qyteti të Kretës dhe i tri qyteteve të tjera të Greqisë kontinentale që mbajnë emrin Pharaj (Akaje, Meseni, Beoti). Ky emër shpjegohet në mënyrë të përkryer nga pellazgo-shqipja: "farë, fara" që shpjegohet "farë, fis, racë".

Psatar (Pshatar)

Kjo fjalë do të thotë "qytetar" në gjuhën e Kabardas (Kaukaz). Kjo qartë të kujton fjalën shqipe "fshatar". Nuk ka asgjë për tu habitur se në këtë rajon të Kaukazit gjenden fjalë të shumta të shpjegueshme me anë të gjuhës shqipe sepse në epokën e Aleksandrit të Madh në Kaukaz ekzistonin etni të shumta të trungut pellazg, madje një rajon i quajtur "Shqipëri e Kaukazit" (sot Legistan, Dagestan, Shirvan) sipas autorëve të shumtë antikë, ndër të cilët Ptolemeu dhe Arrian (Anabaza e Aleksandrit të Madh, III, 8/4).

Signum

Kjo fjalë latine është në zanafillë të frëngjishtes "signe" dhe fjalëve të prejardhura kryesore të saj, signer, signature, signifier, signification, signal, signaler. "Signum" në latinisht do të thotë, tregues, shenjë, provë, simptomë, shenjë paralajmëruese... Në greqisht "signum" thuhet "semeion, sema, semaino". Në shqip kjo fjalë është "shenjë" dhe gjithë fjalët të prejardhura të saj janë "shënim, shënoj" dhe "shënuar" si dhe "shenjoj".

Thalassa

Etimologjia e kësaj fjale kurrë nuk ka qenë ndonjëherë e sqaruar sa duhet. Nuk gjendet asnjë shpjegim i mjaftueshëm në gjuhën greke. Kanë kërkuar të gjejnë në këtë gjuhë "tarasso" (onomatope që imiton shushurimën e dallgëve). Përkundrazi gjuha greke zotëron terma të tjera në lidhje me detin: pontos, pelagos (që të dyja do të thonë "deti"), als (pellg), tallaszi (dallgë, valë).

Fjala mund t'i përkasë vetëm asaj gjuhe të lashtë ku gjendet në harmoni edhe me termat e tjera. Mirëpo të gjithë autorët antikë pohojnë se Pellazgët, Egjeo-kretasit, Leleget, Karianët, Filistinët, Frigjianët, Thrakët, Ilirët dhe Etruskët (këta janë "Turshat" e famshëm, Popuj të Detit, që shumë herë referohen ndër tekstet me hieroglife egjiptiane) ishin të familjarizuar me detin që në mugëtinë e kohërave, pra shumë më përpara se Grekët: shumica e "Popujve të Detit" ishin me zanafillë Pellazge, deti Adriatik (Adria, emër ilir) quhej deti Jonian që është vetëm një transkriptim fonetik e pellazgjishtes "deti i jonë" pra "deti jonë" d.m.th ai i pellazgo-ilirëve dhe që Grekët përveç kësaj e quanin "Ionion pelasgos", deti tirrenian ishte "deti i Etruskëve" dhe në të gjithë bregdetin grek ne gjejmë emërtime të zanafillës pellazge të tilla si "gjiri maliak", "gjiri pellazg" dhe "Thrakiko pelagos" (pjesa verilindore e detit Egje buzë gjithë bregdetit thrak). Pa harruar që "në det të hapur" në greqisht i thonë "pelagos".

Kësaj i shtojmë pohimin e Tuqididit sipas të cilit Korintianët ishin të parët grekë që ndërtuan anijet, ndër të cilat "triere"[1] janë rreth tri shekuj përpara fundit të luftës së Peloponezit (1, 13): d.m.th. nga fillimi i shekullit VII para Krishtit ndërkohë që Pellazgët tashmë kishin kontrollin e detrave qysh 15 shekuj më parë. Sidoqoftë pjesa më e madhe e komentarëve në lidhje me këtë çështje pohojnë se Grekët kur mbërritën nuk zotëronin as edhe një term për të emërtuar "detin". Kësisoj ata i huazuan nga Pellazgët emrat e perëndive të tyre, madje pa

[1] *Triere - Lloj anije e Greqisë së antikitetit.*

kuptuar domethënien e saktë të tyre. Kështu emrat Tethy (s) dhe Theti (s), perëndesha detare të mirëfillta rrjedhin nga pellazgo-shqipja "deti".

Prandaj, meqënëse nuk e kuptonin çfarë do të thonin këto fjalë, ata përdorën për të emërtuar detin një tjetër fjalë pellazge "tallaz" që në pellazgo-shqipen do të thotë "dallgë e madhe". Përveç kësaj fjala e fundit ka qenë huazuar nga gjuha ilire prej sllavëve (një popull i lidhur me tokën, i cili kishte mbërritur nga stepat e Lindjes dhe që nuk e njihte detin). Kjo termë u bë "talas" te Sllavët, duke ruajtur të njëjtin sens si ai i paraqitur nga Thrako-Ilirët, popull pellazg që kanë jetuar në të gjithë rajonin ballkanik dhe që sot zihet nga popujt sllavë qysh prej shekullit VII pas Krishtit.

Dhe së fundi ja edhe mendimi i Meje (Një vështrim mbi historinë e gjuhës greke - Klincksieck, Paris 1965): "Dhe kështu greqishtja, gjatë një farë kohe padyshim që nuk ka patur kurrfarë emri për detin... Përveç kësaj, greqishtja ka emra të tjerë për "detin" dhe shumë të vonshëm: pontos... pelasgos... dhe thallatta, zanafilla e të cilave është e turbullt dhe pa dyshim që janë huazuar nga ndonjë e folur parahelene e Mesdheut... Deti në gjuhën greke nuk ka emër të lashtë; përveç kësaj, nuk ka emërtim tjetër, përveç emrit indo-europian si e tregon grupi këtu më poshtë" etj. Kjo është domethënëse dhe e mbështet argumentimin tim të mësipërm, duke vërtetuar përkatësinë e "thalassas" ndaj fjalorit pellazg, të cilin Meje e quan "e folura parahelene", pa kapur përkatësinë e gjuhës shqipe ndaj të famshmes pellazgjishte të lashtë, e cila ju ka sjellë probleme autorëve antikë dhe atyre të kohëve tona përgjatë më shumë se njëzet shekujve.

Për arsye krahasimi, ja një listë jo e plotë e fjalëve, foljeve bashkë me përkthimin e tyre në shumë gjuhë të huaja të lashta dhe të kohës së sotme. Kjo listë përfshin fjalë të lashta dhe të sotme. Shënja* gjendet në kolonat e gjuhëve gjermane dhe angleze dhe tregojnë respektivisht gjermanishten shumë të hershme dhe irlandishten e vjetër, apo anglo-saksonishten e vjetër. Fjala (got) mes kllapash do të thotë "gjuhë gotike" (dega gjermanike).

Frëngjisht	Greqisht	Latinisht	Sankritisht	Gjermanisht	Anglisht	Shqip
Je suis	eimi	sum	asnis	ich bin	I am	jam (iam)
tu es	ei	es	asi	du bist	you are	je (ye)
il est	esti	est	astier	isthe	is	është
nous sommes	esmen	sumus	smas	wir sind	we are	jemi
vous êtes	este	estis	stha	ihr seid	you are	jeni
ils sont	eisi	sunt	santi	sie sind	they are	janë
OOOOOOO						
boire	pînô	bibêre	pibati	trinken	to drink	pi
brûler	heùo	uri, ùrô	ôsati	verbrennen	to burn	djeg
donner	didômi	dâre donâre	dàdàti	geben	to give	jep
labourer	arôô	arô		eran*	airim*	lëvroj
			(gjer.) pflügen	(angl) to till, ploug		lëroj
manger	edesma	edêre	àdmi	etan*, essen	to eat	ha
mordre	daknô		dàsàti	zangar* beiBen	to bite	kafshoj
naître	giguomaï	nasci	jajàna	geboren werden	to be born	lind
nourrir	an-altos	alô	alan (got)			ushqej
			(gjer.) fütern(angl.) to nourish, board, feed			
porter	phéro	fero	bhàrati	bera*	biru*	baj, mbaj
rire	kakazô	cachinno	kàkhati	lachen	laugh	qesh
vomir	emeô	vomo	vàmiti	brechen	to vomit	vjell
OOOOOOO						
père	atta patêr	atta pater	(pitàr) pitàr	atta (got) fater*	aite* athir*	atë at, babë
mère	mêtêr	mater	matár	mouter mutter	máthir* mother	nënë, nanë
fille	thugátêr	filia	duhitár	tohter* mädchen	daughter	bijë

Frëngjisht	Greqisht	Latinisht	Sankritisht	Gjermanisht	Anglisht	Shqip
fils	huiús	filius	súnus	sunu*		bir, djalë
				sohn	son	
enfant	putrás	nepios	puèr	kind	child	fëmijë
frère	phrêtêr	frater	bhratar	bruoder*	brother	vëlla
sæur	èor	soror	svásar	sxester*		motër
				schwester	sister	
gendre	gambros	gener	jamatar	schwiegersohn	son in law	dhëndër
bru	nuos	nurus	snusa	snur*	snur*	nuse
		(gjer.)schwiegertochter, daughter in law (angl)				
neveu	nepodes	nepos	nápat	nevo*	nia*	nip
				neffe	nephew	
veuve	ê(w)itheos	vidua	vidháva	wituwa*	vidua*	e ve

0000000

champ	agrós	ager	ájras	ackard*		arë
				feld	field	
chêne	aigilops	aesculus		eih*	ac, va	dushk, lis
	krataigos	quercus		eich	oak	
arbre	dóru		doru	triu (got)	daur*	dru
arbor		baum	tree			
noyer	(k)arua	nux°		walnußbaum	walnut	arrë
bouleau	(semidha)	fraxinus	bhurjas	birke	birch	[illegible]
frêne	oksúê, melia	fraxinus		° esche	ash	frashër
hêtre	phêgos	fagus		°buche	beech	ah

0000000

ciel	ouranos	caelum		° himmel	sky	qiell
jour	dios	dies	dinam	tag(m)	dia*	ditë
lune	selene	luna	kandra	mond	moon	hanë
soleil	hêlios	sol	svár	sunna*	súil*	dill, diell
maison	dómos	domus	dámas	haus	house	shtëpi

Frëngjisht	Greqisht	Latinisht	Sankritisht	Gjermanisht	Anglisht	Shqip
eau	udor	aqua	kam(?)	aha*	water	ujë
pluie	ourano	udor	abhrám			
	udatos	pluvia, imber		regen	rain	shi
poisson	ikthus	piscis		° fisk*	iasc*	peshk
moi	ego	ego	eg, ego	ich	me, I	unë
nom	onoma	nomen	nama	name(m)	name	emën
nuit	nuks	nox	nakta	nacht(f)	night	natë
quand	potê	cum quando	kem	wenn	when	kur
qui?	Tis	quis	kas	wer	who	kush
ou	ê(w)e	aut, vel, ve	va	oder	or	ose
venin	ios	venenum	visám	gift	fi*	helm

OOOOOOO

Frëngjisht	Greqisht	Latinisht	Sankritisht	Anglisht	Shqip
un	enas	unus	eka	one	një
deux	dhió	duo	dva	two	dy
trois	treis, tria	tres	tráyas, tri	three	tre
quatre	tessares	quattuor	katvaras	four	katër
cinq	pente	quinque	pánka	five	pesë
six	eksi	sex	sat	six	gjashtë
sept	epta	septem	sapta	seven	shtatë
huit	okhto	octo	asta	eight	tetë
neuf	ennea	novem	nava	nine	nëntë
dix	dheka	decem	dasa	ten	dhjetë
onze	endheka	undecim	ekadasa	eleven	njëmbëdhjetë
vingt	ikosi	viginti	vimsati	twenty	njëzet
trente	triakonta	triginta	trimsat	thirty	tridhjetë
cent	ekaton	centum	satám	hundred	një qind
mille	milion, hilia	mille	sa-hásram	thousand	një mijë

Po e përfundoj këtë kapitull (pellazgjishtja e lashtë) me një paraqitje mbi mënyrën të cilën Pellazgët do ta kenë ndërtuar gjuhën e tyre zanafillore me ndihmën e fjalëve njërrokëshe në të shumtën e rasteve dhe nganjëherë vendosur pranë njëra-tjetrës, madje të bashkangjitura për të formuar së fundi fjalët e tyre të përditshme.

hekur

Gjuha shqipe është e vetmja gjuhë që ka ruajtur emra krejt të ndryshëm me ato të përdorura në sferën greko-romake ose indo-europiane për të emërtuar emrat e metaleve. Për Grekët emri i hekurit është "sideros" dhe për Latino-romakët është "ferrum".

Megjithatë Pellazgët, Etruskët, Filistinët dhe Ilirët (të gjithë kanë dalë nga i njëjti trung etnik) ishin në antikitet të mirënjohur sepse ishin të parët që kishin sjellë përdorimin e metaleve dhe se kishin qenë metalurgë të shkëlqyer, ashtu siç kishin qenë për përdorimin e gurit (ndërtimet ciklopede).

Kur Pellazgët e parë zbuluan përdorimin e burimeve minerare të tilla si bakri, bronzi, argjendi, ari dhe hekuri krejt natyrshëm që donin tu vinin nga një emër:

* bakër greqisht = khalkos, kupros - latinisht = aes cyprium sanskritisht = ayas (metal), Iohas mineral i kuq)
* bronz = hekur greqisht = khalkos - latinisht = aes, aeris sanskritisht = ayas
* hekuri greqisht = sideros - latinisht = ferrum sanskritisht = ayas
* ar greqisht = khrusos - latinisht = aurumsanskritisht = hiranyam
* argjend, serm greqisht = arguros - latinisht = argentum -sanskritisht = rajatam

Si rrjedhojë zbulimi i metalit u bëri të mundur këtyre njerëzve zanafillorë (punues të gurit, shkëmbit dhe strallit) të prodhonin vegla për përdorim të përditshëm (thikë, teh, shpatë, sëpatë, kockë etj.) Nga ky përdorim dhe nga të gjitha llojet e skemave d.m.th të mënyrës së të formuluarit (onomatope, thirrje...) për të bërë apo për të formuluar përvoja të shumëfishta që lindën nga fjalët e para, u bënë të mundur këtyre njerëzve zanafillorë të komunikojnë midis tyre duke emërtuar objektet e krijimeve të tyre, etj.

Kështu fjala hekur do të ketë ardhur nga bashkimi i fjalës heq ose hek dhe gur d.m.th më qartë "ai që thyen gurin, e shkëput apo e formëton". Është si të quhej "gurë-nxjerr" apo "gurë-thyej" fjala hekur në gjuhën frënge.

Është krijuar i njëjti fenomen për fjalët sigur, maniment, siderr ose derë, ndër fjalët e tjera të lashta. Në këtë rast unë kam shpjeguar prejardhjen e dy fjalëve të para (sigur dhe maniment). Le të shohim shkurt çfarë domethënie fshehin respektvisht dy fjalët e tjera (siderr dhe derë) si dhe bakër dhe imperator.

siderr

Kjo fjalë me përpikmëri do të thotë "si derr i egër apo derr i butë" d.m.th. i fortë, i papërpunueshëm si një derr i egër. Përveç kësaj fjala

Kostum femrash
(fisnike e veriut të Shqipërisë) -
Realizuar nga autori në vitin 1958

hekur e Pellazgëve ka të ngjarë që të ketë patur një kuptim dytësor për të emërtuar këtë metal, të fortë, të qëndrueshëm dhe të pathyeshëm. Shqiptarët e sotmë përdorin gjithmonë fjalën kokëderri d.m.th që i reziston gjithçkaje, siç edhe është rasti për metalet (bronxi dhe hekuri)! Ka shumë të ngjarë për arsye të fqinjësisë me Pellazgët, nga kjo Grekët i vunë emrin metalit "sider..os", fjalë që përveç lidhjes së saj me hekurin është krejt i izoluar në gjuhën greke. Grekët duke filluar nga kjo fjalë kanë krijuar "sidero-phron" do të thotë "me zemër hekuri" d.m.th i fortë si hekuri.

dera

Kjo fjalë do të thotë "portë, derë". Për të kuptuar zanafillën e kësaj fjale duhet shkuar shumë larg ndër kohë, shumë përpara epokës të mbiquajtur mikeniane (shekulli XV para Krishtit). Në të vërtetë shtëpia e Pellazgëve të lashtë nuk ka patur dritare, vetëm porta e ajroste shtëpinë: i vetëm kënd nga "del era". Bashkimi i këtyre fjalëve do të ketë qenë në zanafillë të fjalës "dera" [de (le) ra]. Shënojmë se megaronët mikeniane (pra pellazgë), nuk kishin asnjë dritare. Shqiptarët e kanë zbuluar dritaren shumë vonë: e quajnë dritare dhe do të thotë "ajo që dërgon apo lë të hyjë drita".

Bakr, bakër

Kjo fjalë e vjetër pellazge ka mbijetuar në gjuhën shqipe për të emërtuar metalin e bakrit. Për të kuptuar zanafillën e kësaj fjale duhet ngjitur të paktën deri në fillim të epokës të mbiquajtur mikeniane (shekulli XV para Krishtit). Në të vërtetë Pellazgët kishin pushtuar ishullin e Qipros të pasur në minerale, ndër të cilat bakri, ari dhe argjendi. Ata do t'i kenë dhënë emrin metalit që shfrytëzonin: bakr, bakër, fjalë që ka të ngjarë të ketë dalë nga bukr, bukër, bukur që do të thotë "bukur", pa dyshim për shkak të ngjyrës së kuqërremtë të metalit. Ky emër nëpërmjet një procesi të gjatë shndërrimesh të njëpasnjëshme

ose metateze (bakr, bukr, pakr, pukr, kupr + os, prapashtesa greke) ka arritur të marrë formën e saj përfundimtare: kypr(is), kupr(os). Midis shembujve të këtij lloji ne mund të citojmë fjalën "formage" të kthyer në "fromage" ose "mater", "marg" e shndërruar respektivisht në muter, mulgeo etj. Në ditët tona haset në gjuhën e përditshme ky lloj këmbimi apo inversioni (shpesh pa dashje) i bashkëtingëlloreve ose zanoreve të tilla si p.sh infractus në vend të infarctus.

Janë të shumta gjurmët arkeologjike, të cilat datojnë në epokën e ashtuquajtur mikeniane të zbuluara në Qipro (zonë e sotme e Enkomit, Paphos, Amathonte..) Përveç kësaj (sipas një prej legjendave në lidhje me këtë) Afërdita, perëndesha më pellazge se të gjithë të tjerat do të ketë dalë nga Qipro (Afrodito kyprogene) dhe më saktë në Paphos. Ishulli ishte me famë për vendet e tij të shënjta për Afërditën (e quajtur gjithashtu "Pelagia"). Së fundi, fjala kypros ose kupron ka krijuar te Latinët emrin "bakër i kuq": aes cyprium dhe emrat e prejardhur prej tij, të cilat edhe frëngjishtja i përdor gjithmonë si cuprifere, cuprique, cuprite...

Ja një fjalë tjetër pellazge, e cila e ndërfutur nga Etruskët ka kaluar te Romakët dhe si rrjedhojë në botën perëndimore: Imperator... Empereur (Perandor).

Imperator

Për të kuptuar zanafillën e kësaj fjale, duhet gjithashtu duhet të kthehemi në një numër tekstesh historikë. Në botën greke stricto sensu, nuk ka patur monarkë të vërtetë, përveç ardhjes në pushtet të disa mbretërve dorianë të cilët përveç kësaj nuk kanë lënë pa e kujtuar zanafillën e tyre semito-egjiptiane (cf. Herodoti VI, 53 dhe Testamenti i Vjetër I / Makabe, 12 / 19 deri në 23). Në të vërtetë qysh nga epoka e arhondëve të parë deri në periudhën helene ka patur mbretëri vetëm në Epir, ndër të cilat ajo e Pirros dhe në Maqedoni ajo e Aleksandrit të Madh (dy vende fillimisht jo greke). Përveç kësaj mbretëreshat e vetme

të antikitetit perëndimor ishin Teuta ilire, Olimpia epirote (nëna e Aleksandrit) dhe e famshmja Kleopatra VII (ky emër u mbajt nga shtatë mbretëresha të Egjiptit, Lagidëve të zanafillës maqedono-epirote). Duhet shtuar se baza shoqërore e Grekëve, krejt ndryshe nga Pellazgët (sundim matriarkal) kishte një themel patriarkal.



1 - Nuse e Mirditës (Veri).
2 - Veshje e gruas aristokrate (Jug).
3 - Kostum i shpatit (Elbasan - Qendër).
4 - Veshje burri me "çakçir" (Veri) të tilla si pantallonat galeze !
5 – Veshje e burrit me fustanellë si në Epir.

Vetëm mitet dhe legjendat flasin për monarkë të mbiquajtur grekë. Ndërkohë që mbretërit e parë grekë ishin me zanafillë semito-egjiptiane ose azianike: Danaos, Kadmos, Kekrops dhe pasardhësit e tyre, Pelopsi dhe mbretërit dorianë ishin të një zanafille të huaj në sferës ballkano-egjease. Por Grekët, për këtë rast kanë krijuar termin e tyre: monarkhes, fjalë e formuar nga monos (vetëm) arkhein (me komandu) d.m.th "ai që komandon i vetëm".

I njëjti fenomen ka ndodhur në Itali: vetëm Etruskët kanë patur dinasti mbretërore. Në të vërtetë mbretërimi ishte një traditë tipike pellazge. Romakët, për të emërtuar prijësin e tyre, e huazuan te Etrusko-Pellazgët fjalën e tyre të famshme Imperator. Kjo fjalë shpjegohet në mënyrë të përkryer nga pellazgo-shqipja "I mbretëruar, I mbretëror" që fjalë për fjalë do të thotë "i mveshur me pushtet mbretëror". Nuk ka asnjë dyshim që ky emër rrjedh nga folja gjithmonë e përdorur në Shqipëri: mbroj, nga e cila rrjedh çdo tip fjalësh që lidhen me mbret dhe mbretëroi deri te mbretvrasës. Mbreti te Pellazgët ishte ai që mbronte bashkëqytetarët e tij dhe nuk ishte aspak monark absolut.

Fonde të vjetra pellazge dhe leksikologjia e saj

Gjuha e sotme shqipe ka një numër të madh termash arkaike, të cilat rrjedhin drejtpërdrejt nga pellazgjishtja e lashtë, ndër të cilat dy degët kryesore janë ilirishtja (dega perëndimore, nga e cila ka dalë dialekti "geg" i Shqipërisë së Veriut, dialekti venet, pisian, mesapian, peonian, dardanian dhe një pjesë e greqishtes së vjetër, etj.) dhe gjuha thrako-frigjiane (dega lindore, nga e cila ka dalë dialekti "tosk" i Shqipërisë Jugore, dialekti etrusk, thrak, frigjian, trojan, karian, lidian, lisian, hitit etj.) Kjo tregon se shumë popuj kanë folur të njëjtën gjuhë në dialekte të të ndryshme.

Fatkeqësisht protagonistët e gjuhësisë moderne, shpikësit e fjalës "indo-europiane", nuk janë shumë të prirur (apo pjesa më e madhe aspak) ndaj

këtyre gjuhëve dhe për përputhjet që ekzistojnë midis tyre. Duke u nisur nga baza të gabuara apo pista të gabuara, ata qysh në fillim i kanë bërë lëmsh, d.m.th duke filluar nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX. Një nga pasojat ka qenë "klasifikimi" plotësisht i gjuhës shqipe: qysh se kjo gjuhë ka rënë në harresën e historisë.

Si rrjedhojë, janë të paktë gjuhëtarët që kanë zbuluar një fond gjuhësor tepër të lashtë në gjuhën shqipe. Në të vërtetë kjo është e vetmja gjuhë e sotme, e cila ka ruajtur terma të lashta dhe fjalët arkaike, të dala nga fondi i pellazgjishtes së lashtë dhe që ngjitet edhe më tej në parahistorinë europiane. Ja këtu më poshtë disa nga këto terma ose rrënjë që nuk gjenden në asnjë gjuhë tjetër europiane. Mal, pyll, pellë, karpë në zanafillën e emrit "karpate", nga vjen edhe frëngjishtja "escarpé" dhe toponime të ndryshme, gur, det, erë, shi, ujë, diell (diell fjala zanafillore e emrit të ishullit "D(i)elos", rërë, kripë, lëkurë, kalë, mushkë, pelë, lopë, berr, dash, dele, bukë, qumësht, tamël, djathë, hu, Kunjë, za, (zëri zanafilla e emrit të "Zeusit"), "gardh ose garth" (zanafilla e disa prapashtesave të emrave të qyteteve gjermane që mbarojnë me "gart" ose "gartt" dhe e qyteteve sllave përfundojnë me "grad"), thurr, thur (kjo fjalë ka sjellë gjithashtu prapashtesat e qyteteve si p.sh. Vinterthur në Zvicër), po, jo ose numri "një", e vetmja gjuhë në botë që quhet "nji" (një).

Këto fjalë arkaike përkojnë me terma të përdorshme, të shkurtra dhe në përgjithësi "njërrokëshe" të jetës së përditshme praktike të njerëzve parahistorikë: natyra, ushqimi, kafshët e para shtëpiake, etj.

Gjenden edhe sot disa terma pellazge (veçanërisht toponime dhe antroponime) ose fjalët e prejardhura të tyre (të vetme apo të bashkangjitura) në një hapësirë të rëndësishme që shkon nga Europa qendrore dhe Alpet deri në Ballkan dhe nga Atlantiku deri në Azinë e Vogël, madje deri në Indi: Liburnë, Garonë, Oleron, Gavarnie, Berre (pellg), Ill, Illiers, Ille, Kantal, Auvergne (Overnjë), Malvan, Valbonë, ose Malmont në Francë; Gand në Belgjikë, Illiers, Lauba, Loba, Mell

në Zvicër; Ill, Illier Malberg në Gjermani; Messapios, Messapion, Malia, Mallia, Dordhanaj në Kretë; Liburna, Brindi, Kalabri, Karparo (lloj guri për ndërtim), Tolmino, Tolmezzo në Itali; Karpates në Ballkan; Dalmaci; Maltë; Bizant, Milet, Malatya në Azianë e Vogël; Bukuresht në Rumani; Malagë, Toledo, Mallos, Malda në Spanjë; Malabar në Indi; Malaja (Ceilon); Malazia; Malea, Male, Athinë, Larisa, Arkadi në Greqi etj. Unë nuk mund të citoj të gjitha toponimet dhe vendet sepse lista do të ishte tepër e gjatë.

Pra, e gjithë kjo supozon ekzistencën në kohë shumë të hershme të një etnie dhe të një gjuhe jo vetëm parahelene por para indo-europiane në Europë, detin Egje dhe në hapësirën e Mesdheut, madje në Afrikën e Veriut dhe në veçanti Libi, ku ka shumë të ngjarë të kenë banuar popullsi europiane në Europën parahelene si dhe në Oasis të Sivahut në Egjipt dhe ku vendi i shenjtë (i vizituar nga Aleksandri i Madh) kishte përafërsi befasuese me atë të Dodonës (Epir), kryeqytet shpirtëror i Pellazgëve. Shënojmë se fjala "oasis" ishte me zanafillë pellazge dhe vinte nga rrënja "ujë" prej nga rrjedh "ujësi" d.m.th. vend që ka ujë"!

Pra, janë toponimet që i kanë rezistuar më shumë pushtimeve qysh nga parahistoria deri në ditët tona. Në të vërtetë emra të shumtë kanë mbetur në mënyrë të pandryshueshme të fiksuara në disa rajone dhe gjenden pothuajse të paprekura në Alpet dhe në disa emra të shumë qyteteve të lashta të Ballkanit, Kretës, Ishujve të detit Egje, Azi e Vogël, Itali etj. Shkurt, ne i ndeshim kudo ku gjenden Pellazgët, Etruskët, Thrako-Frigjianët dhe Ilirët. Pikërisht aty gjendet prova e pakundërshtueshme e diversitetit të popujve pellazgë por edhe e vërtetësisë historike të këtyre Pellazgëve dhe të "qytetërimit" të tyre dhe mbi të gjitha për të qenët nga një trung me Shqiptarët e sotmë. Pa mbijetesën e këtyre të fundit, Pellazgët do të kishin mbetur "popull parahelen i zhdukur". Kjo paraqitje i bashkangjitet kapitujve të mëparshmëm në lidhje me "antroponimet, etnonimitë ose toponimitë", të zanafillës pellazge dhe të interpretueshme ose të përkthyeshme nëpërmjet gjuhës shqipe.

Disa shembuj të fjalëve të numëruara në studimin e mëposhtëm paraqesin mjaft mirë të qenët nga një trung i gjuhës shqipe të sotme në raport me pellazgjishten e lashtë, e cila ka mbetur e paprekur falë ruajtjes së saj nga ana e folësve të lashtë ilirë dhe thrakë nëpërmjet gjuhës shqipe dhe pa kurrfarë diskutimi përbëjnë një nga provat e ekzistencës së Pellazgëve, të cilën disa kanë dashur ta trajtojnë si një emër "gjenerik" që emërton popujt parahelenë pak a shumë "hipotetikë". Përhapja e qytetërimit grek dhe mbi të gjitha i kulturës së tij përmes botës së lashtë, falë Aleksandrit të Madh (një tjetër Pellazg "i helenizuar"), vetëm se ka fshehur rëndësinë e rolit të luajtur nga Pellazgët në ndërtimin e këtij qytetërimi. Ja pra, sa për të filluar, emrat e formuar me një nga rrënjët më të vjetra pellazgo-shqiptare "mal". Emrat janë ndarë sipas rajoneve ose vendeve:

Mal
malësi
malësor
malatak, malok

ALPET zviceriane, gjermane, italiane dhe franceze

Mal-e: fshat i malësisë së lartë (Alpet e Trentinit);
Mall-es: fshat alpin (burim i Adixhes);
Mall-engio ose Mall-enco: në Alpet zviceriane dhe italiane;
Mal-borgeto: pranë qafës së Brenerit, vendndodhje mbizotëruese;
Mal-ans: në Alpet zviceriane të Grisons;
Mal-oja: rajon i malësisë së lartë të rrethinave të Shën Moricit;
Mall-nic: pranë qafës së "Tauern";
Mal- ta, Mal-tal, Moll–tal: lugina të larta alpine;
Mal-ta: emër i Maltës, ishull malor;
Mal-bah: përrua alpin;

Mal-burg: lokalitet i Pyllit të Zi;
Mell: në Vale pranë Sionit;
Mole: pranë Gjenevës dhe Bonëvil në Savoja;
Mole-son: pranë Friburgut në Zvicër;
Mell-an: në Austri mbi Bregenc;

Pirenej, Spanjë dhe Portugali:

Mal-h: lartësi shkëmbore në Pirenej;
Mal-h ano: Siera e Portugalit;
Mal-partida: fshat pranë të njëjtës Siera;
Mal-los, Mal-da: fshat malor në veri të Taragonës;
San Esteban del Mal-h: lokalitet në Spanjë;
Mal-aga: qytet i Andaluzisë;
Mal-lorka: ishull malor;

Rajone dhe vise të ndryshme

Mal i Zi: emri shqiptar i Montenegros. Ky është emri i një mali të Alpeve shqiptare të Veriut që sot bëjnë pjesë në shtetin e Malit të Zi, të cilit i ka dhënë edhe emrin.

Mull i Kantirës: "Moell", në galike = mali i Kantire Verful;
Mal-ului: Mal në Transilvaninë Perëndimore (majë, kulm).
Malthi: qytet në malësinë në Meseninë e Epërme (Peloponez).
Mal-van: në Alpet në jug të Francës;
Mal-ée: kep në jug të Peloponezit (Lakoni), cituar prej Homerit;
Mal-éa: kep në Lesbos;
Mal-ène: lokalitet i Atarnisë në Misi (Herodoti VI, 29);
Mal-éas: prijës lakonian;
Mol-osses: popull Epirot (në shqip "Malësi", "Malësor" = malësi e lartë, malësor);
Mal-ia: qytet i bregut verior të Kretës;
Mal-lia: qyteti i tretë i epokës së pallateve të mëdhenj të Kretë;
Mal-atya: qytet i Kapadokias lindore (Turqi), Meliteni antik;

Mal-eso, Mal-ison: bredhi i malësive në dialektin piemontez; në Francë e quajnë "mel-eze" [emër që vjen nga Dauphine (Dofinë), krahinë kufitare e Piemontit] pemë halore që rriten në "malësitë" e larta, nën zonën e bredhave. Mal-jen: Mal në Serbi (Valjevo jugore).

Emri "mal" ka sjellë fenomene toponimike që quhen "tautologji". Kjo është e njëjta fjalë e përsëritur nën një formë ortografike të ndryshme, ka të ngjarë nga popullsi të lashta dygjuhëshe si nevojë e të kujtuarit të kuptimit të fjalës zanafillore: "Mal-berg" (Ardenet gjermane), "berg" që do të thotë gjithashtu mal, idem për "Malmont" (mal që mbizotëron qytetin e Draginjanit në Francë).

Megjithatë në disa rajone të Italisë, banorët duke mos ditur kuptimin e fjalës "mal" e kanë ngatërruar (nga superstícioni?) me mbiemrin cilësor latin duke i dhënë një karakter përkeqësues d.m.th "i keq, mallkim"! Është fjala për "Mal-nate, Mal-ano, Mal-ventum, Mal-kantone". Këto dy të fundit kanë qenë respektivisht të modifikuara me "Bene-Ventum dhe Bel-Kantone"!

Çuditërisht vërehet se kjo fjalë "mal" ka udhëtuar deri në kufijtë e Azisë. Në të vërtetë gjendet rrënja "mal" në emrat e rajoneve të shumta të Azisë ku "malësia" ka qenë e pranishme: rajoni malor i Ceylanit (Sri Lanka) "Malaja" dhe bregu shkëmbor jugperëndimor i Dekanit "Mal-abar", vendi juglindor aziatik "Mal-ajzia" (malësia e Azisë?) dhe malet e famshme "Hi mal aya". Dihet që nga mijëvjeçari IV, popullsi të zanafillës mesdhetare kanë krijuar qytetërime tejet të shkëlqyera në Indinë lindore. Pra ka të ngjarë, sipas gjuhëtarit Pizani, që kjo fjalë "mal" të jetë një nga të mbijetuarat e fundit në gadishullin aziatik. Do të shtoja që ushtarët e Aleksandrit të Madh, pjesa më e madhe e të cilëve ishin me zanafillë maqedone, epirote, ose ilire d.m.th të trungut pellazg, kanë shkelur në Indi madje në toka edhe më të largëta. Ka të ngjarë që ata të kenë bartur pjesërisht gjuhën dhe kulturën e tyre në këtë pjesë të botës.

Fatkeqësisht, të gjithë këta dijetarë të cilët kanë thënë të kundërtën e bashkëkohësve të tyre apo "të rregullt nga ana gjuhësore", kanë qenë trajtuar si "kontigjent i pakonsiderueshëm" ose si "të mbrapshtë". Ndërkohë që të tjerë, ata që flisnin të njëjtën gjuhë, ata që ishin të pakushtëzuar nga ideologjia e numrit të madh apo nga diskutimet mjeshtërore të studjuesve të shumtë. Kështu janë vënë kundrejt njëritjetrit Pellazgët, Etruskët, Thrako-Frigjianët dhe Ilirët, meqë këta popuj kishin dalë nga i njëjti trung etnik dhe flisnin të njëjtën gjuhë por me dialekte të ndryshme. Prej këtyre është krijuar qorrsokaku, ku gjendej dhe gjendet ende Etruskologjia, gjuhësia dhe historia parahelene e Pellazgëve midis gabimesh të tjera madhore.

Megjithatë disa autorë shpesh kanë bërë analiza me vend dhe nganjëherë kanë fshikur të Vërtetën. Ja p.sh. çfarë na thotë Nikola Lahovari (Popujt indo-europianë, Neuchatel 1946) në lidhje me fjalën "mal" (faqe 587): "është mjaft simptomatike të vëresh që fjala para-ariane "mal" haset deri në Indinë dravidiane, ku ka ruajtur të njëjtin kuptim, gjë që përjashton çfarëdo rastësie thjesht fonetike dhe anon të mbështesë tezën e unitetit gjuhësor indo-mesdhetar". Megjithatë ai shton (faqe 579): "Dihet tashmë se ka pasur një epokë, nga mijëvjeçari III dhe IV, ku qytetërimet e të njëjtit trung shtriheshin nga India deri buzë Atlantikut, duke kaluar nëpër Iran, Mesopotami dhe Egjipt, në momentin kur njerëzit që i përkisnin një tërësie, tipeve të njëjtë fizikë dhe që flisnin gjuhë të së njëjtës familje banonin në luginën e Indusit, Persi dhe Kaukaz, Mesopotami si dhe brigjet e Detit të Zi dhe Egjeut, Afrikës së Veriut, Greqisë, Italisë, Francës perëndimore, Iberisë dhe Anglisë".

Por paradoksi te ky autor, si te shumë autorë të tjerë, është se ai trajton si "pellazgo-egjease" por etnikisht "mesdhetare", popullsitë parahelene të epokës mikeniane dhe pohon se Dorianët do të kenë indo-europianizuar Greqinë në epokën e Hekurit. Në lidhje me këtë

ai përshtat qartë mendimin e "numrit më të madh"! Ndërkohë që është e sigurt, nëse bazohesh te Homeri, se populllsitë parahelene, të mbiquajtura mikeniane, ishin një etni e përbërë nga elemente danubiane të tipit brakicefal. Problemi thelbësor në pjesën më të madhe të autorëve modernë mbisundon në vështirësinë që ata kanë për të zbuluar elementet e duhur indo-europiane dhe para indo-europiane të populllsitë parahelene; ndërkohë që gjithçka të bën të besosh se elementi para indo-europian është i dallueshëm në gjuhët që kanë dalë nga pellazgjishtja e lashtë, në të cilën marrëdhëniet me populllsitë danubiane janë tejet të shumta. Bëhet fjalë për një mish-mash zhgënjyes. Është pikërisht shpikja e këtij termi "indo-europian" që nxjerr probleme kudo në lëmin e historiografisë, arkeologjisë dhe gjuhësisë moderne. Pa shkuar deri në kohët më të hershme, çka nuk është as objektiv as pretendimi i veprës që keni në dorë, unë mund të pohoj se Pellazgët janë pasardhës të drejtpërdrejtë të populllsive të para që kanë banuar në Europë, Azinë e Vogël, dhe pothuajse në hapësirën mesdhetare. Nga vinë këta Pellazgë? A janë këta Sumerianë, Elamitë apo antropoidët e parë europianë? Çfarë mund të jenë këta Sumerianë, për të cilët thuhet jo-semitë? Kjo është çështja që unë po përpiqem të nis, ka të ngjarë në veprën time të ardhshme.

Le të kthehemi në fjalët e dala nga pellazgjishtja e lashtë dhe që arrijnë të dekriptohen falë gjuhës së sotme shqipe, fosile e gjallë e asaj që ka qenë gjuhë parahistorike e Europës. Pas fjalës mal ekzistojnë terma të tjera para indo-europiane të tilla si gur, krep, shkëmb, gurth, gurtë, gurishtë, guriçkë, gardh, Kandor (guri themeltar), thur, thep, kap (zanafilla e fjalëve anglisht keep, kept) ha, hangër (ka të ngjarë zanafilla e anglishtes hunger, hungry, uri, i uritur), etj....

Gardh, garth ose në mënyrë figurative ka edhe kuptimin e pengesës. Kjo fjalë jep kuptimin e një mjedisi të rrethuar apo të një "qyteti të rrethuar me mure apo mure të lartë". Termi "gardh" hyn në formimin

e shprehjeve të shumta në gjuhën shqipe për të emërtuar atë që është "e rrethuar apo e përmbyllur", p.sh. "e mbështillen gardh = është rrethuar nga të gjitha anët".

Kjo rrënjë është në zanafillën e toponimeve të shumta, gjurmët e të cilave gjenden në rajone të shumta të Europës dhe të Azisë së Vogël, vende të banuara nga Thrako-Frigjianët. Ky toponim shtrihet të paktën në tri mijëvjeçarë. Nënkuptonte "qytet" d.m.th "mjedis i rrethuar" ku banohet. Shembujt e mëposhtëm janë krejt domethënës.

Gord-ion: Në shekullin VIII para Krishtit, kryeqyteti i Frigjisë, i shkatërruar në shekullin VII nga Cimerianët.
Gord-ias : babai i mbretit frigjian Midas.
Gort-yna : qyteti i Kretës.
Gort-ynia: qytet i Maqedonisë.
Gort-ys : qytet i Arkadisë.
Gyrt-on : qytet thesalian i Pellazgoitidës në veri të Larisas.
Gyr-ees : shkëmb i nënujshëm i detit Egje (Odisea IV, 500-509).
Gurt-a : qytet hitit.
Krot-one : qytet i Italisë së Jugut.

Kandor, guri themeltar
Kënd

Kjo rrënjë hyn në përbërjen e fjalëve të shumta dhe toponimeve të Europës perëndimore dhe qendrore të Ballkanit, të Kaukazit dhe të Azisë së Vogël. Fillimisht kjo rrënjë emërtonte në formën e saj kolektive, tokat "gurrore apo të ashpra" dhe më gjerë "shkurraja apo bokërrima".

Kand-avia, Cand-avia: sipas Strabonit (VII, 7/4, 7/8) mal i Ilirisë ku kalonte via Egnatia. Vendndodhja e kësaj malësie gjendej në një rajon të Shqipërisë së sotme të vendosur midis Elbasanit dhe liqenit të Ohrit.

Kand-er: lumë që rrjedh në shkëmbinjtë e Oberlandit.

Kand-em: qytet i Pyllit të Zi në veri të Balës.

Kand-er steg: stacion sportiv dimëror në Zvicër.

Känd-el: malësi në perëndim të Karlsruhes.

Kende-le: në rajonin e Valesë në Zvicër, bëhet fjalë për kanale të gërryer zakonisht në toka shkëmbore.

Kand-asa: fortesë e Karisë antike (Polibi XVI/VIII, 39).

Kantal: do të thotë "gur i madh" në gjuhën baske.

Kand-o, Gand-o, Gvandi: lokalitet në Kaukaz.

Gand: qytet i Belgjikës (Castrum Gandavum antike) e ka marrë emrin e tij nga "shtretër zalli", i cili gjendet në bashkimin e Eskotit dhe Lisit.

Gand-ria: fshat piktoresk i Tesinit (liqen i Luganos), rrëzë një shkëmbi të lartë dhe të thepisur.

Cant-al, Kantal : do të thotë "gur i madh" dhe "shkëmb" në gjuhën baske, spanjolle dhe portugeze.

Kant-al: unë po ndalem pak më gjatë në këtë term. Në Overnjë (Auvergne) bëhet fjalë për një rajon vullkanik dhe "të ashpër" të kufizuar nga rrafshina bazalte. Nuk është për tu çuditur që e rigjen këtë rrënjë pellazge në Overnjë. Në të vërtetë emri i fundit rrjedh nga një popull Gal "Arvernes". Ky popull, ashtu si edhe Keltët, ishte me zanafillë nga e njëjti rajon i banuar prej Ilirëve antikë (rajon danubian i Austrisë dhe i jugut të Gjermanisë). Mirëpo në antikitet, për arsye të këmbimit fonetik, "b" shqiptohej "v" dhe ansjelltas. Ky këmbim haset gjithashtu te "l"dhe "r" që rigjendet në frëngjisht në fjalët "pe l erin" dhe "pe r égriner", që kryhet sipas të njëjtit ndërtim. Në të vërtetë Shqiptarët shpesh quheshin "Arbën, Arbanites, Arvanites, Arvanos, Arvanitis". Polibi (shekulli II para krishtit) në veprën e tij "Historia" (I, 11) përmend një qytet ilir me emrin "Arbon". Përveç kësaj, deri në ditët tona një

rajon i Shqipërisë që gjendet midis Vlorës dhe Sarandës quhet "Arbëri" dhe Shqiptarët e Kalabrisë në Itali quhen "Arbëreshë". Ptolemeu (shekulli II pas Krishtit) përmendte emrin e një fisi ilir (Albanoi) dhe të një qyteti (Albanopolis) që gjendej midis portit shqiptar të sotmë të Durrësit dhe qytetit të Krujës. Prej nga vjen edhe emri Albanie dhe që çuditërisht Shqiptarët midis tyre nuk e përdorin dhe quhen midis tyre "Shqiptarë", d.m.th "bij apo fëmijë të shqipes". Vetë Ptolemeu ka përmendur një "Albanie të Kaukazit". Të mos harrojmë se një nga atributet e "Zeusit pellazg" të Homerit ka qenë pikërisht Shqiponja dhe se nga ana tjetër ushtarët e Pirros e quajtën atë "Shqiponjë" dhe prandaj e quajnë veten "bij të Shqipes". Së fundi do të shtoja se pikërisht në Overnjë, një verë e ngrohtë ose një ujë i vakët që hidhet në një lloj gajdeje për të penguar forcimin e lëkurës quhet: ujrë. Mirëpo kjo është një "reminishencë e gjuhës së të parëve të Overnjantëve, të cilët ujin e quanin "ujë" dhe shumësi është "ujra" pikërisht ashtu si Pellazgët, Thrako-Frigjianët, Ilirët dhe Shqiptarët e sotmë! Në të vërtetë sot vetëm Shqiptarët e quajnë kështu, pra "ujë".

Një tjetër rrënjë arkaike që hyn në formimin e fjalëve të shumta parahelene ose para indo-europiane është fjala "gur" dhe ja fjalët e prejardhura prej saj.

Gur
Gurtë
Gurth, guriçkë, gurishtë

Cilët janë emrat më të vjetër se ata emra që përcaktojnë natyrën apo ushqimin: malësia, shkëmbinjtë, guri, uji, buka etj? Këto fjalë i ka ruajtur vetëm gjuha shqipe. Dhe "rrënjët" e tyre gjenden në ndërtimin e toponimeve më të lashta të Europës, Azisë së Vogël dhe të hapësirës mesdhetare. Siç e kemi vërejtur për fjalët mal, garth, Kandor, i shohim më pranë fjalës "Gur", i cili gjithashtu ka krijuar terma të shumta dhe toponime që shkojnë deri në mugëtirat e kohërave.

Gora: ndajfolje baske që do të thotë "i lartë, i ngritur";

Cerna Gora: emër sllav i Malit të Zi dhe që është përkthim i "Mal i Zi", emri shqip i krahinës malore që gjendet në veri të Shqipërisë. Ky vend, i pushtuar nga Serbët është sllavizuar sistematikisht përveç disa "skutave" pothuajse në kufirin shqiptar, të cilat i kanë rezistuar pushtimit sllav (madje edhe "emrat" shqiptarë janë sllavizuar). Përveç kësaj planet njëherësh fizik, morfologjik dhe të karakterit të Malezezëve, ndryshojnë nga Sllavët e tjerë dhe Serbët e rajonit. Ndryshimi këtu është mëse i dukshëm. Bien në sy "mbetjet" e etnisë iliro-shqiptare.

Gur-assu, gur-biku: në antikitet kështu quheshin disa kala dardanase.

Gur-bita: lokalitet në Dardani.

Gur-ghiului: malësi të larta të Karpateve.

Gar-gano: malësi pranë gadishullit (kep i lartë) me të njëjtin emër në Pulia të Italisë.

Gar-stedt, Garsen, Gar-sden: lokalitete të Alpeve austriake dhe bavareze.

Gar-misch: stacion dimëror në Bavari;

Gur-ichtche: Sipas V. Dal është fjala për një fjalë të rusishtes së vjetër "pirg gurësh". Kjo fjalë duket sikur ngatërrohet me fjalën shqip "gurishtë". Është e sigurt që gjuha shqipe nuk e ka huazuar nga gjuha sllave por e kundërta e kësaj. Në të vërtetë Ilirët dhe Dakët apo Geto-Dakët (Thrako-Ilirët kanë banuar në Rumani dhe Moldavinë e sotme) kanë banuar në rajonet e Danubit të sipërm dhe të mesmë si dhe në një pjesë të Balkanit deri në shekullin V/VI pas Krishtit, përpara mbërritjes së Sllavëve dhe pushtimit përfundimtar të këtyre territoreve të lashta thrako-ilire, rajone që ata vazhdojnë t`i kenë.

Gu-gun: "malësi, kodrinë" në dialekteve të Kaukazit lindor.

Gar-gar: një nga majat e Idas në Troadë (Homeri, Iliada VIII, 48, XIV 292, XV 152);

Gar-amantes: populli i përmendur nga Herodoti (IV, 183) që kanë banuar në rajonet kripore të jugut të Tripolitanit (Fezzan?) apo lartësitë "shkëmbore" të Hogarit.

Në Francë fjala gur hyn në formimin e toponimeve të ndryshme para indo-europiane, të tilla si Gar-onnë, lumë që zbret nga malësitë e larta "shkëmbore" (Val d`Aran në Pirenej); gar-rigue tokë shkurrishte "shkëmbore" ose djerrë dhe në jug të Francës, formacion bimësish që shfaqet në lartësitë "gurrishtë" në toka gëlqerore pas shkatërrimit të pyllit; Gard; malet Gar-rigues (degëzim i Seveneve) rrafshnaltë "e tharë" e Languedokut.

Vërehen disa shndërrime fonetike në shqiptimin e disa "gërmave" p.sh. gërma "l" në "r" (rotacizmi) ose "k" në "g". Krijohet gjithashtu edhe e kundërta. Në rastin e fundit kemi një ilustrim të shkëlqyer të këmbimit të këtyre katër gërmave në "gara" e shndëruar në "kala" (shtëpi prej guri te Baskët dhe Lesgianët e Kaukazit) ose "kula" (shtëpi e fortifikuar te Ilirët dhe Shqiptarët, fjalë që më pas u përhap në të gjithë Ballkanin). Fjala arabe "Kalaa" që do të thotë "kala" ka kaluar nga popujt ballkanikë te Turqit dhe më pas tek Arabët. Në të vërtetë Turqit i pushtuan për më shumë se pesë shekuj njëherësh Ballkanin, Lindjen e Afërme dhe të Mesme, Arabinë dhe Afrikën e Veriut.

Gara-Mulata ose Muleta: Majë masivi malor i Ahmar në Etiopi; në gjuhën amharike (gjuhë semite e folur në Etiopi) fjala "Gara" që do të thoshte malësi. Përsa i takon fjalës "Mulata" duhet përqasur me fjalën etruske "mulu" dhe pellazgo-shqipen "mal". Kjo pra do të përkthehej me: "malësi shkëmbore". Sipas disa gjuhëtarëve Etiopia do të ketë bërë pjesë në bashkësinë gjuhësore indo-mesdhetare. Ndryshe nuk shihet se si këto dy terma tipike pellazge do të kenë arritur deri këtu.

Çukë

Cucco: do të thotë majë, kodrinë "e rrumbullaktë" në Italinë e jugut; Ciuca: i njëjti kuptim në rumanisht.

Gëlbazë, sëmundje e deshëve në Shqipëri (distomatozë: ngacmimi i mëlçisë së zezë i disa kafshëve barngrënëse për shkak të pranisë së hendeqeve të ujit).

Gelb-raze: sëmundje e deshëve në rumani;
Gell-gaitz: sëmundje, ethe në gjuhën baske;

Fjala në vijim është gjithashtu shumë e lashtë. Ka të ngjarë që të jetë në zanafillë të emrit të Etruskëve. Kjo fjalë hyn gjithashtu në përbërjen e disa prapashtesave të qyteteve si p.sh. Vinterthur në Zvicër.

Thur
Thurës
Thurur
Thurim

Tirsenë, Turs-anë, Turs-enoi: emër me të cilin Grekët emërtonin Etruskët (Tuqididi IV, 109);
Turs: rrënjë e emrit Turs-enoi, Tursanë;
Tursis: qytet i fortë, bastion, fortesë në Lidinë jugore;
Tursa, Turra: qytet i Lidisë;
Turs-kum: emri i Etruskëve të umbrianët që ka të ngjarë të jetë në zanafillë të emrit latin: "Etruskum" i cili ka përfunduar duke u shqiptuar "Tusk, Tuski" dhe së fundi "Toskan, Toskana";
Tiras: emër i vjetër i Etruskëve në Bibël;
Tursha, Tereshs: emra egjiptianë të Etruskëve (Populli i Detit).

Berr
Bari
Barishte

Berr: dash në dialektin lombard dhe romanjol;
Berra: "deshë" në dialektin provensal dhe gaskon;
Berra: kullota të deshëve (sot të zëvendësuara nga lopët) në kantonin e Friburgut, në Zvicër;
Barro: lloj dashi në gjuhën baske;
Berro: dash, në dialektin piemontez;
Berre: "Pellg i Dashit" është një reminishencë e së kaluarës ku ushtrohej rritja e "deshëve". Në të vërtetë deshët ishin të shumtë përqark pellgut.

Mëz
Mëzat apo dem (një vjeçar).

Mec, foshnje djalë në dialektin geg, në rajonin e Matit në Shqipëri;

Mezey: lopë e vogël në Kaukaz;
Mez: fëmi, në Kaukaz;
Manz: manzo: viçi në Rumani, Alpet dhe Italia jugore;
Manz: dem, në dialektin engadian.

Rrënjët dhe rrënjësorët me zanafillë pellazgo-liguro-thrako-ilire

Kandor: guri themeltar

Kjo fjalë para indo-europiane ka krijuar një numër të madh toponimesh (vetëm fjalët i kanë rezistuar përzierjeve gjuhësore të pushtimeve të ndryshme në Europë dhe gjetkë), kudo ku banojnë pellazgo-Liguro-thrako-ilirët, ndërtues të famshëm të mureve ciklopike: nga Danubi deri në Egje dhe nga Atlantiku deri në Detin e Zi. Në të gjitha zonat ku shfaqet kjo fjalë rigjendet pothuajse në kuptimin "gur, shkëmb i thepisur, apo gurrishte".

Ky kuptim është pothuajse i njëjtë për të gjithë fjalët në vijim:

Gand	= Belgjikë
Gandavia	= Iliri
Gando, Gvandi	= Kaukaz
Kandava, Kandia	= Frigji, Lisia, Ganda
Gandia, Ganga	= Iberi
Ganda	= Alpet italiane
Gandria	= Tesin
Kande	= lumë me çakëll "Oberland"
Kandern	= qytet që gjendet në veri të Bales (Pylli i Zi)
Kandel	= mal që gjendet në perëndim të Karlsruhes

Kodër

Kotor = Port i Malit të Zi ("Grykat e Kotorrit") i futur rrëzë malësive të thepisura

Kotor = në gjuhën baske do të thotë "pjerrësi thikë apo brinjë e vështirë për t`u ngjitur"

Iliria, Iliri, Iliroi

Term që emërton vendin e Ilirëve: "I lirë". Çuditërisht Grekët e quajnë këtë popull "të pavarurit" pa u kujdesur për kuptimin e saktë të kësaj fjale.

Ilirë, Iliri, Ilirian....Ilier, Illur-o, Illur-on:

Këta emra shqiptohen ndryshe sipas dialekteve dhe rajoneve të banuara qysh në kohë të hershme nga Ilirët.

Ill : lumë në Alsasë

Ill, Iller : në Gjermani

Ille	: lumë i Bretanjës, degë e Vilenës
Iller-Gavonenses	: në Spanjë
Iller-Getes	: në Spanjë, Katalonjë
Illiers	: në Eure dhe Luar, jo larg Shartres
Illiers	: në Zvicër, në Valais
Illos	: mbret legjendar i Trojes, biri i Tros-it, nipi i Dardanos, themeluesi i Illionit (emri grek i Trojës)
Illur-o/ on	: ishull Oleronit në Francë
Illur-Kaukone	: fis me zanafillë kaukone
Illinau	: komunë në Zvicër, kanton i Zyrihut
Is, Isa	: rrënjë që ka hyrë në formimin e rrjedhave të ujit, të shumta në numër në Europë
Ish	: dihet kuptimi i saj në gjuhën shqipe, për diçka të kaluar
Ishull	: gjithmonë në lidhje me ujin.

Për të zgjeruar etimologjinë kemi disa fjalë shqip që kanë nocionin e "shtrëngoj, ndrydh" apo nocionin "zgjeroj, shtrij":

I shtrë (geg), I shtruë = aluzion për "gjatësinë apo shtrirjen" e rrjedhave të ujit si në rastin e Istros (Danubi);

I shtrenguë = kjo të bën të mendosh për ngushtimin e rrjedhave të ujit, në vende të tilla si gryka p.sh. ato të disa lumejve alpinë;

"I zanë"	
Is-ana	: sot "Isen" (Bavaria e sipërme) degë e Inn-it
Isa-ra	: në Francë, emra të lashtë të Iserës dhe Uasës. Pontuaz quhej "Briva Isarae".
Is-asca	: në Piemonte
Is-ella	: në Piemonte
Isa-rella	: lumë i vogël që rrjedh pranë Tulit (Francë)

Is-ar : në kohë të lashta "Isara", degë e Danubit

Is-er : degë e Elbës në Bohemi (në kohë të lashta "Isra")

Is-ca : lumë i Anglisë, sot "Exe"

Is-tros : emër i lashtë i Danubit, një nga lumenjtë më të mëdhenj të Europës. Ky lumë ka qenë boshti lumor i Thrako-Ilirëve të lashtë. I shtrë, I shtruë, në dialektin geg të Shqipërisë së Veriut prej nga del Ishtre-os! Pra ky emër është shtrembëruar nga prapashtesa tipike "os".

Ish-til : (Istil) = pellg, lagunë në gjuhën baske. Ngjashmëria është e dukshme me fjalën shqipe ishull

Ys-sell : degë në formë delte e Rinit në Hollandë

Ys-ser : lumenj në Francë dhe Belgjikë

Mat, Matia : Rrënjë pellazgo-shqipe që do të thotë "breg i pjerrët lumi", por që gjendet edhe si emër i një krahine malore në veri të Shqipërisë dhe lumi kryesor i saj është "Mati". Ky rajon është gjithashtu i famshëm për "shkurrnajat" e saj të shumta.

Mast-ianes : Popull iber, sipas Polibit

Mat-ienes : sipas Herodotit (I, 72, 189, 202; III, 94; V, 49, 52; VII, 72) popull i lashtë pellazg i Azisë së Vogël, Polibi (II, 2/44) i quajnë "Mat- ianes"

Mat-ianes : ortografi e Polibit për të emërtuar të njëjtin popull

Mat-ia : qytet umbrian i Italisë së lashtë (Dioni i Halikarnasit, I,19)

Mat-inus : mal i Apulisë

Mat-in : qytet në Apuli

Mat-sia : popull i lashtë i Indisë. Mat-Asia? Matianë të Azisë?

Shënojmë gjithsesi se lëvizjet e para të popujve europianë drejt Azisë kanë ndodhur me dyndje të shumta: e para ndodhi rreth viteve 6000–4000 para erës sonë dhe e fundit me pushtimet e Aleksandrit të Madh, pjesa më e madhe e trupave të të cilit, sipas Arrianit, ishin me zanafillë

thrako-ilire (Ilirë, Peonian, Thrakë, Maqedonë, Epirotë, Agrianë..)..

Mat-o : drizë, në gjuhën portugeze
Mat-orral : gëmushë në spanjisht
Moita : gëmushë në portugalisht
Motta, Muotta : kjo fjalë do të thotë "gëmushë ose shkurrnajë" në Alpet italiane

Myk: rrënjë e ngjashmë me fjalën shqipe mik. Deri më sot kjo fjalë ka mbetur e pashpjegueshme me anë të gjuhës greke.

Myk-ale = në Azinë e Vogël (mal dhe kep i lartë mbi det)
Myk-arna = në Etoli
Myk -enaï = Mycenes (Peloponez dhe Kretë)
Myk-onos = ishull i Sikladave
Myk-alessos = në Beoti, Karia

Teuta: emër i përveçëm që gjendet në të gjithë popujt me zanafillë ilire. Është fjala për një term shoqëror që emërtonte një tërësi etnike "një të gjithë" dhe për më gjerë kjo do të ketë nënkuptuar "i gjithë populli apo - "thrako-ilire apo pellazge". Në të vërtetë "të tan, të ta" në gjuhën shqipe do të thotë "të gjithë të gjitha". Fjalë që kaloi në mbiemrin latin ("totus"= të gjithë, e gjitha; lidhja midis "tërësia"dhe "shoqëria") e përcjellë nëpërmjet Etruskëve apo popujve të tjerë pellazgë që pushtuan të parët Italinë dhe që do të kenë mbërritur me prejardhje nga rajoni danubian, vatra zanafillore e Thrako-ilirëve. Vetë kjo fjalë ka udhëtuar deri në Azi.

Kjo gjithashtu të bën të mendosh për një fjalë pellazge zanafillore të mbetur të paprekur në gjuhën shqipe: "toka" d.m.th. "tokë, vend, atdhe". Kjo fjalë ka mundur të prishët dhe të shndërrohet me kalimin e kohëve dhe nën ndikimin e dialekteve të ndryshme dhe të bëhet më

në fund "tota", raca, etnia ose populli që ka dalë nga e njëjta "tokë". Mund të ketë rrjedhur edhe nga të famshmit Titanë të mitologjisë, fjala ("të tan") që në shqip do të thotë "të gjithë" dhe më gjerë "gjithë" etnia, "tërësia". Kjo shpjegohet qartë meqenëse Pellazgët, popull zanafillor i Europës, kanë paraprirë Grekët të cilëve iu huazuan një pjesë të trashëgimisë së tyre kulturore dhe të kultit. Gjithashtu, falë gjuhës shqipe – e cila në Europë është e vetmja që ka mundur të ruajë këtë fond të vjetër gjuhësor të Pellazgëve të antikë – ne arrijmë të dekriptojmë fjalë të shumta pellazge

Popujt që përdorin rrënjën teuta në veçanti bëjnë pjesë jo vetëm në "zonën danubiane" (Ilirë, Thrakë, Keltë, Gjermanë, Gale-) por gjithashtu edhe rajone të tjera të banuara nga etni trungut pellazg apo të afërt me të (Etruskët, Trojanët, Oskët, Umbrianët, Baltët, etj.) Ky termë aq më shumë si emër i përveçëm nuk ka pasur kurrë lidhje as me Grekët as me Latinët.

Teuta, Teutana: emër i përveçëm te Ilirët. Mbretëresha e fundit e Ilirisë (shekulli III para Krishtit) quhej Teuta. Ky emër emërton gjithashtu "popullin" te Ilirët.

Teuta : emër i përveçëm femëror te Etruskët

Teutaia, Teutea : variante të tjera të Teutës

Teutamides : mbret i Pellazgëve të Thesalisë, sipas Hellanikosit të Mitilenit dhe që sipas Apollodorit quhet Teutamias

Teutamos : te Homeri (II, 843) ky Teutamos është gjyshi i Hipotosit, prijesi i Pellazgëve të Larisas së Troadës. Ky emër zotëron të njëjtat rrënjë pellazgo-ilire "Teuta". Ai është gjithashtu stërgjyshi i Larisas thesaliane. P. Shantëren (Formimi i emrave në greqishten e lashtë) e njohu këtë rrënjë në një mbihkrim mikenian të Pilos "te-u-ta-ra-ko-ro". Teutae, Teutani, Teutones: variante të emrit Teutamos, Teutates, Teutomatus: emrat e përveçëm gale-.

Teuthea : qytezë e Akaias
Teuthria : ishull i Adriatikut
Tutim, Tuta : në gjuhën etruske = qytet, popull, shtet
Teuta, Touta : në gjuhën kelte = popull, vend
Tauta : në lituanisht dhe letonisht = popull, racë
Tauto : në gjuhën prusiane = vend
Teutates : të Galet "perëndia mbrojtëse e tribusë"
Teuteas : lumë në veri të Azisë së Vogël
Teuthranie : rajon i Misias
Teutomedes : emër i përveçëm thrak
Touto, Toutam : në gjuhën oske = qytet
Tota, Totam : në gjuhën umbriane = qytet
Tuath : irlandishtja e vjetër = fis, popull, vend
Tud : në dialektin breton = njerzit
Tud : në dialektin galez = vend
Thiuda : në islandishten e vjetër = populli
Teudo, Theod : në gjermanishten e vjetër letrare = populli. Kjo fjalë do të ketë krijuar një fjalë tjetër të vjetër "deot" = volk = popull. Nga shtrembërimet ka kaluar në "deuten, diuten" = popullarizoj, bëj të pranueshme. Ka të ngjarë të ketë qenë në zanafillë të fjalës "deutsch", që rrjedh nga "diutisc, theodiuscus".
Thiod : në anglishten e vjetër (anglosaksonen = popull)
Teutons : popull gjermanik
Toda : në persisht = popull

Thumb, thumbi: kjo fjalë e vjetër (shkëmb i lartë i thepisur apo i thiktë) ka ruajtur ende edhe sot kuptimin e diçkaje me majë apo shpuese.. Në të vërtetë në shqip ka po këtë kuptim.

Timpa : në dialektin siçilian do të thotë "shkëmb që bie thikë"
Tempa : në dialektin napolitan (Salerna), i njëjti kuptim; Tempe: gryke në Thesali

Tumpa : grykë në Qipro
Timba : në dialektin katalonas do të thotë "humnerë"
Timpa : në Valencia (Spanjë), i njëjti kuptim.
Tullë : Kjo fjalë me zanafillë para indo-europiane me kuptimin e – apo deltinë, tokë e yndyrshme, argjilë. Në shqip ekziston edhe një tjetër term "tulinë" që do të thotë "tokë e butë". Kjo fjalë tullë ka të ngjarë të jetë paardhësja e fjalës "tuile" (tjegull).
Tell-us : do të thotë "tokë" në gjuhën etruske
Tull-n : qytet në Danub jo larg Vjenës (vend i banuar nga Ilirë tantikë)
Tull-aises : qytet i Alpve të Jugut (vend i banuar nga Ligurët antike)
Tala-mina, Tala-vera : në Iberinë antike
Tala, Tala-va, Tala-na : në Sardenjë
Tala-rus : në Korsike
Tala-r : në Epir (Greqi)
Tali-cus : në Azinë e Vogël
Tol-mino, Tol-lezzo : në Itali
Tol-ede : në Spanjë
Tala-r : në Gjeorgji
Tala-ki : në dialektin gruzian
Teol-enn : në dialektin breton, do të thotë "tullë".

Truall, troje, troja

Kjo fjalë është ende në fjalorin e gjuhës shqipe. Emri i një qyteti legjendar, kaq i përshkruar në Iliadë është Troja, term identik dhe kuptimi i së cilës sigurisht që nuk është shumë larg nga ai i ruajtur në gjuhën e sotme shqipe. A ishte ky vend, ky qoshk, ky terren, territor – ku u zhvillua lufta e mbiquajtur e Trojës. Pas disa qindra përputhjesh gjuhësore të zbuluara në veprën që keni në dorë midis pellazgjishtes së lartë, thrako–ilires, etruskishtes, ose frigjianes dhe shqipes së sotme, a mund të dyshohet qoftë edhe për një çast për zanafillën pellazge të

Trojanëve? Nga ana tjetër ky emër ka të ngjarë të jetë në zanafillë të fjalës latine "territorii" (territor), paraardhëse e frëngjishtes "territoire" (territor).

Tashmë ja dy fjalë të vjetra shqipe shumë kuptimplote që rigjenden te Egjiptianët:

Farë, fara

Kjo fjalë përbën rrënjën e fjalës Phar-aon (Pharaon), që në shqip do të thotë "Farë e onë", pra "fara jonë". Kjo fjalë dhe fjala më poshtë përbëjnë një element gjuhësor thelbësor që del çuditërisht në gjuhën e Faraonëve. Ka të ngjarë të ketë të tjera që do të duhej kohë për t`i studjuar dhe për t`i nxjerrë në pah.

Thot = thotë

Folja "them", në shqip do të thotë edhe tregoj, mendoj, gjykoj. "Thotë" pra nënkupton ai që tregon, mendon, gjykon. Nëse i studiojmë më nga afër atributet e perëndisë egjiptiane Thot, vërejmë një ngjashmëri turbulluese me fjalën shqipe "thotë". Në të vërtetë perëndia Thot ishte perëndia e dijenisë dhe e të shkruajturit. Ajo paraqitej me një kokë të Ibis-it dhe shpesh shoqërohej nga Anubis (perëndia me kokë çakalli që dërgonte të vdekurit në botën tjetër). Të dy përpara Osiris-it duhej të shqyrtonin drejtësinë përpara peshores (peshimi i zemrës së të vdekurit, të cilit sapo vdiste, kopja e tij krahasohej përpara Osirisit që ndihmohej nga dyzet e dy gjykatës). Thot, në epokën greko-romake krahasohej me Hermesin Trismegisti (Mërkuri i Romakëve). Çuditërisht kjo perëndia e fundit, në mitologjinë e ashtuquajtur greke, shpjegohet falë gjuhës shqipe (shiko këtë emër te "përputhjet gjuhësore"). Me pak fjalë Hermes shpjegohet nga "Err mes", në dialektin geg të Shqipërisë së Veriut, që do të thotë "Unë vras terrin" apo ai që vret ose sfidon terrin. Një nga funksionet zanafillore përpara mbërritjes së Grekëve

ishte ai i drejtuesit të shpirtit të të vdekurve drejt banesës së fundit të tyre, d.m.th. "bota e përtejme" (terri). Fjala "Trismegiste" shpjegohet gjithashtu falë gjuhës shqipe. Kjo fjalë, të cilën Grekët e shpjegojnë "nga ana fonetike" nëpërmjet "tri herë më i madh", shpesh shoqërohej me Hermesin. Gjithsesi legjenda tregon se Hermesi e krijoi "lirën" falë zhguallit të breshkës, të cilën e përdori si kuti rezonance dhe zorrët si telat e saj. Pellazgët e asaj kohe e cilësonin atë me "Err mys – Kris me gishta" d.m.th "Hermesi që i bie me gishtat e tij". Ky instrument, si pasojë e një këmbimi u bë "lira" e Apollonit. Kjo është kuptimplote!

Përsa i takon perëndisë egjiptiane Thot të përdorur në titullin e librit "Thot fliste shqip" të Xhuzepe Katapanos (botuar në Romë në vitin 1984) dhe analiza që ai bën në lidhje me këtë, vërteton më së miri përkatësinë e kësaj fjale në onomastikën pellazgo-shqipe.

Pellazgo – shqipja

Për të rigjetur pellazgjishten e lashtë, të trajtuar nga disa si "indo-europiane" dhe "jo indo-europiane" nga të tjerët dhe gjuhë shumë herë e shpallur "parahelene dhe e zhdukur", tashmë na duhet që ta studiojmë në të gjithë tërësinë e saj gjuhën shqipe. Kjo gjuhë është e vetmja gjuhë në Europë që mund të ngjitet deri në mugëtirën e kohërave dhe të inerpretojë gjuhën antike madje parahistorike të këtyre Pellazgëve kaq herë të trajtuar keq njëherësh nga historianët dhe gjuhëtarët. Pra nëpërmjet kësaj gjuhe shqipe, fosile e vërtetë dhe dëshmitare e gjallë, ku gjenden jo vetëm disa grimca por një pjesë e rëndësishme e kësaj pellazgjishteje të lashtë.

Për të shmangur çdo ekuivok dhe për më shumë qartësi, unë do ta emërtoj gjuhën e studimit që keni në dorë me fjalë "pellazgo-shqipe", sepse bëhet fjalë për fillimin (Pellazgët) dhe fundin (Shqiptarët) e një vargu gjuhësor, vijimësia e të cilit deri në ditët tona nuk është kundërshtuar as nga historia as nga gjeografia, as nga arkeologjia madje

as nga antropologjia. Kjo e vërtetë si drita e diellit nuk është kundërshtuar edhe nga ata, të cilët nuk kanë arritur të sjellin edhe provën më të vogël për të kundërtën e saj.

Nëse shkrimet mbesin memece, një gjuhë e harruar dhe e shpërfillur por trashëgimtare e kësaj të kaluare të famshme del qysh nga themelet e njerëzimit për të na sqaruar dhe për të na dhënë kuptimin e toponimeve, oronimeve ose etnonimeve që këto popullsi parahelene na kanë lënë trashëgim. Nëse Shampolijoni nuk do të kishte gjetur të famshmin "gur i Rosetës" që përfshinte tri epigrafe të ndryshme (egjiptiane e lashtë, demotike dhe greqisht) atëherë kurrë nuk do të ishin deshifruar hieroglifet. Pra duke u nisur nga këto krahasime të sigurta ne arrijmë në rezultate bindëse. Është rasti i gjuhës shqipe, e cila megjithë disa papastërti, futje fjalësh të huaja apo huazimesh jo shumë të rëndësishme të detyruara nga stuhitë apo trazirat e kohëve na jep çelsin e kësaj gjuhe parahelene, madje parahistorike.

Një muzikalitet dhe një harmoni, rezonanca mitike e të cilave gjen jehonë në poemat e shumta apo këngët epike të cilat thrako-ilirët e së djeshmes dhe pasardhësit e tyre shqiptarët, gjithmonë i kanë kënduar për të nxitur dashurinë e pashuar dhe ndjenjën e zjarrtë proverbiale për tokën e tyre mëmë si dhe për të parët e tyre të lavdishëm. Kjo gjuhë ka ruajtur strukturën e saj sintaksore zanafillore, e cila e dallon shumë lehtë në intonacionet e ndryshme të saj, fjalët e shumta të tyre njërrokëshe, fonetikën e veçantë dhe fjalorin e saj zanafillor: një gjuhë e prerë dhe thellësisht thirrmore, admiruese, shprehëse, shëmbëllyese dhe demosturese. Eduard Shnaider në librin e tij "Pellazgët: një racë e harruar" (Paris 1894) e ka përmbledhur shumë drejt: "Ne nuk mendojmë që njeriu në kohët e hershme, qysh se ai ka nisur të artikulojë mendimin e tij ka përdorur një frazë, madje një fjalë dyrrokëshe për të emërtuar dielllin, qiellin, yjet, tokën, zjarrin, erën, njeriun, kafshën, zogun, frutin, kokën, ujin, etj.. Të gjithë këta emra duhet të kenë qenë të shkurtër, më shumë të fortë se të butë, shprehës dhe që shpreh

harmoninë shëmbëllyese, e cila u bë figura e parë e retorikës, të cilën njeriu zanafillor e shpiku vetvetiu".

Këta Pellazgë, Lelegë, Thrakë, Trojanë, Frigjianë, Ilirë dhe fise të tjera të shumta të dala nga i njëjti trung etnik (madje nga larmia e emrave të tyre) a nuk na kanë lënë shkrimet e sigurta (ky shkrim në një moment të dhënë a nuk ka ekzistuar dhe dokumentet e saj egzistuese a nuk janë shkatërruar me dashje nga ata që kanë pushtuar historinë e tyre, një pjesë të madhe të trashëgimisë së tyre kulturore?). Ata na kanë lënë një thesar të vyer të përbërë nga emrat e vendeve të ndryshme, emrat e prodhimeve bujqësore, të kafshëve shtëpiake, të orendive shtëpiake, lumejve të vegjël dhe të mëdhenj, kullotave, liqeneve, malësive, të qyteteve, të fortesave, të mureve ciklopike si dhe të emrave të perëndive dhe të heronjve etj. Këta emra kanë kaluar pa u penguar ndër mijëvjeçarë. Pra ata na kanë lënë trashëgim të gjitha këto përgjatë shtegtimeve të tyre të shumta nëpër Europë, Azinë e Vogël, madje Azinë e Largët. Këto janë të vetmet gjurmë të tyre të pashlyeshme të ekzistencës së vërtetë të tyre sepse shkrimi në këto kohë të hershme nuk ekzistonte ende. Në të vërtetë shkrimet e para, ato që e meritojnë këtë emër, janë shfaqur vetëm nga vitet 3300 para erës sonë kur flasim për gjuhën sumeriane dhe rreth 3100 para erës sonë për gjuhën egjiptiane.

Gjuha e sotme shqipe është ruajtur pothuajse e paprekur gjatë më shumë se tridhjetë shekujsh në malësitë e vjetra të Europës dhe mbi të gjitha ato të Alpeve dinarike shqiptare, mur mbrojtës i pamposhtur përballë pushtuesve të shumtë që kanë shkelur tokën e botës së vjetër. Në këtë rajon (hapësira ballkano-egjeo-danubiane) popullsitë zanafillore, ndoshta sepse u përndoqën pa rreshtur nga pushtuesit e ardhur nga vende të tjera, qysh në kohë të hershme përfunduan duke u tërhequr në skutat e tyre malore (Arkadi, Epir, Maqedoni, Thrakë, Iliri, Azi e Vogël, Kretë, Masivi alpin, Pirenej, Kaukaz, etj.), streha natyrore ku lindnin zogjtë e shqiponjave dhe vendet hyjnore ku gjithashtu u pa të lindë, pikërisht në një nga shpellat e tyre (=shpellë, shpella zanafilla e

etnonimisë së Pellazgëve/"Shpella/gji" = njerëz të shpellave) mbreti dhe perëndia e tyre e njohur, Zeusin pellazg, siç e ka cilësuar Homeri në epopenë e tij të famshme (Iliada XVI, 234).

Është e pamohueshme që gjuha e sotme shqipe, nga njëra anë për arsye të vendndodhjes së saj gjeografike dhe të pranisë së saj të pashkëputur në Ballkan si dhe nga ana tjetër të të dhënave historike, arkeologjike, antropoligjike, etnike apo mitologjike të studiuar në veprën që keni në dorë si dhe nga autorë të tjerë, mbetet një gjuhë unike. Fondi i saj i vjetër gjuhësor ngjitet ndër gjuhët e para të folura në Europë: emrat e vendeve parahelene, emrat e perëndive dhe të heronjve të mitologjisë të mbiquajtur greke shpjegohen në mënyrë të përkryer falë gjuhës shqipe dhe aspak asaj greke. Gabimi i gjuhëtarëve, historianëve ose i arkeologëve ka qenë sepse i ka trajtuar këta emra se i përkasin një gjuhe parahelene të zhdukur. Ata nuk kanë bërë përqasjet e nevojshme midis pellazgjishtes së lashtë dhe shqipes së sotme. Përveç kësaj ata nuk kanë vendosur asnjë përputhje etnike dhe gjuhësore midis tribuve të ndryshme që i përkasin së njëjtës etni pellazge: Lelegë, Ligurë, Karianë, Lisianë, Mizianë, Frigjianë, Trojanë, Dardanë, Etruskë, Thrakë dhe Ilirë, duke cituar kështu vetëm më të njohurit. Pra shqipja e sotme bën pjesë në këtë varg të stërmadh etno-gjuhësor.

Përpara se të kalojmë me radhë veçoritë e gjuhës shqipe, këtu më poshtë jepet alfabeti shqip që përbëhet nga tridhjetë e gjashtë gërma (36) nga të cilat vetëm ndonjë dhjetësh janë të ndryshme, p.sh. nga alfabeti francez që ka njëzet e gjashtë gërma (26). Një francez që ka mësuar të dallojë nga ana fonetike këto dhjetë gërma mund që shumë lehtë të lexojë gjuhën shqipe. Unë po shënoj dhe një pikë tjetër thelbësore në lidhje me vërtetësinë historike të gjuhës shqipe për të cilën disa (ata që e njohin jo mirë ose aspak) pohojnë se ajo është e vonshme, madje formim hibrid, që përmbledh vetëm elemente heterogjene (greke, latine, turke, sllave, bullgare...), ndërkohë që fondi i saj gjuhësor rrjedh në mënyrë të pakundërshtueshme nga gjuha e

stërgjyshëve të tyre autoktonë, të cilët qysh prej mijëvjeçarësh kanë jetuar në të njëjtën tokë (hapësira bllkano-danubiane) dhe që janë në zanafillën e formimit të gjuhëve greke (nëpërmjet pellazgjishtes) dhe latine (nëpërmjet gjuhës etruske).

Duke u nisur nga këto të dhëna të gabuara, nga pista të gabuara dhe duke sfiduar të gjitha ligjet e llogjikës, disa ende guxojnë të flasin për të vërteta që pretendojnë se janë të pamohueshme. Gjithsesi kjo gjuhë është një gjuhë e vjetër dhe në mos më e vjetra gjuhë e Europës. Është kjo që përfundimisht, falë treguesve të shumtë të dhënë nga autorët antikë dhe studimet e shumta të shumë fushave të kryera nga autorë të kohëve tona, të cilët për fat të keq kurrë nuk janë dëgjuar.

Ne e dimë se kjo gjuhë rrjedh drejtpërdrejt nga thrako-ilirishtja dhe kjo vetë drejtpërdrejtë nga pellazgjishtja e lashtë.

Me përparimin e qytetërimit grek, kulmi i së cilës vendoset rreth shekullit V para Krishtit dhe pushtimit të viseve ilire (që gjendeshin midis Danubit dhe Greqisë) nga hordhitë romake në vitin 168 para Krishtit, popujt e shumtë thrako-ilirë të rajonit ballkano-danubian u larguan duke u strehuar në strehët e tyre natyrore që janë malësitë dinarike, shqiptare dhe epirote. Aty ata gjendën të veçuar nga pjesa tjetër, ndër skutat e tyre malore, vëllezërit e të njëjtit trung pellazg. Por mbërritja e Sllavëve në shekullin VI–VII pas Krishtit i detyroi këta që kishin mbetur në tokat e të parëve të tyre qoftë të ribashkoheshin me vëllezërit e tyre të një gjaku të strehuar në malësitë e pamposhtura qoftë të integroheshin me pushtuesit sllavë, të cilët arritën të sllavizojnë gjithçka, duke e përthitur apo asimiluar pjesërisht kulturën dhe gjuhën e tyre. Ja përse ekzistojnë disa përafërsi kulturore dhe gjuhësore midis pushtuesve sllavë dhe autoktonëve thrako-ilirë.

Ilirët, për të shkruar gjuhën e tyre përdorën respektivisht alfabetet greke dhe latine, gjuhët më të përdorura të atyre kohëve. Pastaj me kalimin e kohëve ata e humbën përdorimin e të shkruajturit. Nga shekulli XV ata u bënë të vetëdijshëm për këtë mangësi dhe vendosën

ta rishkruajnë gjuhën e tyre. Duke iu munguar alfabeti i tyre ata përfunduan duke përdorur përfundimisht alfabetin e latinëve, të kishës katolike romake (më e përhapura e kësaj epoke, sepse shqiptarët, përveç atyre që vazhduan të adhurojnë perënditë e tyre mitike, në këtë epokë ishin të gjithë të krishterë. Në të vërtetë, Shqipëria është një nga vendet e para të kristianizuara në Europë (rreth shekullit I dhe II).

Përveç kësaj përhapësit e parë të alfabetit të ri shqip dhe të letërsisë shqipe që po lindte ishin shpesh priftërinjtë katolikë shqiptarë, pjesa më e madhe e të cilëve ishin me zanafillë nga veriu i Shqipërisë: rreth vitit 1462 Pal Engjëlli (arkipeshkvi i Durrësit në epokën e Skënderbeut) shkroi në shqip një formulë pagëzimi; në vitin 1555 Gjon Buzuku formuloi në dialektin geg një meshar; Marin Barleti ishte autori i një biografie (në latinisht, i përkthyer më vonë në gjuhën shqipe) të Heroit Kombëtar shqiptar Gjergj Kastrioti - Skënderbeu; në vitin 1592 Lekë Matrënga përktheu në dialektin tosk një katekizëm latin; në vitin 1621 Pjetër Budi, prift shqiptar nga veriu i Shqipërisë, hartoi një katekizëm dhe një ritual roman; në vitin 1635 Frang Bardhi nxorri një alfabet latinisht-shqip (latino-epiriticum – 15 000 fjalë) dhe një apollogji të Skënderbeut; në vitin 1683 Pjetër Bogdani hartoi një trajtesë filozofiko-teologjike (Çeta e Profetëve) dhe një vepër të quajtur "Jetët e Shenjtorëve". Por rreth vitit 1332 një murg francez i quajtur Brokardus, vepra e të cilit duket se i takonte Gulielm Adaes (arkipeshkv i Tivarit) pohon se "Shqiptarët, megjithëse kishin një gjuhë krejt ndryshe nga latinët, në librat e tyre përdornin gërmat latine". Kjo vërteton faktin se Shqiptarët qysh prej kohësh të hershme përdornin alfabetin latin. Por ky alfabet latin u konkretizua përfundimisht vetëm nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi shekullit XX. Në vitin 1878 Lidhja e Prizrenit vendosi zyrtarisht alfabetin latin për të shkruar gjuhën shqipe. Megjithatë në vitin 1908 në Kongresin e Manastirit u modifikua pakëz dhe u thjeshtësua. Por ky alfabet i parë dhe i korrigjuar në formën që është edhe sot daton vetëm qysh nga viti 1917. Së fundi shënojmë se

Turqit, gjatë kohës që lanë alfabetin e tyre arab në vitin 1928, u frymëzuan nga alfabeti i ri shqip për të krijuar alfabetin e tyre (diaspora shqiptare kishte një ndikim të madh në Turqi: Ataturku dhe figura të tjera madhore që krijuan shtetin ishin pjesë e kësaj diaspore).

Gjithsesi, në vitin 1972 Kongresi i Drejtshkrimit, nën pushtetin e regjimit komunist, oligarkik dhe diktatorial të Enver Hoxhës (frankofon dhe me zanafillë nga jugu i vendit), nën petkun e unifikimin gjuhësor, vendosi dialektin tosk në themel të gjuhës letrare dhe zyrtare të Shqipërisë. Në të vërtetë mbizotërimi i dialektit tosk (dialekti i jugut) e ka çuar ndër skutat e harresës gjuhësore dialektin e veriut: dialektin geg. Antagonizmi midis Shqiptarëve të veriut dhe të jugut është i përhershëm për punë të gjuhës së folur e të shkruar. Ata bashkohen apo bien në marrëveshje vetëm përpara ndonjë rreziku kombëtar që prek inegritetin territorial dhe sovranitetin e tyre. Ekziston gjithashtu edhe një pikë tjetër si dukuri negative dhe për të ardhur keq, e cila lidhet me këtë epokë të pasluftës, ajo e futjes së shumë neologjizmave nga gjuhët fqinjë dhe frëngjishtja, gjuha e preferuar e elitave në pushtet.

Kjo paraqitje historike shpjegon përse gjuha shqipe, duke mos qenë as gjuhë latine as neo-latine, shkruhet sot me anë të alfabetit latin të modifikuar sipas kritereve që lidhen me fonetikën dhe sintaksën shqipe, të cilat ne do t'i shqyrtojmë.

A	G	N	T
B	GJ	NJ	TH
C	H	O	U
Ç	I	P	V
D	J	Q	X
DH	K	R	XH
E	L	RR	Y
Ë	LL	S	Z
F	M	SH	ZH

Ky alfabet përbëhet nga shtatë zanore (a, e, ë, i, o, u, y) dhe nga njëzet e nëntë bashkëtingëllore. Është fjala për një alfabet të tipit fonetik ku të gjitha gërmat shqiptohen. Diagramat (dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh), pra grupe dy gërmash, janë krijuar në veçanti për të përshtatur pasurinë e madhe të fonetikës shqipe.

Shqipja ruan ende diftongje të ndryshme (rreth dyzet) ndërkohë që gjuha greke ka jo më shumë se nëntë, sanskritishtja dy dhe latinishtja një. Gjuha shqipe ka edhe rreth shtatëqind e pesëdhjetë "fjalë-rrënjë" njërrokëshe. Këto diftongje dhe njërrokëshet e tyre janë rezultat i një fenomen të vjetër gjuhësore që ka filluar bashkë me belbëzimet e para të njeriut qyshse në zanafillë. Me të vërtetë, nëse krahasojmë fjalët e gjuhës shqipe (kryesisht ato gege) p.sh. pa, ba, ma (mban) dhe po këto fjalë në sanskritisht dallohet me lehtësi se kuptimi i tyre i ndërsjellë është i ndryshëm: pa (mbroj), ba (sjell), ma (prodhoj). Zanafilla e gjuhës, në mënyrë të veçantë duhet kërkuar në fjalët që kanë lidhje me ujin, nuhatjen, pamjen, prekjen, shijen: elementet e para e kanë detyruar njeriun zanafillor të shprehë mendimet, dëshirat, sjelljen apo reagimet falë këtij lloji tingujsh, shpesh njërrokësh. Gjuha e koduar e gjuhëtarëve flet gjithashtu për zanore, diftongje, diftongje të rreme, gjysmë-zanore, zanore të dyfishta, etj.

Gjuhëtarët deri më sot, duke mos u thelluar në studimet e tyre apo duke i shtyrë shumë larg studimet e tyres specifike për shqyrtimin e gjuhës shqipe, e klasifikuan shqipen mes gjuhëve të mbiquajtura indo-europiane, të tipit satem special. Gjithsesi e trajtojnë si një degë më vete. Kjo është një nga arsyet për të cilat ajo, si të thuash, ka qenë vënë mënjanë. Ja përse pas gjuhëtarëve të shekullit XIX dhe atyre të gjysmës së parë të shekullit XX, ithtarët e tyre njëri pas tjetrit pothuajse kanë rimarrë tezat e tyre të ndryshme, pa i vënë në diskutim apo të paktën për të sjellë frymën e kritikës dhe të kundërshtisë së nevojshme për çdo hap shkencor. Pararendësit e gjuhësisë moderne janë shqetësuar

pikësëpari për përpunimin e disa teorive: shpikja e termit indo-europian: shpikja e termit indo-europian, kërkimi i një vatre zanafillore të përbashkët (rrafshina e Pamirit, Baktrian, Ural, Kaspian, Azi e Vogël, Lindja e Afërt dhe së fundi stepat ruse të Kurganëve, teza të mbështetura nga disa autorë slavofilë), diktimi i disa analogjive dhe ngjashmërive sintaksore dhe etimologjike midis gjuhëve perëndimore dhe sanskritishtes. Por në veçanti ata kanë shpërfillur një nga pistat më të rëndësishme, të tillë si ato të quajtura "europiane" ose "ballkano-danubiane" (cf. Kapitulli "Indo-Europianizmi").

Përkatësia e mirëfilltë gjuhësore përcaktohet kryesisht në tërësinë e saj, nëpërmjet identitetit ose ngjashmërive sintaksore, morfologjia gramatikore dhe përafërsitë etimologjike.

Por dy popuj, të largët nga njëri-tjetri nga ana gjuhësore dhe gjeografike, mund të përdorin një fjalë të njëjtë, të kenë fonetizim të njëjtë dhe të mos kenë as edhe një zanafillë të përbashkët! Gjithsesi është ende fonema shtegtuese që hyn në lojë duke bartur emrat dhe të gjitha llojet e fjalëve dhe fonemave në popullsitë që tashmë e kanë gjuhën e tyre. P.sh. fjala mal, të cilën gjuha shqipe është e vetmja në botë që e ruan, (dhe ajo rumune, gjuhë e dalë nga ajo dako-gete, thrako-ilire) dhe e përdor gjithmonë, ka udhëtuar nga njëri skaj i Europës perëndimore deri në skajin e Lindjes: Malberg, Malmont, Mallorka, Malta, Mallia, Malea: Malatya, Hymalaya, Malaya, Malaysia, Malabar...!

Megjithatë është shtjellimi apo bashkimi i faktorëve të shumtë (gjuhësorë, etnikë, historikë, antropologjikë ose arkeologjikë ndër faktorët e tjerë) që përcakton zanafillën ose unicitetin e një gjuhe me një popull të dhënë. Vetëm shqipja e sotme zotëron në Europë këto karakteristike themelore. Kjo gjuhë është folur gjithmonë, me disa nuanca, përafërsisht rreth nyjes së saj etnike qendrore: rajonit ballkano-danubian. Ajo është përhapur në dy skajet e Europës. Ja përse gjuha baske (dhe ka të ngjarë ajo ibere që njihet jo mirë), gjuha kaukaziane e vjetër dhe armenishtja (Armenët e lashtë ishin një popull me zanafillë

thrako-frigjiane) paraqesin ngjashmëri të dukshme me gjuhën shqipe. Autorë të shumtë modernë e kanë vërejtur këtë fenomen, por fatkeqësisht ata nuk e kanë kuptuar mjaftueshëm. Kjo ngaqë është fshehur i gjithë fenomeni, se gjuhësia moderne ka qenë krejtësisht e përafërt në përcaktimin e këtyre faktorëve të shumtë dhe, si rrjedhojë, për t'i mveshur popullit pellazg një rol thelbësor që i takon në ndërtimin e gjuhëve të para të folura në Europë para shfaqjes së Helenëve në shekullin VIII para Krishtit. Nëse gjuhëtari mbyllet me kokëfortësi në kullën e tij të fildishtë, shqyrton veçse hollësitë dytësore të llojit në thelb filologjik, duke anuar në mendime të mirëfillta teorike dhe nuk del nga shtigjet e rrahura ose nga disiplina e tij shkencore për të shkuar dhe për të hulumtuar (me seriozitet) disiplinat e tjera, ai rrezikon në mënyrë të padiskutueshme të dalë me përfundime të cunguara. Pra doja të nxirrja këtë në pah, përpara se të hyja në temën e vërtetë, të cilën unë do ta nis menjëherë. Këtu nuk do t'i hyj aventurës që të jap një kurs prej specialisti të gjuhësisë, sepse nuk është ky qëllimi i këtij libri, i cili pikësëpari është dukshëm didaktik, analitik dhe demonstrativ.

Dialektet

Gjuha shqipe përmban dy dialekte, njëra në veri të vendit, tjetra në jug:

● dialekti geg flitet në veri, përtej një vije ndarjeje të vendosur në përgjithësi nga gjuhëtarët shqiptarë dhe që është lumi Shkumbin, i cili kalon përmes Shqipërisë nga Perëndimi në Lindje dhe që e ndan vendin gjeografikisht në dy pjesë: Veri dhe Jug. Dialekti verior, geg , përfshin të gjithë pjesën mbi lumin Shkumbin, Kosovën dhe rajonet në kufi me Shqipërinë, si jugu i Malit të Zi dhe perëndimi i Maqedonisë. Ky dialekt është shumë më i butë se ai tosk.

● dialekti tosk flitet poshtë kësaj vije deri në Epir. Ky dialekt më i fortë se ai geg karakterizohet nga rotacizmi i tij (shpesh në shqiptimin e bashkëtingëllores "r", brenda fjalës apo në fund të fjalës) si dhe nga

disa veçori të tjera leksikore ose fonetike që ne do të gjejmë në vijimësinë e këtij studimi.

Foljet

Folja në gjuha shqipe përbëhet nga nëntë (9) mënyra dhe njëzetekatër (24) kohë. Foljet zgjedhohen me anë të mbaresave që tregojnë kohën dhe vetën.

Dëftore
- E tashme
- E pakryer
- E kryer e thjeshtë
- E ardhshme
- E kryer
- E kryer e plotë
- E kryer e tejshkuar
- E ardhshme e tejshkuar
- E ardhshme e përparme

Habitore
- E tashme
- E kryer
- E pakryer
- E kryer e plotë

Urdhërore

Paskajore

Pjesore

Lidhore
- E tashme
- E pakryer
- E kryer
- E kryer e plotë

Përcjellore

Shembull i zgjedhimit të foljeve ndihmëse kam dhe jam në kohën e tashme, mënyra dëftore:

Kushtore
- E tashme
- E shkuar

Dëshirore
- E tashme
- E shkuar

Folja kam	Folja jam
kam	jam
ke	je
ka	është
kemi	jemi
keni	jeni
kanë	janë

Shqipja është e vetmja gjuhë e gjallë që ka një "të tashme bindëse", në veçanti në mënyrën habitore por në të vërtetë e papërkthyeshme: paskam, qenkam, qakam.

Theksi dinamik është një fonemë e vjetër pellazge që përvijon në gjuhën shqipe. Ai vendoset në përgjithësi në disa rrokje të rrënjës. Përsa i takon sistemit foljor theksi vendoset në rrokjen e fundit dhe për sistemin emëror vendoset në rrokjen e parafundit.

Emrat dhe lakimet e tyre

Emrat e përveçëm dhe emrat e përbashkët lakohen në dy forma të ndryshme:

- Forma e pashquar

  Tiranë, Durrës, Korçë, Përmet, Elbasan, Mat, Koplik

  Gjon, Viktor, Mark, Pal, Luan, Zog, Aranit...

- Forma e shquar

  Tirana, Durrësi, Korça, Përmeti, Elbasani, Mati, Kopliku.

  Gjoni, Viktori, Marku, Pali, Luani, Zogu, Araniti....

Emri në gjuhën shqipe ndryshon formë duke ndryshuar funksionin. Funksioni i emrit kuptohet vetëm me anë të mbaresës së tij.

Nyja

Nyja në gjuhën shqipe nuk është si ajo që njohim në frëngjisht d.m.th. përpara emrit: ajo vendoset pas emrit dhe luan rolin e një prapashtese. Në përgjithësi për gjininë mashkullore mbizotërojnë "u" dhe "i", në emrat femërorë "a", në mashkulloren shumës "it" dhe "et" dhe në femërore shumës "at". Fillimisht gjuha greke kishte zanore të vendosura në fund (veçori pellazge). Përveç gjuhës shqipe vetëm gjuha rumune, vllahe (e ndikuar nga gjuha dako-gete e dalë prej asaj thrako-ilire), armene (huazime të bëra në gjuhën e Thrako-Frigjianëve që kishin kolonizuar Armeninë), bullgare (Bullgarët, të vetmit ndër Sllavët që përdornin nyjen e vendosur në fund, kanë bërë huazime të shumta në gjuhën e popullit të trungut pellazg të cilin e nënshtruan: Thrakët) si

dhe gjuha baske, disa gjuhë të Kaukazit (dy skajet e shtrirjes pellazge!) dhe gjuha etruske e kanë ruajtur këtë nyje. Të tjerat nuk kanë nyje të vendosur në fund, por mbaresa (latinishtja, rusishtja etj.).

- Bari = bariu =(geg) barít - (tosk) barinj
- Mi = miu = mít - (tosk) minj
- Gomar = gomari = gomaret
- Mal = mali = malet
- Dac = daci = dacat
- Sqep = sqepi = sqepat
- Macë = maca = macet
- Vapë = vapa = vapát
- Tokë = toka = tokát
- Nanë = nana = nanát

Rasat kryesore të lakimit janë si më poshtë :

Rasa emërore

Në gjuhën shqipe përdoret pa parafjalë (rasti i kryefjalës apo të kallzuesit emëror) me parafjalën "nga", (plotësues vendi, kohe...) dhe parafjalën "te" ose "tek" (plotësues i kundrinës së zhdrejtë, të vendit ...).

Rasa gjinore

Kjo rasë tregon përkatësinë dhe ku përdoren emrat si plotësues të disa emrave, foljeve... Në shqip ajo paraprihet nga një nyje.

P.sh. koka e djalit

Rasa dhanore

Kjo rasë shërben për të treguar raportin ndaj dikujt apo diçkaje, në gjuhët ku emrat dhe mbiemrat lakohen. Në gjuhën shqipe kjo përdoret pa parafjalë. Kjo është plotësues i kundrinës së zhdrejtë të një folje kalimtare.

P.sh. ja tregoj djalit

Rasa kallzore

Kjo rasë shërben kryesisht për të treguar sistemin e drejtpërdrejtë të foljeve veprore dhe atë të disa parafjalëve. Kjo është plotësues i

kundrinës së drejtë në një folje kalimtare (pa parafjalë) dhe plotësues vendi, kohe (me parafjalë).

P.sh. mora një macë

zjarrmi ban dam

Rasa rrjedhore

Këtu është fjala për plotësuesin rrethanor që shfaqet në përgjithësi në frëngjisht me anë të parafjalëve me, prej...

Djali kthej prej shkollës

Rasa thirrore

Kjo rasë shërben për t'iu drejtuar apo për të thirrur dikë. Në frëngjisht kjo zëvendësohet nga pasthirma O, e shprehur ose e nënkuptuar.

O, ti që të kam dashur aq shumë, përse më ke tradhtuar?

Gjuha shqipe ka tri gjini në rasat e shquara dhe të pashquara: dy në numrin njëjës, qoftë femërore qoftë mashkullore, si dhe një në asnjëanësen, e cila shfaqet në dy gjinitë e para si dhe në shumës me anë të epentezës "ra" që ndërfutet midis rrënjës apo rrënjësorit dhe nyjës së vendosur në fund (t), pikërisht në shumës:

- qershi, qershia, qershitë
- qershira, qershirat

Dallimi midis gjinive nuk është i thjeshtë sepse për sa më sipër nuk ekziston asnjë rregull i përgjithshëm. Shumësi p.sh. është shumë i ndërlikuar sepse ekzistojnë shumë tipe. Përveç rasteve të shqyrtuara më sipër hasen edhe disa të tjera të veçanta:

Mik	= miq, miqtë
Fik	= fiq, fiqtë
Plak	= pleq, pleqtë
Rrezik	= rreziqe, rreziqet
Ka	= qe, qetë
Kalë	= kuaj, kuajt,
Djalë	= djem, djemtë

Hu	= hunj, hunjtë
Kërcu	= kërcunj, kurcunjtë
Pe	= penj, penjtë
Ulli	= ullinj, ullinjtë
Mbret	= mbretër, mbretërit
Mbretëreshë	= mbretëresha, mbretëreshat
Nip	= nipër, nipërit
Prift	= priftër, priftërinjtë
Djathë	= djathra, djathrat
Fshat	= fshatra, fshatrat

Mbiemri cilësor apo përcaktor paraqitet në forma të shumta. Ai paraprihet nga një nyje lidhëse ("i" për gjininë mashkullore dhe "e" për gjininë femërore, "të" për shumësin):

i	përcakton	gjininë	mashkullore, numri njëjës	: i mirë
e	"	"	femërore, " "	: e mirë
të	"	"	mashkullore, " shumës	: të mirë

të + prapashtesa a ... përcakton gjininë femërore numri shumës: të mira

Çdo mbiemër i shquar lakohet sipas emrit me të cilin lidhet. Kjo lidhje apo përputhje bëhet, ashtu siç do ta shohim, me anën e gërmave të vendosura përpara: i, e, të . Në disa raste mbiemri i pashquar mbaron në gjininë mashkullore shumës më shim ose shëm, ndërsa në gjininë femërore njëjës apo shumës fillon me "të" dhe përfundon me "ë":

i, e dishim (i ditur, e ditur); të dishim (të ditur, të ditura); të dishmë (të ditur)

Prapashtesat përcaktuese

Kjo është një veçori e gjuhës shqipe. Këto prapashtesa i hasim vazhdimisht: ar, an, ak, ik, ek, ac, ec, or, çi, xhi, gji...

Këpucar
Këngëtar
Udhëtar
Bashkatdhetar
Besimtar

Krenar	Kastravec
Kopshtar	Bigavec
Luftëtar	Koprac
Peshkatar	Bahçevan
Besnik	Kapidan
Pashallik	Partizan
Rrumbullak	Pazvan
Fisanak	Shakaxhi
Gjakësor	

Përemrat vetorë

Unë	Ju
Mua, më	Juve
Ti	Ata, ato, atyre, atyne
Ty, të	Unë
Ai	Ti
Ajo	Ai, ajo
Atij, asaj	Ne
Ne, na	Ju
Neve	Ata, ato

Pronorët:

Im, ime, e mi, e mia, i imi, të mitë, yt, jote, sate, yti, të tutë, i tij, të tij, e saj, të saj, i veti, e vetja, të vetët,

Ynë, jonë; tanë; jona; tanët, tonët
Juaj; tuaj; tuaja; juaji; juaja; tuajt, tuajat
Atyre; i tyre, e tyrja; të tyret

Përemrat dëftorë:

Ky	këtyre
këtij	i, e këtij
kjo, këtë	i, e kësaj
kësaj	i, e këtyre
këta	eshtë
këto	ai, ajo, ata, ato

Përemrat lidhorë:

Që, kush; që, ç'; çfarë; i cili, cili; cila, e cila; cilët; cilat; i të cilit, i së cilës, për të cilin, nga i cili; kushdo, cili do që

Përemrat dhe mbiemrat e papërcaktuar

Asnjë; tjetri; të tjerët; secili; dikush; ndonjë; disa; njëri; njëfarë, disa; shumë; çdo, secili; ndonjë, disi; tjetër; tërë.

Format pyetëse:

Kush	Ku
Çfarë, ç'	Kur
Cili, cila, sa	Si
Cila	Pse, përse
Cili	Sa

Ndajfoljet:

Shumë	kurrë
Tepër, shumë	gjithmonë, ngaherë
Pak	ndoshta
Mjaft	këtu, pranë
Më, ma (gegë)	aty, atje
Më pak	përpara
mirë	prapa
keq, e keqe	afër
ende, përsëri, prapë	larg

Parafjalët:

Në; nga; për; gjer, deri në, gjersa, deri sa; para, para se, më parë; përpara; pas; mbi, në; nën; midis; ndërmjet; me; pa.

Lidhëzat:

Por; ku; dhe, edhe; e; pra, domethënë; ja që, mirëpo, por; as; sepse.

Numrat

1 = një; 2 = dy; 3 = tre; 4 = katër; 5 = pesë; 6 = gjashtë; 7 = shtatë; 8 = tetë; 9 = nëntë; 10 = dhjetë; 11 = njëmbëdhjetë; 12 = dymbëdhjetë; 13 = trembëdhjetë; 14 = katërmbëdhjetë; 15 = pesëmbëdhjetë; 16 = gjashtëmbëdhjetë; 17 = shtatëmbëdhjetë; 18 = tetëmbëdhjetë; 19 = nëntëmbëdhjetë; 20 = njëzetë; 30 = tridhjetë; 40 = dyzetë; 50 = pesëdhjetë; 60 = gjashtëdhjetë; 70 = shtatëdhjetë; 80 = tetëdhjetë; 90 = nëntëdhjetë; 100 = njëqind; 300 = treqind; 500 = pesëqind; 1000 = një mijë; 1 milion = një milion, etj.

Fjalët e përbëra

Falë fjalëve të saj të përbëra, gjuha shqipe ka mundur jo vetëm të ripërtërijë fjalorin e saj por edhe ta përvijojë atë. Duke u nisur nga një apo dy rrënjë apo rrënjësorë të bashkangjitur formohen fjalët e përbëra.

Fat

= fatbardhë
= fatbardhësi
= fatbardhësisht
= fatmirë
= fatkeq
= fatkeqësi
= fatkeqësisht

Kokë

= kokëderr
= kokëtrashë
= kokëfortë
= kokëkrisur
= kokëkungull
= kokëposhtë
= kokëmadh
= kokëvogël

zemërbardhë	kundërpeshë
dorështrenjtë	kundërshtim
dorëmbarë	**fale**minderit
dorëshpuar	falënderim
dorëshkrim	**mirë**besim
kundërhelm	mirëbërës
kundërmasë	mirëdita
kundërkuptim	mirënjohës
	mirësi

Emra të shumtë të përveçëm formohen duke u nisur nga fjalët e përbëra të tilla si qafëziu, gurakuqi, kryeziu. Garibaldi kishte një emër me zanafillë shqiptare, Kalibardhë, Kalibardhi. Emri i Marsejës, Marsilia antike shpjegohet me anë të shqipes: Marrsiellia = marr, sjell (import-eksport). Në të vërtetë përpara mbërritjes së Grekëve, në vitin 600 para Krishtit, qyteti iu përkiste Ligurëve, popull pellazg.

Veçoritë midis dialektit "geg" të veriut dhe atij "tosk" të jugut të Shqipërisë dhe të Epirit (veriu i Greqisë):

Krejt ndryshe nga dialekti geg, i njohur për nasalizimin (hundëzimin) e zanores së theksuar a (shndërrohet në zanoren ë në dialektin tosk) përpara bashkëtingëlloreve, toskërishtja karakterizohet mbi të gjitha nga rotacizmi i saj (përdorimi i **r** shpesh e zëvendësuar nga gërma n). Ja disa shëmbuj të këtyre ndryshimeve: kamë (geg) = këmbë (tosk); zâni (geg) = zëri (tosk); baj, bana (geg) = bëj, bëra (tosk); hana (geg) = hëna (tosk); dimën (geg) = dimër (tosk); Shqipni (geg) = Shqipëri (tosk); ble (geg) = blerë (tosk); lishoj (geg) = lëshoj (tosk); likurë (geg) = lëkurë (tosk); ranë (geg) = rërë (tosk), venë (geg) = verë (tosk)...

Një tjetër karakteristikë e këtyre ndryshimeve dialektore është shndërrimi i disa bashkëtingëlloreve të buta (dialekti geg) në bashkëtingëllore të forta (dialekti tosk):

	Geg	Tosk
f - v	= hof	hov
	= sklaf	sklav
f - h	= raf	rah
	= ngref	ngreh
k/q - g	= lak	lag
	= lank	lëng
	= larq	larg
l/n - r	= Albëni	Arbëri
m - mb	= kamë	këmbë
n - r	= Vlona	Vlora
p - b	= qelp	qelb
s - z	= bres	brez
t - d	= munt	mund
	= vent	vend
th – dh	= garth	gardh
	= lith	lidh

Deri në fund të Luftës II botërore, të dy alfabetet, njeri (malësor) i veriut dhe tjetri (fusharak) i jugut merreshin vesh me njëri-tjetrin vetëm me anë të përkthyesit!

Paskajorja perifrazike, formë shumë e lashtë e ruajtur në dialektin geg, i tillë si "me ba" nuk ekziston në dialektin tosk, i cili duke u nisur nga kjo formë ka përfunduar duke krijuar formën e tij "për të bërë".

Mungesa e paskajores është një karakteristikë e përbashkët e gjuhës shqipe, baske, kaukaziane (dy gjuhë që bëjnë pjesë në tërësinë e stërmadhe pellazge) dhe rumanishtes (e ndikuar nga ajo dako-gete me zanafillë thrako-ilire). Midis këtyre dy gjuhëve të fundit dhe gjuhës shqipe ekzistojnë përafërsi të shumta dhe ngjashmëri gramatikore, përdorimi i shpeshtë i foljes ndihmëse me pas më tepër se ai i foljes me qenë. Përsa i takon gjuhës greke ajo e ka pasur mënyrën paskajore, por

e ka humbur shumë herët gjatë kontaktik të saj me pellazgjishten e lashtë. Ja disa fjalë të zakonshme të fjalorit shqip:

po
vit
jo
muaj
tungjatjeta
javë
mirë u pafshim
ditë
faleminderit
e hënë
mirëdita
e martë
mirëmbrëma
e mërkurë
natën e mirë
e enjte
mëngjes
e premte
mbrëmja
e shtunë
pasdarke
e diel
pasdreke
janar, kallnuar
mesditë, drekë
fruar, shkurt
darkë
mars
natë
prill
diell
maj
hënë, hanë
qershor
qiell
korrik
tokë
gusht
veri
shtator
jug
tetor
lindje
nëntor
perëndim
dhjetor
re
mik
shi
dashuri
borë
paqe
erë
luftë
lumë
jetë
det
vdekje
liqen
takim
ishull
punë
mal
zot
kodër, breg
fe
burim
nanë, nënë
pyll
atë, babë
dru
motër
shkrep, shkëmb
vëlla
ujë
burrë, njeri
bukë
kripë
grua
pi
bir, djalë
ha
bijë, vajzë
qaj
nip
qesh

Kostum i "Malësisë së Madhe"
në veri të Shqipërisë .
Përbëhetkryesisht
nga "xhubleta"
(fund me pala vertikale
dhe një brez) ky fustan
unik në Europë , k
a sfiduar mijë-vjeçarët

Fustan etrusk me pala vertikale
(i skicuar sipas Gerhardt,
IV/CCXIV vini re ngjashmërinë
e jashtëzakonshme
me foton në të majtë.



Mbishkrim ilir
i Skutarit (Shkodra):
"alfabeti" ilir (apo gërma)
çuditërisht
të zhdukura !

Përveç të gjitha veçorive gramatikore, sintaksore dhe fonetike, gjuha shqipe dallohet edhe nga morfologjia e saj nëpërmjet apofonisë dhe metafonisë. Në apofoni, e quajtur gjithashtu alternancë vokale, hasim gjatë një lakimi, një zgjedhimi apo një prejardhjeje, variacione të zanoreve ashtu siç kemi mundur ta vërejmë ndër shembujt e shumtë të përmendur në kapitujt e mëparshëm. Megjithatë shënojmë se mbiemrat pronorë dhe një numër i madh përcaktorësh vendosen gjithmonë pas emrit. Shënojmë edhe këtë veçori tjetër që konsiston në shkëmbimin e zanoreve ose zanereve të dyfishta "a" në "e" ose "a", "e", "ie" në "i", në përgjithësi përpara dy bashkëtingëlloreve të ndjekura nga "i": dal, del, dilni; pres, prit, pritni, etj.

Shënojmë gjithashtu që zanorja ë është një nga karakteristikat më të lashta dhe një nga fonemat më të lashta të pellazgo-shqipes. Dorianët e ngatërronin këtë fonemë me "a", Eolianët dhe Jonianët me gërmën greke ç (ë) dhe latinishtja me "e". Nga ana fonetike gjuha shqipe ka dy lloje zanoresh: zanore të gjata ose hundore (të theksuara fort) dhe zanore të shkurtra. Tjetër karakteristike e gjuhës shqipe: ajo përdor pjesëzën "a" në fillim të një fjalie pyetëse: a e keni ba (ose bërë, në dialektin tosk)?

Të mos harrojmë të shënojmë se gjuha shqipe zotëron një terminologji tepër të pasur në lëmin detar (lundrim, peshkim etj.) gjë që vërteton rolin që kanë luajtur Pellazgët, Ilirët, Filistinët, Popuj të Detit dhe të tjera etni të një trungu, në të gjithë pellgun mesdhetar duke përfshirë Adriatikun dhe Egjeun.

Për të përfunduar këtë kapitull duhet shënuar se lëvizja e fjalëve brenda fjalisë si dhe inversioni janë të larmishme dhe tejet të përdorshme në gjuhën shqipe. Kjo është krejt normale dhe nuk e trazon fare sintaksën e saj, siç ndodh krejt ndryshe në frëngjisht apo në gjuhë të tjera. Ja pra disa inversione.

djali e piu ujin	ujin e piu djali
djali ujin e piu	e piu djali ujin
ujin djali e piu	e piu ujin djali

Pasuria e gjuhës shqipe, lakueshmëria e strukturës së saj dhe epshmëria e saj fonetike i japin mundësinë të ripërtërihet dhe të nxjerrë forcën e saj të ndërtimit sintetik dhe të kapacitetit të saj ripërtëritës në fondin e saj të lashtë gjuhësor: pellazgjishten. Ja përse kjo gjuhë ka ruajtur gjithmonë dinamizmin e saj, vijueshmërinë e saj dhe vazhdon të shquhet midis gjuhëve të tjera europiane pavarësisht të gjitha llojeve të huazimeve pak të rëndësishme dhe futje të ndryshme gjuhësore. Asgjë nuk ka arritur të ndryshojë bazat dhe funksionet parësore të kësaj gjuhe.

Për fat të keq, pas Luftës II Botërore drejtuesit komunistë shqiptarë vendosën zyrtarisht (1972) një gjuhë letrare që në thelb rrjedh nga njëri dialekt: dialekti tosk i Shqipërisë së jugut. Në këtë periudhë këta drejtues pretendonin se bëhej fjalë për një shkrirje të dy dialekteve! Nuk është nevoja të jesh gjuhëtar, leksikolog apo ndonjë dijetar tjetër për të kuptuar të kundërtën. Kjo gjuhë e programuar dhe e futur në shkollat dhe universitetet e Shqipërisë, u përshtat zyrtarisht edhe në Kosovë, popullsia e së cilës krejt ndryshe ka përdorur gjithmonë dialektin geg të Shqipërisë së Veriut. Gegërishtja nuk është nxjerrë kurrë si një dialekt krahinor dhe aq më pak si gjuhë. Ajo është trajtuar si një dukuri e parëndësishme madje si një mbetje folklorike e një epoke tjetër. Përveç kësaj elitat e vendit nuk kanë humbur as edhe një rast për ta ironizuar këtë aksent dhe këtë dialekt kaq të veçantë dhe kaq të ndryshëm nga ai i Jugut. Do të përmend këtu vetëm një shembull domethënës: Gjergj Fishta një nga poetët më të mëdhënj epikë të shekullit XX dhe ndër shkrimtarët e tjerë me zanafillë nga veriu, ka qenë i ndaluar në të gjitha leksionet dhe studimet nëpër të gjitha institucionet shtetërore madje edhe në bibliotekat private. Përveç kësaj, në këtë periudhë pjesa më e madhe e intelektualëve dhe dijetarëve si dhe e elitës së vendit dilnin nga jugu i vendit ose lidhur pas dialektit jugor.

Përse ky diskriminim? Pikësëpari, gjithmonë ka ekzistuar një antagonizëm i përjetshëm dhe qysh në vogëli midis dy komuniteteve

gjuhësore. Pastaj edhe gjindja e veriut ka qenë shumë më e pashtruar se ata të jugut ndaj indoktrinimit komunist. Kësaj i shtojmë faktin se veriu ka qenë një mbështetje më e zjarrtë për Mbretërinë e Shqipërisë të themeluar midis dy luftrave nga mbreti Zog, i dalë edhe ky nga një familje fisnike e veriut (krahina e Matit). Së fundi shënojmë se elita e regjimit komunist në pjesën më të madhe ishte me zanafillë nga jugu i vendit. Gjindja e veriut dhe në veçanti fisnikëria (dikur të quajtur prijës të fiseve) kanë qenë të vëzhguar në mënyrë sistematike, (disa janë hequr nga vendi i tyre, ndarë nga familjet e tyre), janë futur në burg ose nganjëherë janë eliminuar fizikisht. Përveç kësaj veriu nuk ka mundur të përfitojë nga përparësitë e shumta të dhëna gjerësisht jugut. Unë mendoj se ka qenë kjo një hakmarrje pa bazë dhe e kotë nga ana e regjimit despotik dhe vazhdimisht në përgjim kundrejt një popullsie që kërkonte vetëm të jetonte në paqe në diversitet dhe të shprehej lirshëm në dialektin e saj.

Kështu dialekti tosk u zhvillua jo vetëm në Shqipëri por edhe te Shqiptarët e Kosovës qysh nga periudha e Titos (intelektualë marksistë, shkolla, universiteti i Prishtinës...) vëllezër të një gjaku dhe megjithatë shokë komunistë të shqiptarëve të atdheut mëmë.

Tashmë ka ardhur koha për t'i ridhënë dialektit geg vendin që ka patur gjithmonë, qysh nga antikiteti i hershëm (Pellazgët, Ilirët...) jo që ajo të bëhet një gjuhë zyrtare (është shumë vonë për ta bërë këtë), por një dialekt tërësisht më vete dhe një gjuhë të denjë për tu studiuar në mësimdhënien publike dhe mbi të gjitha në institucionet e specializuara, me qëllim që universitarët dhe në veçanti gjuhëtarët dhe studjuesit të mund ta hulumtojnë, ta studiojnë dhe të zgjerojnë hulumtimet e tyre specifike. Në të vërtetë këtë dialekt geg shumë pak gjuhëtarë shqiptarë të pasluftës e kanë mësuar mirë apo e kanë studiuar në mënyrë specifike. Ata e kanë cituar vetëm duke e vendosur kundrejt dialektit tosk apo thjesht për ta folur në referatet e tyre prej specialistësh ose në trajtesat e tyre mbi gjuhën, si një gjuhë folklorike pak e përdorur

apo në zhdukje, sipas shembullit të frëngjishtes së vjetër madje të dialektit provensal në Francë. Për shkak të injorancës së tyre apo të njohjes jo mirë të dialektit geg si dhe të mungesës së kërkimeve në lidhje me të, disa gjuhëtarë shqiptarë nuk kanë mundur të nxjerrin stërhollimet dhe nuancat e këtij dialekti të vjetër, ata kanë arritur që disa fjalë shqip t'i nxjerrin me zanafillë greke ndërkohë që është fjala për shfaqje të huazimeve greke të bëra në pellazgjishten e lashtë. Sigurisht ata nuk e dinë që gjuha shqipe (në veçanti dialekti geg) për arsye të zanafillës së tij pellazge është më e lashtë se gjuha greke. Si ithtarë të gjuhëtarëve të huaj, pjesa më e madhe e tyre kanë ndjekur të njëjtat metoda dhe të njëjtën dogmë indo-europiane. Atëherë në këto kushte të njëjta ku thelbi i çështjes që duhej studiuar ka qenë fshehur, si mundet që një albanolog neofit të punojë seriozisht dhe qartë duke u bazuar në punime të kryera nga gjuhëtarë të huaj dhe mbi të gjitha punime të vërtetuara pa kritikën apo kundërshtimin më të vogël nga ithtarët e tyre apo kolegët shqiptarë? Përveç kësaj për studimet historike dhe mbi të gjitha gjuhësore që kanë të bëjnë me Pellazgët nuk janë përpjekur dijetarët shqiptarë, përveç disave ndër të cilët Adhamidhi (fillimi i shekullit XX), Spiro Konda (mesi i shekullit XX) ose Dhimitër Pilika (bashkëkohor).

Kush do të guxonte të pohonte vërtetësinë historike apo epërsinë e dialektit geg (më i lashtë se greqishtja arkaike dhe megjithatë më i afërt me të se sa është dialekti tosk) pa rënë nën sulmet e një regjimi despotik dhe të toskëzuar në pjesën më të madhe?

Në mënyrë paradoksale ky dialekt, megjithëse nga ana gjeografike shumë më i largët nga Greqia se sa dialekti i jugut, i cili është në kufi me të, përqaset më shumë me greqishten e lashtë dhe mbi të gjitha me ilirishten dhe pellazgjishten e lashtë, nga e cila edhe vetë gjuha greke ka bërë huazime të shumta. Theksi dhe të folurit tosk më të vonshme se sa gegërishtja, siç na e vërtetojnë antroponimet e shumta dhe të ndryshme, toponimet ose oronimet e teksteve antike dhe në veçanti

ato të Iliadës dhe të Odisesë, gjuhë nga ana fonetike më e afërt me gegërishten sesa me pjesën e mbetur joniane.

Pra nuk mund të lihet të rrëgjohet një gjuhë kaq e lashtë, kaq e çmuar dhe që përbën një pasuri të vërtetë gjuhësore të Europës, aq më shumë se vetë këta Pellazgë nëpërmjet Etruskëve ua lanë trashëgim Romakëve një pjesë të madhe të kulturës dhe të gjuhës së tyre.

Sot dialekti tosk është bërë një gjuhë zyrtare, gjuhë e popullit, e dijetarëve, e shkrimtarëve, e cila si të gjitha, nuk është e dënueshme. Por më e rënda është se shumë fjalë të huaja (çuditërisht jo latine, as greke por franceze!) kanë vërshuar në gjuhën shqipe dhe e kanë fryrë leksikografinë e saj. Kjo ndotje gjuhësore mund të shmangej duke nxjerrë nga fondet e vetë gjuhës shqipe shumë herë mijëvjeçare dhe të afta për të ripërtërirë dhe për të krijuar neologjizmat e saj. Shumë lehtë mund të pranohej përshtatja e neologjizmave të pamundura për të realizuar në shqip terma shkencore apo për shkak të të qenit fjalë shumë të reja apo fjalë të teknikës. Megjithatë nëse do tu ishte përmbajtur në mënyrë unike këtyre neologjizmave të veçanta, sigurisht kishte qenë e mundur të kufizoheshin.

Por ky vrull për përdorimin e termave të huaja të papërligjshme është shumë alarmant sepse gjuha shqipe rrezikon së tepërmi të deformohet madje të shkelet apo edhe të zhduket duke u kthyer në një gjuhë të pakuptueshme që nuk do të ketë më të bëjë aspak me pellazgjishten e lashtë. Ky nuk është evolucion. Të gjithë janë të vetëdijshëm për një gjuhë të zhvilluar, por jo për shkatërrimin e bazave thelbësore sepse kjo do të thoshte shndërrim i rëndësishëm dhe dëmtues si dhe shpërfytyrim i gjuhës zanafillore. Kjo është ana e rrezikshme e një evolucioni shumë të shpejtë, të parenditur, të pashoshitur, shkatërrues dhe të pakrahasueshëm me vetë thelbin e një gjuhe zanafillore madje unike. Ja përse gjuha thrako-ilire është ruajtur nga këto lloje të papriturash, gjë që ka bërë të mundur të ruajë pothuajse të paprekur fondin e saj të pellazgjishtes së lashtë dhe ta përvijojë në shqipen e sotme.

Përse atëherë regjimi komunist rrezikoi në lidhje me këtë? Ky është një debat i gjatë që meriton një vepër të tërë. Gjuha franceze ka qenë në modë në periudhën gjatë dy luftrave dhe në veçanti në jug (liceu francez i Korçës ishte një fidanishte intelektualësh dhe personalitetesh). Gjithashtu ka ekzistuar një lloj njohjeje e gabuar e vërtetësisë historike së gjuhës shqipe apo thjesht një pavetëdije apo një mungesë respekti e maskuar ndaj një gjuhe pak të njohur, dytësore apo folklorike në krahasim me frëngjishten, "gjuhë e respektuar dhe e njohur anë e mbanë botës". A ishte kjo nga një lloj kompleksiteti pedant apo nga një snobizëm kulturor? A ishte për lehtësi (sepse nuk gjendet në çast fjala e përshtatshme) apo nga një luhatje (sepse nuk duan të hulumtohet) që kërkojnë ndihmën e një gjuhe tjetër? A mos nuk zotërohet mirë gjuha mëmë? Kjo është një temë e gjerë që nuk hyn në kuadrin e studimit të tanishëm.

Ja disa shembuj kuptimplotë (listë jo e plotë) e këtyre futjeve të panevojshme dhe jo të përshtatshme në fjalorin shqip.

*** arrestoj; arrestim**

Ndërkohë që në gjuhën shqipe ekziston fjala shqip "kap" që duket se është endur nëpër Europë sepse ne e gjejmë në latinisht (capere), në anglisht (keep, kept) ose në frëngjisht (capturer)...

*** marshim, marshoj, marshon**

Nuk e kuptoj përse është krijuar ky neologjizëm ndërkohë që gjuha shqipe ka fjalët e saj "ecje, eci, ecim, ecën". Mund të përdorej, në fund të fundit, kjo fjalë për të emërtuar në lëmin muzikor, një marsh ushtarak ("marshim ushtarak") shprehje e shpikur nga të huajt.

*** sukses**

Gjithashtu shqipja zotëron shumë fjalë ndër të cilat "mbarëvajtje, mbarësi, mbrodhësi, ose arritje".

*** audiencë**

Shqipja ka gjithashtu fjalët: vëmendje, pritje, mbledhje...

*** aplikim, aplikacion**

Fjalë të shumta në shqip: vendosje, vënie, zbatim, përdorim.

*** tendencë**

Shqipja ka fjalën e saj: prirje.

*** procedim**

Edhe për këtë shqipja është e pasur: mënyrë veprimi, sjelljeje, mënyrë e sjelljes ...

*** protestoj**

Në shqip ekziston një fjalë në përdorim të përditshëm: kundërshtoj.

*** abuzim**

Gjithashtu shqipes nuk i mungojnë fjalët: shpërdorim, teprim, tepri.

*** ekzistoj**

Edhe për këtë, për një fjalë parësore dhe kaq të rëndësishme shkohet dhe kërkohet në një gjuhë romane relativisht të vonë "frëngjisht"! Ndërkohë që gjuha shqipe zotëron një nga fjalët më zanafillore dhe më të lashtat: jetoj në kuptimin që egzistoj dhe në rastet pavetore ka sëbashku me kuptimin "vazhdon, vazhdon ende" (ose hala) ose edhe "jam gjallë".

*** injorant**

Shqipja zotëron "i paditur, i paditun, nuk di gjë, ose nuk di gja".

*** indipendencë**

Ekziston një fjalë shqipe e shkëlqyer: pavarësi, mëvetësi.

*** inteligjent**

Edhe për këtë fjalë kaq të rëndësishme gjendet mënyra për të përdorur një fjalë të huaj ndërkohë që gjuha shipe ka shumë sinonime: i zgjuar, i mençëm, i ditur...

*** civilizua, civilizuar**

Në shqip ekziston një fjalë e lashtë "qytetërua, qytetëruar" (që rrjedh nga qytet), fjalë e trashëguar nga latinët (nëpërmjet Etruskëve) nën formën civitas (qytet), e cila ka krijuar fjalën italisht citta (qytet) dhe atë franceze cité (qytet). Është kulmi që shqiptarët përdorin një fjalë të

të parëve të tyre të shtrembëruar nga latinishtja dhe të riformuar nga frëngjishtja.

*** plazh**

Edhe për këtë, për tu bërë modernë apo për të folur si njerëz të qytetëruar, në këtë rast si francezë, është përdorur fjala plazh ndërkohë që ekzistojnë fjalë tepër të vjetra: "ranishtë", e cila rrjedh nga fjala "ranë" (dialekti geg) dhe "rërë" (dialekti tosk) si dhe "buzë deti"; por edhe me të vjetrat që kanë kuptimin e njëjtë si "ranë" dhe "kum", e cila është zanafilla e emrave "cumes, cumae", qytet bregdetar i Italisë jugore (Kampania, provincë etruske në këtë periudhë) dhe që ishte qyteti i parë i marrë Etruskëve dhe i pushtuar nga Helenët e parë që mbërritën në Itali!

Po e ndal këtë mori shembujsh sepse lista do të ishte shumë e gjatë për ta numëruar dhe do të zinte një pjesë të madhe të veprës që keni në dorë.

Pra kemi vërejtur zanafillën franceze të disa neologjizmave të papërligjura. Nëse drejtuesit komunistë shqiptarë të pasluftës do të kishin qenë anglofonë a do të kishin të drejtë për neologjizmat me zanafillë angleze? A s'është e trishtë dhe për të ardhur keq, madje mizore të shohësh t'i imponohet të gjithë popullit kjo lloj futje në udhë të gabuar dhe mbi të gjitha shpërfytyrimi i gjuhës së tij, një nga gjuhët më zanafillore dhe më të lashta të Europës dhe kjo si rrjedhojë e vullnetit, pushtetit dhe arbitraritetit të disa drejtuesve doktrinues?

Nuk mund ta mbyll kapitullin pa u ngritur kundër këtij lloj vërshimi të përgjithshëm kundrejt asaj që do ta quaja nga ana gjuhësore e saktë që ka konsistuar dhe konsiston gjithmonë në rimarrjen e disa pohime të gabuara apo pista të gabuara të përpunuara nga pjesa më e madhe pararendësve të gjuhësisë moderne të fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, të përsëritura nga ithtarët e tyre që i kanë trajtuar si fjalë Ungjilli, pa asnjë lloj reflektimi paraprak, pa as edhe kritikën më të vogël dhe akoma më pak "pa ngritur ndonjë dyshim". Midis këtyre

devijimeve gjejmë faktin se kanë vendosur unanimisht ekzistencën e një prirjeje gjuhësore ballkanike, ku shqipja është jo vetëm e nënvlerësuar, por e zhytur në këtë masë gjuhësh heterogjene (greqisht, sllavisht, bullgarisht apo turqisht), ku përbën veçse një idiomë që ka ndjerë ndikime të ndryshme ndër të cilat greqishtja, latinishtja, sllavishtja ose turqishtja përfaqësojnë thelbin e huazimeve gjuhësore, sikur të ishte fjala për një gjuhë hibride! Ky është kulmi, pasi gjuhëtarët të mbyllur hermetikisht në disiplinat e tyre, të verbuar nga bindjet e tyre të pandryshueshme, siguritë e tyre apo hipotezat e tyre të paqëndrueshme, jo vetëm që nuk kanë mbajtur parasysh mendime të kundërta me ideologjinë e tyre (janë të shumtë ata që që kanë thënë me zë të lartë të vërteta të hedhura poshtë njëherësh apo të mbetura në sirtar, etj.) por as nuk kanë zgjeruar fushën e tyre të hulumtimeve falë njohurive të dala nga disiplinat e tjera, as nuk kanë shfrytëzuar zbulimet apo rezultatet që deshifrojnë studimet e shumta dhe hulumtimet, të cilat hedhin dritë mbi zanafillën etno-gjuhësore të popujve parahelenë.

Në të vërtetë ata nuk kanë vendosur asnjë lidhje, nga njëra anë midis Pellazgëve, Thrakëve, Frigjianëve, Etruskëve dhe Ilirëve dhe nga ana tjetër Shqiptarëve të sotëm dhe mbi të gjitha gjuhëve të tyre respektive.

Ja përse gjuhësia moderne, e ngërthyer në kullën e saj të fildishtë ka mbetur në qorrsokak dhe e mbyllur në bindjet e saj pafundësisht të vjetra dhe brenda pistash të gabuara, të huazuara qysh prej më shumë se një shekulli nga autorë të shumtë.

Unë nuk do të shpalos këtu mendimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me problemet lidhur me Gjuhësinë (cf kapitulli në lidhje me këtë). Thjesht do të vëreja se përveç kësaj ngatërrese të koklavitur mund vetëm të jepen disa të pavërteta të nxjerra kundër gjuhës shqipe.

Kjo ka qenë shumë pak e studiuar si gjuhë dhe mbi të gjitha nuk ka qenë vendosur konteksti i saj i vërtetë etno – gjuhësor për arsye të të gjitha llojeve të mangësive, gabimeve historike dhe kronologjike, polemikash të vazhdueshme dhe të një neglizhence ose të një ngurrimi

të dukshëm (nga ana e gjuhëtarëve) për të ndihmuar studime të ndryshme dhe hulumtime ekstra-gjuhësore.

Prova për këtë është se disa gjuhëtarë shqiptarë kanë përshtatur përfundimet e mjeshtërve të tyre gjuhësorë të Perëndimit ose të ish Europës Lindore. Në të vërtetë po marr si shembull mendimin e tre gjuhëtarëve dhe filologëve shqiptarë që i kanë orientuar studimet e tyre në mënyrë të veçantë në gjuhën shqipe dhe ndërfutjet e saj në kontekstin gjuhësor ballkanik. Filologu dhe gjuhëtari shqiptar Eqrem Çabej nuk ka vendosur lidhje të ngushta midis Pellazgëve, Trakëve, Frigjianëve nga njëra anë dhe Ilirëve nga ana tjetër. Ai, ashtu si gjuhëtarë të tjerë shqiptarë dhe për arsye më të fortë ata të huaj, janë kufizuar në studimin strikt të shqipes aq sa si gjuhë e gjallë aq edhe si strukturë gjuhësore, aq edhe si element gjuhësor që bën pjesë në një kompleks rajonal, të cilin ata e quajnë ballkanik. Gjuha shqipe është paraqitur, së dyti, si një gjuhë që bën pjesë në një kompleks rajonal me përafërsi të shumëfishta dhe interferenca gjuhësore që përfshijnë gjuhën greke, serbe, bullgare, shqipe, turke, rumune. Në asnjë pjesë të studimeve të tyre nuk figuron gjuha ilire (dhe si rrjedhojë gjuha shqipe) si një nënshtresë thelbësore në këtë kontekst ballkanik. Përkundrazi në këtë plan këta gjuhëtare kanë rihapur të njëjtat teza të kapura nga një pjesë e madhe e mjeshtërve të tyre të huaj: ata nuk kanë kryer asnjë përqasje dhe as nuk kanë zbuluar asnjë përafërsi midis pellazgjishtes, frigjianes, trakishtes, dako-getes dhe ilirishtes!

Ja disa pjesë të nxjerra nga / gjuhëtari shqiptar Shaban Demiraj (Shqipja – Gjuhët Indo-Europiane, Editions CNRS 1997): "Në gjuhën shqipe ka huazime nga greqishtja e vjetër (dialekti dorian) dhe latinishtja, të cilat datojnë qysh para erës sonë, kështu mokënë/mokërë nga greqishtja e lashtë (doriane) ...[po shënoj kalimthi se "greqishtja e lashtë" është shumë më e vonshme se ilirishtja, gjuhë pellazge dhe parahelene e mirëfilltë]. Megjithatë ai shton: "Historia nuk ka regjistruar asnjë

emigracion masiv, nga lindja në perëndim të Ballkanit, që do të mund të dëshmonte për një migracion relativisht të lashtë të Shqiptarëve të lindjes drejt vendit të sotëm të tyre"... [Nëse ka pasur ose jo "migracion të Lindjes drejt Perëndimit" kjo nuk i ndryshon asgjë zanafillës së Shqiptarëve, sepse stërgjyshërit e tyre popullonin po aq edhe Traken në Lindje sa edhe Ilirinë në Perëndim! Përveç të tjerave, populli dorian ishte i trungut ilir - Periekë dhe Hilotë – krejt ndryshe me prijësit me zanafillë semito-egjiptiane- n.d.l.r. -].... "Shqipja ka ndjekur një evolucion pjesërisht të ngjashëm me atë të gjuhëve të tjera indo-europiane, në veçanti gjuhët ballkanike, por në disa pika nuk ka paralelizma... Kështu shqipja është shndërruar në një gjuhë sintetiko-analitike të tipit ballkanik". Së fundi, ja një tjetër shembull që zbuloj te Remzi Përnaska, bashkautori i librit "Flasim Shqip"(L`Harmattan, 1999) i cili nga ana e tij pohon: "Në fushën e sintaksës, gjuhët ballkanike kanë shumë pika të përbashkëta".

Atëherë po rikthehem në këtë emërtim të famshëm "tip apo gjuhë ballkanike". Përse nuk thuhet tipi "thrako–ilir"? Që ky "tip" ekziston, tashmë është e pamohueshme, por gjithsesi nuk fshihet roli i luajtur nga ilirishtja, element zanafillor dhe thelbësor i këtij "tipi ballkanik", meqenëse elementi sllav është shumë i vonshëm aty dhe daton vetëm nga shekulli VII pas Krishtit dhe jo më parë. Ndërkohë që etnia pellazgo-thrako-ilire ekzistonte të paktën qysh në periudhën neolitike (fakt i dëshmuar nga paleontologjia, arkeologjia dhe antropologjia). Ballkani përpara shfaqjes së Grekëve (VIII para Krishtit), Sllavëve (shekulli VII pas Krishtit - serbo-kroatëve, bullgarëve) dhe Turqve (XIII - XIV pas Krishtit) ishte i populluar nga popullsi pellazge (Trakët ne Lindje, Ilirët në Perëndim dhe Tesprotët, Thesalianët, Arkadianët ... në Jug)! Pa përjashtuar huazimet e pashmangshme reciproke, cila gjuhë do të ketë ndikuar te tjetra? Nuk ka nevojë për koment.

Çuditërisht Shqiptarët njohin vetëm Ilirët si stërgjyshërit e vetëm të tyre. Kështu ilirishtja është shkëputur jo kur duhej nga rrënjët e saj

pellazge, thrako-frigjiane, madje danubiane (tezë e hedhur poshtë prerë!). Pra, në Shqipëri nuk ka patur studime të thella gjuhësore (dialekti "geg" tërësisht i përjashtuar) që të vendosin një lidhje vendimtare midis të gjitha popullsive parahelene të Ballkanit, në thelb e trungut pellazg (Pellazgët, Trakët, Frigjianët, Tirrenë, Ilirë, Epirotë etj.). Studime të sigurta të realizuara në këtë fushë kanë qenë kryer nga dijetarë të huaj, ndër të cilët Von Hahn, Norbert Jokl, Kreçmer, Krahe, G. Mejer, Benloev.

Nëse marrim atë çfarë gjuhëtarët shqiptarë të periudhës se pushtetit komunist, madje dhe ata të ditëve tona, kanë formuluar në lidhje me zanafillën e Shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre, në thelb arrijmë këto:

■ Ilirët janë të vetmit stërgjyshër autoktonë të Shqiptarëve.

■ gjuha shqipe bën pjesë në një tërësi të madhe indo-europiane dhe ballkano-gjuhësore, ku greqishtja dhe latinishtja janë trajtuar si "gjuhë-mëmë"

■ nëse përllogaritet numri i fjalëve shqipe të huazuara sipas gjuhëtarëve te Grekët, Romakët, Serbët dhe Turqit, gjuha shqipe do të reduktohej pothuajse në një hiç, duke përfshirë vetëm një pjesë të parëndësishme të një fondi gjuhësor të lashtë, të cilave nuk u shpjegohet saktësisht zanafilla!

Ndër provat e tjera plotësuese që vërtetojnë pistat e gabuara të huazuara nga gjuhëtarët e huaj në përgjithësi dhe shqiptarë në veçanti, ja edhe pohimet e mëposhtme të nxjerra nga libri "Flasim shqip" (Gut/Përnaska, L`Harmattan, Paris 1999). Në momentin e fundit më është dashur t`i fus në faqet e fundit të kapitullit të tanishëm - në momentin kur po përfundoja veprën time -. Po jap këtu tekstet më domethënës (faqet 75- 82):

"....Teoria e zanafillës pellazge të shqiptarëve, mjaft e dashur për autorët e Rilindjes Shqiptare, u braktis krejt si teoritë fantazuese që e vendosin në Skoci apo në Kaukaz... Në planin gjuhësor disa huazime

shqiptare nga greqishtja shumë e lashtë (mbi të gjitha doriane) dhe te latinishtja shumë e lashtë [shënoj se 'latinishtja e shkruar' daton vetëm prej shekullit III para Krishtit] provojnë lashtësinë e vendosjes së Shqiptarëve në rajonet e njohura që kanë qenë të banuara nga Ilirët ... Dhe në këtë kuadër [formimi i shqipes në tokat e sotme shqiptare] arrihet të flitet për karakterin 'autokton' të Shqiptarëve dhe për gjuhën e tyre, e cila, kuptohet, i është drejtuar huazimeve të shumta leksikore, nuk dihet nëse për arsye të të papriturave të historisë: pra i është drejtuar gjuhës greko-latine, romake, sllave dhe sigurisht, turke"....



Vazo dyshe prej balte të pjekur (nekropol tumulor i Barçit) Epoka I e Hekurit.
Muzeu arkeologjik dhe etnografik - Tiranë.

..."Midis këtyre, elementet latine dhe romane, shpesh të vështira për tu dalluar, zënë vendin e parë... Nëse njeh greqishten, kjo nuk të bën të mundur të kuptosh shqipen dhe të kuptosh latinishten, akoma edhe më shumë. Kjo nuk të pengon të kuptosh që një numër rrënjësh latine në gjuhën shqipe është mjaft i rëndësishëm për të dhënë një

përshtypje të saj tashmë të dëgjuar dhe të njohur... Gjuhëtarë të shumtë të shekullit XIX e trajtojnë [gjuhën shqipe] si një gjuhë gjysmë romane... Italishtja ka lënë gjurmë shumë të rëndësishme në gjuhën shqipe. Pastaj vjen frëngjishtja... Ndikimet sllave ndaj gjuhës shqipe janë të dukshme në fjalorin dhe kulturën materiale dhe ekonomike shtëpiake, mbi të gjitha në rajonet periferike të Shqipërisë, aty ku lidhjet me Sllavët janë apo kanë qenë më të gjata dhe më të shpeshta... Shqipja, ashtu si rumanishtja, është gjuhë indo-europiane ... dhe ballkanike...". Shënoj se sipas këtyre disa paragrafëve të nxjerrë, autorët e librit të lartpërmendur e pranojnë katërçipërisht se greqishtja dhe latinishtja nuk ngjajnë me gjuhën shqipe, por habiten për praninë e rrënjëve të shumta të përbashkëta të këtyre tri gjuhëve. Pa dyshim kjo ndodh sepse ata nuk e njohin barasvlerën nga njëra anë midis Pellazgëve, Etruskëve, Thrako-Ilirëve dhe nga ana tjetër të Shqiptarëve, si në planin historik, arkeologjik dhe antropologjik aq edhe në planin etno-gjuhësor.

Kam përmendur këto paragrafë sepse ato janë krejtësisht të vetëkuptueshme dhe i shprehin mjaft mirë pikëpamjet e gabuara të përshtatura nga pjesa më e madhe e gjuhëtarëve, qofshin shqiptarë apo jo.

Kështu, duke u mbështetur në studimet gjuhësore të dyshimta ose jo shumë bindëse, gjuha shqipe iu duket atyre se është një gjuhë hibride, që zotëron një mbetje gjuhësore që rrjedh nga nënshtresa greke dhe latine me prurjet sllave dhe turke. Për këta, populli ilir ka evoluar duke qenë i izoluar dhe do të ketë krijuar gjuhën e tij duke u nisur nga këto nënshtresa të lashta greko-latine, të përsosur më vonë nga prurjet e reja sllavo-turke, prej nga ka dalë edhe shqipja e ditëve të sotme!

Ndërkohë që është fjala për të kundërtën, për provën e ekzistencës së vetë gjuhës shqipe, fosile e gjallë, e vetmja gjuhë europiane e cila ka ruajtur fondet më të rëndësishme gjuhësore të "pellazgjishtes së lashtë". Kjo është një gjuhë parahelene e mirëfilltë (ashtu si e provojnë autorët grekë të fundit të epokës arkaike dhe ata të fillimit të periudhës klasike) nga e cila gjuha greke ka bërë huazime të mëdha. Kjo pellazgjishte ka krijuar nga njëra anë gjuhën tharke, frigjiane dhe ilire që janë tri dialektet kryesore në Ballkan,

Egje dhe Azinë e Vogël perëndimore dhe nga ana tjetër atë etruske, venete dhe mesape, të cilat janë dialektet e saja kryesore në Itali. Studime të shumta dhe të ndryshme historike, arkeologjike, antropologjike ose etno-gjuhësore provojnë përkatësinë e Thrako-Ilirëve ndër popujt e Pellazgëve antikë, gjuha e të cilëve përvijon përgjithmonë në gjuhën e sotme shqipe. A nuk është gjuha shqipe që dekripton etnonimet e shumta, antroponimet, teonimet, toponimet ose oronimet që disa kanë pohuar se bëhet fjalë për terma të dala nga një gjuhë parahelene e zhdukur dhe që nuk shpjegohen aspak nga greqishtja?

Atëherë, si është e mundur që gjuha thrako-ilire të rrjedhë nga gjuhë më të vonshme, të tilla si greqishtja (e shkruar nga fundi i shekullit VII para Krishtit), latinishtja (shkrimet e para të së cilës janë shfaqur vetëm nga shekulli III para Krishtit dhe që përbën një përzierje të gjuhës greko-etruske, pra pjesërisht pellazge) apo nga sllavishtja – gjuhë që është shfaqur në Ballkan vetëm nga shekulli VII pas Krishtit dhe shkrimi cirilik i së cilës daton vetëm nga shekulli IX-X pas Krishtit?

Përsa i takon pohimit se gjuha shqipe është një gjuhë dytësore që rrjedh nga dy nënshtresa të lashta që rrjedhin nga greqishtja dhe latinishtja, kjo zbulon qoftë pavetëdijen qoftë paaftësinë qoftë manipulimin, qoftë njohjen jo të mirë të studimeve jashtë fushës së gjuhësisë apo mosnjohjen e zbulimeve të realizuara në fushat e tjerat (parahistori, histori parahelene, paleontologji, arkeologji, antropologji, etj.). Në të vërtetë shumë gjuhëtarë janë mbyllur në fushat e tyre specifike dhe të vogla pa kërkuar të dinë apo të kuptojnë atë çfarë ndodh gjetiu dhe në veçanti në fushën e kërkimit që lidhet me popujt parahelenë.

Nga ana tjetër janë të shumtë ata që kanë vendosur lidhje gjuhësore ose ngjashmëri midis gjuhës së sotme shqipe dhe gjuhëve të lashta të njohura, të tilla si greqishtja dhe latinishtja. Gjithsesi ata kanë bërë përqasje të shumta me sllavishten dhe gjuhën turke, gjuhë mjaft të vonshme. Megjithatë në planin etno-gjuhësor ata nuk kanë mbajtur parasysh, kronologjitë në vijimësi për sa i takon lindjes së cilës prej këtyre gjuhëve në kontekstin etrusko-italik për gjuhën latine dhe

ballkano-egjeo-danubian për të tjerat. Vetëkuptohet se, nëse sot, në momentin që flasim, hapet një fjalor i gjuhës shqipe (i redaktuar sipas dialektit toskë) dhe zbulohen të gjitha llojet e neologjizmave dhe fjalët e ndryshme me zanafillë latine, greke, sllave, turke, italiane, apo franceze (këto dy të fundit pothuajse ekspozohen me krenari nga disa shqiptarë!) vetëkuptohet që nuk mund të çuditesh për numrin e madh të huazimeve që gjuha shqipe ka bërë nga këto gjuhë. Aty pikërisht është pika e dobët, pasi kjo nuk do të thotë aspak që gjuha shqipe është në rang të dytë ose e një zanafille më të vonshme se gjuhët të mbiquajtura të lashta, të tilla si greqishtja dhe latinishtja. Në të vërtetë, greqishtja gjatë periudhës së mbrujtjes të saj dhe përpara se të bëhej gjuha që njihet, ka qenë në kontakt me gjuhën pellazge përgjatë qindra vitesh, nga e cila ka huazuar fjalë të shumta dhe një pjesë të strukturës së saj gjuhësore dhe të fonetikës. E njëjta gjë ndodh me latinishten, e cila për më tepër ka qenë në kontakt me dy gjuhë të ndryshme, greqishten dhe etruskishten, nga të cilat ka bërë huazime të shumta.

Rasti i Sllavëve është historikisht dhe kronologjikisht i ndryshëm, meqenëse është shumë më i vonshëm. Por i njëjti fenomen është krijuar me Sllavët, të cilët me mbërritjen e tyre në Ballkan në shekullin VII të erës sonë, kanë zënë një vend krejtësisht të banuar nga popullsi të trungut pellazg (Ilirë, Panonianë, Dalmatë, Dardanë, Dako-Getë, Pelagonë, Thrakë etj.): ata këtu kanë qenë në kontakt me këta popuj, nga të cilët asimiluan një pjesë të kulturës së tyre (rite e zakone, kostume, këngë epike, etj.) dhe gjuhën e tyre. Në këtë pikën e fundit duhen shënuar huazime të shumta gjuhësore të kryera nga Sllavët ndaj popullsive të lashta thrako-ilire dhe për të cilat nuk është dashur aspak të njihet zanafilla pellazgo-thrako-ilire, për arsye të shovinizmit të tepruar, të krenarisë kombëtare apo thjesht nga mosnjohja apo njohja jo e mirë e historisë etno-gjuhësore të Ballkanit.

Gjithsesi duhet shënuar një fakt vendimtar: gjuha e sotme shqipe është cunguar në një element në zanafillë thelbësor: dialekti geg i Shqipërisë së veriut, duke përfshirë rajonet kufitare të saj (Kosova,

jugu i Malit të Zi dhe perëndimi i Maqedonisë). Në të vërtetë, ky dialekt është shumë më i afërt me greqishten e lashtë se sa me dialektin toskë të jugut, megjithëse ky i fundit gjeografikisht është më pranë Greqisë! Dialekti toskë shumë më vonë ka bërë huazime të shumta nga gjuha greke. Gjithsesi, falë malësive të tyre të pamposhtshme që u kanë shërbyer si mure mbrojtës ndaj mësymjeve të ndryshme, Shqiptarët e veriut kanë mundur ta ruajnë pothuajse të paprekur dialektin e tyre, duke ruajtur kështu një pjesë të madhe të pellazgjishtes së lashtë dhe si rrjedhojë të ilirishtes. Ja përse gjuha shqipe arrin të dekriptojë (çuditërisht me pothuajse të njëjtin fonetikë dhe të njëjtat fjalë) të gjitha termat pellazge të ruajtura në gjuhën greke si dhe emrat e shumtë të përveçëm, emra hyjnish ose vendesh të mitologjisë të mbiquajtur greke.

Përjashtimi dhe si rrjedhojë braktisja e dialektit geg janë dukshëm pasojë e ardhjes në fuqi të një kaste drejtuesish komunistë me zanafillë nga jugu i Shqipërisë me në krye Enver Hoxhën, njeri thellësisht anti-verior. Ky qëndrim dashakeqës i pushtetit komunist të kohës ndaj popullsisë veriore të vendit mund të ketë bazën edhe nga fakti se gegët (ruajalistë, anti-doktrinistë, nacionalistë apo të prirë nga bindje të ndryshme politike pro-perëndimore) kanë qenë më këmbëngulësit, ndër popullsinë shqiptare, kundër komunizmit. Gjithsesi edhe një antagonizëm në fushë të gjuhës, ka ekzistuar pothuajse gjithmonë, edhe pse mjaft i fshehur, midis këtyre dy bashkësive dialektore gjuhësore. Hoxha dhe rrethi i tij shkuan deri aty me logjikën e tyre diktuese, sa në vitin 1972 dekretuan dialektin toskë si gjuhë të shkruar dhe zyrtare të Shqipërisë. Këtë "gjuhë letrare", edhe kosovarët (gjithashtu nën pushtetin komunist në atë kohë) e përshtatën pa u merakosur fare. Qysh nga kjo periudhë nuk ka pothuajse asnjë shkrim në dialektin gegë: gjuha shqipe është toskëzuar plotësisht.

Atëherë si munden gjuhëtarët shqiptarë, dhe aq më tepër dijetarët e huaj, në këto kushte, pothuajse duke mos e njohur fare gjithë këtë dialekt, ta hulumtojnë seriozisht gjuhën shqipe, të cilën e njohin vetëm pjesërisht, meqenëse i shkëputur dialekti i saj më i rëndësishëm dhe

më i vjetër? Përveç kësaj, në këtë gjuhë të toskëzuar janë paraqitur neologjizma të panumërta (italishte e paraluftës dhe frëngjishtja e pasluftës) duke e përgjithësuar përdorimin e tyre dhe duke e ngarkuar edhe më shumë këtë gjuhë zyrtare tashmë të përzier me të gjitha llojet e termave të huaja. Autorë të shumtë, duke bërë një përllogaritje aritmetike dhe duke regjistruar të gjitha huazimet kanë shpallur se këto ishin më të shumta në numër, pa arritur të dallojnë rëndësinë e një nënshtrese pellazgo-thrako-ilire në gjuhën shqipe, e cila iu është dukur se zotëron veçse një pjesë të parëndësishme të kësaj nënshtrese arkaike, së cilës ata gjithmonë nuk arrijnë t'ia zbulojnë zanafillën. Ndërkohë që kjo nënshtresë, përkundrazi, është e ngulur thellë: gjuha shqipe e zhveshur nga neologjizmat që e kanë mbingarkuar si dhe huazimet e huaja do t'ia dilte mbanë vetë. Të gjitha këto neologjizma të huaja shpesh janë shartuar (përdorim i dyfishtë) me terma të vjetra pellazgo-iliro-shqiptare, të cilat ekzistojnë, por që nuk i përdorin për tu bërë "modernë apo perëndimorë" dhe për të qenë të kohës!

Gjuha shqipe, e thënë shkoqur, (e çliruar nga të gjitha këto futje gjuhësore) është kaq e pasur sa është e aftë të ripërtërihet dhe të krijojë të gjithë llojet e neologjizmave që i duhen, dhe për këtë nuk ka nevojë t'i kërkojë ndihmë ndonjë gjuhe tjetër të huaj, përveç rasteve kur bëhet fjalë për terma teknike, shkencore apo në lidhje me zhvillimin ekonomiko-shoqëror modern. Argumentet dhe provat e shumta që përmban vepra që keni në dorë i përgjigjen të gjitha këtyre argumenteve.

Për të studiuar moshën e hershme të një gjuhe në raport me një gjuhë tjetër, është e rastësishme madje e rrezikshme të bazohesh në "numrat" apo në të gjitha termat e tjera të krijuara nga kontakte të ndryshme kulturore ose lidhje tregtare. Në të vërtetë disa etnive shumë të vjetra, që kanë hyrë në kontakt me popullsi të tjera që flasin gjuhë të ndryshme, u është dashur të huazojnë (për të thjeshtëzuar kontaktet e tyre sporadike apo të përhershme) numrat, disa terma të zakonshme teknike apo tregtare në përdorim, ndër ata që zotëronin një farë dije apo ndonjë lloj monopoli tregtar (qytetërime që kanë patur një farë

hegjemonie, tregtarë të pasur etj.) Përveç kësaj, te këta popuj të lashtë fjalët që nuk kanë ndryshuar shumë janë toponimet, oronimet, antroponimet, teonimet si dhe fjalët thelbësore ose ato që shprehin nevojat parësore dhe që lidhen me jetën e përditshme të tilla si ujë, bukë, me pi, me ngrënë, me fjet, me shku, me ardh, me dasht etj...

Një tjetër problem që lidhet me këto gjuhë të vjetra zanafillore: kjo shumë shpesh ngatërrohet, dhe kjo vërehet te disa gjuhëtarë, kronologë të epokave të ndryshme në përdorimin e kësaj apo asaj fjale. Kjo është si të evokohej ekzistenca e objekteve të prodhuara në bronz në periudhën e Epokës së Bronzit dhe të ndërfutej përdorimi i "plastikës". Në të vërtetë në mënyrë anakronike krahasohen gjuhët e lashta me ato më të vonshme (p.sh. gjuha sllave dhe balto-sllave - gjuhë që nuk janë aspak më të hershme se periudha e krishterë – me gjuhën greke, latine ose sanskritishten). Gjithsesi iu vishet agresorëve apo pushtuesve të rinj, një fjalë e huazuar te popullsitë autoktone. Marr si shembull fjalën "jug" që në ilirishte dhe në shqip do të thotë "jug" dhe që kishte kaluar te sllavët (midis shumë fjalëve të tjera të lashta) me të njëjtin kuptim: disa gjuhëtarë duke u nxituar kanë arritur në përfundimin se këtu flitej për një fjalë me zanafillë sllave, ndërkohë që Sllavët rreth shekullit VI dhe VII pas Krishtit kishin pushtuar territoret e mëdha që i përkisnin popullsive autoktone thrako-ilire dhe që kishin jetuar aty qysh nga mugëtira e kohërave (territori zanafillor që shkonte nga Danubi deri në Epir dhe nga Deti i Zi deri në Adriatik).

I njëjti fenomen u krijua sipas traditës epike të "rapsodëve" modernë, e cila i vishet gjithashtu Sllavëve, ndërkohë që kjo traditë epike ka përvijuar në Ballkan dhe në veçanti në Iliri, në Trakë dhe në Shqipërinë e sotme (dhe rajonet shqipfolëse në kufi): traditë e trashëguar nga Pellazgët e lashtë, Thrakët, Frigjianët dhe Trojanët (të gjithë popuj të dalë nga e njëjta etni) qysh prej një epoke shumë të hershme kur Sllavët ende nuk ishin prezent në rajon! Është i njëjti fenomen që ka ndodhur me disa zakone dhe mbi të gjitha me disa kostume, që gabimisht iu vishen sllavëve të ardhur më vonë.

Gjithashtu mund të bëjmë një paralelizëm me sanskritishten, avestiken (gjuhë bashkëkohore me gjuhën greke) dhe shumë më e vonë gjuha tokariane: këto gjuhë janë më të vonshme se pellazgjishtja e lashtë nga e cila kanë dalë gjuha frigjiane, thrako-ilire si dhe shqipja e sotme. Kështu shqipja (për mangësi të studimit me themel dhe pa bërë as më të voglën përqasje me pellazgjishten e lashtë) është çuar në skutat e historisë, duke e trajtuar si një gjuhë pak a shumë hibride apo të rangut të dytë (megjithatë e trajtuar si një gjuhë unike dhe e një dege të veçantë në morinë e gjuhëve të mbiquajtura indo-europiane) ndërkohë që është fjala për idiomën më të lashtë europiane, trashëgimtare e drejtpërdrejtë e Pellazgëve parahelenë, nga e cila kanë dalë greqishtja dhe latinishtja.

Disa autorë të dalë nga shtigje të rrahura "nga ana gjuhësore apo historike të sakta" kanë nxjerrë të vërteta të qarta, edhe pse analizat e tyre kanë mbetur nganjëherë të papërfunduara dhe shpesh kanë ecur në një rrugë pa krye.

Xheims Parsons në vitin 1767 (pa dyshim i frymëzuar nga leximi i Biblës, gjë që nuk e ndryshon aspak drejtësinë e mendimeve të tij) pohon se idiomat e Europës, të Indisë dhe të Iranit, kishin dalë të gjitha nga një "stërgjysh i përbashkët" d.m.th nga gjuha e Jafetit, ashtu si Sem është në zanafillë të Semitëve dhe Kam në atë të Kamitëve dhe të pasardhësve të tij, të cilët kishin lënë Armeninë për tu përhapur nëpër botë. Rreth së njëjtës periudhë Uillliam Xhons (1786) pohonte që një "gjuhë zanafillore" do të ketë qenë e përbashkët për pjesën më të madhe të popujve të Europës, të Indisë dhe të Iranit. Fatkeqësisht janë të shumtë autorët që nuk e kanë ndjekur aspak këtë linjë. Por autorë të tjerë mbeten dyshues, në mënyrë që të arrijnë të formulojnë apo sugjerojnë aty-këtu variante që shkojnë në të njëjtin sens të ravijëzuar nga dy autorët e lartpërmendur.

Në të vërtetë, J.P. Mallori (Në kërkim të Indo-europianëve, Seuil–1997) bën analiza mjaft bindëse duke paraqitur të paktën pyetje të cilave gjuhëtarët nuk mund tu gjejnë përgjigjet e duhura. Ja disa shembuj prej tyre: (f. 121): "Tashmë kemi parë greqishten, ilirishten, trakishten,

ka të ngjarë mesapishten, italiken lindore dhe ndoshta edhe të folura të tjera të Italisë që duket se vijnë nga juglindja e Europës – rajon prej nga do të kenë patur zanafillën Frigjianët dhe Armenët, të cilët kanë emigruar drejt Azisë Perëndimore: ngjashmëritë që zbulohen midis greqishtes, armenishtes, iranianes dhe indo-arianes të bëjnë të mendosh për ekzistencën e një vargu të vërtetë gjuhësh që shtrihen nga Ballkani deri në Azinë qendrore duke kaluar nëpër Detin e Zi... por sido që të kenë qenë lidhjet e sakta që i kanë bashkuar këto gjuhë, nuk mund të mohohet se historia e tyre duhet të ketë kaluar nga juglindja e Europës... Për më tepër, meqenëse tashmë kemi postuluar migracionet e Ballkanit drejt Greqisë, që ngjiten deri në mijëvjeçarin III para erës sonë, koherenca na bën të pranojmë që në këtë epokë tejet të lashtë juglindja e Europës tashmë i ka pasur idiomat indo-europiane... (faqe 81): "Grekët kanë bërë një numër të konsiderueshëm huazimesh nga një gjuhë tjetër jo greke. Shqyrtimi i fjalorit të le të hamendësosh se këto huazime nuk janë bërë krejt rastësisht [do të shtoja që Sllavët kanë vepruar saktësisht në të njëjtën mënyrë për sa u takon huazimeve të bëra ndaj popullsive ilire autoktone]... Nga këto vrojtime, mund të nxirret që Grekët nuk janë me zanafillë nga Greqia... Përveç kësaj, disa thonë se kjo hipotezë është e vërtetuar, nga vetë tradita historike greke, meqenëse ajo përmend popullsi më të hershme të cilat u asimiluan nga Grekët, disa prej tyre mbajnë emra që është më se e qartë nuk janë indo-europiane... (faqe 82): "As gjuha e Linearit A, as kultura minoane nuk janë trajtuar si greke nga specialistët... Duket se këta Mikeanianë do të kenë përshtatur në gjuhën e tyre një shkrim shumë të afërt me Linearin A minoan: gabimi i sigurt i të dy syllaberëve*) për të transkriptuar gjuhën greke në të vërtetë të le të hamendësosh se ato do të jenë shpikur fillimisht nga folës grekë... në të vërtetë ajo që ne duhet të parashtrojmë është çështja e zanafillës së Mikenianëve... (faqe 287): "Së fundi në një përmbledhje të kohëve të fundit mbi gjurmët e këtij qytetërimi në Ukrainë, I.K. Sveshnikov, flet për një migracion të një zanafille perëndimore drejt këtij rajoni, madje pa formuluar hipotezën e një ardhjeje nga stepat".

Midis këtyre autorëve ne mund të përmendim gjithashtu Kolin Renfru (Enigma indo-europiane, Champs/Flammarion-1994), i cili gjithashtu ka bërë analiza bindëse apo të paktën ka parashtruar pyetje të bazuara. Ja disa pjesë të nxjerra prej tij: (faqe 176): "Çfarë realiteti historik fshihet pas zanafillës së përbashkët stërgjyshore të të gjitha këtyre gjuhëve? Ne kemi hedhur poshtë teorinë "Kurgan", e cila e daton shpërndarjen rreth viteve 3500-3000 para Krishtit, si dhe ato të Qeramikës së përdredhur dhe të Gobeletëve (rreth viteve 2900-2600) ... (faqe 177): sot mund të dëshmohet që bujqit e parë të Europës janë vendosur në Greqi (dhe në Kretë) përpara viteve 6000 para Krishtit ... (faqe 181): Në një rast të tillë do të mund të dilte që kjo gjuhë e bujqve të parë që jetuan në Greqi rreth viteve 6500 para Krishtit duhet të jetë bartur nëpër Europë ...(faqe 182): "Ky model mund të shpjegonte pjesët e mbetura të gjuhëve jo indo-europiane, të cilat kanë mbijetuar deri në kohët historike, të tilla si gjuha etruske apo baske dhe pa dyshim të tjera të shumta që do të do të kenë qenë folur përpara se të zhdukeshin... (faqe 194): Një gjuhë proto indo-europiane mjaft uniforme ka mundësi të ketë qenë folur që nga Greqia deri në Skandivani, thjesht me disa variacione dialektore... (faqe 209): Asgjë nuk na detyron të hamendësojmë apriori se 'mbërritja' e Indo-Europianëve ka përmbysur gjithçka. Për të ilustruar këtë liri të re të 'të menduarit lokal', do ishte me përparësi të anonim gjithmonë e më shumë mbi problemet e vjetra të 'mbërritjes' së Grekëve... (faqe 122-123): "Në të vërtetë kjo do të thotë se kolonizimi zanafillor i pjesës perëndimore të stepës ka ardhur nga Perëndimi. Pra nga kjo rrjedh se gjuha e parë e stepës perëndimore ka qenë ajo e bujqve të territoreve kufitare me perëndimin... Mjafton pra një arsyetim prej të tri linjash sepse jemi të detyruar të hedhim poshtë hipotezën e Rusisë jugore si dhe atdheun e proto indo-europianëve".

Dhe së fundi, për të përfunduar te J.P. Mallori (Në kërkim të Indo-Europianëve- Seuil/ 1997): "Kjo shkëputje [Neolitik/Shfaqja e të parëve folës indo-europianë] ka ndodhur rreth viteve 3500 para Krishtit dhe ka ndikuar në një seri kulturash lokale, si Maliq III në Shqipëri, Ezero

dhe Karanovo VII në Bullgari si dhe Baden-Kostalac në perëndim të Ballkanit. Është propozuar të përfshihen të gjitha këto kultura nën emërtimin "Kompleksi ballkano-danubian" dhe në fakt ky emërtim është i përshtatshëm sepse ndihmon të dalë në pah një bazë e përbashkët dhe nxjerr në dritë një bosht vijimësie që përshkon materiali arkeologjik ... Do të kuptohet se qeramika e përdredhur dhe kompleksi ballkano-danubian luajnë një rol thelbësor në të gjitha shpjegimet e zanafillave të Indo-Europianëve".

Për sa i takon autorëve Mallori, Renfru apo autorë të tjerë të shquar duhet vërejtur një kontradiktë e dukshme në paraqitjen e fenomenit indo-europian të shpikur në shekullin XX. Në të vërtetë autorë të shumtë i venë kundrejt njëra-tjetrës gjuhët indo-europiane dhe jo indo-europiane si dhe idiomat nga tipi satem deri në tipin centum. Nga njëra anë na është thënë se idioma etruske dhe ajo baske (gjuhë të studiuara pak apo të njohura pak në të cilat megjithatë dallohen ngjashmëri me shqipen e sotme) janë gjuhë jo indo-europiane, se pellazgjishtja e lashtë është një gjuhë parahelene e zhdukur (ndërkohë që shqipja e sotme është një pasardhëse e vërtetë e saj) dhe se nga ana tjetër ngrihet zëri me të madhe qysh prej më shumë se një shekulli se gjuha shqipe është një gjuhë indo-europiane, por krejtësisht degë më vetë sepse nuk ngjan me asnjë gjuhë tjetër të njohur! Arsyeja e këtyre përsiatjeve ose ekuivokëve është fakti se nuk janë bërë përqasje midis pellazgjishtes së lashtë (gjuhë parahelene), thrakishtes, frigjianes, etruskishtes, ilirishtes apo shqipes së sotme. Ky është guri themeltar, pa të cilin gjuhësia do të mbesë ende për një kohë të gjatë në një rrugë pa krye.

Për të përfunduar këtë kapitull do të thoja thjesht se pellazgjishtja e lashtë, nga e cila rrjedh shqipja e sotme, ka qenë gjuhë zanafillore e folur në Europë, Egje dhe Azinë e Vogël qysh të paktën prej viteve 6500 para Krishtit. Do të shtoja që një pjesë e këtyre popullsive, për arsye të ndryshme ka emigruar drejt Lindjes, ka të ngjarë rreth mijëvjeçarit IV dhe mijëvjeçarit në vijim me një ritëm më të ngadaltë. Duke i shtuar kësaj se trupat e Aleksandrit III të Maqedonisë, i quajtur

Aleksandri i Madh, kanë shkelur truallin e territoreve të stërmëdha deri në luginën e Indusit madje përtej këtij. Sipas Arrianit (Anabaza e Aleksandrit të Madh), pjesa më e madhe e ushtrisë së tij ishte me zanafillë thrako-ilire (Maqedonë, Thrakë, Peonianë, Ilirë, Agrianë: "popujt më të fortë dhe më luftarakë të Europës kundrejt racave më të dobëta dhe më pak burrërore të Azisë". - : Libri II / 7). Të gjitha këto migracione të vullnetshme apo të pavullnetshme, (ushtarët vendoseshin në rajonet e pushtuara), kanë lënë në këtë pjesë të Azisë (duke shkuar nga Mesdheu deri në Indus) një pjesë të madhe të kulturës së tyre dhe mbi të gjitha të gjuhës së tyre. Pra nuk është për tu habitur që gjenden fjalë të përbashkëta në Europën ballkano-danubiane dhe në Azinë perëndimore dhe qendrore (gjuha sanskrite, avestike, tokariane etj.)

Pellazgo-shqipja: ndikime të nënshtresës pellazge .

Albert Dauzat në veprën e tij (Europa gjuhësore, Payot 1940) pohon sa më poshtë: "Veprimi i nënshtresës shfaqet në lëmin e fjalorit nëpërmjet vazhdimësisë së disa fjalëve, të cilat, të marra nga gjuha vendase në zhdukje, janë përshtatur, ripërtërirë apo përkthyer. Ky veprim pohohet gjithashtu në një mënyrë më pak të dukshme por më të fortë në prirjet psikike ose psikologjike, nëpërmjet të cilave popullsia e mundur duke e lënë krejtësisht të folurën e saj mori atë të padronëve të saj, gjë që del nga shqiptimi (fonetik) apo nga shprehja e mendimit (morfologji dhe sintaksë).... Përsa i takon leksikut, shkenca rigjen fjalë apo rrënjë që latinishtja e Galisë i kishte marrë nga galishtja; latinishtja e Italisë marrë tek etruskishtja, oskishtja etj., greqishtja e lashtë nga egjeishtja ... qytetërimi gal ishte në një shkallë më të ulët se ai latin, por nga ana tjetër etruskishtja kishte qenë në shkallë më të lartë ndaj qytetërimit të Romakëve zanafillorë, po kështu edhe qytetërimi egjean ndaj atij të Grekëve pushtues të Heladës. Duke shkuar më thellë në të kaluarën, studimi i emrave të vendit ka bërë të mundur të preket një

shtrat më i lashtë dhe të tregohet që emrat e vjetër që emërtojnë rrjedhat e ujit, malet dhe terrenet e thyer si dhe shkëmbinjtë dhe shpellat ngjiten në pjesën më të madhe deri në një gjuhë shumë më të kahershme se të gjitha familjet e njohura historikisht, një gjuhë e folur pothuajse në të gjithë territorin e Europës, uniteti gjuhësor e parahistorik i së cilës duket gjithmonë e më shumë i vërtetë.... Vatra e Indo-Europianëve ka qenë për një kohë të gjatë e diskutueshme. Është e gabuar që dikur ka qenë e vendosur në rajonin e Pamirit apo të Iranit". Dhe i ngazëllyer, madje optimist, ai shton duke e përsëritur pareshtur: "Gjuhët që janë shuar nuk janë zhdukur pa lënë gjurmë, pa plotësuar thellësisht konkurrentet më fatlume që kanë mbijetuar". Çfarë analize bindëse dhe kuptimplote! Fatkeqësisht Dauzati nuk e dinte ende se kjo "gjuhë e folur pothuajse kudo në Europë", gjuha që flisnin Pellazgët, nuk ishte zhdukur dhe, pavarësisht stuhive të kohërave, ajo vijonte të ishte e gjallë nëpërmjet shqipes së sotme.

Të gjitha këto nënshtresa, d.m.th. gjuhët e gjendura poshtë tyre dhe të eliminuara (në pjesën më të madhe) apo të mbizotëruara (për disa) nga grupe të ndryshme të mbiquajtura indo-europiane, janë bërë objekt i hulumtimeve të shumta qysh nga fundi i shekullit XIX deri në gjysmën e shekullit XX. Këto pak nga pak janë venitur deri në atë pikë sa brezat tanë po orientohen gjithmonë e më pak kah disiplinave të gjuhësisë, antropologjisë, etnologjisë, parahistorisë apo të arkeologjisë. Ndër fenomenet e tjera është edhe ky që i zmbraps njohuritë tona në pjesën më të madhe të këtyre fushave shkencore.

Pikërisht thrako-ilirishtja është trashëgimtarja e kësaj pellazgjishteje të lashtë, nga e cila shqipja e sotme paraqet të vetmen dhe të fundit degë gjuhësore të mbetur për një kohë të gjatë jashtë rrjedhave të mëdha shoqërore, ekonomike dhe intelektuale të rajonit ballkanik. Dauzati, pa e ditur këtë, meqenëse nuk kishte bërë përqasje midis pellazgjishtes së lashtë (e cila për të ishte një gjuhë e zhdukur) dhe gjuhës shqipe (gjuhë që nuk njihej mirë apo nuk njihej fare), pa dyshim që shpie ujë

në mullirin tonë. Në të vërtetë nuk është dyshuar as edhe për një çast të vetëm, që mendimet e tij profetike një ditë do të bëheshin realitet. Pra shqipja e sotme është kjo gjuhë, e kthyer në gjuhë magjike dhe që ka mbetur e vetmja gjuhë e gjallë, trashëgimtare e drejtpërdrejtë e pellazgjishtes së lashtë, e aftë për të shpjeguar toponime të panumërta, oronime dhe antroponime të tjera, të cilat i përkasin kësaj gjuhe zanafillore fillestare europiane, para indo-europiane dhe parahelene.

Ja përse ekzistojnë lidhje të shumta dhe përputhje të ndryshme nga njëra anë midis pellazgo-shqipes dhe gjuhëve më të lashta dhe më të njohura dhe nga ana tjetër sanskritishtes, vedikes apo gjuhëve të tjera të mbiquajtura indo-europiane. Sanskritishtja ose vedikja, krejt ndryshe nga ajo që pohojnë disa gjuhëtarë, do të ketë ndjerë ndikimin e kësaj pellazgjishteje shumë më të lashtë, e cila e ka bartur drejt skajit kufitar të kontinentit aziatik gjuhën e saj me emra të tillë si Himalaja, Malajzia, Malabari e të tjera terma që kanë mbijetuar në rajone kaq të largëta dhe të ndara prej mijëra kilometrash nga vatra kryesore pellazge (ballkano-danubiane): këto janë mbetje të gjalla të kësaj idiome të lashtë pellazge.

Në të vërtetë, duke u nisur nga mijëvjeçari V dhe IV ka patur dyndje të shumta emigrimi nga Europa drejt Azisë, ndër të cilat një nga të fundit ishte ajo e trupave të Aleksandrit të Maqedonisë (pellazgo-maqedono-epirote e helenizuar). Pjesa më e madhe e ushtrive të Aleksandrit të Maqedonisë, përveç trupave greke (minoritare), përbëhej nga ushtarë me zanafillë thrako-ilire. (Ilirë, Thrakë, Maqedonë, Peonianë, Agrianë etj.), që ishin edhe më trimat, sipas vetë Aleksandrit (cf. Arrian, II 7/5). Për sa më sipër, nuk ka asnjë dyshim se një pjesë e mirë e kësaj ushtrie, pas vdekjes së Aleksandrit, viti 323 para Krishtit, mbeti në Azi ose u shpërnda dhe u bë kësisoj trungu që përhapi kështu gjuhën, kulturën, traditat pellazge. Në të vërtetë, këta ushtarë ishin gjindja e një populli me zanafillë barbare d.m.th që nuk flisnin gjuhën greke. Vetëm prijësit e tyre ishin dygjuhësh apo të helenizuar, d.m.th.

---

*) *gjuhë (e pe njohur e folur rrjedhësisht nga popuj që flasnin gjuha amtare të ndryshme.*

të shkolluar me gjuhën dhe kulturën greke. Greqishtja (lingua franca)*) ishte e vetmja gjuhë komunikuese e folur nga të gjitha elitat e epokës. Ja pra një shpjegim midis të tjerave, në lidhje me huazimet e shumta aziatike të bëra në pellazgjishten e lashtë. Fatkeqësisht gjuhëtarët nuk e kanë hulumtuar aspak këtë vijimësi kaq interesante për të arritur të kuptojnë këtë problem të gjuhësisë të lashtë, pasi dogma indo-europiane nuk arrin ta zgjidhë aspak këtë dhe as të hedhë dritë mbi të.

Do të duhej që hulumtuesit tanë të ardhshëm, plus studimit të gjuhës shqipe, të mund të orientoheshin dhe të thellonin hulumtimet e tyre krahasuese, studimet dhe analizat e tyre drejt shqyrtimit të hollësishëm të gjuhëve të lashta apo të atyre që kanë mbetur, ndër të cilat sumeriania dhe ajo elamite, gjuhë jo semitike që do të mund të na rezervonin surpriza befasuese për sa i takon përafërsive të tyre të shumta ose përputhjeve me pellazgjishten e lashtë.

Ja pra një studim krahasues i kujdesshëm dhe analiza të ndryshme gjuhësore ndër gjuhët e shumta të lashta apo të njohura dhe pellazgo–shqipes, si dhe një vështrim i shkurtër historik në lidhje me to. Pra është fjala për disa shembuj lista e të cilëve nuk është e plotë.

Gjuha baske dhe pellazgo – shqipja

Në një kapitull tjetër për Baskët do të vërejmë se gjuha e tyre paraqet afri të shumta me shqipen e sotme. Këtu do të mjaftohem duke sjellë disa tregues dytësorë.

Dauzati, ashtu si edhe shumë autorë të tjerë të kohëve tona e krahasonte gjuhën baske me atë ibere: "Por në malësi gjuha ibere e kthyer në baske ka mundur të ruhet deri në ditët tona". Pikërisht kjo ka ndodhur edhe me pellazgjishten e lashtë të ruajtur në shqipen e sotme. Trombeti pohonte se "gjuha baske është një mbetje e kaukazianes së lashtë, hapësira e së cilës shtrihej në të dy skajet e kontinentit europian: Kaukazi dhe Pirenej". Por Trombeti, ashtu si gjuhëtarë të tjerë, e ka kapur problemin e këtyre dy gjuhëve jo në sensin e duhur.

Në të vërtetë si mund që gjuha baske apo gjuhë të tjera mund të ishin "mbetje të gjuhës kaukaziane", ndërkohë që nuk ka asnjë shenjë të një qytetërimi të vërtetë në Kaukaz (midis Detit të Zi dhe Detit Kaspik), vend udhëkryq që ka shërbyer si vendkalim për shumë popuj, ku një palë mbërrinin nga Europa (rajonet danubiane dhe ballkanike) dhe pala tjetër nga Azia e Vogël apo Azia. Ata nuk kanë arritur të kuptojnë (duke mos njohur pellazgjishten e lashtë apo duke e trajtuar si "gjuhë para indo-europiane të zhdukur") se në rajonin e Danubit të Sipërm dhe të Mesëm si dhe në Ballkan ekzistonte një qytetërim tepër i zhvilluar i cili i dha Europës, nëpërmjet Pellazgëve dhe Etruskëve këto dy qytetërime shumë të mëdha: qytetërimin grek dhe atë romak. Të gjithë bien në marrëveshje për të pranuar se Pellazgët dhe Thrako-Ilirët zinin një territor të stërmadh që shkonte nga brigjet e Danubit deri në Egje dhe nga Italia (madje Iberia) deri në Detin e Zi dhe formonin një grup shumë të madh etnik, i cili fliste të njëjtën gjuhë por me dialekte të ndryshme. Krejt ndryshe gjuha baske dhe ajo kaukaziane mund të kenë qenë vetëm mbetje e shtrirjes së fiseve të ndryshme pellazge që lulëzonin në të dy skajet e Europës. Gjuhësia, toponimia, historia, mitologjia, arkeologjia, antropologjia, ja ku janë për ta vërtetuar këtë. Në vatrën e kësaj shtrirjeje ishte rajoni ballkano-danubian që më vonë u përhap drejt Azisë së Vogël dhe Egjeut. Ja përse gjuha baske dhe ajo kaukaziane kanë dalë nga kjo idiomë e vjetër europiane dhe nuk është e kundërta. Eduard Filipon si dhe dijetarë të tjerë, gjuhëtarë e pranojnë të qenët nga një trung të Iberëve, Ligurve dhe Ilirëve. Atëherë përse nuk i kanë dëgjuar? Ne mund të qëmtojmë elemente të ndryshme si përgjigje, përgjatë veprës që keni në dorë.

Tekstet e para të shkruara në gjuhën baske janë shfaqur rreth shekullit XVI, ndër të cilat libri i parë është një përmbledhje poezish (Linguae vasconum primitae), vepër e një prifti të quajtur Deshepar (i botuar në vitin 1545 në Bordo, në dialektin navarez të vonë cizan lindor). Dialektet janë të larmishme, madje të ndryshme nga njëri-tjetri si në planin fonetik aq edhe në planin morfologjik apo sintaksor.

Është kjo, ajo çfarë e bën gjuhën baske shumë të vështirë për ta shkruar dhe dekriptuar. Unë po zbuloj një rastësi shumë befasuese: një nga provincat më të lashta të viseve baske franceze dikur quhej vend i sulës (dialekti suletin) ngjan se ngatërrohet me krahinën e Sulit në Epirin jugor, aty ku gjendej kryeqyteti i kultit të Pellazgëve, Dodona e profetëve të Zeusit pellazg (Iliada XVI, 234) që quheshin Sellë (Selleis)! Për momentin unë nuk kam asnjë verifikim tjetër në lidhje me këtë temë. Gjithsesi kjo do ta meritonte një studim shumë të thellë.

Ekzistojnë shumë pika lidhjeje midis gjuhës baske dhe shqipe.

■ nyja e vendosur në fund, të cilën tashmë e kemi studiuar në kapitullin e mëparshëm.

■ prapashtesa e pjesores baske **ua** është e njëjtë me **ua** (dialekti geg) dhe **uar** (dialekti toskë). Shembujt: chigortua ose merlatua në gjuhën baske; dhe në shqip mallkua, mallkuar apo helmua, helmuar.

■ gjuha baske e ndërton foljen nga një rrënjë me anë të prapashtesave apo parashtesave, duke përfshirë personin e veprimit (shumës).

■ gjuha baske shpesh ka ruajtur të paprekura dhe nganjëherë pakëz të ndryshuara fjalë të shumta që kanë të njëjtin kuptim edhe në gjuhën shqipe. Kjo e fundit, ashtu si gjuha baske në Pirenej, është ruajtur pothuajse e paprekur në malet e pamposhtura të Shqipërisë dhe të vendeve në kufi (Alpet Shqiptare, Alpet dinarike dhe malësitë e larta të Epirit në veri të Greqisë).

■ Emrat, mbiemrat, format foljore, përemrat dhe disa ndajfolje janë të lakueshme.

Armenishtja dhe shqipja

Ashtu si gjuha baske, edhe gjuha kaukaziane ka qenë pjesë e sferës së ndikimit të pellazgjishtes dhe më në veçanti të folmes së njërit prej fiseve më të njohura të tyre: Frigjianëve, të cilët midis vendeve të tjera kaukaziane kolonizuan edhe Armeninë. Ja përse në gjuhën kaukaziane ekzistojnë disa gjurmë pellazge, të cilat arrijnë të dekriptohen me anë të gjuhës shqipe.

Emri vendas i Armenëve është H'aï. Gjithsesi në mbishkrimet perse të epokës së Dariusit, ata janë quajtur Arminiya, të cilën Grekët e shndërruan në Armenioi. Alfabeti armen ka qenë shpikur në shekullin V të erës sonë nga Mesrop Mashtots. Alfabeti armen ka tridhjetë e gjashtë germa pjesërisht imitim i atyre greke. Pra në këtë kohë gjuha armene ka qenë përfundimisht e përcaktuar nëpërmjet shkrimit. Armenishtja e vjetër e quajtur grabar, gjuha klasike dhe ajo e përkthimit të Ungjillit dhe vepra të tjera në veçanti ato të peshkopit Eznik de Kolb. Pavarësisht të tjerave, gjuha armene ka ndjerë ndikimin e gjuhës iraniane. Duke filluar nga Epoka e Mesjetës letërsia armene fillon të pasurohet me vepra të shumta (teologjike, historike, etj.).

Ja pra disa pika përqasjeje midis këtyre dy gjuhëve. Pikësëpari në planin sintaksor, shumësi në gjuhën armene formohet nga er, eri që rigjendet në dialektin toskë të Shqipërisë së jugut. Po e njëjta gjë ndodh edhe për prapashtesën ali të armenishtes së lashtë: Manali (etnonimi), nga vendi i Mani-it, fqinj me Aratat, i quajtur Min në Testamentin e Vjetër si dhe Aramali, vendi i Aram-it. Duhet kujtuar këtu ngjashmëria befasuese me gjinoren etruske al (një gjuhë tjetër pellazge).

Armenisht	**Shqip**
A- dam = dhembi	* Dham (geg) = dhëmbi; dhëmb (toskë)
Azg, Az-k = komb, popull	* Mbaresa e emrit grek të Pellazgëve (Pelasg-oi) = Pellazgji; Shpellagji (në shqip = popull i Shpellave)
Cikh = asgjë	* Çikë = pakëz
Darç, darrçn =	* derëzi
Dzà-kou'm = trung (fisnor)	* Zakon
Erthal, yer-tal = me shku	* Erdha
Gess = gjysmë	* Gjysmë
Gtanem= gjej	* Gjetëm
Gou'r -dz'k = toraks	* Gjoks
H'atz = bukë	* Haze = bukë e bardhë - hasëll
Hi-mar = i çmendur	* I marrë

Jar = zjarr	* Ziarr (zjarr)
Var = i zjarrtë	* I ziarr-të (ziarrtë)
K'ar =	* Gur
Ka-ari =	* Gruri
Kè-ch =	* Keq
Lat-tz'i =	* Lot * lot zi
Yem =	* Iam (jam)
Y'én =	* Ian (janë)
Li-tsh = liqen	* Liqen, litshen, (geg. = litshê)
Me-dz =	* Madh
Bo-tsh =	* Bisht
Tcho-r h'at-z =	* Bukë "kasëll" = hasë (geg)
Tz-aï-n = zëri	* Za, zani (geg)
Tza-va-li	* Zavall
Tze-mer = dimër	* Dimër
U-gh-i	* Udhë (oudh)
	* Ulicë
U-kh-da	* Udha /

Toponime të përbashkëta (Armeni - Ballkan):

Armeni	**Ballkan**
Armenoi, Armenia (etnonimi)	* Armën Armëngh (fis pindo-vlleh)
	* Armën (Epiri i jugut) qytet
	* Armen (Shqipëri, veriu i Selenicës) qytet
Arzene, Arzanêne , Aratsani	* Erzen (Shqipëri)
Lychnitis (liqen)	* Idem, në Iliri Liqen
Bolbénê (rajon)	* Bolbe (liqen në Maqedoni) etj.

Pavarësisht rëndësisë së ndikimeve të gjuhëve iraniane, greke dhe të tjera, dallohet se gjuha armene i ka ruajtur disa fjalë të vjetra thrako-frigjiane, të cilat arrin t'i dekriptojë vetëm gjuha shqipe.

Anglishtja dhe pellazgo - shqipja

Baker = bukëpjekës	* Bukë
Bake, to (beik) = me pjek	* Pjek
Brother = vëlla	* Byrazer * Vëlla - vëllezër, vihet re rotacizmi: (l=r) Dhe këmbime të tjera, veçanërisht në toskërisht vërejmë modifikimet e mëposhtme: vëllazër = berazër = byrazer. Duhet shënuar se në greqisht B shqiptohet v ! Kjo fonemë gjendet në Spanjë ku b arabe shndërrohet në v = Guadalquivir (wad al kebir = lumë i madh)
Cow = lopë	* Kau, * Ka
Door = derë	* Derë
Father = baba	* Patër (shqipja e vjetër) = baba* At, atër (etër)
Gate = portë, gardh, trinë	* Gatis = bëj gati, në gjuhën ushtarake gatitu/ Kjo fjalë ka kaluar në frëngjisht në guet, guetter
I am = unë jam	* Iam (Jam)
He is = ai është	* Është, Isha * Ishe, ishte
You = ju	* Ju
Hunger = hëngër	* Hangër = geg (hëngër)
Keep, kept = mbaj, mbajta	* Kap
Know (now) = di, njoh	* Njoh
Mother = nënë	* Motër (Te Pellazgët, popull me sistem martesor).Kjo do të thotë ajo që zëvendësonte nënë. Emri Demeter është
Ndërtuar me të njëjtën bazë:	Dhé motër
See - shoh	* Sy

wail	= vajtoj	* Vai (vaj)
wear	= vesh	* vesh
View	= pamje	* Vroi (vroj; shqip geg. vrëi)

E ngjashme me parafjalën angleze to (me) parafjala shqipe me, e cila futet në mënyrën paskajore në gjuhën shqipe vetëm si: to bake = me pjek/pjek); to make = me ba, me bë. Ndërsa në frëngjisht, paskajorja formohet pa parafjalë p.sh. cuire = me pjek, faire (me bë)... Gjuha angleze pra ka ruajtur disa forma të gjuhës zanafillore (fonetikë,sintaksë...) të europianëve të parë, në veçanti të Ilirëve të rajoneve danubiane (Danubi i Sipërm dhe i Mesëm), te të cilët Keltët kanë bërë huazime shumë të mëdha gjuhësore.

Kelto-galishtja dhe pellazgo-shqipja

Keltishtja e lashtë njihet me emrin e të shkruarit ogamike, nga e cila janë gjetur 360 mbishkrime të shkurtra të gdhendura në faqet e blloqeve të gurit (ishujt britanikë). Përveç emrave të shumtë të përveçëm të njohur nga autorët antike ose në epigrafitë romake, ne zotërojmë vetëm rreth njëqind mbishkrime të gjuhës kelte të përbashkët (kelte kontinentale ose gale), të cilat konsistojnë në mbishkrime (pjesa më e madhe në Grofesenkes në Aveiron) dhe epigrafe të ndryshme shumë të shkurtra të gjendura në veri të Italisë, luginën e Ronit etj. Këto mbishkrime janë me germa etruske (më të voglat të qarta), greke apo latine. Mbishkrimi më i gjatë është ai që quhet Kalendari i Kolinjit. Ato datojnë rreth shekullit III dhe fillimit të erës sonë. Kjo gjuhë kelte përdorej në Gali, Italinë e veriut, Spanjë dhe madje kishte depërtuar deri në Azinë e Vogël (Mbretëria e Gallatës). E folur qysh në fillim të mijëvjeçarin para Krishtit, ajo shumë shpejt u mbulua nga latinishtja. Ajo u shua në Gali rreth shekujve të parë të erës sonë. Më vonë, përpara pushtimit romak, u shfaqën dialektet keltike ishullore ndër të cilat galikja (Irlandë, veri-perëndimi i Anglisë, Skoci) dhe britanikja (galeze apo simraeg, kornik, breton).

Galikja është dëshmuar që në shekullin IV të erës sonë. Vetëm gjuha irlandeze ka ruajtur një fond të vjetër gjuhësor të keltishtes së lashtë si nga pasuria aq edhe për arkaizmin e lakimit së saj. Gjuha galeze letrare dëshmohet vetëm rreth shekullit XI. Dialekti kornik njihet nga një fjalorth që daton në shekullin XIII dhe disa tekste që fillojnë nga shekulli XV dhe shuhen nga shekulli XVIII. Sa për dialektin breton, i njohur nga disa shënime qysh nga shekulli VIII dhe nga tekstet letrare qysh nga shekulli XIV eshtë ende i folur sot në Bretanjë (Francë perendimore). Bretoni që hyri në Armorik afër shekullit V madje VI të erës sonë, është një gjuhë që ka dalë nga ajo e emigrantëve të ardhur nga Britania e Madhe. Pra kjo nuk është një produkt i mirëfilltë i galezes së lashtë. Emri Bretanjë është Breiz në Kornuell (Kerne), në Leon dhe Tregorrois por shqiptohet Breih në dialektin vanetez. Për të vënë në përputhje të dy grafikë është përshtatur përfundimisht BREIZH. Kjo fjalë shpjegohet nëpërmjet fjalës shqipe Brez, në kuptimin brez (mesi), brez (njerëzor). Ja pra një vështrim i shkurtër i historisë kelte. Gjithsesi dialekti breton dhe galik, për shkak të izolimit të tyre dhe përzierjeve gjuhësore kanë ruajtur një pjesë të fondit të tyre të vjetër gjuhësor.

Autorë të shumtë të kohëve tona kanë vendosur një lidhje midis gjuhës kelte dhe ilire. Ja çfarë pohon Albert Karnoi (Indo - Europianët, 1921): "Ka patur një mjedis para-kelt të cilit i bashkëngjitet gjuha ligure, gjermanike, italike, ilire". Pavarësisht kësaj Karnoi (ashtu si gjuhëtarë të tjerë) pa njohur hallkën pellazgo-trako-ilir, nuk ka mundur të rindërtojë vargun gjuhësor të vërtetë të parahistorisë europiane.

Është interesante që përveç disa përaferësive gjuhësore dhe disa ngjashmërive fizike (shtati i lartë, qëndrim fisnik), apo kulturore (forca e zakoneve të tyre, të vëresh që ngjashmëri në një pjesë të riteve dhe dokeve, ndër të cilat mbajtja e kilti-it në Skoci që është e njëjtë me fustanellën në Shqipëri dhe në Epir) ndër Higlanders (malësorët) skocezë dhe malësorëve shqiptarë.

(Shiko leksikun e përputhjeve gjuhësore).

Gjermanishtja dhe pellazgo-shqipja :

Gjermanishtja e lashtë ka formuar tri grupe dialektore: gotikja apo gjermanishtja lindore apo ostike, gjermanishtja veriore e mbiquajtur nordike (islandisht, norvegjisht, suedisht, danisht) dhe gjermanishtja perëndimore (gjermanishtja e hershme, gjermanishtja e vonë, frison dhe anglishtja e vjetër).

Gotishtja dëshmohet qysh në shekullin IV të erës sonë nga mbetjet e një përkthimi të Biblës, vepër e peshkopit Vulfila (rreth viteve 311–383) të Mesisë. Gjuha e Burgondëve dhe e Vandalëve i përkiste gotëve. Gotët qysh në kohë të lashta zinin Skandinavinë jugore ku rigjendet emri i tyre: Götland, Gottland, ata e pushtuan në shekullin II të erës sonë, viset që gjenden midis pellgut të Vistulës dhe veriu i Detit të Zi. Në shekullin III ata themeluan, midis Danubit të Poshtëm dhe Dnjeprit, një mbretëri të ndarë në dy popuj: Ostrogotë dhe Visigotë.

Gjermanishtja veriore apo nordike përfaqësohet pikësëpari nga mbishkrime të shkurtra runike, ndër të cilat ato më të lashtat janë më të vonshme se shekulli III i erës sonë. Kjo është gjuha gjermane më e lashtë e dëshmuar dhe e njohur midis shekujve II dhe VIII prej rreth pesëqind mbishkrimesh në alfabetin runik. Në përgjithësi gjuha e këtyre mbishkrimeve quhet nordike e përbashkët apo norrois.

Gjermanishtja perëndimore, e cila nuk zotëron mbishkrime përpara shekullit VIII të erës sonë, nuk ka asnjë unitet dialektor. Letërsia, në thelb kishtare, ka filluar vetëm në shekullin IX. Gjermanishtja e hershme përfshin bavarishten, alemaniken dhe frankonianen. Letërsia gjermane moderne u shfaq vetëm në Epokën e Mesjetës dhe në veçanti në qytetet e Saksonisë. Teksti më i lashtë i gjermanishtes së vonë daton vetëm nga shekulli IX, e dëshmuar nga poema e Heliand që daton rreth vitit 830 dhe e ruajtur në dorëshkrimet e shekujve IX dhe X. Gjuha e Anglo-Saksonëve (frison dhe anglishtja e vjetër) dëshmohet me forma të ndryshme qysh nga shekulli IX. Anglishtja e vjetër e quajtur gjithashtu anglo-saksone është bërë gjuha më e folur e Britanisë së Madhe.

Emri i Gjermanëve është një ekstrapolim i autorëve antikë, të cilët duke u nisur nga emri i një fisi (që gjendej në brigjet e Rinit dhe fqinj me Keltët) e kanë përzmadhuar në një tërësi të fiseve të tjera të vendosura në Europën e Veriut midis Vistulës, Rinit dhe Alpeve.

Përsa i takon gjuhëve të ndryshme gjermanike, shënojmë se krejt ndryshe me gjuhën kelte ato shumë më vonë kanë pësuar ndikimin e gjuhëve të Lindjes, ndër të cilat ato baltike, sllave (indo-iraniane). Përveç kësaj, nënkuptohen huazimet e bëra te gjuha kelte, latine dhe greke.

Pellazgo-shqipja dhe greqishtja :

Përsa i takon gjuhës greke dhe strukturave të saj gramatikore, sintaksore apo fonetike po ia lë fjalën shkurtimisht, disa autorëve të shquar. Në të vërtetë objekti i këtij kapitulli nuk është të kryej një studim gjuhësor të greqishtes së lashtë, por për të përcaktuar etnogjenezën e saj, për të zbuluar në planet leksikologjike dhe semantike huazimet e shumta të bëra në pellazgjishten e lashtë dhe dekriptimin apo shpjegimin e mundshëm të tyre falë shqipes së sotme, e vetmja gjuhë indo-europiane që ka ruajtur një pjesë të madhe të këtyre fondeve të vjetra gjuhësore.

Pikësëpari, ja një paraqitje mbi gjuhën greke të P. Shantëren (Morfologjia historike e greqishtes, Klincksieck, Paris,1961): "Greqishtja i përket familjes së gjuhëve indo-europiane dhe në morfologjinë e saj ajo paraqet qartë strukturën e një gjuhe indo-europiane arkaike: 1) Ndarja e plotë e sistemit emëror dhe e sistemit foljor; 2) Sistemi emëror i bazuar mbi dallimin e tri gjinive: mashkullore, femërore dhe asnjanëse; dhe tre numra; njëjës shumës dhe duel (numër i veçantë shumës që përdoret në disa gjuhë); funksioni i emrave të treguar nga një sistem rasash; 3) Struktura, gjithashtu arkaike, për foljen me dy trajta veprore dhe mesatare (pësorja është një veçori e trajtës mesatare), tri veta dhe si emër tre numra. Mënyrat, përveç dëftores, përfshijnë urdhëroren, lidhoren dhe dëshiroren. Ekzistojnë forma

emërore të foljeve, mënyra paskajore dhe pjesorja. Së fundi, temat themelore që shprehin aspektin janë tri: e tashme (bashkë me të ardhmen, që ka dalë nga një temë e veçantë e së tashmes), e përcaktuar dhe e kryer. Nga ana tjetër një fjalë greqisht në parim duhet të analizohet nga një rrënjë, një prapashtesë dhe një mbaresë. Por është fjala vetëm për një parim. Mbaresa mund të mungojë dhe kemi formën që karakterizohet nga mbaresa zero", etj.

Së fundi ja mendimi i helenistit dhe gjuhëtarit të shquar A. Meje (Vështrim mbi historinë e gjuhës greke Klincksieck, 1965):

"Greqishtja është një gjuhë indo-europiane. Kjo është e dukshme, por është e udhës të përcaktojmë atë çfarë kuptohet me të. Midis pjesës më të madhe të gjuhëve të Europës - mund të thuhet midis të gjitha gjuhëve të njohura të Europës, përveç gjuhës ibere dhe asaj baske (padyshim që i përkasin të njëjtit grup) në perëndim, etruskishtja në Itali, finlandishtja dhe gjuha hungareze (kjo e fundit e sjellë në periudhën historike nga një pushtim) dhe së fundi turqishtja është një importim modern – dhe disa gjuhë të Azisë: armenishtja, "tokariania" e njohur kohët e fundit nga tekstet që kanë raportuar misionet në Turkistanin kinez, gjuha "hitite" e deshifruar kohët e fundit, gjuha iraniane, të folurat ariane të Indisë dhe në veçanti literatura e madhe letrare që emërohet "sanskritishte", ka grupe përputhjeje prej nga hamendësohet se të gjitha gjuhët, që janë kthyer në gjuhë të ndryshme me kalimin e kohëve janë forma të marra nga e njëjta idiomë e lashtë. Kjo idiomë nuk ka qenë kurrë e fiksuar me anë të shkrimit; nuk ka mbijetuar asnjë monument, për më tepër as ka mbetur një kujtim nga populli të cilit i ka shërbyer kjo gjuhë. Por përputhjet që vërehen midis gjuhës sanskrite, iraniane, armene, sllave, dialektet baltike (të tilla si lituanishtja) shqip, greqisht, gjermanisht, keltisht, latinisht, osko-umbriane - të cilave tashmë iu duhet shtuar "tokariania" dhe ajo "hitite" – kanë dhënë material për një tërësi hulumtimesh të njohura nën emrin "gramatika krahasuese e gjuhëve indo-europiane"... Megjithëse ato janë hasur në

numrin e vendndodhjeve të popullsive të gjuhës indo-europiane, ndër të cilat të folurit kishte me greqishten ngjashmëri të shumta, Grekët e lashtë kurrë nuk e ravijëzuar identitetin zanafillor të gjuhës së tyre me atë të këtyre "barbarëve"... dhe nëse vëren midis sanskritishtes dhe greqishtes sasi përputhjesh të ngjashme, kjo do të thotë që sanskritishtja dhe greqishtja janë dy forma të diferencuara nga një gjuhë e përbashkët që është parë e udhës të quhet gjuhë indo-europiane... tekstet më të lashta vedike janë po aq të lashta sa tekstet homerike... Kështu nga një rastësi historike, greqishtja shfaqet si gjuhë e izoluar midis gjuhëve indo-europiane... Nëse dihej çfarë gjuhësh hasën njerëzit që sollën me vete gjuhën e rëndomtë greke, qoftë në Greqi qoftë në ishujt dhe brigjet e Mesdheut që ata i kolonizuan, do të mund të bëheshin përpjekje që të hulumtohej për gjithçka që i detyrohen atyre popullsive që "Helenët" i asimiluan, për sa i takon veçorive të shqiptimit ose të gramatikës së greqishtes dhe nga ana tjetër për të përcaktuar midis fjalëve greke se cilat janë ato që janë huazuar te një idiomë e pushtuesve të mëparshëm ose te gjuhët e qytetërimit të Mesdheut. Problemi paraqitet i tillë: nuk ka të dhëna të mjaftueshme për ta zgjidhur atë plotësisht...

Diçka është e sigurt: risitë që e bënë sistemin grek të ndryshojë nga sistemi indo-europian supozojnë tendenca të dallueshme nga ato që karakterizojnë gjuhën indo-europiane dhe si pasojë veprimtaria e popullsive vendase me të cilat u përzien pushtuesit e gjuhës indo-europiane. Duke kaluar nga gjuha indo-europiane në greqishten e rëndomtë hyhet në një botë të re... Për gjuhët e folura në gadishullin grek përpara pushtimit helen nuk dihet asgjë. Pellazgët janë vetëm një emër... Ka të ngjarë që në greqisht të ketë fjalë, të cilat grekët si të thuash i kanë grumbulluar gjatë udhës dhe të tjera që i kanë gjetur në Greqi, ku ata kanë pritur popullsi të ndryshme të botës "egjease"..."

Kam cituar paragrafët e fundit të Mejesë sepse ato përmbajnë elemente thelbësore të argumentimit tim mbi problemet e krijuara nga shpikja e termit indo-europian, për pistat e gabuara dhe nga çoroditjet që rrjedhin nga këto. Pra, çfarë thotë ai?

1) se ka ekzistuar një idiomë e lashtë (të cilën ai nuk e njeh, ashtu si nuk njeh pjesën tjetër, Pellazgët), e folur kudo përpara shfaqjes së indo-europianëve; se kjo idiomë është zhdukur pa lënë shkrime, as monumente "për më tepër nuk ka mbetur asnjë kujtim për popullin që e ka përdorur atë".

2) se kjo idiomë e lashtë, e zhdukur dhe e copëzuar ka përfunduar duke formuar gjuhë të shumta të kthyera në gjuhë të ndryshme me kalimin e kohës.

3) se nën veprimin e popullsive vendase, gjuha e popujve të mbiquajtur indo-europianë ka pësuar një ndikim të fuqishëm gjuhësor para indo-europian.

4) se midis gjuhëve kryesore të Europës (shqip, greqisht, latinisht, greqisht osko-umbriane, kelte, gjermanike, lituane, letonishte, sllave) dhe disa gjuhëve të Azisë perëndimore (sanskritishtja, iraniane, tokariane, hitite ose armene) ekzistojnë grupe të përputhjeve gjuhësore.

5) se gjuha ibere, baske etruske, finlandeze, hungareze dhe turqishtja nuk bëjnë pjesë në këtë tërësi gjuhësore.

6) se greqishtja nga "një rastësi historike" mbetet e izoluar mdis gjuhëve indo-europiane.

7) se ekzistojnë në gjuhën greke fjalë të shumta të huazuara ndër popullsitë vendase në Greqi madje në vetë botën egjease, popullsitë të cilat do të kenë përpunuar pak karakterin indo-europian të greqishtes.

Meje ka parashtruar pyetje me vend, por nuk ka dhënë përgjigjet e duhura dhe ndonjëherë s'ka dhënë as kurrfarë përgjigje. Le t'i marrim duke i analizuar disa pika thelbësore të paraqitura nga ai.

* Ai e pranonte ekzistencën e një gjuhe të lashtë madje unike që ka paraprirë të gjitha gjuhët e tjera dhe në veçanti greqishten si dhe atë që në mënyrë të përgjithshme quhet indo-europiane qysh prej më se një shekulli. Por ai nuk e njihte as zanafillën as popullin që e ka përdorur këtë gjuhë. Ai citon Pellazgët si (në lojën e betejave detare: ai është pothuajse pranë por nuk arrin ta prekë) por nuk i njeh sa duhet, madje

aspak, meqenëse pohon se ky popull është zhdukur pa lënë asnjë gjurmë. Ndërkohë që ky popull ka qenë përmendur shumë herë me radhë nga autorët antikë të shekullit VI dhe V para Krishtit, siç do ta shohim pak më tej në këtë kapitull.

* Ai e pranonte se kjo idiomë e lashtë kishte lënë gjurmë në gjuhët e tjera, madje midis atyre të quajtura indo-europiane. Në të vërtetë ai parashtron një çështje me vend por nuk arrin një përgjigje me vend. Ndërkohë që kjo "idiomë e lashtë" rigjendet në emrat e ndryshëm të vendit, të perëndive ose të heronjve të mitologjisë të mbiquajtur greke; ndërkohë që këta emra gjejnë shpjegimin e tyre pikërisht falë gjuhës shqipe të sotme dhe jo asaj greke; se kjo gjuhë shqipe e dalë nga ajo thrako-ilire, ajo vetë e dalë drejtpërdrejt nga pellazgjishtja e lashtë, është e vetmja gjuhë që ka shpëtuar nga kjo idiomë e lashtë, për të cilën Meje dhe të tjerë nuk i njohin zanafillën dhe popullin që e përdori. Kjo gjuhë, fosile e gjallë, pothuajse e paprekur ndër popullsitë iliro-shqiptare të malësive të pamposhtura të Shqipërisë së sotme, të Kosovës, të Maqedonisë perëndimore, të Alpeve dinarike (Mali i Zi) dhe malësitë e Epirit (Greqia e veriut).

* Meje pohon gjithashtu se kjo idiomë e lashtë ka përfunduar duke formuar gjuhë të tjera të kthyera në gjuhë të ndryshme me kalimin e kohës. Kjo është pika e dobët. Sipas arsyetimit të Mejesë: një gjuhë e vetme duhet të ketë ekzistuar në kohët e hershme dhe do të ketë krijuar gjuhë të tjera përpara shfaqjes së gjuhës indo-europiane. Kështu këtu do të ketë patur nga njëra anë gjuhë të dala nga kjo idiomë e lashtë dhe nga ana tjetër gjuhë të dala nga një gjuhë hipotetike apo artificiale e quajtur arbitrarisht "indo-europeane" e cila gjuhë ka pësuar ndikimin e një grup të parë i qenësishëm ati idiomit të lashtë. Roli i grupit të mbiquajtur indo-europian duket tejet i errët për arsyet që ne jemi përpjekur të hedhim dritë këtu më poshtë apo të paktën për të sjellë disa sqarime.

* Meje dhe shumë gjuhëtarë të tjerë i klasifikojnë disa gjuhë të cilat ata pothuajse nuk i njohin fare, "në shumë sirtarë" të ndryshme dhe

megjithatë duke shprehur pothuajse të njëjtën gjë: gjuhë të zhdukura, gjuhë parahelene, gjuhë egjease, para indo-europiane ose jo indo-europiane. Sipas Mejesë ja edhe pjesa më e madhe e këtyre gjuhëve: etruske, ibero-baske, finlandeze, hungareze dhe turqishte. Përveç dy gjuhëve të para ne mund t`i klasifikojmë finlandishten, hungarishten dhe turqishten midis gjuhëve jo europiane të quajtura jo indo-europiane. Përkundrazi, nuk mund të japim krahasim të tillë për sa i takon etruskishtes dhe baskes.

Në të vërtetë këto dy gjuhë bëjnë pjesë në grupin gjuhësor të dalë nga kjo idiomë e lashtë e famshme. Kemi një provë të dukshme: përputhjet e shumta gjuhësore midis këtyre dy gjuhëve dhe shqipes (cf kapitulli që ka të bëjë me etruskishten dhe gjuhën baske). Megjithatë etnonimia "Baskët" shpjegohet në mënyrë të përkryer nga shqipja "Bashkë", gjë që vërtetohet nga simboli i Baskëve që është "BASHKIMI" d.m.th. populli që është në egzil, larg në malet Pirenej, por që ka mbetur "i bashkuar". Nga ana tjetër autorët antikë të shekullit VI dhe V kanë pohuar se Pellazgët dhe Tirrenët (Etruskët) ishin qoftë popuj vëllezër qoftë një popull i vetëm, një i tërë, pavarësisht se kishin ruajtur dy emërtime të ndryshme. Pra, nga njëra anë si mund të trajtohet gjuha shqipe si një gjuhë indo-europiane nëse ajo është klasifikuar në një degë krejt më vete (normal, meqë nxjerr probleme!) dhe nga ana tjetër si mund të trajtohet etruskishtja si një gjuhë e panjohur dhe jo indo-europiane? Këtu sistemi indo-europian nuk funksionon më.

* Nëse analizojmë mirë themelin e problemit, dallohet me lehtësi që të gjitha gjuhët e mbiquajtura indo-europiane janë relativisht më të vonshme (në raport me pellazgjishten e lashtë ose sipas Mejesë idioma e lashtë para indo-europiane) dhe më të vjetrat ndër to si vedikja/ sanskritishtja nuk ngjitet më lart se shfaqja e Helenëve. Të jenë këta Grekë pararendësit e vërtetë të kësaj gjuhe hipotetike "indo-europiane"? Ky fond gjuhësor në kohë të lashta, a ka qenë i ndërtuar duke u nisur nga një nënshtresë pellazge? Në këtë rast, a do të ketë evoluar më vete?

Ka mundësi. Sido që të jetë, Grekët për një kohë të gjatë kanë qenë në kontakt me Pellazgët, nga të cilët ata kishin bërë huazime shumë të mëdha gjuhësore dhe kulturore.

* Për mua është e qartë ndarja midis asaj që është mbiquajtur indo-europiane nga njëra anë dhe jo indo-europiane apo para indo-europiane nga ana tjetër.

- Ajo që Meje e quan idiomë të lashtë, sipas mendimit tim përfaqëson të gjitha dialektet e dala nga gjuha pellazge e lashtë: gjuha etruske, frigjiane, thrako-ilire (ndër të cilat shqipja), madje hitite dhe bëhet fjalë për dialektet e lashta më të njohura, pastaj baske, armene, rumune dhe disa gjuhë të Kaukazit, kur është fjala për gjuhë të prejardhura dhe që kanë ruajtur pak a shumë një pjesë të madhe të këtij fondi të vjetër pellazg. Përsa i takon gjuhës latine është fjala për një gjuhë të bastarduar që ka pësuar një ndikim të dyfishtë, atë të etruskishtes nga njëra anë dhe të greqishtes nga ana tjetër. Disa madje arrijnë sa të pohojnë se është fjala për një gjuhë që rrjedh drejtpërdrejt nga një e folur dialektore etrusko-greke e bastarduar. Patjetër duhet shënuar se Etruskët dhe Pellazgët janë shfaqur në Itali shumë më përpara shfaqjes se Latinëve në Latium dhe mbërritjes së Grekëve në Kumes, kolonia e parë e tyre në Itali.

* Përsa i takon greqishtes, ajo zë një vend të veçantë për shkak të qytetërimit të madh, i cili ka dalë nga rrënojat e qytetërimit të Pellazgëve. Në të vërtetë Helenët e kishin pushtuar vendin e tyre rreth shekullit VIII para Krishtit (asgjë greke nuk shfaqej përpara kësaj periudhe, as në gadishullin ballkanik as në Egje, as në Azinë e Vogël, si në planin etno-gjuhësor ashtu dhe në planin historik dhe arkeologjik). Ata asimiluan një pjesë të madhe të kulturës, gjuhës dhe fesë së Pellazgëve siç e provojnë gjurmë të ndryshme gjuhësore të bëra te pellazgjishtja e lashtë, antroponimet e ndryshme, eponimet ose oronimet që ne hasim në epopetë homerike, legjendat dhe mitet, tekstet e lashta dhe në planin toponimik, emrat e vendeve që ne i hasim në të gjitha territoret e pushtuara më pas nga pushtuesit helenë. Të gjithë autorët antikë kanë pohuar se Pellazgët flisnin një gjuhë ndryshe nga

greqishtja. Kjo është e rëndësishme për të kuptuar etnogjenezën e gjuhës greke. Gjithashtu Helenët flisnin gjuhën e tyre kur mbërritën në vendin e Pellazgëve. Pra nga kjo përzierje e dy gjuhëve të ndryshme do të ketë lindur gjuha greke.

* Ja përse Meje parashtron këtë pyetjen tjetër me vend, por pa sjellë përgjigjen e duhur, duke pohuar: "... megjithëse greqishtja dukej e izoluar midis gjuhëve indo-europiane.... risitë që e bëjnë sistemin grek të ndryshojë nga sistemi indo-europian supozojnë prirje të dallueshme nga ato që karakterizojnë indo-europianen". Ky anketim i Mejesë ravijëzon një farë destabilizimi të bazamentit "indo-europian" të gjuhës greke. Arsyeja është e thjeshtë: greqishtja, atë që është thelbësore për gjuhën e saj e ka nxjerrë nga dy shtrate të ndryshme: nga njëra anë pellazgjishtja e lashtë, gjuhë e pushtuesve të lashtë të Greqisë, të Egjeut dhe të Azisë së Vogël perëndimore (Pellazgët, Lelegët, Karianët, Lisianët, Frigjianët, Ilirët, Trakët etj.) dhe nga ana tjetër gjuha zanafillore greke, ajo e Helenëve, pushtues të vendit të Pellazgëve. Kjo skemë e ndërmjetme i kundërvihet pra tezës së pranuar në përgjithësi, e cila nxjerr në pah indo-europianizmin e disa gjuhëve europiane, ndër të cilat greqishtja, ndërkohë që pellazgjishtja e lashtë ka dhënë ndihmesën e saj në lindjen e pjesës më të madhe të gjuhëve europiane, madje përafërsisht atyre aziatike.

Por çfarë është atëherë gjuha indo-europiane? Kjo gjuhë nuk ka ekzistuar kurrë. Ajo ka lindur nga imagjinata e gjuhëtarëve të parë të shekullit XIX, të cilët pasi vërejtën dhe zbuluan ngjashmëri dhe përputhje gjuhësore midis disa gjuhëve të Europës dhe gjuhëve përafërsisht aziatike (sanskrite, iraniane, dravidiane, tokariane etj.) shpallën shpikjen e fjalës indo-europiane, simbol i kësaj përzierje euro-aziatike. Pastaj ata e shënuan këtë gjuhë hipotetike në grupet e gjuhëve, në nëngrupe, dialekte dhe nëndialekte. Dhe në bazë të asaj se si njëra palë dhe pala tjetër e shqiptojnë fjalën "cent", jepet e drejta të cilësohet një gjuhë e dhënë si gjuhë satem apo centum, ndërkohë që e dimë shumë mirë që brenda edhe një gjuhe të vetme mund të ketë modifikime të

rëndësishme fonetike, madje edhe leksikore. Përveç kësaj, të cilësosh një gjuhë vetëm nga mënyra e të shqiptuarit e numrit njëqind (cent) është edhe më tepër jo-logjike nëse mendohet se kjo gjuhë mund të ketë një zanafillë shumë të lashtë madje që bën pjesë në një gjuhë jo indo-europiane dhe ta ketë mësuar numrin apo përdorimin e shifrave shumë vonë në historinë e saj ose thjesht ta ketë huazuar këtë shifër "cent" (dhe shqiptimin e saj zanafillor) nga një gjuhë e ndryshme: kjo gjuhë cilësohet madje indo-europiane, ndërkohë që në të vërtetë ajo ka një zanafillë tjetër. Ekzistojnë kontradikta të dukshme dhe paradokse të shumta në sistemin indo-europian, i cili për më tepër ka ngritur një autoritet të panatyrshëm.

* Shpesh në studimet e tyre krahasuese, gjuhëtarë të shumtë, midis bazave të këtyre të dhënave kanë ngatërruar "gjuhët e lashta" dhe "gjuhët e vonshme". Kronologjia historike e secilës prej këtyre gjuhëve nuk është respektuar gjithmonë. Në të vërtetë secila gjuhë ka ndjekur një proces të gjatë zhvillimi dhe përparimi. Gjatë rrjedhës së këtij procesi ajo shpesh ka ndjerë (e gjendur para lëvizjesh të ndryshme popullsie) ndikime të shumta të huaja ose nganjëherë ndikime që lidheshin me një dialekt tjetër të së njëjtës gjuhë. Ky është rasti i njërës prej gjuhëve të fundit të arritura në Europë në periudhën pas Krishtit (midis shekullit II dhe IX, sipas rajoneve): pra, gjuha sllave. Pra përdorej herë pas here. Madje gjuha sllave është provë e së kundërtës, se ajo nuk është ndonjë gjuhë e mbijetuar nga ndonjë gjuhë indo-europiane. Krahasohet me gjuhën indo-europiane ndërkohë që kjo gjuhë ka përaferësi të shumta me indo-iranianen. Në rajonet e pushtuara sot nga Sllovenët, Serbo-Kroatët, Maqedonët dhe Bullgarët, banonin (përpara mbërritjes së këtyre popullsive të fundit sllave dhe bullgare) popujt autoktonë të zanafillës thrako-ilire (nga Adriatiku deri në Detin e Zi dhe nga Danubi deri në Epir). Kultura dhe gjuha sllave pa dyshim që e kanë ndjerë ndikimin e këtyre popujve thrako–ilirë, të cilët në pjesën më të madhe i kanë nënshtruar dhe të cilëve përveç kësaj u kanë asimiluar një pjesë të gjuhës, të riteve dhe zakoneve të tyre. Megjithatë vihen në pah gjuha

kelte dhe gjermanishtja (gjuhë më të lashta se sllavishtja) me gjuhën sllave. Disa sllavofilë gjithmonë përpiqen ta trajtojnë se është shqipja e cila ka bërë huazime të mëdha nga gjuha sllave, ndërkohë që kjo e fundit është shumë më e vonshme se gjuha shqipe: këto dy gjuhë i ndajnë dy mijë vjet; aq më tepër që gjuha sllave ka bërë huazime të mëdha nga gjuha ilire, gjuha e stërgjyshërve të Shqiptarëve! Që ka patur ndërfutje gjuhësore midis të gjitha këtyre gjuhëve të Europës është krejt normale madje e pashmangshme për arsye të kohërave që kanë kaluar dhe të fqinjësisë së këtyre popullsive të ndryshme. Por për fat të mirë që hamendësitë nuk merren si të sigurta dhe që nuk i vishet apriori lashtësia një gjuhe, ndërkohë që ajo nuk e ka këtë. Duhet të dish ta bësh me ndershmëri zgjedhjen midis asaj që është e lashtë dhe asaj që nuk është dhe asaj që mund t`i vishet një gjuhe dhe jo një tjetre. Për sa kohë që nuk do të përjashtohen nacionalizmat e tepruara dhe shovinizmat, shkenca dhe gjuhësia do të mbeten gjithmonë në rrugë pa krye.

* Përsa i takon gjuhëve të tjera indo-europiane po e fillojmë me gjuhën kelte, e cila ka dalë nga një rajon i supozuar se është ndër vatrat e para pellazgo-ilire (Aunietitz, Luzakë, Fusha e urneve, Hallstadt...) dhe që përfshihet midis Danubit të Sipërm dhe të Mesëm (Bavari, Zvicër, Austri dhe Bohemi). Ja përse gjuha kelto-galeze ka ruajtur karakteristikat gjuhësore të trashëguara nga pellazgo-ilirishtja e lashtë dhe më vonë etruskishtja. Shumë më vonë, Gjermanët, të cilët mbërritën nga vendet nordike, kanë sjellë prurjet e tyre gjuhësore. Por më pas, nga shekujt e parë të periudhës pas Krishtit madje edhe më vonë, të gjitha këto gjuhësi dhe gjuhët baltike kanë ndjerë një ndikim të trefishtë: atë të gjuhëve uralo-ugore (finlandisht, estonisht dhe Laponisht në Veri si dhe hungarisht në qendër); latinisht (madje greko-latine) dhe etruskishte në Jug dhe akoma më vonë atë të dyndjes së fundit të pushtuesve që vinin nga viset lindore dhe që flisnin gjuhë indo-iraniane, ndër të cilat gjuha sllave.

Pra Meje është munduar të përcaktojë vërtetësinë historike të gjuhës greke dhe të kuptojë etnogjenezën dhe etapat e ndryshme të përparimit

të saj. Fatkeqësisht ai ka synuar pikërisht zanafillën e saj dhe nuk ka mundur të përcaktojë me saktësi as popullin as gjuhën e lashtë të folur përpara shfaqjes njëherësh të Grekëve dhe të asaj që e quajnë indo-europiane. Pra ai është gjetur përpara një muri të pakapërcyeshëm për arsye të shumta. Përveç kësaj, ky qerthull ekziston ende meqenëse të gjithë gjuhëtarët pas tij (madje përpara tij) kanë rimarrë të njëjtat teza njëra pas tjetrës qysh prej më shumë se një shekulli dhe të mbështetur gjithashtu nga disa historianë të tjerë dhe arkeologë bashkëkohorë. Ja pra cilat janë gabimet.

■ Kokëfortësia e tyre për të mos njohur vërtetësinë historike të Pellazgëve dhe përjetësinë e gjuhës së tyre, të cilën ata e besojnë të "zhdukur", por që përvijon përmes shqipes së sotme nëpërmjet Ilirëve, Thrakëve, Frigjianëve, Etruskëve, Ligurve dhe të tjerë akoma. Ky mosbesim, kjo mungesë vullneti, ky indoktrinim i përjetshëm, kjo verbëri e panatyrshme ose ky ngulmim për të ndjekur pista të gabuara, jo vetëm që i kanë çoroditur brezat e hulumtuesve, por mbi të gjitha ka zmbrapsur shpalljen e së vërtetës. Për më tepër, ata nuk kanë marrë parasysh pohimet e shumta të autorëve antikë grekë, të cilët nuk kanë reshtur së thëni se vendi i tyre ka qenë i banuar nga Pellazgët "përpara mbërritjes së Helenëve" dhe se gjuha e këtyre Pellazgëve nuk ka qenë gjuha greke.

■ Meqenëse Pellazgët nuk kanë lënë dokumente të shkruara, meqenëse historia e tyre dhe ekzistenca e tyre nuk kanë qenë konkretizuar nga fakte të besueshme apo bindëse, ata në mënyrë të padrejtë e kanë trajtuar se bëhet fjalë për një popull me zanafillë të papërcaktuar, madje një emër gjenerik që emërton një popull të zhdukur, i cili është zhdukur pa lënë asnjë gjurmë.

■ Ky është gabimi fatal i tyre, pasi gjurmë të ekzistencës së tyre janë të shumta por duhen kërkuar madje edhe ndër poemat epike, në tekstet antike, rrënojat arkeologjike (ndërtimet ciklopike të quajtura pellazge, pelargikon apo mur rrethues parahelen i Athinës, megaronët e mbiquajtur mikenianë etj.) legjendat dhe mitet parahelene, qytetërimet parahelene të mbiquajtura "mikeniane, kretase dhe egjease".

■ Gjurmët e tyre rigjenden në emrat e shumtë të perëndive dhe të

heronjve legjendarë dhe mitikë, ndër ata të Iliadës dhe Odisesë dhe që nuk shpjegohen aspak nga gjuha greke por vetëm nga gjuha e sotme shqipe.

■ Rigjenden gjurmë të tyre në toponime të shumta të një pjese të madhe të Europës (nga Pirenej deri në Detin e Zi dhe nga Danubi deri në Detin Egje, pa harruar Iberinë, Azinë e Vogël, Qipron dhe "Palestinën" që e ka marrë emrin e saj nga Pellazgët, të quajtur "Peleshtim" nga Hebrenjtë). Në lidhje me këtë shohim studimet e shumta dhe përputhjet gjuhësore të kryera në veprën që keni në dorë.

■ Rigjenden gjithashtu gjurmët e tyre në gjuhë të ndryshme që kanë bërë huazime në pellazgjishten e lashtë. Përveç gjuhës shqipe gjuhë e dalë drejtpërdrejt nga Thrako-Ilirët me zanafillë pellazge, gjuhë që ka ruajtur një fond të rëndësishëm gjuhësor të kësaj idiome të vjetër pellazge janë ato gjuhë popujt e të cilëve janë shpërndarë dhe "izoluar" në dy skajet e Europës. Ky largim nga vatra zanafillore (ballkano-danubiane) dhe mbi të gjitha izolimi shpesh ndër malësi të thella (streha natyrore kundër hyrjeve të huaja), i ka bërë të mundur këtyre gjuhëve të ruajnë gjatë më shumë se njëzet e pesë shekujsh një fond shumë të madh gjuhësor të kësaj pellazgjishteje të lashtë: gjuha baske në Perëndim, armenishtja, rumanishtja dhe disa gjuhë të Kaukazit në Lindje.

■ Gabimi më i rëndë është se kanë izoluar etruskishten, për arsye të mungesës së hulumtimeve të thelluara, analizave bindëse dhe përputhjeve apo përqasjeve gjuhësore me shqipen e sotme. Megjithatë të gjithë autorët antikë klasikë (shekulli V para Krishtit) me përjashtim të disa autorëve kryeneçë dhe gjithsesi më të vonshëm, ndër të cilët Dionisi i Halikarnasit (vdekur në vitin 8 para Krishtit), kanë pohuar të qenët nga një trung etnik dhe gjuhësor të Pellazgëve dhe Tirrenëve (Tirsenë, Tursanë, Turshas dhe së fundi të quajtur Tuskis ose Etruskë). Në të vërtetë kjo gjuhë ka përafërsi të shumta gjuhësore me gjuhën shqipe, e cila arrin të dekriptojë pothuajse dyqind e pesëdhjetë fjalë etruske (cf lista jo e plotë).

■ Përveç Etruskëve rigjenden etni të tjera pellazge në një hapësirë të stërmadhe gjeografike. Si për mrekulli ato kanë lulëzuar në të gjitha

vendet ku kanë banuar, duke lënë emra të shumtë vendesh (toponime) malësish apo lumenjsh (oronime), etj. Përveç kësaj të gjithë emrat e fiseve pellazge janë të shpjegueshme falë gjuhës shqipe: Lelegët, Karianët, Lisianët, Ligurët, Trojanët, Kretasit, Thrakët, Frigjianët, Etruskët, Filistinët, Ilirët, Dalmatët, Molosët, Pelagonët, Maqedonët, Dakët, Getët etj. Në lidhje me këtë janë shpjegimet e ndryshme të paraqitura në leksikologjinë e veprës që keni në dorë.

Për arsye të shkëputjes së shpeshtë të Pellazgëve nga Etruskët, Ligurët, Frigjianët, Trakët, Ilirët, Shqiptarët dhe të gjithë popujve midis tyre, Historia dhe Gjuhësia kanë shkuar në udhë të gabuar. Prandaj pothuajse nuk janë bërë përqasje apo përputhje gjuhësore midis të gjitha këtyre gjuhëve dhe gjuhës së sotme shqipe si dhe me gjuhë fqinje, të tilla si gjuha baske, armene, rumune dhe disa gjuhë të Kaukazit.

Pellazgo-shqipja dhe latinishtja

Përpara se të flasim për gjuhën latine dhe ndërfutjen e saj në procesin qytetërues të Perëndimit, unë do të kujtoja shkurtimisht historinë para-romake të Italisë dhe të Latiumit, territor i vogël, i cili për Romën ishte qendra shoqërore-kulturore dhe politike dhe ku më vonë do të zhvillohej kultura e madhe latine, e cila arriti të përhapej në të gjithë Italinë, madje në Europën Perëndimore.

21. 04. 753 para Krishtit është data legjendare e themelimit të qytetit të Romës: Romulus, pasi eliminoi vëllain e tij Remus, u bë mbreti i parë i Romës. Gjithsesi duke nisur nga shekulli XVIII gërmimet arkeologjike dëshmojnë se Latiumi kishte qenë i banuar qysh nga mijëvjeçari II. Zona e Mont Palatinit ishte e banuar të paktën qysh nga shekulli X para Krishtit. Në një fshat të gjendur në të njëjtën zonë, përveç të tjerave arkeologët kanë zbuluar kasolle primitive dhe disa varre që datojnë nga shekulli VIII para Krishtit, ku mund të ketë qenë vetë vendi ku Romulus themeloi qytetin e tij.

Por disa pohojnë se janë Etruskët, ata që në të vërtetë e kanë themeluar Romën. Ata do të kenë bashkuar fshatrat e kodrave fqinje

dhe do të kenë ndërtuar murin e parë që do të ketë shërbyer si mur rrethues i fortifikuar. Kjo hollësi ka një rëndësi të madhe kur dihet se Etruskët, ashtu si edhe Pellazgët, ishin ndërtues të talentuar dhe ishin të njohur nga Grekët me emrat Tursanes, Tirsenë (emër i shndërruar në Tirrenë, Tirrenianë, Tuskis, Toskanë, Etruskë dhe më në fund Toskë, emërtimi i Shqiptarëve të jugut), emër që shpjegohet nga fjala shqipe Thurrës, që rrjedh nga folja thur, end. Kjo provon se Etruskët ishin ndërtues me famë të mureve të mëdha që rrethonin qytetet e tyre të fortifikuara ashtu si ato që ndërtuan (Greqi, Azi e Vogël, Kretë, Itali, Lindja e Afërme ndër të cilat Palestina dhe Judea) vëllezërit e tyre të së njëjtës racë disa shekuj më parë, Ciklopët ose të quajtur ndryshe Pellazgë. Përveç kësaj emri Romulus shpjegohet gjithashtu nga dialekti geg i Shqipërisë së Veriut "rromulak" (në dialektin toskë = rrumbullak) dhe më gjerë d.m.th "ai që ka kokë të rrumbullakët", çfarë në gjuhën moderne dhe shkencore përkthehet me brakicefali, d.m.th. ai që ka kokën sa të gjatë aq edhe të gjerë, pra të rrumbullakët. Në të vërtetë kjo është një nga karakteristikat antropologjike të europianëve të parë dhe ajo e shqiptarëve të sotëm, një nga popujt ku treguesi cefalik (> 85) është më i larti i Europës dhe për më tepër me një tendencë hiperbrakicefale dhe planokcipitale.

Në lidhje me këtë zanafillë pellazge apo pellazgo-ilire shënojmë që disa autorë antikë, ndër të cilët Tit Livi (Libri I/III) dhe Dionisi i Halikarnasit (Antikitete, Libri I/XXVIII, 7) kanë cituar emrin Gegania ose Gegan që emërtonte një fis aleat të Albanëve (krahasuar me Alb, Alp, Alpes, Albëni, Arbëro, Albanie, Albanopolis, Albion, Alb Gjatoshi, Albe fucentia, Albensis dhe Albens në Francë). Mirëpo është e qartë se ky emër Gegan, Gegania është i ngjashëm, pse vetëm identik, me emrin që edhe sot i jepet Shqiptarëve të Veriut, të cilët quhen Geg, Gega, Geganët, Gegët. Bëhet fjalë për një provë plotësuese të ekzistencës së Pellazgëve në Itali.

Do t'i kthehem për një moment historisë zanafillore, madje legjendare të Romës antike. Është fjala për legjendën e Eneas, hero

trojan i trungut pellazg (në të vërtetë është fjala për një histori parahelene të shndërruar në shekullin VIII-VII nga kolonët e parë grekë të Azisë së Vogël) dhe biri i Ankizit dhe perëndeshës Afërditë (Venusi romak). Homeri në Iliadë nuk e përshkruan Enean si një hero të jashtëzakonshëm. Në Iliadë është Poseidoni që profetizon se ai dhe pasardhësit e tij do të mbretërojnë mbi Trojanët. Pas Homerit, Helanikosi i Mitilenës e zhvilloi më tej legjendën, sipas së cilës Enea kapërceu Helespontin dhe pushtoi perëndimin europian. Katër shekuj më vonë Virgjili e rimerr këtë temë duke e romanizuar. Por është historiani grek Time, i cili një shekull pas Helanikosit pohoi se qyteti i Laviniumit ishte themelimi i parë i Eneas në Itali. Ka të ngjarë që në këtë epikë Albi Gjatoshi rivendikoi zanafillën trojane të mbretërve të tij të lavdishëm, ndër të cilët Askanji, biri i Eneas dhe themeluesi i qytetit, rival i Romës. Por krenaria kombëtare e detyron Romën të përfitojë duke e mbështetur historinë e saj në atë të popujve legjendarë parahelenë që disa kanë arritur ta trajtojnë si grekë. Bëhet fjalë në këtë rast për historinë e Evandrit, Pelasgu i Arkadisë dhe bir i Hermesit (apo me një babai njerëzor) dhe i nimfës arkadiane Nikostrata, të cilën Romakët e quanin Karmenta, Karmentis. Ky hero arkadian është pra në zanafillë të kësaj legjende, e përcaktuar për të krijuar një lidhje trungu midis Romës dhe Greqisë. Tit -Livi (Libri I) dhe Plini (VII, 57/58) pohojnë se janë Pellazgët të udhëhequr nga Evandri, ata që sollën në Latium njohuritë për gërmat e zbuluara të alfabetit, që siç thonë ata "i habitën këta popuj".

Shtatë mbretërit që vijuan në Romë përpara shpalljes së Republikës në vitin 509 (para Krishtit) ishin si më poshtë:

- Romulus	753 - 715
- Numa Pompilius, i Përkushtuari	715 - 672
- Tullus Hostilius, Luftaraku	672 - 640

Nën mbretërimin e këtij u shpall lufta kundër Albit, prej nga është marrë episodi i famshëm i "Horaci dhe Kuriasët".

- Ankus Martins	640 - 616
- Tarkini i Lashti	616 – 578

- Servius Tulius 578 - 534

- Tarkini, i Mrekullueshmi, mbreti i fundit etrusk : 534 - 509 para Krishtit.

Duke filluar nga data e fundit, vendosja e Republikës në Romë (viti 509 para Krishtit), kur me të vërtetë fillon historia e popullit romak. Kjo Republikë do të zgjatë rreth pesë shekuj (VI – I para Krishtit) e ndjekur nga Perandoria e parë Romake, e cila do të zgjasë gjithashtu pesë shekuj, deri në rënien e Perandorisë romake të Perëndimit në vitin 476 pas Krishtit. Por Perandoria e Lindjes do të rezistojë deri në rënien e saj në vitin 1450, çka do të shënojë fundin e Mesjetës.

Historia e gjuhës latine dallohet nga katër periudha të mëdha:

1) Periudha arkaike: shekulli III - I para Krishtit. Ajo ilustrohet nga shkrimtarët më të lashtë të njohur latinë: Plauti (rreth 254 -184), Enius (239 – 169), Terenci (rreth 190 – 159), Lucilius (180 – 102).

2) Periudha klasike; shekulli I para Krishtit, e përjetësuar nga Ciceroni (106 – 43 para Krishtit), Cezari (101 – 44 para Krishtit), Lukreci (98 – 55 para Krishtit) ...

3) Periudha perandorake apo pas-klasike; shekulli I dhe II pas Krishtit, e ilustruar nga shkrimtarët e mëdhenj të tillë si Tit – Livi (64/ 59 deri 17 pas Krishtit), Virgjili (70 para krishtit deri 19 pas Krishtit), Horaci (65 para krishtit deri 8 pas Krishtit), Seneka filozofi (rreth 4 para Krishtit deri 65 pas Krishtit), Lukani (39 - 65), Juvenal (60 – 140), Taciti (55 – 120), Apule (120 - 140)....

4) Periudha e vonshme dhe ajo pas Krishtit: qysh nga fillimi i shekullit III pas Krishtit e ilustruar nga Tertuliani (rreth 155 - rreth 220), Jeronimi (rreth 347 – 420), Augustini (354 - 430 /), Amnien Marcellini (rreth 340 – 400 /), Prudenca (348 – rreth 415 /).

Rreth shekullit VI të erës sonë gjuha latine ndryshoi së tepërmi në sistemet gjuhësore: kjo është lindja e gjuhëve romane të quajtura gjithashtu gjuhë neolatine: italisht, frëngjisht, spanjisht, portugalisht, romanike dhe rumune. Latinishtja mbeti një gjuhë e dijetarëve si dhe e fesë katolike deri në shekullin XVIII.

Megjithatë latinishtja në fillim ishte një gjuhë "e folur". Ajo ka qenë përcaktuar si "gjuhë e fshatarëve, tregtarëve apo e ushtarëve", d.m.th. e aftë për të emërtuar më mirë konkreten sesa abstrakten. Në zanafillë të latinishtes ishte vetëm dialekti i Romës (sermo urbanus), i cili përballej me "sermo rusticus" të territoreve fqinjë (Lanuvium, Preneste ose Faleri). Ajo u shtri hap pas hapi në të gjitha vendet përreth dhe pastaj në të gjithë Italinë dhe më në fund përthithi të gjitha gjuhët e tjera të vendit (etruskishten, gjuhët e mbiquajtura italike, mesapishten etj.). Deri në atë moment kjo gjuhë kishte shërbyer për formulat e tipit juridik dhe praktik. Përveç kësaj emërtimi i saj si "gjuhë e fshatarëve" verifikohet nga mbisundimi e jetës rurale në fjalorin latin. Gjuha bëhet abstrakte vetëm nën ndikimin e filozofëve dhe shkrimtarëve të tillë si Ciceroni, Lukreci ose Seneku.

Vetëm nga shekulli III para Krishtit u shfaq parchemin*) apo "letra e Pergamenit" (Pergamena). Kjo ishte lëkura e dhisë, dashit apo viçit (nga vjen fjala velin) dhe duke filluar nga këto filluan të prodhoheshin librat, falë këtij materiali të fortë dhe rezistent: ato lidheshin fletë-fletë dhe nuk bëheshin rulo si më parë. Kjo është lindja e librit që shfletohej, krejt ndryshe nga volumen (ruloja e dorëshkrimit) e cila çmbështillej.

Teksti i parë latin është një mbishkrim i gjendur në Praenesta (Palestrina) mbi një fibul prej ari, e cila daton nga fundi i shekullit VII para Krishtit. Kjo është shfaqja e parë e ekzistencës së një të folure latine në Gadishullin Italik. Zhaklin Danzhel (Historia e gjuhës latine, PUF 1995) në lidhje me këtë pohon: kjo është dhënë [procesverbali i parë zyrtar i ekzistencës së latinishtes] nga një mbishkrim i cili u gjet në një fibul të quajtur fibula e Prenestës, nëse kjo kryevepër dhe dëshmia e shkruar e saj nuk janë të rreme... Ky është një fakt që tregon se latinishtja e ka arritur statusin e të folurit të saj mbizotërues vetëm rreth shekullit III para Krishtit, në momentin kur uniteti italik është duke u realizuar, falë pushtetit centralist të Romës".

*) *Lëkura e kafshëve e përpunuar në mënyrë të veçantë si një lloj materiali për të shkruar.*

Në të vërtetë tekstet më të vjetra letrare datojnë vetëm nga shekulli III para Krishtit. Livius Andronikus (280 – 205 para Krishtit?) më zanafillë greke, i cili kishte arritur shumë i ri në Romë, gjatë marrjes së parë të Tarentës, ishte i pari që ka shkruar në gjuhën latine (paraqitja e parë e një drame në vitin 240). Naevius, me zanafillë romake ka të ngjarë të këtë qenë autori i dytë i lashtë që ka shkruar në latinisht në vitet 235 – 204 para Krishtit. Është fjala për njerëz të famshëm të panjohur! Latinishtja është një gjuhë e lakueshme, e karakterizuar nga lidhjet midis emrave, mbiemrave dhe përemrave, të cilat brenda një fraze apo gjymtyrëve të një fraze sipas rastit janë të shprehura nëpërmjet mbaresave (mbaresa të ndryshme të fjalëve). Gramatika latine përfshin tri gjini (mashkullore, femërore dhe asnjanëse), dy numra (njëjës dhe shumës) dhe rasa të shumta: emërore (emri), kallëzore (plotësuesi i kundrinës), gjinore (plotësues i emrit), dhanore (plotësues përcaktori) dhe thirrore.

Alfabeti i epokës klasike përfshin njëzetenjë (21) germa: A, B, C, D, E, F, G, H, I, K, L M, N, O, P, Q, R, S, T, V, X, dhe dy germa të tjera të shtuara më vonë (shekulli I para Krishtit) për transkriptimin e greqishtes, në këtë rast Y dhe Z. Duhet shënuar se germa U dhe W janë shënuar si V dhe germa J si I. Alfabeti latin si edhe numrat romakë janë huazuar nga Etruskët, të cilët i kanë paraqitur duke filluar nga Azia e Vogël, Egjeu ose Ballkani. Në të vërtetë, sipas legjendës dhe disa autorëve latinë, ndër të cilët Tit Livi dhe Plini, alfabeti është futur në Itali nga Pellazgu i Arkadisë i quajtur Evandri. Dominik Brikel na thotë në lidhje me këtë (Pellazgët në Itali, Shkolla franceze e Romës/ pallati Farnez 1984, faqe 447): "Gjuha latine do të ketë qenë formuar, midis të tjerave, nga prurjet eoliane dhe futja e tyre do të jetë bërë nga Arkadiani Evandri. Ky saktësimi i fundit mund të na habisë, të na befasojë meqë jemi mësuar të dallojmë dialektin arkadian nga ai eolian".

Ne e dimë shumë mirë se dialekti arkadian, i quajtur gjithashtu arkado-qipriot, është idioma më e lashtë e Greqisë arkaike. Nuk është e mundur të mos dihet se Arkadia ka qenë në Greqi një nga vatrat e

qytetërimit pellazg së bashku me Argosin Pellazg si dhe Tesprotë. Pikërisht dy nga vendet e shenjta më të famshme parahelene dhe pellazge ishin ato të Dodonës në Tesproti dhe ai i Malit Lice në Arkadi. Është pranuar njëzëri nga dijetarët modernë dhe të gjithë autorët antikë se Pellazgët ishin një popull parahelen, i cili ka lënë gjurmë të shumta qytetëruese në atë që do të bëhej Greqi (gjuhë, kulturë, fé...). Në antikitet Arkadianët trajtoheshin si banorët më të lashtë të Greqisë. Këta Pellazgo-Arkadianë, të mbrojtur nga malet e tyre të pamposhtura, do t'i shpëtojnë mbizotërimit dorian dhe ndryshimeve të mëdha kulturore dhe gjuhësore që pësoi pjesa tjetër e Greqisë. Së fundi sipas legjendës, Zeusi (pellazg dhe Dodonas, cf Iliada XVI, 235) do të ketë lindur në malin Likaos (Lice). Legjenda shton se Likaosi, mbret i Arkadisë ishte biri i Pelasgos, mbret i Argosit.

Sidoqoftë, është e qartë se në planin praktik, alfabeti latin rrjedh nga ai i Etruskëve, i cili është pak ndryshe nga ai i Grekëve (alfabeti kalkidian): - ruajtja e Q , H, digamës (f/8 etruske) etj. Por gjithmonë ekziston polemika rreth këtij alfabeti, qoftë i zanafillës etruske apo kalkidike. Në të vërtetë helenofilët pohojnë se Etruskët i kanë huazuar nga kolonët grekë të Kumës në Kampania, i cili iu është përcjellë atyre nga Kadmos Fenikasi, dhe jo nga Pellazgët. Asgjë nuk provon se ky alfabet e ka zanafillën e tij nga Fenikasit, të cilët përkundrazi do ta kenë përshtatur gjuhën e tyre nga alfabeti i lashtë arkado-egjeas. Ende edhe sot janë të shumtë ata që mendojnë se alfabeti fenikas rrjedh drejtpërdrejt nga një shkrim proto-sinaitik. Megjithatë për shkak të provave bindëse mbetet mister e gjithë kjo temë. Por disa hamendësime provash nuk janë më pak sqaruese.

Pjesa më e madhe e gjuhëtarëve pohon se latinishtja së bashku me oskishten dhe umbrianen i përket grupit të mbiquajtur "italik", i cili i është bashkangjitur grupit italo-keltik të familjes të quajtur në përgjithësi indo-europiane. Të tjerë e trajtojnë se gjuha osko-umbriane dhe latino-faliske janë dy degë të ndryshme të grupit italik. Por edhe aty kundërshtitë vazhdojnë. Fatkeqësisht ky grup "italik" ngjan disi me

një depo të çuditshme ashtu si përdoret pjesa tjetër, grupi indo-europian . "Klasifikime" të shumta janë të diskutueshme. Oskishtja (gjuha e Samnitëve) dhe umbriania nuk janë njohur mirë për arsye të numrit të paktë të teksteve të besueshme që lidhen me të. Në të vërtetë i vetmi tekst i vërtetë i shkruar në umbrianisht, që është një nga gjuhët më të lashta të Italisë (shpesh e krahasuar me gjuhën ligure pellazge) na vjen nga tabelëzat iguvine (shtatë tabela prej bronzi të zbuluara në Gubio, në vitin 1444). Por këto tekste të shkruara me germa etruske (ato më të lashtat) dhe me germa latine (për pjesën tjetër) datojnë nga fundi i shekullit III para Krishtit (midis 200–70). Pra ato janë shumë të vonshme dhe të dala nga një periudhë dhe rajon ku latinishtja tashmë kishte qenë shumë në modë. Sipas Katonit, Umbrianët ishin një popull shumë i lashtë dhe kryeqyteti i tyre Ameria ishte themeluar 380 vjet para Romës, d.m.th. në vitin 1133 para Krishtit. Përveç kësaj, autorët antikë pohojnë se në Itali kishte dyzet e shtatë popuj të trungut umbrian. Zanafilla e dialektit venet është shumë e diskutuar, pasi një palë e klasifikojnë midis dialekteve ilire (versioni më i besueshëm) dhe të tjerë e përfshijnë në grupin italik apo italo-keltik.

Shënojmë se gjuhë të shumta të Italisë janë të zanafillës pellazge apo thrako-ilire, ndër të cilat të folura nga Etruskët, Ligurët, Japigët, Mesapët, Pisenët, Daunianët, Peusetianët, Konët, Pelinjianët, Volskët, Venetët madje Sikulët. Venetët dhe Sikulët kanë qenë gjithashtu të një trungu me Mesapët dhe Ilirët. Sipas Filistosit Sikulët ishin me zanafillë Ligure. Por meqë pothuajse asnjë studiues nuk ka bërë as edhe përqasjen më të vogël me pellazgjishten e lashtë dhe akoma më pak me etruskishten apo thrako-iliren, gjuha ligure mbetet e izoluar ose e një trungu me gjuhën kelte. Përveç kësaj ekzistojnë fjalë të shumta pellazgo-ilire në gjuhën umbriane. Disa emra të vendeve provojnë se tranzicioni midis Umbrianëve dhe Etruskëve është bërë midis dy popujve të një trungu. Qyteti umbrian Teuta u bë Piza etruske. Disa e pranojnë zanafillën ilire të emrit "Teuta". Shembuj të këtij lloji janë të shumtë.

Në të vërtetë, duket mirë se Etruskët do të kenë arritur në vend, në

Itali, kur tashmë aty ekzistonin popuj të zanafillës pellazge ose ilire. Përveç kësaj Etruskët me mbërritjen e tyre nuk kanë hasur asnjë armiqësi nga ana e popullsisë vendase. Ky paqësim është kuptimplotë dhe midis argumenteve të tjerë bindës provon se ekzistonin lidhjet etno-gjuhësore midis Etruskëve, Ligurve, Umbrianëve dhe popullsive të lashta të trungut pellazg. Historia e të gjithë këtyre popujve është e përzier me atë të Pellazgëve të Italisë së Lashtë. Antagonizmat, armiqësitë dhe luftërat filluan shumë më vonë, me ngritjen e pushtetit, përzmadhimin e grindjeve për hegjemoni dhe zhvillimin e lëvizjeve të popullsive.

Përse nuk janë bërë përqasje midis gjuhës etruske, ligure, umbriane ose ilire? Në përgjithësi gabimi u takon gjuhëtarëve që e kanë parë gjuhën umbriane (tekstet umbriane të zbuluara datojnë vetëm nga shekulli II para Krishtit) vetëm si një gjuhë të përafërt me latinishten. Ndërkohë që latinishtja e shkruar u shfaq më vonë (e shumta rreth shekullit III madje shekulli II para Krishtit), pothuajse njëqind vjet para zbulimit të dokumenteve umbriane. Në këtë epokë pjesa kryesore e gjuhës umbriane ishte pothuajse e latinizuar. Përveç kësaj pjesa më e madhe e këtyre gjuhëtarëve nuk kanë bërë asnjë përqasje midis gjuhës ligure, etruske dhe umbriane.

Ja pra në çfarë ngatërrese apo mishmashi kanë punuar dhe ende punojnë gjuhëtarët, për më tepër me një njohje jo të mirë dhe të pamjaftueshme të pellazgjishtes së lashtë dhe të gjuhës shqipe dhe të një mangësie të plotë të lidhjeve me këto gjuhët e fundit si dhe ato të grupit të mbiquajtur italik.

Ja mendimi i Enriko Kampanile (Gjuhët indo-europiane, Cns Editions, 1997): "Pra për shumicën e gjuhëve, analiza dialektologjike dhe objektivisht e pamundur, gjë që ndodh për shkak të pamjaftueshmërisë së materialeve ose numrit të paktë të interpretimeve gjuhësore dhe interpretimeve bindëse të teksteve që rrjedhin prej kësaj ... Përkundrazi ne nuk shohim asnjë mundësi konvergjence në Itali nga pikëpamja historike, të paktën që supozohet për kontakte shumë të lashta ndër-etnike që do të kenë patur për themel vetëm përafërsitë

gjuhësore; atëherë do të ishte fjala për një rreth të vërtetë vicioz... Latinishtja dhe dialektet italike, për të cilat kemi folur deri tani, përbëjnë në të vërtetë polet më skajore dhe më të njohura të një realiteti gjuhësor shumë më kompleks, meqë në Italinë qendrore ne gjejmë dëshmi të tjera gjuhësore, që janë ndërfutur ndryshe nga pikëpamja gjeneanologjike në kuadrin e një unitetit italik".

Këto pikëpyetje të fundit e shpjegojnë më së miri brishtësinë e dogmës indo-europiane. Në të vërtetë, qysh prej pothuajse njëqind vitesh, gjuhësia moderne sillet rreth së njëjtës pikë, nga ky i famshëm "rreth vicioz" (cf Enriko Kampanile, paragrafi i mësipërm).

Pjesa më e madhe e gjuhëve, për të cilat thuhet të jenë indo-europiane, janë relativisht më të vonshme dhe dokumentet të cilat përdorin specialistët datojnë për latinishten nga shekulli III madje për shekullin II para Krishtit për gjuhë të tjera, të tilla si gjuha keltë dhe gjermanike edhe më të vonshme, për greqishten nga fillimi dhe mesi i shekullit VI para Krishtit dhe së fundi për gjuhën sllave dokumentet e para të shkruara datojnë vetëm nga shekulli IX pas Krishtit. Vetvetiu, sa më shumë tekste të lashta që studiohen dhe që përqasen me fillimin e erës sonë aq më shumë ka shans të rigjenden gjuhë të ngjashme ose që të kenë pika të përbashkëta sa në planin gramatikor aq edhe në atë leksikor. Përveç disa përjashtimeve të rralla (gjuhët e zhdukura shumë herët si etruskishtja apo të mbetura të izoluara ndaj përzierjeve si gjuha shqipe, baske dhe disa gjuhë të Kaukazit), stuhitë e kohërave, afërsitë gjuhësore, lëvizjet migruese, kolonizimet apo përzierjet etnike, nga njëra anë i kanë larguar pak a shumë këto gjuhë nga fondi i tyre i lashtë gjuhësor dhe nga ana tjetër i kanë përqasur me njëra tjetrën. Megjithatë përhapja e "gjuhëve të qytetërimit" (në thelb gjuha greke dhe latine) ka qenë e tillë sa që gjuhë të shumta kanë përfunduar duke i asimiluar dhe integruar në kontekstin e tyre gjuhësor rajonal. Idiomave të lashta iu mbivendosën këto gjuhë të reja, brenda një intervali ku një pseudo-nënshtresë tashmë kishte pësuar të njëjtin proces që konsistonte në asimilimin e gjuhëve vendase. Më pas këto gjuhë kanë evoluar në

hapësirën e tyre shoqëroro-kulturore. Pra të gjitha mendimet janë përqendruar në këto ngjashmëri gjuhësore dhe të gjitha studimet dhe hulumtimet janë bazuar mbi dy gjuhët e folura në rajone tashmë të latinizuara apo të romanizuara mjaft vonë. Ky ndërlikim i pazbërthyeshëm i këtyre gjuhëve dhe radhitjet e ndryshme të tyre, ka shumë të ngjarë të kenë çoroditur shumë gjuhëtarë. Si mundet që në këto kushte të projektosh në një të kaluar të largët të gjuhëve, të cilat kishin përfunduar së qeni në një nënshtrat të lashtë dhe që të gjitha kanë përfunduar duke përngjarë me njëra tjetrën? A është aty zanafilla e kësaj indo-evropianeje të kuptuar keq?

Gjenden vetëm toponime, oronime, antroponime të lashta, të cilat kanë mundur t'i rezistojnë përpunimeve të ndryshme për arsye të lëvizjeve të popullsive, pushtimeve apo kolonizimeve paqësore (rrugët tregtare, qytetet e krijuara nga dyndjet e emigrantëve...). Ky është një nga burimet e hulumtimeve që është shfrytëzuar në veprën që keni në dorë. Le të kthehemi tashmë te gjuha latine, objekti kryesor i këtij kapitulli.

Është interesante të vëresh se në studimet e tyre mbi zanafillën e gjuhës latine, pjesa më e madhe e gjuhëtarëve e pranojnë që bëhet fjalë për një gjuhë më të vonshme dhe pohojnë se është e vështirë, që nga fillimi e deri në fund, nga mungesa e teksteve themeluese dhe themelore. Megjithatë janë të shumtë ata, të cilët ende nuk e kanë pranuar se bëhet fjalë për një gjuhë hibride që i ka mbështetur themelet e saj në gjuhë të shumta, midis tyre gjuha etruske, greqishte dhe gjuhë të mbiquajtura italike, pa dyshim të zanafillës pellazge. Në të vërtetë Latinët jetonin pranë Pellazgëve, Etruskëve të Kampanias, Volkëve të jugut të Latiumit (Pellazgë) dhe Grekëve të Kumës.

Zhaklin Danzhel në librin e saj të përmendur më lart pohon: "Rreth shekullit VI para Krishtit, të dhënat fonetike dhe morfologjike që përbëjnë bazën e kodit të gjuhës, paraqesin një nivel realizimi që është larg të qenit e arritur, sistemi gjuhësor përmban tashmë thelbin e invarianteve të saj strukturore... Në mënyrë të përgjithshme, qysh nga fillimi i shekullit VI para Krishtit deri në shekullin III mbizotëron përshtypja e përgjithshme

se evolucioni ndodh ngadalë me qëllim që të përforcojë strukturat... Vetëm është e udhës të nënvizojmë se deri në fund të shekullit IV para erës sonë, monumentet e shkrimit latin mbeten të rralla dhe shpesh të shkurtra, kjo ngase që do të jenë zhdukur ose asokohe shkrimi nuk do të ketë qenë një teknikë e përhapur, siç e saktëson F. Desborde. Në të vërtetë duhet pritur shekulli III para Krishtit që tërësia epigrafike arkaike të bëhet më e pasur dhe e rrjedhshme".

Dionisi i Halikarnasit (Libri I, XC) nga ana e tij pohon: "Romakët flasin një gjuhë e cila nuk është as krejtësisht barbare as plotësisht greke, por një përzierje e këtyre të dyjave, ku mbizotëruese është gjuha eoliane". Duhet shpjeguar kjo pika e fundit e ngritur nga Dionisi. Gjuha eoliane është një nga katër dialektet e para-greke ndër të cilat arkado-qipriotja duket më e lashta. Në të vërtetë dialekti eolian i bashkëngjitet këtij dialektit të fundit. Së fundi theksojmë se Evandri pellazgo-arkadian fliste pellazgjishten e lashtë të Arkadisë. Ja përse Dionisi e ngatërron dialektin eolian me atë arkadian. Kjo gjithashtu i përgjigjet pyetjes së Dominik Brikel në paragrafin e përmendur më lart.

Së fundi, për të përfunduar këtë histori, ja edhe mendimi i A. Mejesë (Skicë e historisë së gjuhës latine, Klicksieck, Paris 1966/177): "Nëse përjashtohen monumentet e para që i japin pak të dhëna gjuhëtarit, latinishtja arrin të dëshmohet vetëm nga fillimi i shekullit III para Krishtit ... Historia politike e Romës dhe historia e qytetërimit romak, shpjegojnë historinë e gjuhës latine... Roma etruske ishte një qytet. Por pas prijësve etruskë drejtimin e morën latinët ruralë; Roma ka qenë për një kohë të gjatë kryeqyteti i këtyre fshatarëve dhe janë pronarët e tokave përreth Romës që vendosën latinishten romake, pozicion ndaj së cilit "latinishtja" pa dyshim i detyrohet pjesërisht asaj pjese që paraqet luhatjet dhe inkoherencat e vogla të formës... "Latinishtja" që u vendos, nuk ishte gjuha e një klase qytetare të kulturuar, ishte ajo e një aristokracie fshatare të aftë, e cila mori në zotërim një nyje rrugësh dhe që pushtuan një qendër qytetërimi... Kur flitet për latinishten, atëherë mendohet për gjuhën e Romës; është bërë e

zakontë të njëjësohen nga pikëpamja gjuhësore, të dy termat, termi latin dhe ai romak; dhe sipas këtij zakoni është emri "latin" që mbizotëroi". Së fundi në lidhje me këtë shtoj se Dionisi i Halikarnasit në epokën e tij pohonte se "shumë historianë e kanë trajtuar Romën si një qytet etrusk".

Pas gjithë këtyre analizave do të ishte e tepërt të pohoje siç e sugjeron Meje, se gjuha latine është krijim i një kaste të pasur shfrytëzuesish bujqësorë (aristokraci agrare), të cilët e pushtuan Romën pasi kishin dëbuar prej aty Etruskët. Romakët për tu zhvilluar dhe për tu dalluar nga paraardhësit e tyre të shquar etruskë, do të kenë krijuar këtë dialekt, i cili më pas u bë gjuha zyrtare e Romës, pastaj gjuhë rajonale dhe më pas kombëtare me atë prestigj që pati më vonë në të gjithë Europën.

Ja pra, kjo ishte shkurtimisht etnogjeneza e gjuhës latine.



1



2



3



4

Sipas Haberlandt (1917): 1)Djep i Mirditës (Veri).
2) Djep i Shkodrës.
3) Djep i Vladit (Veri)
Sipas bartonit Nopsca (1925): 4) Djep i Mirditës

Pellazgo-shqipja dhe etruskishtja :

Fjalor etrusko-shqip dhe përputhjet gjuhësore

Gjuha etruske për disa gjuhëtarë mbetet gjithmonë e paqartë. Është thënë gjithçka pro dhe kundër në lidhje me këtë. Një palë e trajtojnë si një gjuhë jo indo-europiane apo para indo-europiane madje "peri-indo-europiane", ndërkohë që të tjerë e cilësojnë si indo-europiane apo e hamendësuar indo-europiane. Gjithsesi, për hir të së vërtetës, duket se ekzistojnë të gjithë llojet e "përbërësve" (autorë antikë, studime të ndryshme të kohëve tona: arkeologji, antropologji, toponimi...), por "majoneza" nuk është zënë. Në fakt, tundimet e shumta të autorëve të ndryshëm modernë, shpesh bindës madje të saktë janë vërtitur rreth një pike për arsye të mangësisë së lidhjeve, kohezionit apo të barasvlerës midis tyre.

Secili prej tyre është mbyllur në kullën e tij të fildishtë, në dogmatizmin e tij apo mungesën e një bagazhi specifik të tij. Kështu nuk kanë patur mundësi ose nuk kanë dashur ta lidhin gjuhën etruske me këtë hapësirë gjuhësore parahelene (unë parapëlqej këtë term kundrejt termit para indo-europian). Në të njëjtën mënyrë nuk njiheshin lidhjet që ekzistonin midis gjuhëve anatoliane, etruske dhe pellazgjishtes së lashtë, e cila ka lulëzuar kudo në hapësirën mesdhetare, rajonin ballkano-danubian, Itali, Europën perëndimore madje deri në Kaukaz dhe në Azi. Shumë të vërteta të veçuara kanë dalë në lidhje më këtë temë, por pa arritur kurrë një përfundim të besueshëm, përputhës dhe koherent. Disa kanë përqasur etruskishten me lisianen, madje me gjuhën hitite por jo me pellazgjishten e lashtë, as me gjuhë të tjera që bashkëngjiten me të. Megjithatë kjo përqasje është krejt normale meqë bëhet fjalë për gjuhë të dala nga i njëjti brumë gjuhësor: gjuhë të quajtura anatoliane (gjuha kariane, lisiane, lidiane, frigjiane, gjuhë të përafërta me gjuhën hitite), trakishtja ilirishtja, gjuhë të mbiquajtura italike (mesapishte, daunisht, pieseniane, gjuhë të cilave iu bashkëngjitet gjuha

oske dhe ajo umbriane...) dhe shqipja e sotme.

Gjithsesi autorë të shumtë, ndër të cilët Trombeti, Ribeco dhe hitologu Hrozni, kanë bërë përqasje midis gjuhës hitite nga njëra anë dhe etruskishtes, lidianes dhe frigjianes nga ana tjetër. Por janë të rrallë ata që kanë bërë lidhje midis tyre apo aq më pak me pellazgjishten e lashtë, thrako-iliren dhe gjuhën e sotme shqipe. Hrozni (Etruskishtja dhe gjuhët hitite 1919) ka zbuluar tipare të shumta të përbashkëta midis gjuhës etruske dhe asaj hitite, të tilla si p.sh. prapashtesa "al". Ai përqas gjithashtu perëndinë etruske Kulsan me perënditë hitite Kulkes. Së fundi ai thekson se "Etruskët kanë ardhur në Itali nga një rajon që gjendej në fqinjësi të drejtpërdrejt me Hititët d.m.th. Azia e Vogël". Në lidhje me këtë ja se çfarë thotë Perikli Dukati (Problemi etrusk, Ernest Leroux, 1938): "Gjuhëtari C. Pauli historian orientalist, Prof. Cezare de Kara, arkeologët italianë Xhuzepe Pelegrini dhe Luçio Mariani, si dhe Fon Duhn, i cili hoqi dorë nga teoria e Nibur-it, ishin gjithashtu tradicionalistë, madje dhe antropologu Xhuzepe Serxhi, i cili shumë herë ka pranuar të qenët nga një trung të Etruskëve me Kretasit, Hititët dhe në përgjithësi popujt e Azisë së Vogël". Dukati është i të njëjtit mendim me ata tradicionalistë që pohojnë apo e ravijëzojnë zanafillën egjease apo anatoliane të Etruskëve në të njëjtën mënyrë si bëjnë të gjithë autorët antikë grekë, përveç Dionisit të Halikarnasit.

Por kjo mori popujsh, të cilët ishin veçse fise të dalë nga një trung i përbashkët etnik, ka frikësuar apo ka çoroditur shumë specialistë. Në të vërtetë këta të fundit janë përpjekur ta ndajnë të gjithë këtë magmë popujsh, duke u caktuar atyre gjuhë dhe kultura të shumta. Ata që deri tashmë e kanë parë këtë si të drejtë, për fat të keq nuk iu është vënë veshi. Udha pa krye në të cilën gjenden gjuhësia moderne dhe historiografia e Greqisë parahelene, në pjesën më të madhe është për shkak të këtij keqkuptimi mjeran dhe të të gjitha llojeve të dykuptimësive, pistave të gabuara apo hamendësive (personale apo në mënyrë të përbashkët dogmatike) të ngritura si të sigurta.

Nëse i referohemi të dhënave të transmetuara nga autorët më të

lashtë grekë, sipas të cilave Pellazgët kanë paraprirë mbërritjen e Grekëve, se Pellazgët dhe Tirrenët flisnin të njëjtën gjuhë "barbare" dhe se kishin dalë nga i njëjti trung etnik dhe se këta të fundit kishin zbarkuar në Itali duke ardhur nga Lidia rreth shekullit XIII para Krishtit (Hekate i Miletit, Helanikosi i Mitilenit, Herodoti, Tuqididi, duke cituar këtu më të shquarit) dhe nëse mbajmë parasysh përafërsitë e shumta gjuhësore që ekzistojnë midis gjuhës etruske, ilire, mesapiane dhe shqipes, atëherë çështja e zanafillës së Etruskëve as që duhej parashtruar. Ishte Dionisi i Halikarnasit, i cili pesë shekuj pas Herodotit dhe Helanikosit (ithtarë të zanafillës egjeane dhe lidiane të Etruskëve) shpalli se Etruskët nuk vinin nga asnjë vend tjetër dhe se ishin popull autokton. Kjo manovër e rremë u bëhej për tu marrë me sy të mirë nga aristokracia romane, me qëllim që t`i nxirrte se ishin pasardhës të denjë të Pellazgëve të lashtë, të cilët për më tepër ai i trajtonte si stërgjyshat e Grekëve. Qëllimi i pashprehur i Dionisit: Romakët dhe Grekët janë popuj vëllezër. Ja e vërteta. Përveç kësaj ai pohonte se "gjuha etruske nuk i ngjante asnjë gjuhe tjetër të njohur". Ne e njohim shumë mirë grackën e ndryshimeve dialektore. Po marr si shembull të vetëm atë të dy dialekteve të gjuhës shqipe: toskërishtja në jug dhe gegërishtja në veri. Në të vërtetë përpara Luftës së Dytë Botërore, dy shqiptarë analfabetë, njëri nga veriu dhe tjetri nga jugu kishin nevojë për ndihmën e një përkthyesi për tu marrë vesh! Gjithsesi, në të vërtetë është fjala për një gjuhë të vetme.

Pra është ky i pari shkaktar trazirash si dhe të gjithë këta që kanë pasur këtë mendim qysh prej pothuajse dy mijë vjetësh (cf. Kapitulli i rezervuar për Etruskët në volumin e ardhshëm që është për botim).

Përveç pohimeve të autorëve antikë grekë dhe përafërsive gjuhësore që ekzistojnë midis etruskishtes dhe gjuhës shqipe, një nga provat më të dukshme të zanafillës lidiane ose egjease të Etruskëve është zbulimi i mbishkrimeve të stelës së Lemnosit, ku vihet re një ngjashmëri e dallueshme midis gjuhës lemniane (idiomë egjeo-pellazge) dhe gjuhës

etruske. Ajo çfarë mbështet pohimin e Herodotit për sa i takon të qenit nga një trung midis Pellazgëve dhe Tirrenëve (Etruskët): Dionisin e Halikarnasit do të duhej ta hidhte poshtë!

Në faqet në vijim do të shohim ngjashmërinë befasuese midis fjalëve të shumta (afërsisht dyqind e pesëdhjetë fjalë) të gjuhës etruske dhe asaj shqipe. (Gjuha shqipe, siç e kemi nënvizuar edhe më lart, është gjuha e vetme në Europë që ka ruajtur pothuajse të paprekur fondin e saj të vjetër gjuhësor të dalë nga pellazgjishtja e lashtë).

Të gjitha fjalët etruske gjenden në listën në vijim (jo e plotë) që përbëhet nga ajo çfarë ka mbetur prej disa mbishkrimeve etruske (rreth 13 000, të cilat datojnë prej shekullit I para Krishtit) dhe që kanë mbërritur deri në ditët tona. Shpesh është fjala për tekste të shkurtra, të cilat kanë të bëjnë me mbishkrime varresh apo rituale, përpilime administrative, kalendarë dhe tregues të tjerë fetarë si dhe identitete të disa personazheve. Tekstet më të gjata janë ato të mumies së Zagrebit. (mbishkrimi mbi një pëlhurë liri që ka shërbyer për të mbështjellë një mumie, e quajtur mumia e Zagrebit meqenëse në të vërtetë gjendet në këtë qytet), tjegulla e Kapuas, e Cipas të Peruzës dhe stela e Vetulonias (shekulli VII para Krishtit). Por letërsia etruske e përmendur nga autoret antikë është zhdukur përfundimisht pa lënë as edhe gjurmën më të vogël.

Përveç ngjashmërive të fjalorit midis dy gjuhëve, gjuha etruske ka edhe përafërsi të tjera me shqipen, ndër të cilat janë ato si më poshtë:

- **përdorimi i nyjës së vendosur në fund.**
- **shumësi, i cili mbaron me ar.**
- **përdorimi i gjerë i prapashtesave emërore apo nyejve shquese të ndryshme.**
- **gjinorja "al", si për pjesën tjetër, armenishtja etj.**

Për një lexim më të mirë të gjuhës etruske unë i kam transkriptuar nga ana fonetike në frëngjisht të gjitha fjalët etruske. Do të gjeni me germa italike apo në thonjëza transkriptimin frëngjisht të fjalëve shqip të ndërlikuara apo të pashqiptueshme. Kur një përkthim ka nuanca (fjalë etruske) ajo është e shënuar me thonjëza. Duhet kujtuar se Latinët

e kanë huazuar alfabetin e tyre nga Etruskët: ai është zanafilla e këtij alfabeti që përdoret sot në Europën perëndimore. Shënojmë së fundi se alfabeti etrusk është i vetmi, së bashku me alfabetin lidian që ka shenjën 8 ("f").

Për të respektuar origjinalitetin e karakterit të tyre etrusk unë kam ruajtur grafinë zanafillore të letrave ? (th/dh) dhe X (ch/kh).

ETRUSKISHTE	SHQIP
Ai	ai
Ame	ama
AXuia	agu
	agim
	agon
ana	anë,ana (gegë)
	enë (toskë) idem
anë	
anθiam	endja, (endia)
ap, ep	ap, ep
ape, apa	hap, hapa
aplu	amël (gegë), ëmbël
	amëlsi, ëmbëlsi
aperucen	hap rrugën
	kapërcen
ar	ar
are	altar
ardh, arth	ardh
	ardhje
arXate	arkëtar
ast	asht
at, ati	atë, ati
a na	nana
atr, atranes, etnam	atër
aune	ynë
bacchetidis	bagëti

ETRUSKISHTE	SHQIP
balteus	mbartës
	mbajtës,
bilia	bijë, bija
ca	ca
caerimo	kremtja
	kremtoj
	kremtimila
caius	kal
	kalush
cale	kalon
calusin	kalorës
	kalos
came	gjamë, prej foljes gjamoj
canetha	(kënaqësi)kënaq
capesar	këpucar
caraθ	gardh
casθi	gjashtë
caθ (dielli)	gacë
ceise	gjejsh
celi	gjellë, gjelli
cemnac	gjëmon
cena	çmim
ceus	gjysh
çsmes	çezmë
ciane	qanë
ciani	qani

ETRUSKISHTE	SHQIP
citia	kithi (horizontalisht)
cia	qaj
cnan	qenë, qenia, qenun
cuie	kujë
cure	gur
cver, cuer	(depo) quer (depo, guve)
almahi	dele, delma, delmat
0anasa,	thanasa thanës
0am	tham (gegë)
0ar, tar	darë, da
0el	(dalje) del
	dalje
0ans, dhent	dhënt
0ecdek	(gegë), vdek
0ial	djalë
θima, temt	dhembja
	dhemia (gegë)
0ra	(dhallë) dhallë
0resu	thërres
θu	dy
0un	dhomë
0ufarce	thupër
0uk, ux	dukë
0uscu	dushku
0uluter	dy lutës
0urs	thur
drouna	druaj
	druhën
ecnas	nesh
elucee	lus
elpa, elfa	elb, elbi
eparu	i parë
epëra	(gegë), epërm
	epërsi
	ersi errësi (gegë)
ersce	errshëm
etule	tuli, tule
evnu	venë (gegë)
fabulonia ose babulonia:	ulurin
	bubullim
falas ose balas	ballë
fipece ose bipece:	bëfasohej
	befas
fanu s ose banu	sbanesë
felic, flere	fli
fina, bina0	Bima
fis	fis
flezru	fle, fjetur (fietur)
fufluns ose pupluns	pupë
giltz	çils (çelës)
ha	ha
hek	heq
hetum	etje
hia, he	hija
	hëj (gegë)
hulu	hulli
ic, iX	iki
icni	ikni
iduare	i ndarë
i0nac	idhnak
i0nin	idhnim
ikkas	ikës
ims	gjysmë
itXrani	idhnim
iu	hyu
	hyjni (perëndi)

ETRUSKISHTE	SHQIP
kapes	kapēs
katek	katoq
Ka, ke	ka, qe
Kran	ngranē
Kru	krye (i)
Kte	kthe
Kukaian	kuq
	kuqërem
kurpu	(mjerē) korbë
kvil, kuil	kulluē, kulluar
la	la
lacθ	lag
laci	laj (gegë = laj)
latha	lidha
lapis	lypēs
lariza	larzoj (larzoj)
lart, larth	lartē
lenia	lenia
libitina	lebeti
lunasie	lojna (gegë=lojna)
lurlyerē,	luej
lus, lut	lus, lutem, lut
mal mal	
maie	majë (mal)
malave, maluve	malave
marka	maraq
marni	merrni
marun	marunë (gegë)
matan	matanë
mena s	mënash (gegë)
manatha	me natë
matesi	madhësi
me	me

ETRUSKISHTE	SHQIP
mer	merr
	mirë
mlesul	amëlsi (gegë)
muluane	mulli
munθ	mund
mursil	mërshel (gegë) (me mbyll)
nam	nam, nëmë
naper	nëpër
nata	nata
ne	në
neri	njeri
neris	njerës
nuk	nuk
nulis ulis	(duke u ulur)
në ulicë	(në rrugë)
	ulët
num	njomë
nuna	nana, nëna
orti	urtë
pacu	pak
parzura	përzura
pataks	patok
patrpa	tërë (shikoi të gjithë)
pav, pava	pau (shikoi)
pazu	baxho
peiare	pijetar
pel	(prodhoj) pjell
perpru	përpara
peva	piva, peva
pia	pija, (pia)
pi, piva	pi, piva
pican	pjekun
peku	plaku

ETRUSKISHTE	SHQIP
pleni	bleni
puiagrua,	gruja
purθ	prushis
putist	puthem, puthet
put	puth
raθ	radhë
ratum	radhis
raX	rrah
repine	rrypinë
ri	re
ri	i ri
rite	ritë (të)
rinirini,	rinia
ru, ron	ru, ruaj, ron
sa	sa
scare, scara	shqerra
scushko,	shku (gegë), shkuar
	shkoj
se she	(përrua që nuk shteron)
secsuc	(gegë) (bijë)
setra	sedër, sedra
setirune	shterunë
shshoh, shih	
shi, sishi	
shu	shumë
sil	sjell (sill)
siu	ziu (i)
siunë	sy (në)
ste, sual	shtyej (shtuej)
	lyej (luej)
snati	zgjat, zgjati
snu	s'njoh (s'shoh)
spu	s'pi

ETRUSKISHTE	SHQIP
streshtrë	(gegë) (shtrirë)
su	sy
suv	(vështroj!)shoh, shof
svulare	zbuloj
taliθa	tallje
tarcste	treg
tashur	dashur
tasheru	dashura, dashërua
ter	tërë
tesham	desha
	deshëm
	dashun
teftef	(teh thike)
tarcste, trec	tregti
	treg
terash	thëras
thar	ther
thi	dhi
thui	thuaj
thuth	thith
timθim	dhimbje (gegë)
tisa, tise	disa
tul	tul
tular	(kufi rrethues fushe etj.)
	tullë
tur	thur
turesa	turi
turi	turizë (gojzë)
turice	dhuratë
	dhurues
tursi	thurës, thurimë
tva·ose tua	dua
uθari	udhëtari

ETRUSKISHTE	SHQIP
ufli	fli
	unë fli
ui	ujë
ulesh	ulesh, ulem
umas	masë
	u mat
	unë masë
urθe	uri
ure	urë
uruesi	urtësi, i urti
uzarale	u zjarr (u dogj)
vaXr	vjehërr
vacl	vagjëli
vanθ	vend
vaze	vajzë
vc, ucuk	(gegë), ujk
ve	vë
velka	falka (fal)
vinum	vënë (gegë) (vera, si pije)
volote	volitshëm
vraθ	vras
Xertie	kërthi
Zar	zjarr (zjar)
ZaX	gjak (jak)
zatis	zatetem, zatet (orvatem)
zea	zia, zi
zemra	zemra
zeri	zëri, zani
zi	zi
zna	zgjat
	zgjas
zui	zonjë

Gjuha pelazgo-shqipe, thrako-ilire, mesape

Nga të gjitha të folurat pellazge të arritura deri në ditët tona, ilirishtja zë një vend të veçantë. Megjithatë unë parapëlqej të flas për gjuhën thrako-ilire sepse ishte një guhë pellazge e folur nga fise të shumta në një territor të stërmadh (përpara pushtimit romak në vitin 168 para Krishtit si dhe mbërritjes së hordhive të pushtuesve sllavë në Ballkan drejt shekullit VII të erës sonë) duke shkuar prej Adriatikut deri në Detin e Zi dhe brigjet e Danubit deri në veri të Greqisë. Ky territor ishte fillimisht i ndarë midis Trakëve, Getëve, Dakëve, Mesianëve, Peonianëve dhe Maqedonëve (përpara helenizimit të tyre) në lindje dhe të fiseve të shumta ilire në perëndim, ndër të cilët Dardanët, Panonianët, Liburnët, Dalmatët, Venetët, Autariatët, Dasaretët,

Taulantët, Enkelët, Pellagonët etj. Për më tepër të mos harrojmë se veriu i Greqisë, në të vërtetë ka qenë zemra e Greqisë tepër vonë. Kështu Epirotët (Epiri i quajtur dikur Pellazgji dhe më pas Tesproti), Molosët dhe Kaonët ishin popuj tipikë ilirë. Të gjithë këta fise flisnin pra të njëjtën gjuhë në dialekte të ndryshme dhe ka të ngjarë jo kaq shumë të ndryshëm. Në të vërtetë të dy fiset më të mëdha pellazge në Ballkan ishin Trakët dhe Ilirët. Pra ka të ngjarë që të ketë patur vetëm dy apo tri dialekte të mëdha, siç është rasti me dy dialektet e vetme pellazge që kanë mbijetuar dialekti gegë në veri të Shqipërisë dhe ai toskë në jug. Ja përse do të quaja këtë gjuhë thrako-ilire kundrejt një dialekti tjetër të madh pellazg, dialektit thrako-frigjian i folur në Azinë e Vogël dhe në kohë më të lashta nga Lelegët, Karianët dhe Lisianët.

Fatkeqësisht, ashtu si edhe për pellazgjishten e lashtë nuk na kanë mbetur shkrime të besueshme të kësaj gjuhë thrako-ilire. Numri i vogël i mbishkrimeve epigrafike (shpesh me germa greke, të cilat datojnë nga shekulli VI madje édhe më herët, shekulli VII para Krishtit) që zotërojmë, kanë të bëjnë me antroponimitë, etnonimitë, teonimitë, eponimet, oronimet dhe toponime të shumta. Ne i hasim këto të fundit në një hapësirë të stërmadhe gjeografike që shkonte nga Pirenejtë deri në Kaukaz dhe nga Danubi deri në detin Egje. Pra nuk duhet të lemë pa paraqitur dialektet ilire të Italisë, të folura në të gjithë bregun lindor të Italisë (nga veriu i Venecias deri në Kalabri). Bëhet fjalë kryesisht për mesapishten. Çuditërisht në Italinë jugore, vendi i Japigëve, Daunianëve dhe Mesapëve ku janë zbuluar një numër i madh mbishkrimesh ilire (rreth pesë qind) në dialektin mesapian. Përveç kësaj janë zbuluar më shumë se dyqind mbishkrime të shkruara (në germa të etruskishtes veriore) në dialektin venet, të cilat datojnë në shekujt VI – I para Krishtit në rajonin e Mantovas, Padovas, Triestes dhe Estes si dhe në luginën e Pavias.

Përveç këtij materiali të paktë gjuhësor të përbërë nga mbishkrime të ndryshme të zbuluara aty-këtu, bazat e vetme gjuhësore janë tekstet

gjuhësore antike (Homeri dhe autorë antikë grekë), ku janë cituar emra të shumtë të përveçëm, emra perëndish dhe emra vendesh të cilat mbeten të pashpjegueshme nëpërmjet gjuhës greke, por që arrin t'i shpjegojë vetëm gjuha e sotme shqipe. Ja disa pjesë të nxjerra nga libri i Mejesë (Vështrim mbi historinë e gjuhës greke, Klincksieck/ Paris1965) ku ai nxjerr disa të vërteta të mbetura të izoluara. Por me pak fjalë, ai gjithmonë nuk arrin të paraqesë vërtetësinë historike të pellazgjishtes së lashtë dhe përafërsitë që e lidhin atë me gjuhën egjeane, thrake, frigjiane, ilire dhe shqipe:

"Nga gjuhët që fliteshin në gadishullin grek përpara pushtimit helen nuk dihet asgjë. Pellazgët janë vetëm se një emër... Po ashtu në Qipro, një tekst që ka shërbyer për të shënuar, në shumicën e rasteve është shkruar në greqisht por është e dallueshme se nuk ka qenë shpikur për të shënuar në greqishten dhe nuk përputhet mirë me gjuhën greke... Gjithsesi huazimi i alfabetit fenikas dëshmon patjetër për një ndikim të madh të Fenikasve mbi Helenët, të paktën një paralelizëm zhvillimi..... Por Maqedonët, pa dyshim, nuk kanë shkruar kurrë në gjuhën e tyre dhe aristokracia e tyre u helenizua aq sa mundi. Me pak fjalë në momentin kur Helenët mbërritën aty, njihet vetëm në mënyrë të turbullt gjeografia gjuhësore e popujve mesdhetarë.... Qytetërimi që veproi mbi atë grek është ai i botës egjease, botë të cilës nuk i njihet gjuha... Ka të ngjarë se në greqisht ka fjalë që Helenët si të thuash gjatë udhës i kanë grumbulluar nga të tjerët që gjetën në Greqi ose i morën nga popullsi të ndryshme të botës "egjease"... Por nuk i duhet mveshur gjuhës indo-europiane ajo që ka mundësi të jetë më saktë "egjease"... Fjalori grek pasqyron një qytetërim profan, i kahershëm i kulturës së lashtë indo-europiane... Përveç Ζευς (Zeusi), perënditë e mëdha greke kanë emra që nuk shpjegohen nga greqishtja dhe për të cilat nuk gjenden emra korrespondues në gjuhët e tjera indo-europiane: mitologjia greke nuk ka pothuajse asgjë indo-europiane".

Ja pra çfarë është e qartë dhe nuk ka nevojë për asnjë plotësues

sqarimesh nëse nuk do të ishte shpërfillja e njohurive të thella të shqipes së vjetër dhe veçanërisht të dialektit gegë të veriut dhe mbi të gjitha të dallimit të një gjuhë parahelene (ai citon Pellazgët dhe Egjeasit, jo më shumë) si dhe pamundësia për të dalluar me saktësi gjuhën zanafillore parahelene të popullit që e fliste atë. Nga ana tjetër Meje pohon se emri Zeus shpjegohet me lehtësi me anë gjuhës indo-europiane, ndërkohë që përkthimi i këtij emri nga kjo gjuhë etalon, e shpikur sipas rastit nga gjuhëtarë që e parapriu atë, nuk e shpjegon as në mënyrë të qartë dhe as me themel. Vetëm gjuha shqipe e shpjegon atë pa asnjë mangësi (për referim, te kapitulli "pellazgo-shqipja dhe greqishtja").

Gjuhëtarët modernë e kanë klasifikuar ilirishten midis gjuhëve indo-europiane por në mënyrë të izoluar dhe në një degë krejt më vete. Çfarë mishmashi! Të pavërtetat ziejnë nga të gjitha anët sepse mendime të shumta divergojnë në lidhje me këtë. Ja p.sh disa mendime të ndryshme.

Meje: "Në veri-perëndim të gadishullit të Ballkanit dhe duke bërë një farë lloj lidhjeje midis kontinentit dhe botës greke, italike dhe gjermanike, në antikitet gjendet grupi i stërmadh ILIR. Ai është grupi i njohur më pak... Ilirët kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm, ende të përcaktuar jo mirë, në qendër të Europës dhe kanë vepruar në tri drejtime: kundrejt botës gjermanike me të cilën lidhjet dhe shkëmbimet kanë qenë të pareshtura; kundrejt Italisë ku popuj të shumtë ilirë janë vendosur (madje është hamendësuar se Umbrianët ishin një nënndarje ilire); kundrejt botës helene ku pushtimi dorian ka shtyrë elementët ilirë... Gjithashtu ka të ngjarë se duhen trajtuar si me zanafillë ilire Filistinët, të cilët i dhanë emrin Palestinës (greqisht Palestine)". Këtu Meje përqafon tezën sipas së cilës pushtimi dorian jo vetëm ekzistonte, por se erdhi nga Veriu. Në të vërtetë autorë të shumtë modernë e hedhin poshtë këtë tezë, të mbështetur nga disa arkeologë, të cilët nuk kanë zbuluar asnjë gjurmë të këtij pushtimi të hamendësuar.

Në të vërtetë ky pushtim ngjan më se i pamundur për arsyen e vetme se prijësit dorianë (Herodoti, VI/ 53; Makabe I, 12/20 deri në

23) nuk ishin europianë por semito-egjiptianë me prejardhje nga Danaos vëllai i Egjiptos. Pra ata nuk mund të vinin nga Veriu, i cili në këtë epokë ishte i banuar në veçanti nga popullsi të trungut pellazg (tesprotë dhe ilirë) dhe flisnin një gjuhë barbare d.m.th jo greke. Kjo elitë e vogël i imponoi ligjin e saj popullit të mundur, i cili në pjesën më të madhe ishte i trungut pellazg: ishte fjala për popullsitë ilire, të cilat patjetër që kishin dalë nga veriu i Greqisë. Midis gabimesh të tjera dhe pistash të gabuara është edhe kjo ngatërresë që i ka çoroditur një numër të madh historianësh dhe gjuhëtarësh.

Norbert Jokl: "Sidoqoftë shënojmë se trashëgimia gjuhësore që na vjen nga gjuhët e lashta të Ballkanit, si gjuha ilire apo ajo trake, janë të lidhura ngushtë me gjuhën shqipe."

S. Bugge (Etruskishtja dhe armenishtja, Christiana, 1890) vërteton ekzistencën e përafërsive të shumta gjuhësore, madje një identitet të plotë midis mesapishtes dhe ilirishtes.

Poli-Visova ka gjetur përputhje të rëndësishme midis mesapishtes dhe shqipes së sotme. Ai pohon gjithashtu se Shqiptarët janë një e treta Ilirë dhe dy të tretat Trakë. Këtë mendim kishte edhe Konuei.

Sanfeld (Gjuhësia ballkanike, Paris 1930) pohon se gjuha shqipe është një etapë moderne e gjuhës ilire.

H.Shushardt ka venë në dukje përafërsi të shumta gjuhësore midis gjuhëve thrako-ilire, armene dhe asaj shqipe.

J. Pokorni pohonte se si në Austri dhe në Bohemi ekzistojnë gjurmë të shumta të kësaj gjuhe para indo-europiane, me toponimi dhe ngjashmëri befasuese edhe me etruskishten (në mos po ka qenë një gjuhë e lidhur ngushtë me të, të një trungu me të).

K. Kun (kryetar i një ekspedite etnografike të bërë në Shqipëri nën përkujdesjen e universitetit të Harvardit, 1950) pohon ekzistencën e lidhjeve të ngushta të ilirishtes dhe dialektit gegë të Shqipërisë së Veriut: "Dialekti gegë i gjuhës shqipe, në themel është dialekti ilir"....

Thrako-ilire-mesape	shqip
a (il)	a... (pyetje apo hamendësim)
aker (il)	acar
amolusta (th)	amël, amëlsi (gegë)
amalusta (th)	kamomil
ania, oania	anije (anija)
ank (il)	ankth
ar (il)	ar (metali)
as	as (mohuese)
-at	at - mbaresë karakteristike e emrave etnik ilirë : Dalmat, Autariat, Aseriat. Kjo gjendet ende në Shqipëri në emrat e fiseve (Demat, Beqirat...) dhe në toponime (Dukat, Berat, Progonat...)
balus (il)	ballë
bardus (il)	bardhë
Bardylli (il)	Bardhë ylli - mbret ilir, fjalë që do thotë "yll i bardhë".
Barzides (mes)	antroponim Bardhësi Barazues
barka (il)	barku
barga	plevicë bar
bauria (il)	burrnia (gegë), burrëria
Beskides (il)	mal në Karpate
Bene	bëra, bana (gegë) bënë, banë (gegë) bjeshkë (bjeshk)
bigeste (il)	bigë (mal më dy maja)
bistum (il)	bisht
bora (maq)	mal në Maqedoni

	bora
borea (il)	borë
brendon (mes)	dre
Brindia (il)	qytet ilir në Bosnjë
Brindisi (il)	port në Itali (breg juglindor)
	Brin'dashi
	bri, brinë (gegë)
	brinja (brinia)
brenton, Brendon (mes)	idem
	tjetër emër mesap i Brindisit
bigeste (il)	bigë
	bigël
bile (il)	bijë
bilia (mes)	idem
bunnos (il)	qytet ilir
buni (il) fis ilir	Ka të ngjarë që Bunitë të ishin "banorë të kasolleve".
Buneima (il)	qytet (Epir)
buni (il)	bun, buni - Kasolle bjeshkësh e barinjve. Ka të ngjarë që kjo fjalë e lashtë rrjedh nga fjala banoj. Ky toponim gjendet të Malabanus (banorë ta maleve), mala (male) banues (banorë).
Acra-banus (il)	I njëjti fenomen: banorë ta majave.
darde, dardan (il)	dardhë
Dardania (il)	Dardania, vend i dardhave.
delma, delmat (il)	dele, delma, delmë.
Delmatia, Dalmatia	Delmaci, Dalmaci.
Delminiom (il)	qytet ilir.
dalmaihi (mes)	delmë (dele).
Dimalum (il)	Dy male.
èana (mes)	zana
e	e (dhe)

eirene (il)	rrënë, rrënia (gegë)
fama	fama
fimia	fëmia
fis	fis
gai	gajret
Gordium (il)	toponimi që rrjedh nga fjala gardh, prej nga edhe emri hitit Gurta = qytet
gur (il)	gur
gurassu (il)	rrjedh nga gur, kala dardane
hri	hiri (hijeshia)
hopaie	hopi (me)
Hut-tenia (il)	toponimia = katër qytete Hut (katër) ndjeja (ndenie, qëndrim).
hiyneron	hyu neron (gegë) (hyjnizon).
Ie	je
ika (il)	ik, ika Perëndeshë e mëmësisë në Iliri.
Iluthia, Eileitha	ndoshta lidhet me kordonin e kërthizës lidh, lidhja (lidhia).
Ith	ith (ngrohtësia e tokës).
kaie	kjajë, qaj
karpoï, karpiloï (th)	karpë
lene	lenë
liri	liri
lot	lot
math	madh
malea(il)	mal
malea, malé (kret)	emër kepeve të dalë (Lakoni, Kretë, Lesbos, vende fillimisht të popuiluara nga Pellazgët).
manteia(th)	man
marakhun (il)	merak, merakun
maraz (il : ankth)	idem
menzana (il)	mëz, maz mëzat
miia	mija (mia)

mori	mori (e)
nai	na
naip	na ep
nairon	na e rron (që rron)
ni	në
par	parë
	i parë
	parësi
Pardalas	Emër lidian shumë i lashtë, ashtu si Paris rrënjën e ka te fjala "i parë".
Pellagones	pellg
	"fis që ka jetuar buzë liqenit të Ohrit".
	Kjo fjalë nuk mund të rrjedhë nga fjala greke pelagos(det) që do të jetë formuar shumë më vonë.
Pino (th)	pi, piva
	pia
piva (kret)	piva
plakos (il)	plak
pro (thrako, dake)	për
Ro	rro
Reze	rreze
Rhinos	re, retë
Saih	sha, shaj
Salapia (il)	qytet bregdetar në Pulia.
	shëlija (shëllira). A. Majer e ka shpjeguar këtë me ujë të kripur. Por për arsye të lashtësisë së Ilirëve dhe Etruskëve në raport me Latinët si dhe të fqinjësisë së tyre janë këta të fundit që e kanë huazuar rrënjën "sal",prej nga rrjedh fjala e tyre salire.
Shi	shi
Sceli	shkeli
si apk	si (e) hapke

si fai	si faj
skiare (thrakisht = shpatë)	Çjerr (shtierr), gris
taf	taft (ngrohtësi)
te (il)	te
Tergitio (il)	Emër i përveçëm në latinisht me Negociator, e
cila	përkon plotësisht me Tergitio dhe me : treg, tregti, tregtar.
thana (il)	zana
Thana (il)	Emër grash i hasur shpesh ndër Etruskët
Ugur	ugur, ogur
Ulko (il)	lumë në Panoni
	ujk , uk . Fjalë e lashtë pellazge që do të thotë "ujk". Fjalë e kaluar të Sllavët (vuk) dhe që gjendet te Grekët (lykos), Indianët vrkah etj....
Ulkenion (il)	Toponim në Panoni.
Ulcisia castra (il)	kamp ushtarak
Ulcinium (il)	në shqip "Ulcin", qytet ilir në Mal të Zi. Kjo fjalë është latinizuar nga Romakët.
Vendon (il)	Qytet te Japodët ilirë (Itali)
Venda, vendo (il)	Emër i përveçëm të Venetët ilir: vend, vendi, vent, venët (gegë).
Veies (etrusk.)	Qytet i madh etrusk.
Veius (il)	Emër i përveçëm ilir
	Ve . Sipas G. Mejer është fjala për rrënjën bazë të fjalës vend.
Vanè (il)	perëndesha e Tokës te Etruskët .Ndoshta perëndesha e Atdheut.
Uridua (il)	urti-dua , ura dua
	Sipas S.E. Man ky emër nënkupton dituri-dua, ai i perëndeshës së diturisë tek Ilirët.
yinoriz, uinoriz	hyjnorës
zero	zuri
zi	zi (e zezë)



Via Appia



Via Egnatia



Rrugë e Lindjes së Afërme
Rruga romake nga Roma në Jerusalem

I - Kelto-gjermanikja dhe pellazgo-shqipja

Në kapitullin "Pellazgo-Shqiptarët: ndikime të nënshtresës pellazge" kemi arritur të krijojmë një ide mbi disa gjuhë të vjetra të Europës qendrore dhe perëndimore përpara dyndjes së Sllavëve në Europë: gjuhët kelto-gale dhe gjermanike.

Tashmë do të shqyrtojmë përputhjet gjuhësore midis këtyre gjuhëve dhe pellazgo-shqipes.

Kelto - gjermanike	**shqip**
atta (got)	atë
beer (angl)	birrë
bier (gj)	"
	pirja (piria)
berg (vx. ht. gj = mali)	breg
	bregore
brâka (gjer)	brekë
braca (kelt)	"
bragoù, bragez (breton)	"
brêk, brêc (ang. saks)	"
broek (holl.)	"
braie (pantallona galeze)	"
Breizh, Breiz	Etnonimi e Bretanjës
	dhe e Bretonëve.
	Brez (në shqip)
	brind (sued) dre i madh
	në veri të Europës
	bri, brini (briri)
	brin'dre
	brendon (mesap.) = dre
Deile	fëmijë i birësuar
	Djalë
Druis (gal)	Druide
Drui (irl)	"
Drouiz (breton)	"

dru, druri, druni —: në shqip emri i lashtë i lisit, emblema e përbashkët e Pellazgëve dhe e Druidëve të cilët e

	marrin emrin e tyre nga lisi (dru)
	pellazgo-shqip
geiri (gjer = gjiri, prehri)	gjiri
glun (v. irl)	gju, gjunë (gegë)
glin (gal)	gju
hel (nordi)	perëndesha e vdekjes
hell (angl)	ferri
hölle, f (gj)	"
	helli
ik (v. irl =iki)	ik, iki
kaput (gj)	dobësohet
	këput. Krejt ndryshe nga ajo që pohojnë disa gjuhëtarë kjo fjalë nuk rrjedh nga latinishtja, e cila ka huazuar qoftë nga Etruskëtqoftë nga popullsitë fqinje pellazge.
kirsche	qershi
	Kerason, fjalë greke e huazuar nga
frigjiania	antike, pra pellazge.
Kirche	kishë
koe (holl. = kau)	kau
Kuni (gotisht = gjini)	Kunjë
lug (i shndritshëm)	Perëndi irlandeze
	lugat
rann,runnun(got)	rrjedh
	re, u vranë (i vrenjtur)
rêren (ht., gj)	ra, ranë, me rënë
scodria (v. irl. = nisja)	shkoj
steg	shteg
	shteg
uscias (te Druidët)	ujë, ujera
iusce (v. irl)	ujë
Vaterland (gjer. = atdhe)	vatër

II - Gjuha hitite dhe pellazgo-shqipja

Gjuha hitite është një nga gjuhët më të vjetra të Azisë së Vogël. Pjesa më e madhe e tabelëzave hitite vijnë nga gërmimet e Boghaz Koi (Azia e Vogël, 150 km në lindje të Ankarasë). Këto tabelëza të zbuluara në këtë vendth dhe shkrimet në stilin Kunei akadian por në gjuhën hitite, të cilat i përkasënin një periudhe që luhatet midis shekujve XIX - XIV para Krishtit. Gjithsesi në Egjipt dhe Tel el Amarna, arkeologët kanë zbuluar një farë numri germash (midis përputhjeve të tjera ato që gjenden midis Amenofis IV - Akhenaton - dhe mbreti hitit Supiluliuma). Këto tabelëza të fundit ishin të shkruara në gjuhën akadiane (gjuha diplomatike e epokës) përveç dy germave, të shkruara me shkrim Kuneiform. Tipike hitite (përputhjet midis Amenofisi III dhe mbretit hitit Trahun-Daradu i Àrzava-s). Ka patur edhe zbulime të tjera që lidhen me gjuhën hitite, në veçanti janë mbishkrime epigrafike të zbuluara mbi monumente të ndryshme dhe shkrime të shkruara me hieroglifë. Sa i takon gjuhës luvite disa e trajtojnë si shumë të përafërt me gjuhën hitite.

Gjuha hitite u deshifrua nga B. Hrozni në vitin 1916. Emri biblik i Hititëve është Hittim dhe është trajtuar nga gjuhëtarë të shumtë si një idiomë indo-europiane dhe në veçanti në strukturën e saj gramatikore (lakimi emëror, zgjedhimi, lakimet...). Por sipas disa gjuhëtarëve një pjesë e madhe e fjalorit do të ketë qenë me zanafillë jo indo-euroipane. Shpesh gjuhën hitite e kanë përqasur me gjuhën etruske dhe atë thrako-ilire (çka është e njëjta gjë).

Tradita vendase e quante gjuhën hitite "gjuha nesite", emër që rrjedh nga qyteti Nesas (Nashili, Nesumnili), sot Kyltepe. Për sa i takon hatti-t, Hititët ia referonin këtë term gjuhës jo indoeuropiane të banorëve të parë të vendit. Në të vërtetë nuk duhet lënë pa marrë parasysh se Hititët ishin një popull i vogël në numër (një elitë në pushtet), të cilët kishin pushtuar Azinë e Vogël. Sipas disa autorëve ata do të kenë qenë me zanafillë thrako-ilire dhe me zanafillë nga Ballkani.

Përveç të tjerave ata janë zanafilla e qytetërimit të hekurit në Azinë e Vogël, të shfaqur rreth viteve 1400 para Krishtit. Shumë më herët Hatianët apo sipas disa autorëve modernë protohititët përshtatën qytetërimin asirian midis viteve 1905-1775 para Krishtit. Mbretëria hitite u zhduk shpejt, rreth vitit 1200 para Krishtit.

Gjuha hitite	*** shqip**
Atta	atë (baba)
Cur	gur
Deg	djeg
dug (me u duk)	duk, dukje
gim	dimën
gurta (qytet)	gardha
	gurtë
heu	shiu
kallis	thërras
	kallëzoj
karimmi	kremtim
ket	këtu
kikis (kishte?)	kishit
(ishte?)	ishit
la, le	la, le
lip	lëpij
lukkés (me qenë e qartë)	llagartë
lulu	lule
sakuaii (me pa)	shohja
	shikoj
siu	hyi (hyjni)
taï	ndej (ndenji)
taru	dru
tekan	toka, tokën
uatar (ujë)	ujtar
uès	vesh (me vesh)
uitt	vit

III – Rumanishtja dhe pellazgo-shqipja

Rumunët, të rrethuar nga Sllavët dhe Hungarezët janë të vetmit në Ballkan që flasin një gjuhë neo-latine, nënkuptohet, me shumë prurje gjuhësore të trashëguara nga banorët e lashtë me zanafillë thrako-ilire. Në të vërtetë vendi i tyre u romanizua pas pushtimit romak që filloi me pushtimin e Trajanit rreth viteve 101-106 pas Krishtit. Kështu Dako-Getët, popull thrako-ilir, kanë banuar në vendin e tyre gjatë pothuajse dy mijë vjetësh dhe janë romanizuar rrreth shekullit të dytë pas Krishtit. Pra në dallim nga Sllavët, të cilët janë një popull pushtues që e pushtuan Ballkanin rreth shekullit VII pas Krishtit, Rumunët janë një popull autokton, pak a shumë i përzier por nga ana gjuhësore i afërt me Shqiptarët. Ndër të tjera kjo autoktoni është e vërtetuar nga elemente bindëse (historia, arkeologjia, antropologjia...) nga fakti se Rumunët kanë ruajtur një fond të vjetër gjuhësor të trashëguar nga stërgjyshërit e tyre Dako-Getët të trungut pellazg. Ja përse rumanishtja është shumë e afërt me shqipen e sotme, krejt ndryshe nga Sllavët, popull imigrues që ka ndjerë ndikimin e popullsive thrako-ilire dhe të cilët i kanë sllavizuar pjesërisht dhe nga të cilët kanë bërë huazime të mëdha kulturore dhe gjuhësore. Leksiku në vijim (listë jo e plotë) është paraqitje e të qenit nga një përafërsi gjuhësore midis rumanishtes dhe shqipes. Megjithatë po shënojmë përafërsitë e shumta me gjuhën etruske, një tjetër gjuhë e trungut pellazg (cf leksiku etrusko-shqip i përputhjeve gjuhësore).

rumanisht	**shqip**
ara	lëroj tokën
arat	lëvrim
	arë, ara, arat
aspru	ashpër
abur	avull
barzã	bardhë
bisnitar	bestar, besnik

balbai	belbëzoj (belbëzoi)
babalac	baballëk
balta	baltë
brad	bredh
bucate	
bucatar	bukë
ca	ca
cal	kalë
capac	kapak
catran	katran
catun	katun, katund
ceafa	qafë, qafa
ciudat	çudi, çuditë
cizma	çizme
copil	kopil
cula	kulla
cursa	kurth
cuvantâ	kuvënd
da	dha
dalta	daltë
dara	darë (geg) ndarë
drac	dreq
durea	duroj (duroi)
faliment	falimentim
fara	fare
fluture	flutur
frica	frika
galbeaza	gëlbazë
gard	gardh
gâti	gati, gatim
ghioonoaie	gjon
gloc	guaskë
grâne	grunë (geg)
grâu	"
gresia	gëressë (gërhasë)

grija	grinja (geg)
groapa	gropë, gropa
hames	hamës
harbuz	karpuz
hau	hon
hrana	ngrana (geg)
iata	ja ata (ia ata)
iepure	lepur
imbuka	im buka
înalt	i naltë (geg)
îngropa	gropa
inot	not, noti
robie	robëri
la	la
largime	largim
lene	lë, lëne
liman	liman
lipsit	lypësit
magar	magjar (geg)
mai	ma (geg), më
mânz	maz (geg)
mânzat	mëzat
marti	martë
mata	maca (matsa)
mei	miell
menire	mënyrë
mic	mec (geg)
mos	(mosh) moshë
mugur	mugull
muncâ	mundi
na!	na (merre)
nevoie	nevojë (nevoi)
gêne	i gjori
obor	oborr
papagal	papagall

pic	pikë
pregatit	pregatis
propãsire	përparësi, përparim
robie	robëni
samar	samar
sa	sa
sclav	skllav
	Emri i frëngjishtuar esclave nuk rrjedh nga greqishtja, as nga latinishtja e vjetër (servus, sevulus, servula : ai apo ajo që nuk është në gjendje të lirë ; ai, ajo që është në bujkrobëri) . Gjendet një kuptim befasues i gjuhës shqipe tek togfjalëshi s'ka llaf, e cila duke u shkurtuar dhe unizuar është bërë sklaff, që do të thotë "ai që nuk ka të drejtën e fjalës apo ai që është i privuar nga e drejta e të shprehurit". Kjo fjalë do të ketë dhënë të famshmen "slavus" . Por disa pohojnë se fjala e fundit ka si zanafillë Sllavët e shumtë të jugut që u shitën si skllevër! Kjo fjalë ilire a nuk ka një rezonancë të vërtetë në shqip?
Scurt	shkurt
Sfarsi	shfaros
Sigur	sigurt
Spada	shpata
Spuma	shkuma
stâna	stan, stana
stegar	shteg, shtegtar
strâmba	shtrembë (geg), shtremba-shtremba
strângâtor	shtënguar
strut	struc
sturz	shtur
schiop (shkiop)	shqep
solm (sholm)	shkabë

talaz	tallaz
tarã	darë (geg), ndarë
tatã	tata, at (ë)
tângui	ankesë
târg	treg
temelie	themeli, themel
tremur	tërmet
tânc (tsanc)	çun (tshun)
tap (tsap)	sqap (stiap)
tare (tsark)	qark (tshark)
tigla	tjegull (tiegul)
ulei	ulli
ulita	ulica (ulitsa)
uluc (uluk)	ulluk
ura	uroj (uroi), ura, uratë
varã	vera
vatrã	vatër, vatra
zânâ	zana
zarzavat	zarzavatë

IV – Lituanishtja, letonishtja dhe pellazgo-shqipja

Gjuhët balltike përfshijnë prusishten e vjetër, lituanishten dhe letonishten apo lete.

Prusishtja e vjetër flitej në Prusinë lindore deri në shekullin XVII. Kjo gjuhë njihet nga një dorëshkrim zanafillar që daton qysh nga shekulli XIV. Ky tekst, i cili përmban tetëqind e dy fjalë, quhej "fjalori i Elbingut.

Por të dy gjuhët balltike, ato më të njohurat dhe që ekzistojnë ende, janë lituanishtja (lietuvishkai) dhe letonishtja (latviski). Ato janë të dëshmuara qysh nga shekulli XVI: lituanishtja nëpërmjet përkthimit të një katekizmi të Luterit në vitin 1546 dhe letonishtja nëpërmjet përkthimit të një katekizmi katolik në vitin 1585. Këto gjuhë deri në shekullin XIX mbetën idioma fshatareske përpara se të bëhen gjuhë kombëtare dhe letrare.

Lituanisht, letuanisht	**shqip**
Anas	ana, anë, anësi
Baltas	bardhë, bardha
Degas	djeg (dieg)
Dels	djalë (dial)
Du	dy
Kardas	kordë
Lenta	lëndë, lënda
Luigas	llogac, lagët, lagështirë, lag, lagur, laguri, lëngu, legen
mazu	maz, maza, mëz mëz, mec (geg)
metu	mot, moti
prushoas	prushis, prush
regeti	ragim
stirna	shterunë
tauta (popull)	tatë

Teuta Mbretëreshë e Ilirisë në shekullin III para Krishtit Ky është një emër tipik ilir dhe për arsye të forta pellazg (Teutamos është mbret i Pellazgëve : Iliada, XVI/843). Ajo çka është më befasuese, ky emër gjendet me grafi pak a shumë të ndryshme në të gjithë popujt me zanafillë pellazge ose shumë të afërt me ata thrako-ilirë: Etruskë, Ilirë, Oskë, Umbrianë, Keltë... Ky emër te të gjithë këto etni do të thoshte popull, si për të kujtuar se ato i përkisnin të njëjtës linjë fisnore, të njëjtit "popull".

Përveç kësaj shtojmë se ky emër do të ketë rrjedhur nga emri i Titanëve (në shqip = TE TAN d.m.th. TË GJITHË dhe më gjerë "ata që mbeten së bashku", të gjithë ata që i përkasin të njëjtës linjë fisnore).

uogli (vogli)	i vogël, i vogëli
vaïuis	vesh, veshi
vershis	viçi (vitshi)
zaryjos	zjarr (ziar), zjarros



Mat - Vlorë - Gjirokastër : - dorezë dhe shpata prej bronzi - Epoka e Bronzit
(Sipas "Shqipëria arkeologjike"- Tirana - 1971)

Pellago-shqipja dhe ndërfutjet e ndryshme të saj

Tashmë do të shqyrtojmë ndikimin që gjuha pellazge ka ushtruar mbi gjuhët e tjera të shfaqura me mbërritjen e Grekëve dhe pas mbërritjes së tyre në jug të gadishullit ballkanik, detit Egje, Azinë e Vogël ose Italinë e Jugut.

Fiset pellazge ishin në një numër shumë të madh dhe lulëzuan në të gjithë hapësirën mesdhetare: në Azinë e Vogël, në Ballkan, në Europën Qendrore, në Itali dhe Iberi. Herodoti tashmë e kishte paraqitur rëndësinë dhe numrin e madh të Thrakëve, popull pellazg i mirëfilltë (V, 3): "Populli thrak, pas Indianëve, është populli më i shumtë në numër që mund të egzistojë në botë. Nëse Thrakët do të kishin një prijës të vetëm dhe do të merreshin vesh me njëri-tjetrin do të formonin popullin më të pamposhtur dhe sigurisht më të fuqishmin nga të gjithë popujt, sipas mendimit tim; por për ata kjo është diçka e pamundur dhe krejt e parealizueshme, prej nga rrjedh edhe dobësia e tyre". Më poshtë po hap një parantezë. Shumë thjesht mund të vihet në zbatim ky pohim, që është një tregues për të gjithë popujt pellazgë, duke përfshirë këtu Shqiptarët e sotmë, bashkimi i shënjtë i të cilëve mungon (përveçse në rast fatkeqësie kombëtare mund të jetë krejt relativ). Dhe kjo ndodh, midis mangësive të tjera, për arsye të antagonizmave të tyre dhe mosmarrëveshjeve reciproke, egocentrizmit të tyre, karakterit të tyre kryeneç dhe shumë të pavarur, për krenarinë e jashtëzakonshme të tyre, prirjen për të emigruar dhe për të punuar për zhvillimin e vendeve të tjera dhe ndonjëherë për shkak të mungesës së zellit për të ndërtuar së bashku fatin e tyre, gjëra që i pengojnë të krijojnë shumë shpejt një qytetërim dhe një shtet të madh. Do të shtoja se në qoftë se këto fise pellazge do të kishin qenë të bashkuara, pa dyshim që nuk do të kishte patur qytetërim grek. Në të vërtetë Pellazgët dhe Thrako-Ilirët zinin një territor të stërmadh që shkonte nga brigjet e Danubit deri në Egje dhe nga Adriatiku deri në Detin e Zi! Sot territori i tyre

stërgjyshëror është reduktuar sa të vjen keq dhe rëndësia e tyre e qëmoçme ka përfunduar në një hiç. Por krejt ndryshe, ata kanë arritur të ruajnë pothuajse të paprekura traditat e tyre mijëvjeçare dhe, mbi të gjitha, gjuhën e tyre, e vetmja fosile e gjallë që ka shpëtuar nga Pellazgët e lashtë. Kjo cilësi e fundit i zbut pakëz disa nga mangësitë e tyre, të cilat janë për të ardhur keq.

As Herodoti as ndonjë autor tjetër nuk ishin gjuhëtarë (shkencë e shfaqur më vonë në shekullin XIX) dhe prandaj nuk mund t'i vendosnin përputhjet gjuhësore midis të gjitha fiseve, që ata i mendonin si krejt të ndryshëm, duke mos përfshirë asnjë nga dialektet e tyre! Ja përse edhe autorë të huaj modernë nuk kanë bërë asnjë përqasje gjuhësore dhe etnike midis të gjithë këtyre fiseve (shpesh të trajtuar gabimisht si popuj të ndryshëm) të dala nga i njëjti trung pellazg, ndër të cilët më të njohurit janë si më poshtë: Pellazgët, Thrakët, Frigjianët, Ligurët, Lelegët, Karianët, Lisianët, Dardanët, Trojanët, Etruskët, Lidianët, Miianët, Dakët, Getët, Liburnët, Japigët, Mesapët, Liburnët, Panponianët, Ilirët ose Shqiptarët e sotshme. Kjo magmë e fiseve që flisnin të njëjtën gjuhë në dialekte të ndryshme ka çorientuar shumë historianë, gjuhëtarë, arkeologë ose hulumtues. Në të vërtetë të gjithë këta dijetarë, shpesh edhe me mendimin e mirë, nuk kanë vendosur lidhje, përqasje, ngjashmëri apo përafërsi njëjësuese a gjuhësore midis këtyre fiseve dhe gjuhës së tyre të përbashkët.

Pas shekullit VIII para Krishtit dhe me mbërritjen e Grekëve që mbivendosën kulturën dhe gjuhën e tyre ndaj kulturës dhe gjuhës së këtyre fiseve, pjesa më e madhe e popullsive të trungut pellazg u nënshtrua nga pushtuesit e rinj helenë. Ja përse shpesh aty ka patur ngatërresa datash, kulturash, mitesh, gjuhësh, etnish etj. Këtu unë nuk flas për "popuj pellazgë" (në shumës), sepse kjo do të nënkuptonte "etni" të ndryshme dhe të dallueshme dhe nuk është aspak një rast i tillë. Ja pra në çfarë mjedisi u zhvillua qytetërimi i Helenëve të parë në këtë rajon. Ky zhvillim e arriti kulmin në shekullin V para Krishtit,

d.m.th. dy apo tre shekuj pas mbërritjes së tyre. Ja përse unë jam përpjekur që gjatë veprës që keni në dorë, ta shpjegoj të gjithë këtë duke e mbështetur me argumente, studime, analiza dhe referenca. Pas këtij bashkëbisedimi do t`i rikthehemi gjuhësisë.

Në mungesë të epigrafeve dhe të teskteve bindëse parahelene, si elemente gjuhësore konkrete në lidhje me Pellazgët dhe fiset e të njëjtit trung, ne zotërojmë vetëm toponime të ndryshe dhe oronime që nisin midis Pirenejve dhe Azisë së Vogël madje Kaukaz dhe Armeni nga njëra anë dhe brigjet e Danubit dhe deti Egje nga ana tjetër. Megjithatë zotërojmë materiale jo më pak të rëndësishme të përbëra nga antroponime, etnonime dhe eponime, të cilat kësaj here gjenden në shkrimet e para greke: Homeri me epopetë e tij Iliada dhe Odisea, Hesiodi (Teogonia, Punët dhe Ditët) dhe poema të tjera të ciklit homerik, emra të shumtë të gjetur në stela apo monumente të ndryshme dhe më në fund dëshmitë e autorëve më të lashtë antikë të tillë si Hekate i Miletit, Helanikosi i Mitilenit, Herodoti, Tuqididi dhe të tjerë jo më pak të shquar. Këto dy forma materialesh që citova bashkohen, përputhen apo ngatërrohen për shkak të ngjashmërisë dhe të njëjëshmërisë së elementeve gjuhësore që shpalosen aty.

Pjesa më e madhe e këtyre emrave shpjegohen falë gjuhës së sotme shqipe, e cila është e vetmja që ka ruajtur në Europë këtë fond të vjetër gjuhësor të dalë nga Pellazgët antikë. Deri më sot disa që nuk kanë mundur të bëjnë as përqasjen më të vogël midis pellazgjishtes dhe shqipes, kanë shpallur se këta emra, të pashpjegueshëm nga gjuha greke do të kenë dalë nga një gjuhë parahelene e zhdukur. Kjo pistë e gabuar e ka çuar gjuhësinë dhe historiografinë moderne në një udhë pa krye. Këtë do të studiojmë në paragrafët e ardhshëm.

Si në shumë gjuhë, formimi i emrave dhe fjalëve të ndryshme në pellazgo-shqipe, në përgjithësi është bërë duke u nisur nga fjalë të përbëra ose sintagma të fiksuara (në gjuhën shqipe është fjala për elemente gjithmonë të bashkangjitura, pa vijë lidhëse) të bazuara në

një apo shumë rrënjë. Gjithashtu mund të jetë fjala për një apo rrënjë të shumta, parafjalë të vendosura përpara dhe (ose) prapashtesa.... Kjo veçori e fundit është e përdorur gjerësisht në pellazgo-shqipen si p.sh. në rastin e nyjes të vendosur në fund.

Një nga kompozitat më të vjetra apo formimi i fjalëve që rigjendet edhe sot është emri i Marsejës, qytet që i përkiste Ligurëve (popull pellazg i mirëfilltë) përpara vendosjes së Grekëve në vitin 600 para Krishtit. Në të vërtetë ky emër në pellazgo-shqipen është i përbërë nga dy rrënjë marr dhe sjella, e cila më gjerë do të thotë me marr dhe me dhënë. A nuk është kjo një shfaqje e vjetër e tregtisë dhe e këmbimit? Ky qytet i quajtur në kohë të lashta Massilia përpara se të quhej Fose nga Grekët, a nuk ka qenë një port tregtie si dhe i të gjitha llojeve të transaksioneve midis vendeve të Mesdheut dhe pjesës tjetër të Europës, mbi të gjitha asaj veriore? A nuk ishte kjo forma e parë e tregtisë ndërkombëtare: import-eksport (me marr - me sjell)?

Gjuha shqipe, e pasur në këtë lloj përngjitjeje zanafillore, shembujt e mëposhtëm të së cilës janë të formuara gjithashtu nga dy rrënjë të ndryshme, duke përfshirë një rrënjë identike me atë të Marsejës: marr në zanafillë të formimit të emrit të saj.

Marrëdhënia

Marrëveshja

Marramenthi

Ndikimet e pellazgjishtes së lashtë mbi greqishten

Ja tashmë për ndikimin që ka patur pellazgjishtja e lashtë mbi gjuhën greke dhe huazime të shumta që kjo ka bërë nga gjuha pellazge dhe ku edhe sot gjenden mbetje të shumta gjuhësore.

Këtu nuk do të rinis listën e gjatë të antroponimeve dhe toponimeve të shqyrtuara (dhe të shpjeguara nga pellazgo-shqipja) nëpër kapitujt e tjerë të veprës që keni në dorë, por do të citoj një pjesë prej

tyre, ato më kuptimplotet sepse pretendohet të trajtohen si me zanafillë greke apo që kanë dalë nga një gjuhë parahelene e zhdukur, ndërkohë që kjo gjuhë është ruajtur pothuajse e paprekur në shqipen e sotme.

Emrat: Zeusi, Akili, Hera, Apolloni, Afërdita, Artemisi, Athina, Argos, Korinti, Olimpi ose fjalët hyppos, diphtere, gigas (gjigandë) chaos, chronos, muses ... janë të shpjegueshme në mënyrë të përkryer me anë të shqipes së sotme! Ndërkohë që deri më sot na është mësuar se këta emra apo fjalë ishin tipike greke! Për atë fjalë që nuk është mundur të shpjegohet me greqishten është ngatërruar keq dhe është fshehur e vërteta nëpërmjet formulës së famshme, të pakuptueshme madje mashtruese: gjuhë parahelene! Dhe kështu e gjithë bota u zu në një terr që nuk të çon askund dhe vetëm se të sjell përqark një pike. Ja përse në lëmin e historisë dhe të gjuhës së popullsive të mbiquajtura parahelene kanë mbetur në udhë pa krye studimet dhe hulumtimet.

Pra unë do ta nis shqyrtimin e disa emrave dhe fjalëve domethënëse të paraqitura deri këtu si greke, por që në të vërtetë janë me zanafillë pellazge. Pavarësisht përpjekjeve të shumta të mbetura të padobishme apo pak të besueshme, askush nuk ka mundur t'i interpretojë apo t'i shpjegojë këto fjalë në mënyrë të qartë me anë të gjuhës greke. Gjithçka mbështetet në gjuhën e sotme shqipe, fosile e gjallë e kësaj gjuhe e quajtur shumë herë "parahelene dhe e zhdukur"! Ky është çelësi i problemit. Gjithsesi shënojmë se qysh prej njëqindepesëdhjetë vjetësh autorë të shumtë, midis tyre gjuhëtarë të shquar, antropologë, etnologë dhe specialistë të historisë parahelene kanë dhënë alarmin duke përsëritur me zë të lartë se gjuha shqipe paraqiste një thesar gjuhësor të vyer dhe se Pellazgët, Frigjianët, Etruskët dhe Thrako-Ilirët, stërgjyshër të Shqiptarëve, ishin paraardhësit e dy qytetërimeve të shkëlqyera europiane: grek dhe romak. Por thirrja e tyre shkoi kot sepse nuk u dëgjua nga ata studiues, të cilët në epoka të ndryshme dhe nga maja e katedrës së tyre universitare apo nga kulla e tyre e fildishtë, mbisundonin majat e gjuhësisë dhe të historisë së lashtë të Europës.

Një numër i madh i ithtarëve të tyre kanë ndjekur me budallallëk tezat e tyre të gabuara, pistat e tyre të gabuara apo thjesh dogmën e tyre.

Gjuhësia nga njëra anë dhe historiografia e Greqisë parahelene nga ana tjetër kanë rënë në të njëjtën grackë, atë të zanafillës së Grekëve, e cila ka qenë lidhur apo përngjitur me atë të Mikenianëve, nga të cilët edhe kanë nxjerrë përfundimisht prejardhjen e Helenëve. Përse atëherë? Sepse në vitin 1952 Mikel Ventris, të cilit më pas iu bashkua Xhon Kadvik, besoi se zbuloi në Linearin B një formë të lashtë të greqishtes, ndërkohë që ishte fjala për një gjuhë parahelene (pellazge), nga e cila gjuha greke kishte bërë huazime të shumta! Në pamje të parë, ishte krejt normale të gjeje në këtë nënshtresë pellazge (mikeniane) një farë ngjashmërie me greqishten e lashtë, meqenëse kjo e fundit e ka ndjerë ndikimin e saj. Kjo greqishte ka trashëguar disa veçori gramatikore, disa forma sintaksore dhe një farë numri fjalësh që janë të pellazgjishtes së lashtë dhe që rigjenden në shqipen e sotme. Ky është rrethi vicioz rreth të cilit rrotullohen të gjithë. Kësisoj ngatërrohet gjithçka, mbivendosen apo kthehen anasjelltas të dhëna të ndryshme dhe bëhen përzierje të ndryshme në faktet historike, mitet, emrat e perëndive, heronjve dhe vendeve. Megjithatë mjafton të rilexohen autorët antikë, ndër të cilët Hekate i Miletit, Helanikos i Mitilenit, Herodoti ose Tuqididi për të dalluar se përpara "mbërritjes" së Grekëve, Pellazgët ishin zotë të vendit që do të bëhej Greqi! Për së dyti, disa prej tyre në një farë mënyre i kanë poshtëruar Pellazgët duke mos iu dhënë vendin që u kishin caktuar autorët antikë për sa i takon së vërtetës historike të qytetërimit të tyre shumë më të mëparshëm nga ai i Grekëve. Pastaj ka patur një "boshllëk" prej katër shekujsh (midis viteve 1200-800 para Krishtit) që cilësohet i errët sepse nuk është e perceptueshme asgjë greke dhe asnjë element i besueshëm nuk arrin të vërtetojë praninë e Helenëve. Pavarësisht kësaj, disa kanë dashur t`i shohin Grekët kudo, madje edhe përpara ekzistencës së tyre! Është kjo, çfarë unë kam vendosur të analizoj dhe të paraqes me ndihmën e argumenteve të

verifikueshme apo të dallueshme dhe me anë provash të qarta.

Alfabeti grek në fillim ka qenë quajtur "phoenika grammata" (germa fenikase) ose "kadmeia grammata" (germat kadmene). Quhen gjithashtu germat pellazge! Herodoti pohon se është Kadmosi ai që i futi në Greqi bashkë me artet e tjera apo shpikjet fenikase (V, 58, 59). Sipas disave ky alfabet ka dalë nga proto-sinatikja (fenikase, hebre, armene). Në të vërtetë forma e germave është e përafërt madje e njëjtë me ato fenikase. Grekët i kanë shqiptuar një për një këto germa me theksin e tyre, por duke imituar të njëjtën fonetikë. Gjithsesi këto germa nuk kanë asnjëfarë kuptimi në greqisht, krejt ndryshe nga gjuhën fenikase: Aleph (bagëti, dem apo ka), Bet (shtëpi), Gimel (deve), Hé (njeri që lutet) etj. Greqishtja arkaike përdorte njëzet e dy (22) germa të dala nga alfabeti semitiko-perëndimor (kanaen, paleo-hebraik), ndër të cilat disa janë kthyer në zanore. Grekët i kanë shtuar germat Y, PHI, KHI, PSI, OMEGA, të cilat i kanë vendosur në fund të alfabetit fenikas. Sa i takon greqishtes moderne, ajo ka njëzet e katër germa (24). Zanoret janë shtatë (a, e, e, i, o, o, u). Shkrimi grek në fillim shkruhej horizontalisht nga e djathta në të majtë madje në mënyrë alternative (bustrofedone). Mbishkrimet e para u shfaqën rreth viteve 740-730 para Krishtit. Por pika e hasjes, e mbetur misterioze, pasi përdorimi i këtij shkrimi nuk ka qenë patjetër Greqia. A të ketë qenë në Lidi, në Kumenë, Italinë e Jugut apo në Egje? Asgjë nuk mund të na japë me vërtetësi një përgjigje pa gabuar. Kjo bën pjesë në pikat e errëta që mbulon historinë e Greqisë së lashtë, por që disa ende i shohin të qarta e të kulluara: zanafillë, gjuhë, histori mitologji...!

Sidoqoftë nga fundi i epokës arkaike dhe gjatë epokës klasike, Grekët flisnin vetëm një gjuhë dhe kuptoheshin midis tyre, pavarësisht larmisë së dialekteve të tyre. Por kudo ata jetonin midis apo të rrethuar nga popullsi që flisnin një gjuhë krejt të ndryshme. Për arsye të morisë së fiseve (disa i thonë popuj), të cilët flisnin këtë gjuhë, ata besonin se fliteshin gjuhë të ndryshme të shumta në numër, ndërkohë që ka qenë

folur një gjuhë e vetme, por në dialekte apo aksentë të ndryshëm. Ata i quajtën popuj barbarë, që në kuptimin që i jepej në epokën klasike, ishin ata që flisnin një gjuhë të "pakuptueshme", pra të ndryshme nga greqishtja.

Këta Grekë ndër vendet që ata pushtuan ishin të paktë në numër në këtë epokë të hershme. Ishte fjala për një kastë drejtuesish të cilët nënshtruan vendin duke dëbuar prijësit apo mbretërit e qyteteve që ata pushtuan (Danaos Egjiptiani në Argos, Kadmos Fenikasi në Tebë, Pelops Azianiku në Lakedemonia, etj...) Pra këta Grekë mbërritën me gjuhën dhe kulturën e tyre. Por shumë shpejt ata asimiluan një pjesë të madhe të gjuhës, kulturës, fesë, miteve stërgjyshore të popullsive autoktone të trungut pellazg. Ata përfunduan duke krijuar gjeneanologji falso në mënyrë që të besohej se edhe ata ishin autoktonë. Kjo ide e fundit rigjendet e ripërsëritur pambarimisht, pothuajse në të gjitha ceremonitë e tyre fetare dhe kremtimeve politike-shoqërore. Fakti gjendet po aty, ata gjendeshin në një vend i cili nuk ishte i tyre dhe ku shumica e popullsisë me zanafillë etnike të ndryshme fliste një gjuhë të huaj. Me kalimin e kohës dhe ndikimin e popullsive të trungut pellazg, e folura e grekëve pësoi disa ndryshime sipas krahinave (theksat, dialektet). Ky dallim i të folurit është në zanafillë të dialekteve greke, të cilat i ripërtërinë në fise të ndryshme që i quajtën Jonianë, Eolianë dhe Dorianë. Pra duke filluar nga ndarjet gjuhësore ose dialektore u krijuan artificialisht ndarjet etnike.

Më vonë komentarët japin të dhëna se, në skutat ku u kufizuan, popullsitë e lashta parahelene (pellazge) kishin ruajtur një theks dhe një të folur të ndryshme nga tri të tjerat: Arkadi (si rastësisht një nga vatrat e Pellazgëve) dhe Qipro (koloni e lashtë pellazge, e mbiquajtur mikeniane). Ja përse këta eruditë të penës krijuan dialektin arkado-qipriot, të cilin e deklaruan si më të lashtin e Greqisë dhe të afërt me popullsitë parahelene të trajtuara gabimisht si stërgjyshër të Grekëve. Mirëpo Arkado-Qipriotja ka ruajtur përafërsi të shumta me Pellazgjishten e lashtë (e mbiquajtur mikeniane). A nuk na e thotë këtë legjenda se Evandri, i lindur në Arkadi,

ishte njeriu i parë që futi alfabetin pellazg në Itali dhe më saktë në Latium mbi malin Palatin? Për një kohë të gjatë Arkadia ruajti kultet dhe traditat e mirëfillta pellazge. Kjo është e vetmja krahinë e Greqisë qendrore që ka ditur të ruhet dhe të formohet si traditë stërgjyshore shumë më pas pushtimit të Helenëve.

Ja pra me pak fjalë historia e këtyre dialekteve të zëvendësuar në etni (për më shumë hollësi në lidhje me këtë temë drejtohuni në kapitujt përkatës me studimet dhe analizat e ndryshme që kanë të bëjnë me etnitë greke: që do të dalë së shpejti). Së fundi, në lidhje me shkrimin grek shënojmë se mbishkrimet e para mbi poçeritë ose epigrafet më të lashta datojnë qysh nga fundi i shekullit VIII para Krishtit: të gjetura paradoksalisht (për shembull gota e Nestorit) në ishullin e Pitekuzës, etapa e parë e kolonëve grekë përpara pushtimit të tyre të Kumës. Tekstet e para të shkruara, mbi të gjitha poezi lirike, datojnë vetëm nga shekulli VII. Iliada dhe Odiseja u botuan zyrtarisht vetëm nën sundimin e Pisistratit (rreth viteve 600–527 para Krishtit). Ky i fundit kishte hartuar recitimin e këtyre poemave epike gjatë festimit të Parathënëve. Mbishkrimi i parë në dialektin atik, i cili përmend etnonimin e Helenëve daton nga vitit 586 para Krishtit.

Ja ndarja gjeografike e dialekteve të ndryshme greke:

* Eolian: Beoti, Thesali, veriu i Egjeut, ndër të cilët Lesbos, Eolidë (Azia e Vogël).

* Dorian i lidhur me dialektin e veri-perëndimit (Fosidë, dy Lokridat, Akarnani, Etoli, Elidë): Peloponezi lindor dhe jugor, ishujt jugorë të Egjeut (duke përfshirë aty Kretën, bregun jug-perëndimor të Azisë së Vogël, ndër të cilët Rodin dhe së fundi Sisilia dhe Greqia e Madhe.

* Arkado-Qipriot: Arkadi, Qipro dhe në një masë më të vogël Pamfili, dialekti i së cilës është i përzier me atë dorian.

Kjo kap krejtësisht analizat e mia të forcuara gjatë veprës që keni në dorë. Në të vërtetë dialekti jonian i përket një grupi arkado-qipriot që ka dalë drejtpërdrejt nga ai mikenian (unë e quaj kështu për lehtësi).

Herodoti na thotë se Athinas-Jonianët (VII, 94; I, 56; VIII, 44) dhe Eolianët (VII, 95) ishin Pellazgë, të cilët u kthyen në Helenë duke përshtatur gjuhën greke. Përveç kësaj dimë se Arkadia, vendi ku lindi Zeusi pellazg (Iliada XVI, 234) dhe Pelasgos (mbret dhe eponim i Pellazgëve) bashkë me Thesalinë dhe Epirin ishte një nga tri vatrat pellazge të Greqisë së lashtë. Paralelizmi është befasues. Këto tri rajone, që mbajnë vulën e stërgjyshërve të tyre, kanë qenë të ndikuara më shumë se të tjerat nga Pellazgët. Ja përse disa pohojnë se këto dy dialekte ishin të lashtë dhe të afërt me atë mikenian. Duhet shënuar se ky emërtim i fundit është jo vetëm emërtim artificial, por një krijim i arkeologëve modernë, të cilët zbuluan në Mikenë (qytet i përmendur nga Homeri se ishte i mbushur me ar) rrënoja parahelene dhe në veçanti maska të arta. Ja përse ky qytetërim parahelen u quajt zyrtarisht "qytetërim mikenian", ndërkohë që asnjë autor antik nuk e përmend këtë. A nuk është pra e habitshme që Arkadianët dhe Qipriotët të kenë ruajtur huazime të shumta gjuhësore, kulturore, të kultit dhe përafërsi të tjera me popullsitë pellazge që banonin në këto zona të Greqisë deri në një epokë tejet të vonë dhe ndërkohë flisnin gjuhën e tyre stërgjyshore (Herodoti i ka përmendur tashmë në vende të shumta të Greqisë kontinentale dhe në Egje)?

Ky është një nga gurët themeltarë sepse të gjithë autorët e kohëve tona janë futur në këtë pistë të gabuar mikeninane. Në të vërtetë mjaftoi që dy autorë, Ventris dhe Kadvik, të shpallnin se dialekti mikenian ishte një formë arkaike e greqishtes së lashtë, ndërkohë që bëhej fjalë për pellazgjishten, dhe kësisoj e gjithë bota të përpihej në këtë udhë pa krye. Pikësëpari, shkrimi (Lineari B) që ata zbuluan në tabelëzat prej argjile ishte një nga variantet që rridhnin nga Lineari A kretas (i cili ka mbetur i padeshifruar). Shkruesit e pallateve, të mbiquajtur mikenianë, kanë transkriptuar dialektin e tyre me anë të këtij Lineari B. Përpos kësaj, ky shkrim nuk është domethënës apo vendimtar sepse nuk na mëson asgjë mbi historinë apo faktet historike të këtyre popullsive,

meqenëse nuk është fjala për një shkrim letrar por për një përllogaritje përmbledhëse dhe lista të prodhimeve të ndryshme që kanë të bëjnë me shkëmbime tregtare. Përveç kësaj, aty gjendet pjesa më e madhe e emrave të perëndive parahelene, të cilat nuk shpjegohen me asnjë gjuhë tjetër përveçse shqipes së sotme! Kësisoj, këta dy deshifruesit tanë të shquar vërejtën një farë "ngjashmërie" me greqishten e lashtë. Prandaj ata pohuan se bëhej fjalë për gjuhën mëmë të greqishtes së lashtë. E gjithë bota shkencore u sul mbi këtë rast dhe nisi të bëjë shpjegime mbi zanafillën e Grekëve "të cilët mund ta kishin prejardhjen vetëm nga këta Mikenas hipotetikë". Por pikërisht këtu është kleçka, pasi këta dijetarë nuk kanë përthithur mjaft mirë gjithshka që kanë pohuar autorët antikë në lidhje me Pellazgët, d.m.th se ata ishin banorët e parë (që flisnin një gjuhë barbare) të Greqisë përpara mbërritjes së Grekëve, të cilët trashëguan traditat e tyre të kultit dhe prurje të ndryshme kulturore dhe teknike. Për fat të keq, duke mos bërë asnjë përqasje midis pellazgjishtes së lashtë (gjuha e "Mikenianëve" të famshëm) dhe thrako-ilirishtes dhe shqipes, ata i kanë çuar hulumtuesit në gabime nga brezi në brez.

Kësisoj, nëse ka patur Pellazgë gjatë kësaj periudhe parahelene, nuk mund të ketë patur Grekë dhe aq më pak stërgjyshër të lavdishëm, të tillë si ata të shkruar në Iliada dhe Odise. Pastaj, së fundi e gjithë kjo përputhet dhe vërtetohet nga toponimet, oronimet, antroponimet, eponimet dhe etnonimet, të cilat nuk mund të deshifrohen me anë të gjuhës greke, por vetëm me anë të shqipes së sotme, e vetmja që ka shpëtuar nga kjo gjuhë parahelene dhe që është bërë një lloj dedektori magjik. Nëse gjuha e këtyre, të cilët quhen Mikenianë, ishte greqishtja, atëherë përse nuk arrin të dekriptojë pjesën më të madhe të emrave të shumtë të perëndive të mitologjisë si dhe emrat e heronjve dhe toponimet e përmendura në Iliada dhe Odiseja?

Ja një shembull, midis shumë të tjerëve, që përcakton këtë mangësi mendjemprehtësie ose gjykimi në leximin e teksteve antike dhe verbim apo kokëfortësi të padëgjuar, që nuk kanë parë apo nuk kanë dashur të

shohin te Pellazgët vetëm një emër gjenerik të përdorur nga një mori popujsh të ndryshëm dhe heterogjenë, të cilët kanë folur gjuhë të ndryshme dhe për më tepër nuk përbënin një trung. Antuan Meje, një nga predikuesit e parë të gjuhësisë moderne, na e shpreh këtë në veprën e tij "Vështrim mbi historinë e gjuhës greke" (Klincksieck, Paris 1965): .... idiomë e lashtë... Kjo idiomë nuk ka qenë kurrë e fiksuar me anë të të shkruarit; nuk ka mbijetuar asnjë monument i saj, nuk ka mbetur një kujtim i popullit që e përdori... Mirëpo në të vërtetë del se asnjë gjuhë e përbashkët nuk ka mbijetuar, e cila të paraqesë përputhje me greqishten në një tërësi risish karakteristike; kështu nga një aksident historik greqishtja shfaqej e izoluar midis gjuhëve indo-europiane". Ndërsa për Pellazgjishten ky monument ekziston dhe është fjala për shumë më tepër se kjo: për një fosile të gjallë, që është shqipja e sotme. Ja sesi, për shkak të padijes apo të njohjes jo mirë të gjuhës shqipe, historia parahelene dhe gjuhësia moderne kanë mbetur në qorrsokak. Shumë pak dijetarë e kanë kuptuar këtë. Këtyre për fat të keq nuk ua kanë vënë veshin kurrë.

Alfabeti i ri grek

Α, α = alfa, a	Η, η = ita	Ν, ν = N, n	Τ, τ = T, t
Β, β = beta, b	Θ, θ = Th, th	Ξ, ξ = ksi	Υ = y
Γ, γ = G, g	Ι, ι = I, i	Ο, = o	Φ, φ = F, f
Δ, δ = D, d	Κ, κ = K,k	Π, π = P, p	Χ, χ = K,k
Ε, ε = E, e	Λ, λ = L, l	Ρ, ρ = R, r	Ψ, ψ = psi
Ζ, ζ = Z, z	Μ, μ = M, m	Σ, σ, ς = S, s	Ω, ω = O, o

Vihet re se germa B, b nuk ekziston nga ana fonetike në alfabetin grek meqenëse ajo shqiptohet V,v. Që të mund të shqiptohet kjo germë përdoret bashkimi i dy bashkëtingëlloreve të tjera MP, mp apoΜΠ, μπ..

Pellazgo-shqipja dhe gjuhët jo semitike: sumeriane dhe elamite

Nuk mund ta përfundoj këtë kapitull në lidhje me gjuhësinë, pa folur për gjuhën dhe shkrimin sumerian, më të lashtin që njihet nga Lindja e Mesme. Për fat të keq do të flisja vetëm shumë shkurt, sepse

nuk kam kryer asnjë studim të thelluar në lidhje me këtë temë.

Sa për krahasim, hieroglifët u shfaqën vetëm rreth viteve 3100 para Krishtit.

Ndër qytetërimet e njohura, gjuha sumeriane është gjuha më e lashtë e shkruar. Piktogramet e para datojnë nga viti 3500 para Krishtit. Sumerianët janë shpikësit e shkrimit Kuneiform. Disa e vendosin shfaqjen e këtij shkrimi midis viteve 3300–3200 para Krishtit. Qysh nga antikiteti më i hershëm (mijëvjeçari IV) ata zinin rajonin që gjendej midis jugut të Babilonisë dhe Gjirit Persik. Qendrat kryesore të tyre të qytetërimit ishin Uruk, Kish, Larsa, Lagash, Ur-Nanshe, Sumer, Nipur. Ky qytetërim (kulturë, gjuhë, fe) nuk shfaqet në asnjë gjuhë tjetër të njohur: Sumerianët janë më vete në histori. Emri i Sumerianëve na vjen nga Babilonasit, të cilët i quanin Sumeru dhe nga Egjiptianët që i quanin Sngr.

Sipas teksteve sumeriane, qyteti më i vjetër i përmendur do të ketë qenë Eridu. Zona e tij do të ketë qene e identifikuar me vendin e mbiquajtur Abou Shahrein, pesëmbëdhjetë kilometra në jug-perëndim të zonës së lashtë të qytetit të Ur-it. Ky ishte qyteti i Enkit, perëndia e shiut dhe e ajrit të lagësht. Përpara dinastisë së parë të Lagashit (2500–2350 para Krishtit) kishte tri epoka paradinastike: Eridu (rreth 4500 para Krishtit), Obeid (rreth 4000 para Krishtit), Uruk (rreth 3000 para Krishtit, epoka heroike). Nuk ekziston version sumerian zanafillor i tërësisë së epopesë së Gilgameshit. Babilonasit kanë modifikuar dhe kanë lidhur midis tyre rrëfenja të ndryshme të shkëputura, të huazuara nga Sumerianët. Sipas S.N. Kramer (Historia fillon në Sumer, Flammarion 1994) rrëfenja biblike e Përmbytjes nuk është një krijim hebraik. Specialistët kanë arritur të identifikojnë disa episode me zanafillë sumeriane: episode të Pyllit të Sedrëve (tabelëzat III - V), të Demit hyjnor (tabelëza VI) paragrafë të shumtë të kërkimit të pavdekësisë (tabelëzat IX, X,XI) dhe atë të Përmbytjes (tabelëza XI).

Këtu më poshtë unë po hap një parantezë të shkurtër. Pa rrezikuar shumë që të gabojmë, ne mund të bëjmë një paralelizëm me Iliadën dhe Odisenë e Homerit (Homeri, nëse me të vërtetë ka ekzistuar, rreth

fillimit apo mesit të shekullit VIII do të ketë qenë një nga dëshmitarët okularë të mbërritjes së Grekëve në rajonin ballkano-egjeas). Këto epope traditash gojore, të mbiquajtura homerike, janë dorëzuar apo botuar zyrtarisht vetëm nën Pisistratin, afërsisht nga mesi i shekullit VI para Krishtit dhe të përpunuara përfundimisht (të tilla siç i njohim ne sot) në epokën e mbiquajtur Aleksandrine, në të cilën Aristarku (rreth 214–143 para Krishtit) ishte një nga kritikët më të shquar. Në të vërtetë këto poema me zanafillë pellazge, me kalimin e kohës kanë pësuar modifikime të ndryshme, ripunime dhe ndërfutje të tjera nga zotët e rinj të vendit të Pellazgëve: Grekët...

Pas shpartallimit të tyre përpara Semitëve të udhëhequr nga Hamurabi rreth vitit 1757 para Krishtit, Sumerianët u zhdukën nga skena politike, por jo pa u lënë trashëgim asiro-babilonasve elemente të shumta të qytetërimit të tyre të përparuar. Gjuha e tyre mbijetoi për një kohë të gjatë si gjuhë dijeje dhe kishtare (të njëjtin rol që ka luajtur në Perëndim gjuha latine). Traditat e tyre mbetën të gjalla përmes kulturës mesopotame të Babilonisë.

Duke folur për tipin e tyre fizik, nga ana antropologjike ky është i afërt me atë të Europianëve. Në të vërtetë sipas disa studimeve të ndryshme (antropologjike, etnologjike, gjuhësore ose arkeologjike), nuk bëhej fjalë për Semitët. Ata bënin pjesë ndër ata që disa autorë i quanin Malësorë. Vendi i zanafillës së tyre ka mbetur gjithmonë i diskutueshëm.

Për sa u takon Elamitëve, zanafilla e tyre ka mbetur e paqartë, gjuha e tyre aglutinante (përngjitëse) ishte e përafërt me atë sumeriane. Por disa gjuhëtarë e bashkëngjisin atë me dravidianen (në jug të Indisë) madje me atë brahui (gjuhë e folur gjithmonë në Balukistan). Suse (Susu në gjuhën akadiane, Suzan në atë hebraike dhe Sousa në greqisht) ishte kryeqyteti i tyre kryesor. Elami ishte një vend shumë i lakmuar për shkak të pasurive të mëdha: bakër, plumb, argjend, dru, gurë për ndërtim, gurë të çmuar (alabastër, diorit).Ky popull ka banuar në rajonin malor që shkonte nga rrafshina mesapotamike në rrafshnaltën iraniane, duke përfshirë Zagrosin, Luristanin dhe Kuzistanin e sotëm.

Shumë më herët ai do të ketë luajtur një rol të rëndësishëm në historinë e lashtë të Azisë së Vogël.

Shkrimi elamit Kuneiform ka qenë një nga tri gjuhët e përdorura bashkë me persishten e vjetër dhe atë akadiane nga Perandoria akemenide (shekulli VI- IV para Krishtit). Emri Elam (Toka e Perëndisë) ose Elamtu (ne greqisht Elumais) rrjedh nga një shtrembërim biblik i Haltamti ose Hatamtu, mbretëri e lashtë që gjendej në jug-perëndim të rrafshnaltës iraniane (Kuzistani i sotëm). Gjithsesi elemente të shumtë gjuhësorë të rëndësishëm, pikërisht struktura e gjuhës elamite, madje edhe tekstet akemenide nuk janë qartësuar krejtësisht.

Le të shohim tashmë një nga gjuhët (relativisht) të lashta dhe të studiuara më në përgjithësi nga gjuhëtarët modernë: sanskritishtja. Në të vërtetë, qysh nga shekulli XIX sanskritishtja përdoret (grupi indo-iranian) si bazë krahasimi me gjuhë të tjera të mbiquajtura indo-europiane. Disa pothuajse e kanë bërë atë etalon.

Sanskritishtja, gjuhë e fisnikëve (samskrta) gjendet përballë asaj prakrite, gjuhë e popullit (prakrta). Alfabeti i saj është silabik. Fillimisht gojore, kjo gjuhë që rrjedh nga vedikja e lashtë është transkriptuar shumë vonë. Ajo nuk është aq e lashtë sa pretendojnë disa gjuhëtarë, të cilët e kanë bërë një element thelbësor në studimet e tyre krahasuese. Kjo na çon në paradoksin e mëposhtëm: grupi gjuhësor parahelen (ballkano-danubian, egjean, anatolian, i dalë nga pellazgjishtja e lashtë, por për të cilën fatkeqësisht dokumentet e lashta janë qoftë të rralla qoftë të pamjaftueshme qoftë që nuk ekzistojnë) i dy mijëvjeçarëve më të lashtë shpesh ka qenë fshehur në përfitim të sanskritishtes.

Tekstet e para të familjes indiane, duke përfshirë indishten vedike, të quajtur nganjëherë sanskritishtja vedike dhe e përbërë nga katër përmbledhje hymnesh (Rig-Veda, Atharva-Veda, Sama-Veda dhe Yajur-Veda), pastaj sanskritishtja e vërtetë vedike (gjuhë shumë e vonshme) e fiksuar si gjuhë kishtare e brahmanizmit dhe që nuk do të ketë qenë një gjuhë e mirëfilltë. Sipas Mejesë ajo mbështetet në dialektin e veri-perëndimit të Indisë (Penxhab) me prurje të shumta të dialekteve të

Lindjes aziatike. Rig-Veda (Veda e këngëve), e trajtuar si më arkaikja e teksteve vedike (shekulli VIII, VII para Krishtit?) është një përmbledhje liturgjike e himneve. Ndër më të rëndësishmet janë Atharva-Veda, e cila është një himn lutjesh, namatisjesh dhe formulash magjike (veda e priftërinjve Atharvanë), Brahmana (shënime shpjeguese për Vedan), Upanisad (traktate filozofike), etj. Mahabaratë, Ramajana janë epope të mëdha në vargje si dhe frymëzimi laik të shkruara në sanskritishten klasike. Përdorimi i sanskritishtes laike është futur shumë vonë.

Ja çfarë na thotë Meje (Gjuhët e botës, 1952) në lidhje me sanskritishten: "Duke filluar nga shekulli IV sanskritishtja bëhet gjuha e vetme e epigrafisë zyrtare. Sanskritishtja klasike, e vendosur si gjuhë e dijes nga vepra e gramatikanëve të shumtë (mbi të gjithë Panini, shekulli IV para Krishtit) ka krijuar një letërsi tejet të gjerë (lirike, dramatike, rrëfimtare, filozofike, teknike etj.) dhe u ruajt deri në epokën moderne si gjuhë letrare dhe si gjuhë e dijes: Panditët e Indisë e përdornin këtë gjuhë ashtu si dijetarët e Mesjetës përdornin latinishten". Dhe në lidhje me tekstet më të lashta vedike ai pohon në veprën e tij "Vështrim në historinë e gjuhës greke" (Klincksieck, 1965): "Shpesh Rig-Vegas i vishet një datë tejet e hershme; por shkrimi nuk është shumë i lashtë në Indi; dhe meqë nuk është aspak e besueshme që një tekst i dëgjuar të jetë ruajtur gojarisht pa pësuar ndryshime të mëdha gjuhe përgjatë shekujve, duhet pranuar që, të paktën në formën e tyre gjuhësore, tekstet më të lashta vedike janë po aq të lashta sa tekstet homerike". Ky paragrafi i fundit do të thotë së tekstet më të lashta vedike datojnë, më e hershmja, në shekullin VIII para Krishtit, pse jo shekulli VII, madje shekulli VI para Krishtit.

Midis gjuhëve me zanafillë indiane, përveç gjuhës vedike, sanskrite dhe pali, ekzistojnë edhe gjuhë të tjera më të vonshme, ndër të cilat hindi, urdu, bengali, penxhabi, singale, nepali dhe cigane (e quajtur gjithashtu gitan apo romani). Gjuhëtarët modernë kanë shpikur termin indo-iranian duke përqasur grupin gjuhësor që paraprin atë të zanafillës iraniane, i cili përfshin persishten e vjetër, avestiken, pehlevi, parte,

sogdiane dhe persishten moderne (farsi ose iraniane), kurde, afgane, osete, taxhik, baluçe dhe pashtu. Pra, në këtë mënyrë ka lindur grupi gjuhësor i quajtur indo-iranian, pjesa aziatike e grupit indo-europian.

Baskët dhe gjuha e tyre

Këtu nuk do të ndërmarrim në analizë shkrimin e të gjithë historisë së Baskëve, por thjesht një skemë të pjesës së saj më të lashtë, si dhe do të ve në dukje përputhjet historike, dhe mbi të gjitha gjuhësore, që ekzistojnë midis kulturës së tyre dhe gjuhës si dhe kulturave dhe gjuhëve të tjera të lashta, madje atyre të sotme, në këtë rast gjuha shqipe.

Populli bask nuk është përmendur nga autorët antikë. A i kanë ngatërruar me Iberët? A të ketë dalë nga e njëjta etni si edhe Iberët? Nëse Tartesianët trajtohen si Iberë, përgjigjja është po, dhe Baskët mund të trajtohen si një krijim i vërtetë i popullsive të para europiane dhe fillimisht e Pellazgëve, të cilët ishin pararendësit e qytetërimeve të para neolotike, ndër të cilat Ligurët dhe Iberët përbënin degën perëndimore. Në planin gjuhësor nënshtresa iberike ka të ngjarë të ketë pësuar disa ndikime afro-semitike dhe shumë më vonë ato greke dhe romake. Për sa i takon Baskëve, a është fjala me të vërtetë për një nënndarje të popullit iber, i cili i shtyrë nga pushtimet e jugut u ngjit drejt veriut dhe u strehua në Pirenej në një epokë të mugët? Në lidhje me temën e tyre është shkruar shumë dhe gjithmonë ekzistojnë kundërshtitë, për mungesë të dokumenteve të shkruara ose të dëshmive të besueshme. Gjithsesi gjuhësia hedh një dritë të re dhe na bën të mundur të dallojmë më mirë enigmën baske. Por krejt ndryshe nga Iberët e jugut të gadishullit, Baskët do ta kenë ndjerë më pak ndikimin kulturor apo gjuhësor të kolonizimeve të reja.

Ja përse emri i tyre, i panjohur nga autorët klasikë të antikitetit u shfaq më vonë, gjë që i bën Baskët të trajtohen si një popull relativisht i vonshëm ose më pak i lashtë se të tjerët. Unë nga ana ime mendoj se shumë herët Baskët u mënjanuan nga çdo qytetërim, duke u izoluar në strehën e tyre natyrore që formohej nga vargmali i Pirenejve midis

Francës dhe Spanjës. Kjo është taktika e përdorur nga të gjithë popujt e lashtë të trungut pellazg: Pellazgët e Arkadisë, Lelegët e Lakonisë, Pellazgët e Kretës dhe të Qipros, Ligurët e jug-perëndimit të Europës, prej Marsejës deri në Piemontit, Thrako-Ilirët e Europës qendrore dhe jugore (Alpet në Ballkan) etj. Falë këtyre tërheqjeve taktike, disa popullsi të lashta si për mrekulli janë rishfaqur më vrullshëm në mugëtirat e Antikitetit, madje të parahistorisë, sa në planin kulturor aq edhe gjuhësor: Shqiptarët e sotshëm, disa popuj të Kaukazit, Baskët, Kurdët në Lindjen e Mesme ose Berberët në Afrikën e veriut etj. Falë maleve të tyre të pamposhtura dhe izolimit të tyre këta popuj arritën të ruajnë pothuajse të paprekur fondet e tyre zanafillore dhe në veçanti kulturën e tyre, një pjesë të madhe të traditave, zakoneve dhe mbi të gjitha gjuhën e tyre.

Përveç kësaj, fakti që nuk është folur shumë për ta nuk do të thotë aspak se të gjithë këta popuj nuk kanë patur histori apo se kanë përbërë një sasi të papërfillshme popujsh të vegjël. Sot ata janë kujtesa, njëherësh e historisë, gjuhës dhe kulturës së tyre shumë herë mijëvjeçare, të cilën ata e kanë trashëguar nga stërgjyshërit e tyre të lavdishëm përpara se të ndaheshin përjetësisht. Pikësëpari duhet thënë se të gjitha këto gjuhë dhe këto kultura të lashta të mbërritura deri në ditët tona pa shumë dëme, kanë evoluar në mënyrë të izoluar në raport me vatrën e tyre zanafillore respektive dhe janë zhvilluar në mjedise të veçanta. Nënkuptohet se kjo nuk përjashton futje të huaja të mëvonshme dhe ndikime të ndryshme si në planin gjuhësor edhe në atë kulturor, madje antropologjik, të cilat arrihen të dallohen me mjaft lehtësi.

Kalimthi shënoj se Cezari pohonte se Akuitenët (baskët e sotshëm, bregu francez) zinin të gjithë rajonin e përfshirë midis Pirenejve, Garonës dhe oqeanit.

Gjuha baske e shkëputur shumë shpejt nga mjedisi i saj stërgjyshor ka ndjekur një rrugë zhvillimi paralele me degën mëmë dhe me dialektet e ndryshme të saj. Duhet shënuar se shpesh dy gjuhë shumë të afërta në fillim të zhvilluara në mënyrë të izoluar ose më vete, mund të kenë patur

një fjalor të ndryshëm por nga ana tjetër do të kenë ruajtur të paprekura fondet e tyre gjuhësore zanafillore, fonetikën e tyre dhe strukturën e tyre sintaksore apo gramatikore themelore. Prandaj për të studiuar të gjitha këto gjuhë të lashta dhe mbi të gjitha të izoluara, si gjuha baske apo shqipja e sotme, duhet t'i pastrosh nga të gjitha llojet e fjalëve parazitare dhe neologjizmave të krijuara duke u nisur nga fjalët e huaja. Unë do t'i quaja këto, nëse do të guxoja ta shprehja, skorie të të folurit. Pasi të jetë kryer kjo punë dallohet shpesh me lehtësi se ekziston një fill-lidhës midis disa gjuhëve të dala nga i njëjti fond gjuhësor.

Për shembull gjuhëtari italian Trombeti pohon se gjuha baske është një mbetje e gjuhës kaukaziane, hapësira e së cilës shtrihej në të dy skajet e kontinentit europian d.m.th. nga Kaukazi deri në Pirene. Kur dihet se ekzistojnë përafërsi të shumta, nga njëra anë midis kaukazianes dhe baskes dhe nga ana tjetër gjuhës shqipe, kuptohet më mirë shtrirja e kësaj përhapjeje, duke filluar nga rajoni danubo-ballkanik që është pikënisja e kulturës pellazge. Në të vërtetë Trombeti gabohet duke e bërë Kaukazin një zonë "qytetëruese", e cila do të ketë përhapur njëherësh kulturën dhe gjuhën e saj kundrejt rajoneve të tjera, ndërkohë që Ballkani dhe lugina e Danubit kanë qenë vatrat e para qytetëruese të Europës.

Megjithatë disa eruditë të kohëve tona nuk hezitojnë t'i ndajnë Baskët dhe Iberët. Nëse ata kanë arritur në këtë mendim, kjo ndodh pa dyshim sepse ata nuk i kanë hulumtuar aspak ose aq sa duhet të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me këto dy etni dhe as nuk kanë bërë përqasjet e nevojshme, as përputhjet e domosdoshme si në planet historike, gjuhësore dhe kulturore aq edhe në planet antropologjike dhe etnike. Megjithatë elemente të ndryshëm dhe të shumtë priren t'i përqasin Baskët dhe Tartesianët, të dalë nga i njëjta tërësi etno-kulturore në të cilën bëjnë pjesë Ligurët, Lelegët, Etruskët, Pellazgët apo Thrako-Ilirët, nga të cilët rrjedhin Shqiptarët e sotëm. Si rrjedhojë ne nuk mund t'i shkëputim të gjitha këto etni nga njëra tjetra. Kjo tërësi etno-gjuhësore, duke nisur nga vatra qendrore e saj (ballkano-danubiane) do të ketë lulëzuar në një perimetër të stërmadh, duke shkuar prej Atlantikut (p.sh. me Baskët),

në Kaukaz (p.sh. me Dagestan, Abkhazi, Leghistan, Armeni si dhe vendet e Tushëve, Çerkezëve ose Sirkazianëve, Kushanëve dhe Kabardëve) duke kaluar nga Italia, Greqia, Egje dhe Azi e Vogël.

Ja përse rigjenden gjurmë (kultura, gjuha, mbetje toponimike dhe arkeologjike tejet të ngjashme) të shumta të këtyre popujve vëllezër nga pak kudo nëpër Europë dhe mbi të gjitha në hapësirën mesdhetare. Ata që kanë dashur t'i veçojnë apo t'i ndajnë Pellazgët, Lelegët, Ligurët, Etruskët, Frigjianët, Thrako-Frigjianët dhe popuj të tjerë të dalë nga i njëjti trung etnik kanë ndjekur pista të shumta të gabuara, e kanë bërë një lëmsh të ngatërruar historinë e lashtë të popujve të botës së vjetër dhe kanë dëmtuar shumë rëndë çdo përparim në drejtim të njohjes së të vërtetës apo të paktën për një konceptim më të drejtë të kësaj pjese të botës parahistorike, proto-historike dhe antike, kërthiza e njerëzimit dhe përtëritësja e qytetërimeve tepër madhështore.

Akoma më e rëndë ka qenë njohja jo e mirë apo shpërfillja e studimit të gjuhës shqipe, e cila duket se është një bazament i rëndësishëm, madje një nga mbetjet e rralla të asaj që ishte gjuha apo gjuhët e para të Europës. Unë mendoj se themelet e asaj që quhet "gjuhët indo-europiane", shpikje e gjuhëtarëve të fundit të shekullit XIX, janë aktualizuar apo janë rishikuar me seriozitet. Duke besuar në zhdukjen e gjuhës Pellazge, madje të Pellazgëve dhe duke lënë pas dore kryerjen e përputhjeve apo të përqasjeve nga njëra anë midis kësaj gjuhe dhe nga ana tjetër gjuhës frigjiane, thrako-ilirishtes dhe shqipes së sotme. Kjo e ka çuar erudicionin modern në një qorrsokak të vështirë dhe ka shkaktuar dëme të vërteta: një shekull zvarritje, humbje kohe dhe përfundime sigurisht të gabuara.

Çfarë zotërojmë ne si elemente serioze për të studiuar gjuhën baske? Ato janë të llojeve të shumta: gjuha e tyre dhe studimet e ndryshme gjuhësore të kryera deri në ditët tona, kultura e tyre, mjedisi në të cilin ata kanë evoluar vazhdimisht dhe që ka gjeneruar në mënyrë spontane krijime të ndryshme (nga njëra anë "piktura nëpër shkëmbinj, monumente megalitike, fortifikime ciklopike" dhe nga ana tjetër

"oronime, toponime, antroponime", etj.) shkrime të ndryshme specifike, studime të teksteve të lashta dhe punime të shumta etnologjike, antropologjike ose hematologjike që lidhen me to. Përveç kësaj studimet krahasuese bëjnë të mundur që të përballet e gjithë kjo me elemente të tjerë që kanë të bëjnë me etni të një trungu apo në një rast të duhur të bëjnë përqasje të përshtatshme për të nxjerrë përfundime që të zënë vend për çdo rast.

Tashmë të hymë në brendësi të temës dhe të vendosim ta qarkojmë më nga afër këtë enigmë të pretenduar ose të paktën këtë mister, i cili nga shumë pikëpamje dhe siç do ta shohim nuk është fare i tillë.

Baskët e quajnë vendin e tyre Eskual-Herri që është vendi i Eskuaras apo Euskara, fjalë që emërton gjuhën baske. Eskualdun ose Eskuara-dun ("ai që zotëron vendin e eskuaras") emërton "popullin bask". Ky emër i përbërë përfshin fjalën "dun" që ngjason se ngatërrohet me fjalën shqip "don" (shumës dunë) që do të thotë duan!

Sot Baskët ndahen katër të pestat në Spanjë (Biskaj, Alava, Gipuzkoa, Navarra) dhe një e pesta në Francë. Në mënyrë skematike vendi bask francez gjendet përtej një vije midis Bajonës dhe një pjesë Oloron Shën Mëri. Gjuha baske e shkruar është dëshmuar vetëm duke nisur nga shekulli X i erës sonë, por libri i parë daton vetëm në vitin 1545.

Folja në gjuhën baske ndërtohet nga një rrënjë me anë prapashtesash dhe parashtesash duke përfshirë vepruesin, kundrinën, pësuesin e veprimit (shumës) ashtu si në gjuhën e sotme shqipe. Nyja është e vendosur në fund, si në gjuhën shqipe, rumanisht, armenisht, paleokaukaziane madje berbere. Në lidhje me gjuhën baske dhe iberike ja çfarë pohon Nikolas Lahovari, më shumë se pesëdhjetë vjet më parë (Popujt europianë, 1946): "Gjuha baske ashtu si edhe gjuha shqipe ruajnë gjurmë të dukshme të sistemit vigesimal, i cili është rregull në gjuhët paleokaukaziane, në atë sumeriane dhe elamite. Nën ndikimin e gjuhëve prearianë, frëngjishtja ka ruajtur mbetje deri në ditët tona, në numrat "quatre-vingts" tetëdhjetë), "quinze-vingts", etj... Shqipja e vendos lidhëzën, bashkë me rumanishten, disa dialekte të së cilës paraqesin

një rotacizëm shumë të theksuar (në përgjithësi, përveç të tjerave, me anë të regresionit në kohët moderne). Fenomeni rigjendet në Armeni, fakt në veçanti domethënës në gjuhën baske, si në atë gaskone (akuiten) ... Sipas zakonit të Para Indo-Europianëve për t`i dhënë emrin e një lumi apo të një lugine, mund të përfytyrohet se kjo ka qenë e njëjtë edhe për Ilirët e Europës qendrore. Dhe në të vërtetë në të gjithë rajonin që shtrihet prej Danubit të Hungarisë deri në Pirenej, d.m.th. në këtë rajon ku pikërisht ne kemi zbuluar emra të vendeve të epokës para-ariane, ne gjejmë një numër lumenjsh që mund t`i bashkëngjiteshin emrit të Ilirëve [Lahovari midis të tjerave përmend toponime Iller në Bavari, Ill në Alsasë, Illier në Vllahi, Isle në vendet vaskon dhe që lag Liburnin, qyteti i Illes pranë Perpinjanit].. Përveç kësaj, emrat e përmendur deri këtu janë vetëm një pjesë e vogël e atyre që Iliria e lashtë ose Thraka kanë të përbashkët me pjesën tjetër të botës para-ariane të Mesdheut dhe të Europës në jug të Danubit".

Ekzistojnë ngjashmëri të shumta midis gjuhës shqipe dhe asaj baske, ndër të cilat prapashtesa e pjesores "ua" në gjuhën baske dhe "ua" në shqipen e veriut (gegërisht) dhe "uar" në shqipen e jugut (toskërisht) dhe prapashtesa përcaktuese "ak" e njëjtë në të dy gjuhët (baske : chigortua = i tharua – baske : merlatue = i sheqerosuar ; shqip gegë : mallkua; helmua, etj. Për të ilustruar të përafërsi gjuhësore basko-shqipe, ja edhe disa shembuj që flasin vetë.

Pikësëpari emri i Baskëve shpjegohet pikërisht nga gjuha shqipe, siç e kemi parë tashmë për Iberët. Në të vërtetë simboli i Baskëve është UNION (BASHKIM). Mirëpo në gjuhën shqipe BASHKË dihet që është bashkimi. Sot flitet për "gjuhën baske të unifikuar" (Euskara "battua" që përqaset me shqipen "bashkua"). Përqasjet nuk kanë të mbaruar sepse përveç këtyre toponimeve, oronimeve, hidronimeve apo antroponimeve të zakonshme sepse kur është fjala për të krahasuar këto dy gjuhë të lashta, analogji të shumta që kanë mbijetuar në fjalët e përdorura. Ja një listë jo e plotë e fjalëve (a = shqip dhe b = baske) në të cilën unë kam frëngjishtuar shqiptimin, në veçanti ato në shqip, me

qëllim që krahasimet fonetike me atë gjuhën baske të jenë më të qarta dhe më të kuptueshme.

Leksiku shqip - bask

a * agon; po agon
b * egune = dita; egu-antz = agimi
a * atë, ati
b * aïta = atë
a * amë, ama =nënë
b * ama = nënë
a * arëz = arëz, grerëz
b * areze, aneze = bleta; arez, erle = grerëz
a * arrë
b * ur, hur = lajthi
a * ari = femërorja është arushë
b * artz = ariu
a * as
b * ez = nuk
a * belbër = belbëzoj; belbëzim
b * barbar = britmë e çjerrë
a * berr =dashi (gegë). Ky emër gjendet në Pellgun e Berrave (étang de Berre-France). E dimë se ky rajon i deltës së Ronit ishte i njohur për mbarështimin e "berrave". Ka të ngjarë që ky emër të ketë zanafillë ligure, prapellazge.
b * barro = lloj dashi (të njëjtin kuptim në dialektin gaskon dhe provensal)
a * bar; barishtë
b * baratze = kopsht
a * baltë
b * balsa, baltsa = moçal, kënetë
a * bisht
b * pitsho = penis*, buztan - bishti
a * brohoroj = brohoras; brohori
b * orro = ulërima
a * burrë
b * buru = kokë, prijës
a * çelës
b * giltz = çelës

a * çikë = një çikë (pak)
b * chiki = i vogël
a * çurgu = curril uji
b * churru-ta, chuuru-pita = curril uji
a * derri
b * zerri
a * dordolec
b * durdurika = zhurmë; durdusia - kërcënim
a * edhe
b * eta, ta = dhe
a * goce
b * gazte = vashëz
a * gruri, gruni
b * gari = gruri
a * hala = akoma
b * ala = kështu
a * hardhi
b * ardanza = hardhi; ardo, ardao, arno - vera
a * hirrë
b * erro = sisë lope
a * huti
b * huntz = huti
a * ishull
b * i stil (ishtil) = lagunë, pellg
a * jasht
b * oste, ostean = jashtë
a * lart
b * arte = e drejtë; lerden = e zhdërvjellët
a * lehtësi
b * lehtazi = lehtas
a * lendinë; lendë = lëndë druri
b * landa = tokë e rrethuar, shkorret, shkurrajë
a * lëroj
b * larre = kullotë
a * lolo
b * lolo = budalla
a * lule
b * lili, liliak = lule

a * luzmë
b * luze = e madhe
a * mal
b *malda = kodrinë
a * mugull = filiz
b * murgil, mugul = gonxhe
a * mun, mund; men, mend
b * men = fuqi
a * mori = mori, turmë
b * muru = grumbull, tog
a * ngrykë, grykë
b * garkhora, gorondo = zverk
a * kikelë = maj, kulm; kikë = majë
b * kukula = majë
a * kodër
b * kotor = shpat (mali) thikë
a * Kryq
b * gurutz = kryq
a * llajush (llajush) = dashi zi
b * loï, lohi = njollë ilun = i errët
a * e man = e mban, e ruan
b * eman, ema-ten = me dhënë, me pas besim
a * mëz; mëzat = rrjedh nga ilirishtja manzë
b * mando = mushk; femër shterpë
a * ngrysur; u ngrys =
b * gerisa (khereiz) = hije
a * patë =
b * ate, ahate = rosak
a * puth
b * pot = puthja
a * qarr = lis
b * ar-itz, ar-te, har-itz = lisi
a * rrajë (rrajë) , rre = askaride
b * ar, har = krimb ; arrai, arra-in = helmë
a * rrëke Uraka (Urakë) = degë e lumit Mat
b * erreka = rrëke
a * rrëzon ; rrëzë =
b * erroitz = hon humnerë; ertz =skaj, buzë
a * ri, i ri; re, e re

b * berri, barri = i ri, e re
a * rron ; rroni
b * iraun = me vazhdu
a * rruan b * arron-t-atu = lë zhveshur, tullë, korr grurina * rrush = b * buruxca = rrushia * rruza e shpinës =b * erroz-gora = shtrihem në kurriz
a * samar ; gomarib* zama = barra ; zamari = kali
a * sy ; shoh
b * so = vështroj,
a * sule = barkë e vogël ; përqaset me gjermanishten züle, zulle "barkëz"
b * zulo, zulho, chulo, silo = brimë; zultu, culatu, cilatu = me gërmu
a * souli (Suli) = emër i një krahine të Epirit të jugut. Ky emër rrjedh nga Sellët (profetët ose interpretuesit e Zeusit dodonas dhe pellazg i Homerit (Iliada XVI, 234)
b * soule (vendi i Sulit) = rajon i lashtë bask në Francë.
a * shkabë
b * sahi = shkabë
a * shok, shoqe
b * ezkondu = bashkëshort
a * shurrë
b * Tchurru (Kurru) = përrua ; corro = ulluk ; curru-ta = curril uji
a * skotë, skota =racë, klan, fis
b * esku = fjala e parë në formimin e zanafillës së Baskëve ; esku-ara (kombi ose gjuha baske) esku-aldun (Basku)
a * sorrë, shturë
b * tsorri, chorri = zog
a * tokë
b * toki = vend
a * trashë
b * tireso = i fortë
a * tchikë (Çikë) = një çikë (pak); çikë, vashëz
b * chiki= i vogël
a* Çurgu = curril uji, çurg
b* churru = rrjedhë uji
a* Çun
b* otsein = shërbëtor
a* ujr, ujra
b* uar, uarre = përmbytje, përrua
a* urë
b* erre = me djeg
a* urrej

b* erra – gorro - to = urrejtje
a* usht = kalli gruri
b* osto, hosto = drapër ; ozi, hozi = filiz
a* ushtri
b* ozte, oste = turmë
a* uzdajë
b* uste = pritje, shpresë, uzdaj
a* ujvar
b* ubar, ubarre = lumë
uar, uarre = përmbytje
a* vazhdë
b* matz, hatz, atz = gjurmë, hap, pistë
a* i epni
b* ipini, ibeni, imini = vë, vendos, depozitoj
a* vigan
b* bigun = forcë, fuqi
a* vlon
b* erion = rrjedh, gufon
a* yll
b* ill- argi – muaji, hëna
a* zagar
b* zakhur = qen
a* zane = i zënë (i zanë – gegë)
b* zain = ruaj

Kemi vërejtur ngjashmëri të çuditshme dhe përafërsi gjuhësore midis gjuhës baske dhe asaj shqipe. Pavarësisht modifikimeve të pashmangshme leksikore apo fonetike thelbi (rrënja apo rrënjësori) i këtyre fjalëve është ruajtur pothuajse i paprekur pavarësisht shekujve që kanë kaluar dhe largësisë që ndajnë këto dy etni që gjenden në dy skaje të kundërta! Do të gjejmë të njëjtin fenomen midis gjuhëve të Kaukazit, madje midis armenishtes (gjuhë me zanafillë thrako-frigjiane, megjithëse shumë e përzier) dhe gjuhës shqipe, e cila nga të gjitha gjuhët e Europës ka ruajtur fondin më të vjetër gjuhësor të pellazgjishtes së lashtë për arsye të ruajtjes në territorin e saj stërgjyshëror – vatrën zanafillore me Arkadinë, Thesalinë dhe Epirin – nga Pellazgët dhe Thrako–Ilirët.

Nuk është fjala për një apo disa përputhje të rastit por për një tërësi elementesh homogjenë, madje një monolit gjuhësor të përbashkët.

Së fundi po shënoj se linguistët tanë të fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX dhe të gjithë ata që i kanë ndjekur në mënyrë të verbër, të paaftë për të dekriptuar gjuhën baske, shpallën se ishte fjala për një gjuhë "jo indo-europiane" ndërkohë që për ta gjuha shqipe, megjithëse e afërt me të është një gjuhë indio-europiane e mirëfilltë. Duhet kujtuar se eruditë të shumtë, duke mos mundur të nxjerrin të gjitha burimet e informacionit dhe as të vendosin përputhjet gjuhësore të nevojshme dhe as të studiojnë me themel disa gjuhë të lëna mënjanë, të tilla si gjuha shqipe, si dhe duke e nënvleftësuar pellazgjishten e lashtë apo duke mos e marrë seriozisht, këta eruditë i kanë shpallur në mënyrë sistematike gjuhët që ata kanë mundur t`i deshifrojnë apo dekriptojnë si të jenë gjuhë të zhdukura apo gjuhë jo indo-europiane apo para indo-europiane. Gjuhëtarët jo vetëm që nuk kanë patur parasysh faktorin pellazg por kanë refuzuar të bëjnë ndonjë lloj përqasjeje me gjuhë të tjera të lashta (gjuha thrake, frigjiane, ligure, ilire...) dhe mbi të gjitha ato moderne (ato që i kanë mbijetuar stuhive të kohëve) të tilla si gjuha shqipe, baske ose gjuha kaukaziane. Ja një nga dështimet kryesore të këtij sistemi ose të dogmës indo-europiane.

Megjithatë gjuhëtarë të shumtë kanë qenë më të saktë apo më mendjemprehtë dhe ndonjëherë më vizionarë se të tjerët. Janë të shumtë ata që kanë thënë të vërteta drithëruese pa e ditur, d.m.th. kanë nxjerrë vrojtime të logjikshme, hipoteza të ndërtuara mirë dhe gjithashtu kanë skicuar rrjedhojat bindëse, por në mënyrë paradoksale ato janë të pakrahasueshme me dogmën e tyre ose pistat e tyre të gabuara. Ja një shembull midis të tjerave: d.m.th. të thuash nga njëra anë se Pellazgët kanë paraprirë Grekët në Ballkan, Egje dhe Azinë e Vogël është një e vërtetë e dukshme, por të thuash se ata janë zhdukur pa lënë asnjë gjurmë qytetëruese ndër ata që i pasuan, pra Grekët, është një pavërtetësi e dukshme dhe së fundi të thuash që Mikenianët ishin Grekë (ndërkohë që këta të fundit

nuk ekzistonin ende) është gjithashtu një e pavërtetë që rrjedh në mënyrë të padiskutueshme nga e para! Vetë Dumezil hamendësonte për një moment se gjuha baske duhet të ketë qenë nga trungu i një familjeje të madhe mesdhetare në të cilën bënin pjesë gjuha etruske dhe gjuhët kaukaziane. Fatkeqësisht ideja e tij e shkëlqyer ka mbetur në sirtar sepse arsyetimi i tij nuk u ndoq nga asnjë hulumtim shkencor dhe i mungonin përfundimet bindëse. Pra, ai ka thënë një të vërtetë pa e hulumtuar kurrë atë dhe pa sjellë për të as zgjidhjen më të vogël.

Kështu mbi gjuhën baske janë thënë gjithfarëlloj mendimesh. Në të vërtetë disa madje kanë kaluar në absurditet duke sugjeruar një afri midis gjuhës baske dhe asaj japoneze, madje edhe me gjuhët amerindiane!

Gjergj Kastrioti i mbiquajtur SKËNDERBEU:
Hero Kombëtar shqiptar (1405 -1468) Pikturë e autorit

Epilog

I kam kushtuar tridhjetë vjet të jetës sime mendimit, reflektimit, të hulumtuarit të së kaluarës shumë të largët dhe të qëmtuarit edhe të provës më të vogël, argumentit më të vogël, treguesit më të vogël ose hollësisë më të vogël, e cila më në fund mund të më sqarojë dhe të hedhë dritë mbi këta Pellazgë madhështorë, etnia e stërmadhe e të cilëve – pavarësisht dallgëve të kohëve, pushtimeve, vuajtjeve të panumërta dhe fatkeqësive që kanë pësuar gjatë mijëvjeçarëve – ka mbijetuar për mrekulli, megjithëse hapësira jetike e tyre është katandisur në këtë qoshk të vogël malor të mbrojtur nga një popull i panënshtruar dhe trim dhe mbi të gjitha i denjë për nga heronjtë e mëdhenj të epopeve dhe legjendave. Pas këtij udhëtimi të gjatë drejt këtyre krahinave dhe këtyre popujve kaq të largët, unë kam kaluar edhe pesë vite të tjera duke punuar me përpikëri dhe me ngulm dhe pas shumë netësh pa gjumë më në fund kam mundur të mbaroj këtë udhëtim misterioz si dhe të përfundoj punimin e stërmadh të studimeve dhe hulumtimeve: të rivendos më në fund një të vërtetë, ta nxjerr nga errësira dhe mbi të gjitha të ngre më në fund kapakun gjigand të plumbtë që po i ze frymën qysh prej njëzetepesë shekujsh.

Në kundërshtim me atë që na është mësuar deri tani, ne kemi një tjetër mësim të historisë së Shqipërisë: një vështrim historik arkeologjik,

antropologjik dhe kulturor të kombit shqiptar. Gjithsesi 2/3 e veprës së sotme i janë kushtuar gjuhësisë, duke trajtuar në mënyrë të veçantë gjuhën shqipe (të cilën unë e quaj "pellazgo-shqipja" dhe përafritë e saj, bashkëlidhjet dhe përputhjet gjuhësore me gjuhë të shumta të lashta dhe moderne, ndër të cilat gjuha etruske, greqishtja e lashtë, baske, rumune apo latine: një fosile e gjallë, e tillë ishte gjuha e të parëve të Thrako-Ilirëve dhe të Shqiptarëve të sotëm: pellazgjishtja e lashtë.

Përveç gjuhësisë që sjell një provë të qartë mbi vërtetësinë historike të Pellazgëve (dhe si rrjedhojë të Thrako-Ilirëve dhe të Shqiptarëve të sotëm) dhe ndihmesën e tyre në krijimin e dy qytetërimeve tona më të shquara perëndimore (etrusk dhe grek), ka katër kyçe themelorë që bëjnë të mundur të hapet debati dhe të kuptohet më mirë përse historiografia e Greqisë së lashtë është futur në rrugë të gabuar si pasojë e rrugëve të gabuara dhe duke rënë në një lloj ideologjie të përjetësuar nga shumica e historianëve, arkeologëve dhe gjuhëtarëve. Ja pra një vështrim i shkurtër i përmbajtjes të librit tim të dytë të dalë në vitin 2004: "GREQIA (Mikenët = Pellazgët) ose zgjidhja e një enigme.

1) Hekate i Miletit, Helanikos i Mitilenit, Tuqidi, Diodori i Siçilisë, Straboni dhe mbi të gjitha Herodoti kanë thënë të vërteta të qarta dhe drithëruese, d.m.th. vendi që do të bëhej Greqi ishte i populluar nga Pellazgët autoktonë, popull "barbar" (kjo fjalë, "barbar", në atë epokë nuk kishte kuptimin që i jepet sot sepse asokohe do të thoshte thjesht "nuk flasin gjuhën greke"). Vetë Herodoti pohonte se Jonianët ishin Pellazgë autoktonë të kthyer në grekë pasi kishin mësuar gjuhën greke dhe se mbretërit e tyre dorianë mburreshin se ishin me zanafillë egjiptiane dhe se Soloni gjatë udhëtimit të tij në Egjipt (në Sajis, kryeqyteti i faraonëve të epokës të mbiquajtur "saite", rreth shekullit VII para Krishtit) ishte pritur nga Egjiptianët si një njeri i tyre. Por kush ishin vallë këta Grekë? Një pyetje me vend që kërkon një përgjigje me vend. Homeri dhe Hesiodi nuk i kanë cituar kurrë "Helenët" si "Popull" apo "Komb". Homeri te Iliada, citonte kundër Trojanëve

vetëm Akenët, Danaenët dhe Argianët si dhe në këto rrethana nuk ka cituar Kadmenët: provë kjo se Fenikasit kanë mbërritur pas Danaenëve. Pra ai nuk mund ta njohë atë që ka mbërritur pas tij! Pra, kush ishin këta popuj të përmendur nga Homeri? Akenët vinin nga veriu i Fenikit, nga një zonë që gjendej në jug-lindje të Azisë së Vogël (Pamfili dhe Silisia). Por emri i këtij populli është një çështje e diskutueshme sepse ai ka lënë vetëm një emër në fashitje, të cilin Romakët e kanë përdorur për të emërtuar një provincë të Greqisë (Akaja), të cilën e pushtuan (viti 148 para Krishtit). Danaenët ishin Egjiptianë (Danaos ishte vëllai i Egjiptos) dhe Argianët ishin thjesht "banorë" të Argos (kryeqyteti i "Pellazgjisë" përpara pushtimit të Danaos) të nënshtruar nga Danaenët. Emri "Helenë" u shfaq shumë vonë. Në të vërtetë, këta që do të bëheshin "Helenë" e morën këtë emër vetëm në epokën e Pindarit (510-438 para Krishtit). Gjithsesi Helenët e vërtetë ishin "prijës ose mbretër" Dorianë: përzierje e Danaenëve dhe e Kadmenëve. Pra Dorianët zinin gjithë Peloponezin (nga emri i Pelops "i huaj i ardhur nga Azia" na thotë Tuqididi: ky emër në greqisht do të thotë "fytyrë e lerosur" d.m.th. "e zeshkët"). Por banorët e Peloponezit në këtë epokë përbëheshin nga fiset pellazge dhe në veçanti Ilirët, të cilët ishin nënshtruar nga pushtuesit dorianë. Prandaj i quajtën Periekë, Hilotë dhe Penestë. Mbreti dorian, Agios III, pohonte se në Spartë ndër tri ishin Periekë dhe Spartan!) Atëherë përse ishin gjithmonë në luftë, mbi të gjitha një luftë që zgjati 27 vjet (Lufta e Peloponezit në vitet 431-404 para Krishtit). Fare thjesht, shkaku i kësaj lufte dhe i kësaj armiqësie ishte një luftë e ashpër (midis dy etnive të ndryshme) për pushtet dhe hegjemoni. Në të vërtetë Athinasit ishin pasardhës të Jonianëve (popull pellazg autokton) dhe pretendonin (me të drejtë) se ishin banorët e parë të Greqisë: ata e quanin veten "autoktonë" në raport me Dorianët, të cilët ata i trajtonin si "të ardhur dhe të huaj". Në të vërtetë Jonianët ishin nënshtruar nga pushtuesit e parë semito-egjiptianë: ata morën emrin HELENË pasi kishin mësuar greqishten, na thotë babai i Historisë, Herodoti. Ky emër Jonianë iu mvesh

nga vëllezërit e një trungu, Pellazgët, të cilët ata i trajtonin si "të tyret", d.m.th. që rridhnin nga etnia e tyre" (I onë, pra "i jonë").

2) Tuqididi, më shovinisti nga autorët grekë, vetë ai pohon se Pellazgët ishin një popull autokton dhe barbar (jo grek) dhe që në epokën e tyre Grekët nuk flisnin fare për ta. Ai gjithashtu e ka cilësuar "Pelopsin" të huaj të ardhur nga Azia. Përveç kësaj, ky emër në greqisht do të thotë "fytyrë e lerosur" që nënkupton "i zeshkëti" Por aty ku ai ka mëkatuar (dhe këtu është një pikë shumë e rëndësishme) është fjala se ai ka kapërcyer shend e verë katër "shekuj të mbiquajtur të errët" (1200-800). Ai ka ngatërruar "luftën" e Illionit (emër grek që emërton Trojën) në kohën e pushtimit të Azisë së Vogël (në fillim Eolida, Jonia pastaj Dorida) nga Grekët e parë rreth vitit 680 para Krishtit) me atë hipotetiken "lufta e Trojës" nga epopeja homerike (Iliada). Fjala Trojë në shqip do të thotë Troje, truall! Arkeologjia moderne nuk ka zbuluar as gjurmën më të vogël të kësaj lufte në këtë epokë të kahershme (shekulli XII para Krishtit). Përkundrazi ekzistojnë gjurmë të luftës së Illionit grek, të cilat datojnë nga shekulli VII (rreth vitit 680 para Krishtit). Pra, Tuqididi ka thënë se Dorianët janë shfaqur 80 vjet pas luftës së Illionit (nënkuptohet atë të vitit 680 para Krishtit, pasi nuk ka asnjë dokument që të provojë egzistencën e luftës të vitit 1193 para Krishtit!). Përveç kësaj, Dorianët nuk janë përmendur në Iliadë dhe dy citime që gjenden aty janë trajtuar nga specialistët si "ndërfutje të mëvonshme". Në të vërtetë emri i Dorianëve është cituar vetëm ndonjëherë, rreth shekullit VI dhe pikërisht nga Pindari. Si rrjedhojë nëse hiqen 80 vitet nga data e pushtimit të Azisë së Vogël (680 para Krishtit) atëherë marrim saktë vitin 600 para Krishtit dhe jo 1183 - 80 = 1103 para Krishtit. Duhet shënuar se hipotetitkja "luftë e Trojës" sipas Iliadës do të ketë vazhduar dhjetë vjet (1193-1183 para Krishtit, datë e marrë pa asnjë provë e prekshme por e pranuar në përgjithësi). Në qoftë se trajtohet se Tuqididi është gabuar për "luftën" ai nuk është gabuar për 80 vitet! Është kjo datë (1100), e cila është marrë në

konsideratë është mbështetur në mënyrë të gabuar nga Eratosteni, aspak i famshëm dhe i diskutueshëm!

3) Për gabimin e mëposhtëm i detyrohemi Aristotit: ai ka thënë se Helenët vinin nga Veriu i Greqisë. Ai ka bërë ashtu si të tjerët, ka ngatërruar popullin dorian (të trungut ilir, ndër të cilët Periekët, Hilotët dhe Penestët, të ardhur nga Veriu i Greqisë) me mbretërit dorianë, të cilët ishin me zanafillë semito-egjiptiane. Pra këta nuk janë mbretërit dorianë që kanë ardhur nga Veriu! Përveç kësaj të gjithë mbretërit e njohur të Greqisë arkaike, vetëm Kranaos ishte Pellazg (mbreti i fundit pellazg). Të tjerët (Kekropsi, Eriktonios, etj.) ishin me zanafillë semito-egjiptiane si dhe Poseidoni, Akrisios (fij të Abas), Perseu, Herakles, etj.... të gjithë kanë dalë nga një linjë semito-egjiptiane. Përveç kësaj Veriu i Greqisë gjithmonë ka qenë i banuar nga "fiset autoktone të pavarura" (I lirë, fjalë shqipe), d.m.th. Thrako-Ilirët, ndër të cilët bëjnë pjesë Epirotët dhe Maqedonasit.

4) Së fundmi, ngatërresa e fundit e kësaj udhe ishte Shliman dhe në një masë më të vogël Evans (zbuluesi i Knosos në Kretë), Kadvik dhe Ventris (deshifruesit e linearit B). Shliman ka zbuluar rrënojat e "Mikenës". Ja përse e kanë emërtuar "mikenian" qytetërimin e këtyre rrënojave. Në të vërtetë nuk ka patur kurrë qytetërim që të ketë mbajtur këtë emër. Nëse këto rrënoja do të kishin qenë zbuluar në Korint ai do ta kishte quajtur qytetërimi korintian! Meqë në këtë epokë aty nuk ka patur Grekë (shekujt e errët 1200-800) dhe meqë nuk dihet absolutisht asgjë për këtë periudhë, do të kishte qenë mëse normale që ky qytetërim të emërtohej: qytetërimi pellazg meqë të gjithë autorët e lashtë kanë thënë dhe e kanë përsëritur se përpara mbërritjes së Grekëve, Pellazgët zinin vendin që do të bëhej Greqi. Evans nga ana e tij e ka emërtuar qytetërimin e rrënojave të Knosos minoan (nga emri i mbretit legjendar Minos). Në të vërtetë nuk ka patur kurrë qytetërim që të ketë mbajtur këtë emër të fundit, eponim i mbretit Minos. Përsa i takon Ventris dhe Kadvik, ata e kanë deshifruar linearin B (shkrimi i pellazgëve – që

rrjedh nga lineari A gjithmonë i padeshifruar). Për këtë, këta dy autorë kanë arritur sa të thonë se është fjala për greqishten e vjetër. Për sa më lart ata nuk janë gabuar aspak sepse dialekti më i vjetër (jonian, greqishtja e vjetër) grek ka dalë nga pellazgjishtja e lashtë (cf Herodoti). Mjafton të nxjerrim në pah që terma të panumërt të lashtë, antroponime, etnonime, oronime, teonime, eponime janë të shjegueshme nga shqipja e sotme, një lloj fosile e gjallë, e cila ka ruajtur fondin më të lashtë gjuhësor të Europës, falë malësive të pamposhtura (strehë natyrore) e Shqipërisë dhe trojet rreth saj.

Kështu për të arritur në përfundimet e tezës që unë kam trajtuar në librat e mi, më është dashur të sjell prova nëpërmjet "gjashtëses". Si rrjedhojë kërkimet e mia dhe studimet e mia nuk janë të kufizuara vetëm në "gjuhësi", e cila është veçse elementi i gjashtë pas historisë së lashtë, arkeologjisë, antropologjisë, mitologjisë dhe etnologjisë. Pra, krejt ndryshe ndaj asaj që mendojnë disa, nuk është "vetëm" gjuhësia për të provuar prejardhjen e Ilirëve nga Pellazgët tanë të famshëm. Në të vërtetë historia e lashtë (të gjithë autorët antikë grekë, pa përjashtim), epopetë homerike (Iliada dhe Odisea) dhe Hesiodi (Teogonia si dhe Punët dhe Ditët) pohojnë vërtetësinë historike të Pellazgëve që kanë paraprirë Mbërritjen e Helenëve në Ballkan, Azi e Vogël dhe Egje. Në këtë epokë këta Pellazgë kanë lulëzuar prej Atlantikut deri në Detin e Zi (duke përfshirë aty rajonet e Kaukazit) dhe nga dy brigjet e Danubit deri në detin Egje (unë e quaj këtë periudhë "era e homo-pelasgus"). A nuk i cilëson Homeri Pellazgët "hyjnorë" dhe Zeusin "pellazg"? Dhe siç e kemi parë në paragrafin e parë, Helenët nuk kanë qenë cituar kurrë si Popull apo si Komb. Përveç kësaj Herodoti pohon se Pellazgët u kanë dhënë Grekëve emrat e hyjnive të tyre dhe se Jonianët (I oni) ishin Pellazgë të kthyer në Helenë pasi kishin mësuar greqishten! Pra, nuk është për tu çuditur që greqishtja e vjetër të ketë patur të njëjtën zanafillë me shqipen e sotme (mbi të gjitha gegërishtja që ka ruajtur fjalët më të vjetra pellazge) dhe që emrat e mitologjisë të mbiquajtur

greke dhe fjalë të tjera të shumta shpjegohen nëpërmjet gjuhës shqipe! Ja pra tri (Histori e Lashtë, Gjuhësia dhe Mitologjia) nga gjashtë "elementet" që bashkohen, përputhen dhe vërtetohen në mënyrë reciproke. Gjithashtu antropologjia ka vërtetuar ekuacionin "Pellazgë = thrako-ilirë dhe Shqiptarë": Pellazgët, Mikenët (Pellazgët në zanafillë sepse emri "Mikenë" është shpikur nga arkeologët modernë të fundit të shekullit XIX, ndër të cilët Shliman) dhe Thrako-Ilirët ishin "brakicefalët" ashtu si Shqiptarët e sotëm (treguesi cefalik më i lartë, sipër 85). Nga ana tjetër duhet shënuar që të famshmit "Malësorë me kokë të rrumbullaktë" të cilët zinin Mesopotaminë, qysh rreth 6000 vjet më parë, kanë ardhur nga rajoni i Ballkanit (në veçanti "Sumerianët", të cilët nuk ishin Semitët). Dhe së fundmi se prijësit dhe mbretërit "hititë" ishin gjithashtu me zanafillë nga Ballkani që në këtë periudhë ka qenë populluar nga Pellazgët. Arkeologjia ka treguar (gërmime të realizuara në Shqipëri pas luftës II Botërore) se hapësira e periudhës të mbiquajtur mikeniane (pellazge) shtrihej deri në Shqipëri (qendër metalurgjike e rëndësishme), ku janë gjetur kafka brakicefale të "mikenëve" të lashtë (XVI dhe XV para Krishtit), shpata të mibiquajtura mikeniane, speranca dhe objekte të tjera shumë të lashta. Ja pra edhe dy elemente të tjera (antropologji dhe arkeologji) që përputhen me gjashtë elementët e tjerë. Dhe së fundmi, dijetarë të shumtë të shekullit XIX kanë pohuar se "Shqipëria ka kostumet më të pasura dhe më të larmishme të Europës dhe se këto kostume rigjenden kudo në Europë Lindore": kjo është normale, pasi Ilirët shtriheshin përtej Danubit. Pra ky është elementi i gjashtë etnologjik dhe kulturor që arrin edhe një herë tjetër të vërtetojë vërtetësinë historike, vijimësinë etno-gjuhësore dhe kulturore të Pellazgëve dhe të Thrako-Ilirëve.

Pellazgët formonin një familje të madhe etno-gjuhësore të përbërë nga një numër i madh "fisesh", ndër të cilat më të lashtat ishin Lelegët, Lisianët, Karianët, Ligurët, Iberët (ndër të cilët Baskët janë pasardhës), Tirrenët (Etruskët), Teukrët (Trojanët), Filistinët, (të quajtur "popujt

e Detit")... Pak më vonë tribu të tjera pellazge dallohen (në planin ushtarak, kulturor dhe politik), ndër të cilët Thrakët, Brigët, Frigjianët, Moskët, Ilirët... Këta të fundit përbënin një popull të quajtur "i lirë", i cili përfshinte Peonianët, Agrianët, Dardanianët (ose Dardanët), Triballët, Pellagonët, Panonianët, Dalmatët, Venetët, Istrianët, Thesprotët (Epirotët), Molosët, Getët, Dakët... Pra ai që quhet "popull" ilir. Emri "Shqiptar" (Albanoi, Albanois, Albanians..) është shfaqur shumë vonë (rreth shekullit I para Krishtit). Në të vërtetë ky është emri i një fisi ilir (Albanët te Gegët dhe Arbëret te Toskët - rajon që gjendet midis Durrësit dhe Dibrës dhe kryeqyteti i të cilit "Albanopolis" sot është Zgërdheshi), i cili i ka dhënë emrin e tij Shqipërisë: pra për këtë kanë përgjegjësi të huajt. Ashtu siç ka qenë rasti për Grekët, të emërtuar kështu ("Graikos" fis epirot dhe jo "helen") gabimisht nga Romakët (cf. veprat e mia). Janë Grekët që i kanë dhënë emrin e Egjiptit sepse Egjiptianët nuk e quajnë kështu por e quajnë "Misr" dhe se Gjermanët midis tyre nuk quhen Gjermanë por "deutsch", etj..

Emri i Ilirëve (i njohur tashmë përpara mbërritjes së Grekëve në shekullin VIII para Krishtit) në të vërtetë është përhapur vetëm pas pushtimit romak në vitin 168 para Krishtit. Në këtë periudhë romakët kanë kufizuar me vullnet të plotë territorin e madh (nga Danubi deri në Greqi) të "popullit të lirë" (Ilirët), duke emërtuar vetëm një pjesë tepër të vogël të kësaj hapësire: ata krijuan provincën e Ilirisë së Jugut. Ja përse disa mendje me qëllim dashakeq apo të keqinformuar e kufizojnë Ilirinë me këtë provincë romane. Në këtë epokë nuk flitet më për Pellazgët (ky emër është zhdukur rreth shekullit V para Krishtit: i zëvendësuar me atë të Thrakëve, Ilirëve, Maqedonëve dhe Epirotëve): nga populli pellazg mbetën vetëm Thrakët (ndër të cilët Getët, Dakët, Maqedonët) dhe Ilirët (ndër të cilët Epirotët). Ja përse unë e cilësoj "thrako-ilir" këtë qytetërim të fundit pellazg dhe gjuhën e tij "pellazgo-shqiptare".

Pra nga linja e drejtpërdrejtë (vijimësia historike, territoriale, etno-gjuhësore dhe kulturore) shqiptarët rrjedhin nga Ilirët dhe Pellazgët.

BIBLIOGRAFI

AUTORË TË LASHTËSISË

Rreth -750/-650 HOMERE (poet grek) – Iliade et Odysée [Iliada dhe Odise] (plejadë).

Rreth -700/-650 HESIODE (poet grek): [Théogonie – Les travaux et les jours] Teogonia - Punët dhe ditët.

Rreth -560/-480 HEKATE de MILET: (Historian dhe gjeograf grek) Periegesis (Përshkrimi i botës) – [Généalogies] – Gjeneanologjia.

Rreth -484/-420 HERODOTE (historian grek): – [L'Enquête] Hulumtimi (Plejadë).

Rreth -460/-400 THUCYDIDE (historian grek): - La guerre du Péloponnèse (Lufta e Peloponezit) (plejadë).

Rreth shek V HELLANICOS de MYTILENE (historian, logograf grek).
? V CALLIAS – [Origines du peuple romain] (Origjina e popullit romak).

Rreth -430/-355 XENOPHON (Shkrimtar, filozof [Les Helléniques (I...VII) – la Cyropédie – Les Mémorables]

Rreth -428/-338 PLATON (Filozof grek)
[République – Protagoras – Banquet – Timée – Ménéxène – Critias] Republika, Protagoras, Banket, Timeu, Meneksene, Kritias...

-436/-338 ISOCRATE (orator grek) – [Panégyrique d'Athènes] Panegjirikë e Athinës.

IV EPHORE, ithtar i Isokratit (historian grek) -

-378/-323 THEOPOMPE, ithtar i Isokratit (historian grek) [Histoire hellénique – Histoire philippique] (Historia Helene – Historia filipike).

Rreth -350/-236 DEMETRIOS de PHALERE (historian grek)

? -340/-240 TIMEE (historian dhe retor grek): [Histoire de Sicile – Histoire de Pyrrhus] (Historia e Siçilisë – Historia e Pirros).

-295/-230 APOLLONIOS de RHODES (poet dhe gramatikan grek): [Les Argonautiqes] Argonautët.

Rreth -200/-125 POLYBE (historian grek) – [Histoire] Historia (Plejadë).

-116/-27 VARRON Marcus Terentius Varro (Poligraf latin).

-100 -44 ÇEZAR Jules – [Comentaires (Guerre civile) – Livre III] Komentarët (Lufta civile) – Libri III.

-64 -59/ > 17 TITE-LIVE (historian latin) – [Décades: Histoire romaine des origines à 9 av JC] Dekadat: Historia Romake nga zanafilla deri në shekullin 9 para Krishtit.

-58/ > 21, 25 STRABON (gjeograf grek): [Géographica – Livres V... VIII (Belles Letres)] Gjeografia - Libri V ... VIII.
† rreth 8 para J.K. DENYS d'HALLICARNAS (historian grek) [Les origines de Rome – Livre I et II (Belles Letres)

	– Antiquités romaines] Origjina e Romës – Libri I dhe II - Antikitetet Romake.
I para J.K	DIODORE de SICILE (historian grek) [Bibli. Historique – Livre IV (Mythologie des Grecs).. Livre VII (guerre de Troie)] Bibliografi historike - Libri IV (Mitologjia Greke).. Libri VII (Lufta e Trojës).
> 23/ 79	PLINE l'ancien (shkrimtar latin) – [Histoire naturelle] Historia e Natyrës.
> 37/ 100	FLAVIUS JOSEPHE (gjeneral dhe historian hebre - i helenizuar). [Contre Apion (Belles letres) – Guerre des Juifs –Antiquités judaïques] Kundër Apionit – Lufta e çifutëve - Antikitetejudaike.
> 50/ 125	PLUTARKU (Shkrimtar grek) [Vies parallèles: Pyrrhos, Lysandre, Sylla (Belles lettres) – Alexandre, César, Alcibaide, Coriolan, Démétrios, Antoine(GF) – Thésée – Oeuvres morales] (Jetët paralele: Pirro, Marius, Lisandër, Silla) - Aleksandër, Cezar, Alçibiadi, Koriolani Demetrios, Antoni (GF) – Tezeé
> 55 120	TACITE (historian romak): [Annales(GF) – Histoires – La Germanie – Vie d'Agricola – Dialogue des orateurs] (Analet (GF) –Historia –Gjermania – Jeta e Agrikolas – Dialogu i oratorëve.)
Rreth > 95	APPIEN (historian grek): [Histoire romaine des origines ... Trajan] (Historia romake e zanafillave ... Trajani)
> 105 > 180	ARRIEN Flavius Arrianus (historian) – [Livre I] Libri I
> II	PAUSANIAS (historian dhe gjeograf grek): [Periegesis/ description de la Gréce (Periegesis/Përshkrimi i Greqisë).
> II	ATHENEE (Historian) – [Livre XIII] Libri XIII
	Rreth 265/340 EUSEBE (Peshkop i Cezarit) – [Histoire ecclésiastique] (Historia eklesiastike)
> III— ?	DIOGENE de LAERTE (shkrimtar grek): [Biographies de philosophes célèbres] Biografitë filozofëve të shquar - 2 volume (GF).

SHQIPËRIA dhe rajoni ballkanik

BOGDAN Henri*	[Histoire des pays de l'Est des origines à nos jours] Historia e vendeve të lindjes prej zanafillës deri në ditët e sotme Perrin/1982
BOPPE A*	[L'Albanie et Napoléon (1797-1814)] Shqipëria dhe Napoleoni (1797-1814) Hachette - 1914
BYRON lord *	[Poems-Poetry & the drama] Poema - Poezi & drama – vol II
DURAND-MONTI*	[Albanie] Shqipëria – Guide Arthaud - 1990
DURHAM Marie Edith	[High Albania] Shqipëria e epërme – Virago Press-London/1985

GARDES Gilbert * [Le guide de l'Albanie] Guidë e Shqipërisë – Editions la Manifacture - 1995
GIBERT Frederic * [Les pays d'Albanie et leur histoire] Trojet e Shqipërisë dhe historia e tyre - P. Rosier – 1914
JOUVENEL (R de)* [Les Enfants de l'Aigle] Bijtë e Shqipes Les èditeurs français réunis - Paris 1958
LEJEAN G. [Les Mirdites] Mirdita - Buletin (sté de géograpfie) 1870
LOUIS-JARAY G.* [L'Albanie inconnue] Shqipëria e panjohur - Hachette/1913
MAHUZIER Albert* [L'Albanie entrouvre ses frontières] Shqipëria hap kufijtë e saj - Presses de la Cité - 1965
MUZET Alphonse* [Le monde balkanique] Bota ballkanike – Ernest Flammarion - 1917
RISTELHUEBER R* [Histoire des peuples balkaniques] Historia e popujve ballkanikë – Artheme Fajard – 1950
STILLMAN Edm* [Les Balkans] Ballkani – LIFE/Autour du monde – 1964
VAN CALVEN [Les Mirdites d'Albanie] Mirdita Shqiptare – Revue bénédictine (Abbaye de Maredsous-Belgique) – 1893
Vicomte de MEAUX [Scanderbeg et l'Albanie] Skënderbeu dhe Shqipëria – 1855
ZAKHOS Emmanuel* [Albanie] Shqipëria - Petite planète - 1972

ETRUSKËT - ILIRËT - ITALIA ARKAIKE

ALTHEIM F.* [Le déclin du monde antique] Rënia e botës antike – Payot/Paris 1953
BLOCH Raymond* [Les Etrusques] Etruskët – Edit. Que sais-je ? PUF – 1963
CABANES Pierre* [Les Illyriens de Bardylis ... Genthios] Ilirët e Bardhylit... Gentit (shek. IV-II para Krishtit) – Editions CDU dhe Secles – 1988
DUCATI Pericle* [Le problème étrusque] Problemi Etrusk – Ernest Leroux – 1937
FALASCHI Nermin(VLORA)* [Antiche civilita mediteranee] Qytetërime antike mesdhetare [Etruschi, Albanesi] Etruskët, Shqiptarët – Noi pubblicisti / Roma - 1984
HOMO Leon [L'Italie primitive] Italia zanafillore Albin Michel – 1953
ISLAMI Selim [Les Illyriens] Ilirët – Academie des Sciences / Tirana - 1985
JANNOT J. Ren, [A la rencontre des Etrusques] Takimi me Etruskët – Ouest – France / Universite – 1987
KELLER Verner [Les Etrusques] Etruskët – Fayard 1976/1994
MASSA Aldo [Les Etrusques] Etruskët – Minerva – Geneve 1973
MAYANI Zacharie [Les Etrusques commencent à parler] Etruskët fillojnë të flasin – Arthaud/ 1961

" " [La fin du mystere etrusque] Fundi i Misterit etrusk - Maloine / Paris 1970
PALLOTINO [Civilisation etrusque] Qytetërimi Etrusk - Payot - 1949
WERNER Keller [Les Etrusques] Etruskët - Fayard 1976

ETHNOLOGIE - ANTHROPOLOGIE - ARCHEOLOGIE

BARAMKI Dimitri [Phoenicia and Phoenician] Feniki dhe Fenikasit - Beyrouth 1961
BERMANN V [Carte Etnographique des Balkans] Harta etnografike e Ballkanit - Laipcig 1882
BOYD William C [Genetiques et races humaines] Gjenetika dhe racat njerëzore - Payot / Paris 1952
CARAPANOS Constantin
[Dodone et ses ruines] Dodona dhe rrënojat e saj - Hachette 1878
COLLIGNON Max [Manuel d 'archeologie] Manual i Arkeologjisë - A. Quantin / Paris
DECHELETTE [Manuel d'archéologie préhistorique, celtique et gallo-romaine] Manual i arkeologjisë Prehistorike, keltike dhe galo-romake - Paris 1910/14
DENIKER J [Les races et peuples de la terre] Racat dhe popujt e tokës - Paris 1900 /26
DOTHAN M [Philistine material and its mycenean affinities] Materiali filistin dhe përafërsitë e tij mikeniane -Karageorghis edition / Nikozi - 1973
DOTHAN Trude, Krakauer[The Philistines and their material culture] Filistinët dhe kultura e tyre materiale - Yale University Press/Jerusalem 1982
GEIPEL, John [Anthropologie de l' Europe, une histoire ethnique et linguistique] Antropologjia e Europës, një histori etnike dhe gjuhësore - Robert Laffont - 1971
LAHOVARY Nicol [Les peuples européens] Popujt europianë - Editions de la Baconniere / Neuchatel - 1946
MOSCATI Sabatino [The world of Phoenicians] Bota e Fenikasve - London 1968
[Sulla Storia del nome Canaan] Mbi historinë e emrit Kanaan - Roma 1959
MOUNRO R [Les stations lacustres de l'Europe aux Ages de la pierre et du bronze] Stacionet liqenore të Europës në Epokat e gurit dhe të bronzit - Paris /1907
NESTOURKH Mikh [Les races humaines] Racat njerëzore - Editions du progres/ Moscou - 1979 (?)

PARVAN [Dacia – Recherches et decouvertes archeologique en Roumanie] Dakia dhe kërkimet arkeologjike në Rumani – 1924

PITTARD -[Les peuples des Balkans] Popujt e Ballkanit – 1920
-[Esquisse antropologique] Skica antropologjike – Attingar freres 1920
-[Contribution a l'étude anthropologique des Albanais] Ndihmesë për studimin antropologjik të Shqiptarëve – Revue de l'ecole d'anthropologie – 1902

POISSON Georges [Le peuplement de l'Europe: Etat actuel, origines, evolution] Popullsia e Europës: Shtetet e sotme, zanafillat, evolucioni– Payot / Paris – 1939

RACHET Guy [Dictioinnaire de l'archeologie] Fjalori i arkeologjisë – Bouquins Robert Laffont – 1983

REVUE des Balkans [Decouvertes archeologiques en Albanie] Zbulime arkeologjike në Shqipëri – 02/1929

SAUTER Mark R [Les races de l'Europe] Racat e Europës – Payot 1952

SPRAGUE J [Les Enigmes de l'archeologie] Enigmat e arkeologjisë

TOPINARD [Elements d'anthropologie generale] Elemente të antropologjisë së përgjithshme - Paris 1985

VULPE R [L' Age du Fer dans les regions thraces de la peninsule balcanique] Epoka e Hekurit në rajonet thrake të Gadishullit ballkanik – Paris 1930

MYTHOLOGIE DIVERSE

ARNOLD Paul [Le mystère basque devoilé] Zbulimi i Misterit bask – Editions du Rocher/Monaco

BETTENCOURT M.F [Les dieux grecs / Généalogies] Perënditë greke / Gjeneanologji - Editions Christian - Paris 1944

BRUNET Philippe [La naissance de la littérature dans la Grèce ancienne] Lindja e letërsisë në Greqinë e lashtë– Livre de poche Paris 1977

CHARACHIDZE Georges [La memoire indo-européenne du Caucase] Kujtesa indo-europiane në Kaukaz - Hachette 1987

CHUVIN Pierre [La mythologie grecque] Mitologjia greke – Flammarion / Champs 1998

DETIENNE Marcel [L'invention de la mythologie] Shpikja e mitologjisë – Gallimard 1981

DUMEZIL Georges -[Le crime des Lemniennes] Krimi i Lemnienëve – Macula – Paris 1988
-[Mythes et dieux indo-europiennes Mite dhe perëndi indo – europiane – Flammarioin / 1992
-[Mythe et epopee] Mite dhe epope – NR /Galimard 1968

GERNET Louis [Anthropologie de la Grèce antique] Antropologjia e Greqisë antike – Flammarion / Champs – Paris 1982

GONSALVEZ & HERON
[La Grande Encyclopedie] Enciklopedia e Madhe – H.Lamirault & Cie - Editeur Paris / 1984
GRAVES Robert [Les Mythes grecs] Mitet greke – Fayard - 1967
GRIGORIEFF Vlad [Mythologies du monde entier] Mitologjia e gjithë botës - Marabout 1987
GUIRAND / SCHMIDT
[Mythes – Mythologie] Mite – Mitologji – Larousse / Bordas - 1996
HACQUARD G [Guide mythologique de la Grece et de Rome] Guida mitologjike e Greqisë dhe e Romës – Hachette – 1984/ 1990
JUBAINVILLE de [La Mythologie grecque et l'histoire de l'Europe occidentale] Mitologjia greke dhe historia e Europës perëndimore - F.Vieweg, Paris 1878
MIREAUX Emile [Les Poemes homeriques] Poemat Homerike
[I – Homere de Chios et les routes de l'etain] Homeri i Kios dhe udhët e Kiosit.
[II – L'Iliade et l'Odyssee et les rivalités coloniales] Iliada dhe Odiseja dhe rivalitetet koloniale – Albin Michel – Paris / 1948
MOMIGLIANO A [Sagesses barbares] Maturi barbare – Gallimard / Folio, Paris 1991
MOSSE Claude [Dictionnaire de la civilisation grecque] Fjalori i qytetërimit grek – Editions Complexe - 1998
PERNAUD – ORLIAC [Petit guide de la prehistoire] Guidë e vogël e parahistorisë – Seuil 1997
RECLUS Elysee [Nouvelle géographie universelle] Gjeografia e re universale – 1894
ULRICH Paul [Les grandes enigmes des civilisations disparues] Enigmat e mëdha të qytetërimeve të zhdukura – Editions de Cremille / Geneve 1971
VERNANT Jean Pierre [L'Univers, les Dieux, Les Hommes] Universi, Perënditë, Njerëzit – Seuil 1999
VEYNE Paul [Les Grecs ont ils-crus a leurs mythes] Grekët a u kanë besuar miteve të tyre? Seuil – Paris 1983
VEYRIN Philippe [Les Basques] Baskët – Arthaud 1995

HISTOIRE ANTIQUE

ARRIEN [Histoire d'Alexandre] Historia e Aleksandrit – Editions de Minuit 1984
BARAMKI D [Phoenicea and Phoeniceans] Feniki dhe Fenikasit – Beyrouth 1961
BAURAIN Claude [Les Grecs et la Mediterranee orientale] Grekët dhe Mesdheu lindor – PUF 1997
BENLOËW Louis -La Grece avant les Grecs] Greqia përpara Grekëve – Maisonneuve & Cie – Dijon / 1877

-Les Semites, Illion ou la vérite sur la guerre de Troie - Semitët, Illionë ose e vërteta mbi luftën e Trojës - A.Frank - Paris/1963
BLOCH R [Les origines de Rome] Zanafillat e Romës - Puf/ 1984
BRAUDEL Fernand [Les mémoires de la Méditerranée] Kujtesa të Mesdheut- Editions de Fallois - Paris 1998
BRIQUEL Dominique [Les Pellasges en Italie] Pellazgët në Itali - Ecole Francaise /Rome 1984
CABANES Pierre [Introduction à l'histoire de l'antiquité] Hyrje në historinë e antikitetit - Albin Michel - Paris / 1992 -95
CARAPANOSConstantin [Dodona et ses ruines] Dodona dhe rrënojat e saj - Hachette 1878
CHAMOUX F [La civilisation grecque] Qytetërimi grek - Paris 1967
CHILDE Gordon Vere [L'aube de la civilisation européenne] Agimi i qytetërimit europian - Payot 1949
COON Carleton S [The mountains of Giants] Malet e Gjigantëve - Cambrigde - Massachusets 1950
CROISET Maurice [La civilisation de la Grèce antique] Qytetërimi i Greqisë antike Payot / Petite bibliotheque - 1969/1994
D'ANGELY H.R [I - L'Enigme des Pellasges] Enigma e Pellazgëve
[II - L'Enigme des Thraces et des Illyriens] Enigma e Trakëve dhe e Ilirëve - Cismonte e Pumonti Edizione - 1990
DOTHAN M [The Myceneans in the East-Mediterranean] Mikenët në Mesdheun Lindor - Nicosie - 1982
DUCELLIER Alain [L'Albanie entre Byzance et Venise X - XV s] Shqipëria midis Bizantit dhe Venecias X - XV)
DUSSAUD Rene [Les civilisation préhelleniques] Qytetërimet parahelene - Paul Geuthener - Paris 1910
FAUCOUNAU Jean [Le dechiffrement du disque de Phaistos] Deshifrimet e diskut të Faistos - L'Harmattan - 1999
FAURE Paul -[La Grèce au Temps de Minos, 1500 avant J.C.] Greqia në kohën e Minos, 1500 para Krishtit - Hachette 1975
-La Grèce au temps de la guerre de Troie -1200 av.JC. Hachette 1975
FLINDERS PETRIE W [The Egyptian bases of Greek history] Bazat egjiptiane të historisë Greke (Journ. Hell. Studies, XI) - 1890
FINLEY Moses I -[Sur l'histoire ancienne: la matiere, la forme et la methode] Mbi historinë e lashtë: lënda, forma dhe metoda - E. de la decouverte - 1987
-Les anciens grecs] Grekët e lashtë - F. Maspero - 1977
-[Le Monde d'Ulysse] Bota e Uliksit - Paris 1969
-[On a perdu la Guerre de Troie] Kemi humbur Luftën e Trojës - Belles Lettres 1993
-[Les premiers temps de la Grèce] Kohët e mugëta të Greqisë - Flammarion 1980

GLOTZ Gustav [Histoire grecque] Historia greke - PUF - Paris/1938 : La civilisation egeene - Paris 1923

HATZFELD Jean [Histoire de la Grece ancienne] Historia e Greqisë së Lashtë - Payot, Paris 1931

JARDE A -[La formation du peuple grec] Formimi i popullit grek - La Renaissance du livre / Paris 1923
-[La Grece antique et la vie grecque] Greqia antike dhe jeta greke / Delagrave 1914

JUBAINVILLE H d'Arbois (de) -[Les premiers habitants de l'Europe d'apres les auteurs de l'antiquité et les recherches les plus recentes de la linguistique] Banorët e parë të Europës sipas autorëve të antikitetit dhe kërkimet më të vonshme mbi gjuhësinë - 2 vol. E. E Thorin - Paris / 1889
-[La mythologie grecque et l'histoire de l'Europe occidentale] Mitologjia greke dhe historia e Europës perëndimore - Vieweg - Paris / 1878

KARST Joseph [Les Ligures dans l'Europe illyrienne ..] Ligurët në Europën ilire Heitz & Cie /Strasbourg

KRAMER Samuel Noah -[L'histoire commence a Sumer] Historia fillon në Sumer /Flammarion / 1994

MOMIGLIANO A [Sagesses barbares] Maturi Barbare * Gallimard / Histoire 1976
-[Contributi alla storia dei studi classici] Kontribute në historinë e studimeve klasike 1967

MOSSE Claude [La Grece archaique d'Homère/...Eschyle] Greqia arkaike e Homerit / ...Eskilit - Seuil 1984

MURRAY Oswyn [La Grèce à l'epoque archaïque] (Early Greece) Greqia në epokën arkaike P.U. du Mirail - 1995

ORRIEUX Claude [Le papyrus de Zenon] Papirusi i Zenonit - Macula 1983

OZANNE Isabelle [Les Myceniens, pillards, paysans et poètes] Mikenët, plaçkitësit, fshatarët dhe poetët - Armand Colin - 1990

POISSON Georges [Le peuplement de l'Europe - Etat actuel, origines, evolution] Popullsia e Europës - Shteti aktual, zanafillat, evolucioni - Payot 1939

POURSAT Jean - Claude [La Grèce préclassique des origines a la fin du VI] Greqia paraklasike e zanafillave në fund të shekullit VI- Seuil 1995

PRADO Jean - Jacques [L'Invasion de la Méditerranee par les peuples de l'Océan] Pushtimi i Mesdheut nga popujt e Oqeanit - L'Harmattan 1992

SARTIAUX Felix [Les civilisations anciennes de l'Asie Mineure] Qytetërimet e lashta të Azisë së Vogël / Editions Rieder - Paris 1928

SERGENT Bernard [Les indo - europeens: Histoire, langue, mythes] Indo - Europianët: Historia, gjuha, mitet - Payot 1995

SEVERYNS A [Grèce et Proche-Orient avant Homère] Greqia dhe Lindja e Afërme përpara Homerit – Office de Publicite – Bruxelles 1960

SCHNEIDER Edouard Les Pelasges et leurs descendants] Pellazgët dhe pasardhësit e tyre – Ernst Leroux – Paris 1894

VAN EFFENTERRE -[Mycènes, vie et mort d'une civilisation] Mikena, jeta dhe vdekja e qytetërimit – Edition Errance 1985
-Les Egéens, aux origines de la Grèce – A.Colin 1986

LINGUISTIQUE

BEONLEW [La Grèce avant les Grecs – Etude linguistique] Greqia përpara Grekëve – studim gjuhësor -Maisonneuve - 1877

BENVENISTE Emilie - [Origines de la formation de noms indo-europeens-] Zanafillat e formimit të emrave europiane A. Maisonneuve - 1984
- [Le vocabulaire des institutions indo-européennes - Vol I - Economie, parenté, societé] Fjalori i institucioneve indo – europiane – Vol I Ekonomia, fisi, shoqëria Vol II - [Pouvoir, droit, religion] Pushteti, drejtësia, feja – A.Masonneuve – 1984

CATAPANO Giuseppe [Thot parlava albanese] Thot fliste shqip – Romë -1984

CARNOY Albert [Les Indo-européens – Préhistoire des langues, des moeurs et des croyances de l'Europe] Indo-Europianët -Parahistoria e gjuhëve, zakoneve dhe e bestytnive të Europës – Paris / Bruxelles 1921

CAVALLI – SFORZA Luca[Genes, peoples and languages] Gjenet, popujt dhe gjuhët - Stanford /California

CHANTERAINE P- [Morphologie historique du grec] Morfologjia historike e gjuhës greke – Klincksieck 1964 - [La formation des noms engrek ancien] Formimi i emrave në greqishten e lashtë – Champion / 1933
- [Dictionnaire étimologique de la langue grecque (Histoire des mots)] Fjalor etimologjik i gjuhës greke (Historia e fjalëve) – Paris 1968/77

C.N.R.S. Collection dirigee par Francois BADER
- [Les Langues indo-europeen] Gjuhët indo-europiane – CNRS Editions 1977

CUNY Albert - [Les mots du fonds préhelenique en grec, latin, etc].Fjalë fondit parahelen, në greqisht, latinisht etj Revue des études anciennes – faculté de lettres/ Bordeaux 1910 - Les origines grammaticales des langues indo- européennes et chamito - Semitiques] Zanafillat gramatikore të gjuhëve indo-europiane dhe kamito-semitike) H.Champion 1924

DELAMARRE X [I e vocabulaire indo – europeen] Fjalori indo – europian – A. Maisonneuve / 1984

DANGEL Jacqueline- [Histoire de la langue latine] Historia e gjuhës latine - PUF - 1995

FERRAND Eugen- [Le parterre des racines gréco - latines] Shtrati i rrënjëve greko - latine - Buletin de l'education Nationale (1960)

GEORGIEV Vladimir Ivanov - [Introduction to the history of the indo-europeen languages] Hyrje në Historinë e gjuhëve indo-europiane - Sofia 1981 (consacré aux langues balkaniques mal attestées: thrace, dace, macédonien, pélasgique...)- [L'origine minoenne de l'alphabet phenicien (cyrillique) Zanafilla minoane e alfabetit fenikas (cirilik) BN - * X 24218

LEJEUNE M [Phonétique historique du mycéniens et du grec ancien] (Fonetika historike e alfabetit fenikas) - Paris / 1972

MALHERBE Michel [Les langages de l'humanite] Gjuhët e njerëzimit - Robert Laffont 1983/95

MANSION J [Esquisse d'une histoire de la langue sanscrite] Skicë e historisë së gjuhës sanskrite Paris 1931 (initiation)

MASSON E [Recherches sur les plus anciens emprunts sémitiques en grec] Hulumtime mbi huazimet më të lashta semitike në gjuhën greke - Paris 1967

MEILLET & ERNOUT [Dictionnaire étymologique de la langue latine] Fjalor etimologjik i gjuhës Latin - Paris 1967 (Histoire des mots)

MEILLET A. -[Aperçu d'une histoire de la langue grecque] Vështrim mbi historinë e gjuhës greke - Klincksiesk - 1965
- [Esquisse d'une histoire de la langue latine] Skicë mbi historinë e gjuhës latine - Klincksieck - 1966
- [Les langues du monde] Gjuhët e botës - Paris 1952

OGUIBENNE Boris - [Essai sur la culture védique et indo-européenne] Skicë mbi kulturën vedike dhe indo-europiane - Giardini editori - Pise /1984

RENFREW - [L'énigme indo-européenne - Archeologie et langage] Enigma indo-europiane - Arkeologjia e gjuha - Flammarion 1994

RUHLEN Merrit [L'origine des langues] Zanafilla e gjuhëve - Collection

SERGENT Bernard [Les indo-europeens: histoire, langue, mythes] Indo-europianët - Historia, gjuha, mitet - Payot / 1995

WALTER Hemriette [L' aventure des langues en Occident] Aventura e gjuhëve në Perëndim - Robert Laffont - 1994

SHQIPJA DHE GJUHËT E ASIMILUARA

ALTHEIM F [Der Ursprung der Etrusker] Zanafilla e Etruskëve - 1950

BEONLOEW Louis [La Grèce avant les Grecs - Etudes linguistique et ethnographiques - Pélasges, Lélèges] Greqia përpara Grekëve - Studime gjuhësore dhe etnografike - Pellazgët, Lelegët - Maisonneuve / 1877

BUONAMICI G [Di alcune vere od apparenti analogie fra l'etrusco e l' albanese] Disa analogji të vërteta ose të përafërta midis etruskishtes dhe gjuhës shqipe (Rivista indo-greca-italica III) - 1919

CABEJ Eqrem Hyrje në historinë e gjuhësisë shqipe - Sofia - 1960

CAPIDAN TH Romanii diu albanese -Bucarest 1928

CORDIGNANO F [La lingua albanese] Gjuha shqipe - Milano / 1931

DAUZAT Albert [L' Europe linguistique] Europa gjuhësore (bibl.. s scientif.) Payot / 1953

DEVOTO G [Illiri, Tirreni, Piceni] Ilirë, Tirrenë, Picenë (SE, XI) -1937

FISHTA Gjergj Lahuta e Malësisë - Shkodër

GUT C - BRUNET A - PERNASKA R.
[Parlons albanais] Flasim shqip - L'Harmattan - Paris/1999

HAHN J.G (Von) -[Albanesische Studien] Studime Shqiptare - 1854

HAMP Eric -[Albanian and Messapic] Shqipja dhe mesapishtja (studies presented to J. Whatmough 1957)
-[The position of albanian] Pozicioni i shqipes -1966

HULD M.E [Basic albanien etymologies] Etimologjitë shqiptare bazë - Columbus/Ohio 1984

JOKL Norbert -[Studien zur alban.etymologie und wörterbildung] Studime mbi etimologjinë shqiptare dhe formimin e fjalëve, 1911
-[Illyrier die sprache] Ilirët, gjuha
-Illyrier - Albaner - Phryger] Ilirët - Shqiptarët - Frigjianët / Eberts M. reallexikon der Vogeschichte
-[Die Thraker - Die Albaner] Trakët - Shqiptarët 1924
-[Linguistisch... des albanesischen] Gjuhësorja ..... e shqipes- Berlin / 1923

KATICIC Rdoslav [Ancient languages of the Balkans] Gjuhët e lashta të Ballkanit - La Haye / Paris 1976

KOKONA Vedat -[Dictionnaire Français - albanais] Fjalor frëngjisht - shqip- Tirana 1989
-[Dictionnaire Albanais - Français] Fjalor shqip - frëngjisht - Tirana 1977 Konda Spiro Shqiptarët dhe problemi pellazgjik - Tirana

KRAHE H -[Lexicon der altillyrischen personennnamen] Leksikon i emrave të përveçëm të ilirishtes së lashtë 1929
-[Die alten Balkan-Illyrischen geographischen namen] Emra të vjetër gjeografikë ballkano ilirë Heidelberg/1925
-Nachlese nu de Balkan-Illyrischen - Heidelberg 1929
-Die Illyrier in ihren Sprachbezie hungen zu ital. und Griechen (Ilirët në marrëdhëniet gjuhësore me italishten dhe Grekët)

KRETSCHMER Paul -[Einleitung in die Geschichte der grieschichen Sprache] Hyrje në Historinë e gjuhës greke - Gottingen / 1896
-[Die tyrrhenischen Inschriften der stele von Lemnos] Mbishkrimet tirrene në stelën e Lemnosit / Glotta XXIX, 1942

KRISTOFORIDHI Konstandin (Elbasanasi)
[Dictionnaire albanais] Fjalorth i gjuhës shqipe

LIBRANDI V [Grammatica albanese con la poesia rare di Variboda] Gramatika shqiptare me poezi të rralla Varibodas - Milano / 1928

MANN SE [An historical albanian - english dictionary] Një fjalor historik anglisht - shqip London/1948
-An indo-european comparative dictionary - Hamburg - 1984

MAYER A Die Sprache der alten Illyrier] Gjuha e Ilirëve të lashtë, 1959

MEYER G [Albanesische studien] Studime shqiptare (plusieurs vol.) - Leipzig / 1883 - 97
-Etymologische wörterbuch der albanesischen sprache -Strasbourg 1891

MIKLOSICH Franz -[Le prefixe roman? ... en albanais] Parashtesa romake? ... në shqip - Extrait [Revue de linguistique et de philologie comparée] Revista gjuhësore e filologjisë krahasuese - Maisonneuve & Cie - Paris 1971.

MUSTILLI D [L'illiricita del popolo albanese] Të qenit ilir i popullit shqiptar - Rivista d'Albania, III/ I, 194)

PISANI Vittore [Parenté linguistique] Përafërsi gjuhësore - Lingua III - 1952

SANFELD [Linguistique balkanique] Gjuhësia ballkanike - Paris 1930

STUARTE E. MASON [A historical albanian - english dictionary] Fjalor historik shqip - anglisht - 1928

TAGLIAVINI C -[La lingua albanese - Studi albanesi] Gjuha Shqipe - Studime shqiptare V/VI
-[L'albanese di Dalmacia] Shqipja e Dalmacisë - Florence / 1937

THUNMANN J.G. (I.G.?)
[These sur l'origine illyrienne] Teza mbi zanafillën ilire - 1974 ?

TROMBETTI A -[La lingua etrusca] Gjuha etruske - 1928 -[Nuovi contributi alla solucioine del problema etrusco] Kontribute të reja për zgjidhjen e problemit etrusk (SE, IV) - 1930

VARIBODA Gramatica albanese (Gramatika shqipe) - Milano /1897

WHATMOUGH J [The Prae-Italic dialects of Italy] Dialektet para-italike të Italisë - 1933

WEIGANG G Jahresberichte des inst.fin die rumanische sprachforsch Balkan archiv/ 1924.





Perandoria e Aleksandrit dhe lëvizjet në masë dhe të fundit etnokulturore



Popujt pellazgë dhe ata të një trungu me atë



Hapësira gjeografike e zënë nga pellazgët e parë



Qendra e qytetërimeve danubiane



Sipas Georges Poisson - "Popullimi i Europës" - Payot 1939



Kafkë meolitike e Ofnet (Bavari).
Sipër, një brakicefal; poshtë një dolikocefal i tipit paleolitik



Shembuj të nënshtresës mesdhetare sipas A. Dauzat



Gjuha ibere dhe baske sipas A. Dauzat



Gjuhët kryesore
të Italisë në
Epokën e bronxit



Gjuha e Kaukazit
(sipas Xhon Geupel - Robert Lafont - 1971)

Përputhjet gjuhësore (toponimi dhe etni) Ballkan - Itali



(Sipas Zaklaria Majanit - Fundi i misterit etrusk - Maloine 1970)



• Koloni akene ▪ koloni joniane ○ koloni doriane



Greqia e shekullit V para Krishtit



Greqia stricto sensu dhe kolonitë e saj në shekullin V para Krishtit



Perandoria e Augustit në shekullin I para Krishtit

SHQIPERIA - harta administratave



SHQIPERIA -
harta ekonomike







Zona të ngjashme
(Greqi dhe Shqipëri)
që datojnë qysh nga
Epoka e Bronxit
e hershme dhe e mesme,
epoka e mbiquajtur
"mikeniane" Tumulus
me të shquarat në
Shqipëri:
Ivanaj, Belshani,
Kruma, Çinamaka, Laç, Bruc,
Klos, në Veri;
Peshtak, Kuç i Zi,
Vajza, Mashkullorë, në Jug.



ILIRËT
(Sipas "Ilirët" - vepër kolektive / Tirana 1985)

Harta e viseve
të Shqipërisë
sipas BARBARICH

Kufijtë e Shqipërisë;
Konferenca e Londrës
(12/1912 - 05/1913)



DAKË: populli autoktone
SERBË: populli emigrantësh

Shqiptarja, 1872
(pikturë nga Corot)
Muzeu i Artit, Bruklin

Mathju Aref ka lindur më 1 Mars 1930 në Kajro të Egjiptit, në një familje me origjinë shqiptare nga Mati. Prindërit e autorit rrjedhin nga dy familje të shquara që në kohën e Skënderbeut (Canameti, Stafa, Preni nga ana e babait dhe Lala, Kola, Lufi nga ana e nënës). Arrin ne Paris me 1961, për t'i kushtuar me pas 30 vjet të jetës së tij studimore dilemës së madhe rreth prejardhjes apo jo indo-evropiane te gjuhes dhe kombit shqiptar.

Perveç ketij libri të botuar ne vitin 2003, nje sukses tjetër i madh i autorit është edhe vepra "Greqia (Mikeanët = Pellazgët) ose zgjidhja e një enigme" (Paris 2004), teorinë e së cilës në vija të përgjithshme autori e parashtron edhe në këtë vëllim.

Ky libër do të befasojë shumë lexues.
Ai nuk nguron të ndërmarrë një qëndrim krejt të kundërt ndaj asaj, që, me sa duket, është një e vërtetë e ndërtuar. A mos ka qenë i mbivlerësuar vendi i Grekëve në historinë e Gadishullit Ballkanik dhe, me sa duket, vet-vetiu e pa nxjerrë pikëpyetje, ne jemi mësuar ta ngjisim deri në periudhën Mikeniane e madje edhe më tej dhe ta vendosim pothuajse natyrshëm si të ketë qenë faktori thelbësor i historisë së këtij rajoni?

Në këtë vepër, Mathieu Aref (Aref Mati)hulumton në një tjetër drejtim dhe ravijëzon një botë tjetër, atë Pellazge, së cilës Grekët i detyrohen për një pjesë jo të vogël të së kaluarës së tyre. Por kësaj here ajo nuk duhet kërkuar jashtë apo matanë deteve, ajo duhet të ketë qenë aty, në Ballkan, përpara Grekëve, dhe këtyre, kur mbërritën, nuk u mbeti gjë tjetër veçse të depërtonin e të merrnin atë çfarë ajo u ofronte.

Kuptohet që këta Grekë do ta kenë damkosur Herodotin për tradhti ndaj helenizmit dhe do ta kenë denoncuar për dashaligësinë e tij - gjë do të bëhet objekt i një trajtese të vogël të Plutarkut - e cila e shtyn atë të njohë cilësitë e barbarëve, dhe kjo, sipas atyre, i zhvlerëson bashkëpatriotët. Por Herodoti ka patur shumë të drejtë : Grekët nuk kanë qenë të parët mbi këtë tokë dhe, nëse ka patur të tjerë më parë, atëherë është më se e qartë se u detyrohen atyre për një pjesë të rëndësishme të qytetërimit.

Dominique BRIQUEL
Profesor në Universitetin e Sorbonës

ISBN 978-99943-903-9-7

Çmimi 1250 Lekë
10 €